

**XHAMI'US-SUNENI
I TIRMIDHIUT
جامع الترمذي**

VĚLLIMI II

Përktheu dhe përshtati nga gjuha boshnjake:

Nig'jar Bajrami Hoti

Përgatitja teknike dhe korrektura gjuhësore si
dhe krahasimi nga përkthimi në gjuhën angleze:

Dr. Ilir Hoti

[Hadithet janë të marr nga faqja <https://sunnah.com/tirmidhi>]

KAPITULLI MBI NAMAZIN (vazhdim)

كتاب الصلاة

Transmetuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

284. Mbi dy sehvi-sexhdet para selamit¹

باب مَا جَاءَ فِي سَجْدَتَيِ السُّهُورِ قَبْلَ السَّلَامِ

388. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, ai ka transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Abdurrahman el-A'rexhi, e ai nga Abdullah b. Buhajne el-Esdi, aleatit të Bennu Abdul-Muttal-libit – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është ngritur në namazin e drekës pa e bërë uljen (teshehudin e parë). Pasi që e përfundoi namazin, i bëri ulur dy sexhde para selamit, duke e shqiptuar tekbinin për çdo sexhde. Me të, në vend të teshehudit të harruar e bëri edhe xhemati.²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Abdurrahman b. Avfi.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ الْأَعْرَجِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ ابْنِ بُحَيْنَةَ الْأَسَدِيِّ، حَلِيفِ بْنِ عَبْدِ الْمُطَّلِبِ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَامَ فِي صَلَاةِ الظُّهْرِ وَعَلَيْهِ جُلُوسٌ فَلَمَّا أَتَمَّ صَلَاتَهُ سَجَدَ سَجْدَتَيْنِ يُكَبِّرُ فِي كُلِّ سَجْدَةٍ وَهُوَ جَالِسٌ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ وَسَجَدَهُمَا النَّاسُ مَعَهُ مَكَانَ مَا نَسِيَ مِنَ الْجُلُوسِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ .

389. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – ata i ka informuar Abdu-A'la dhe Ebu Davudi, ata i ka informuar Hishami, duke transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Muhammed b. Ibrahim – që Ebu Hurejre dhe Saib el-Kariu dy sexhde i kanë bërë, para selamit.

¹ Që të mos ketë ngatërime, këtu, nën nocionin dy sehvi-sehde mendohet në sehvi-sexhdet e zakonshme të ne, e cila përbëhet nga dy sexhde. Domethënë, nuk ka të bëjë me dy sehvi-sexhde nga dy sexhde por vetëm mbi njërin.

² Sipas mendimit të dijetarëve islam, janë katër situata, në të cilat bëhet sehvi-sexhde: a) Kur për shkak të harresës, shkurtohet namazi dhe, në vend të rekatit të tretë (të akshamit) ose të katërt (të drekës, ikindisë e të jacisë) selami jepet pas të dytës përkatësisht pas rekatit të tretë. Në situata të tilla, duhet falur numrin e lëshuar të rekateve dhe pastaj duhet bërë sehvi-sexhden. b) kur e shtojmë numrin e rekateve dhe në vend të dy rekateve, i falim tre ose, në vend të katër rekateve, pesë apo ngjashëm me këtë. Në situatë të tillë, sipas mendimit të disa dijetarëve, pas faljes së rekatit të tretë, përkatësisht të rekatit të pestë dhe selamit të dhënë, duhet bërë dy sexhde. Sipas mendimit të Ebu Hanifes, kemi për t'i falur edhe katër, përkatësisht rekatit e gjashtë dhe pas asaj kemi për ta lexuar Et-Tehijjatin, Salavatet, japim selam dhe i bëjmë dy sehvi-sexhde. c) Nëse lëshohet teshehudi i parë ose cilido tjetër vaxhib i namazit, sipas mendimit të Ebu Hanfes, përkatësisht sunnet i namazit sipas mendimit të dijetarëve të tjerë. d) Nëse jemi në dilemë duke mos e ditur sa rekate i kemi falur – se a e kemi falur për shembull një apo dy, tre apo katër rekate, përherë duhet ta marrim atë në çfarë jemi të sigurtë, e kjo është: që kemi falur numër të vogël të rekateve. Nëse është dilema një ose dy, ne do ta marrim që e kemi falur një rekat, mandej i shtojmë duke u falur edhe numrin e rekateve që na kanë mbetur dhe i bëjmë dy sehvi-sexhde.

Ebu Isai thotë: “Hadithi i Ibn Buhajnes është hasen.³ Sipas këtij, kanë vepruar disa dijetarë. Kështu është qëndrimi i Shafiut, i cili konsideron që çdo sehvi-sexhde duhet bërë para selamit. Ai thotë: “Ky hadith është derogues për hadithet e tjera, mbi këtë temë.” – dhe thekson, që praktika e fundit e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë e këtillë.”

Ahmedi dhe Is’haku thonë: “Në rast se personi ngrihet drejtpërdrejt pas dy rekateve, duhet t’i bëjë dy sehvi-sexhde para selamit, duke vepruar sipas hadithit të Buhajnes.”

Ebu Isai, thotë: “Abdullah b. Buhajne është Abdullah b. Malik b. Buhajne. Maliku është i ati, ndërsa Behajne është nëna e tij. Kështu më ka informuar Is’hak b. Mensuri, duke transmetuar nga Ali b. Medini.”

Dijetarët nuk janë të një mendimi, në pikëpamje të dy sehvi-sexhdeve, se a bëhen ato, para dhënies së selamit, apo pas dhënies së selamit. Disa konsiderojnë, që duhet bërë pas selamit. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe i dijetarëve të Kufas. Disa thonë, se ato duhet bërë, para selamit. Kështu mendojnë, shumica e fakihëve medinas, siç është Jahja b. Seidi, Rebiu dhe të tjerët. Ky qëndrim është edhe i Shafiut. Disa thonë: “Në rast se diç shton në namaz, sehvi-sexhdet duhet bërë pas selamit. Por nëse diç i ikën nga namazi, ato duhet bërë para selamit.” Ky është qëndrimi i Malik b. Enesit.

Ahmedi, thotë: “Të gjitha, që transmetohen, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi dy sehvi-sexhdet, do të aplikohen mbi çështjet mbi të cilat flasin ato hadithe.” Ai konsideron, që ai i cili ngrihet pas dy rekateve (duke mos e bërë teshehudin e parë), në pajtim me hadithin e Buhajnes, sehvi-sexhdet ka për t’i bërë para selamit. Ndërsa, në rast se ndokush (në vend të katër rekateve) i falë pesë rekate të namazit të drekës, ai sehvi-sexhden ka për ta bërë pas selamit. Ndërkaq, në rast se ndokush gjatë namazit të drekës apo të ikindisë jep selam pas dy rekateve, sehvi-sexhdet (gjithashtu) ka për t’i bërë pas selamit. Pra, çdo transmetim aplikohet për situatën mbi të cilën flitet. Për çdo situatë, mbi të cilën, nga i Dërguari nuk është përmendur asgjë, kanë për t’u bërë dy sehvi-sexhde para selamit. Qëndrimi i Is’hakut, është i ngjashëm, me qëndrimin e Ahmedit, përveç që ai konsideron, që për situatë të harresës, mbi të cilën nuk ka transmetim të veçantë nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në rast se ka të bëjë me ndonjë shtesë në namaz, dy sehvi-sexhde duhet bërë pas selamit, ndërsa nëse ka të bëjë me ndonjë lëshim, atëherë ato duhet bërë para selamit.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْأَعْلَى، وَأَبُو دَاوُدَ قَالَ حَدَّثَنَا هِشَامٌ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ، أَنَّ أَبَا هُرَيْرَةَ، وَالسَّائِبَ الْقَارِيَّ، كَانَا يَسْجُدَانِ سَجْدَتَيِ السُّهُورِ قَبْلَ التَّسْلِيمِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ بُحَيْنَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ يَرَى سُجُودَ السُّهُورِ كُلَّهُ قَبْلَ السَّلَامِ وَيَقُولُ هَذَا النَّاسُ لِغَيْرِهِ مِنَ الْأَحَادِيثِ وَيَذْكُرُ أَنَّ آخَرَ فِعْلِ النَّبِيِّ ﷺ كَانَ عَلَى هَذَا . وَقَالَ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ إِذَا قَامَ الرَّجُلُ فِي الرَّكَعَتَيْنِ فَإِنَّهُ يَسْجُدُ سَجْدَتَيِ السُّهُورِ قَبْلَ السَّلَامِ عَلَى حَدِيثِ ابْنِ بُحَيْنَةَ . وَعَنْ عَبْدِ اللَّهِ ابْنِ بُحَيْنَةَ هُوَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مَالِكٍ وَهُوَ ابْنُ بُحَيْنَةَ مَالِكُ أَبُوهُ وَبُحَيْنَةُ أُمُّهُ . هَكَذَا أَخْبَرَنِي إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ عَنْ عَلِيِّ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْمَدِينِيِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي سَجْدَتَيِ السُّهُورِ مَتَى يَسْجُدُهُمَا الرَّجُلُ قَبْلَ السَّلَامِ أَوْ بَعْدَهُ فَرَأَى بَعْضُهُمْ أَنَّ يَسْجُدُهُمَا بَعْدَ السَّلَامِ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ يَسْجُدُهُمَا قَبْلَ السَّلَامِ . وَهُوَ قَوْلُ أَكْثَرِ الْفُقَهَاءِ مِنْ أَهْلِ الْمَدِينَةِ مِثْلَ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ وَرَبِيعَةَ وَغَيْرِهِمَا وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا كَانَتْ زِيَادَةٌ فِي الصَّلَاةِ قَبْعَدَ السَّلَامِ وَإِذَا كَانَ نُقْصَانًا فَقَبْلَ السَّلَامِ . وَهُوَ قَوْلُ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ . وَقَالَ أَحْمَدُ مَا رَوَى عَنْ النَّبِيِّ ﷺ فِي سَجْدَتَيِ السُّهُورِ فَيُسْتَعْمَلُ كُلُّ عَلَى جِهَتِهِ يَرَى إِذَا قَامَ فِي الرَّكَعَتَيْنِ عَلَى حَدِيثِ ابْنِ بُحَيْنَةَ فَإِنَّهُ يَسْجُدُهُمَا قَبْلَ السَّلَامِ وَإِذَا صَلَّى الظُّهْرَ خُمُسًا فَإِنَّهُ يَسْجُدُهُمَا بَعْدَ السَّلَامِ وَإِذَا سَلَّمَ فِي الرَّكَعَتَيْنِ مِنَ الظُّهْرِ وَالْعَصْرِ فَإِنَّهُ يَسْجُدُهُمَا بَعْدَ السَّلَامِ وَكُلُّ يُسْتَعْمَلُ عَلَى جِهَتِهِ . وَكُلُّ سُهُورٍ لَيْسَ فِيهِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ ذِكْرٌ فَإِنَّ سَجْدَتَيِ السُّهُورِ قَبْلَ السَّلَامِ . وَقَالَ إِسْحَاقُ نَحْوُ قَوْلِ أَحْمَدَ فِي هَذَا كُلِّهِ إِلَّا أَنَّهُ قَالَ كُلُّ سُهُورٍ لَيْسَ فِيهِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ ذِكْرٌ فَإِنَّ كَانَتْ زِيَادَةٌ فِي الصَّلَاةِ يَسْجُدُهُمَا بَعْدَ السَّلَامِ وَإِنْ كَانَ نُقْصَانًا يَسْجُدُهُمَا قَبْلَ السَّلَامِ .

³ Përveç Tirmidhiut, atë e kanë shënuar edhe Buhariu dhe Muslimi në Sahihun, çka tregon se është i besueshëm.

285. Mbi dy sehvi-sexhde pas selamit dhe të biseduarit

بَاب مَا جَاءَ فِي سَجْدَتِي السُّهُو بَعْدَ السَّلَامِ وَالْكَلَامِ

390. Na ka treguar Is'hak b. Mensuri – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdiu, atë Shu'be, duke transmetuar nga Hakemi, ai nga Ibrahim, ai nga Alkami – që Abdullah b. Mes'udi ka thënë: “Me një rast, i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë namazit të drekës i falë pesë rekate, atij i është thënë: “Vallë, a është shtuar numri (i rekateve) në namaz, apo ke harruar?” Ai, pastaj i bëri dy sexhde pasi që dha selam.”⁴

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁵

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ الْحَكَمِ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ عَلْقَمَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى الظُّهْرَ خَمْسًا فَقِيلَ لَهُ أَزِيدَ فِي الصَّلَاةِ سَجْدَتَيْنِ بَعْدَ مَا سَلَّمَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

391. Na kanë treguar Hennadi dhe Muhammet b. Gajlani – ata i ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga A'meshi, ai nga Ibrahim, ai nga Alkami – që Abdullahu ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka bërë dy sehvi-sexhde pas bisedës.”⁶

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Muaviu, Abdullah b. Xha'feri dhe Ebu Hurejre.”

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، وَمُحَمَّدُ بْنُ عِزَّانٍ، قَالَا حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ عَلْقَمَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ سَجَدَ سَجْدَتَيْنِ السُّهُو بَعْدَ الْكَلَامِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ مُعَاوِيَةَ وَ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ جَعْفَرٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ .

392. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, duke transmetuar nga Hisham b. Hasani, ai nga Muhammed b. Sirini, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i ka bërë dy sexhde pas selamit.

⁴ Në hadithin e kapitullit të mëparshëm qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), dy sehvi-sexhde i ka bërë para se me dhënë selam. Hadithet nga ky kapitull, tregojnë që ai sehvi-sexhde i ka bërë pas dhënies së selamit. Nga kjo rrjedhin qëndrimet e ndryshme të dijetarëve mbi atë se a duhet bërë sehvi-sexhde para apo pas dhënies së selamit. Ebu Hurejre, Mekhuli, Zuhriu, Jahja b. Seid el-Ensari, Evzaiu, Lejth b. Sadi, Shafi'u dhe dijetarët e Shomit konsiderojnë që sehvi-sexhde përherë duhet bërë para selamit. Ata, qëndrimin e tillë, e bazojnë mbi hadithin e Ibn Buhajnes nga kapitulli i mëparshëm.

Shafi'u pohon, që me këtë hadith janë deroguar të gjitha hadithet, në të cilët tregohet, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), sehvi-sexhde i ka bërë pas selamit.

Ali b. Ebu Talibi, Sa'd b. Ebu Vekkasi, Hasan el-Basri, Ibrahim en-Nehai, Abdurrahman b. Ebu Lejl, Eth-Thevriu, Ebu Hanife dhe dijetarët e tjerë kufjanë, konsiderojnë, që sehvi-sexhden duhet bërë pas dhënies së selamit. Ata, qëndrimin e vet e mbështesin mbi hadithet nga ky kapitull.

Malik b. Enesi, Ebu Thevriu dhe El-Muzeni, konsiderojnë, që nëse bëhet ndonjë lëshim gjatë namazit, sehvi-sexhden duhet bërë para selamit, ndërsa pas selamit kur i shtohet diç namazit. Sipas mendimit të Ibn Abdul Berras, kjo është më e pranueshme, sepse me të arrihet kompromisi, në mes të haditheve të ndryshme mbi këtë çështje.

⁵ Shënohet edhe në *Kutubus-sitte*.

⁶ Në transmetimin e këtij hadithi të Buhariut qëndron se: “Me një rast i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i ka falur pesë rekate. Pasi që dha selam, i është thënë: “Vallë, a është shtuar numri i rekateve në namaz?” “Çfarë ashtu?” – pyeti ai. “I fale pesë rekate.” – u përgjigjën të pranishmit. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i bëri dy sehvi-sexhde, pasi që tani kishte dhënë selam.” Në bazë të këtij hadithi, shumica e dijetarëve konsideron se namazin nuk e ka të prishur personi i cili duke harruar i falë pesë rekate, madje as atëherë nëse pas rekatis të katërt nuk e bënë teshehudin – uljen e fundit. Me atë nuk pajtohet Ebu Hanife. Ai konsideron se namazi është i prishur dhe që duhet përsëritur, në rast se nuk i bëhet teshehudi pas rekatis të katërt. Sipas tij, sehvi-sexhdja për atë i cili duke harruar ngrihet në rekatin e pestë, vlen vetëm nëse ngrihet pas teshehudit.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Atë e kanë transmetuar, Ejubi dhe të tjerët nga Ibn Sirini.”

Hadithi i Ibn Mes’udit, është hasen-sahih. Sipas tij, veprojnë disa nga dijetarët. Ata thonë: “Në rast se personi, në drekë i falë pesë rekate, namazin e ka në rregull, ka për t’i bërë dy sehvi-sexhde, edhe pse nuk është ulur pas rekatit të katërt. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.

Disa thonë: “Nëse ndokush, në drekë i falë pesë rekate, e nuk ulet pas rekatit të katërt për ta thënë (Et-Tehijatin), namazin e ka të prishur.” Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe i disa dijetarëve të Kufasë.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، عَنْ هِشَامِ بْنِ حَسَّانَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ سَجَدَهُمَا بَعْدَ السَّلَامِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَاهُ أَيُّوبُ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ ابْنِ سِيرِينَ . وَحَدِيثُ ابْنِ مَسْعُودٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ قَالُوا إِذَا صَلَّى الرَّجُلُ الظُّهْرَ خَمْسًا فَصَلَاتُهُ جَائِزَةٌ وَسَجْدَتَايِ السُّهُوِّ وَإِنْ لَمْ يَجْلِسْ فِي الرَّابِعَةِ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا صَلَّى الظُّهْرَ خَمْسًا وَلَمْ يَقْعُدْ فِي الرَّابِعَةِ مَقْدَارَ التَّسْبِيحِ فَسَدَتْ صَلَاتُهُ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَبَعْضِ أَهْلِ الْكُوفَةِ .

286. Mbi teshehudin⁷ pas sexhdeve të kryera

باب مَا جَاءَ فِي التَّسْبِيحِ فِي سَجْدَتَيِ السُّهُوِّ

393. Na ka treguar Muhammed b. Jahja – atë e ka informuar Muhammed b. Abdullah el-Ensari, atë Esh’asi⁸, duke transmetuar nga Ibn Sirini⁹, ai nga Halid el-Hazaiu, ai nga Muhel-lebi – që Imran b. Husejni ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, duke u falur si imam, kishte harruar diç, i bëri dy sehvi-sexhde. Pastaj (përsëri) bëri teshehud dhe, dha salam.”¹⁰

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.¹¹ Ibn Sirini, nga Ebu Muhel-lebi, ndërsa ai është xhaxhai i Ebu Kilabes, ka transmetuar edhe hadithe të tjera. Këtë hadith, Muhammedi e ka transmetuar nga Halid el-Hazali, ai nga Ebu Kilabi, ndërsa ai nga Ebu Muhel-lebi. Emri i Ebu Muhel-lebit është Abdurrahman b. Amër, gjithashtu thuhet edhe Muavi b. Amër. Abdulvehab es-Sekafi, Hushejm dhe shumë të tjerë, këtë hadith në tërësi e kanë transmetuar nga Halid el-Hazai, ai nga Ebu Kilabe, e ky në të vërtetë është hadithi i Imran b. Husajnit, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) e ka falur ikindinë tre rekate (dhe ka shkuar) dhe ishte ngritur një njeri me emrin Harbak.”¹²

⁷ Këtu, nën kuptimin teshehut, mendohet në uljen në namaz, në të cilën recitohet Et-Tehijati, salavati dhe duatë deri te selami.

⁸ Esh’as b. Abdulmeliku, është ravi i besueshëm dhe njohës i madh i të drejtës sheriatike.

⁹ Muhammed b. Sirin el-Basriu, është tabi’in. Vlerësohet si ravi jashtëzakonisht i besueshëm, njeri i devotshëm dhe studiues i shkëlqyeshëm. I takon gjeneratës së tretë të ravive. Ai konsideron se hadithet nuk mund të transmetohen sipas kuptimit.

¹⁰ Studijuesit e shkollës së drejtësisë hanefite, në lidhje me këtë hadith, kanë marr qëndrim që, pas bërjes së sehvi-sexhdes, duhet prapë të bëhet teshehudi, recitimi i Et-Tehijatit, Salavatet, Duaja dhe dhënia e selamit.

¹¹ Shënon Ebu Davudi në *Sunen*, Ibn Hibani në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*. Hakimi konsideron, që ky hadith është i besueshëm sipas kriterëve të Buhariut dhe Muslimit. Ibn Abdulberri dhe Bejhekiu e vlerësojnë të dobët.

¹² Muslimi, në Sahih, ka shënuar prej Ibrahim b. Husejnit, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, duke e falur ikindinë, ka dhënë salam pas rekatit të tretë, pastaj ka hyrë në dhomën e vet. Është ngritur një njeri me emrin Harbak, shkoi dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, ti i fale vetëm tre rekate!” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), doli i zemëruar duke e tërhequr pelerinën, erdhi në mesin e as’habëve të pranishëm dhe pyeti: “A është e vërtetë çfarë thotë ky?” “Po.” – u përgjigjën të pranishmit. Ai, atëherë e fali edhe një rekat dha salam dhe i bëri dy sehvi-sexhde dhe përsëri dha salam. Këtë hadith, si bazë

Dijetarët, janë ndarë në pikëpamje të teshehudit të drekës, pasi që bëhen dy sehvi-sexhde. Disa prej tyre konsiderojnë, që pas tyre duhet përsëri të bëhet teshehudi dhe të jepet selami. Disa konsiderojnë, që nuk është e nevojshme bërja e sërishme e teshehudit. Në rast se, sehvi-sexhdet bëhen para selamit, nuk është e nevojshme përsëritja e teshehudit. Ky është mendimi i Ahmedit dhe Is'hakut, të cilët thonë: “Në rast se, ndokush i bënë sehvi-sexhdet para selamit, nuk ka nevojë për ta bërë përsëri teshehudin.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَحْيَى النَّيْسَابُورِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الْأَنْصَارِيُّ، قَالَ أَخْبَرَنِي أَشْعَثُ، عَنْ ابْنِ سِيرِينَ، عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ، عَنْ أَبِي قِلَابَةَ، عَنْ أَبِي الْمُهَلَّبِ، عَنْ عُمَرَ بْنِ حُصَيْنٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى بِهِمْ فَسَجَدَ فَسَجَدَتَيْنِ ثُمَّ تَشَهَّدَ ثُمَّ سَلَّمَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَرَوَى مُحَمَّدُ بْنُ سِيرِينَ عَنْ أَبِي الْمُهَلَّبِ وَهُوَ عَنْ أَبِي قِلَابَةَ غَيْرَ هَذَا الْحَدِيثِ . وَرَوَى مُحَمَّدُ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ عَنْ أَبِي قِلَابَةَ عَنْ أَبِي الْمُهَلَّبِ . وَأَبُو الْمُهَلَّبِ اسْمُهُ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ عَمْرِو وَيُقَالُ أَيْضًا مُعَاوِيَةُ بْنُ عَمْرِو . وَقَدْ رَوَى عَبْدُ الْوَهَّابِ النَّخَعِيُّ وَهُشَيْمٌ وَغَيْرُ وَاحِدٍ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ عَنْ أَبِي قِلَابَةَ بِطَوِيلٍ وَهُوَ حَدِيثُ عُمَرَ بْنِ حُصَيْنٍ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ سَلَّمَ فِي ثَلَاثِ رَكَعَاتٍ مِنَ الْعَصْرِ فَقَامَ رَجُلٌ يُقَالُ لَهُ الْخَزْبَائِيُّ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي التَّشَهُّدِ فِي سَجْدَتِي السَّهْوِ فَقَالَ بَعْضُهُمْ يَتَشَهَّدُ فِيهِمَا وَيُسَلِّمُ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ لَيْسَ فِيهِمَا تَشَهُّدٌ وَتَسْلِيمٌ وَإِذَا سَجَدَهُمَا قَبْلَ السَّلَامِ لَمْ يَتَشَهَّدُ . وَهُوَ قَوْلُ أَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ قَالَا إِذَا سَجَدَ سَجْدَتِي السَّهْوِ قَبْلَ السَّلَامِ لَمْ يَتَشَهَّدُ .

287. Mbi atë, i cili është në dilemë, se a ka falur më tepër ose më pak rekate

باب مَا جَاءَ فِي الرَّجُلِ يُصَلِّي فَيَشُكُّ فِي الزِّيَادَةِ وَالنَّقْصَانِ

394. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ismail b. Ibrahim, atë Hisham ed-Destevejaj, ai ka transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri – që Ijad b. Hilali ka thënë: “I thash Ebu Seidit: ‘Ndonjëherë ndodh, që ndokush nga ne të mos e di se si është falur (dhe sa ka falur).’ Ai tha: “I Dërguari i Allahut ka thënë: ‘Kur ndokush prej jush falet, e nuk e di se sa rekate i ka falur, derisa është ende ulur, le t’i bëjë dy sexhde.’”¹³

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Uthmani, Ibn Mes’udi, Aishja dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Ebu Seidit është hasen.¹⁴ Ky hadith është transmetuar nga Ebu Seidi edhe në versione të tjera.”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Kur ndokush nga ju mund të jetë në dilemë, se ai ka falur një rekat, dy apo tre rekate, le të merr që ka falur dy dhe në atë situatë le t’i bëjë dy sexhde para dhënies së selamit.” Sipas këtij hadithi veprojnë dijetarët e hadithit.

Disa dijetarë thonë: “Kush gjatë namazit bie në dilemë, duke mos e ditur se sa (rekate) i ka falur, le ta përsëritë namazin.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، حَدَّثَنَا هِشَامُ الدَّسْتَوَائِيُّ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ عِيَاضِ بْنِ يَعْنَى ابْنِ هِلَالٍ، قَالَ قُلْتُ لِأَبِي سَعِيدٍ أَخَذْنَا بِصَلَاتِي فَلَا يَذُرِي كَيْفَ صَلَّيْتُ فَقَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا صَلَّيْتُ أَحَدُكُمْ فَلَمْ يَذُرْ كَيْفَ صَلَّيْتُ فَلْيَسْجُدْ سَجْدَتَيْنِ وَهُوَ جَالِسٌ

për qëndrimin e vet, e merrnin ata të cilët konsiderojnë, që nuk është e nevojshme pas sehvi-sexhdeve të bërit e teshehudit përsëri. Sipas tyre, mjafton vetëm dhënia e selamit. Të gjitha këto divergjenca, në mes dijetarëve, përkohet me atë, që sehvi-sexhdet i bënë pas dhënies së selamit. Sa i përket atij që sehvi-sexhdet i bën para dhënies së selamit – gati të gjithë janë të pajtimit, se nuk është e nevojshëm teshehudi i sërishëm dhe këndimi i Et-Tehijjat-it, Salavateve dhe duave.

¹³ Muslimi, në *Sahih*, shënon, që Ebu Seid el-Hudriu ka treguar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush vjen në dilemë, ashtu, që nuk di se a i ka falur tri apo katër rekate – le ta hudh dyshimin dhe t’i përmbahet asaj në çka është i sigurtë. Pastaj, le të bëjë dy sexhde para se të jap selam.”

¹⁴ E shënojnë, Muslimi në *Sahih*, me sened tërësisht të ndryshëm, edhe Ebu Davudi në *Sunen*, si dhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned*.

" . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُثْمَانَ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَعَائِشَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " إِذَا شَكَ أَحَدُكُمْ فِي الْوَاحِدَةِ وَالثَّانِيَةِ فَلْيَجْعَلْهُمَا وَاحِدَةً وَإِذَا شَكَ فِي الثَّانِيَةِ وَالثَّلَاثِ فَلْيَجْعَلْهُمَا ثِنْتَيْنِ وَيَسْجُدْ فِي ذَلِكَ سَجْدَتَيْنِ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ " . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَصْحَابِنَا . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِذَا شَكَ فِي صَلَاتِهِ فَلَمْ يَدْرِ كَمْ صَلَّى فَلْيُعِدْ .

395. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Vjen shejtani te ndonjëri prej jush, derisa është në namaz, dhe i futë ngatërresë, ashtu që nuk e di se sa ka falur. Kur ndokush nga ju gjendet në situatë të tillë, derisa është ulur, le t’i bëjë dy sexhde.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹⁵

396. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Muhammed b. Halid b. Asme, atë Ibrahim b. Sa’di, atë Muhammed b. Is’haku, duke transmetuar nga Mekhuli, ai nga Kurejbe, ai nga Ibn Abbasi – që Abdurrahman b. Avfi ka thënë:

E kam dëgjuar të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Në rast se ndokush nga ju harron gjatë namazit dhe nuk e di se a e ka falur një apo dy (rekate), le të merr që e ka falur një rekat. Në rast se, nuk e di se a i ka falur dy apo tre rekate, le të merr, që i ka falur dy rekate. Po, në rast se nuk e di, se a i ka falur tre apo katër rekate, le ta merr që i ka falur tre dhe le t’i bëjë dy sehvi-sexhde para selamit.”¹⁶

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹⁷ Ky hadith nga Abdurrahman b. Avfi është i transmetuar me një rrugë tjetër. Atë e ka transmetuar Zuhri nga Ubejdullah b. Abdullah b. Atbe, ai nga Ibn Abbasi, ai nga Abdurrahman b. Avfi, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). ”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ خَالِدٍ ابْنُ عُثْمَةَ الْبَصْرِيِّ، حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ سَعْدٍ، قَالَ حَدَّثَنِي مُحَمَّدُ بْنُ إِسْحَاقَ، عَنْ مَكْحُولٍ، عَنْ كُرَيْبٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ، قَالَ سَمِعْتُ النَّبِيَّ ﷺ يَقُولُ إِذَا سَهَا أَحَدُكُمْ فِي صَلَاتِهِ فَلَمْ يَدْرِ وَاحِدَةً صَلَّى أَوْ ثِنْتَيْنِ فَلْيُبْنِ عَلَى وَاحِدَةٍ فَإِنْ لَمْ يَدْرِ ثِنْتَيْنِ صَلَّى أَوْ ثَلَاثًا فَلْيُبْنِ عَلَى ثِنْتَيْنِ فَإِنْ لَمْ يَدْرِ ثَلَاثًا صَلَّى أَوْ أَرْبَعًا فَلْيُبْنِ عَلَى ثَلَاثٍ وَلْيَسْجُدْ سَجْدَتَيْنِ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ رَوَاهُ الزُّهْرِيُّ عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ .

¹⁵ E shënojnë në *El-Kutubus-sitte*.

¹⁶ Në bazë të haditheve të lartpërmendura, shumica e ulemasë, konsideron, se personi tek i cili gjatë namazit shfaqet dilema duke mos e ditur se sa rekate i ka falur, përherë duhet t’i mbahet asaj që është më e sigurtë, e kjo është, që ka falur numër më të vogël të rekateve. Nëse ndokush, do të jetë në dilemë se a e ka falur një apo dy rekate, ai ka për të marr se e ka falur një rekat, mandej ka për t’i falur rekatet e mbetura dhe para se të jep selam, ka për t’i bërë dy sehvi-sexhde. Në të njëjtën mënyrë, ka për të vepruar, kur është në dilemë se a i ka falur dy apo tre rekate, përkatësisht tre apo katër rekate. Ebu Hanife, konsideron, se tek personi tek i cili kjo dilemë shfaqet për herë të parë, duhet ta përsërisë namazin. Ndërkaq, nëse tek ai ato dilema shfaqen shpesh, atëherë ai duhet të veprojë, ashtu siç konsiderojnë shumica e dijetarëve. Ndërsa, disa dijetarë, konsiderojnë se ai i cili gjendet në situatë të tillë, çdoherë duhet ta përsërisë namazin, pa e pasur parasysh se a i shfaqen dilemat e tilla shpesh apo rrallëherë. Qëndrimin e këtillë e mbështesin mbi disa hadithe të dobëta, andaj ai konsiderohet i pabazë.

¹⁷ Përveç Tirmidhiut, e shënon Ahmed b. Hanbeli në *Musned*.

288. Mbi personin i cili në namazin e drekës dhe të ikindisë jep salam pas dy rekateve

باب مَا جَاءَ فِي الرَّجُلِ يُسَلِّمُ فِي الرَّكَعَتَيْنِ مِنَ الظُّهْرِ وَالْعَصْرِ

397. Na ka treguar El-Ensari – atë e ka informuar Ma’ni, atë Maliku, duke transmetuar nga Ejub b. Ebu Temim es-Sahtijani, ai nga Muhammed b. Sirini – që Ebu Hurejre ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast ka dhënë salam pas dy rekateve dhe Dhul-Jedejni¹⁸ i ka thënë: ‘Vallë, a është shkurtuar namazi, apo ke harruar, o i Dërguar i Allahut?’ ‘A është e vërtetë kjo, që është duke e thënë Dhul-Jedejni?’ – pyeti i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). “Është.” – u përgjigjën të pranishmit. Atëherë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) u ngrit, i fali dy rekatet e duhura dhe dha salam. Pastaj e shqiptoi tekbirin, bëri edhe një sexhde të ngjashme me të mëparshmen ose më të gjatë.”¹⁹

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Imran b. Husejni, Ibn Umeri dhe Dhul-Jedejni. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²⁰

Dijetarët janë ndarë, në pikëpamje të këtij hadithi. Disa dijetarë Kufjanë thonë: “Nëse ndokush nga harresa, padituria, apo për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, flet gjatë namazit – është i obliguar ta përsërisë namazin. Ata argumentojnë, që ky hadith ka pasuar para se të ndalohej të folurit në namaz.”

Shafiu konsideron, që ky hadith është i besueshëm dhe që qëndrimi i tij është në pajtim me të.

Ai thotë: “Ky hadith është më i besueshëm sesa hadithi i cili është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbi agjëruetin i cili ha diç nga harresa. Ai nuk do ta kompensojë (atë ditë), e tilla trajtohet si dhuratë me të cilën e ka furnizuar Allahu i Madhëruar. Edhe këta, në bazë të haditheve të Ebu Hurejres, kur është fjala mbi ushqimin e agjëruetit, bëjnë dallim nga të ngrënit e qëllimshëm, dhe të ngrënit nga harresa.”

Ahmedi thotë: “Sipas hadithit të Ebu Hurejres – në rast se gjatë namazit flet imami, duke qenë i bindur, që e ka kryer namazin, pastaj e kupton që nuk e ka kryer – ai vetëm ka për ta vazhduar atë, derisa ai, i cili falet pas imamit, në rast se flet ndërsa e di që ende nuk ka përfunduar namazi, është i obliguar ta përsëritë namazin.” Si argument për të, ai cekë që farzet gjatë të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), janë shtuar dhe janë zvogëluar. Dhul-Jedejni ka folur, sepse ka qenë i bindur, që namazi ka qenë i përfunduar. Ndërkaq, sot ajo nuk vlenë. Sot, askush nuk mund të flas në atë kuptim, në të cilin ka folur Dhul-Jedejni, sepse farzet më, as nuk shtohen e as nuk pakësohen. Për shembull, Ahmedi e ka shqiptuar këtë qëndrim. Is’haku mbi këtë temë ka thënë ngjashëm me atë, që ka thënë Ahmedi.

¹⁸ Emri i Dhul-Jedejnit është Harbak, ndërsa pseudonimi i tij sipas fëmijës, siç pohon Neveviu, Ebu Urajn. Ai ka jetuar pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Disa e kundërshtonin rrëfimin e Ebu Hurejres mbi intervenimin e Dhul-Jedejnit bërë të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të përmendur në hadithin e cekur, duke pohuar se Dhul-Jedejni ka vdekur në Betejën e Bedrit vitin 2 hixhri, derisa Ebu Hurejre ka ardhur në Medinë në vitin 7 hixhri. Ndërkaq, të gjithë ekspertët eminentë, të hadithit dhe hafidhët, përveç Zuhriut, konsiderojnë se në Bedër ka vdekur Umejr b. Amër el-Huzai, i njohur si Zush-Shimalejn, e jo Dhul-Jedejn.

¹⁹ Nga transmetimi i Buhariut, të këtij hadithi, kuptojmë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke e falur drekën ka dhënë salam pas dy rekateve. Në këtë hadith, e kanë mbështetur qëndrimin e tyre, dijetarët, të cilët konsiderojnë, që personi i cili jep salam nga harresa, pas rekatit të dytë në farzet katër rekatësh, nuk duhet të përsërisë namazin. Është e mjaftueshme që t’i falë dy rekatet e mbetura dhe pas tyre t’i bëjë dy sexhde.

²⁰ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

حَدَّثَنَا الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنٌ، حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ أَيُّوبَ بْنِ أَبِي تَمِيمَةَ، وَهُوَ أَيُّوبُ السَّخْتِيَانِيُّ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ انْصَرَفَ مِنَ اثْنَتَيْنِ فَقَالَ لَهُ دُو الْيَدَيْنِ أَفْصَرْتَ الصَّلَاةَ أَمْ نَسِيتَ يَا رَسُولَ اللَّهِ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ أَصَدَقَ دُو الْيَدَيْنِ " . فَقَالَ النَّاسُ نَعَمْ . فَقَامَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَصَلَّى اثْنَتَيْنِ أُخْرَيْنِ ثُمَّ سَلَّمَ ثُمَّ كَبَّرَ فَسَجَدَ مِثْلَ سُجُودِهِ أَوْ أَطْوَلَ ثُمَّ كَبَّرَ فَرَفَعَ ثُمَّ سَجَدَ مِثْلَ سُجُودِهِ أَوْ أَطْوَلَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ بْنِ حُصَيْنٍ وَابْنِ عُمَرَ وَذِي الْيَدَيْنِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي هَذَا الْحَدِيثِ فَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْكُوفَةِ إِذَا تَكَلَّمَ فِي الصَّلَاةِ نَاسِيًا أَوْ جَاهِلًا أَوْ مَا كَانَ فَإِنَّهُ يُعِيدُ الصَّلَاةَ وَاعْتَلَوْا بِأَنَّ هَذَا الْحَدِيثَ كَانَ قَبْلَ تَحْرِيمِ الْكَلَامِ فِي الصَّلَاةِ . قَالَ وَأَمَّا الشَّافِعِيُّ فَرَأَى هَذَا حَدِيثًا صَحِيحًا فَقَالَ بِهِ وَقَالَ هَذَا أَصَحُّ مِنَ الْحَدِيثِ الَّذِي رُوِيَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي الصَّلَاةِ إِذَا أَكَلَ نَاسِيًا فَإِنَّهُ لَا يَقْضِي وَإِنَّمَا هُوَ رَزَقٌ رَزَقَهُ اللَّهُ . قَالَ الشَّافِعِيُّ وَفَرَّقُوا هُؤُلَاءِ بَيْنَ الْعَمْدِ وَالنِّسْيَانِ فِي أَكْلِ الصَّلَاةِ بِحَدِيثِ أَبِي هُرَيْرَةَ . وَقَالَ أَحْمَدُ فِي حَدِيثِ أَبِي هُرَيْرَةَ إِنْ تَكَلَّمَ الْإِمَامُ فِي شَيْءٍ مِنْ صَلَاتِهِ وَهُوَ يَرَى أَنَّهُ قَدْ أَكْمَلَهَا ثُمَّ عَلِمَ أَنَّهُ لَمْ يُكْمِلْهَا يُبَيِّنُ صَلَاتَهُ وَمَنْ تَكَلَّمَ خَلْفَ الْإِمَامِ وَهُوَ يَعْلَمُ أَنَّ عَلَيْهِ بَقِيَّةً مِنَ الصَّلَاةِ فَعَلَيْهِ أَنْ يَسْتَقْبِلَهَا . وَاجْتَنَبَ بِأَنَّ الْفَرَائِضَ كَانَتْ تُزَادُ وَتُنْقُصُ عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَإِنَّمَا تَكَلَّمَ دُو الْيَدَيْنِ وَهُوَ عَلَى يَقِينٍ مِنْ صَلَاتِهِ أَنَّهَا تَمَّتْ وَلَيْسَ هَكَذَا الْيَوْمَ لَيْسَ لِأَحَدٍ أَنْ يَتَكَلَّمَ عَلَى مَعْنَى مَا تَكَلَّمَ دُو الْيَدَيْنِ لِأَنَّ الْفَرَائِضَ الْيَوْمَ لَا يَزَادُ فِيهَا وَلَا يُنْقُصُ . قَالَ أَحْمَدُ تَحَوَّا مِنْ هَذَا الْكَلَامِ . وَقَالَ إِسْحَاقُ نَحْوُ قَوْلِ أَحْمَدَ فِي الْبَابِ .

289. Mbi faljen e namazit mbi të mathura (sandale)

باب ما جاء في الصَّلَاةِ فِي النَّعَالِ

398. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ismail b. Ibrahim – që Seid b. Jezid Ebu Seleme²¹ ka thënë: “I kam thënë Enes b. Malikut: “A është falur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me të mbathurat?” “Po.” – tha ai.”²²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Mes’udi, Abdullah b. Ebu Habibe, Abdullah b. Amri, Amër b. Hurejthi, Shidad b. Evsi, njeriut nga fisi Benu Shejbe. Hadithi i Enesit është hasen-sahih.”²³ Dijetarët veprojnë në pajtim me këtë (hadith).”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ يَزِيدَ أَبِي مَسْلَمَةَ، قَالَ قُلْتُ لِأَنَسِ بْنِ مَالِكٍ أَكَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يُصَلِّي فِي نَعْلَيْهِ قَالَ نَعَمْ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي حَبِيبَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ وَعُمَرُو بْنُ حُرَيْثٍ وَشَدَّادُ بْنُ أَوْسٍ وَأَوْسُ الثَّقَفِيِّ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَطَاءُ رَجُلٍ مِنْ بَنِي شَيْبَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ .

290. Mbi leximin e duasë së Kunutit në sabah

باب ما جاء في الْقُنُوتِ فِي صَلَاةِ الْفَجْرِ

399. Na kanë treguar Kutejbe dhe Muhammed b. Musenna – ata i ka informuar Muhammed b. Xhaferi, ai ka transmetuar nga Shu’be, ai nga Amër b. Murre, ai nga Ibn Ebu Lejli – që Berra b. Azibi

²¹ Seid b. Jezid Ebu Seleme el-Ezd el-Basri, është ravi i besueshëm. Ka transmetuar hadithe nga Enes b. Maliku, Ebu Nadri, Hasan el-Basriu dhe shumë të tjerë. Nga ai kanë marrë hadithe Shu’be, Ismail b. Ibrahim, Ibn Ulejte dhe tjerët.

²² Ibn Bettali konsideron, që është e lejuar falja në betejë, nën kushtin që të jetë i pastër. Njëjtë konsiderojnë edhe shumica e dijetarëve islam. Ibn Dekiku thotë, që falja në betejë, duhet kuptuar si lehtësim në situata kur është e nevojshme, e jo si diçka që është e këndshme dhe e lavdërueshme.

²³ E shënojnë edhe Buhari dhe Muslimi në *Sahihë*.

حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَقَالَ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ إِنَّ قَنْتَ فِي الْفَجْرِ فَحَسَنٌ وَإِنْ لَمْ يَقْنُتْ فَحَسَنٌ . وَاخْتَارَ أَنْ لَا يَقْنُتْ . وَلَمْ يَرِ ابْنُ الْمُبَارَكِ الْقُنُوتَ فِي الْفَجْرِ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَأَبُو مَالِكٍ الْأَشْجَعِيُّ اسْمُهُ سَعْدُ بْنُ طَارِقٍ بْنُ أَشِيمٍ .

401.- Na ka treguar Salih b. Abdullahu – atë e ka informuar Ebu Avani, duke transmetuar nga Ebu Malik el-Eshxhei me këtë sened – hadithi sipas rëndësisë është i ngjashëm me të mëparshmin.

حَدَّثَنَا صَالِحُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ أَبِي مَالِكٍ الْأَشْجَعِيِّ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ بِمَعْنَاهُ .

292. Personi i cili teshtinë në namaz

باب مَا جَاءَ فِي الرَّجُلِ يَغْطُسُ فِي الصَّلَاةِ

402. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Rifa b. Jahja b. Abdullah b. Rifa b. Rafi ez-Zukerijj,²⁷ ai ka transmetuar nga xhaxhai i babait, Musa b. Rifai, që babai i Muadh b. Rifait,²⁸ ka thënë: “Jam falur me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të),²⁹ unë teshtiva dhe thash: “Falënderimi i takon Allahut! E falënderoj me falënderimin, i cili është i shpeshtë, i këndshëm, i bekuar dhe i vazhdueshëm – siç e dëshiron atë Sunduesi im – dhe me të cilin Ai është i kënaqur!” Pasi që i Dërguari e përfundoi namazin, e ktheu kokën në drejtimin tonë dhe tha: “Kush foli në namaz?” Askush nuk foli. Përherë të dytë ai tha: “Kush foli në namaz?” Përsëri asnjëri nuk foli. Ai për herë të tretë tha: “Kush foli në namaz?” Atëherë, Rifa b. Rafi’u tha: “Unë fola, o i Dërguar i Allahut” – ndërsa ai tha: “E çfarë the?” “Unë thash: “Falënderimi i takon Allahut! E falënderoj me falënderimin, i cili është i shpeshtë, i këndshëm, i bekuar dhe i vazhdueshëm – siç e dëshiron atë Sunduesi im – dhe me të cilin Ai është i kënaqur!” Ndërsa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) tha: “Pasha atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, tridhjetë e disa melaikë garonin³⁰ se cila e para (me ato fjalë) do të ngrihet (në qiell).”³¹

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Enesi, Vaib b. Huxhri dhe Amir b. Rebie. Hadithi i Rifait është hasen. Sipas disa dijetarëve, ajo mbi çfarë flet ky hadith, ka ndodhur në namazin vullnetar, sepse shumica e tabi’inëve, kanë thënë: “Kur personi teshtinë në namazin vullnetar, ai do t’i falënderohet në vetvete Allahut.” – dhe mbi atë nuk kanë thënë asgjë më gjerësisht.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا رِفَاعَةُ بْنُ يَحْيَى بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ رِفَاعَةَ بْنِ الرَّزْقِيِّ، عَنْ عَمِّ، أَبِيهِ مُعَاذِ بْنِ رِفَاعَةَ عَنْ أَبِيهِ، قَالَ صَلَّيْتُ خَلْفَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَعَطَسْتُ فَقُلْتُ الْحَمْدُ لِلَّهِ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ مُبَارَكًا عَلَيْهِ كَمَا يُحِبُّ رَبُّنَا وَيَرْضَى . فَلَمَّا صَلَّى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ انْصَرَفَ فَقَالَ " مَنْ الْمُتَكَلِّمُ فِي الصَّلَاةِ " . فَلَمْ يَتَكَلَّمْ أَحَدٌ ثُمَّ قَالَهَا الثَّانِيَةَ " مَنْ الْمُتَكَلِّمُ فِي الصَّلَاةِ " . فَلَمْ يَتَكَلَّمْ أَحَدٌ ثُمَّ قَالَهَا الثَّلَاثَةَ " مَنْ الْمُتَكَلِّمُ فِي الصَّلَاةِ " . فَقَالَ رِفَاعَةُ بْنُ رَافِعِ بْنِ عَفْرَاءَ أَنَا يَا رَسُولَ اللَّهِ . قَالَ " كَيْفَ قُلْتَ " . قَالَ قُلْتُ الْحَمْدُ لِلَّهِ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ مُبَارَكًا عَلَيْهِ كَمَا يُحِبُّ رَبُّنَا وَيَرْضَى فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَقَدْ ابْتَدَرَهَا بِضَعَةٌ وَثَلَاثُونَ مَلَكًا أَيُّهُمْ يَصْنَعُ بِهَا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ وَوَائِلِ بْنِ حُجْرٍ وَعَامِرِ بْنِ رَبِيعَةَ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ رِفَاعَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَكَأَنَّ هَذَا الْحَدِيثَ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّهُ فِي التَّطَوُّعِ لِأَنَّ غَيْرَ وَاحِدٍ مِنَ التَّابِعِينَ قَالُوا إِذَا عَطَسَ الرَّجُلُ فِي الصَّلَاةِ الْمَكْتُوبَةِ إِنَّمَا يَحْمَدُ اللَّهَ فِي نَفْسِهِ وَلَمْ يُسَبِّحُوا فِي أَكْثَرِ مَنْ ذَلِكَ .

²⁷ Rifa b. Jahja b. Abdullah b. Rifa b. Rafi el-Zurek el-Ensari, është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së tetë të ravive. Kohë të gjatë ka qenë imam në xhaminë Benu Zurejk.

²⁸ Babai i tij është quajtur Rifa b. Rafi el-Ensari. Ai ka marr pjesë në Betejën e Bedrit. Ka vdekur gjatë kohës së udhëheqjes së Muaviut.

²⁹ Në transmetimin e Taberaniut, të këtij hadithi, qëndron, se ai ka qenë namazi i akshamit.

³⁰ Në transmetimin e Buhariut të këtij hadithi, qëndron, që tridhjetë e disa melaiket kanë garuar se cila e para do t’i shkruaj këto fjalë në mesin e veprave të mira.

³¹ Nga ky hadith, vijmë në konkludim, që është e lejuar për atë që teshtinë në namaz të falënderoj Allahun. Disa thonë se, është e lejuar bërja e saj me zë, derisa me të nuk i shqetëson të tjerët në namaz.

293. Mbi ndërprerjen e të folurit në namaz

باب ما جاء في نسخ الكلام في الصلاة

463. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, atë Ismail b. Ebu Halidi, ai ka transmetuar nga Harith b. Shubejli, ai nga Ebu Amër esh-Shejbani – që Zejd b. Erkami ka thënë: “Ne, derisa faleshim pas të Dëguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), flisnim gjatë namazit – ndokush fliste me atë që ishte afër tij (dhe bënim ashtu), gjithnjë, derisa nuk u shpall ajeti kur’anor: **“...dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut..!”** Që atëherë na është urdhëruar që të heshtim (në namaz) dhe na është ndaluar të folurit.”³²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe nga Ibn Mes’udi dhe Muavi b. Hakemi. Hadithi i Zejd b. Erkamit është hasen-sahih. Në përputhshmëri me të, është praktika e shumicës së dijetarëve. Ata thonë: “Në rast se personi gjatë namazit qëllimisht ose nga harresa flet, është i obliguar ta përsëritë namazin.” Ky është qëndrimi i Eth-Thevriut dhe i Ibn Mubarekut. Disa dijetarë thonë: “Në rast se flet qëllimisht, është i obliguar ta përsërisë namazin. Por, nëse atë e bënë nga harresa ose nga padituria, atëherë nuk është i obliguar. Qëndrimin e këtillë e mbështetë Shafiu.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، أَخْبَرَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ أَبِي خَالِدٍ، عَنِ الْحَارِثِ بْنِ سُبَيْلٍ، عَنْ أَبِي عَمْرٍو الشَّيْبَانِيِّ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَرْقَمٍ، قَالَ كُنَّا نَتَكَلَّمُ خَلْفَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي الصَّلَاةِ يُكَلِّمُ الرَّجُلُ مِمَّا صَاحِبُهُ إِلَى جَنْبِهِ حَتَّى نَزَلَتْ: (وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ) فَأَمَرْنَا بِالسُّكُوتِ وَتُهْمِينًا عَنِ الْكَلَامِ. قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَمُعَاوِيَةَ بْنِ الْحَكَمِ. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ زَيْدِ بْنِ أَرْقَمٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ. قَالُوا إِذَا تَكَلَّمَ الرَّجُلُ عَامِدًا فِي الصَّلَاةِ أَوْ نَاسِيًا أَعَادَ الصَّلَاةَ. وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ. وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا تَكَلَّمَ عَامِدًا فِي الصَّلَاةِ أَعَادَ الصَّلَاةَ وَإِنْ كَانَ نَاسِيًا أَوْ جَاهِلًا أَجْزَأَهُ. وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ.

294. Mbi namazin gjatë pendimit

باب ما جاء في الصلاة عند التوبة

404. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avvani, ai ka transmetuar nga Uthman b. Mugire, ai nga Ali b. Rebiu – që Esmā b. Hakem el-Fezari, ka thënë: “E kam dëgjuar Aliun kur ka thënë: ‘Unë u takoj atyre njerëzve, të cilët kur e dëgjonin hadithin nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nga ai përfitoja aq sa dëshironte Allahu. Ndërsa, nëse atë ma tregonte ndonjëri nga as’habët e tij, unë kërkoja që të betohet³³ - dhe nëse betohej, unë atë (që më tregonte) e konsideroja të vërtetë. Më ka treguar Ebu Bekri, ai e fliste të vërtetën dhe thoshte: “E kam dëgjuar të

³² Nga ky hadith vijmë në përfundim, që në fillim ka qenë e lejuar biseda në namaz. Pasi që është shpallur ajeti 238 i sures El-Bekare, është ndaluar çdo bisedë në namaz. Prej kësaj, Sufjan eth-Thevriu, Ibn Mubareku dhe Ebu Hanife, thonë, që personi i cili është në namaz, nëse flet çfarëdo qoftë, njëjtë, të ketë bërë atë me qëllim apo nga harresa bile edhe nga padituria, namazi i prishet dhe duhet ta përsëris atë.

³³ Në bazë të këtyre fjalëve dhe fjalëve të tjera të ngjashme me to, që i ka shqiptuar Ali b. Ebu Talibi, disa dijetarë të hadithit pohojnë, se pranimin e hadithit, Aliu çdoherë e ka kushtëzuar, me atë, që transmetuesi t’ia vërtetojë me të betuarit se atë e ka dëgjuar nga i mëparshmi. Ebu Bekri dhe Uthmani, e kushtëzonin se edhe ndokush të dëshmonte se e ka dëgjuar atë. Disa orientalistë perëndimorë dhe bashkëmendimtarët e tyre nga bota islame, detajet e këtilla dhe të ngjashme, i kanë shfrytëzuar që të vërtetonin se si edhe vet as’habët kanë qenë të prirë për të gënjyer mbi të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe se për atë shkak katër hulefaï rashidinët për ta pranuar hadithin, kërkonin dëshmitar, përkatësisht betimin. Ndërkaq, secili hulumtues analitik që është sadopak serioz dhe objektiv, për të cilin kjo materie është e afërt, fare mirë e di se Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani, vetëm në disa raste kanë kërkuar dëshmitar, ndërsa Aliu të betuarit, thotë që ai nuk ka qenë kriter i vazhdueshëm i pranimin të haditheve. Ata shumë hadithe i kanë pranuar pa kurrfarë verifikimi, çka tregon mbi pohimet e pabazuara të përmendura nga orientalistët dhe bashkëmendimtarët e tyre.

Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur tha: “Asnjë person nuk ka për ta bërë mëkatin, pastaj të ngrihet, të pastrohet, të falet dhe të kërkojë falje nga Allahu, e që Allahu të mos e falë atë.” Pastaj e citoi këtë ajet: **“Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre - e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë,...”** [Ali Imran: 135].³⁴

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Mes’udi, Ebu Derda, Enesi, Ebu Uname, Muadhi, Vasile dhe Ebu Jusra, i cili quhet Ka’b b. Amër. Hadithi i Aliut është hasen.”³⁵ Nuk na është i njohur vetëm përmes Uthman b. Mugires. E kanë transmetuar Shu’be dhe shumë të tjerë, duke e ngritur (senedin e tij) deri tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e Ebu Avvanit. Sufjan eth-Thevriu dhe Mis’ari, atë e kanë transmetuar me senedin i cili është ndalë dhe nuk është i lidhur për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ky hadith, nga Mis’ri është transmetuar gjithashtu edhe si merfu’.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ عُثْمَانَ بْنِ الْمُغِيرَةِ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ رَبِيعَةَ، عَنْ أَسْمَاءَ بِنِ الْحَكَمِ الْفَزَارِيِّ، قَالَ سَمِعْتُ عَلِيًّا، يَقُولُ إِنِّي كُنْتُ رَجُلًا إِذَا سَمِعْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ حَدِيثًا نَفَعَنِي اللَّهُ مِنْهُ بِمَا شَاءَ أَنْ يَنْفَعَنِي بِهِ وَإِذَا حَدَّثَنِي رَجُلٌ مِنْ أَصْحَابِهِ اسْتَحْلَفَنِي فَإِذَا حَلَفَ لِي صَدَّقْتُهُ وَإِنِّي حَدَّثَنِي أَبُو بَكْرٍ وَصَدَقَ أَبُو بَكْرٍ قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ " مَا مِنْ رَجُلٍ يُذْنِبُ ذَنْبًا ثُمَّ يَقُومُ فَيُتَطَهَّرُ ثُمَّ يُصَلِّي ثُمَّ يَسْتَغْفِرُ اللَّهَ إِلَّا غَفَرَ اللَّهُ لَهُ " . ثُمَّ قَرَأَ هَذِهِ الْآيَةَ : (وَالَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا فَاحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ وَمَنْ يَغْفِرِ اللَّهُ فَمَا لَهُ) . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي الدَّرْدَاءِ وَأَنَسٍ وَأَبِي أُمَامَةَ وَمُعَاذٍ وَوَالِئَةَ وَأَبِي الْيَسْرِ وَاسْمُهُ كُغَبُ بْنُ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَلِيٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ مِنْ حَدِيثِ عُثْمَانَ بْنِ الْمُغِيرَةِ . وَرَوَاهُ سَفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَمِسْعَرٌ فَأَوْفَقَاهُ وَلَمْ يَرْفَعَاهُ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ وَقَدْ رَوَى عَنْ مِسْعَرٍ هَذَا الْحَدِيثَ مَرْفُوعًا أَيْضًا .

295. Kur obligohet fëmija me namaz

باب مَا جَاءَ مَتَى يُؤْمَرُ الصَّبِيُّ بِالصَّلَاةِ

405. Na ka treguar Ali b. Huxhri, atë e ka informuar Harmel b. Abdulaziz b. Rebi’ b. Sebre el-Xhuheni, ai ka transmetuar nga xhaxhai i vet, Abdulmelik b. Rebi b. Sebre, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga gjyshi i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Mësojani fëmijës namazin kur i bënë shtatë vjet, ndërsa urdhërojani namazin kur i bënë dhjetë vjet.”³⁶

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Abdullah b. Amri. Hadithi i Sebre b. Ma’bed el-Xhuhenit është hasen-sahih.”³⁷ Sipas tij veprojnë disa nga dijetarët. Por, sipas tij veprojnë

³⁴ Ibn Huzejme, në *Sahih*, shënon nga Abdullah b. Burejde, të ketë thënë: “Një mëngjes, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e thirri Bilalin dhe i tha: ‘Bilal, me çka më ke kaluar në Xhennet? Mbrëmë më është paraqitur Xhenneti, dhe përpara meje dëgjova zhurmën tënde.’ Ai tha: ‘I Dërguar i Allahut – asnjëherë nuk kam bërë një mëkat e që menjëherë të mos i kam falur dy rekate duke kërkuar falje. Dhe asnjëherë nuk e kam humbur abdesin, e që menjëherë pas saj nuk kam marr abdest dhe kam falur dy rekate.’”

³⁵ Përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe, në *Sunene* dhe Ibn Hibbani, në *Sahih*.

³⁶ Ebu Davudi, shënon nga Ibn Abbasi, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Rekomandoni namazin fëmijëve kur i mbushin shtatë vjet, e kur i mbushin dhjetë vjet, atëherë ju urdhëroni ata dhe ndani ata në shtrat gjatë gjumit.” Dijetarët islam dhe juristët kanë qëndrime shumë rigoroz ndaj atij, që tërësisht e ka lënë namazin. Shafiu konsideron, se personi i tillë e meriton dënimin me vdekje. Mekhuli, Hammad b. Zejdi, Veki dhe Ibn Xherrah, konsiderojnë, se personin e atillë, së pari duhet thirrur të pendohet dhe nëse nuk pendohet, atëherë, mbi të zbatohet dënimi me vdekje. Ebu Hanife konsideron, që mos-falësin duhet burgosur dhe mbajtur në burg, derisa nuk fillon të falet.

³⁷ E ka shënuar edhe Ebu Davudi në *Sunen*. Hakimi thotë, që ky hadith është i besueshëm sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit.

edhe Ahmedi dhe Is'haku, të cilët kanë thënë: 'Çdo namaz të lënë pa falur nga vajza apo djali, pasi që i mbushin dhjetë vjet, duhet t'i kompensojnë ato. Sebre është i biri i Ma'bed el-Xhuheniut, ndërsa disa thonë se është i biri i Avsexhes.'

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا حَزْمَةُ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ الرَّبِيعِ بْنِ سَبْرَةَ الْجُهَنِيِّ، عَنْ عَمِّهِ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ الرَّبِيعِ بْنِ سَبْرَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: عَلِّمُوا الصَّبِيَّ الصَّلَاةَ ابْنَ سَبْعِ سِنِينَ وَاصْزُبُوهُ عَلَيْهَا ابْنَ عَشْرِ. " قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَبْرَةَ بْنِ مَعْبُدٍ الْجُهَنِيِّ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَعَلَيْهِ الْعَمَلُ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ. وَقَالَا مَا تَرَكَ الْعِلَامُ بَعْدَ الْعَشْرِ مِنَ الصَّلَاةِ فَإِنَّهُ يُعِيدُ. قَالَ أَبُو عِيسَى وَسَبْرَةُ هُوَ ابْنُ مَعْبُدٍ الْجُهَنِيِّ وَيُقَالُ هُوَ ابْنُ عَوْسَجَةَ.

296. Mbi personin i cili pas teshehudit e humb avdesin

بَاب مَا جَاءَ فِي الرَّجُلِ يُحَدِّثُ فِي الشَّهَادَةِ

406. Na ka treguar Ahmed b. Muhammedi – atë e ka informuar Ibn Mubareku, atë Abdurrahman b. Zijad b. En'umi, atë e kanë informuar Abdurrahman b. Rafiu dhe Bekër b. Sevadi, duke transmetuar nga Abdullah b. Amri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: "Kur personi e humb avdesin, pasi që është ulur në fund të namazit, por para se të jepte salam – namazi i tij është i vlefshëm."³⁸

Ebu Isai thotë: "Senedi i këtij hadithi nuk është i fuqishëm, në të (ravitë) bien ndesh."³⁹

Disa dijetarë e mbështesin qëndrimin e këtillë. Ata thonë: "Në rast se personi, duke qenë ulur, e kryen teshehudin (e reciton Et-tehijjatin dhe Salavatet), pastaj – para se të jep salam – e humb avdesin, ai e ka plotësuar namazin."

Disa thonë: "Në rast se humb avdesin, para se ta kryente teshehudin ose të jep salam, ka për ta përsëritur namazin." Ky është qëndrimi i Shafiut.

Ahmedi thotë: "Nëse jep salam para se ta plotësojë teshehudin – namazi i tij vlenë – në përputhshmëri me fjalët e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). 'Përfundimi i tij është selami.' Ndërsa, teshehudi është më pak i rëndësishëm, d.m.th. nuk është farz. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është ngritur pas rekatit të dytë dhe e ka vazhduar namazin, ndërsa assesi nuk e ka kryer teshehudin."

³⁸ Sipas mendimit të Ebu Hanifes, ulja e fundit në namaz është farz, derisa dhënia e selamit është sunnet. Andaj, sipas mendimit të tij, Muhammedit, dhe Ebu Jusufit, në rast se personi, pasi që e ka kryer teshehudin e fundit (e ka lexuar Et-Tehijjatin dhe Salavatet), e para se të jepte salam e ka humbur abdesin, namazi i tij është i vlefshëm dhe nuk është i obliguar që ta përsëris atë. Sipas mendimit të Shafiut, edhe ulja e fundit edhe dhënia e selamit është farz. Prandaj, sipas mendimit të tij, personi që e humb abdesin pas teshehudit të bërë para dhënies së selamit, namazin e ka të prishur dhe duhet ta përsëris atë. Sipas mendimit të Ahmedit, ulja e fundit nuk është farz, derisa dhënia e selamit është farz. Prandaj, nëse personi ka arritur të jep salam, namazi i tij është i vlefshëm, madje edhe nëse nuk ka arritur që ta bënte teshehudin e fundit.

³⁹ Sipas mendimit të Bejhekiut, ky hadith ka ardhur nëpërmjet Abdurahman b. Zijad el-Ifrikit, i cili, sipas vlerësimit të Jahja b. Meinit, mësuesit të Buhariut, Jahja b. Seid el-Kattanit, Ahmed b. Hanbelit dhe Abdurrahman b. Mehdiut, është ravi i dobët. E sikur, ky hadith edhe të ishte i besueshëm, kjo ka vlejtur para se të jetë përshkruar selami në namaz.

Ali el-Kari, konsideron, që ky hadith vjen në shumë transmetime, të cilat atë e ngritin në shkallën hasen-li-gajrihi. Abdurahman el-Mubarekfuri pajtohet me El-Kariun, që transmetime të shumta e ngritin hadithin e dobët në rang hasen-li-gajrihi, sipas kushteve, që të vjen në rrugë të ndryshme. Duke pasur parasysh që të gjitha transmetimet e këtij hadithit shkojnë përmes Abdurrahman b. Zijadit, i cili është ravi i dobët, ai në asnjë rast nuk mund të ngrihet në shkallën e hadithit hasen, vetëm me atë, nuk mund ta ketë vlerën si argument i vlefshëm.

Is'hak b. Ibrahim thotë: “Në rast se e kryen teshehudin, e nuk jep salam, i mjafton.” Ai si argument e ka paraqitur hadithin e Ibn Mes’udit në të cilin qëndron, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pasi e ka kryer recitimin, ka thënë: “Kur përfundon me këtë (teshehudin), ti e ke përmbushur obligimin tënd.”

Is'hak b. Ibrahim thotë: “Në rast se e bënë teshehudin por nuk jep salam, për te është e mjaftueshme.” Ai, si argument ka cekur hadithin e Ibn Mes’udit, në të cilin qëndron, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pasi që e ka mësuar, ka thënë: “Kur përfundon me këtë (teshehudin), ti ke përmbushur obligimin tënd.”

Ebu Isai thotë: “Abdurrahman b. Zijadi është El-Ifriki. Disa nga dijetarët e hadithit, atë e kanë vlerësuar si ravi të dobët, ndërsa në mesin e tyre janë, Jahja b. Seid el-Kattani dhe Ahmed b. Hanbeli.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مُحَمَّدٍ بْنُ مُوسَى الْمَلَقِيُّ، مَرْدَوَيْهِ قَالَ أَخْبَرَنَا ابْنُ الْمُبَارَكِ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زِيَادٍ بْنُ أَنْعَمٍ، أَنَّ عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ رَافِعٍ، وَبَكْرَ بْنَ سَوَادَةَ، أَخْبَرَاهُ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا أَحَدُثَ - يَعْنِي الرَّجُلُ - وَقَدْ جَلَسَ فِي آخِرِ صَلَاتِهِ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ فَقَدْ جَارَتْ صَلَاتُهُ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ إِسْنَادُهُ لَيْسَ بِذَلِكَ الْقَوِيَّ وَقَدْ اضْطَرَبُوا فِي إِسْنَادِهِ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا . قَالُوا إِذَا جَلَسَ مِقْدَارَ التَّشَهُّدِ وَأَحَدُثَ قَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ فَقَدْ تَمَّتْ صَلَاتُهُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِذَا أَحَدُثَ قَبْلَ أَنْ يَتَشَهُّدَ وَقَبْلَ أَنْ يُسَلِّمَ أَغَادَ الصَّلَاةَ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ . وَقَالَ أَحْمَدُ إِذَا لَمْ يَتَشَهُّدَ وَسَلَّمَ أَجْزَأَهُ لِقَوْلِ النَّبِيِّ ﷺ " وَتَخْلِيلُهَا التَّسْلِيمُ " وَالتَّشَهُّدُ أَهْوَنُ قَامَ النَّبِيُّ ﷺ فِي اثْنَتَيْنِ فَمَضَى فِي صَلَاتِهِ وَلَمْ يَتَشَهُّدَ . وَقَالَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ إِذَا تَشَهُّدَ وَلَمْ يُسَلِّمْ أَجْزَأَهُ . وَاحْتَجَّ بِحَدِيثِ ابْنِ مَسْعُودٍ جِئَ عَالِمُهُ النَّبِيُّ ﷺ التَّشَهُّدَ فَقَالَ " إِذَا فَرَعْتَ مِنْ هَذَا فَقَدْ قَضَيْتَ مَا عَلَيْكَ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زِيَادٍ بْنُ أَنْعَمٍ هُوَ الْإِفْرِيقِيُّ وَقَدْ ضَعَّفَهُ بَعْضُ أَهْلِ الْحَدِيثِ مِنْهُمْ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْقَطَّانُ وَأَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ .

297. Kur bie shi, namazi mund të falet edhe në vendbanim

باب مَا جَاءَ إِذَا كَانَ الْمَطَرُ فَالصَّلَاةُ فِي الرِّحَالِ

407. Na ka treguar Ebu Hafs Amër b. Aliu – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Zuhejr b. Muaviu, ai ka transmetuar nga Ebu Zubejri – që Xhabiri ka thënë: “Ishim me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në një udhëtim dhe ra shi. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) tha: “Kush dëshiron le të falet në vendpushimin e vet.”⁴⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Semure, Ebu Mulejhi, nga babai i vet dhe Abdurrahman b. Semure. Hadithi i Xhabirit është hasen-sahih.⁴¹ Disa dijetarë, e lejojnë mungesën në namazin e përbashkët (me xhematë) dhe në xhuma gjatë kohës së rënies së shiut (të madh) dhe baltës. Ky është qëndrimi i Ahmedit.”⁴²

Ebu Isai, thotë: “E kam dëgjuar Ebu Zur’an, kur ka thënë: “Afan b. Muslimi (si mësues) e ka transmetuar hadithin nga (nxënësi i vet) Amër b. Aliu. Në Basra, nuk kam parë që ndokush më mirë ka mbajtur në mend sesa këta tre vetë: Ali b. Medini, Ibn Shazikuni dhe Amër b. Aliu. Ebu Mulejh b. Usami, quhet Amir, ndërsa i thuhet edhe Zejd b. Usame b. Umejr el-Hudheli.”

⁴⁰ Sipas këtij hadithi, vijmë në përfundim, që është e lejuar, që në kohë të shiut të fortë dhe motit të keq, gjatë udhëtimit por edhe në shtëpi, të mungosh në xhematë dhe të falësh namazin në shtëpi apo vendqëndrim.

⁴¹ E shënojnë Ahmedi në *Musned*, Muslimi në *Sahih* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

⁴² Sipas mendimit të Ahmed b. Hanbelit dhe Is'hakut, shiu i madh, koha e pavolitshme dhe balta e madhe, janë shkaqe të vyeshme për mos-shkuarjen në namazin e përbashkët dhe namazin e xhumasë, gjatë shirave dhe motit të keq, kur xhumaja falej vetëm nëpër qytete dhe kur duhej të shkelej balta e madhe për të arritur deri në xhami, sot, kur rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, kur xhumaja falet gati në çdo vend, ku rrugët, bile te ne kryesisht të asfaltuara ose bile të shtruara me rrëre dhe ku çdo njeri ka ombrellë, ose mantel për shi – me siguri të gjitha të përmendurat nuk mund të konsiderohen të justifikueshme si shkak për të munguar në xhuma.

حَدَّثَنَا أَبُو حَفْصٍ، عَمْرُو بْنُ عَلِيٍّ الْبَصْرِيُّ حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا زُهَيْرُ بْنُ مُعَاوِيَةَ، عَنْ أَبِي الزُّبَيْرِ، عَنْ جَابِرٍ، قَالَ كُنَّا مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فِي سَفَرٍ فَأَصَابَنَا مَطَرٌ فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " مَنْ شَاءَ فَلْيُصَلِّ فِي رَحْلِهِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَسَمُرَةَ وَأَبِي الْمَلِيحِ عَنْ أَبِيهِ وَعَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ سَمُرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ جَابِرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَخَّصَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْقُعُودِ عَنِ الْجَمَاعَةِ وَالْجُمُعَةِ فِي الْمَطَرِ وَالطَّيْنِ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . قَالَ أَبُو عِيسَى سَمِعْتُ أَبَا زُرْعَةَ يَقُولُ رَوَى عَنْهُ ابْنُ مُسْلِمٍ عَنْ عَمْرُو بْنِ عَلِيٍّ حَدِيثًا . وَقَالَ أَبُو زُرْعَةَ لَمْ نَرِ بِالْبَصْرَةِ أَحْفَظَ مِنْ هَؤُلَاءِ الثَّلَاثَةِ عَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ وَابْنُ الشَّاذْكُونِيِّ وَعَمْرُو بْنُ عَلِيٍّ . وَأَبُو الْمَلِيحِ اسْمُهُ غَابِرٌ وَيُقَالُ زَيْدُ بْنُ أَسَامَةَ بْنِ غَمِيرٍ الْهَذَلِيُّ .

298. Mbi tesbihin⁴³ pas namazit

باب مَا جَاءَ فِي التَّسْبِيحِ فِي أَذْبَارِ الصَّلَاةِ

408. Na kanë treguar Is'hak b. Ibrahim b. Habib b. Shehid dhe Ali b. Huxhri – atyre u ka treguar Attab b. Beshiri, ai ka transmetuar nga Husajfi, ai nga Muxhahidi dhe Ikrimë - që Ibn Abbasi ka thënë: “Të varfrit⁴⁴ kanë ardhur tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe thanë: “I Dërguari i Allahut, të pasurit falen sikur edhe ne, agjërojnë si ne, e përveç saj kanë pasuri me të cilën i lirojnë robërit dhe ndajnë në emër të sadakasë.” Ai tha: “Kur e kryeni namazin,⁴⁵ ju thuani tridhjetë e tre herë *Subhanallah/I Lavdëruar qoftë Allahu*, tridhjetë e tre herë *El-Hamdulillah/Falënderimi i takon Allahut* dhe tridhjetë e tre herë *Allahu ekber/Allahu është më i Madhi* dhe dhjetë herë *La ilahe il-Lallah/Nuk ka Zot përveç Allahut* – keni për t’i arritur (në shpërblim) atë që ju ka tejkaluar dhe nuk kanë për t’ju tejkaluar ata që vijnë pas jush.”⁴⁶

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ka’b b. Uxhre, Enesi, Abdullah b. Amri, Zejd b. Thabiti, Ebu Derda, Ibn Umeri dhe Ebu Dherre. Hadithi i Ibn Abbasit është hasengarib.”⁴⁷

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Në rast se muslimani do të ketë kujdes mbi dy veçori, ato kanë për ta futur në Xhennet. Nëse pas çdo namazi muslimani (rregullisht) e lavdëron Allahun, duke shqiptuar tridhjetë e tre herë (*SubhanAllah*) duke e falënderuar Atë, me shqiptimin e fjalëve tridhjetë e tre herë (*El-hamdulil-lah*), duke e madhëruar Atë me shqiptimin e fjalëve tridhjetë e katër herë (*Allahu Ekber*), Allahu është Një dhe nëse, para se të flinte e lavdëron, me shqiptimin e fjalëve (*Subhanallah*) dhjetë herë, duke e falënderuar Atë me

⁴³ Fjala *tesbih*, në gjuhën arabe domethënë: lavdërim dhe falënderim i Allahut, duke thënë me fjalën *SubhanAllah*. Në rastin konkret, ka të bëjë me shqiptimin e fjalëve: *SubhanAllah*, *El-hamdulillah* dhe *Allahu Ekber* nga tridhjetë e tri herë pas çdo namazi.

⁴⁴ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, nga Ebu Hurejre, qëndron se të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i erdhën muhaxhirët e varfër.

⁴⁵ Në hadithin e Ka’b b. Uxhres, të cilin e shënon Muslimi në *Sahih*, qëndron: “Kur e kryeni namazin e obliguar, ju thuani...”

⁴⁶ Muslimi, në *Sahih*, shënon nga Ebu Hurejre, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush thotë pas namazit: ‘Tridhjetë e tri herë *SubhanAllah*, tridhjetë e tri herë *El-hamdulil-lah* dhe tridhjetë e tri herë *Allahu Ekber* – në total nëntëdhjetë e nëntë herë – dhe e plotëson të njëqindtën duke thënë *La ilahe il-Lallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ‘ala kul-li shej’in kadir*, do t’i jenë të falura mëkatet, qofshin ato edhe sa shkuma e detit.” Dijetarët, duke kërkuar kompromis në mes transmetimeve, në të cilat qëndron, se edhe Allahu Ekber, shqiptohet tridhjetë e tri herë dhe, të atyre në të cilët qëndron, se Allahu Ekber shqiptohet tridhjetë e katër herë, ata janë nisur nga ky hadith. Ata thonë, që para se të shqiptohet *La ilahe il-Lallahu vahdehu la sherike leh...* mund të shqiptohet edhe një tekbir, por, nuk është e domosdoshme. Pasi që shqiptohet tridhjetë e tri herë Allahu Ekber, drejtpërsëdrejti të shqiptohet *La ilahe il-Lallahu vahdehu la sherike leh...*

⁴⁷ E ka shënuar, Nesaiu në *Sunen*.

shqiptimin (*El-hamdulilah*) dhjetë herë dhe duke e madhëruar Atë me shqiptimin e fjalëve (*Allahu Ekber*) dhjetë herë.”⁴⁸

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ بْنِ حَبِيبِ بْنِ الشَّهِيدِ الْبَصْرِيِّ، وَعَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، قَالَا حَدَّثَنَا عَثَابُ بْنُ بَشِيرٍ، عَنْ خُصَيْفٍ، عَنْ مُجَاهِدٍ، وَعِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ جَاءَ الْفُقَرَاءُ إِلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَقَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّ الْأَغْنِيَاءَ يُصَلُّونَ كَمَا نُصَلِّي وَيَصُومُونَ كَمَا نَصُومُ وَلَهُمْ أَمْوَالٌ يُعْتَفُونَ وَيَتَصَدَّقُونَ قَالَ " فَإِذَا صَلَّيْتُمْ فَقُولُوا سُبْحَانَ اللَّهِ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ مَرَّةً وَالْحَمْدُ لِلَّهِ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ مَرَّةً وَاللَّهُ أَكْبَرُ أَرْبَعًا وَثَلَاثِينَ مَرَّةً وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ عَشْرَ مَرَّاتٍ فَإِنَّكُمْ تَدْخُلُونَ بِهِ مَنْ سَبَقَكُمْ وَلَا يَسْبِقُكُمْ مَنْ بَعْدَكُمْ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ وَأَنْسٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَزَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ وَأَبِي الدَّرْدَاءِ وَابْنِ عُمَرَ وَأَبِي ذَرٍّ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدَّثَنَا ابْنُ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَفِي الْبَابِ أَيْضًا عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَالْمَغِيرَةَ . وَقَدْ رَوَى عَنْ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " خَصَلْتَانِ لَا يَخْصِيهِمَا رَجُلٌ مُسْلِمٌ إِلَّا دَخَلَ الْجَنَّةَ يَسْبِيحُ اللَّهَ فِي ثَلَاثِ صَلَاةٍ عَشْرًا وَيَحْمَدُهُ عَشْرًا وَيَكْبِرُهُ عَشْرًا وَيَسْبِيحُ اللَّهَ عِنْدَ مَنْامِهِ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ وَيَحْمَدُهُ ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ وَيَكْبِرُهُ أَرْبَعًا وَثَلَاثِينَ " .

299. Për namazin mbi të shaluarën, kur është baltë dhe shi

باب مَا جَاءَ فِي الصَّلَاةِ عَلَى الدَّابَّةِ فِي الطَّيْنِ وَالْمَطَرِ

409. Na ka treguar Jahja b. Musa – atë e ka informuar Shebab b. Suvvar, atë Umer b. Remmah, ai ka transmetuar nga Kethir b. Zijadi, ai nga Umer b. Uthman b. Ja’la b. Murre, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga gjyshi i vet – që me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kanë qenë në (një) udhëtim. Gjatë kohës së hyrjes së namazit, kanë arritur deri te një grykë mali, të gjithë të lagur. Mbi ta ishte qielli (shiu) ndërsa nën ta toka e lagur baltë. I Dërguari i Allahut (duke mos zbritur nga e shaluara) e thirri ezanin, pas asaj ikametin.⁴⁹ Pastaj, mbi të shaluarën kaloi ca përpara dhe është falur si imam. Rukun dhe sexhden e bënte me lëvizjen e kokës, duke e lëshuar atë më ulët në sexhde sesa në ruku.”⁵⁰

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është garib.”⁵¹ Umer b. Rimah el-Belhi, atë vet e ka transmetuar dhe është i njohur vetëm nga kallëzimet e tij. Nga ai kanë transmetuar shumë dijetarë. Ashtu është transmetuar, që Enes b. Maliku është falur mbi të shaluarën gjatë shiut dhe baltës. Sipas kësaj veprojnë shumë dijetarë. Ky është qëndrimi i Ahmedit dhe Is’hakut.”

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا شَيْبَانَةُ بْنُ سَوَّارٍ، حَدَّثَنَا عُمَرُ بْنُ الرَّمَّاحِ الْبَلْخِيُّ، عَنْ كَثِيرِ بْنِ زَيْادٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ عُثْمَانَ بْنِ يَعْلَى بْنِ مَرَّةٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، أَنَّهُمْ كَانُوا مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فِي مَسِيرٍ فَأَنْتَهُوا إِلَى مَضِيقٍ وَحَضَرَتِ الصَّلَاةُ فَمَطَرُوا السَّمَاءَ مِنْ فَوْقِهِمْ وَالْبَلَّةُ مِنْ أَسْفَلٍ مِنْهُمْ فَأَذَّنَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَهُوَ عَلَى رَأْسِهِ وَأَقَامَ - أَوْ أَقَامَ - فَقَتَمَ عَلَى رَأْسِهِ فَصَلَّى بِهِمْ يَوْمَئِذٍ إِيمَاءً يَجْعَلُ السُّجُودَ أَخْفَضَ مِنَ الرُّكُوعِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ تَقَرَّرَ بِهِ عُمَرُ بْنُ الرَّمَّاحِ الْبَلْخِيُّ لَا يُعْرَفُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِهِ . وَقَدْ رَوَى عَنْهُ غَيْرٌ وَاجِدٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَكَذَلِكَ رَوَى عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ أَنَّهُ صَلَّى فِي مَاءٍ وَطِينٍ عَلَى دَابَّتِهِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا أَهْلُ الْعِلْمِ بِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

⁴⁸ Këtë hadith, Tirmidhiu e shënon në këtë përmbledhje, në kapitullin Mbi Duatë.

⁴⁹ Sipas fjalëve të Sujutit, Neveiu, në bazë të kësaj, e ka vërtetuar që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) personalisht e ka thirrur ezanin dhe ikametin. Në hadithin, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*, qëndron, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me atë rast e ka urdhëruar Bilalin ta thërras ezanin dhe pastaj ikametin. Për atë arsye, El-Mubarekfuri pohon, që Timidhiu këtë hadith e ka sjell në formë diç më të shkurtër dhe konsideron, që fjalët: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (duke mos zbritur nga e shaluara) e ka thirrur ezanin, e pas asaj edhe ikametin.” – duhet kuptuar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke mos zbritur nga e shaluara, e ka urdhëruar Bilalin ta thërras ezanin dhe më pastaj ikametin, e jo në kuptimin, që ai vet e ka thirrur.

⁵⁰ Ky hadith është argument i çartë se, kur për të ekziston arsye e justifikueshme, namazi mund të falet mbi të shaluar, e analogjikisht me atë edhe në çdo mjet tjetër transportues dhe, duke qëndruar ulur ose në ndonjë mënyrë më të përshtatshme. Në atë rast, rukuja dhe sexhdja do të bëhen me lëkundjen e kokës.

⁵¹ Atë, e kanë shënuar Nesaiu dhe Darekutni, nga Enesi. Sufjan eth-Thevriu konsideron, që ky hadith është hasen-sahih, derisa Bejhekiu atë e vlerëson si të dobët.

300. Mbi përpikërinë gjatë namazit

باب مَا جَاءَ فِي الْإِجْتِهَادِ فِي الصَّلَاةِ

410. Na kanë treguar Kutejbe dhe Bishër b. Muadh – ata i ka informuar Ebu Avani, ai ka transmetuar nga Zijad b. Alaki – që Mugire b. Shu’be ka thënë: “I Dërguari i Allahut është falur aq gjatë, sa që iu ishin enjtur këmbët dhe i është thënë: “Përse po ngarkohesh kur të është falur (çdo) mëkat të cilin (eventualisht) e ke bërë dhe atë të cilin (eventualisht) ke për ta bërë?” Ai tha: “Vallë a të mos jem rob falënderuas!”⁵²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Hurejre dhe Aishja. Hadithi i Mugire b. Shu’bes është hasen-sahih.”⁵³

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَبِشْرُ بْنُ مُعَاذٍ الْعَقَدِيُّ، قَالَا حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ زِيَادِ بْنِ عِلَاقَةَ، عَنِ الْمُغِيرَةِ بْنِ شُعْبَةَ، قَالَ صَلَّى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ حَتَّى انْتَفَحَتْ قَدَمَاهُ فَقِيلَ لَهُ أَنْتَ كَلَّفْتَ هَذَا وَقَدْ غُفِرَ لَكَ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ قَالَ " أَفَلَا أَكُونُ عَبْدًا شَكُورًا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ الْمُغِيرَةِ بْنِ شُعْبَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

301. Gjëja e parë që robi (i Allahut) ka për t’u llogaritur në Ditën e Kijametit është Namazi

باب مَا جَاءَ أَنَّ أَوَّلَ مَا يُحَاسَبُ بِهِ الْعَبْدُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ الصَّلَاةُ

411. Na ka treguar Ali b. Nasir b. Ali el-Xhehdami – atë e ka informuar Sehl b. Hammadi, atë Hemmami, atë Katade, duke transmetuar nga Hasani – që Hurejth b. Kabisi ka thënë: “Duke ardhur në Medine unë kam thënë: “O Allah, më falë një bashkëfolës të mirë!” Dhe u ula tek Ebu Hurejre dhe i thash: “E kam lutur Allahun, që të më jap një bashkëfolës të mirë, andaj më trego hadithin të cilin e ke dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndoshta Allahu ma mundëson që të shërbehem me të.” Ai tha: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Gjëja e parë që robi (i Allahut) për veprat e veta ka për t’u llogaritur në Ditën e Kijametit është namazi. Dhe nëse namazi i tij ka qenë i mirë, ai është i shpëtuar dhe fitimtar. Por, nëse namazi i tij është i keq, ai është humbës dhe i shkatërruar. Ndërkaq, nëse ndonjë farz e ka të mangët, Sunduesi i Lartësuar ka për të thënë: “Shikoni se a ka robi Im ndonjë namaz vullnetar dhe me atë do të përmbushet mangësia te fardet. Pastaj në të njëjtën mënyrë ka për të vepruar edhe me veprat e tjera të tij.”⁵⁴

⁵² Çdo veprim i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për pasuesit e tij, ka karakter edukativo arsimor. Shembull i tillë, nga ky hadith, ua drejton të gjithë pasuesve, një mesazh të çartë: “Nëse atij, të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i është garantuar shkalla më e lartë në Xhennet dhe të cilit, të gjitha mëkatet i janë falur, ka qëndruar aq shumë duke bërë ibadet, derisa këmbët i janë enjtur, atëherë si duhet të veprojmë ne, të cilët kemi shumë mëkate dhe assesi nuk jemi të sigurt që kemi për të qenë të shpëtuar.

⁵³ E kanë shënuar, Bejhekiu dhe Muslimi në *Sahihë*, e Bejhekiu në *Sunen*.

⁵⁴ Iraki, në komentimin e vet, të përmbledhjes së hadithit nga Tirmidhiu, thotë, se ekziston kontradiktë në mes këtij dhe hadithit të besueshëm, në të cilin qëndron: “E para që në Ditën e Gjykimit kanë për t’u gjykuar njerëzit, është gjaku.” Sipas tij, hadithi nga ky kapitull flet mbi dhënien e llogarisë për obligimet tona ndaj Allahut të Lartësuar, derisa në këtë hadith flitet për dhënien e llogarisë për hakun ndaj njerëzve, Iraki thotë: “Nuk është përjashtuar as njëra, e as tjetra. Ndërkaq, ajo mbi çka udhëzojnë hadithet e shumta, është, që megjithatë, së pari llogaria ka për t’u dhënë për hakun ndaj Allahut, e pastaj për hakun ndaj njerëzve.

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadith edhe nga Temim Ed-Dariu. Hadithi i Ebu Hurejres, në këtë formë, është hasen-garib.⁵⁵ Ky hadith, është transmetuar me tjetër rrugë, nga Ebu Hurejre. Disa bashkëkohës të Hasanit kanë transmetuar nga Hasani, ai nga Kabis b. Zuvejbe, një hadith më ndryshe se ky. Ndërkaq, ai më tepër është i njohur si Kabis b. Hurejje. Është transmetuar nga Enes b. Hakimi, ai nga Ebu Hurejre, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ngjashëm me këtë.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ نَصْرِ بْنِ عَلِيٍّ الْجَهَنَمِيُّ، حَدَّثَنَا سَهْلُ بْنُ حَمَّادٍ، حَدَّثَنَا هَمَّامٌ، قَالَ حَدَّثَنِي قَتَادَةُ، عَنِ الْحَسَنِ، عَنْ حُرَيْثِ بْنِ قَبِيصَةَ، قَالَ قَدِمْتُ الْمَدِينَةَ فَقُلْتُ اللَّهُمَّ يَسِّرْ لِي جَلِيسًا صَالِحًا . قَالَ فَجَلَسْتُ إِلَى أَبِي هُرَيْرَةَ فَقُلْتُ إِنِّي سَأَلْتُ اللَّهَ أَنْ يَرْزُقَنِي جَلِيسًا صَالِحًا فَحَدَّثَنِي بِحَدِيثٍ سَمِعْتُهُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ لَعَلَّ اللَّهَ أَنْ يَنْفَعَنِي بِهِ فَقَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ " إِنَّ أَوَّلَ مَا يُحَاسَبُ بِهِ الْعَبْدُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنْ عَمَلِهِ صَلَاتُهُ فَإِنْ صَلَحَتْ فَقَدْ أَفْلَحَ وَأَنْجَحَ وَإِنْ فَسَدَتْ فَقَدْ خَابَ وَخَسِرَ فَإِنْ انْتَقَصَ مِنْ فَرِيضَتِهِ شَيْءٌ قَالَ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ انْظُرُوا هَلْ لِعِبْدِي مِنْ تَطَوُّعٍ فَيُكَمَّلَ بِهَا مَا انْتَقَصَ مِنَ الْفَرِيضَةِ ثُمَّ يَكُونُ سَائِرُ عَمَلِهِ عَلَى ذَلِكَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ثَمِيمِ الدَّارِيِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَقَدْ رَوَى بَعْضُ أَصْحَابِ الْحَسَنِ عَنْ الْحَسَنِ عَنْ قَبِيصَةَ بْنِ حُرَيْثٍ غَيْرَ هَذَا الْحَدِيثِ وَالْمَشْهُورُ هُوَ قَبِيصَةُ بْنُ حُرَيْثٍ . وَرَوَى عَنْ أَنَسِ بْنِ كَعْبٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوُ هَذَا .

302. Çfarë shpërblimi ka për ta pasur ai i cili gjatë ditës dhe natës i falë dymbëdhjetë rekate sunnet

باب مَا جَاءَ فِيْمَنْ صَلَّى فِي يَوْمٍ وَلَيْلَةٍ ثِنْتَيْ عَشْرَةَ رَكْعَةً مِنَ السَّنَةِ وَمَا لَهُ فِيهِ مِنَ الْفَضْلِ

412.- Na ka treguar Muhammed b. Rafi – atë e ka informuar Is’hak b. Sulejman er-Razi,⁵⁶ atë Mugire b. Zijadi,⁵⁷ ai ka transmetuar nga Ata’i,⁵⁸ ndërsa ai nga Aishja – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush në vazhdimi i falë dymbëdhjetë rekate sunnet – katër para namazit të drekës dhe dy pas namazit të drekës, dy pas namazit të akshamit, dy pas namazit të jacisë dhe dy para namazit të sabahut (fardit) – Allahu atij ka për t’ia ndërtuar një shtëpi në Xhenet.”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ummu Habibja, Ebu Hurejre, Ebu Musai dhe Ibn Umeri. Hadithi i Aishes, në këtë formë, është garib.⁵⁹ Disa dijetarë nuk janë shprehur mirë mbi të mbajturit në mend të Mugire b. Zijadit.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ رَافِعٍ النَّيْسَابُورِيُّ، حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ سُلَيْمَانَ الرَّازِيُّ، حَدَّثَنَا الْمُغِيرَةُ بْنُ زَيْادٍ، عَنْ عَطَاءٍ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ مَنْ تَابَرَ عَلَى ثِنْتَيْ عَشْرَةَ رَكْعَةً مِنَ السَّنَةِ بَنَى اللَّهُ لَهُ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ أَرْبَعِ رَكَعَاتٍ قَبْلَ الظُّهْرِ وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرِبِ وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْعِشَاءِ وَرَكَعَتَيْنِ قَبْلَ الْفَجْرِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أُمِّ حَبِيبَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَأَبِي مُوسَى وَابْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَمُغِيرَةُ بْنُ زَيْادٍ قَدْ تَكَلَّمَ فِيهِ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ قَبْلِ حَفْظِهِ .

413. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Muemmeli,⁶⁰ atë Sufjan eth-Thevriu, duke transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Musejjeb b. Rafiu, ai nga Anbes b. Ebu Sufjani, ndërsa ai nga

⁵⁵ E ka shënuar Ebu Davudi në *Sunen*, ndërsa e transmeton edhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned*.

⁵⁶ Emri i plotë i El-Raziut është, Ebu Jahja Isak b. Sulejman el-Razi el-Kufi. Është i besueshëm dhe ravi i vlefshëm. I ka takuar gjeneratës së dhjetë.

⁵⁷ Mbi Mugire b. Zijad ed-Bexhli el-Mevsiu, janë të shquptuara lehtësime të ndryshme. Ibn Mein dhe Vekiu, e konsiderojnë të besueshëm, derisa Ebu Hatimi thotë, që është shejh, hadithet e të cilit mund të shërbejnë si argument. Ibn Haxheri atë e konsideron ravi të singertë, i cili ndonjëherë gabonte.

⁵⁸ Ata b. Ebu Rebbah është ravi i singertë dhe i vlefshëm. Shquhej si njohës i madh i fikhut dhe të drejtave sheriatike. Për te, Ibn Abbasi, duke iu drejtuar Mekasve, ka thënë: “O mekas, pse tuboheni rreth meje, kur në mesin tuaj e keni Ata b. Ebu Rabbahun!” Ebu Hanife, thotë: “Unë nuk e kam takuar as një njeri më të vlefshëm se Ata b. Ebu Rabbahun.” Ka vdekur në vitin 114 sipas hixhretit.

⁵⁹ Përveç Tirmidhiut, atë e kanë shënuar Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

Ummu Habibja – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush gjatë ditës dhe natës i falë dymbëdhjetë rekate – katër para dhe dy pas fardit të drekës, dy pas fardit të akshamit, dy pas fardit të jacisë, dy para fardit të sabahut – atij ka për t’ju ndërtuar një shtëpi në Xhennet.”

Ebu Isai thotë: “Hadithi i Anbeses nga Ummu Habibja, mbi këtë temë, është hasen-sahih.⁶¹ Është transmetuar në shumë mënyra nga Anbese.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيَالَانَ، حَدَّثَنَا مُؤَمَّلٌ، - هُوَ ابْنُ إِسْمَاعِيلَ حَدَّثَنَا سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ الْمُسَيَّبِ بْنِ رَافِعٍ، عَنْ عُبَيْسَةَ بْنِ أَبِي سُفْيَانَ، عَنْ أُمِّ حَبِيبَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى فِي يَوْمٍ وَلَيْلَةٍ ثِنْتَيْ عَشْرَةَ رُكْعَةً بُنِيَ لَهُ بَيْتٌ فِي الْجَنَّةِ أَرْبَعًا قَبْلَ الظُّهْرِ وَرُكْعَتَيْنِ بَعْدَهَا وَرُكْعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرَبِ وَرُكْعَتَيْنِ بَعْدَ الْعِشَاءِ وَرُكْعَتَيْنِ قَبْلَ صَلَاةِ الْفَجْرِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ عُبَيْسَةَ عَنْ أُمِّ حَبِيبَةَ فِي هَذَا الْبَابِ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَقَدْ رُوِيَ عَنْ عُبَيْسَةَ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ .

303. Mbi vlerën e dy rekateve të sunnetit të sabahut

بَاب مَا جَاءَ فِي رُكْعَتِي الْفَجْرِ مِنَ الْفَضْلِ

414. Na ka treguar Salih b. Abdullahu,⁶² atë e ka informuar Ebu Avani, duke transmetuar nga Katade, ai nga Zurare b. Evfi,⁶³ ai nga Sa’d b. Hishami,⁶⁴ ai nga Aishja – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dy rekate sunnet të namazit të sabahut janë më të mirë se kjo botë dhe çdo gjë që është në të.”⁶⁵

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe, edhe nga Aliu, Ibn Umeri dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Aishes, është hasen-sahih.⁶⁶ Ahmed b. Hanbeli ka transmetuar hadithe nga Salih b. Abdullah et-Tirmidhiu.”

حَدَّثَنَا صَالِحُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ التِّرْمِذِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ زُرَّارَةَ بْنِ أَوْفَى، عَنْ سَعْدِ بْنِ هِشَامٍ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " رُكْعَتَا الْفَجْرِ خَيْرٌ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَابْنِ عُمَرَ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ عَنْ صَالِحِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ التِّرْمِذِيِّ حَدِيثَ عَائِشَةَ .

⁶⁰ Muemmel b. Ismail el-Adijj, sipas vlerësimit të Ibn Meinit është ravi i besueshëm. Ebu Hatimi, atë e konsideron si ravi të sinqertë, i cili shumë gabonte gjatë transmetimit të haditheve. Vlerësimin e njëjtë mbi të e ka shqiptuar edhe Ebu Zur’a. Buhariu thotë, se i ka kundërshtuar shumë ravitë e besueshëm. Ka vdekur në Mekke në vitin 206 sipas hixhretit.

⁶¹ E shënon Nesaiu në *Sunen*.

⁶² Salih b. Abdullah b. Zekvan el-Bahili Ebu Abdullah et-Tirmidhiu është ravi i besueshëm. I takon gjeneratës së dhjetë të ravive.

⁶³ Zuare b. Evfa el-Amiri el-Hareshi, është ravi i besueshëm dhe i veçantë. Ka vdekur gjatë namazit. Ka qenë kadi i Basras, i ka takuar gjeneratës së tretë të ravive.

⁶⁴ Sa’d b. Hisham b. Amir el-Ensari el-Medeni, është ravi i besueshëm. I takon gjeneratës së tretë të ravive. Ka rënë si shehid në Indi.

⁶⁵ Shah Velijullah ed-Dehlevi, në veprën *Huxhxhetul-lahil-baliga*, thotë: “Dy rekate të sunnetit të sabahut janë më të mirë se kjo botë dhe çdo gjë që është në të, për atë që kjo botë dhe çdo gjë që është mbi të nuk janë të përrjetshme por janë kalimtare, derisa veprat e mira janë të përrjetshme.” Në hadithin, të cilin e transmeton Muslimi nga Aishja, qëndron, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi dy rekate të sunnetit të sabahut ka thënë: “Për mua janë më të dashura nga kjo botë dhe çdo gjë që është mbi të.”

⁶⁶ E shënojnë, Muslimi në *Sahih* dhe Ahmed i në *Musned*.

304. Mbi shkurtesën e dy rekateve sunnet të sabahut dhe recitimit në to

بَاب مَا جَاءَ فِي تَخْفِيفِ رَكْعَتَيِ الْفَجْرِ وَمَا كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَقْرَأُ فِيهِمَا

415. Na kanë treguar Mahmud b. Gajlani dhe Ebu Ammari⁶⁷ - ata i ka informuar Ebu Ahmed ez-Zubejri, atë Sufjani, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Muxhahidi – që Ibn Umeri ka thënë: “Unë një muaj e kam vështuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai në dy rekartet e namazit të sabahut e recitonte *Kul ja ejjuhel-kafirun* dhe *Kul-huvAllahu Ehad*.”⁶⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Mes’udi, Enesi, Ebu Hurejre, Ibn Abbasi, nga Hafsa dhe Aishja. Hadithi i Ibn Umerit është hasen.⁶⁹ Ai nuk na është i njohur nëpërmjet Thevrit nga Ebu Is’haku, përveç nga rrëfimi i Ebu Ahmedit, ndërsa, në mesin e njerëzve është i njohur si hadithi i Israilit nga Ebu Is’haku. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar nga Ahmedi, ndërsa ai nga Ebu Israili.”

Ebu Ahmed ez-Zubejri, është ravi i besueshëm dhe hafiz i hadithit. Ai, ka thënë: “E kam dëgjuar Bundarin kur ka thënë: ‘Nuk e kam parë askënd që i ka mbajtur më mirë hadithet sesa Ebu Ahmed ez-Zubejri.’ Emri i tij është Muhammed b. Abdullah b. Ez-Zubejr el-Esed el-Kufi.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيلَانَ، وَأَبُو عَمَّارٍ قَالَ حَدَّثَنَا أَبُو أَحْمَدَ الرَّبِيعِيُّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ مُجَاهِدٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ رَمَعْتُ النَّبِيَّ ﷺ شَهْرًا فَكَانَ يَقْرَأُ فِي الرَّكْعَتَيْنِ قَبْلَ الْفَجْرِ ب: (يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ) وَ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَأَنْسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَحَفْصَةَ وَعَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ وَلَا نَعْرِفُهُ مِنْ حَدِيثِ الثَّوْرِيِّ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ أَبِي أَحْمَدَ وَالْمَعْرُوفِ عِنْدَ النَّاسِ حَدِيثُ إِسْرَائِيلَ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ . وَقَدْ رَوَى عَنْ أَبِي أَحْمَدَ عَنْ إِسْرَائِيلَ هَذَا الْحَدِيثُ أَيْضًا . وَأَبُو أَحْمَدَ الرَّبِيعِيُّ ثِقَةٌ حَافِظٌ . قَالَ سَمِعْتُ بُنْدَارًا يَقُولُ مَا رَأَيْتُ أَحَدًا أَحْسَنَ حِفْظًا مِنْ أَبِي أَحْمَدَ الرَّبِيعِيِّ . وَأَبُو أَحْمَدَ اسْمُهُ مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الرَّبِيعِ الْكُوفِيُّ الْأَسَدِيُّ .

305. Mbi bisedimin pas (faljes së) dy rekateve sunnet të sabahut

بَاب مَا جَاءَ فِي الْكَلَامِ بَعْدَ رَكْعَتَيِ الْفَجْرِ

416. Na ka treguar Jusuf b. Isa – atë e ka informuar Abdullah b. Idrisi, atë Malik b. Enesi, ai ka transmetuar nga Ebu Nadri, ai nga Ebu Seleme – që Aishja ka thënë: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përfundonte me faljen e dy rekateve të sabahut, nëse i duhej diç nga unë, fliste me mua, ndërsa nëse nuk i duhej, ai (menjëherë) dilte (në xhami) për shkak të namazit (fard).”⁷⁰

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.⁷¹ Disa dijetarë nga gjenerata e as’habëve mbajnë qëndrim, që çdo bisedë, përveç dhikrit të Allahut dhe të asaj që është e domosdoshme, që nga agimi e derisa nuk falet sabahu, është e qortuar. Ky është edhe qëndrimi i Ahmedit dhe i Is’hakut.”⁷²

⁶⁷ Ebu Ammar Husejn b. Hurejth el-Huzaiu, është ravi i besueshëm. I takon gjeneratës së dhjetë të ravive.

⁶⁸ Në bazë të këtij dhe haditheve tjera mbi këtë temë, shumica e dijetarëve islam kanë ardhur në përfundim që sunnetet e sabahut është mirë që të shkurtohen dhe ato të mos zgjaten.

⁶⁹ E shënojnë të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Nesaiut.

⁷⁰ Buhariu dhe Muslimi, shënojnë që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pasi i falte dy rekartet e sunnetit të sabahut, bisedonte me mua, atëherë kur isha e zgjuar. E atëherë kur nuk isha e zgjuar, ai u shtrinte.” Në bazë të këtij hadithi, shumica e dijetarëve konsiderojnë, që pas faljes së sunnetit të sabahut dhe para faljes së namazit farz, është e lejuar bisedimi dhe ai nuk është mekruh.

⁷¹ E shënojnë, në *El-Kutubus-sitte*.

حَدَّثَنَا يُونُسُ بْنُ عِيسَى الْمَرْزُوقِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، قَالَ سَمِعْتُ مَالِكَ بْنَ أَنَسٍ، عَنْ أَبِي النَّضْرِ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا صَلَّى رَكَعَتَيِ الْفَجْرِ فَإِنْ كَانَتْ لَهُ إِلَى حَاجَةٍ كَلَّمَنِي وَإِلَّا خَرَجَ إِلَى الصَّلَاةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ كَرِهَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمُ الْكَلَامَ بَعْدَ طُلُوعِ الْفَجْرِ حَتَّى يُصَلِّيَ صَلَاةَ الْفَجْرِ إِلَّا مَا كَانَ مِنْ ذِكْرِ اللَّهِ أَوْ مِمَّا لَا بُدَّ مِنْهُ وَهُوَ قَوْلُ أَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ .

306. Nuk ka kurrfarë namazi pas lindjes së agimit, përveç dy rekateve

باب مَا جَاءَ " لَا صَلَاةَ بَعْدَ طُلُوعِ الْفَجْرِ إِلَّا رَكَعَتَيْنِ "

417. Na ka treguar Ahmed b. Abd ed-Dabijj – atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi, ai ka transmetuar nga Kudame b. Musai, ai nga Muhammed b. Husajni, ai nga Ebu Alkami, ai nga Jesari, nga i mbrojturi i Umerit – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Nuk ka kurrfarë namazi tjetër pas agimit (deri te fardi i sabahut), përveç dy rekateve të sunnetit të sabahut.”⁷³

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Amri dhe Hafsa. Hadithi i Ibn Umerit është garib.⁷⁴ E kemi të njohur vetëm nëpërmjet Kudame b. Musait.⁷⁵ Nga ai e kanë transmetuar shumë vetë. Ajo, rreth së cilës janë pajtuar dijetarët, është, që pas lindjes së agimit (deri te fardi) personi e ka mekruh faljen e çfarëdo tjetër përveç dy rekateve të sunnetit të sabahut. Kuptimi i këtij hadithi është (në atë), që ai thotë: ‘Nuk ka kurrfarë namazi tjetër, pas shfaqjes së agimit (deri te fardi), përveç dy rekateve të namazit të sabahut.’

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ الصَّغِيِّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ قُذَامَةَ بْنِ مُوسَى، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْحُسَيْنِ، عَنْ أَبِي عَلْقَمَةَ، عَنْ يَسَارٍ، مَوْلَى ابْنِ عُمَرَ عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " لَا صَلَاةَ بَعْدَ الْفَجْرِ إِلَّا سَجْدَتَيْنِ " . وَمَعْنَى هَذَا الْحَدِيثِ إِنَّمَا يَقُولُ لَا صَلَاةَ بَعْدَ طُلُوعِ الْفَجْرِ إِلَّا رَكَعَتَيِ الْفَجْرِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَحَفْصَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ قُذَامَةَ بْنِ مُوسَى وَرَوَى عَنْهُ غَيْرُ وَاحِدٍ . وَهُوَ مَا اجْتَمَعَ عَلَيْهِ أَهْلُ الْعِلْمِ كَرَهُوا أَنْ يُصَلِّيَ الرَّجُلُ بَعْدَ طُلُوعِ الْفَجْرِ إِلَّا رَكَعَتَيِ الْفَجْرِ .

⁷² Dijetarët, të cilët mbajnë qëndrim, që biseda pas sunnetit të sabahut dhe para faljes së farzit, është mekruh, mendimin e vet e bazojnë, në etherin e Ibn Mes’udit, të cilin e shënon Taberaniu në *Mu’xhemul-Kebiru*, e në të cilin, qëndron: “Ibn Mes’udi, me një rast, pas agimit të mëngjesit, erdhi (në xhami) dhe i takoi njerëzit duke biseduar dhe u tha: “Ju këtu jeni për t’iu përgjigjur namazit – ose faluni, ose heshtni.” Abdurahman el-Mubarekfuri, thotë, që senedi i këtij etheri është i ndërprerë, pasi që Ata, i cili e transmeton, nuk ka dëgjuar hadithe nga Ibn Mes’udi.

⁷³ Shumica e dijetarëve islamë, konsideron se është mekruh falja e çfarëdo nafileje, që nga shfaqja e agimit deri te fillimi i farzit të sabahut. Sipas mendimit të tyre, gjatë asaj periudhe, mund të falen vetëm dy rekate sunnet të sabahut. Tirmidhiu, pohon, që mbi këtë çështje, në mes ulemasë është arritur koncensus, me të cilin nuk pajtohet El-Mubarekfuri. Ai konsideron, se ka dijetarë, në mesin e të cilëve është Maliku, të cilët konsiderojnë, se edhe nafilet e tjera mund të falen deri te farzi i sabahut. Gjatë kësaj, ata mbështeten mbi hadithin të cilin e ka shënuar Ebu Davudi në *Sunnan*, në të cilin qëndron, se Amër b. Anbes e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “O i Dërguar i Allahut, në cilën pjesë të natës më së tepërmi pranohet ibadeti?” “Në pjesën e fundit” – tha ai – “Prandaj falu sa më shumë që të mundesh, sepse në namaz të (natës) janë të pranishme melaiket dhe ai pranohet, gjithnjë, derisa nuk e falë sabahun.” Në versionin tjetër, të këtij hadithi qëndron: “Falu sa më tepër që të mundesh, gjithnjë, derisa nuk e falë sabahun.”

⁷⁴ Sipas vlerësimit të El-Mubarekfurit, ky hadith është i dobët. Është i dobët sepse nuk është konstatuar emri i vërtetë i shejhut të Kudames, nga i cili ai e ka marr këtë hadith. Disa thonë se emri i tij është Ejub b. Huzajn, ndërsa disa Muhammed b. Husajn. Sipas asaj, ai është raviu i panjohur, e secili hadith në senedin e të cilit gjendet ravi i panjohur, sipas kriterëve të dijetarëve të hadithit, ai hadith është i dobët.

⁷⁵ Zejlei pajtohet me konstatimin e Tirmidhiut, që ky hadith, u është i njohur vetëm nëpërmjet Kudame b. Masait. Ai pohon, që Taberaniu këtë hadith e ka transmetuar me dy senele të ndryshëm, në asnjërin nuk është Kudame b. Musai. El-Mubarekfuri, thotë: “Nuk ka përse Zejlei të mos pajtohet me Tirmidhiun. Tirmidhiu nuk ka pohuar se ky hadith nuk ka ardhur edhe nëpërmjet ravive të tjerë. ai vetëm ka cekur se për te nuk është i njohur me rrugë të tjera, përveç nëpërmjet Kudame b. Musait.”

307. Mbi shtrirjen në njërën anë pas faljes së dy rekateve të sunnetit të sabahut

باب مَا جَاءَ فِي الْإِضْطِجَاعِ بَعْدَ رَكْعَتِي الْفَجْرِ

418. Na ka treguar Bishr b. Muadh el-Akadijj – atë e ka informuar Abdulvahid b. Zijadi, atë A'meshi, duke transmetuar nga Ebu Salih, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndonjëri nga ju i falë dy rekate sunnet të sabahut, le të shtrihet ca në anën e djathtë.”⁷⁶

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Aishja. Hadithi i Ebu Hurejres, në këtë formë, është hasen-sahih-garib.⁷⁷ Është transmetuar nga Aishja, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nëse i falte në shtëpi dy rekate sunnet të sabahut, shtrihej (ca) mbi anën e djathtë. Disa dijetarë, veprimin e këtillë e konsiderojnë mustehab – të pëlqyer.”

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مَعَاذٍ الْعَقَدِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَاحِدِ بْنُ زِيَادٍ، حَدَّثَنَا الْأَعْمَشُ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ " إِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ رَكْعَتِي الْفَجْرِ فَلْيُضْطَجِعْ عَلَى يَمِينِهِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ عَائِشَةَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ إِذَا صَلَّى رَكْعَتِي الْفَجْرِ فِي بَيْتِهِ اضْطَجَعَ عَلَى يَمِينِهِ . وَقَدْ رَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ يُفْعَلَ هَذَا اسْتِحْبَابًا .

308. Kur thirret ikameti, nuk ka namaz tjetër, përveç namazit të urdhëruar (fardit)

باب مَا جَاءَ " إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا صَلَاةَ إِلَّا الْمَكْتُوبَةُ "

419. Na ka treguar Ahmed b. Meni, atë e ka informuar Revh b. Ubade,⁷⁸ atë Zekerija b. Is'haku, atë Amër b. Dinari, atë Ata b. Jesari, i cili ka transmetuar nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur thirret ikameti, nuk ka namaz tjetër, përveç namazit të urdhëruar (fardi).”⁷⁹

⁷⁶ Buhariu dhe Muslimi, shënojnë nga Aishja, këtë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në mes të jacisë dhe sabahut i falte njëmbëdhjetë rekate të namazit të natës. Kur muezini e përfundonte ezanin e sabahut, ngrihej dhe i falte dy rekate më të shkurtra të sunnetit të sabahut. Por, kur muezini e fillonte ikametin, dilte dhe i falte fardet e sabahut.” Në bazë të këtyre haditheve, shumica e dijetarëve islamë, janë të mendimit se është mustehab për atë i cili sunnetet e sabahut i falë në shtëpi, që pasi t'i falë, të shtrihet ca në anën e djathtë. Shafi'u këtë e konsideron sunnet. Disa dijetarë, shkojnë aq larg, sa që për shtrirjen pas sunnetit të sabahut thonë se është vaxhib, disa bile shkojnë aq larg, sa që atë e konsiderojnë edhe farz dhe kusht për rregullsinë e namazit të sabahut. Ndërkaq, nuk ka argumente të vlefshme për pohime të këtilla, sidomos kur merret parasysh, që atë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e ka bërë rregullisht, e çfarë shihet edhe nga fjalët e Aishes: “Kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) përfundonte me faljen e sunnetit të sabahut, nëse isha e zgjuar, ai bisedonte me mua. Por, nëse nuk isha, ai shtrihej.”

⁷⁷ Atë e shënojnë edhe Ahmed i në *Musned*, e edhe Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunene*. Neveviu dhe Ebu Jahja Zekeri el-Ensari, konsiderojnë, që ky hadith është i besueshëm, sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit.

⁷⁸ Revh b. Ubade b. Ala b. Hasan el-Kajsi Ebu Muhammed el-Basri, është i njohur si hafiz i hadithit. Ka shkruar vepra të shumta nga të cilat më e njohura është *Tefsiri* dhe *Suneni* i tij. Sipas mendimit të Haxhi Halifiut, ka vdekur në vitin 205, e disa shënojnë 207 sipas hixhretit.

⁷⁹ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, qëndron: “Kur thirret ikameti, nuk ka namaz tjetër, përveç atij, për të cilin është thirrur ikameti.” Ibn Haxheri konsideron, që në këto hadithe ndalohet falja e çfarëdo namazi vullnetar madje as sunnetit pas ikametit të thirrur. Sepse, ai thotë, nën nocionin i *urdhëruar*, mendohet pikërisht për farz. Neveviu konsideron, që ndalesa në hadithet e përmendura, bëhet fjalë për fillimin e faljes së namazit, pas thirrjes së ikametit, pa dallim se a ka të bëjë me nafilet e zakonshme apo me sunnetet e rregullta. Ky është qëndrimi i Shafiut dhe shumicës së dijetarëve islam. Ebu Hanifë konsideron, që

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadith edhe nga Ibn Buhajne, Abdullah b Amri, Abdullah b. Serxhisi, Ibn Abbasi dhe Enesi. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen.⁸⁰ Kështu kanë transmetuar edhe Ejubi, Verka b. Umeri, Zijad b. Sa’di, Ismail b. Muslimi dhe Muhammed b. Xhuhadi nga Amër b. Dinari, ai nga Ata b. Jesari, ai nga Ebu Hurejre, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). E kanë transmetuar edhe Hammad b. Zejdi dhe Sufjan b. Ujejne nga Amër b. Dinari, por nuk i cekin të gjithë transmetuesit (deri te i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)). Në përputhshmëri me këtë është veprimi i dijetarëve nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerëve. Ata konsiderojnë, që personi pas ikametit të thirrur nuk mund të falë kurrfarë namazi tjetër, përveç (fardit) të urdhëruar. Ky është qëndrimi edhe i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut, Shafiut, Ahmedit dhe i Is’hakut.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا رَوْحُ بْنُ عُبَادَةَ، حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا بْنُ إِسْحَاقَ، حَدَّثَنَا عَمْرُو بْنُ دِينَارٍ، قَالَ سَمِعْتُ عَطَاءَ بْنَ يَسَارٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا صَلَاةَ إِلَّا الْمَكْتُوبَةُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ بُحَيْنَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَرْجَسٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَهَكَذَا رَوَى أَبُو يُوْبَ وَوَرَقَاءُ بْنُ عَمْرٍو وَزِيَادُ بْنُ سَعْدٍ وَإِسْمَاعِيلُ بْنُ مُسْلِمٍ وَمُحَمَّدُ بْنُ جُحَادَةَ عَنْ عَمْرٍو بْنِ دِينَارٍ عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَرَوَى حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ وَسُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ عَنْ عَمْرٍو بْنِ دِينَارٍ فَلَمْ يَرْفَعَاهُ . وَالْحَدِيثُ الْمَرْفُوعُ أَصَحُّ عِنْدَنَا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ أَنْ لَا يُصَلِّيَ الرَّجُلُ إِلَّا الْمَكْتُوبَةَ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ رَوَاهُ عَبَّاسُ الْقُتَيْبِيُّ الْمِصْرِيُّ عَنْ أَبِي سَلَمَةَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ هَذَا .

309. Kush nuk arrin për t'i falur dy rekate sunnet para fardit të sabahut, ka për t'i falur ato pas fardit

باب مَا جَاءَ فِيْمَنْ تَفَوُّتَهُ الرَّكَعَتَانِ قَبْلَ الْفَجْرِ يُصَلِّيَهُمَا بَعْدَ صَلَاةِ الْفَجْرِ

420. Na ka treguar Muhammed b. Amr es-Sevvaku⁸¹ - atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi,⁸² duke transmetuar nga Sa'd b. Seidi, ai nga Muhammed b. Ibrahim – që Kajs, gjyshi i Muhammed b. Ibrahim, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), doli e thirri ikametin edhe unë e fala sabahun me të. Pastaj, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ishte nisur, duke më parë që isha duke u falur, tha: ‘Më ngadalë, Kajs! Vallë, a dy farde në të njëjtën kohë?’ Kur përfundova, thash: ‘O i Dërguar i Allahut, nuk i pata falur dy rekate sunnet të sabahut.’ – e ai tha: ‘Nëse është ashtu, atëherë nuk pengon që t'i falësh.’”⁸³

personi, nëse nuk i ka falur sunnetet e sabahut, mundet ta fillojë faljen e tyre edhe pas ikametit të thirrur, nëse është i sigurt që duke i falur sunnetet nuk ka për ta lëshuar edhe rekatin e dytë pas imamit. Eth-Thevriu konsideron, se mund t' filloj, nëse është i sigurt se nuk ka për t' i ikur rekati i parë i farzit pas imamit.

⁸⁰ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*, përveç në *Sahihun* e Buhariut.

⁸¹ Muhammed b. Amr es-Sevvak el-Behli është ravi i sinqertë. Ka transmetuar hadithe nga Deraverdiu, Hushejme, Vekiu dhe të tjerët. Nga ai, hadithe kanë marrë Buhariu, Tirmidhiu, Ebu Zur'a dhe të tjerët. Ka ydekur në vitin 236 sipas hixhretit.

⁸² Abdulaziz b. Muhammed b. Ebu Ubejd ed-Deraverdi Ebu Muhammed el-Medeni është, siç thotë Ibn Haxheri, dijetarë i njohur i hadithit. Jahja b. Meini, e konsideron si ravi të besueshëm. Ebu Zur'a konsideron, që ai nuk mbante në mend mirë. Ahmed b. Hanbeli pohon, që hadithet të cilat i transmeton nga libri i vet, janë të besueshëm, derisa gabonte kur ishin në pyetje hadithet që i ka marrë nga librat e dijetarëve të tjerë. Nesaiu thotë, që nuk është ravi i keq. Buhariu, nga ai ka marrë dy hadithe dhe atë pa sened.

⁸³ Në bazë të këtij hadithi, Shafi, Ata', Tavusi dhe Ibn Xhurejxhi, konsiderojnë, që personi i cili arrin t'i falë sunnetet e sabahut para farzit, mund t'i falë të njëjtat edhe pastaj, menjëherë pas farzit apo para daljes së diellit. Evzaiu, Ahmed b. Hanbeli dhe Is'haku, konsiderojnë që është e mundur falja pas farzit, por vetëm atëherë kur dielli lind. Ebu Hanife, Muhammedi dhe Ebu Jusufi, konsiderojnë që, derisa dikush dëshiron, mund të falë pas lindjes së diellit, me atë që ata nuk e konsiderojnë të obliguar, sepse sunneti sipas mendimit të tyre është nafile.

Ebu Isai thotë: “Hadithi i Muhammed b. Ibrahim, nuk na është i njohur në këtë formë, përveç nëpërmjet Sa’d b. Seidit.”⁸⁴

Sufjan b. Ujejne, thotë: “Ata b. Ebu Rebbah, këtë hadith e ka dëgjuar nga Sa’d b. Seidi. Ndërkaq, ky hadith transmetohet si mursal.”

Disa dijetarë të Mekës, në frymë të këtij hadithi, thonë: “Nuk pengon që personi t’i falë dy reakte sunnet pas fardit, para se të lindë Dielli.”

Ebu Isai thotë: “Sa’d b. Seidi është vëllai i Jahja b. Seid el-Ensariut, derisa Kajsi është gjyshi i Jahja b. Seidit. Thuhet që ai është Kajs b. Amri, por thuhet edhe që është Kajs b. Kahd. Senedi i këtij hadithi nuk është i ngjitur, sepse Muhammed b. Ibrahim et-Tejmiu nuk ka dëgjuar nga Kajsi. Disa, këtë hadith e kanë transmetuar nga Sa’d b. Seidi, e ai nga Muhammed b. Ibrahim. Në atë transmetim qëndron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka dalë dhe e ka parë Kajsin.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَمْرِو السَّوَّاقِ الْبَلْخِيُّ، قَالَ حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ جَدِّهِ، قَيْسٍ قَالَ خَرَجَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَأَقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَصَلَّيْتُ مَعَهُ الصُّبْحَ ثُمَّ انْصَرَفَ النَّبِيُّ ﷺ فَوَجَدَنِي أَصْلَى فَقَالَ " مَهْلًا يَا قَيْسُ أَصَلَاتَانِ مَعًا " . قُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّي لَمْ أَكُنْ رَكْعَتِي الْفَجْرِ . قَالَ " فَلَا إِذَا " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ مُحَمَّدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ لَا نَعْرِفُهُ مِثْلَ هَذَا إِلَّا مِنْ حَدِيثِ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ . وَقَالَ سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ سَمِعَ عَطَاءُ بْنُ أَبِي رَبَاحٍ مِنْ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ هَذَا الْحَدِيثَ . وَإِنَّمَا يَرْوَى هَذَا الْحَدِيثَ مُرْسَلًا . وَقَدْ قَالَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ مَكَّةَ بِهَذَا الْحَدِيثِ لَمْ يَرَوْا بَأْسًا أَنْ يُصَلِّيَ الرَّجُلُ الرَّكْعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَكْتُوبَةِ قَبْلَ أَنْ تَطْلُعَ الشَّمْسُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَسَعْدُ بْنُ سَعِيدٍ هُوَ أَخُو يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ . قَالَ وَقَيْسٌ هُوَ جَدُّ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ وَيُقَالُ هُوَ قَيْسُ بْنُ عَمْرٍو وَيُقَالُ هُوَ قَيْسُ بْنُ قَهْدٍ . وَإِسْنَادُ هَذَا الْحَدِيثِ لَيْسَ بِمُتَّصِلٍ مُحَمَّدُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ التَّيْمِيُّ لَمْ يَسْمَعْ مِنْ قَيْسٍ . وَرَوَى بَعْضُهُمْ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ خَرَجَ فَرَأَى قَيْسًا . وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ الْعَزِيزِ عَنْ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ .

310. Mbi pritjen për ta falur atë (sunnetin) pas lindjes së diellit

باب مَا جَاءَ فِي إِعَادَتِهِمَا بَعْدَ طُلُوعِ الشَّمْسِ

421. Na ka treguar Ukbe b. Mukrem el-Amijj el-Basri⁸⁵ - atë e ka informuar Amër b. Asimi⁸⁶, atë Hemmami, duke transmetuar nga Katade,⁸⁷ ai nga Nadër b. Enesi, ai nga Beshir b. Nehiku, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush nuk arrin që t’i falë dy rekate sunnet të sabahut le t’i falë pasi që të lindë Dielli.”⁸⁸

Ebu Isai thotë: “Ky hadith nuk na është i njohur, përveç me këtë rrugë. Transmetohet, që Umeri ka vepruar⁸⁹ kështu, por edhe disa dijetarë kanë vepruar kështu. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Shafiut, Ahmedit, Is’hakut dhe i Ibn Mubarekut, i cili thotë: “Nuk na është e njohur që ndokush tjetër

⁸⁴ E kanë shënuar Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunene*, Ahmedit në *Musned* dhe Hakimi në *Mustedrek*.

⁸⁵ Ukbe b. Mukrem el-Ami Ebu Abdulmelik el-Basri është ravi i besueshëm. Ka transmetuar hadithe nga Jahjaa b. Seid el-Kattani, Gunder b. Mehdiu dhe të tjerët. Nga ai, hadithe kanë marrë Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe. Ebu Davudi, thotë: “Është i besueshëm.”

⁸⁶ Amr b. Asim b. Ubejdullah el-Kilabi el-Kajsi Ebu Uthman el-Basri, sipas mendimit të Nesaiut dhe Ibn Meinit, është ravi i besueshëm. Ibn Haxheri thotë, që është i sinkertë.

⁸⁷ Katade b. Diame es-Sedusi el-Basri, shquhet si hafiz i hadithit në kohën e vet. Nesaiu thotë që ka anuar kah tedlisi.

⁸⁸ Ky hadith, sipas mendimit të Hakimit, është i besueshëm sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit. Megjithatë, Abdurrahman el-Mubarekfuri, e konsideron si të dobët, sepse në senedin e tij gjendet Katade b. Diame es-Sedusi, i cili, sipas mendimit të Nesaiut, anon kah tedlisi.

⁸⁹ Maliku në *Muvetta*, shënon që Abdullah b. Umeri, sunnetet e sabahut i ka falur pas lindjes së diellit, atëherë kur nuk ka arritur që t’i falte para farzit.

këtë hadith me këtë kuptim dhe me këtë sened e ka transmetuar nga Hemmami, përveç Amër b. Asim el-Kilabiut.”

Është i njohur hadithi, të cilin Katade e transmeton nga Nadër b. Enesi – ai nga Beshir b. Nekiku, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush arrin ta falë një rekat të fardit të sabahut, para lindjes së Diellit, ai ka arritur ta falë sabahun (në kohë).”

حَدَّثَنَا عُقْبَةُ بْنُ مُكْرَمٍ الْعَمِّيُّ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَمْرُو بْنُ عَاصِمٍ، حَدَّثَنَا هَمَّامٌ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ النَّضْرِ بْنِ أَنَسٍ، عَنْ بَشِيرِ بْنِ نَهْيٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ لَمْ يُصَلِّ رَكْعَتِي الْفَجْرِ فَلْيُصَلِّهَا بَعْدَ مَا تَطْلُعُ الشَّمْسُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّهُ فَعَلَهُ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . قَالَ وَلَا نَعْلَمُ أَحَدًا رَوَى هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ هَمَّامٍ بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَ هَذَا إِلَّا عَمْرُو بْنُ عَاصِمٍ الْكِلَابِيُّ . وَالْمَعْرُوفُ مِنْ حَدِيثِ قَتَادَةَ عَنِ النَّضْرِ بْنِ أَنَسٍ عَنْ بَشِيرِ بْنِ نَهْيٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَنْ أَدْرَكَ رَكْعَةً مِنْ صَلَاةِ الصُّبْحِ قَبْلَ أَنْ تَطْلُعَ الشَّمْسُ فَقَدْ أَدْرَكَ الصُّبْحَ " .

311. Mbi katër rekate sunnet, para fardit të drekës

باب مَا جَاءَ فِي الْأَرْبَعِ قَبْلَ الظُّهْرِ

422. Na ka treguar Bundari⁹⁰ - atë e ka informuar Ebu Amiri⁹¹, atë Sufjani, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Asim b. Damre⁹² - që Aliu, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), para fardit të drekës i falte katër, ndërsa pas farzit dy rekate (sunnet).”⁹³

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja dhe Ummu Habibja. Hadithi i Aliut është hasen⁹⁴. Na ka treguar Ebu Bekër el-Atari që Ali b. Abdullahu ka thënë, duke transmetuar nga Jahja b. Seidi, ai nga Sufjani i cili ka thënë: “Ne e kemi njohur vlerën e hadithit të Asim b. Dameres, në krahasim me hadithin e Harithit.”

Sipas këtij hadithi, ka vepruar shumica e dijetarëve nga gjenerata e as'habëve dhe atyre pas tyre. Ata i japin përparësi mendimit, që personi para (fardit) të drekës duhet t'i falë katër rekate sunnet. Ky është qëndrimi edhe i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut dhe i Is'hakut.⁹⁵ Disa dijetarë thonë: “Namazet

⁹⁰ Bundari, është Muhammed b. Beshshari.

⁹¹ Emri i tij i plotë është Ebu Amir Abdulmelik b. Amr el-Kajsi el-Akadi. Është ravi i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së nëntë.

⁹² Asim b. Damre es-Seluli el-Kufi është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së tretë. Ali b. Medini dhe Ibn Meini e kanë vlerësuar si të besueshëm.

⁹³ Buhariu në *Sahih* shënon, që Aishja, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk i ka lëshuar katër rekate sunnet para dhe dy rekate pas farzit të drekës.”

⁹⁴ Në senedin e këtij hadithi është edhe Ebu Is'hak es-Subej'i, i cili, sipas mendimit të Mubarekfurit, ka anuar kah tedlisi, veçanërisht kur hadithet i ka transmetuar me *an*. Ai këtë hadith nga Asim b. Damrea e transmeton me *an*.

⁹⁵ Ebu Hanife, Sufjan eth-Thevriu, Ibn Mubareku dhe Is'haku, konsiderojnë, që katër rekate sunnet para namazit farz të drekës, duhet falur me një selam. Qëndrimin e tyre e bazojnë në hadithin vijues. Shënojnë Ebu Davudi, në *Sunen* dhe Tirmidhiu, në *Shemal*, nga Ebu Ejubi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për katër rekate sunnet para farzit të drekës pa dhënien e selamit dhe dy rekate të cilat falen pas tij, hapen dyert e qiellit.” Shënon Ibn Maxhe në *Sunen*, nga Ebu Ejubi: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka falur katër rekate kur Dielli lëvizte nga gjysma e qiellit dhe nuk jepte selam pas rekatit të dytë.” Ebu Davudi këtë hadith, e konsideron të dobët.

vullnetare të ditës dhe të natës falen dy nga dy rekate.” Ata konsiderojnë që pas çdo dy rekateve duhet dhënë selam. Ashtu thonë Shafi'u dhe Ahmedi.”⁹⁶

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ الْعَقَدِيُّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ صَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُصَلِّي قَبْلَ الظُّهْرِ أَرْبَعًا وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَأُمِّ حَبِيبَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَلِيٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ . قَالَ أَبُو بَكْرِ الْعَطَّارُ قَالَ عَلِيُّ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ عَنْ سُفْيَانَ قَالَ كُنَّا نَعْرِفُ فَضْلَ حَدِيثِ عَاصِمِ بْنِ صَمْرَةَ عَلَى حَدِيثِ الْحَارِثِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ يَخْتَارُونَ أَنْ يُصَلِّيَ الرَّجُلُ قَبْلَ الظُّهْرِ أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَإِسْحَاقَ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ صَلَاةُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مِثْلَى مِثْلَى يَزُورُ الْفَصْلَ بَيْنَ كُلِّ رَكْعَتَيْنِ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ .

312. Mbi dy rekate (sunnet) pas (fardit) të drekës

باب مَا جَاءَ فِي الرَّكْعَتَيْنِ بَعْدَ الظُّهْرِ

423. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ismail b. Ibrahim, duke transmetuar nga Ejubi, ai nga Nafi – që Ibn Umeri, ka thënë: “Me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i kam falur dy rekate (sunnet) para dreke dhe dy pas fardit të drekës.”⁹⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu edhe nga Aishja. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”⁹⁸

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ صَلَّيْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ رَكْعَتَيْنِ قَبْلَ الظُّهْرِ وَرَكْعَتَيْنِ بَعْدَهَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَعَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ صَحِيحٌ .

313. Edhe një kapitull mbi temën e njëjtë

باب مِنْهُ آخَرُ

424. Na ka treguar Abdulvarith b. Ubejdullah el-Atel el-Mirvezi – atë e ka informuar Abdullah b. Mubareku, duke transmetuar nga Halid el-Hazaiu, ai nga Abdullah b. Shekiki – që Aishja ka thënë: “I

⁹⁶ Ata mendimin e vet, e bazojnë në hadithin, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, Ebu Davudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, në *Sunene*, të Ibn Hibbanit dhe Ibn Huzejmes, në *Sahihë*, përmes Ali b. Abdullah el-Barikiut nga Abdullah b. Umeri, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Namazet (nafile) e natës dhe të ditës falen dy nga dy.” Ibn Haxheri thotë, që shumica e dijetarëve të hadithit, konsiderojnë, që fjala *të ditës* është e shtuar. Atë e ka shtuar dikush prej ravive, sepse, asnjëri nga ata, të cilët, këtë hadith e kanë marr drejtpërdrejtë nga Ibn Umeri, nuk e përmend këtë fjalë.

⁹⁷ Buhariu dhe Muslimi shënojnë, që Ibn Umeri, ka thënë: “Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i kam mbajtur në mend dhjetë rekate (sunnet): dy para dhe dy pas farzit të drekës, dy pas farzit të akshamit në shtëpi, dy pas farzit të jacisë dhe dy para farzit të sabahut.” Në shikim të parë, në mes këtyre haditheve, në të cilat qëndron se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), para dreke i ka falur dy rekate sunnet dhe hadithet nga kapitulli i mëparshëm, në të cilët qëndron, se i ka falur katër, ekziston kontradikta. Abdurrahman el-Mubarekfuri, atë e sqaron kështu:

a) Ekziston mundësia, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndonjëherë para dreke, i ka falur katër, ndërsa ndonjëherë dy rekate sunnet.

b) Që në shtëpi i ka falur dy rekate, mandej kur ka dalë në xhami i ka falur edhe dy rekate dhe Aishja atë e ka parë në shtëpi dhe në xhami, transmeton atë çfarë ka parë ajo, ndërsa Ibn Umeri e ka parë vetëm në xhami, e transmeton atë çfarë ka parë ai.

Që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur falte sunnetet në shtëpi, i falte katër rekate, ndërsa kur i falte në xhami i falte vetëm dy.

⁹⁸ Atë e kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahih*, në formë diç më të gjatë.

Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nëse nuk arrinte t'i falte katër rekate sunnet para fardit të drekës, i falte pas fardit të drekës.”⁹⁹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib,¹⁰⁰ në këtë formë na është i njohur vetëm nëpërmjet Ibn Mubarekut. E ka transmetuar në kuptim të ngjashëm edhe Kajs b. Rebiu, nga Shu'be, ndërsa ai nga Halid el-Hazaiu. Nuk na është e njohur, që ndokush tjetër përveç Kajs b. Rebiut, e ka transmetuar nga Shu'be. Është transmetuar nga Abdurrahman b. Ebu Lejl, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me të.”

حَدَّثَنَا أَبُو الْوَارِثِ بْنُ عُبَيْدٍ اللَّهِ الْعَتَكِيُّ الْمُرُوزِيُّ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ، عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ شَقِيقٍ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ إِذَا لَمْ يُصَلِّ أَرْبَعًا قَبْلَ الظُّهْرِ صَلَّاهُنَّ بَعْدَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ إِنَّمَا نَعْرِفُهُ مِنْ حَدِيثِ ابْنِ الْمُبَارَكِ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رَوَاهُ قَيْسُ بْنُ الرَّبِيعِ عَنْ شُعْبَةَ عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ نَحْوَ هَذَا . وَلَا نَعْلَمُ أَحَدًا رَوَاهُ عَنْ شُعْبَةَ غَيْرَ قَيْسِ بْنِ الرَّبِيعِ وَقَدْ رَوَى عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ هَذَا .

425. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Jezid b. Haruni, duke transmetuar nga Muhammed b. Abdullah esh-Shuajsiu, ai nga babai i vet, ai nga Anbes b. Ebu-Sufjani, që Ummu Habibe ka thënë, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Kush para fardit të drekës i falë (rregullisht) katër rekate (sunnet), Allahu atë ka për t’ia bërë të ndaluar zjarrit.”¹⁰¹

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.¹⁰² Përveç kësaj është transmetuar edhe me një rrugë tjetër.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا يَزِيدُ بْنُ هَارُونَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عُنَيْسَةَ بْنِ أَبِي سُفْيَانَ، عَنْ أُمِّ حَبِيبَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى قَبْلَ الظُّهْرِ أَرْبَعًا وَبَعْدَهَا أَرْبَعًا حَرَّمَ اللَّهُ عَلَى النَّارِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ وَقَدْ رُوِيَ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ .

426. Na ka treguar Ebu Bekër Muhammed b. Is'hak el-Bagdadi – atij i ka treguar Abdullah b. Jusuf et-Tunejs esh-Shami, atij i ka treguar Hejthem b. Humejd, atë e ka informuar Ala b. Harithi, duke transmetuar nga Kasim Ebu Abdurrahmani – që Anbes b. Ebu Sufjani, ka thënë: “E kam dëgjuar motrën time, Ummu Habiben, bashkëshorten e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Kush kujdeset për katër rekate sunnet para fardit të drekës dhe katër pas fardit të drekës, Allahu atë, ka për t’ia ndaluar Zjarrit.”¹⁰³

Ebu Isai thotë: “Ky hadith, në këtë formë është hasen-sahih-garib.¹⁰⁴ Kasimi është i biri i Abdurrahmanit, pseudonimin sipas të birit e ka Ebu Abdurrahman, është i mbrojturi i Abdurrahman b. Halid b. Jezid b. Muaviu. Ai është nga Shami. Është ravi i besueshëm. Ka qenë bashkëkohës i Ebu Umames.”

⁹⁹ Në transmetimin e këtij hadithi nga Ibn Maxhe, qëndron: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk arrinte t'i falte katër rekate sunnet të drekës para farzit, i falte ato pas farzit, pas sun-sunnetit.”

¹⁰⁰ Shevkani në veprën *Nejlul-Evtar*, pohon, që të gjithë ravitë, në senedin e këtij hadithi, janë të besueshëm.

¹⁰¹ Kjo, ka të bëjë me personin, përveç asaj, që i fal rregullisht dhe në kohë të gjitha farzet, kujdeset edhe për katër rekate të sunnetit të drekës. Kjo, nga ana tjetër, tregon mbi fortësinë dhe karakterin e imanit të tij.

¹⁰² Atë e shënojnë të gjithë, në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut. Sipas mendimit të Shevkanit, ky hadith është argument, që është mustehab falja e katër rekateve sunnet të drekës, para farzit dhe katër pas tij.

¹⁰³ Por, el-Karni, thotë, që është sunnet falja e dy rekateve sunnet pas farzit të ikindisë, ndërsa mustehab edhe dy.

¹⁰⁴ Atë e kanë shënuar edhe Ahmed i në *Musned* dhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ، مُحَمَّدُ بْنُ إِسْحَاقَ الْبَغْدَادِيُّ حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ يُوسُفَ النَّيْسَابُورِيُّ، حَدَّثَنَا الْهَيْثَمُ بْنُ حَمِيْدٍ، أَخْبَرَنِي الْعَلَاءُ، هُوَ ابْنُ الْحَارِثِ عَنِ الْقَاسِمِ أَبِي عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ عُنَيْسَةَ بِنِ أَبِي سَفْيَانَ، قَالَ سَمِعْتُ أُخْتِي أُمَّ حَبِيبَةَ، زَوْجَ النَّبِيِّ ﷺ نَقُولُ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ " مَنْ حَافِظٌ عَلَى أَرْبَعِ رَكَعَاتٍ قَبْلَ الظُّهْرِ وَأَرْبَعٍ بَعْدَهَا حَرَّمَهُ اللَّهُ عَلَى النَّارِ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَالْقَاسِمُ هُوَ ابْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ يُكْنَى أَبَا عَبْدِ الرَّحْمَنِ وَهُوَ مَوْلَى عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ خَالِدِ بْنِ يَزِيدَ بْنِ مُعَاوِيَةَ وَهُوَ ثِقَةٌ شَامِيٌّ وَهُوَ صَاحِبُ أَبِي أُمَامَةَ .

314. Mbi katër rekate sunnet para fardit të ikindisë

باب مَا جَاءَ فِي الْأَرْبَعِ قَبْلَ الْعَصْرِ

427. Na ka treguar Bundar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Ebu Amiri, atë Sufjani, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Asim b. Damre – që Aliu ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), para ikindisë i falte katër rekate duke i ndarë ato me teslim mbi melaiket e afërta (të Zotit) dhe atyre që i pasojnë ata, në mesin e muslimanëve dhe mu'minëve." ¹⁰⁵

Ebu Isai thotë: "Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri dhe Abdullah b. Amri. Hadithi i Aliut është hasen. Is'hak b. Ibrahim, në bazë të këtij hadithi i ka dhënë përparësi mendimit, që nuk duhet dhënë selam pas dy rekateve. Ai konsideron që fjalët *i ndante ato me teslim*, do të thotë: në mes tyre e bënte teshehudin."

Shafi'u dhe Ahmedi konsiderojnë, që edhe nafilet e natës edhe nafilet e ditës duhet të falen dy nga dy rekate. Të dytë, dhënie e selamit, pas çdo dy rektave, e konsiderojnë më të zgjedhur.

حَدَّثَنَا بُذَارٌ، مُحَمَّدُ بْنُ يَشَّارٍ حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ، هُوَ الْعَقَدِيُّ عَبْدُ الْمَلِكِ بْنُ عَمْرِو حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ صَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُصَلِّي قَبْلَ الْعَصْرِ أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ يَفْصِلُ بَيْنَهُنَّ بِالسَّلَامِ عَلَى الْمَلَائِكَةِ الْمُغْرَبِينَ وَمَنْ تَبِعَهُمْ مِنَ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُؤْمِنِينَ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ عَلِيٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَاخْتَارَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ أَنْ لَا يُفْصَلَ فِي الْأَرْبَعِ قَبْلَ الْعَصْرِ وَاحْتَجَّ بِهَذَا الْحَدِيثِ . وَقَالَ إِسْحَاقُ وَمَعْنَى أَنَّهُ يُفْصَلُ بَيْنَهُنَّ بِالسَّلَامِ يَعْنِي التَّسْهُدَ . وَرَأَى الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ صَلَاةَ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مَثْنَى مَثْنَى يَخْتَارَانِ الْفَصْلَ فِي الْأَرْبَعِ قَبْلَ الْعَصْرِ .

428. Na kanë treguar Jahja b. Musa, Ahmed b. Ibrahim, Mahmud Gajlani dhe të tjerët – ata i ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë e ka informuar Muhammed b. Muslim b. Mihrani, ai e ka dëgjuar gjyshin e vet kur ka transmetuar nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: "Allahu e mëshiroftë personin, i cili para ikindisë i falë katër (rekate sunnet)." Ebu Isai thotë: "Ky hadith është hasen-garib."

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، وَمَحْمُودُ بْنُ غِيْلَانَ، وَأَحْمَدُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ الدُّورَقِيُّ، وَغَيْرُ وَاحِدٍ، قَالُوا حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ مُسْلِمٍ بْنُ مِهْرَانَ، سَمِعَ جَدَّهُ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " رَحِمَ اللَّهُ امْرَأً صَلَّى قَبْلَ الْعَصْرِ أَرْبَعًا " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ حَسَنٌ .

¹⁰⁵ Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që ky hadith është argument, që falja e katër rekateve sunnet para ikindisë, është mustehab. Taberaniu në *Mu'xhemul-kebir* dhe në *Vesit*, shënon, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: "Kush rregullisht i falë katër rekate sunnet para ikindisë, zjarri nuk ka për t'ia prekur trupin." Taberaniu, gjithashtu, në *Mu'xhemil-kebir*, shënon nga Ummu Seleme, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: "Kush rregullisht i falë katër rekate (sunnet), para ikindisë, Allahu ka për t'ia ndaluar zjarrit të Xhehennemit për ta djegur trupin e tij." Ebu Davudi në *Sunnen*, shënon, me senedin nga Aliu, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), para ikindisë, i ka falur katër rekate sunnet. Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, se nga këto mund të konkludohet, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndonjëherë para ikindisë, i ka falur katër, e ndonjëherë dy rekate sunnet.

315. Mbi dy rekate (sunnat) pas (fardit) të akshamit dhe recitimit gjatë tyre

بَاب مَا جَاءَ فِي الرَّكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرَبِ وَالْقِرَاءَةِ فِيهِمَا

429. Na ka treguar Muhammed b. Musena – atë e ka informuar Behdel b. Muhabber, atë Abdulmelik b. Behdel b. Muhaber, atë Abdulmelik b. Ma’dan,¹⁰⁶ duke transmetuar nga Asim b. Behdeli,¹⁰⁷ ai nga Ebu Vaili – që Abdullah b. Mes’udi ka thënë: “Shumë herë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se si gjatë sunneteve pas akshamit dhe para sabahut, e recitonte *Kul ja ejjuhel-kafirun* dhe *Kul-huvallahu ehad*.”¹⁰⁸

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Ibn Umeri. Hadithi i Ibn Mes’udit është garib,¹⁰⁹ nuk na është i njohur përveç nëpërmjet Abdulmelik b. Ma’danit nga Asimi.”

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا بِدَلُّ بْنُ الْمُحَبَّرِ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْمَلِكِ بْنُ مَعْدَانَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ بَهْدَلَةَ، عَنْ أَبِي وَائِلٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، أَنَّهُ قَالَ مَا أَحْصَى مَا سَمِعْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ يَقْرَأُ فِي الرَّكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرَبِ وَفِي الرَّكَعَتَيْنِ قَبْلَ صَلَاةِ الْفَجْرِ بِ: (قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ) وَ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ). قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ مَسْعُودٍ حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ حَدِيثِ ابْنِ مَسْعُودٍ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ مَعْدَانَ عَنْ عَاصِمٍ .

316. Mbi atë, që ai ka falur në shtëpi

بَاب مَا جَاءَ أَنَّهُ يُصَلِّيهِمَا فِي الْبَيْتِ

430. Na ka treguar, Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ismail b. Ibrahim, ai ka transmetuar nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “Me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i kam falur dy rekate (sunnat) pas akshamit.”¹¹⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Rafi b. Hadixhe dhe Ka’b b. Uxhre. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”¹¹¹

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبرَاهِيمَ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمرَ، قَالَ صَلَّيْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ رَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرَبِ فِي بَيْتِهِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ رَافِعِ بْنِ خَدِيجٍ وَكَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

431. Na ka treguar, Hasan b. Ali el-Hulvani – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma’meri, ai ka transmetuar nga Ejubi, ai nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “Nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i kam mbejtur në mend dhjetë rekate (sunnat), të cilat ai i falte gjatë

¹⁰⁶ Abdulmelik b. Velid b. Ma’dani, është vlerësuar në mënyra të ndryshme nga dijetarët e hadithit. Jahja b. Meini, e konsideron të mirë. Buhariu thotë, që është diskutabile. Ebu Hatimi dhe Ibn Maxhe, e konsiderojnë si ravi të dobët.

¹⁰⁷ Asim b. Behdele b. Ebu Nexhudi, është imam i njohur në kiraet. Ne e pasojmë kiraetin e tij. Si ravi i hadithit është, siç pohon Ibn Haxheri, i sinqertë, por, nganjëherë gabonte. Nga ai hadithet i kanë transmetuar Buhariu dhe Muslimi.

¹⁰⁸ El-Mubarekfuri, konsideron, që ky hadith është argument, që në sunnetet e akshamit është bukur të recitohen dy sure.

¹⁰⁹ Sipas vlerësimit të el-Mubarekfurit, ky hadith është i dobët, për shkak të asaj, që në senedin e tij gjendet Abdulmelik b. Ma’dani, i cili është ravi i dobët. “Ndërkaq,” – thotë ai – “në shumë transmetime ka ardhur me shumë transmetime, të cilat në një mënyrë, e fuqizojnë atë.”

¹¹⁰ Ajo, që Ibn Umeri i ka falur sunnetet me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në shtëpinë e tij, sipas mendimit të El-Ajniut, nuk do të thotë, që i ka falur me xhemat, por, veç e veç. El-Mubarekfuri, në bazë të këtij hadithi, pohon, që sunnetet e akshamit, është më e këndshme të falen në shtëpi, sesa në xhami.

¹¹¹ Këtë hadith e ka shënuar Buhariu në *Sahih*.

natës dhe gjatë ditës: dy rekate para dhe dy rekate pas dreke, dy pas akshamit, dy pas jasisë. Ndërsa më ka treguar Hafsa” – thotë ai – “që edhe para sabahut i ka falur dy rekate.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen – sahih.”¹¹²

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ الْخَلَوَانِيُّ الْخَلَّالُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ خَفِضْتُ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ عَشْرَ رَكَعَاتٍ كَانَ يُصَلِّيْهَا بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ رَكَعَتَيْنِ قَبْلَ الطُّهْرِ وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَهَا وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرَبِ وَرَكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْعِشَاءِ الْآخِرَةِ . قَالَ وَحَدَّثَنِي حَفْصَةُ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي قَبْلَ الْفَجْرِ رَكَعَتَيْنِ . هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

432.- Na ka treguar Hasan b. Aliu – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma’meri, duke transmetuar nga Zuhriu, ai nga Salimi, ai nga Ibn Umeri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹¹³

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِثْلَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

317. Mbi vlerën e gjashtë rekateve të namazit vullnetar pas akshamit

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ التَّطَوُّعِ وَسِتِّ رَكَعَاتٍ بَعْدَ الْمَغْرَبِ

433. Na ka treguar Ebu Kurejbe, d.m.th., Muhammed b. Ala el-Hemdan el-Kufi – atë e ka informuar Zejd b. Hubabi, atë Umer b. Ebu Hasani, ai ka transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Kush pas akshamit i falë gjashtë rekate, duke mos folur ndërmjet tyre asgjë të keqe – është e barabartë me ibadetin e bërë dymbëdhjetë vite.”¹¹⁴

Është transmetuar nga Aishja, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush pas akshamit i falë njëzet rekate, Allahu, atij ka për t’ia ndërtuar një shtëpi në Xhenet.”¹¹⁵

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Hurejres është garib. Atë nuk e kemi të njohur përveç nëpërmjet Zejd b. Hubabit nga Umer b. Ebu Hath’ami. E kam dëgjuar Muhammed b. Ismailin, kur ka thënë: “Umer b. Abdullah b. Ebu Hath’am ka transmetuar hadithe-munker.” Ai, atë e konsideron ravi jashtëzakonisht të dobët.”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، - يَعْنِي مُحَمَّدَ بْنَ الْعَلَاءِ الْهُمْدَانِيَّ حَدَّثَنَا زَيْدُ بْنُ الْخُبَابِ، حَدَّثَنَا عُمَرُ بْنُ أَبِي خَنْعَمٍ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى بَعْدَ الْمَغْرَبِ سِتَّ رَكَعَاتٍ لَمْ يَتَكَلَّمْ فِيهَا بَيِّنَةً بِسُوءٍ عُذِلَ لَهُ بِعِبَادَةِ ثِنْتَيْ عَشْرَةَ سَنَةً " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رُوِيَ عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَنْ صَلَّى بَعْدَ الْمَغْرَبِ عَشْرِينَ رَكَعَةً بَنَى اللَّهُ لَهُ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ زَيْدِ بْنِ الْخُبَابِ عَنْ عُمَرَ بْنِ أَبِي خَنْعَمٍ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدَ بْنَ إِسْمَاعِيلَ يَقُولُ عُمَرُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي خَنْعَمٍ مُنْكَرُ الْحَدِيثِ . وَضَعَفَهُ جَدًّا .

¹¹² E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

¹¹³ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

¹¹⁴ Ky hadith është i dobët, sepse në senedin e tij, gjendet Umer b. Ebu Has’am, i cili, sipas vlerësimit të Buhariut, është jashtëzakonisht i dobët. Përkrah kësaj, u shërbente shumë ravive të besueshëm.

¹¹⁵ Këtë hadith e shënojnë Ibn Maxhe nga Ja’kub b. Veli del-Medainiut, ai nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, ai nga Aishja. Edh-Dhehebi, në veprën *El-Mizan*, pohon që Ahmed b. Hanbeli, Ebu Hatimi dhe Jahja b. Me’in Ja’kub b. Velidi e kanë konsideruar gënjeshtar. Sipas kësaj, ky hadith është apokrif.

318. Mbi dy rekate sunnet pas fardit të jaciesë

باب مَا جَاءَ فِي الرَّكَعَتَيْنِ بَعْدَ الْعِشَاءِ

434. Na ka treguar Ebu Seleme Jahja b. Halef – atë e ka informuar Bishr b. Mufeddal, ai ka transmetuar nga Halid el-Hadhau – që Abdullah b. Shekiku ka thënë: “E pyeta Ajshen, mbi namazin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ajo më tha: “Rregullisht i ka falur dy rekate (sunnet), para fardit të drekës¹¹⁶ dhe dy pas fardit të drekës, mandej, dy rekate pas fardit të akshamit dhe pas fardit të jaciesë dhe dy rekate sunnet para (fardit) të sabahut.”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu dhe Ibn Umeri. Hadithi i Abdullah b. Shekikut është hasen-sahih.”¹¹⁷

حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ، يَحْيَى بْنُ خَالْفٍ حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ الْمُفَضَّلِ، عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ شَقِيقٍ، قَالَ سَأَلْتُ عَائِشَةَ عَنْ صَلَاةِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَقَالَتْ كَانَ يُصَلِّي قَبْلَ الظُّهْرِ رَكْعَتَيْنِ وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ وَبَعْدَ الْمَغْرَبِ ثِنْتَيْنِ وَبَعْدَ الْعِشَاءِ رَكْعَتَيْنِ وَقَبْلَ الْفَجْرِ ثِنْتَيْنِ. قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَابْنِ عُمرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ شَقِيقٍ عَنْ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

319. Mbi atë, që namazi i natës falet dy nga dy rekate

باب مَا جَاءَ أَنَّ صَلَاةَ اللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى

435. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, ai ka transmetuar nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Namazi i natës, falet dy nga dy rekate.”¹¹⁸ Në rast se ke frikë se do të agojë, ti fale namazin vitër, vetëm një rekat. Bëjë ashtu, që namazi vitër të jetë namazi i fundit.”¹¹⁹

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Amër b. Abeseu. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”¹²⁰ Sipas tij veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që namazi i natës falet dy nga dy rekate. I këtillë është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut, Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " صَلَاةُ اللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى فَإِذَا خَفَتِ الصُّبْحُ فَأَوْزِرْ بِوَاحِدَةٍ وَاجْعَلْ آخِرَ صَلَاتِكَ وَتَرَا " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمرَ وَابْنِ عَبَّاسَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ صَلَاةَ اللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيِّ . وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

¹¹⁶ Në transmetimin e këtij hadithi nga Muslimi, qëndron, që Aishja ka thënë: “Në dhomën time, para farzit të drekës rregullisht i falte katër rekate sunnet, mandej dilte dhe i falte farzet si imam i xhematit.”

¹¹⁷ E shënon Muslimi në *Sahih*.

¹¹⁸ Në transmetimin e këtij hadithi nga Muslimi, qëndron, që Hutbe b. Hurejth, e ka pyetur Ibn Umerin: “Çfarë do të thotë ajo *dy nga dy*?” – e ai ka thënë: “Kjo do të thotë, të japësh selam pas çdo dy rekateve.”

¹¹⁹ Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, ky hadith është argument, që namazi i natës është më mirë të falet duke dhënë selam pas çdo dy rekateve. Gjithashtu, ky hadith është argument, që mund të falet vetëm një rekat i vitr namazit, nëse ekziston frika, që mund të vjen agimi (i diellit) dhe që vitr namazi mund të vjen në pyetje.

¹²⁰ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahih*.

320. Mbi vlerën e namazit të natës

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ صَلَاةِ اللَّيْلِ

436. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avane, ai ka transmetuar nga Ebu Bishri, ai nga Humejde b. Abdurrahman el-Himjeriu, e ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Pas ramazanit, agjërimi më i vlefshëm është, në muajin e Allahut, muharremin.”¹²¹ Ndërsa, pas namazit të obliguar më i vlefshëm është, namazi i natës.”¹²²

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabiri, Bilali dhe Ebu Uname. Hadithi i Ebu Hurejres, është hasen.”¹²³ Ebu Bishër quhet Xha’fer b. Ijasi, ndërsa në të vërtetë, ai është, Xha’fer b. Vahshijje Ijasi.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ أَبِي بَشْرٍ، عَنْ حُمَيْدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْجُمَيْرِيِّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَفْضَلُ الصَّيَامِ بَعْدَ شَهْرِ رَمَضَانَ شَهْرُ اللَّهِ الْمُحَرَّمُ وَأَفْضَلُ الصَّلَاةِ بَعْدَ الْفَرِيضَةِ صَلَاةُ اللَّيْلِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ وَبِلَالٍ وَأَبِي أُمَامَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَأَبُو بَشْرِ اسْمُهُ جَعْفَرُ بْنُ أَبِي وَحْشِيَّةٍ وَاسْمُ أَبِي وَحْشِيَّةٍ إِيَّاسٌ .

321. Mbi namazin e natës, të të Dërguarit

باب مَا جَاءَ فِي وَصْفِ صَلَاةِ النَّبِيِّ ﷺ بِاللَّيْلِ

437. Na ka treguar Is’hak b. Musa el-Ensari – atë e ka informuar Ma’ni, atë Maliku, duke transmetuar nga Seid b. Ebu Seid el-Makburi – që Ebu Seleme e ka pyetur Aishen, se si dukej namazi vullnetar i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë kohës së ramazanit, ajo ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë ramazanit, e as pas tij, nuk ka falur më tepër se njëmbëdhjetë rekate. Së pari i falte katër rekate, mos pyet mbi bukurinë dhe gjatësinë e tyre! Pastaj, i falte (edhe) katër rekate”¹²⁴ - mos pyet mbi bukurinë dhe gjatësinë e tyre – e pastaj i falte (edhe) tre rekate.”¹²⁵ Aishja thotë: “Unë thash: “O i Dërguari i Allahut, vallë, a ke për të fjetur pa e falur vitrin?” Ai tha: “O Aishe, (dije) edhe kur sytë e mi flenë, me të vërtetë, zemra ime nuk fle.”¹²⁶

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹²⁷

¹²¹ Tibi, konsideron, që këtu mendohet mbi agjërimin e ditës së ashures. Ali el-Karni, konsideron, që kjo ka të bëjë me muajin e plot të muharremit.

¹²² Neveviu konsideron, që ky hadith është argument, që namazi i natës është më i vlefshëm edhe se namazet e sunnetit. Sipas mendimit të shumicës, ata madje, janë më të vlefshëm se namazi i natës.

¹²³ Shënojnë edhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*, si dhe Ibn Huzejme në *Sahih*.

¹²⁴ Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që nga kjo vijmë në përfundim, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), namazin e natës e ka falur ashtu, që selam ka dhënë pas rekatit të katërt. Ai, pastaj, shumicën e namazit të natës, e ka falur ashtu, që selamin e ka dhënë pas çdo dy rekati, çfarë edhe kemi parë nga kapitulli i mëparshëm. Ndonjëherë, namazin e natës e falte duke dhënë selam në fund pas çdo katër rekati, çfarë na tregon edhe ky hadith. Ky është argument, që edhe mënyra e parë por edhe e dyta janë të lejuara.

¹²⁵ Ndonjëherë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kishte shprehur, që pasi i falte tetë rekate të namazit të natës, të shtrihej pak, e pasi që flinte pak, përsëri ngrihej dhe e falte namazin e vitrit. Andaj, edhe pyetja e Aishes: “Vallë, a ke për të fjetur para se ta falësh namazin e vitrit?”- sepse, pas faljes së gjatë të nafileve, deri natën vonë, ajo nuk e kishte të çartë, se ai prapë do të ngrihet, duke e ndërprerë gjumin, duke marr abdest për ta falur namazin e vitrit.

¹²⁶ Neveviu, në komentimin e Muslimit në *Sahih*, konsideron, që këtu ka të bëjë mbi specifitetet, të cilat janë karakteristikë vetëm e të Dërguarve të Allahut. Ibn Haxheri, konsideron, që të Dërguarit e Allahut, duke fjetur nuk e kanë humbur abdesin.

¹²⁷ Atë e shënojnë edhe Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنُ، حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي سَعِيدٍ الْمَقْبُرِيِّ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، أَنَّهُ أَخْبَرَهُ أَنَّهُ، سَأَلَ عَائِشَةَ كَيْفَ كَانَتْ صَلَاةُ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ بِاللَّيْلِ فِي رَمَضَانَ فَقَالَتْ مَا كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَزِيدُ فِي رَمَضَانَ وَلَا فِي غَيْرِهِ عَلَى إِحْدَى عَشْرَةِ رَكْعَةٍ يُصَلِّي أَرْبَعًا فَلَا تُسَالُّ عَنْ حُسْنِيَّهِنَّ وَطَوْلِيَّهِنَّ ثُمَّ يُصَلِّي ثَلَاثًا . فَقَالَتْ عَائِشَةُ فَقُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ أَتَنَامُ قَبْلَ أَنْ تُؤْتَرَ فَقَالَ " يَا عَائِشَةُ إِنَّ عَيْنِي تَنَامُ وَلَا يَنَامُ قَلْبِي " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

438. Na ka treguar Is'hak b. Musa el-Ensari – atë e ka informuar Ma'n b. Isa, atë Maliku, duke transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Urve – që Aishja ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), natën i falte njëmbëdhjetë rekate. Një rekat prej tyre e bënte vitër. Kur përfundonte, shtrihej mbi anën e djathtë.”

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنُ بْنُ عِيسَى، حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ غُرُوةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يُصَلِّي مِنَ اللَّيْلِ إِحْدَى عَشْرَةَ رَكْعَةً يُؤْتِرُ مِنْهَا بِوَاحِدَةٍ فَإِذَا فَرَغَ مِنْهَا اضْطَجَعَ عَلَى شِقِّهِ الْأَيْمَنِ .

439. Na ka treguar Kutejbe – duke transmetuar nga Maliku, ai nga Ibn Shihabi – ngjashëm me hadithin e mëparshëm. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، عَنْ مَالِكٍ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

322. Kapitulli mbi temë të njëjtë

باب مِنْهُ

440. Na ka treguar Ebu Kurejbe – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Shu'be, ai nga Ebu Xhemre¹²⁸ - që Ibn Abbasi ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), natën i falte trembëdhjetë rekate.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹²⁹

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، قَالَ حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ شُعْبَةَ، عَنْ أَبِي جَمْرَةَ الضُّبُعِيِّ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُصَلِّي مِنَ اللَّيْلِ ثَلَاثَ عَشْرَةَ رَكْعَةً . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو جَمْرَةَ الضُّبُعِيُّ اسْمُهُ تَصْرُ بْنُ عَمْرَانَ الضُّبُعِيُّ .

323. Edhe një kapitull mbi të njëjtën temë

باب مِنْهُ

441. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebul-Ahvesi, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Ibrahim, ai nga Esvedi b. Jezid – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), natën i falte nëntë rekate.”¹³⁰ Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre,

¹²⁸ Emri i plotë i Ebu Xhemres është Nasr b. Imran b. Isam ed-Dubai. Është vendosur në Horasan. Është ravi i besueshëm dhe i sigurt. I takon gjeneratës së tretë të ravive.

¹²⁹ E shënon Buhariu në *Sahih*, e gjithashtu edhe Ibn Abbasi.

¹³⁰ Sikurse që mund të shihet nga hadithet e përmendura, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e falte përherë numrin e njëjtë të rekateve të namazit të natës. Shumicën, së bashku me namazin e vitrit, i falte katërmëdhjetë rekate. Sikur që cek Aishja, ai as gjatë ramazanit e as pas ramazanit nuk ka falur më tepër se aq. Ndonjëherë, së bashku me vitrin i ka falur njëmbëdhjetë rekate. Derisa ishte më i ri dhe më i fuqishëm kurrë nuk ka falur më pak se nëntë rekate. Por, kur është plakur dhe është dobësuar, i falte – siç thotë Aishja – së bashku me vitrin shtatë rekate. Numër më i vogël se ky nuk përmendet.

Zejd b. Halidi dhe Fadl b. Abbasi. Ebu Isai thotë: “Hadithi i Aishes, në këtë formë, është hasen-garib.¹³¹

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ الْأَعْمَشِ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنِ الْأَسْوَدِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُصَلِّي مِنَ اللَّيْلِ تِسْعَ رَكَعَاتٍ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَزَيْدِ بْنِ خَالِدٍ وَالْفَضْلِ بْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

442. Në këtë kuptim të ngjashëm, e ka transmetuar edhe Sufjan eth-Thevriu nga A'meshi. Mbi atë na ka treguar Mahmud b. Gajlani dhe ka thënë: ‘Na ka informuar Jahja b. Ademi, duke transmetuar nga Sufjani, ndërsa ai nga A'meshi.’”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), namaz të natës ka falur më së tepërmi trembëdhjetë rekate me vitër, ndërsa më së paku nëntë rekate.”

وَرَوَاهُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ عَنِ الْأَعْمَشِ، نَحْوَ هَذَا حَدَّثَنَا بِذَلِكَ، مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ حَدَّثَنَا بِحَيْثُ بُنِ آدَمَ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، . قَالَ أَبُو عِيسَى وَكَثُرَ مَا رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي صَلَاةِ اللَّيْلِ ثَلَاثَ عَشْرَةَ رَكْعَةً مَعَ الْوُثْرِ وَأَقَلُّ مَا وُصِفَ مِنْ صَلَاتِهِ بِاللَّيْلِ تِسْعَ رَكَعَاتٍ .

Kur dikujt i kalon namazi i natës për shkak të fjeturit, ai i falë ato gjatë ditës

باب إِذَا نَامَ عَنْ صَلَاتِهِ، بِاللَّيْلِ صَلَّى بِالنَّهَارِ

433. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avani, duke transmetuar nga Katade, ai nga Zurare b. Evfi, ai nga Sa'd b. Hishami – që Aishja ka thënë: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për shkak të gjumit ose të përgjumurit nuk falte (asgjë) natën, ai të nesërmen i falte dymbëdhjetë rekate.”¹³² Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹³³

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ زُرَّارَةَ بْنِ أَوْفَى، عَنْ سَعْدِ بْنِ هِشَامٍ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا لَمْ يُصَلِّ مِنَ اللَّيْلِ - مَنَعَهُ مِنْ ذَلِكَ النَّوْمُ أَوْ غَلَبَتْهُ عَلَيْهِ صَلَاتُ مِنَ النَّهَارِ ثِنْتَيَّ عَشْرَةَ رَكْعَةً . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

444. Na ka treguar Abbasi, ndërsa ai është i biri i Abdul-Adhim el-Anberit - atë e ka informuar Attab b. Musenna – që Behz b. Hakimi ka thënë: “Një ditë Zurare b. Evfi, kadiu i Basras, duke u falur si imam, në fisin Benu Kashir, pasi që në namazin e sabahut recitoi: **“E, kur të fryhet në Sur, Atëherë ajo është ditë e vështirë.”** [El-Muddeththir: 8-9], ka rënë i vdekur. Edhe unë isha njëri nga ata të cilët e kanë dërguar në shtëpinë e tij.”¹³⁴

¹³¹ Muslimi, në *Sahih*, e shënon versionin diç më të gjatë të këtij hadithi, në të qëndron se Sa'd b. Hishami ka thënë: “I thash Aishes, nënës së besimtarëve: “Më informo mbi namazin e vitrit të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)!” Ajo tha: “Ne ia përgatisnim misvakun dhe ujin për avdes. Pasi që zgjohej natën – kur donte Allahu që të zgjohej – i lante dhëmbët me misvak, merrte avdes, mandej i falte nëntë rekate. Nuk ulej në namaz deri pas rekatit të tetë. Atëherë ulej, e falënderonte Allahun dhe i drejtonte lutje, mandej, pa dhënë selam ngrihej e falte rekatën e nëntë dhe ulej përsëri. Gjatë uljes, e madhëronte Allahun, e përmendte Atë, mandej selamin e jepte me zë për ta dëgjuar ne. Pas asaj ngrihej dhe i falte edhe dy rekate – gjithsejtë janë trembëdhjetë. Pasi që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është plakur dhe është trashur ca, i falte shtatë rekate namaz vitër, duke i falur në të njëjtën mënyrë edhe dy rekate, ato janë gjithsejtë nëntë rekate, biri im.”

¹³² Ky hadith është argument, që ai i cili rregullisht falë numër të caktuar rekatesh në namaz të natës, e i lëshon ato, mund t'i falë të njëjtat gjatë ditës. Në hadithin e Ibn Umerit, qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), zakonisht është falur nga lindja e diellit deri në mesditë.

¹³³ E shënon Muslimi në *Sahih*.

¹³⁴ Abdurrahman el-Mubarekfuri, thekson, që janë shënuar shumë raste, ku njerëzit e devotshëm, duke e mësuar dhe duke e dëgjuar ajetin mbi vdekjen, mbi Ditën e Gjykimit, apo vuajtjeve të xhehenemit, kanë vdekur nga frika e tmerrshme përpara asaj të vërtetë dhe pasigurie. Ai e cek rastin e Hulejdes, i cili, duke lexuar Kur'an në nafilet e natës, aq gjatë e ka përsëritur ajetin *Çdo qenie e gjallë ka për ta shijuar vdekjen*, që nga këndi i shtëpisë së tij është dëgjuar zëri: “Deri kur më ke për ta përsëritur atë atjet, tani më katër xhinë kanë vdekur të

حَدَّثَنَا عَبَّاسُ بْنُ عَبْدِ الْعَظِيمِ الْعَنْبَرِيُّ حَدَّثَنَا عَبَّابُ بْنُ الْمُنْتَنَى عَنْ بَهْزِ بْنِ حَكِيمٍ قَالَ كَانَ زُرَّارَةُ بْنُ أَوْفَى قَاضِي الْبَصْرَةِ وَكَانَ يَوْمَ فِي بَنِي مُشَيْرٍ فَقَرَأَ يَوْمًا فِي صَلَاةِ الصُّبْحِ: (فَإِذَا نُقِرَ فِي النَّاقُورِ * فَذَلِكَ يَوْمُنَا يَوْمَ عَسِيرٍ) فَخَرَّ مَيِّتًا فَكُنْتُ فِيمَنْ اخْتَمَلَهُ إِلَى دَارِهِ.

Ebu Isai thotë: “Sa’di është i biri i Hisham b. Amir el-Ensarit, ndërsa, Hisham b. Amiri është as’habi i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. قَالَ أَبُو عِيسَى وَسَعْدُ بْنُ هِشَامٍ هُوَ ابْنُ عَامِرٍ الْأَنْصَارِيُّ وَهِشَامُ بْنُ عَامِرٍ هُوَ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ.

324. Mbi zbritjen e Sunduesit të Bekuar çdo natë mbi qiellin tokësorë

باب مَا جَاءَ فِي نَزُولِ الرَّبِّ عَزَّ وَجَلَّ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا كُلِّ لَيْلَةٍ

445. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Jakub b. Abdurrahman el-Iskenderani, duke transmetuar nga Suhejl b. Ebu Salihi, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Allahu i Lartësuar dhe i Bekuar, zbret për çdo natë mbi qiellin tokësorë, kur kalon e treta e parë e natës dhe thotë: “Unë Jam Sunduesi, andaj, cili është ai që dëshiron të Më drejtohet me lutje, e Unë t’i përgjigjem? Cili është ai që dëshiron të kërkojë diç nga Unë, e Unë t’ia japë? Dhe, cili është ai që dëshiron të kërkojë falje nga Unë, e Unë ta falë atë?” Dhe pandërprerë kështu derisa nuk shfaqet agimi.”¹³⁵

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ali b. Ebu Talibi, Ebu Seidi, Rifae el-Xhuhenui, Xhubejr b. Mut’imi, Ibn Mes’udi, Ebu Derda dhe Uthman b. Ebu Asi. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.¹³⁶ Me shumë rrugë është transmetuar nga Ebu Hurejre, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Allahu i Lartësuar dhe i Bekuar, zbret kur fillon pjesa e tretë e fundit e natës.” Ky transmetim është më i besueshëm.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا يَعْقُوبُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْإِسْكَنْدَرَانِيُّ، عَنْ سُهَيْلِ بْنِ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " يَنْزِلُ اللَّهُ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا كُلِّ لَيْلَةٍ حِينَ يَمْضِي ثُلُثُ اللَّيْلِ الْأَوَّلِ فَيَقُولُ أَنَا الْمَلِكُ مَنْ ذَا الَّذِي يَدْعُونِي فَاسْتَجِبْ لَهُ مَنْ ذَا الَّذِي يَسْأَلُنِي فَأُعْطِيهِ مَنْ ذَا الَّذِي يَسْتَغْفِرُنِي فَأَغْفِرَ لَهُ فَلَا يَزَالُ كَذَلِكَ حَتَّى يُضِيَءَ الْفَجْرُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ وَأَبِي سَعِيدٍ وَرَقَاعَةَ الْجُهَنِيِّ وَجُبَيْرِ بْنِ مُطْعِمٍ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي الدَّرْدَاءِ وَعُثْمَانَ بْنِ أَبِي الْعَاصِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ مِنْ أَوْجُهٍ كَثِيرَةٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَرَوَى عَنْهُ أَنَّهُ قَالَ " يَنْزِلُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ حِينَ يَبْقَى ثُلُثُ اللَّيْلِ الْآخِرِ " . وَهُوَ أَصَحُّ الرِّوَايَاتِ .

tronditur me përsëritjen tënde të vazhdueshme të asaj të vërtete të pashmangshme, nga e cila askush nuk mund të ikën!”

¹³⁵ Dijetarët kanë divergjenca, në pikëpamje të kuptimit të fjalës së zbriturit. Ata konsiderojnë, që Ai me qenien e Vet zbret në qiellin e kësaj bote. Ndërkaq, sipas mendimit të shumë dijetarëve, krahasimi i Allahut të Lartësuar me çfarëdo, është absolutisht e palejueshme dhe e papranueshme. Disa, siç janë mu’tezilët dhe harixhitë, të gjitha hadithet, në të cilat flitet mbi zbritjen e Allahut, në qiellin e kësaj bote, i refuzojnë duke i konsideruar të pabesueshëm. Qëndrimi i të gjithë dijetarëve selefi, është, që në të tëra që kanë ardhur në Kur’an dhe sunnet, duhet besuar, duke mos diskutuar mbi mënyrën dhe cilësinë. Sipas asaj, duhet besuar që Allahu i Lartësuar zbret në pjesën e tretë të natës, çdo natë mbi qiellin e kësaj toke. Se a vetëm me mëshirën e Vet, me diturinë e Vet dhe me fuqinë e Vet, ose me qenien e Vet, në mënyrën, në të cilën vetëm Atij i përshtatet – në atë nuk duhet lëshuar tepër. Mendja jonë përafërsisht e kufizuar, nuk është në gjendje që t’i kuptoj gjërat edhe më të thjeshta, po si atëherë mund të kuptoj ato që kanë të bëjnë me Sunduesin e botëve, cilësitë dhe emrat e Tij.

¹³⁶ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

325. Mbi recitimimin gjatë natës

باب مَا جَاءَ فِي قِرَاءَةِ اللَّيْلِ

446. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Jahja b. Is'haku, atë Hammad b. Seleme, ai ka transmetuar nga El-Bunami, ai nga Abdullah b. Rebbah el-Ensari, ndërsa ai nga Ebu Katade - që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka thënë Ebu Bekrit: “Unë kalova afër teje, e ti ishe duke lexuar me zë të lehtë!” Ebu Bekri tha: “Në të vërtetë, jam duke biseduar, me Atë i Cili më dëgjon pa e ngritur zërin.” Në atë, ai tha: “Ngrite pak zërin!” Umeri ka thënë: “Kalova afër teje, e ti ishe duke lexuar me zë të ngritur!” Ai tha: “Jam duke recituar për të zgjuar atë i cili fle dhe për ta larguar shejtanin.” Ai tha: “Ule pak zërin!”¹³⁷

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Umi-Hane, Enesi, Ummu Seleme dhe Ibn Abbasi.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ إِسْحَاقَ، هُوَ السَّالِجِيُّ حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ سَلَمَةَ، عَنْ ثَابِتِ بْنِ أَنَسٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ رِبَاحٍ الْأَنْصَارِيِّ، عَنْ أَبِي قَتَادَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ لِأَبِي بَكْرٍ " مَرَرْتُ بِكَ وَأَنْتَ تَقْرَأُ وَأَنْتَ تَخْفِضُ مِنْ صَوْتِكَ " . فَقَالَ إِنِّي أَسْمَعُ مَنْ نَاجَيْتُ . قَالَ " ارْفَعْ قَلِيلًا " . وَقَالَ لِعُمَرَ " مَرَرْتُ بِكَ وَأَنْتَ تَقْرَأُ وَأَنْتَ تَرْفَعُ صَوْتَكَ " . قَالَ إِنِّي أَوْقِظُ الْوَسْطَانِ وَأَطْرُدُ الشَّيْطَانَ قَالَ " اخْفِضْ قَلِيلًا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَأُمِّ هَانِيٍّ وَأَنْسٍ وَأُمِّ سَلَمَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ .

447. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Muavi b. Salihu – që Abdullah b. Ebu Kajsi, ka thënë: “E kam pyetur Aishen, se si dukej të recituarit e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (në namazin e natës) natën – a recitonte në vete apo me zë, ajo ka thënë: “Të gjitha ato i bënte. Ndonjëherë recitonte në vete, e ndonjëherë me zë.” Unë thash: “Falënderimi i takon Allahut, që ka lënë gjerësi në atë.”¹³⁸

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ مُعَاوِيَةَ بْنِ صَالِحٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي قَبَيْسٍ، قَالَ سَأَلْتُ عَائِشَةَ كَيْفَ كَانَ قِرَاءَةُ النَّبِيِّ ﷺ بِاللَّيْلِ أَكَانَ يُسِرُّ بِالْقِرَاءَةِ أَمْ يَجْهَرُ فَقَالَتْ كُلُّ ذَلِكَ قَدْ كَانَ يَفْعَلُ رُبَّمَا أَسْرًا بِالْقِرَاءَةِ وَرُبَّمَا جَهْرًا . فَقُلْتُ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي جَعَلَ فِي الْأَمْرِ سَعَةً .

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është sahih-garib.¹³⁹ Ky hadith i Ebu Katades është garib. Atë me sened nga Hammadi e ka transmetuar Jahja b. Seidi. Shumica e dijetarëve këtë hadith e kanë transmetuar nga Thabiti, ndërsa ai nga Abdullah b. Rebbahi, si mursel.”

قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَإِنَّمَا أَسْنَدُهُ يَحْيَى بْنُ إِسْحَاقَ عَنْ حَمَّادِ بْنِ سَلَمَةَ وَأَكْثَرُ النَّاسِ إِنَّمَا رَوَوْا هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ ثَابِتٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ رِبَاحٍ مُرْسَلًا .

448. Na ka treguar, Ebu Bekër Muhammed b. Nafi el-Basriu – atë e ka informuar Abdusammed b. Abdulvarithi, duke transmetuar nga Ismail b. Muslim el-Abdi, ai nga Ebu Mutevekkil en-Naxhiu – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një ajet falej (tërë) natën.”¹⁴⁰ Ebu Isai thotë: “Ky hadith në këtë formë është hasen-garib.”¹⁴¹

¹³⁷ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ebu Davudi në *Sunen*, qëndron: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), një natë ka dalë nga shtëpia dhe e ka takuar Ebu Bekrin duke e falur namazin e natës. Kur’an ka recituar me zë të ulët. Pastaj, ka kaluar pranë Umerit, i cili ishte duke e falur namazin e natës duke recituar Kur’an me zë të ngritur. Të nesërmen, kur jemi takuar tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai i tha Ebu Bekrit: ‘Kalova pranë teje, e ti recitoje me zë të ulët...’”

¹³⁸ Ky hadith është argument, që në namazin e natës është i lejuar recitimi në vete dhe me zë. Megjithatë, hadithi i Ebu Katades është argument, që është mustehab recitimi me zë mesatar – as shumë pa zë dhe as shumë me zë.

¹³⁹ Shënojnë të gjithë autorët në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut.

¹⁴⁰ Nesaiu dhe Ibn Maxhe, shënojnë, që Ebu Dherri, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tërë natën, deri në sabah, në (namazin e natës) recitonte vetëm një ajet. E ai ajet është ky: “*Nëse*

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ، مُحَمَّدُ بْنُ نَافِعٍ الْبَصْرِيُّ حَدَّثَنَا عَبْدُ الصَّمَدِ بْنُ عَبْدِ الْوَارِثِ، عَنْ إِسْمَاعِيلَ بْنِ مُسْلِمٍ الْعَبْدِيِّ، عَنْ أَبِي الْمُثَنَّى النَّاجِيِّ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَامَ النَّبِيُّ ﷺ بِأَيِّهِ مِنَ الْقُرْآنِ لَيْلَةً. قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ.

326.- Mbi vlerën e faljes në shtëpi, të namazit vullnetar

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ صَلَاةِ النَّطُوعِ فِي الْبَيْتِ

449. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Muhammed b. Xha'feri, atë Abdullah b. Seid b. Ebu Hindi,¹⁴² duke transmetuar nga Salim Ebu Nadri,¹⁴³ ai nga Jusra b. Seidi, ai nga Zejd b. Thabiti – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Më i vlefshëm është namazi, të cilin e falni në shtëpitë tuaja, përveç namazit të obliguar (fardit).”¹⁴⁴

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ سَعِيدٍ بْنُ أَبِي هَنْدٍ، عَنْ سَالِمِ أَبِي النَّضْرِ، عَنْ بُسْرِ بْنِ سَعِيدٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " أَفْضَلُ صَلَاتِكُمْ فِي بُيُوتِكُمْ إِلَّا الْمَكْتُوبَةَ " .

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Umer b. Hattabi, Xhabir b. Abdullahu, Ebu Seidi, Ebu Hurejre, Ibn Umeri, Aishja, Abdullah b. Sa'di dhe Zejd b. Halid el-Xhuhejniu. Hadithi i Zejd b. Thabitit është hasen.¹⁴⁵ Dijetarët janë ndarë në transmetimin e këtij hadithi. Musa b. Ukbe dhe Ibrahim b. Ebu Nadir, atë e transmetojnë si merfu, derisa disa dijetarë e transmetojnë si hadith-mevkuf. Maliku, atë e ka transmetuar nga Ebu Nadri, por nuk e ka lidhur atë për të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Hadithi i cili lidhet për të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është më i besueshëm.”

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَأَبِي سَعِيدٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَعَائِشَةَ وَعَبْدَ اللَّهِ بْنِ سَعْدٍ وَزَيْدِ بْنِ خَالِدٍ الْجُهَنِيِّ. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ. وَقَدْ اخْتَلَفَ النَّاسُ فِي رَوَايَةِ هَذَا الْحَدِيثِ فَرَوَاهُ مُوسَى بْنُ عُقْبَةَ وَإِبْرَاهِيمُ بْنُ أَبِي النَّضْرِ عَنْ أَبِي النَّضْرِ مَرْفُوعًا وَرَوَاهُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ عَنْ أَبِي النَّضْرِ وَلَمْ يَرْفَعْهُ وَأَوْفَقَهُ بَعْضُهُمْ وَالْحَدِيثُ الْمَرْفُوعُ أَصَحُّ.

450.- Na ka treguar Is'hak b. Mensuri – atë e ka informuar, Abdullah b. Numejni, duke transmetuar nga, Ubejdullah b. Umeri, ai nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut

Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (El-Maide: 118).”

Muhammed b. Nasri, ka shënuar, diç më të gjatë, hadithin për namazin e natës. Në të qëndron, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tërë namazin e tij të natës, deri në lindje, e ka falur vetëm me një ajet. Me të ka bërë edhe ruku edhe sexhde dhe me të është lutur. Ai ajet është: “**Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.**” Në fund të hadithit, qëndron, që Abdullahu, ka thënë: “I Dërguar i Allahut – të dua më shumë se babain dhe nënën time – ti tërë natën je falur vetëm me një ajet, me të bën ruku dhe sexhde dhe me të lutesh, ndërsa Allahu të ka mësuar tërë Kur'anin!” Ai tha: “Jam lutur për umetin tim.”

¹⁴¹ El-Mubarekfuri, thotë: “Në senedin e këtij hadithi, gjendet Ebu Bekr Muhammed b. Nafi el-Basri, gjendja e të cilit nuk më është e njohur.”

¹⁴² Abdullah b. Seid b. Ebu Hind el-Fezari el-Medeni, është i sinqertë. Ibn Meini dhe Ahmed b. Hanbeli e vlerësojnë atë si ravi të besueshëm. Nga ai hadithe kanë marrë në *El-Kutubus-sitte*.

¹⁴³ Salim b. Ebu Umejje Ebu Nadr et-Tejmi el-Medeni, është ravi i besueshëm dhe i sigurt. Nga ai, hadithe kanë marrë në *El-Kutubus-sitte*. Ka transmetuar hadithe mursal.

¹⁴⁴ Nga ky hadith, mund të përfundojmë, siç pohon el-Mubarekfuri, që të gjitha namazet nafile (vullnetare), përveç namazit të bajramit, namazit me rastin e Eklipsit të Diellit dhe të Hënës dhe namazit për lutje për shiun, më mirë është të falen në shtëpi, sesa në xhami. Të gjitha namazet e obliguara, më mirë është të falen në xhami.

¹⁴⁵ E shënojnë, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ibn Maxhes, porse në këtë formë: “Namazi i personit është më i vlefshëm në shtëpinë e tij, përveç namazit të obliguar.”

qoftë mbi të), ka thënë: “Faluni në shtëpitë tuaja, e mos i shndërroni ato në varreza.”¹⁴⁶ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”¹⁴⁷

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ ثُمَيْرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " صَلُّوا فِي بُيُوتِكُمْ وَلَا تَتَّخِذُوهَا قُبُورًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

¹⁴⁶ Edhe kjo, ka të bëjë me namazet vullnetare, në çka bien edhe namazet e sunnetit. Namazet farz, sipas mundësisë, duhet falur ekskluzivisht në xhami.

¹⁴⁷ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

Në emër të Allahut, Mëshiruesit të Gjithmëshirshmit!

Kapitulli mbi vitrin

أَبْوَابُ الْوَيْتْرِ

327. Mbi vlerat e namazit të vitrit

بَابُ مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الْوَيْتْرِ

451. Na ka treguar Kutejbe – atij i ka treguar Lejth b. Sa'di, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Habibi, ai nga Abdullah b. Reshid ez-Zevfiu, ai nga Abdullah b. Ebu Mure ez-Zevfiu – që Harixhe b. Hudhafe,¹⁴⁸ ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (me një rast) doli para nesh dhe tha: ‘Allahu na ka shtuar (edhe) një namaz, ai për ju është më i mirë se bagëtitë më të mira.’¹⁴⁹ Ai është namazi vitër. Allahu ua ka obliguar, në mes namazit të jacisë dhe agimit, derisa nuk shfaqet.”¹⁵⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Abdullah b. Amri, Burejde dhe Ebu Busre, mikut të të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Hadithi i Harixhe b. Hudhafes është garib¹⁵¹. Na është i njohur, vetëm nëpërmjet Jezid b. Ebu Habibit. Ndonjëri, nga muhadithët, ka gabuar në këtë hadith kur ka thënë: ‘Abdullah b. Rashid ez-Zureku.’”¹⁵²

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ رَاشِدٍ الزُّوْفِيِّ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي مُرَّةٍ الزُّوْفِيِّ، عَنْ خَارِجَةَ بْنِ خُذَافَةَ، أَنَّهُ قَالَ خَرَجَ عَلَيْنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَقَالَ " إِنَّ اللَّهَ أَمَدَّكُمْ بِصَلَاةٍ هِيَ خَيْرٌ لَكُمْ مِنْ حُمْرِ النَّعَمِ الْوَيْتْرِ جَعَلَهُ اللَّهُ لَكُمْ فِيمَا بَيْنَ صَلَاةِ الْعِشَاءِ إِلَى أَنْ يَطْلُعَ الْفَجْرُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَبُرَيْدَةَ وَأَبِي بَصْرَةَ الْعَفَّارِيِّ صَاحِبِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ خَارِجَةَ بْنِ خُذَافَةَ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ . وَقَدْ وَهَمَ بَعْضُ الْمُحَدِّثِينَ فِي هَذَا الْحَدِيثِ فَقَالَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ رَاشِدٍ الزُّرَقِيِّ وَهُوَ وَهْمٌ فِي هَذَا .

¹⁴⁸ Harixhe b. Hudhafe, është as'hab i njohur dhe kalorës i shquar kurejshit, të cilin e kanë krahasuar me njëmijë kalorës të tjerë. Pas vdekjes së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka jetuar në Egjipt. Në vitin dyzet, sipas hixhretit, e ka vlarë një harixhi, duke menduar që është Amr b. As. Me të vërtetë, tre harixhi janë betuar që kanë për ta vlarë, Aliun, Muavinë dhe Amr b. Asin. Secili është kthyer në drejtimin e vet për ta kryer detyrën. Është vlarë vetëm Aliu. Në vend të Amr b. Asit, është vlarë Harithe b. Hudhafe.

¹⁴⁹ Humru-neam, është lloji më i mirë i devesë, të cilat kanë qenë kapitali më i dashur i Arapëve të atëhershëm. Ky, në të vërtetë, është aludim mbi këtë botë dhe çdo gjë që ka mbi të, e cila, sado që është tërheqës, është kalimtare, derisa veprat e mira zgjasin përgjithmonë.

¹⁵⁰ Ebu Hanife, në lidhje me këtë hadith, ka marrë qëndrim që namazi i vitrit është vaxhib.

¹⁵¹ Këtë hadith, e ka shënuar edhe Hakimi në *Mustedrek* dhe ka thënë, që senedi i tij është i besueshëm.

¹⁵² Në rregull është Abdullah b. Rashid ez-Zevfi.

328. Mbi atë, që vitri nuk është namaz i obliguar

بَاب مَا جَاءَ أَنَّ الْوُثْرَ لَيْسَ بِحُتْمٍ

452. Na ka treguar Ebu Kurejb – atë e ka informuar Ebu Bekër b. Ajjashi, atë Ebu Is'haku, duke transmetuar nga Asim b. Damre – që Aliu, ka thënë: “Vitri, nuk është i obliguar, siç janë namazet e juaja të obliguara (fardet). Atë, e ka konstatuar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke thënë: “Me të vërtetë Allahu është Tek dhe e do numrin tek. Andaj faleni vitrin, o pasuesit e Kur'anit!”¹⁵³

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ عَيَّاشٍ، حَدَّثَنَا أَبُو إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ الْوُثْرُ لَيْسَ بِحُتْمٍ كَصَلَاتِكُمْ الْمَكْتُوبَةِ وَلَكِنْ سَنَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَقَالَ " إِنْ اللَّهَ وَثَرَ يُحِبُّ الْوُثْرَ فَأَوْتِرُوا يَا أَهْلَ الْقُرْآنِ " .

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Ibn Mes'udi dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Aliut është hasen.”¹⁵⁴

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَلِيٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ .

Sufjan eth-Thevriu dhe të tjerët, transmetojnë nga Ebu Is'haku – ai nga Asim b. Damre – që Aliu ka thënë: “Namazi i vitrit, nuk është i obliguar në atë formë, në të cilën është i obliguar namazi i urdhëruar, por ai është sunnet të cilin e ka konstatuar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

وَرَوَى سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ، وَغَيْرُهُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ الْوُثْرُ لَيْسَ بِحُتْمٍ كَهَيْئَةِ الصَّلَاةِ الْمَكْتُوبَةِ وَلَكِنْ سُنَّةٌ سَنَّهَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ .

453. Mbi atë, na ka treguar Bundari dhe ka thënë: “Ne, na ka informuar Abdurrahman b. Mehdiu, duke transmetuar nga Sufjani.” Ebu Isai thotë: “Kjo është më e besueshme se hadithi i Ebu Bekër b. Ajjashit. Ndërsa ka transmetuar edhe Mensur b. Mu'temiri nga Ebu Is'haku, ngjashëm me transmetimin e Ebu Bekër b. Ajjashit.”

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ عَنْ سُفْيَانَ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ . وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ أَبِي بَكْرِ بْنِ عَيَّاشٍ . وَقَدْ رَوَاهُ مَنْصُورُ بْنُ الْمُعْتَمِرِ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ نَحْوَ رَوَايَةِ أَبِي بَكْرِ بْنِ عَيَّاشٍ .

329. Mbi mos pëlqimin e të fjeturit para faljes së namazit të vitrit

بَاب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ النَّوْمِ قَبْلَ الْوُثْرِ

445. Na ka treguar Ebu Kurejb – atë e ka informuar Zekerija b. Ebu Zaidi, ai ka transmetuar nga Israili, ai nga Isa b. Garrei, ai nga Sha'bi, ai nga Ebu Thevr el-Ezdiu – që Ebu Hurejre, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më ka urdhëruar që ta fali namazin e vitrit para se të bie të flejë.”¹⁵⁵ Isa b. Ebu Garri, thotë: “Esh-Sha'bi, e falte namazin e vitrit, me fillimin e natës, pastaj binte për të fjetur.”

¹⁵³ Shumica e dijetarëve islam, në bazë të këtij hadithi, kanë vërtetuar, që namazi i vitrit nuk është vaxhib, por është sunnet.

¹⁵⁴ E kanë shënuar Nesaiu në *Sunen* dhe Hakimi në *Mustedrek*. Hakimi, e ka vlerësuar sahih.

¹⁵⁵ Buhariu dhe Muslimi, shënojnë, që Ebu Hurejre, ka thënë: “Shoku im më ka porositur tri gjëra: që nga secili muaj të agjëroj tre ditë, të fali dy rekate të namazit duha dhe të mos flejë para se të fali namazin e vitrit.” Muslimi, fjalët e njëjta i ka shënuar nga Ebu Derda, ndërsa Nesaiu nga Ebu Dherri. Ibn Haxher el-Askalani

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ زَكَرِيَّا بْنُ أَبِي زَائِدَةَ، عَنْ إِسْرَائِيلَ، عَنْ عِيسَى بْنِ أَبِي عَزَّةَ، عَنِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ أَبِي ثَوْرٍ الْأَزْدِيِّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ أَمَرَنِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ أَنْ أُوتِرَ قَبْلَ أَنْ أَنْامَ .

Ebu Isa thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Dherri. Në këtë formë, hadithi i Ebu Hurejres është hasen-garib.¹⁵⁶

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي ذَرٍّ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

Emri i Ebu Thevr el-Ezdiut është Habib b. Ebu Mulejke. Disa dijetarë nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, kanë përzgjedhur mendimin, në të cilin qëndron, që personi, nuk duhet të flejë, para se ta falë namazin e vitrit.”

Është transmetuar që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush frikohet se nuk do të mund të zgjohej në fund të natës, atëherë namazin-vitër le ta falë që në fillim të saj. E kush është në gjendje të zgjohet, (le ta falë) para fundit të natës, sepse në recitimin e Kur’anit, në fund të natës, janë të pranishme melaiket, kjo është më e mirë për të.”

وَأَبُو ثَوْرٍ الْأَزْدِيُّ اسْمُهُ حَبِيبُ بْنُ أَبِي مُلَيْكَةَ . وَقَدْ اخْتَارَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ أَنْ لَا يَنَامَ الرَّجُلُ حَتَّى يُوتَرَ . وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " مَنْ خَشِيَ مِنْكُمْ أَنْ لَا يَسْتَيْقِظَ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ فَلْيُوتِرْ مِنْ أَوَّلِهِ وَمَنْ طَمِعَ مِنْكُمْ أَنْ يَقُومَ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ فَلْيُوتِرْ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ فَإِنْ قَرَأَ الْقُرْآنَ فِي آخِرِ اللَّيْلِ مُحْضُورَةً وَهِيَ أَفْضَلُ " .

455. Na ka treguar Hennadi dhe ka thënë: “Neve na ka lajmëruar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Ebu Sufjani, ai nga Xhabiri, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ هَنَادٌ حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ عَنِ الْأَعْمَشِ عَنْ أَبِي سُفْيَانَ عَنْ جَابِرٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ بِذَلِكَ .

330. Mbi vitrin, në fillim dhe në fund të natës

باب مَا جَاءَ فِي الْوُتْرِ مِنْ أَوَّلِ اللَّيْلِ وَآخِرِهِ

456. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ebu Bekër b. Ajjashi, atë Ebu Hasin, duke transmetuar nga Jahja b. Vessabi – që Mesruku, e ka pyetur Aishen, mbi vitr-namazin të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ajo ka thënë: “Ai, vitr-namazin e falte në çdo pjesë të natës – në fillim, në mes dhe në fund. Pak para vdekjes, vitrin e falte para agimit.”¹⁵⁷

Ebu Isai, thotë: “Emri i Ebu Hasinit është Uthman b. Asim el-Esedi. Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Xhabiri, Ebu Mes’udi, el-Ensari dhe Ebu Katade. Hadithi i Aishes, është hasen-sahih.¹⁵⁸ Mendimi i përzgjedhur i dijetarëve, është, që vitër-namazi është më mirë të falet në fund të natës.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ عَيَّاشٍ، حَدَّثَنَا أَبُو حَصِينٍ، عَنْ يَحْيَى بْنِ وَثَّابٍ، عَنْ مَسْرُوقٍ، أَنَّهُ سَأَلَ عَائِشَةَ عَنْ وَتْرِ، رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَقَالَتْ مِنْ كُلِّ اللَّيْلِ قَدْ أُوتِرَ أَوَّلُهُ وَأَوْسَطُهُ وَآخِرُهُ فَانْتَهَى وَتَرُهُ حِينَ مَاتَ إِلَى السَّحَرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى أَبُو حَصِينٍ اسْمُهُ عُثْمَانُ بْنُ

konsideron, që është mustehab falja e namazit të vitrit para gjumit, vetëm për ata të cilët frikësohen se më vonë, natën, nuk mund të zgjohen. Neveviu, thotë: “Për ata të cilët mund të zgjohen, më mirë është që namazin e vitrit ta falin në fund të natës.”

¹⁵⁶ Buhariu dhe Muslimi, e kanë shënuar në formën e përmendur.

¹⁵⁷ Ky hadith është argument i çartë, që namazi i vitrit është i lejuar të falet në çdo kohë të natës – jo shumë larg pas jacisë, në mes apo në fund të natës – me atë që, është më mirë që të falet në fund të natës.

¹⁵⁸ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

عاصِمِ الْأَسَدِيِّ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَجَابِرٍ وَأَبِي مَسْعُودٍ الْأَنْصَارِيِّ وَأَبِي قَتَادَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهُوَ الَّذِي اخْتَارَهُ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ الْوَثْرُ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ .

331. Mbi namazin e vitrit, nga shtatë rekate

باب مَا جَاءَ فِي الْوَثْرِ بِسَبْعٍ

457. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Amër b. Murre, ai nga Jahja b. Xhezzari – që Ummu Seleme, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i falte trembëdhjetë rekate të vitër-namaz. Por, kur është moshuar dhe është dobësuar fizikisht, i falte shtatë rekate të vitër-namazit.”¹⁵⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Aishja. Hadithi, i Ummu Selemes, është hasen.”¹⁶⁰

Transmetohet që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka falur vitrin, trembëdhjetë, njëmbëdhjetë, nëntë, shtatë tre dhe një rekat.¹⁶¹

Is'hak b. Ibrahim, ¹⁶² thotë: “Ajo, që transmetohet se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka falur trembëdhjetë rekate vitër, do të thotë, që së bashku me vitër i ka falur trembëdhjetë rekate namaz të natës, duke ia përshkruar namazin e natës vitrit.” Ai, mbi këtë, e transmeton hadithin nga Aishja. Ai, atë e bazon, mbi atë, që është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të):. “Falen vitrin, o pasuesit e Kur'anit!” Ai ka thënë: “Kjo ka të bëjë me namazin e natës, sepse namazi i natës, është prezent vetëm te pasuesit e Kur'anit.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ الْأَعْمَشِ، عَنْ عَمْرِو بْنِ مُرَّةَ، عَنْ يَحْيَى بْنِ الْجَرَّارِ، عَنْ أُمِّ سَلَمَةَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُوتِرُ بِثَلَاثِ عَشْرَةٍ رَكْعَةً فَلَمَّا كَبُرَ وَضَعَتْ أُوتِرَ بِسَبْعٍ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أُمِّ سَلَمَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ الْوَثْرُ بِثَلَاثِ عَشْرَةٍ وَإِحْدَى عَشْرَةٍ وَتِسْعٍ وَسَبْعٍ وَخَمْسٍ وَثَلَاثٍ وَوَاحِدَةٍ . قَالَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ مَعْنَى مَا رُوِيَ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يُوتِرُ بِثَلَاثِ عَشْرَةٍ قَالَ إِنَّمَا مَعْنَاهُ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي مِنَ اللَّيْلِ ثَلَاثَ عَشْرَةٍ رَكْعَةً مَعَ الْوَثْرِ فَتُسَبِّحُ صَلَاةُ اللَّيْلِ إِلَى الْوَثْرِ . وَرَوَى فِي ذَلِكَ حَدِيثًا عَنْ عَائِشَةَ وَاحْتَجَّ بِمَا رُوِيَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " أَوْتَرُوا يَا أَهْلَ الْقُرْآنِ " . قَالَ إِنَّمَا عَلَى بِهِ قِيَامُ اللَّيْلِ يَقُولُ إِنَّمَا قِيَامُ اللَّيْلِ عَلَى أَصْحَابِ الْقُرْآنِ .

¹⁵⁹ Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, në këto trembëdhjetë rekate marrin pjesë, namazi i natës dhe vitri, madje edhe sunneti i sabahut. Atë e vërtetojnë edhe hadithet në vijim. Buhariu shënon, me senedin nga Aishja: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë natës i falte gjithsejtë trembëdhjetë rekate. Aty merrnin pjesë namazi i natës, namazi i vitrit dhe dy rekate të sunnetit të sabahut.

Në transmetimin e këtij hadithi, te Muslim qëndron: “I falte dhjetë rekate të nafileve të natës, një rekat të namazit të vitrit dhe dy rekate të namazit të sabahut (pas asaj) – ato janë gjithsejtë trembëdhjetë rekate.”

¹⁶⁰ Shënon Nesaiu në *Sunen*.

¹⁶¹ Kjo nënkupton, që vitri bashkohet me namazin e natës. Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*, dhe Ebu Davudi, në *Sunen*, shënojnë nga Abdullah b. Ebu Kajsi, duke transmetuar nga Aishja: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka praktikuar faljen e katër rekateve të namazit të natës dhe tri vitër, gjashtë rekate namaz të natës dhe tri vitër, tetë rekate namaz të natës dhe tri vitër dhe dhjetë rekate namaz të natës dhe tri vitër. Asnjëherë nuk ka falur (së bashku me vitër) më shumë se trembëdhjetë, e as më pak se shtatë rekate.”

¹⁶² Is'hak b. Ibrahim është Is'hak b. Rahivejh.

332. Mbi namazin e vitrit nga pesë rekate

باب مَا جَاءَ فِي الْوُتْرِ بِخَمْسٍ

457. Na ka treguar Is'hak b. Mensuri – atë e ka informuar Abdullah b. Numejri, atë Hisham b. Urve, duke transmetuar nga babai i vet – që Aishja, ka thënë: “Namazi i natës, i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përbëhej nga trembëdhjetë rekate. Prej tyre i falte pesë rekate si vitër-namaz. Gjatë tyre nuk ulej, përveç në fund. Kur muezini e thërriste ezanin (e sabahut), ngrihej dhe i falte dy rekate më të shkurtra (sunset).”¹⁶³

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُصْطَوِرٍ الْكُوسَجِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ نُمَيْرٍ، حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَتْ صَلَاةُ النَّبِيِّ ﷺ مِنَ اللَّيْلِ ثَلَاثَ عَشْرَةٍ رُكْعَةً يُوتَرُ مِنْ ذَلِكَ بِخَمْسٍ لَا يَجْلِسُ فِي شَيْءٍ مِنْهُنَّ إِلَّا فِي آخِرِهَا فَإِذَا أَدَّى الْمُؤَدِّي قَامَ فَصَلَّى رُكْعَتَيْنِ خَفِيفَتَيْنِ .

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, hadith është transmetuar edhe nga Ebu Ejubi. Hadithi i Aishes është hasen-sahih.¹⁶⁴ Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve, konsiderojnë, që namazi i vitrit duhet falur pesë rekate. “Nuk duhet” – thonë ata – “të ulen askund, përveç në fund.”

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي أَيُّوبَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَغَيْرُهُمُ الْوُتْرَ بِخَمْسٍ وَقَالُوا لَا يَجْلِسُ فِي شَيْءٍ مِنْهُنَّ إِلَّا فِي آخِرِهَا .

333. Mbi vitër-namazin, nga tre rekate

باب مَا جَاءَ فِي الْوُتْرِ بِثَلَاثٍ

458. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Bekër b. Ajjashi, ai ka transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Harithi,¹⁶⁵ që Aliu ka thënë: “I Dërguari i Allahut, vitër-namazin e falte nga tre rekate. Gjatë tyre, i recitonte nëntë sure sipas radhës El-Mufessal. Në çdo rekat i recitonte tre sure. E fundit prej tyre ka qenë *Kul-huvallahu ehad*.”¹⁶⁶

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرٍ بْنُ عِيَّاشٍ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ الْحَارِثِ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُوتَرُ بِثَلَاثٍ يَقْرَأُ فِيهِنَّ بِسْمِ اللَّهِ سُورَ مِنَ الْمُفَصَّلِ يَقْرَأُ فِي كُلِّ رُكْعَةٍ بِثَلَاثِ سُورٍ آخِرُهُنَّ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) .

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Imran b. Husajni, Aishja, Ibn Abbasi, Ebu Ejubi, Abdurrahman b. Ebzi dhe Ubejj b. Ka’bi. Transmetohet gjithashtu, nga Abdurrahman b. Ebzi, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).¹⁶⁷ Disa, kanë

¹⁶³ Të gjitha transmetimet e përmendura, na udhëzojnë në atë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk ka falur gjithmonë numër të njëjtë të rekateve të namazit të vitrit. Ndonjëherë ka falur një rekat, në të shumtën e rasteve tri, e ky hadith tregon që ka falur edhe pesë rekate duke u ulur vetëm në fund. Të gjitha këto janë argumente të çarta, që te namazi i vitrit, nuk është urdherë decidivë numri i rekateve, mirëpo që ky namaz mund të bëhet në mënyra të shumta dhe me numër të ndryshëm rekatesh.

¹⁶⁴ Shënojnë Buhari dhe Muslimi në *Sahihë*.

¹⁶⁵ Harith b. Abdullah el-A’veri, është mbështetësi i Aliut. Ai është shiit. Shabij dhe Ibn Medini, e konsiderojnë gënjeshtar.

¹⁶⁶ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*, qëndron që shejhu i Ahmedit, Esved b. Amri ka thënë: “Në rekatën e parë, i lexonte suret *El-haku mu-tekathur*, *Inna enzelnahi dhe Idha zul-zilet il erdu zilzaleha*. Në rekatën e dytë, lexonte *Vel-asri*, *Inna A’tajnakel kevther dhe Idha xha’e*. Në rekatën e tretë, lexonte: *Kul ja ejjuhel-kafirun*, *Tebbet-jeda dhe Kul-huvallahu ehad*. ”

¹⁶⁷ Hadithin, të cilin e transmeton Abdurrahman b. Ebz drejtpërdrejtë nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e shënojnë Nesaiu, Tahaviu, Ahmed b. Abd b. Humejdi. Dijetarët janë ndarë rreth asaj, se a ka qenë Abdurrahman b. Ebz as’hab dhe a ka mundur që ai t’i dëgjonte drejtpërdrejt nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), apo ndoshta i ka marr hadithet nëpërmjet Ubejj b. Ka’bit. Buhariu, Ebu Haxheri,

transmetuar kështu, duke mos e përmendur nga Ubejje. Disa e kanë përmendur nga Abdurrahman b. Ebzi nga Ubejje.¹⁶⁸ Disa dijetarë, nga gjenerata e as'habëve, i përmbahen kësaj. Ata konsiderojnë, që personi duhet t'i falë tre rekate vitër-namaz."

Suffjani, thotë: "Nëse dëshiron, mund t'i falësh pesë, mundesh tre, ndërsa mundesh edhe një rekat të vitër-namazit.¹⁶⁹ Është mustehab falja e tre rekateve të vitër-namazit." Ky është qëndrimi i Ibn Mubarekut dhe i dijetarëve kufjan.

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عِمْرَانَ بْنِ حُصَيْنٍ وَعَائِشَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي أُيُوبَ . وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ أَبِي عَنْ أَبِي بِنِ كَعْبٍ وَبُرْوَى أَيْضًا عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي عَنْ النَّبِيِّ ﷺ . هَكَذَا رَوَى بَعْضُهُمْ فَلَمْ يَذْكُرُوا فِيهِ عَنْ أَبِي وَذَكَرَ بَعْضُهُمْ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي عَنْ أَبِي . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ ذَهَبَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِلَى هَذَا وَرَأَوْا أَنَّ يُوتَرِ الرَّجُلُ بِثَلَاثٍ . قَالَ سُفْيَانُ إِنَّ شَيْئًا أَوْتَرْتُ بِخَمْسٍ وَإِنْ شَيْئًا أَوْتَرْتُ بِثَلَاثٍ وَإِنْ شَيْئًا أَوْتَرْتُ بِرَكْعَةٍ . قَالَ سُفْيَانُ وَالَّذِي اسْتَحَبُّ أَنْ أَوْتَرَ بِثَلَاثٍ رَكْعَاتٍ . وَهُوَ قَوْلُ ابْنِ الْمُبَارَكِ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ .

459. Na ka treguar Seid b. Ja'kub et-Talekani, atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, ai ka transmetuar nga Hishami – që Muhammed b. Sirini ka thënë: "E falnin (as'habët dhe tabi'inët) vitër-namazin nga pesë rekate, nga tre rekate dhe nga një rekat – dhe të tëra këto i konsideronin të mira."

حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ يَعْقُوبَ الطَّلَقَانِيُّ حَدَّثَنَا حَمَادُ بْنُ زَيْدٍ عَنْ هِشَامٍ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ قَالَ كَانُوا يُوتَرُونَ بِخَمْسٍ وَبِثَلَاثٍ وَبِرَكْعَةٍ وَيَرَوْنَ كُلَّ ذَلِكَ حَسَنًا .

334. Mbi namazin e vitrit nga një rekat

باب مَا جَاءَ فِي الْوُتْرِ بِرَكْعَةٍ

460. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi – që Enes b. Sirini,¹⁷⁰ ka thënë: "E pyeta Ibn Umerin: 'A kam për t'i zgjatur dy rekatet e sunnetit të sabahut?' Ai tha: 'I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), namazin e natës e falte dy nga dy rekate. E falte një rekat të vitër-namazit, ndërsa, dy rekatet e sunnetit të sabahut, i falte me nxitim (në atë mënyrë i falë) ai që e dëgjon ikametin."¹⁷¹

Ebu Isai, thotë: "Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Xhabiri, Fadl b. Abbasi, Ebu Ejubi dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.¹⁷² Sipas tij veprojnë disa dijetarë nga gjenerata e as'habëve dhe e tabi'inëve. Ata konsiderojnë, që personi duhet t'i ndajë (me selam) dy

tahaviu dhe dijetarët e tjerë, pohojnë, se ai ka qenë as'hab dhe që hadithet i ka marr drejtpërdrejt nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

¹⁶⁸ Në *El-Kutubus-sitte*, e kanë shënuar të gjithë, përveç Tirmidhiut, nga Abdurrahman b. Ebzi, e ai nga Ubejj b. Ka'bi, këtë: "I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në namazin e vitrit ka lexuar *Sebbihisme rabbikel-a'la*, *Kul ja ejjuhel-kafirun* dhe *Kul-huvallahu ehad*."

¹⁶⁹ E shënojnë Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe, në *Sunene*, nga Ebu Ejub el-Ensari, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: "Namazi i vitrit është obligim, për secilin pasues të islamit. Ashtu që, kush dëshiron të falë namazin e vitrit pesë rekate, le ta falë. Kush dëshiron ta falë nga tri rekate, le ta falë. E kush dëshiron ta falë vetëm një rekat namaz vitër, le ta falë."

¹⁷⁰ Enes b. Sirini, është vëllai i lindur i dijetarit të njohur nga gjenerata e tabi'inëve, Muhammed b. Sirini.

¹⁷¹ Në bazë të këtij hadithi, Ebu Jusufi, Muhammedi dhe Shafiu, kanë vërtetuar, që është mustehab, që te namazi i natës, selami të jepet pas çdo dy rekati, por është e lejuar falja edhe e vetëm një rekati të namazit të vitrit. Në këtë hadith, Ibn Umeri thotë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka falur sunnetet e sabahut shkurtë dhe aq me shpejtësi, sikur që i falë personi i cili e dëgjon ikametin dhe frikësohet se do të vonohet në farz.

¹⁷² Shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

reakte nga i treti dhe ta falë një rekat vitër-namaz.” Ashtu mendojnë, Maliku, Shafiu, Ahmedi dhe Is’haku.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ سَبْرِينَ، قَالَ سَأَلْتُ ابْنَ عُمَرَ فَقُلْتُ أُطِيلُ فِي رُكْعَتِي الْفَجْرِ فَقَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُصَلِّي مِنَ اللَّيْلِ مِائَتَيْ مِائَتَيْنِ وَيُوتِرُ بِرُكْعَةٍ وَكَانَ يُصَلِّي الرُّكْعَتَيْنِ وَالْأَذَانَ فِي أَذْنِهِ . يَعْنِي يُخَفِّفُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَجَابِرٍ وَالْفَضْلِ بْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي أُيُوبَ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَالتَّابِعِينَ رَأَوْا أَنْ يَفْصَلَ الرَّجُلُ بَيْنَ الرُّكْعَتَيْنِ وَالتَّالِثَةِ يُوتِرُ بِرُكْعَةٍ . وَبِهِ يَقُولُ مَالِكٌ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

335. Çfarë recitohet në vitër-namazin

باب مَا جَاءَ فِيمَا يُقْرَأُ بِهِ فِي الْوُتْرِ

461. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Sheriku, ai ka transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Seid b. Xhubejri – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në vitër-namazin, recitonte *Sebbihisme rabbikel-e’ala, Kul ja ejjuhel kafirun, Kul-huvallahu ehad*, në çdo rekat nga një sure.”¹⁷³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuara hadithe edhe nga Aliu, Aishja, Abdurrahman b. Ebzi, ai nga Ubejje b. Ka’bi, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se në rekatën e tretë të vitër-namazit ka recituar *Muavedhetejn* dhe *Kul-Huvallahu ehad*. Shumica e dijetarëve, nga gjenerata e as’habëve dhe të atyre pas tyre, konsiderojnë, që duhet recituar *Sebbihine rabbike-e’ala, Kul ja ejjuhel kafirun* dhe *Kul-HuvAllahu ehad* – dhe atë në çdo rekat nga një prej tyre.

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا شَرِيكٌ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُقْرَأُ فِي الْوُتْرِ بِ (سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى) وَ (قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ) وَ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) فِي رُكْعَةٍ رُكْعَةٍ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَعَائِشَةَ وَعَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي رَافٍ عَنْ أَبِي بِنِ الْكُغْبِ وَيَزُودُ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي رَافٍ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رُوِيَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَرَأَ فِي الْوُتْرِ فِي الرُّكْعَةِ الثَّالِثَةِ بِالْمُعَوِّذَتَيْنِ وَ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) . وَالَّذِي اخْتَارَهُ أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ أَنْ يُقْرَأَ بِ (سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى) وَ (قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ) وَ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) . يُقْرَأُ فِي كُلِّ رُكْعَةٍ مِنْ ذَلِكَ بِسُورَةٍ .

462. Na ka treguar Is’hak b. Ibrahim b. Habib b. Shehid el-Basri – atë e ka informuar Muhammed b. Seleme el-Harrani, ai ka transmetuar nga Husajfe – që Abdulaziz b. Xhurejxhi, ka thënë: “E kam pyetur Aishen: ‘Çfarë ka recituar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në vitër-namazin?’ – ajo tha: ‘Në rekatën e parë e recitonte *Sebbihinne rabbikel-e’ala*, në rekatën e dytë *Kul ja ejjuhel-kafirun*, ndërsa në të tretin *Kul-Huvallahu ehad* dhe *Muavidhetejn*.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib¹⁷⁴. Abdulazizi është i ati i Ibn Xhurejxhit,¹⁷⁵ e nxënësi i Atait. Emri i Ibn Xhurejxhit është Abdulmelik b. Abdulaziz b. Xhurejxh. Këtë hadith e ka transmetuar Jahja b. Seid el-Ensari, nga Amre, ai nga Aishja, ndërsa ai, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

¹⁷³ Në bazë të këtij hadithi dhe atyre të ngjashëm me të, Ebu Hanife ka vërtetuar, që namazi i vitrit përmban ekskluzivisht tri rekate. Sipas tij, nuk mund të falen as më shumë, e as më pak se tri rekate namaz të vitrit.

¹⁷⁴ Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, është diskutabile se a mund të konsiderohet ky hadith hasen, për shkak të dy arsyeve: 1) Abdulaziz b. Xhurejxhi, nuk e ka dëgjuar hadithin nga Aishja; 2) në senedin e këtij hadithi gjendet Husajfi, i cili para fundit të jetës së tij është bërë harrestar – ashtu që nuk dihet sigurt, se Muhammed b. Seleme këtë hadith e ka marr nga ai, para apo pas kësaj gjendjeje.

¹⁷⁵ Ibn Xhurejxhi, është dijetar i njohur i fik’hut dhe përmbledhës i haditheve nga Mekka. Ka vdekur në vitin 150 sipas hixhretit. Ibn Xhurejxhi, thotë: “Nga Ata b. Ebu Rebbahu, kam mësuar shtatëmbëdhjetë hadithe.”

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ بْنِ حَبِيبِ بْنِ الشَّهِيدِ الْبَصْرِيِّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سَلَمَةَ الْحَرَّانِيُّ، عَنْ خُصَيْفٍ، عَنْ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ جُرَيْجٍ، قَالَ سَأَلْنَا عَائِشَةَ بِأَيِّ شَيْءٍ كَانَ يُوتَرُ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ قَالَتْ كَانَ يَقْرَأُ فِي الْأُولَى بِ (سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى) وَفِي الثَّانِيَةِ بِ (قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ) وَفِي الثَّلَاثَةِ بِ (قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ) وَالْمُعَوِّذَاتَيْنِ. قَالَ أَبُو عِيسَى. وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ. قَالَ وَعَبْدُ الْعَزِيزِ هَذَا هُوَ وَالِدُ ابْنِ جُرَيْجٍ صَاحِبِ عَطَاءٍ وَابْنِ جُرَيْجٍ اسْمُهُ عَبْدُ الْمَلِكِ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ جُرَيْجٍ. وَقَدْ رَوَى يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيُّ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ عَمْرَةَ عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ.

336. Mbi duanë e Kunutit në vitër-namazin

باب ما جاء في القنوت في الوتر

463. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebul-Ahves, ai ka transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Burejde b. Ebu Merjemi,¹⁷⁶ ai nga Ebul-Havrai – që Hasan b. Aliu, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) m’i ka mësuar fjalët, të cilat i shqiptoj në vitër-namaz: “O Allah, më udhëzo në rrugë të drejtë me ata që i ke udhëzuar! Më mbrojtë, me ata që i ke mbrojtur! Më bëjë të afërt me Ty, me ata të cilët i ke bërë të afërt me Ty! Më beko në atë që më ke dhuruar! Më ruaj nga e keqja e asaj që e ke caktuar – sepse, Ti, çdo gjë që dëshiron mundesh dhe asnjëri caktimin Tënd nuk mund ta ndryshojë! Nuk mund të jetë i nënçmuar, ai të cilin Ti e mbron! Sunduesi ynë, Ti je i Bekuar dhe i Lartësuar!”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Aishja. Ky hadith është hasen,¹⁷⁷ në këtë formë, na është i njohur, vetëm nëpërmjet Ebul-Havas es-Sa’dij, ndërsa emri i tij është Rebi b. Shejban. Asgjë nuk është e lidhur, për duanë e Kunutit nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e transmetuar nga ky.”

Dijetarët janë ndarë, në pikëpamje të duasë së Kunutit në vitër-namazin. Abdullah b. Mes’udi, konsideron, që duanë e Kunutit në namazin e vitrit, duhet recituar gjatë tërë vitit dhe atë, para rukusë. Ky, është qëndrimi i disa dijetarëve, në mesin e të cilëve janë, Sufjan Eth-Thevriu, Ibn Mubareku, Is’haku dhe dijetarët e Kufës.¹⁷⁸

Transmetohet që Ali b. Ebu Talibi, nuk e recitonte duanë e Kunutit, përveç në gjysmën e dytë të ramazanit. Ai duanë e Kunutit, e recitonte pas rukusë. Disa dijetarë, e mbështesin qëndrimin e këtillë. Në mesin e tyre janë, Shafi’u dhe Ahmedî.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْزَصِ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ بُرَيْدِ بْنِ أَبِي مَرْيَمَ، عَنْ أَبِي الْحَوَّارِ السَّعْدِيِّ، قَالَ قَالَ الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَلَّمَنِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ كَلِمَاتٍ أَقُولُهُنَّ فِي الْوُتْرِ " اللَّهُمَّ اهْدِنِي فِيمَنْ هَدَيْتَ وَعَافِنِي فِيمَنْ عَافَيْتَ وَتَوَلَّنِي فِيمَنْ تَوَلَّيْتَ وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَ وَقِي شَرَّ مَا قَضَيْتَ فَإِنَّكَ تَقْضِي وَلَا يَقْضِي عَلَيْكَ وَإِنَّهُ لَا يَدُلُّ مَنْ وَالَيْتَ تَبَارَكْتَ رَبَّنَا وَتَعَالَيْتَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ مِنْ حَدِيثِ أَبِي الْحَوَّارِ السَّعْدِيِّ وَاسْمُهُ رِبْعَةُ بْنُ شُبَّانٍ . وَلَا نَعْرِفُ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ فِي الْقُنُوتِ فِي الْوُتْرِ شَيْئًا أَحْسَنَ مِنْ هَذَا . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْقُنُوتِ فِي الْوُتْرِ فَرَأَى عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مَسْعُودٍ الْقُنُوتَ فِي الْوُتْرِ فِي السَّنَةِ كُلِّهَا وَاخْتَارَ الْقُنُوتَ قَبْلَ الرُّكُوعِ . وَهُوَ قَوْلُ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ وَإِسْحَاقُ وَأَهْلُ

¹⁷⁶ Burejd b. Ebu Merjem es-Seluli el-Basri, është ravi i besueshëm. Ka vdekur në vitin 144 sipas hixhretit.

¹⁷⁷ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

¹⁷⁸ Ebu Hanife, konsideron, që dua e Kunutit në namazin e vitrit, shqiptohet gjatë tërë vitit, që duhet të shqiptohet para rukusë në rekatin e tretë dhe që duhet, para shqiptimit të duasë së Kunutit të shqiptohet tekbi duke i ngritur duart. Ai qëndrimin e këtillë e mbështetë mbi hadithin, të cilin e shënon Ibn Maxhe nga Ubejj b. Ka’bi. Në atë hadith qëndron, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duanë e Kunutit gjatë vitrit e ka shqiptuar në rekatin e tretë, para rukusë. Ai gjithashtu, hadithin e vet e fuqizon edhe me hadithin, të cilin e shënon Buhariu, në *Sahih*, në kapitullin *El-Megazi*. Një njeri, e ka pyetur Enesin, se dua e Kunutit a shqiptohet pas rukusë apo pas përfundimit të këndimit, ai ka thënë: “Pas përfundimit të këndimit.”

الْكُوفَةِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ أَبِي طَالِبٍ أَنَّهُ كَانَ لَا يَقْنُتُ إِلَّا فِي الصَّنْفِ الْآخِرِ مِنْ رَمَضَانَ وَكَانَ يَقْنُتُ بَعْدَ الرُّكُوعِ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ .

337. Mbi personin i cili fle dhe i kalon vitri, apo e harron atë

بَاب مَا جَاءَ فِي الرَّجُلِ يَنَامُ عَنِ الْوُثْرِ أَوْ يَنْسَاهُ

464. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, atë Abdurrahman b. Zejd b. Esleme,¹⁷⁹ duke transmetuar nga i ati i vet, ai nga Ata b. Jesari, ai nga Ebu Seid el-Hudriu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kujt i ikën namazi i vitrit duke fjetur ose e harron atë, le ta falë atë kur i kujtohet ose kur zgjohet.”¹⁸⁰

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ نَامَ عَنِ الْوُثْرِ أَوْ نَسِيَهُ فَلْيَصِلْ إِذَا ذَكَرَ وَإِذَا اسْتَيْقَظَ " .

465.- Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdullah b. Zejd b. Esleme, duke transmetuar nga babai i vet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Kujt i ikën namazi duke qenë në gjumë, le ta falë (atë) pasi që të zgjohet në mëngjes.”

Ebu Isai thotë: “Kjo është më e besueshme, se hadithi i parë.¹⁸¹ E kam dëgjuar Ebu Davud es-Sixhziun d.m.th., Sulejman b. Esh’asin, kur ka thënë: ‘E kam pyetur Ahmed b. Hanbelin mbi Abdurrahman b. Zejd b. Eslemen, ai më tha: “Vëllai i tij, Abdullahu, është njeri modest.’ Por, e kam dëgjuar Muhammedin duke përmendur, që Ali b. Abdullahun e ka karakterizuar Abdurrahman b. Zejd b. Eslemen, si ravi të dobët: ‘Abdullah b. Zejd b. Esleme është ravi i besueshëm...’”

Disa dijetarë të Kufës, i përmbaheshin këtij hadithi. Ata kanë thënë: “Personi ka për ta falur namazin e vitrit, atëherë, kur t’i kujtohet, madje qoftë ajo edhe pas lindjes së diellit.” Kështu mendon edhe Sufjan eth-Thevriu.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " مَنْ نَامَ عَنْ وَثْرِهِ فَلْيَصِلْ إِذَا أَصْبَحَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا أَصَحُّ مِنَ الْحَدِيثِ الْأَوَّلِ . قَالَ أَبُو عِيسَى سَمِعْتُ أَبَا دَاوُدَ السَّجْزِيَّ يَغْنِي سُلَيْمَانَ بْنَ الْأَشْعَثِ يَقُولُ سَأَلْتُ أَحْمَدَ بْنَ حَنْبَلٍ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ فَقَالَ أَخُوهُ عَبْدُ اللَّهِ لَا بَأْسَ بِهِ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَذْكُرُ عَنْ عَلِيِّ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ أَنَّهُ ضَعَّفَ عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ وَقَالَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ ثِقَةٌ . قَالَ وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ بِالْكُوفَةِ إِلَى هَذَا الْحَدِيثِ فَقَالُوا يُؤْتِرُ الرَّجُلُ إِذَا ذَكَرَ وَإِنْ كَانَ بَعْدَ مَا طَلَعَتِ الشَّمْسُ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ .

¹⁷⁹ Abdurrahman b. Zejd b. Eslemi, sipas vlerësimit të Ahmed b. Hanbelit, Ali b. Medinit, Nesaiut dhe ravive të tjerë është i dobët.

¹⁸⁰ Shumica e dijetarëve islamë, në mesin e të cilëve është Ebu Hanife, Evzaiu, Shafiu, Maliku, Is’haku, Ahmed b. Hanbeli dhe të tjerët, konsiderojnë, që namazin e vitrit, nëse lëshohet nga harresa, ose ndoshta duke fjetur, duhet kompensuar – me atë që kanë divergjenca, në pikëpamje të kohës, deri tek e cila mund ta kompensojnë atë. Shafiu, Ahmedi dhe Hanbeli, e të tjerët, konsiderojnë, që namazi i vitrit mund të kompensohet gjithnjë, derisa nuk falet sabahu. El-Ibrahim en-Nihaiu, konsideron, që namazi i vitrit, mund të falet edhe pas sabahut, deri te lindja e diellit. Sha’bi, Ata’i, Hasan el-Basriu, Muxhahidi, Hammad b. Ebu Sulejmani dhe të tjerët, konsiderojnë, që namazi i vitrit mund të kompensohet edhe pas sabahut, por edhe pas lindjes së diellit, gjithnjë, deri në drekë. Ky qëndrim, është në përputhshmëri me hadithin e cekur.

¹⁸¹ Hadithi i parë, është i transmetuar nga Abdurrahman b. Zejdi b. Esleme, i cili, siç është cekur tani, është ravi i dobët, derisa hadithi tjetër është transmetuar nga vëllai i tij, Abdullah b. Zejd b. Esleme, i cili sipas vlerësimit të Buhariut, është ravi i besueshëm.

338. Mbi atë, që vitrin duhet falur para sabahut

باب مَا جَاءَ فِي مُبَادَرَةِ الصُّبْحِ بِالْوُتْرِ

466. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar, Jahja b. Zekerija b. Ebu Zaidi, atë Ubejdullahu, duke transmetuar nga Nafiu, e ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Faleni vitrin para namazit të sabahut.”¹⁸² Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ زَكَرِيَّا بْنُ أَبِي رَأْدَةَ، حَدَّثَنَا غُنَيْدُ اللَّهِ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " بَادِرُوا الصُّبْحَ بِالْوُتْرِ ". قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

467.- Na ka treguar Hasan b. Ali el-Halal- atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma'meri, ai ka transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Ebu Nadri, ai nga Ebu Seid el-Hudriu, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Faleni namazin e vitrit para agimit.”¹⁸³

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ الْخَلَّالُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ أَبِي نَضْرَةَ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَوْتَرُوا قَبْلَ أَنْ تُصْبِحُوا " .

468. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani, atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ibn Xhurejxhi, ai ka transmetuar nga Sulejman b. Musai, ai nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur shfaqet agimi, ka kaluar çdo lloj namaz nate dhe vitri. Andaj, namazin e vitrit faleni para agimit.” Ebu Isai thotë: “Sulejman b. Musai atë e transmeton vet me këtë tekst.”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka vitër pas namatit të sabahut.”¹⁸⁴ Ashtu thonë shumë dijetarë, siç janë Shafiu, Ahmedi dhe Is'haku. Ata konsiderojnë, që vitri nuk mund të falet pas sabahut.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا ابْنُ جُرَيْجٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ مُوسَى، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ " إِذَا طَلَعَ الْفَجْرُ فَقَدْ ذَهَبَ كُلُّ صَلَاةِ اللَّيْلِ وَالْوُتْرُ فَأَوْتَرُوا قَبْلَ طُلُوعِ الْفَجْرِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَسُلَيْمَانُ بْنُ مُوسَى قَدْ تَقَرَّرَ بِهِ عَلَى هَذَا اللَّفْظِ . وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " لَا وَتْرَ بَعْدَ صَلَاةِ الصُّبْحِ " . وَهُوَ قَوْلٌ غَيْرُ وَاحِدٍ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ لَا يَزُونَ الْوُتْرَ بَعْدَ صَلَاةِ الصُّبْحِ .

339. Mbi atë që gjatë një nate nuk mund të falen dy namaze vitër

باب مَا جَاءَ لَا وَتْرَانِ فِي لَيْلَةٍ

469. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Mulazim b. Amri, atij i ka treguar Abdullah b. Bedri, duke transmetuar nga Kajs b. Talk b. Aliu, që babai i Kajs b. Talk b. Aliut, ka thënë: “Nuk mund të falen dy namaze vitër brenda një nate.”¹⁸⁵ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”¹⁸⁶

¹⁸² E shënon, Ebu Davudi në *Sunen*.

¹⁸³ E shënojnë, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut dhe Ebu Davudit.

¹⁸⁴ E ka shënuar Muhammed b. Nasri, në veprën *Kijamul-lejli*, nga Ebu Seid el-Hudriu. Ndërkaq, në senedin e tij gjendet Ebu Harun el-Abdi, të cilin Shu'be e konsideron ravi të dobët, derisa El-Xhevzexhani, e konsideron gënjeshtar.

¹⁸⁵ Ibn el-Arebi, në veprën *Aridatul Ahvezi*, thotë: “Kjo do të thotë, që ai i cili e ka falur njëherë namazin e vitrit, të njëjtin nuk e përsërit më, nëse më vonë ka falur edhe ndonjë nafile.”

¹⁸⁶ E kanë shënuar të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ibn Maxhes.

Dijetarët, janë ndarë, në pikëpamje të asaj, i cili në fillim të natës e falë namazin e vitrit, ndërsa, para se të përfundojë, nafilen.¹⁸⁷ Disa, nga gjenerata e as'habëve dhe dijetarëve pas tyre, konsiderojnë, që me atë do të anulohet vitri (të cilin e ka falur), ashtu që ka për ta falur edhe një rekat dhe do t'ia shtojë vitrit. Pas asaj, ka për të falur rekate nafile, aq sa dëshiron dhe në fund namazin e vitrit, sepse nuk mund të falen dy namaze vitër gjatë një nate. Ky është qëndrimi edhe i Is'hakut.

Disa dijetarë, nga gjenerata e as'habëve dhe të tjerët, konsiderojnë, që personi, nëse e falë namazin e vitrit në fillim të natës dhe pas asaj bie të flejë, pastaj para se të përfundojë nata, zgjohej dhe falë nafile, me atë nuk ka për t'u anuluar namazi i vitrit (i falur), prandaj as nuk ka për ta falur përsëri. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, i Malik b. Enesit, Ahmedit dhe Ibn Mubarekut. Kjo është më e drejtë, sepse në shumë transmetimet është transmetuar, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka falur (nafile) pas namazit të vitrit.

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا مُلَاذِمُ بْنُ عَمْرِو، حَدَّثَنِي عَبْدُ اللَّهِ بْنُ بَدْرٍ، عَنْ قَيْسِ بْنِ طَلْقٍ بْنِ عَلِيٍّ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ " لَا وَتْرَانِ فِي لَيْلَةٍ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الَّذِي يُوتَرُ مِنْ أَوَّلِ اللَّيْلِ ثُمَّ يَقُومُ مِنْ آخِرِهِ فَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ نَقُضَ الْوَتْرُ وَقَالُوا يُضَيَّفُ إِلَيْهَا رُكْعَةٌ وَيُصَلِّي مَا بَدَأَ لَهُ ثُمَّ يُوتَرُ فِي آخِرِ صَلَاتِهِ لِأَنَّهُ " لَا وَتْرَانِ فِي لَيْلَةٍ " . وَهُوَ الَّذِي ذَهَبَ إِلَيْهِ إِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِذَا أُوتِرَ مِنْ أَوَّلِ اللَّيْلِ ثُمَّ نَامَ ثُمَّ قَامَ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ فَإِنَّهُ يُصَلِّي مَا بَدَأَ لَهُ وَلَا يَنْقُضُ وَتْرَهُ وَيَدْعُ وَتْرَهُ عَلَى مَا كَانَ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَمَالِكِ بْنِ أَنَسٍ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ وَأَحْمَدَ . وَهَذَا أَصَحُّ لِأَنَّهُ قَدْ رُوِيَ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَدْ صَلَّى بَعْدَ الْوَتْرِ .

470. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Hammad b. Mesadi, duke transmetuar nga Mejmun b. Musa el-Mevaiu, ai nga Hasani – që Ummu Seleme, nëna e Hasanit, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (ndonjëherë) pas namazit të vitrit, i falte dy rekate (nafile).”¹⁸⁸

Ebu Isai, thotë: “Ngjashëm me këtë, është transmetuar edhe nëpërmjet Ebu Umames, Aishes dhe shumë të tjerëve, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ مَسْعَدَةَ، عَنْ مَيْمُونِ بْنِ مُوسَى الْمَرْزَبِيِّ، عَنْ الْحَسَنِ، عَنْ أُمِّهِ، عَنْ أُمِّ سَلَمَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يُصَلِّي بَعْدَ الْوَتْرِ رُكْعَتَيْنِ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَقَدْ رُوِيَ نَحْوُ هَذَا عَنْ أَبِي أُمَامَةَ وَعَائِشَةَ وَغَيْرِ وَاحِدٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ .

340. Mbi faljen e namazit të vitrit, mbi të shaluarën

باب مَا جَاءَ فِي الْوَتْرِ عَلَى الرَّاحِلَةِ

471. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Malik b. Enesi, duke transmetuar nga Ebu Bekr b. Umer b. Abdurrahmani – që Seid b. Jesari, ka thënë: “Isha me Ibn Umerin në një udhëtim dhe mbeta prapa, pas tij. ‘Ku ishe?’ – tha ai. ‘E fala namazin e vitrit?’ – u pergjigja, e ai në atë më tha: ‘Vallë, a nuk e ke shembullin më të mirë tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)?

¹⁸⁷ Mbi atë, se si duhet vepruar ai, që pasi që e ka falur namazin e vitrit dëshiron të falë ende nafile – është diskutabile në mes dijetarëve islam. Disa, në mesin e të cilëve është Sufjan eth-Thevriu, konsiderojnë, që ka për ta falur vetëm një rekat, të cilin me nijet, ka për t'ia shtuar namazit të vitrit, duke e shndërruar atë nga namazi tek në namazin çift, mandej falë nafile ende sa ka dëshirë dhe pas asaj e falë namazin e vitrit. Me atë, namazin e vitrit e ka bërë namaz të fundit, duke mos i falur dy namaze vitër, në të njëjtën natë, sepse i pari është anuluar. Shumica e dijetarëve, konsiderojnë, që personi, pasi që e falë namazin e vitrit, mund të falë nafile sa të dëshiroj dhe nuk është i obliguar pasa asaj përsëri ta falë namazin e vitrit, nëse një herë e ka falur atë. Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, ky është qëndrim i drejtë.

¹⁸⁸ Përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar Ahmed b. Hanbeli në *Musned* dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur e ka falur namazin e vitrit mbi të shaluarën.”¹⁸⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ibn Abbasit.¹⁹⁰ Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”

Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, veprojnë sipas këtij hadithi. Ata, konsiderojnë, që personi mund ta falë namazin e vitrit, mbi të shaluarën e vet. Qëndrimin e këtillë, e mbështesin Shafiu, Ahmedi dhe Is’haku.

Disa dijetarë, thonë: “Personi, nuk mund ta falë namazin e vitrit, mbi të shaluarën. Ai, kur dëshiron ta falë namazin e vitrit, duhet të zbresë nga e shaluara dhe të zbres në tokë.” Qëndrimin e këtillë e mbështesin disa dijetarë të Kufës.¹⁹¹

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ بْنِ عُمَرَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ يَسَارٍ، قَالَ كُنْتُ أُمَشِي مَعَ ابْنِ عُمَرَ فِي سَفَرٍ فَتَخَلَّفْتُ عَنْهُ فَقَالَ ابْنُ كُنْتُ فَقُلْتُ أَوْتَرْتُ . فَقَالَ أَلَيْسَ لَكَ فِي رَسُولِ اللَّهِ أَسْوَأُ رَأَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يُوتِرُ عَلَى رَأْسِهِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِلَى هَذَا وَرَأَوْا أَنَّ يُوتِرُ الرَّجُلُ عَلَى رَأْسِهِ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ لَا يُوتِرُ الرَّجُلُ عَلَى الرَّأْسِ وَإِذَا أَرَادَ أَنْ يُوتِرَ نَزَلَ فَأَوْتَرَ عَلَى الْأَرْضِ . وَهُوَ قَوْلُ بَعْضِ أَهْلِ الْكُوفَةِ .

341. Mbi Duha-namazin¹⁹²

بَاب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الضُّحَى

472. Na ka treguar Ebu Kurejb Muhammed b. Ala – atë, e ka informuar Junus b. Bekejr, ai ka transmetuar nga Muhammed b. Is’haku, atij i ka treguar Musa b. Fulan b. Enesi, duke transmetuar nga xhaxhai i vet Thumame b. Enes b. Maliku, ndërsa, ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush i falë dymbëdhjetë rekate namaz duha, Allahu ka për t’ia ndërtuar një pallat nga Ari në Xhennet.”¹⁹³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, jam transmetuar hadithe edhe nga Ummi Hane, Ebu Hurejre, Nuajm b. Hemhari, Ebu Dherri, Aishja, Ebu Uname, Utbe b. Abdus-Sulemi, Ibn Ebu Evfi, Ebu Seidi, Zejd b. Erkami dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Enesit është garib, na është i njohur vetëm me këtë rrugë.”¹⁹⁴

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، مُحَمَّدُ بْنُ الْعَلَاءِ حَدَّثَنَا يُونُسُ بْنُ كُبَيْرٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِسْحَاقَ، قَالَ حَدَّثَنِي مُوسَى بْنُ فَلَانَ بْنِ أَنَسٍ، عَنْ عَمِّهِ، ثُمَامَةَ بْنِ أَنَسٍ بْنِ مَالِكٍ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى الضُّحَى ثِنْتَيْ عَشْرَةَ رُكْعَةً بَنَى اللَّهُ لَهُ قَصْرًا مِنْ ذَهَبٍ فِي الْجَنَّةِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أُمِّ هَانِيٍّ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَنُعَيْمِ بْنِ هَمَّارٍ وَأَبِي ذَرٍّ وَعَائِشَةَ وَأَبِي أُمَامَةَ وَعُتْبَةَ بْنِ عَبْدِ السَّلَامِ وَابْنِ أَبِي أُوْفَى وَأَبِي سَعِيدٍ وَزَيْدِ بْنِ أَرْقَمٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

473. Na ka treguar, Ebu Musa Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Muhammed b. Xha’feri, atë Shu’be, duke transmetuar nga Amër b. Murre – që Abdurrahman b. Ebu Lejli ka thënë: “Askush,

¹⁸⁹ Ky hadith, është argument, që namazi i vitrit është i lejuar të falet mbi të shaluarën, e analoge me atë edhe në cilindo mjet transportues tjetër, ashtu siç i vjen më lehtë falësit.

¹⁹⁰ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

¹⁹¹ Sipas mendimit të Abdurrahman el-Mubarekfurit, ky është qëndrimi i Ebu Hanifes.

¹⁹² Namazi Duha, është lloj i veçantë i namazit vullnetar, i cili falet para namazit të drekës. Bedrudin el-Ajni, thotë, që koha e tij e vërtetë është, nga momenti kur dielli e kalon një të katërtën e qiellit deri në drekë.

¹⁹³ Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kurrë nuk ka falur më tepër se dymbëdhjetë rekate të namazit duha. Me të pajtohet edhe Bedrudin el-Ajni.

¹⁹⁴ Neveviu këtë hadith, e radhit në mesin e haditheve daif.

përveç Umme Hanes, nuk më ka informuar, që e ka parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se si e falte namazin duha. Ajo, ka treguar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Ditën e Çlirimit të Mekkes, ka hyrë në shtëpinë e saj, ishte larë dhe i kishte falur tetë rekate (namaz duha). Kurrë më herët, nuk e kam parë, që i ka falur (rekate) më të shkurtra, por megjithatë e plotësonte rukunë dhe sexhden.”¹⁹⁵

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Ahmed konsideron, që hadithi i Umme Hanes, është diç më i besueshëm, mbi këtë temë. Janë ndarë, rreth emrit të plotë të Nuajmit. Disa thonë, se ai është Nuajm b. Hammar, disa se është Ibn Hemmar, thuhet edhe Ibn Hebbar dhe Ibn Hemmam. E drejtë është Ibn Hemmar. Disa, nga ravitë, ka bërë lëshim kur ka thënë Ebu Nuajm Ibn Hammar dhe në atë ka gabuar. Pastaj e ka lënë anash fjalën Ebu dhe ka thënë, që e ka transmetuar Nuajmi nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Mbi këtë më ka informuar Abd b. Humejd, duke transmetuar nga Ebu Nuajmi!

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، أَخْبَرَنَا شُعْبَةُ، عَنْ عَمْرِو بْنِ مُرَّةَ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى، قَالَ مَا أَخْبَرَنِي أَحَدٌ، أَنَّهُ رَأَى النَّبِيَّ ﷺ يُصَلِّي الضُّحَى إِلَّا أُمُّ هَانِيٍّ فَإِنَّهَا حَدَّثَتْ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ دَخَلَ بَيْتَهَا يَوْمَ فَتَحَ مَكَّةَ فَأَغْتَسَلَ فَسَبَّحَ ثَمَانِ رَكَعَاتٍ مَا رَأَيْتُهُ صَلَّى صَلَاةً قَطُّ أَخَفَّ مِنْهَا غَيْرَ أَنَّهُ كَانَ يَتِمُّ الرُّكُوعَ وَالسُّجُودَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَكَانَ أَحْمَدُ رَأَى أَصَحَّ شَيْءٍ فِي هَذَا الْبَابِ حَدِيثُ أُمِّ هَانِيٍّ . وَاجْتَلَفُوا فِي نَعِيمٍ فَقَالَ بَعْضُهُمْ نَعِيمُ بْنُ خَمَارٍ وَقَالَ بَعْضُهُمْ ابْنُ هَمَارٍ وَيُقَالُ ابْنُ هَمَارٍ وَيُقَالُ ابْنُ هَمَامٍ وَالصَّحِيحُ ابْنُ هَمَارٍ . وَأَبُو نَعِيمٍ وَهُمْ فِيهِ فَقَالَ ابْنُ جَمَارٍ وَأَخْطَأَ فِيهِ ثُمَّ تَرَكَ فَقَالَ نَعِيمٌ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَأَخْبَرَنِي بِذَلِكَ عَبْدُ بْنُ حُمَيْدٍ عَنْ أَبِي نَعِيمٍ .

474. Na ka treguar Ebu Xha'fer es-Simani – atë e ka informuar Muhammed b. Husejini, atë Ebu Mushiri, atë Ismail b. Ajjashi, duke transmetuar nga Behir b. Sa'di, ai nga Halid b. Ma'dani, ai nga Xhubejr b. Nufejri, ai nga Ebu Derda dhe Ebu Dherri, ata dy nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – që Allahu i Lartësuar ka thënë: “O biri i Ademit, fali ekskluzivisht për shkak Timin katër rekate në fillim të ditës. Unë kam për të plotësuar nevojat e tua, në pjesën e mbetur të ditës.”¹⁹⁶

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është garib.”¹⁹⁷

حَدَّثَنَا أَبُو جَعْفَرٍ السِّمَنَانِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو مُسْهِرٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ عَاقِشٍ، عَنْ جَبْرِ بْنِ سَعْدٍ، عَنْ خَالِدِ بْنِ مَعْدَانَ، عَنْ جُبَيْرِ بْنِ نُفَيْرٍ، عَنْ أَبِي الزُّدَاءِ، وَأَبِي، ذَرٍّ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ " عَنْ اللَّهِ، عَزَّ وَجَلَّ أَنَّهُ قَالَ ابْنُ آدَمَ ارْكَعْ لِي مِنْ أَوَّلِ النَّهَارِ أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ أَفْكَ آخِرُهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

Veliu, Nadr b. Shumejli dhe shumë dijetarë tjerë të hadithit, këtë hadith e kanë transmetuar nga Nehhas b. Kahma. Dhe, neve na është i njohur vetëm përmes tij.”

قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رَوَى وَكِيعٌ وَالنَّضَرُ بْنُ شَمِيلٍ وَغَيْرُ وَاحِدٍ مِنَ الْأَيْمَةِ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ نَهَّاسِ بْنِ قَهْمٍ وَلَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِهِ .

¹⁹⁵ Ibn Ebu Shejbe, shënon nga Hudhejfe, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke e falur namazin duha, lexonte shumë gjatë. Kjo tregon, që ndonjëherë, varësisht nga situata, namazin duha e falte me shpejtësi, duke lexuar shkurt, ndërsa ndonjëherë e ka zgjatur me leximin. Nga hadithi, të cilin e ka shënuar Muslimi, nëpërmjet Ikrime b. Halidit, nga Umme-Haneja vërehet, që llojin e këtyllë të nafileve, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për herë të parë e ka falur në Ditën e Çlirimit të Mekkes. Ummihaneja thotë: “Kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) arriti në Mekke, i fali tetë rekate (të namazit vullnetar). Duke e parë atë, unë thash: “Çfarë namazi është ky?” Më është thënë: “Ky është namazi duha.”

¹⁹⁶ Tirmidhiu dhe Ebu Davudi, konsiderojnë, që këto katër rekate, kanë të bëjnë me namazin duha. Disa thonë, që kanë të bëjnë me sunnetet e sabahut dhe farzet.

¹⁹⁷ Mundhiri, pohon, që në ekzemplarin e dorëshkrimit të përmbledhjes së haditheve të Tirmidhiut, të cilat ai i ka poseduar, Tirmidhiu këtë hadith e ka vlerësuar si hasen-garib.

475. Na ka treguar Muhammed b. Abdul-Ala el-Basri – atë e ka informuar Zejd b. Zurej, ai ka transmetuar nga Nehhas b. Kahma, ai nga Seddad Ebu Ammari, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ai, i cili i falë rregullisht dy rekate namaz duha, kanë për t’iu falur mëkatet sikur t’i kishte edhe sa shkuma e detit.”¹⁹⁸

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْأَعْلَى الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، عَنْ نَهَّاسِ بْنِ قَهْمٍ، عَنْ سَدَّادِ أَبِي عَمَّارٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ حَافِظٌ عَلَى شُفْعَةِ الضَّحَى غُفِرَ لَهُ ذُنُوبُهُ وَإِنْ كَانَتْ مِثْلَ زَيْدِ الْبَحْرِ "

476. Na ka treguar Zijad b. Ejub el-Bagdadi – atë e ka informuar Muhammed b. Rebiu, ai ka transmetuar nga Fudajl b. Merzuku, ai nga Atije el-Avfîu – që Ebu Seid el-Hudriu ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në (një periudhë) rregullisht e ka falur namazin duha, saqë kemi menduar që kurrë më nuk do ta lë. Më pastaj, ndaloj me të falurit e tij, saqë kemi menduar që kurrë më nuk ka për t’u falur.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”¹⁹⁹

حَدَّثَنَا زِيَادُ بْنُ أَيُّوبَ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ رِبْعَةَ، عَنْ فَضَيْلِ بْنِ مَرْزُوقٍ، عَنْ عَطِيَّةِ الْعُوفِيِّ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ كَانَ نَبِيُّ اللَّهِ ﷺ يُصَلِّي الضَّحَى حَتَّى نَقُولَ لَا يَدْعُ وَيَدْعُهَا حَتَّى نَقُولَ لَا يُصَلِّي. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ.

342. Mbi namazin vullnetar të paradites

بَاب مَا جَاءَ فِي الصَّلَاةِ عِنْدَ الزَّوَالِ

477. Na ka treguar Ebu Musa Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Muhammed b. Muslim b. Ebul-Veddah, ndërsa, ai është Ebu Seid El-Mueddibi, ai ka transmetuar nga Abdulkerim el-Xhezeriu, ai nga Muxhahidi – që Abdullah b. Saibi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur Dielli largohej nga zeniti, para namazit të drekës, i falte katër rekate dhe thoshte: “Ai është momenti kur hapen dyert e qiellit, andaj dëshiroj, që në të, të ngrihet vepra ime e mirë.”²⁰⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu dhe Ebu Ejubi. Hadithi i Abdullah b. Thaibitit është hasen-garib.”²⁰¹

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i falte katër rekate pas zenitit, dhe jepte selam vetëm pas përfundimit të tyre.

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ مُسْلِمٍ بْنُ أَبِي الْوَضَّاحِ، هُوَ أَبُو سَعِيدٍ الْمُؤَدَّبُ عَنْ عَبْدِ الْكَرِيمِ الْجَزْرِيِّ، عَنْ مُجَاهِدٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ السَّائِبِ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يُصَلِّي أَرْبَعًا بَعْدَ أَنْ تَزُولَ الشَّمْسُ قَبْلَ الظُّهْرِ وَقَالَ " إِنَّهَا سَاعَةٌ تَفْتَحُ فِيهَا أَبْوَابُ السَّمَاءِ وَأُحِبُّ أَنْ يَصْنَعَ لِي فِيهَا عَمَلٌ صَالِحٌ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَأَبِي أَيُّوبَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ السَّائِبِ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ بَعْدَ الزَّوَالِ لَا يُسَلِّمُ إِلَّا فِي آخِرِ هُنَّ .

¹⁹⁸ Ky hadith është i dobët, sepse në senedin e tij gjendet, raviu Nehhas b. Kahmi, i cili, sipas vlerësimit të El-Mubarekfurit, është i dobët.

¹⁹⁹ E shënon, Hakimi në *Mustedrek*.

²⁰⁰ Iraki, konsideron, që këtu bëhet fjalë mbi veçantinë e llojit të namazit vullnetar nga katër rekate, afër sunnetit të drekës, i cili quhet salat-ul-zevval, i cili falet, pasi që dielli largohet nga zeniti.

²⁰¹ E ka shënuar, Ahmed b. Hanbeli në *Musned*.

343. Mbi namazin për ndihmë

باب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْحَاجَةِ

478. Na ka treguar Ali b. Isa b. Jezid el-Bagdadi – atë e ka informuar, Abdullah b. Bekr es-Sehmi, atë Abdullah b. Muniri, duke transmetuar nga Abdullah b. Bekri, ai nga Faïd b. Abdurrahman b. Abdullah b. Ebu Evfa – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nëse ndokush ka ndonjë dëshirë ose kërkesë tek Allahu i Lartësuar, ose te ndonjëri nga njerëzit, le të merr avdes bukur dhe me përpikëri, pastaj le t’i falë dy rekate, pastaj, pas lavdërimit të Allahut, të recituarit e Et-Tehijatit dhe bërjes salavat mbi të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), le të thotë: ‘Nuk ka të Adhuruar tjetër, përveç Allahut, të Butit dhe Fisnikut! Lavdërimi i takon Allahut, Sunduesit të botëve! Unë të lutem, që të ma mundësosh bërjen e veprave, që kanë për t’ma siguruar mëshirën Tënde dhe veprave, të cilat kanë për të ma garantuar faljen Tënde, çdo të mirë me bollëk dhe siguri e shpëtim nga çdo mëkat! Mos më lë asnjë mëkat, e që të mos ma falësh, e asnjë brengë e që të mos ma largosh, e asnjë dëshirë dhe nevojë, e cila është në kornizat e kënaqësisë Tënde, e që të mos ma plotësosh, o më i Mëshirshmi!’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib,²⁰² mbi senedin e tij është diskutuar. Faïd b. Abdurrahmani është konsideruar si ravi i dobët i hadithit. Faizi është Ebul Veruka.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ عِيسَى بْنِ يَزِيدَ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ بَكْرٍ السَّهْمِيُّ، . وَحَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُنِيرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بَكْرٍ، عَنْ قَائِدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي أَوْفَى، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ كَانَتْ لَهُ إِلَى اللَّهِ حَاجَةٌ أَوْ إِلَى أَحَدٍ مِنْ بَنِي آدَمَ فَلْيَتَوَضَّأْ وَلْيُحْسِنِ الْوُضُوءَ ثُمَّ لْيُصَلِّ رَكْعَتَيْنِ ثُمَّ لْيُثْنِ عَلَى اللَّهِ وَلْيُصَلِّ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ ثُمَّ لْيَقُلْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْخَلِيمُ الْكَرِيمُ سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ أَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ وَغَرَائِمَ مَغْفِرَتِكَ وَالْغَنِيمَةَ مِنْ كُلِّ بَرٍّ وَالسَّلَامَةَ مِنْ كُلِّ إِثْمٍ لَا تَدْعُ لِي ذَنْبًا إِلَّا غَفَرْتَهُ وَلَا هَمًّا إِلَّا فَرَجْتَهُ وَلَا حَاجَةً هِيَ لَكَ رِضًا إِلَّا قَضَيْتَهَا يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ وَفِي إِسْنَادِهِ مَقَالٌ . قَائِدُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ يُضَعَّفُ فِي الْحَدِيثِ وَقَائِدٌ هُوَ أَبُو الْوُرَقَاءِ .

344. Mbi istihare²⁰³ namazin

باب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْإِسْتِخَارَةِ

479. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdurrahman b. Ebu Mevali, ai ka transmetuar nga Muhammed b. Munkediri – që Xhabir b. Abdullahu, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), na mësonte mbi namazin istihare, për çdo çështje dhe çdo punë, sikur që na i mësonte suret kur’anore. Ai thoshte: ‘Kur, ndonjëri nga ju dëshiron diç, le t’i falë dy rekate namaz vullnetar. Pas asaj, le të thotë: “O Allah! Unë në bazë të diturisë Tënde, nga Ti kërkoj zgjidhjen më të mirë dhe të lutem me Fuqinë Tënde dhe kërkoj nga Ti mirësi – sepse Ti je në gjendje, ndërsa unë nuk jam. Ti Di, ndërsa unë nuk di. Ti je Ai i Cili Di të gjitha sekretet! O, Allah! Nëse është, sipas diturisë Tënde, kjo gjë (çështje) e mirë për mua, për fenë time, jetën time dhe për përfundimin tim? – ose ka thënë – edhe tani edhe më vonë, ma lehtëso atë, e pastaj ma beko atë! Por, nëse sipas Diturisë Tënde, kjo gjë është e keqe për mua, për fenë time, për jetën time dhe për përfundimin tim- ose ka thënë –

²⁰² El-Mudhiri, në veprën *Et-Tergibu vet-Terhibu*, thotë që këtë hadith e kanë shënuar Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, të dytë nga Faïd b. Abdurrahman Ebul-Veruku, i cili, sipas mendimit të tyre, është ravi i refuzuar. Ibn Adijj, thotë: “Edhe përkrah asaj, që është ravi i dobët, prej tij kanë marrë hadithe dhe i kanë shënuar.”

²⁰³ Namazi i istihares, është lloj i veçantë i namazit vullnetar, i cili falet kur njeriu ka për qëllim, të bëjë ndonjë punë dhe dëshiron, që Allahu i Lartësuar t’i ndihmojë në marrjen e vendimit të drejtë. Në atë rast, falen dy rekate dhe bëhet lutja, e cila është përmendur në hadith, që ta lus Allahun e Lartësuar, që t’ia mundësoj zgjedhjen, e cila për të do të jetë hajr.

edhe tani edhe më vonë, zmbrapse nga unë dhe caktoma atë që është e mirë për mua, pastaj më bëjë të kënaqur me atë!’ Thotë: ‘Këtu ka për ta përmendur dëshirën dhe kërkesën e vetë?’²⁰⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Mes’udi dhe Ebu Ejubi. Hadithi i Xhabirit, është hasen-garib.²⁰⁵ Nuk na është i njohur, përveç nëpërmjet Abdurrahman b. Ebu Mevaliut, ai është i besueshëm dhe njëri nga shejhët e Medines. Nga ai, Sufjani e ka transmetuar një hadith. Nga Abdurrahmani hadithe kanë transmetuar shumë imamë.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ أَبِي الْمَوَالِي، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ، عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يُعَلِّمُنَا الْإِسْتِخَارَةَ فِي الْأُمُورِ كُلِّهَا كَمَا يُعَلِّمُنَا السُّورَةَ مِنَ الْقُرْآنِ يَقُولُ " إِذَا هَمَّ أَحَدُكُمْ بِالْأَمْرِ فَلْيَرْكَعْ رَكْعَتَيْنِ مِنْ غَيْرِ الْفَرِيضَةِ ثُمَّ لْيَقُلِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْتَخِيرُكَ بِعِلْمِكَ وَأَسْتَقْدِرُكَ بِقُدْرَتِكَ وَأَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ الْعَظِيمِ فَإِنَّكَ تَقْدِرُ وَلَا أَقْدِرُ وَتَعْلَمُ وَلَا أَعْلَمُ وَأَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ اللَّهُمَّ إِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ خَيْرٌ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي وَعَاقِبَةِ أُمْرِي أَوْ قَالَ فِي عَاجِلِ أَمْرِي وَآجِلِهِ فَيَسِّرْهُ لِي ثُمَّ بَارِكْ لِي فِيهِ وَإِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ شَرٌّ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي وَعَاقِبَةِ أُمْرِي أَوْ قَالَ فِي عَاجِلِ أَمْرِي وَآجِلِهِ فَاصْرِفْهُ عَنِّي وَاصْرِفْنِي عَنْهُ وَاقْدِرْ لِي الْخَيْرَ حَيْثُ كَانَ ثُمَّ أَرْضِنِي بِهِ قَالَ وَيُسَمِّي حَاجَتَهُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي أَيُّوبَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ جَابِرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي الْمَوَالِي . وَهُوَ شَيْخٌ مَدِينِيٌّ ثَقَّةٌ رَوَى عَنْهُ سَفْيَانٌ حَدِيثًا وَقَدْ رَوَى عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ غَيْرُ وَاحِدٍ مِنَ الْأَثَمَةِ وَهُوَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدٍ بْنُ أَبِي الْمَوَالِي .

345. Mbi tesbih-namazin

باب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ التَّسْبِيحِ

480. Na ka treguar, Ebu Kurejb Muhammed b. Ala – atë e ka informuar Zejd b. Hubab el-Ukli, atë Musa b. Ubejde²⁰⁶, atë Seid b. Ebu Seidi²⁰⁷, i mbrojturi i Ebu Bekër b. Muhammed b. Amër b. Hamzas, ai ka transmetuar nga Ebu Rafiu - që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka thënë Abbasit: “O xhaxha, vallë, a nuk dëshiron që t’i mbaj lidhjet farefisnore me ty? A nuk dëshiron që të të jap dhuratë? A nuk dëshiron që të ta bëjë ndonjë të mirë?” “Si nuk dëshiroj, o i Dërguar i Allahut!” – tha ai. I Dërguari në atë tha: “Xhaxha, fali katër rekate (namaz vullnetar). Në çdo rekat recito Fatihanë dhe një sure. Pas përfundimit të recitimit, e para se të shkosh në ruku, thuaj: *Allahu Ekber vel-hamdulil-lahi ve subhanAllahi* – pesëmbëdhjetë herë. Pastaj, shko në ruku dhe thuaj, dhe në ruku thuaj atë dhjetë herë. Pastaj ngrite kokën nga rukuja dhe thuaj atë dhjetë herë. Pastaj, shko në sexhden (e parë) dhe në të thuaj atë dhjetë herë. Pastaj ngrite kokën, dhe thuaj atë dhjetë herë. Pastaj shko në sexhden (e dytë) dhe në të thuaj njëjtë – dhjetë herë. Pastaj ngrite kokën dhe thuaj të njëjtën dhjetë herë para se të ngrihesh. Kjo gjithsejtë është shtatëdhjetë e pesë në çdo rekatë, ndërsa treqind (here) në të katër rekate. Sikur mëkatet e tua të ishin sikur brigjet ranore, Allahu do t’i kishte falur ato!” Ai tha: “O i Dërguar i Allahut, e kush është në gjendje që ta shqiptojë atë për çdo ditë?” Ai në atë tha: “Nëse nuk je në gjendje që ta shqiptosh atë çdo ditë, atëherë njëherë në javë. Nëse nuk je

²⁰⁴ Sipas hadithit, të cilin e shënon Ibn Sunni nga Enes b. Maliku, është mirë që namazet – istihare të përsëriten deri shtatë herë. Pas herës së shtatë, duhet vepruar ashtu siç të thotë zemra. Enes b. Maliku thotë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ke ndonjë çështje me rëndësi ose punë, kërko zgjidhje nga Allahu (duke e falur istihare namazin shtatë herë, pastaj vepro sipas asaj kah synon zemra – kjo për ty është hajr.” El-Mubarekfuri thotë, që në këtë sened ka ndërprerje, prandaj nuk mund të merret si argument. Neveviu dhe dijetarët e tjerë konsiderojnë, që është mustehab në rekatin e parë leximi i Fatihasë, pas Fatihasë *Kul-ja ejuhel-kafirun*, e në rekatin e dytë *Kul-huvallahu Ehad*.

²⁰⁵ E shënon, Buhariu në *Sahih*.

²⁰⁶ Musa b. Ubejde b. Neshit er-Rebzi Ebu Abdulaziz el-Medeni, është ravi i dobët. I ka takuar gjeneratës së gjashtë të ravive.

²⁰⁷ Për Seid b. Ebu Seidin, Ibn Haxher el-Askalani, në veprën *Takribu-tehziib*, thotë se është ravi i panjohur, derisa, në veprën *Tehdhibu-tehziib*, e ka cekur, se si Ibn Hibbani, atë e ka radhitur në mesin e ravive të besueshëm.

dhe duhet shqiptuar të njëjtat dhjetë herë. Pastaj, duhet shkuar në sexhden (e parë) dhe duhet shqiptuar atë dhjetë herë. Pastaj duhet ngritur kokën nga sexhdja dhe duhet shqiptuar atë dhjetë herë. Pastaj duhet shkuar përsëri në sexhden (e dytë) dhe duhet përsëritur atë dhjetë herë. Ka për t'i falur katër rekate në këtë mënyrë – e ato janë gjithsejtë shtatëdhjetë e pesë madhërime (tesbihe) në çdo rekat. Në çdo rekatë (tespihin) duhet filluar me pesëmbëdhjetë herë. Pastaj duhet lexuar (Kur'an), pastaj ka për të shqiptuar tesbih dhjetë herë. Në rast se falet natën, kisha pasur dëshirë që selamin ta jep pas çdo dy rekati. Por nëse falet ditën, nëse e dëshiron atë, mund të je selam (pas rekatit të dytë), por nuk është i detyruar nëse nuk e dëshiron atë.”

Ebu Vehbi thotë: “Më ka informuar Abdulazizi, ndërsa ai është i biri i Ebu Rizmeut, që Abdullahu ka thënë: “Në ruku, së pari duhet të shqiptoj *Subhane rabijel-adhim* tre herë, ndërsa në sexhde *Subhane rabbijel-ala* tre herë, pas tyre ka për t'i shqiptuar tesbihet (e përmendura).”

Ahmed b. Abdi, ka thënë: “Neve na ka informuar Vehb b. Zum'a, atë Abdulazizi, e ai është i biri i Ebu Rizmes: “I kam thënë Abdullah b. Mubarekut: ‘Nëse personi harron, a ka për t'i kompensuar fjalët (e tesbihut) e lavdërimit në sexhde nga dhjetë herë?’ “Jo.”- tha ai – ‘Ky namaz përbëhet nga treqind tespihe (të shqiptuarit e fjalëve të lavdërimit).”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ حَدَّثَنَا أَبُو وَهْبٍ قَالَ سَأَلْتُ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ الْمُبَارَكِ عَنِ الصَّلَاةِ الَّتِي يُسَبِّحُ فِيهَا فَقَالَ يُكَبِّرُ ثُمَّ يَقُولُ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى جَدُّكَ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ غَيْرُكَ ثُمَّ يَقُولُ خَمْسَ عَشْرَةَ مَرَّةً سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ ثُمَّ يَتَعَوَّذُ وَيَقْرَأُ (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ) وَفَاتِحَةَ الْكِتَابِ وَسُورَةَ ثُمَّ يَقُولُ عَشْرَ مَرَّاتٍ سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ ثُمَّ يَرْكَعُ فَيَقُولُهَا عَشْرًا . ثُمَّ يَرْفَعُ رَأْسَهُ مِنَ الرُّكُوعِ فَيَقُولُهَا عَشْرًا ثُمَّ يَسْجُدُ فَيَقُولُهَا عَشْرًا ثُمَّ يَسْجُدُ النَّائِبَةَ فَيَقُولُهَا عَشْرًا يُصَلِّي أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ عَلَى هَذَا فَذَلِكَ خَمْسٌ وَسِتُّونَ تَسْبِيحَةً فِي كُلِّ رَكَعَةٍ يَبْدَأُ فِي كُلِّ رَكَعَةٍ بِخَمْسٍ عَشْرَةَ تَسْبِيحَةً ثُمَّ يَقْرَأُ ثُمَّ يَسْجُدُ عَشْرًا فَإِنْ صَلَّى لَيْلًا فَاحْبُبْ إِلَى أَنْ يُسَلِّمَ فِي الرَّكَعَتَيْنِ وَإِنْ صَلَّى نَهَارًا فَإِنْ شَاءَ سَلَّمَ وَإِنْ شَاءَ لَمْ يُسَلِّمْ . قَالَ أَبُو وَهْبٍ وَأَخْبَرَنِي عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ أَبِي رَزْمَةَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ أَنَّهُ قَالَ يَبْدَأُ فِي الرُّكُوعِ بِسُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ وَفِي السُّجُودِ بِسُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى ثَلَاثًا ثُمَّ يَسْجُدُ التَّسْبِيحَاتِ . قَالَ أَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ حَدَّثَنَا وَهْبٌ بْنُ زَمْعَةَ قَالَ أَخْبَرَنِي عَبْدُ الْعَزِيزِ وَهُوَ ابْنُ أَبِي رَزْمَةَ قَالَ قُلْتُ لِعَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْمُبَارَكِ إِنْ سَهَا فِيهَا يُسَبِّحُ فِي سَجْدَتِي السَّهْوِ عَشْرًا عَشْرًا قَالَ لَا إِنَّمَا هِيَ ثَلَاثُمِائَةٍ تَسْبِيحَةٍ .

346. Mbi përshkrimin e salavateve ndaj të Dërguarin

باب مَا جَاءَ فِي صِفَةِ الصَّلَاةِ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ

483. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atij i ka treguar Ebu Usame, ai ka transmetuar nga Mis'ari,²¹⁰ Exhlehi²¹¹ dhe Malik b. Migveliu, ata nga Hakem b. Utejbë, ai nga Abdurrahman b. Ebu Lejlei – që Ka'b b. Uxhre ka thënë: “Ne thamë ‘O i Dërguar i Allahut, për sa i takon selamit, ne dimë se si të thërrasim, por si të dërgojmë ty salavate?’ Ai tha: “Thoni: ‘O Allah, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij ashtu siç e ke bekuar Ibrahimin, Ti në të vërtetë je Ai të Cilit i takon lavdërimi dhe meriton Falënderimin! Jepi bereqet Muhammedit dhe familjes së tij, ashtu siç i ke dhënë bereqet Ibrahimit, Ti në të vërtetë je Ai, të Cilit i takon lavdërimi dhe meriton Falënderimin!’”²¹²

Mahmudi shënon, që Ebu Usame, ka thënë: “Por, më shtoi Zaide, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Hakemi, ndërsa ai nga Abdurrahman b. Ebu Lejli: ‘Ne themi: ‘Dhe mbi ne me ta!’”

²¹⁰ Mish'ar b. Kudam.

²¹¹ Exhlehi b. Abdullah b. Huxhijje, është ravi i sinqertë, i cili i takon sektiit shiit. I takon gjeneratës së shtatë.

²¹² Në transmetimin e Muslimit, të këtij hadithi, qëndron: ‘Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar, që ne ty të dërgojmë salavate, por si dhe në ç'mënyrë ta bëjmë atë?’ Pas asaj, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), heshti, ashtu që dëshiruam, që të mos ishte pyetur, e pastaj tha: ‘Thuani: ‘Allahu im, begatoje Muhammedin dhe familjen e tij siç e ke begatuar...”

Ebu Isa thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Alia, Ebu Humejde, Ebu Mes’udi, Talha, Ebu Seidi, Burejde, Zejd b. Harixhe dhe thotë edhe i Ibn Xhariut dhe Ebu Hurejres. Hadithi i Ka’b b. Uxhres është hasen-sahih.²¹³ Abdurrahman b. Ebu Lejle²¹⁴ është pseudonimi sipas fëmiut të Ebu Isait. Emri i Ebu Lejlit është Jesar.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو أَسَامَةَ، عَنْ مِسْعَرٍ، وَالْأَجْلَحِ، وَمَالِكِ بْنِ مَعُوذٍ، عَنِ الْحَكَمِ بْنِ عُثَيْبَةَ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى، عَنْ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ، قَالَ قُلْنَا يَا رَسُولَ اللَّهِ هَذَا السَّلَامُ عَلَيْكَ قَدْ عَلِمْنَا فَكَيْفَ الصَّلَاةُ عَلَيْكَ قَالَ " قُولُوا اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ " . قَالَ مُحَمَّدٌ قَالَ أَبُو أَسَامَةَ وَزَادَنِي زَائِدَةُ عَنْ الْأَعْمَشِ عَنِ الْحَكَمِ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى قَالَ وَنَحْنُ نَقُولُ وَعَلَيْنَا مَعَهُمْ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَأَبِي حُمَيْدٍ وَأَبِي مَسْعُودٍ وَطَلْحَةَ وَأَبِي سَعِيدٍ وَبُرَيْدَةَ وَزَيْدَ بْنِ خَارِجَةَ وَيُقَالُ ابْنُ جَارِيَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ أَبِي لَيْلَى كُنْيَتُهُ أَبُو عِيْسَى وَأَبُو لَيْلَى اسْمُهُ يَسَارٌ .

347. Mbi rëndësinë e dërgimit salavat të Dëguarit

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الصَّلَاةِ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ

484. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Muhammed b. Halid b. Asme²¹⁵, atij i ka treguar Musa b. Jakub ez-Zemijj,²¹⁶ atij Abdullah b. Kejsani, atë e ka informuar Abdullah b. Sheddadi, duke transmetuar nga Abdullah b. Mes’udi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Në Ditën e Gjykimit, të drejtën më të madhe mbi shefaatin tim, kanë për ta pasur dhe kanë për të qenë më të afërt me mua, ata të cilët kanë dërguar salavate më së tepërmi mbi mua.”²¹⁷ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen garib.”²¹⁸

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush mbi mua e sjellë një salavatë, Allahu mbi të ka për t’i sjellë dhjetë salavate dhe kanë për t’iu shënuar dhjetë vepra të mira.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، بُنْدَارٌ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ خَالِدِ بْنِ عَثْمَةَ، حَدَّثَنِي مُوسَى بْنُ يَعْقُوبَ الرَّمَعِيُّ، حَدَّثَنِي عَبْدُ اللَّهِ بْنُ كَيْسَانَ، أَنَّ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ شَدَادٍ، أَخْبَرَهُ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " أَوْلَى النَّاسِ بِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَكْثَرُهُمْ عَلَى صَلَاةٍ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " مَنْ صَلَّى عَلَى صَلَاةٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ بِهَا عَشْرًا وَكَتَبَ لَهُ بِهَا عَشْرَ حَسَنَاتٍ " .

485. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ismail b. Xha’feri, ai ka transmetuar nga Ala b. Abdurrahmani, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush mbi mua dërgon një salavat, Allahu mbi të ka për t’i dërguar dhjetë salavate.”

²¹³ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

²¹⁴ Abdurrahman b. Ebu Lejla el-Ensari el-Evsi është i biri i as’habit të njohur Ebu Lejle el-Ensariu, emri i të cilit është Jesar. I ka takuar njëqind e nëntëdhjetë as’habit.

²¹⁵ Muhammed b. Halid b. Asme el-Hanefi el-Basri është ravi i sinqertë, por ka qenë i prirë për gabime. I ka takuar gjeneratës së dhjetë të ravive. Ibn Haxheri, konsideron, që Asme ka qenë nëna e tij.

²¹⁶ Musa b. Jakub ez-Zem’ijj Ebu Muhammed el-Medeni, është vlerësuar në mënyra të ndryshme, nga ana e dijetarëve të hadithit. Ibn Haxheri konsideron, që është ravi i sinqertë, me atë që keq ka mbajtur në mend. Ibn Meini, e ka konsideruar ravi të besueshëm. Nesaiu thotë, që nuk është ravi i fuqishëm. Ali b. Medini atë e ka konsideruar ravi të dobët, i cili i ka kundërshtuar ravitë e besueshëm.

²¹⁷ Darekutni, shënon, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka thënë Ammar b. Jasirit: “O Ammar, pas vdekjes sime, Allahu ka për ta ngarkuar melaiken e posaçme, e cila pas vdekjes sime ka për të qëndruar pranë varrit tim për të m’i transmetuar salavatet, nga pasuesit e mi. Askush, nga ummeti im nuk ka për të shqiptuar salavate mbi mua, e që ajo të mos më thotë: “Ky dhe ky, i biri i këtij dhe këtij, bënë salavate mbi ty!” Pastaj Allahu i Lartësuar, për secilin salavat të tij mbi të ka për t’i dërguar dhjetë.”

²¹⁸ E shënon Ibn Hibbani në *Sahih*.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdurrahman b. Avfi, Amir b. Rebiu, Ammari, Ebu Talha, Enesi dhe Ubejje b. Ka’bi. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²¹⁹

Është transmetuar, që Sufjan eth-Thevriu dhe shumë dijetarë tjerë, kanë thënë: “Dërgimi i salavateve nga Sunduesi (me të vërtetë), është mëshira e Tij, ndërsa, dërgimi i salavateve nga ana e melaikeve, është kërkimi i faljes (së tyre për ty).”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنِ الْعَلَاءِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى عَلَى صَلَاةٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ بِهَا عَشْرًا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ وَعَامِرِ بْنِ رَبِيعَةَ وَعَمَارِ وَأَبِي طَلْحَةَ وَأَنْسَ وَأَبِي بَنْ كَعْبٍ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَرَوَى عَنْ سَعْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَغَيْرِ وَاحِدٍ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ قَالُوا صَلَاةُ الرَّبِّ الرَّحْمَةُ وَصَلَاةُ الْمَلَائِكَةِ الْإِسْتِغْفَارُ .

486. Na ka treguar Ebu Davud Sulejman b. Muslim El-Belhi el-Musahifijj, atë e ka informuar Nadir b. Shumejli, ai ka transmetuar nga Ebu Kurre el-Esedi, ai nga Seid b. Musejjebi – që Umer b. Hattabi ka thënë: “Duaja ndalet në mes qiellit dhe tokës, asgjë nga ajo nuk ka për t’u ngritur, gjithnjë derisa nuk dërgon salavate mbi të Dërguarin tënd (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، سُلَيْمَانُ بْنُ سَلَمٍ الْمَصَافِي الْأَلْجِي أَخْبَرَنَا النَّضْرُ بْنُ شُمَيْلٍ، عَنْ أَبِي قُرَّةِ الْأَسَدِيِّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ، قَالَ إِنَّ الدُّعَاءَ مَوْفُوتٌ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ لَا يَصْعَدُ مِنْهُ شَيْءٌ حَتَّى تُصَلِّيَ عَلَى نَبِيِّكَ ﷺ .

Ebu Isai, thotë: “Ala b. Abdurrahmani është i biri i Jakubit, ndërsa ishte i mbrojturi i El-Hurekës. Ala është tabi’inë. Ka dëgjuar hadithe nga Enesi dhe të tjerët. Abdurrahman b. Jakubi është i ati i Alait, ai gjithashtu është tabi’inë. Ka dëgjuar hadithe nga Ebu Hurejre dhe Ebu Seid el-Hudriu. Jakubi është tabi’ini më i vjetër. Ai e ka takuar Umer b. Hattabin dhe ka transmetuar prej tij.”

قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . عَبَّاسُ هُوَ ابْنُ عَبْدِ الْعَظِيمِ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَالْعَلَاءُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ هُوَ ابْنُ يَعْقُوبَ وَهُوَ مَوْلَى الْخُرَاقَةِ وَالْعَلَاءُ هُوَ مِنَ التَّابِعِينَ سَمِعَ مِنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ وَغَيْرِهِ . وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ يَعْقُوبَ وَالِدُ الْعَلَاءِ هُوَ أَيْضًا مِنَ التَّابِعِينَ سَمِعَ مِنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَأَبِي سَعِيدِ الْخُدْرِيِّ وَابْنِ عُمَرَ . وَيَعْقُوبُ جَدُّ الْعَلَاءِ هُوَ مِنْ كِبَارِ التَّابِعِينَ أَيْضًا قَدْ أَدْرَكَ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ وَرَوَى عَنْهُ .

487. Na ka treguar Abbas b. Abduladhim el-Anberi – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdi, ai ka transmetuar nga Malik b. Enesi, ai nga Ala b. Abdurrahman b. Jakubi, ai nga babai i vet, ai nga gjyshi i vet – që Umer b. Hattabi ka thënë: “Në tregun tonë, mos të tregojnë, përveç atyre, që e njohin dhe e kuptojnë fenë!” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا عَبَّاسُ الْعَنْبَرِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، عَنْ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ، عَنِ الْعَلَاءِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ يَعْقُوبَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، قَالَ قَالَ عُمَرَ بْنُ الْخَطَّابِ لَا يَبِيعُ فِي سَوْقِنَا إِلَّا مَنْ قَدْ تَقَفَّهُ فِي الدِّينِ .

²¹⁹ E kanë shënuar Muslimi në *Sahih*, dhe Ebu Davudi e Nesaiu në *Sunene*.

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

Kapitulli mbi ditën e Premte - Xhumanë

كِتَابُ الْجُمُعَةِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

348. Vlera e namazit të xhumasë

بَابُ مَا جَاءَ فِي فَضْلِ يَوْمِ الْجُمُعَةِ

488. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Mugire b. Abdurrahmani, ai ka transmetuar nga Ebu Zinadi, ai nga A'rexhi, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dita më e mirë, në të cilën lindë dielli, është e premteja. Në të është krijuar Ademi, në të është futur në Xhennet, në të është nxjerr nga ai dhe nuk ka për të ndodhur dita e Kijameti, përveç se në ditën e premte.”²²⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Lubabe Selmani, Ebu DHerri, Sa'd b. Ubade dhe Evs b. Evsiu. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²²¹

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا الْمُغِيرَةُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِي الرَّزَّادِ، عَنْ الْأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " خَيْرُ يَوْمٍ طَلَعَتْ فِيهِ الشَّمْسُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِيهِ خُلِقَ آدَمُ وَفِيهِ أُدْخِلَ الْجَنَّةَ وَفِيهِ أُخْرِجَ مِنْهَا وَلَا تَقُومُ السَّاعَةُ إِلَّا فِي يَوْمِ الْجُمُعَةِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي لُبَابَةَ وَسَلْمَانَ وَأَبِي ذَرٍّ وَسَعْدِ بْنِ عُبَادَةَ وَأُسَ بْنِ أَوْسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

349. Mbi momentin në të cilin të premteve pranohet duaaja

بَابُ مَا جَاءَ فِي السَّاعَةِ الَّتِي تُرْجَى فِي يَوْمِ الْجُمُعَةِ

489. Na ka treguar Abdullah b. Sabbah el-Hashim el Basriu – atë e ka informuar Abdullah b. Abdulmexhid el-Hanefi, atë Muhammed b. Ebu Humejd,²²² atë Musa b. Verdani, ai ka transmetuar nga Enes b. Maliku – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kërkoni momentin, në të cilin, të premteve pranohet lutja, duke filluar nga ikindia e deri te perëndimi i Diellit.”²²³

²²⁰ Ademi a.s. nuk është dëbuar nga Xhenneti, siç është rasti me Iblisin. Ai është nxjerr nga Xhenneti, që në Tokë të zhvillohet raca njerëzore dhe që nën kornizat e qenies njerëzore, janë shfaqur të dërguarit e Allahut.

²²¹ E shënojnë edhe Muslimi në *Sahih*, Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

²²² Muhammed b. Ebu Humejd Ibrahim el-Ensari ez-Zureki el-Medeni, sipas vlerësimit të Ibn Haxherit është ravi i dobët. I ka takuar gjeneratës së shtatë.

²²³ Dijetarët islam, në përpjekjet për ta kuptuar dhe për ta caktuar me precizitet se kur do të mund të ishte ai moment, gjatë të cilit të premteve mund të pranohet lutja, janë bukur shumë të ndryshme. Ibnul Haxher el-Askalani, në veprën Fet'hul-Barit, i ka përmendur rreth dyzet mendime të ndryshme, mbi atë pikëpamje. Sipas tij, më të afërt, me të vërtetën, janë ata të cilët bazohen mbi dy hadithe. Atë të cilin e shënon Muslimi, në *Sahih*, nga Ebu Musai, e në të cilin qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë,

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith, në këtë formë është garib. Ai, në një mënyrë tjetër është transmetuar nga Enesi, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Muhammed b. Ebu Humejden, disa dijetarë e konsiderojnë, si ravi të dobët, për shkak të të mbajturit në mend. Thuhet, që është quajtur Hammad b. Ebu Humejd. Disa thonë, se ai është Ebu Ibrahim el-Ensari, i cili i ka kundërshtuar ravitë e besueshëm. Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve, konsiderojnë, që momenti në të cilin pranohet lutja, është pas ikindisë e deri te perëndimi i diellit. Kështu mendojnë edhe Ahmedi dhe Is’haku.”

Ahmedi thotë: “Shumica e haditheve, në të cilat flitet mbi momentin, në të cilin pranohet lutja, tregojnë, që ai është pas ikindisë, e mund të jetë edhe pas drekës.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الصَّبَّاحِ الْهَاشِمِيُّ الْبَصْرِيُّ الْعَطَّارُ، حَدَّثَنَا غُنَيْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الْمَجِيدِ الْحَنْفِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ أَبِي حُمَيْدٍ، حَدَّثَنَا مُوسَى بْنُ وَرْدَانَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " اَلْتَمِسُوا السَّاعَةَ الَّتِي تُرْجَى فِي يَوْمِ الْجُمُعَةِ بَعْدَ الْعَصْرِ إِلَى غَيْبُوبَةِ الشَّمْسِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ . وَمُحَمَّدُ بْنُ أَبِي حُمَيْدٍ يُضَعِّفُ ضَعْفَهُ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ قَبْلِ جَفْظِهِ وَيُقَالُ لَهُ حَمَّادُ بْنُ أَبِي حُمَيْدٍ وَيُقَالُ هُوَ أَبُو إِبْرَاهِيمَ الْأَنْصَارِيُّ وَهُوَ مُنْكَرُ الْحَدِيثِ . وَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ السَّاعَةَ الَّتِي تُرْجَى فِيهَا بَعْدَ الْعَصْرِ إِلَى أَنْ تَغْرُبَ الشَّمْسُ . وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ أَحْمَدُ أَكْثَرُ الْأَحَادِيثِ فِي السَّاعَةِ الَّتِي تُرْجَى فِيهَا إِبَابَةُ الدَّعْوَةِ أَنَّهَا بَعْدَ صَلَاةِ الْعَصْرِ وَتُرْجَى بَعْدَ زَوَالِ الشَّمْسِ .

490. Na ka treguar Zijad b. Ejub el-Bagdadi – atë e ka informuar Ebu Amir el-Akadi, atë Kethir b. Abdullah b. Amër b. Avf el-Muzeni, ai ka transmetuar nga babai i vet, ai nga gjyshi i vet – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Të premteve, është një moment në të cilin, asnjë rob nuk ka për të kërkuar diç nga Allahu, e që Ai të mos ia jep atë.” “Cili është ai moment, o i Dërguar i Allahut?” – pyetën të pranishmit. Ai tha: “Ai është në kohën kur thirret ikameti (për fardin e xhumasë) dhe, gjithnjë, derisa nuk përfundojnë ato.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Musai, Ebu Dherre, Selmani, Abdullah b. Selami, Ebu Lubabe dhe Sa’d b. Ubade. Hadithi i Amër b. Avfit është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا زِيَادُ بْنُ أَيُّوبَ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ الْعَقَدِيُّ، حَدَّثَنَا كَثِيرُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ عَوْفٍ الْمَرْزِيُّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِنَّ فِي الْجُمُعَةِ سَاعَةً لَا يَسْأَلُ اللَّهَ الْعَبْدُ فِيهَا شَيْئًا إِلَّا آتَاهُ اللَّهُ إِيَّاهُ " . قَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ أَيُّهُ سَاعَةٌ هِيَ قَالَ " حِينَ تَقَامُ الصَّلَاةُ إِلَى الْإِنْصِرَافِ مِنْهَا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي مُوسَى وَأَبِي ذَرٍّ وَسَلْمَانَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَلَامٍ وَأَبِي لُبَابَةَ وَسَعْدِ بْنِ عُبَادَةَ وَأَبِي أَمَامَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَمْرٍو بْنِ عَوْفٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

491. Na ka treguar Is’hak b. Musa el-Ensari – atë e ka informuar Ma’ni, atë Malik b. Enesi, ai ka transmetuar nga Jezid b. Abdullah b. Hadiu, ai nga Muhammed b. Ibrahim, ai nga Ebu Seleme, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dita më e mirë, në të cilën lind dielli, është e premtja. Në të është krijuar Ademi, në të ka hyrë në Xhennet, në të është nxjerr nga Xhenneti dhe në të gjendet një moment – asnjë rob musliman, duke u falur, nuk ka për të kërkuar diçka nga Allahu, e që Ai nuk ka për t’ia dhënë.” Ebu Hurejre, thotë: “Me një rast e kam takuar Abdullah b. Selamin dhe ia përmenda këtë hadith, e ai më tha: “Unë më së miri e di se kur është ai moment.” Unë thash: “Më informo mbi të dhe mos u bëjë koprrac ndaj meje!” Ai tha: “Ai është në kohën pas ikindisë, derisa nuk perëndon dielli.” Unë thash: “Si mund të jetë pas ikindisë, kur i Dërguari i Allahut ka thënë: ‘Asnjë rob musliman, në atë moment, nuk ka për të kërkuar diç, e ajo është koha gjatë së cilës (asgjë) nuk falet?’” Abdullah b. Selami, në atë tha: “Vallë, a nuk ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Kush ulet në ndonjë vend, me qëllim

se ai moment do të mund të ishte në kohën kur hatibi ulet në minber dhe derisa nuk përfundon namazi. I dyti është, në të cilin shënon Tirmidhiu nga Abdullah b. Selami, e në të cilin qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ai moment do të mund të ishte në kohën, që nga pas ikindisë dhe derisa nuk perëndon dielli.” Me siguri ishte urtësi, për shkak të së cilës, ky moment ka mbetur sekret, sekreti fshihet në atë që pasuesit e islamit t’i kushtojnë pak më tepër kohë ibadetit, ditën e premtë, veçanërisht duasë.

për ta pritur namazin – konsiderohet që është në namaz, gjithnjë, derisa është duke e pritur atë.” “Po” – u përgjigja, e ai tha: “Ja, kjo është ajo!”

Ebu Isai, thotë: “Në disa hadithe është paraqitur rrëfim më i gjatë mbi atë.²²⁴ Ky hadith është sahih. Fjala *ed-danin* – në fjalë: “Më informo mbi të dhe në atë mos u bëjë koprrac ndaj meje!” – do të thotë koprraci, derisa fjala *edh-dhanin* do të thotë *i akuzuari*.”

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنٌ، حَدَّثَنَا مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْهَادِ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " خَيْرُ يَوْمٍ طَلَعَتْ فِيهِ الشَّمْسُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِيهِ خُلِقَ آدَمُ وَفِيهِ أُدْخِلَ الْجَنَّةَ وَفِيهِ أُهْبِطَ مِنْهَا وَفِيهِ سَاعَةٌ لَا يُوَافِقُهَا عَبْدٌ مُسْلِمٌ يَصَلِّيُ فَيَسْأَلُ اللَّهَ فِيهَا شَيْئًا إِلَّا أَعْطَاهُ إِيَّاهُ " . قَالَ أَبُو هُرَيْرَةَ فَلَقِيتُ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ سَلَامٍ فَذَكَرْتُ لَهُ هَذَا الْحَدِيثَ فَقَالَ أَنَا أَعْلَمُ بِتِلْكَ السَّاعَةِ . فَقُلْتُ أَخْبِرْنِي بِهَا وَلَا تَضُنَّنْ بِهَا عَلَيَّ قَالَ هِيَ بَعْدَ الْعَصْرِ إِلَى أَنْ تَغْرُبَ الشَّمْسُ . فَقُلْتُ كَيْفَ تَكُونُ بَعْدَ الْعَصْرِ وَقَدْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا يُوَافِقُهَا عَبْدٌ مُسْلِمٌ وَهُوَ يُصَلِّي " . وَتِلْكَ السَّاعَةُ لَا يُصَلِّي فِيهَا فَقَالَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ سَلَامٍ أَلَيْسَ قَدْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ جَلَسَ مُجْلِسًا يَنْتَظِرُ الصَّلَاةَ فَهُوَ فِي صَلَاةٍ " . قُلْتُ بَلَى . قَالَ فَهُوَ ذَلِكَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَفِي الْحَدِيثِ قِصَّةٌ طَوِيلَةٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَمَعْنَى قَوْلِهِ " أَخْبِرْنِي بِهَا وَلَا تَضُنَّنْ بِهَا عَلَيَّ " . لَا تَبْخُلْ بِهَا عَلَيَّ وَالضَّنُّ الْبُخْلُ وَالطَّنِينُ الْمُنْتَهَمُ .

350. Mbi larjen (gusl) të premtëve

باب مَا جَاءَ فِي الْإِغْتِسَالِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

492. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Salimi, e ai nga babai i vet – që e ka dëgjuar të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Kush vjen në xhuma le të lahet.”²²⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi, Umeri, Xhabiri, Bera, Aishja dhe Ebu Derda. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar nga Zuhriu, ai nga Abdullah b. Umeri, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّهُ سَمِعَ النَّبِيَّ ﷺ يَقُولُ " مَنْ أَتَى الْجُمُعَةَ فَلْيَغْتَسِلْ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ وَأَبِي سَعِيدٍ وَجَابِرٍ وَالْبَرَاءِ وَعَائِشَةَ وَأَبِي الدَّرْدَاءِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَرُويَ عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ هَذَا الْحَدِيثُ أَيْضًا .

493. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa'di, duke transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Abdullah b. Abdullah b. Umeri, ai nga Abdullah b. Umeri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

²²⁴ Këtë hadith, në tregimin e tij të plotë, e shënojnë Maliku në *Muvetta* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

²²⁵ Në transmetimin e Muslimit, të këtij hadithi, qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur dikush nga ju dëshiron të shkojë në xhuma, atëherë le të lahet.” Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*, e shënojnë nga Ebu Seidi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Çdo musliman është i obliguar, që të premtëve të lahet, t'i lajë dhëmbët, nëse ka mundësi, të parfumohet.” Nesaiu, në *Sunen*, ka shënuar nga Xhabiri, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Çdo musliman e ka të obliguar të lahet (së paku) një herë në javë dhe atë të premtëve.” Disa dijetarë islam, në bazë të hadithit të përmendur dhe të tjerëve, kanë deklaruar, që larja të premtëve është vaxhib për çdo musliman dhe muslimane, pa marr parasysh a kanë për të marrë pjesë në xhuma apo jo. Dikush pohon, që larja të premtëve është obligim vetëm për ata musliman dhe muslimane që e kanë ndërmend faljen e xhumasë. Ata, këtë qëndrim, e bazojnë në hadithin, të cilin e transmeton Ibn Hibbani dhe Ibn Huzejme, në *Sahihë*, nga Uthman b. Vakidi, e ai nga Nafiu, në të cilin qëndron: “Ata prej burrave dhe grave, që kanë ndërmend ta falin namazin e xhumasë, le të lahen. Ata, të cilët nuk kanë ndërmend, nuk duhet.”

Muhammedi thotë: “Të dy hadithet – edhe ai i Zuhriut nga Selimi nga babai i tij, dhe hadithi i Abdullah b. Abdullahut, nga babai i tij – janë të besueshëm.”

Njëri nga nxënësit e Zuhriut, duke transmetuar nga ai, ka thënë: “Më kanë treguar të afërmit e Abdullah b. Umerit, duke transmetuar nga Ibn Umeri: “Me një rast, derisa Umer b. Hattabi mbante hutben, ka hyrë njëri nga as’habët.²²⁶ Umeri i tha: ‘A je duke e parë se çfarë kohe jemi?’ Ai në atë tha: ‘Vetëm se, pasi që e dëgjova ezanin,²²⁷ jam ndalur aq sa kam marr avdest.’ Në atë, Umeri përsëri tha: “Dhe (vetëm) avdest!? Ndërsa, e ke të njohur, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka urdhëruar larjen!”

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ قُتَيْبَةُ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ عَنْ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ عَنْ أَبِيهِ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ مِثْلُهُ . وَقَالَ مُحَمَّدٌ وَحْدَيْهِ الرَّهْرِيُّ عَنْ سَالِمٍ عَنْ أَبِيهِ وَحْدَيْهِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ أَبِيهِ كِلَا الْحَدِيثَيْنِ صَحِيحٌ . وَقَالَ بَعْضُ أَصْحَابِ الرَّهْرِيِّ عَنْ الرَّهْرِيِّ قَالَ حَدَّثَنِي آلُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنْ عُمَرَ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ فِي الْغُسْلِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ أَيْضًا وَهُوَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ رَوَاهُ يُونُسُ وَمَعْمَرٌ عَنِ الرَّهْرِيِّ عَنْ سَالِمٍ عَنْ أَبِيهِ بَيْنَمَا عُمَرُ بْنُ الْخَطَّابِ يَخْطُبُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ إِذْ دَخَلَ رَجُلٌ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَ أَيُّ سَاعَةٍ هَذِهِ فَقَالَ مَا هُوَ إِلَّا أَنْ سَمِعْتُ الدَّاءَ وَمَا زِدْتُ عَلَى أَنْ تَوَضَّأْتُ . قَالَ وَالْوُضُوءُ أَيْضًا وَقَدْ عَلِمْتُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ أَمَرَ بِالْغُسْلِ .

494. Mbi atë, na ka treguar Muhammed b. Ebani: “Neve na ka informuar Abdurrezaku, duke transmetuar nga Ma’meri, ndërsa ai nga Zuhriu.”

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ أَبُو بَكْرِ مُحَمَّدُ بْنُ أَبَانَ حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ عَنْ مَعْمَرٍ عَنِ الرَّهْرِيِّ .

495. Na ka treguar Abdullah b. Abdurrahmani – atë e ka informuar Abdullah b. Salih, ai ka transmetuar nga Lejthi, ai nga Junusi, ndërsa ai nga Zuhriu – këtë hadith (të njëjtë).

Ebu Isai thotë: “Këtë hadith e ka transmetuar edhe Maliku nga Zuhriu, e ai nga Salimi, i cili ka thënë: “Derisa Umeri mbante hutbe të premtëve...” – pastaj e përmendi hadithin e mëparshëm. E pyeta Muhammedin (Buhariun) mbi këtë hadith, e ai tha: “Hadithin, të cilin Zuhriu e transmeton nga Salimi, e ai nga babai i vet, është i besueshëm.”

Muhammedi thotë: “Ngjashëm me këtë hadith, ka transmetuar Maliku nga Zuhriu, nga Salimi, e ai nga babai i vet.”

قَالَ وَحَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، أَخْبَرَنَا أَبُو صَالِحٍ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ صَالِحٍ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ يُونُسَ، عَنِ الرَّهْرِيِّ، بِهَذَا الْحَدِيثِ . وَرَوَى مَالِكٌ، هَذَا الْحَدِيثَ عَنِ الرَّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، قَالَ بَيْنَمَا عُمَرُ بْنُ الْخَطَّابِ يَخْطُبُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ . فَذَكَرَ هَذَا الْحَدِيثَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ هَذَا فَقَالَ الصَّحِيحُ حَدِيثُ الرَّهْرِيِّ عَنْ سَالِمٍ عَنْ أَبِيهِ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَقَدْ رَوَى عَنْ مَالِكٍ أَيْضًا عَنِ الرَّهْرِيِّ عَنْ سَالِمٍ عَنْ أَبِيهِ نَحْنُ هَذَا الْحَدِيثِ .

351. Mbi vlerat e larjes të premtëve

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الْغُسْلِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

496. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, ai ka transmetuar nga Sufjani dhe Ebu Xhenab Jahja b. Ebu Hajjei,²²⁸ ata nga Abdullah b. Isai, ai nga Jahja b. Harithi, ai nga Ebul-

²²⁶ El-Mubarekfuri, thekson, se në shumë ajete konfirmohet, se ai ka qenë Uthman b. Affani.

²²⁷ El-Mubarekfuri pohon, që këtu është fjala për ezanin e dytë, i cili thirret pas faljes së sunnetit, e para hutbes.

²²⁸ Ibn Haxheri, në *Tekribut-tehzip*, thotë dikush Ebu Xhenab Jahja b. Hajjen e ka konsideruar si ravi të dobët, për shkak të tendencës së tij për të mashtruar. Ai hadithe ka transmetuar nga Abdullah b. Isaa dhe shumë të tjerë, derisa prej tij hadithe kanë marrë Vekiu, Sufjani dhe tjerët.

Esh'as es-San'aniu – që Evs b. Evs ka thënë: “Më ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Kush të premtëve e lanë kokën dhe pjesët e tjera të trupit, pastaj shkon herët (në xhami) në orën e parë, i afrohet imamit, e dëgjon hutben në heshtje – për çdo hap që e ka kaluar do të ketë shpërblimin sikur të kishte agjëruar dhe të ishte falur vullnetarisht një vit.”²²⁹

Duke folur mbi këtë hadithi, Mahmudi,²³⁰ ka treguar që Vekiu ka thënë: “Që ai dhe gruaja e tij lahen (nga xhunubllëku).”

Transmetohet, që Ibn Mubareku, mbi këtë hadith, ka thënë: “*Kush e lanë* dhe *lahet* domethënë: e lanë kokën mirë dhe lahet.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Bekri, Imran b. Husejni, Selmani, Ebu Dherre, Ebu Seidi, Ibn Umeri dhe Ebu Ejubi. Hadithi i Evs b. Evsit është hasen²³¹, ndërsa emri i Ebul-Esh'as es-San'niut është Shurahbil b. Ade.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، وَأَبُو جَنَابٍ يَحْيَى بْنُ أَبِي حَيَّةٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عِيسَى، عَنْ يَحْيَى بْنِ الْحَارِثِ، عَنْ أَبِي الْأَشْعَثِ الصَّنْعَانِيِّ، عَنْ أُوسِ بْنِ أُوسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ اغْتَسَلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَغَسَلَ وَبَكَرَ وَابْتَكَرَ وَدَنَا وَاسْتَمَعَ وَأَنْصَتَ كَانَ لَهُ بِكُلِّ خُطْوَةٍ أَجْرُ سَنَةِ صِيَامِهَا وَقِيَامِهَا " . قَالَ مُحَمَّدٌ قَالَ وَكِيعٌ اغْتَسَلَ هُوَ وَغَسَلَ امْرَأَتُهُ . قَالَ وَيُرَوَّى عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْمُبَارَكِ أَنَّهُ قَالَ فِي هَذَا الْحَدِيثِ " مَنْ غَسَلَ وَاغْتَسَلَ " . يَغْنِي غَسَلَ رَأْسَهُ وَاغْتَسَلَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي بَكْرٍ وَعُمَرَانَ بْنِ حُصَيْنٍ وَسَلْمَانَ وَأَبِي ذَرٍّ وَأَبِي سَعِيدٍ وَابْنِ عُمَرَ وَأَبِي أَيُّوبَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أُوسِ بْنِ أُوسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَأَبُو الْأَشْعَثِ الصَّنْعَانِيُّ اسْمُهُ شَرَاهِبِلُ بْنُ أَدَةَ . وَأَبُو جَنَابٍ يَحْيَى بْنُ حَبِيبٍ الْقَصَابُ الْكُوفِيُّ .

352. Mbi avdesin të premtëve

باب مَا جَاءَ فِي الْوُضُوءِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

497. Na ka treguar Ebu Musa Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Seid b. Sufjan el-Xhahderi, atë Shu'be, duke transmetuar nga Katade, ai nga Hasani, ndërsa ai nga Semure b. Xhundubi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush të premtëve merr avdes, ajo mjafton. Por nëse ndokush lahet, porse larja është më e vlefshme.”²³²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Enesi dhe Aishja. Hadithi i Semures është hasen. Këtë hadith e kanë transmetuar disa nga nxënësit e Katades, ai nga Hasani, e ai nga Semure. Disa, prapë e kanë transmetuar nga Katade, ai nga Hasani, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si hadith-mursel. Në përputhshmëri me këtë

²²⁹ Taberaniu në *Mu'xhemul-keiru* dhe *Mu'xhemul-vesitu*, shënon nga Ebu Bekri dhe Imran b. Husejni, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ai që lahet të premtën, do t'i jenë të falura bërja e gabimeve dhe gabimet. E nëse udhëton (deri në xhami), për çdo hap kanë për t'iu shkruar nga njëzet sevape. Kur e përfundon namazin, do të shpërblehet sikur të ketë bërë vepra të mira dyqind vjet.” El-Mubarekfuri, thotë, që në senedin e këtij hadithi, gjendet ravi Dahak b. Hamza, të cilin Ibn Meini dhe Nesaiu, e kanë vlerësuar të dobët. Ibn Hibbani e ka klasifikuar në mesin e ravive të besueshëm.

²³⁰ Ai është Mahmud b. Gajlani, mësuesi i Tirmidhiut.

²³¹ Mundhiri, në veprën *Et-Tergibu vet-Terhibu*, pasi që e ka cekur këtë hadith, thotë: “E kanë shënuar Ahmed, Ebu Davudi, e Tirmidhiu thotë se është i mirë. Nesaiu, Ibn Maxhe, Ibn Hibbani, Ibn Huzejme dhe Hakimi e konsiderojnë si të besueshëm.”

²³² Në bazë të këtij hadithi, shumica e juristëve islam, ka caktuar, se të premtëve mjafton marrja e avdesit. Sipas mendimit të tyre, larja të premtëve, është mustehab – e pëlqyer, e jo vaxhib. Disa, mendojnë se larja të premtëve është e obliguar dhe se ajo është kusht për rregullsinë e xhumasë. Ky mendim nuk ka bazë. Atë, veçanërisht e vërteton rasti i Umerit dhe i Uthmanit. Që larja është abdesti. Nga ana tjetër, Umeri e kthente atë, për t'u larë dhe nuk e lejonte që të merrte pjesë në xhuma. El-Mubarekfuri, konsideron, se qëndrimi më i mirë është i atyre të cilët mendojnë se larja është sunnet i vërtetuar.

hadith, veprojnë as'habët dhe ata pas tyre. Ata konsiderojnë, që larja të premteve është më e vlefshme. Por nëse merret vetëm avdes, mjafton.”

Shafi'u thotë, që urdhri i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi larjen të premteve, e ka kuptimin e zgjedhjes, e jo të obligimit. Mbi atë, tregojnë fjalët e Umerit, të drejtuar Uthmanit: “Vallë, a vetëm avdest? Ndërsa është e njohur që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të premteve e ka urdhëruar larjen?” Sikur, ky urdhër të ishte në kuptimin e obligimit, Umeri do ta kishte kthyer Uthmanin për t'u larë, duke i thënë: “Kthehu dhe lahu!” Ndërkaq, pasi që ai ia ka tërhequr vërejtjen Uthmanit edhe përkundër të njoftuarit mbi atë – ky hadith tregon mbi vlefshmërinë e larjes në ditën e premte, e jo domosdoshmërinë.

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ سَفْيَانَ الْجَدْرِيُّ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنِ الْحَسَنِ، عَنْ سَمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ تَوَضَّأَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِيهَا وَبَعَثَ وَمِنْ اغْتَسَلَ فَالْغُسْلُ أَفْضَلُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ وَأَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَمُرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَاهُ بَعْضُ أَصْحَابِ قَتَادَةَ عَنْ قَتَادَةَ عَنِ الْحَسَنِ عَنْ سَمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ وَرَوَاهُ بَعْضُهُمْ عَنْ قَتَادَةَ عَنِ الْحَسَنِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ اخْتَارُوا الْغُسْلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَرَأَوْا أَنَّ يُجْزَى الْوُضُوءُ مِنَ الْغُسْلِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ . قَالَ الشَّافِعِيُّ وَمِمَّا يَدُلُّ عَلَى أَنَّ أَمْرَ النَّبِيِّ ﷺ بِالْغُسْلِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ أَنَّهُ عَلَى الْإِخْتِيَارِ لَا عَلَى الْوُجُوبِ حَدِيثُ عُمَرَ حَيْثُ قَالَ لِعُثْمَانَ وَالْوُضُوءُ أَيْضًا وَقَدْ عَلِمْتُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ أَمَرَ بِالْغُسْلِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ . فَلَوْ عَلِمْنَا أَنَّ أَمْرَهُ عَلَى الْوُجُوبِ لَا عَلَى الْإِخْتِيَارِ لَمْ يَبْرُكْ عُمَرُ عُثْمَانَ حَتَّى يَرُدَّهُ وَيَقُولَ لَهُ ارْجِعْ فَاعْتَسِلْ وَلَمَّا خَفِيَ عَلَى عُثْمَانَ ذَلِكَ مَعَ عِلْمِهِ وَلَكِنْ دَلَّ فِي هَذَا الْحَدِيثِ أَنَّ الْغُسْلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِيهِ فَضْلٌ مِنْ غَيْرِ وَجُوبٍ يَجِبُ عَلَى الْمَرْءِ فِي ذَلِكَ .

498. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga A'meshi, ai nga Ebu Salihi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush merr avdes bukur dhe me përpikëri, pastaj shkon në xhuma, i afrohet (imamit) dhe e dëgjon (hutben) duke heshtur – atij do t'i falen mëkatet që i ka bërë ndërmjet kësaj dhe xhumasë së kaluar dhe tre ditë më shumë. Kush gjatë kohës së hutbes i prekë guralecët, ai bënë vepër të keqe.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”²³³

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، قَالَ حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ تَوَضَّأَ فَأَحْسَنَ الْوُضُوءَ ثُمَّ أَتَى الْجُمُعَةَ فَدَنَا وَاسْتَمَعَ وَأَنْصَتَ غُفِرَ لَهُ مَا بَيْنَهُ وَبَيْنَ الْجُمُعَةِ وَرِيَادَةُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ وَمَنْ مَسَّ الْحَصَى فَقَدْ لَغَا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

353. Mbi shkuarjen e hershme në namazin e xhumasë

باب ما جاء في التَّكْبِيرِ إِلَى الْجُمُعَةِ

499. Na ka treguar Is'hak b. Musa b. Ensari – atë e ka informuar Ma'ni, atë Maliku, ai ka transmetuar nga Summejj, ai nga Ebu Salihi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush lahet të premteve, sikur që lahet nga xhunubllëku, pastaj shkon në xhami në orët e para²³⁴ - sikur ta kishte sakrifikuar një deve. Kush shkon në orën e dytë,²³⁵

²³³ E shënojnë Muslimi në *Sahih*, Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

²³⁴ Në transmetimin e Malikut, të këtij hadithi, qëndron: “Në orët e para.”

²³⁵ Sipas mendimit të Malikut, orët e kanë kuptimin e periudhave më të shkurtra kohore, të cilat fillojnë, që nga momenti kur dielli e kalon Zenitin dhe zgjasin deri tek fillimi i faljes së namazit të xhumasë. Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve islam, orët këtu kanë të bëjnë me periudhat kohore, të cilat fillojnë nga mëngjesi dhe zgjasin deri në fillim të hutbes (ligjëratës). Se sa ka zgjatur koha e një ore në kohën e tyre, nuk është cekur askund. Por, në bazë të vet haditheve, mund të konkludohet se përafërsisht ka qenë sa një orë e jona e zakonshme – pra gjashtëdhjetë minuta. Në këtë hadith është përmendur (periudha kohore) pesë orëshe, derisa në Sunnenin e Nesaiut, në hadith, është përmendur gjashtë. Në të qëndron, kjo: “Kush shkon në orën e katërt, sikur ta kishte sakrifikuar një gusë. Kush shkon në orën e pestë, sikur ta kishte sakrifikuar një pulë. Ndërsa kush

sikur ta kishte sakrifikuar një lopë, kush shkon në orën e tretë, sikur ta kishte sakrifikuar dashin brinoç. Kush shkon në orën e katërt, sikur ta kishte sakrifikuar një pulë. Kush shkon në orën e pestë, sikur ta kishte sakrifikuar një ve. Ndërsa, kur imami hip (mbi minber), melaiket janë prezent në dëgjimin e hutbes.”²³⁶

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Amri dhe Semuriu. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²³⁷

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنٌ، حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ سَمِيِّ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ " مَنْ اغْتَسَلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ غُسْلَ الْجَنَابَةِ ثُمَّ رَاحَ فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَدَنَهُ وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الثَّانِيَةِ فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَقَرَةً وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الثَّالِثَةِ فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ كَبْشًا أَقْرَنَ وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الرَّابِعَةِ فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ دَجَاجَةً وَمَنْ رَاحَ فِي السَّاعَةِ الْخَامِسَةِ فَكَأَنَّمَا قَرَّبَ بَيْضَةً فَإِذَا خَرَجَ الْإِمَامُ خَضِرَتْ الْمَلَائِكَةُ يَسْتَمِعُونَ الذِّكْرَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَسُمْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

354. Neglizhimi i namazit të xhumasë pa ndonjë arsye të justifikuar

باب مَا جَاءَ فِي تَرْكِ الْجُمُعَةِ مِنْ غَيْرِ عَذْرِ

500. Na ka treguar Ali b. Hashremi,²³⁸ atë e ka informuar Isa b. Junusi, ai ka transmetuar nga Muhammed b. Amri, ai nga Ubejde b. Sufjani, ai nga Ebu Xha'di, do të thotë Ed-Damriu,²³⁹ i cili sipas mendimit të Muhammed b. Amrit, është as'hab – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush mungon pa arsye, Allahu do t’ia vulosë zemrën.”²⁴⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Ibn Abbasi dhe Semure. Hadithi i Ebu Xha'dit është hasen.²⁴¹ E kam pyetur Muhammedin (Buhariun) për emrin e Ebu Xha'd ed-Damirit, e ai nuk e dinte. Ai tha: ‘Nuk më është e njohur që ai transmeton nga i Dërguari i Allahut, diçka tjetër përveç këtij hadith.’ Ky hadith më është e njohur vetëm nëpërmjet Muhammed b. Amrit.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ خَشْرَمٍ، أَخْبَرَنَا عِيسَى بْنُ يُونُسَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ عُبَيْدَةَ بْنِ سُفْيَانَ، عَنْ أَبِي الْجَعْدِ يَعْنِي الضَّمُرِيَّ، وَكَانَتْ لَهُ صُحْبَةٌ فِيمَا رَعَى مُحَمَّدُ بْنُ عَمْرٍو قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ تَرَكَ الْجُمُعَةَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ تَهَاوُنًا بِهَا طَبَعَ اللَّهُ عَلَى قَلْبِهِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَمْرِو وَابْنِ عَبَّاسٍ وَسُمْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي الْجَعْدِ حَدِيثٌ حَسَنٌ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ اسْمِ أَبِي الْجَعْدِ الضَّمُرِيِّ فَلَمْ يَعْرِفْ اسْمَهُ وَقَالَ لَا أَعْرِفُ لَهُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ إِلَّا هَذَا الْحَدِيثَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَلَا نَعْرِفُ هَذَا الْحَدِيثَ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو .

shkon në orën e gjashtë, sikur ta kishte sakrifikuar një ve.” Kjo i përgjigjet distancës kohore, nga mëngjesi në mbrëmje, gjatë dimrit dhe verës.

²³⁶ Ibn Huzejme në Sahihun e vet, shënon nga Abdullah b. Amri, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Të premtëve, nëpër të gjitha dyert e xhamive, dërgohen melaiket për t’i regjistruar, të gjithë ata që vijnë në xhuma, gjithnjë, derisa imami nuk e fillon hutben (ligjëratën). E kur imami fillon me mbajtjen e hutbes, ata i lënë (ulin) pendat dhe i mbyllin fletoret. Me atë rast, melaikja i thotë melaikes tjetër: “Çfarë e pengoi këtë dhe këtë për të ardhur në xhuma?” Mandej thonë: “Allahu ynë, në rast se ka devijuar nga rruga e drejtë Ti udhëzoje atë! Nëse është i sëmurë, Ti dhuroi shëndet atij. Por, nëse është në vështirësi, Ti, ndihmoje atë!”

²³⁷ E kanë transmetuar edhe Maliku në *Muvetta*, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*, si dhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

²³⁸ Ali b. Hashremi është ravi i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së dhjetë.

²³⁹ Ebu Xha'd ed-Damriu, siç thotë Ibn Hibbani, në veprën *Es-Sikat*, është Edre. Sipas mendimit të Muhammed b. Amrit, ai ka qenë as'hab. Ibn Haxheri ka theksuar, që ka vdekur në Betejën rreth devesë.

²⁴⁰ E shënojnë Ebu Ja'la, në *Musned*, nga Ibn Abbasi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush lë radhazi tri xhuma, ai islamini e ka hedhur pas shpine.” Ibn Haxheri thotë, që të gjithë ravitë në senedin e këtij hadithi janë të besueshëm.

²⁴¹ Ibn Haxher el-Askalani, pohon, që Ibn Sekeni, këtë hadith në këtë formë, e ka vlerësuar të besueshëm.

355. Çfarë distance duhet kaluar për të ardhur në namazin e Xhumasë

بَابُ مَا جَاءَ مِنْ كَمْ تُؤْتَى الْجُمُعَةُ

501. Na kanë treguar Abd b. Humejd dhe Muhammed b. Meddariju²⁴² - atyre ju ka treguar Fadl b. Dukejni, atë e ka informuar Israili, ai ka transmetuar nga Suvejri,²⁴³ ai nga një njeri nga Kuba – që babai i tij, i cili është as'hab, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), na ka urdhëruar që nga Kuba²⁴⁴ te vinim në xhuma.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith na është i njohur vetëm në këtë formë. Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi këtë temë nuk ka ardhur asgjë e besueshme.”

Ebu Hurejre, transmeton, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Xhumanë është i obliguar ta falë çdonjëri, që pas faljes së xhumasë mund të kthehet në shtëpi deri në mbrëmje.”²⁴⁵

Senedi i këtij hadithi është i dobët, sepse transmetohet nga Mubarik b. Abbadi, ai nga Abdullah b. Seid el-Makburiu. Jahja b. Seid el-Kattani, konsideron, që Abdullah b. Seid el-Makburi është ravi i dobët.

Dijetarët nuk kanë mendim të unifikuar mbi atë se kush është i obliguar ta falë xhumanë. Disa thonë: “Atë, është i obliguar ta falë secili, që pas faljes mund të kthehet në shtëpi deri në mbrëmje.” Disa thonë: “Janë të obliguar ta falin ata, të cilët e dëgjojnë ezanin.” Ky është qëndrimi edhe i Shafiut, Ahmedit dhe Is'hakut.

Tirmidhiu thotë: “E kam dëgjuar Ahmed b. Hasanin,²⁴⁶ kur ka thënë: ‘Ishim tek Ahmed b. Hanbeli dhe e përmendën namazin e xhumasë – se kush është i obliguar ta falë atë. Ahmedi mbi atë, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk ka përmendur asgjë.’ Ahmed b. Hasani thotë: ‘I thash, Ahmed b. Hanbelit: ‘Mbi atë është transmetuar nga Ebu Hurejre, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)’ – Ahmed b. Hanbeli në atë tha: ‘Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)?’ ‘Po.’ – i thash.’”

حَدَّثَنَا عَبْدُ بْنُ حُمَيْدٍ، وَمُحَمَّدُ بْنُ مَرْثُومٍ، قَالَا حَدَّثَنَا الْفَضْلُ بْنُ دُكَيْنٍ، حَدَّثَنَا إِسْرَائِيلُ، عَنْ ثُوَيْرٍ، عَنْ رَجُلٍ، مِنْ أَهْلِ قُبَاءَ عَنْ أَبِيهِ، وَكَانَ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ - قَالَ أَمَرَنَا النَّبِيُّ ﷺ أَنْ نَشْهَدَ الْجُمُعَةَ مِنْ قُبَاءَ . وَقَدْ رَوَى عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي هَذَا وَلَا يَصِحُّ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَلَا يَصِحُّ فِي هَذَا الْبَابِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ شَيْءٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ قَالَ " الْجُمُعَةُ عَلَى مَنْ آوَاهُ اللَّيْلُ إِلَى أَهْلِهِ " . وَهَذَا حَدِيثٌ إِسْنَادُهُ ضَعِيفٌ إِنَّمَا يُرَوَّى مِنْ حَدِيثِ مُعَارِكِ بْنِ عَبَادٍ

²⁴² Muhammed b. Ahmed b. Husejn b. Meddevije el-Kureshi, është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së njëmbëdhjetë të ravive.

²⁴³ Suvejri b. Ebu Fahite Seid b. Aleka el-Kufi Ebu Xhehmi, është ravi i dobët. Dhehebi në veprën *Mizanul-I'tidal*, thotë, që Darekutni, për të ka thënë, se është metrik, d.m.th. i dyshuar për gënjeshtëri. I ka takuar gjeneratës së katërt të ravive.

²⁴⁴ Kuba është periferi e medines, larg prej saj rreth dy apo tri milje.

²⁴⁵ Abdllah b. Umeri, Ebu Hurejre, Enes b. Maliku, Hasan el-Basriu, Ata', Nafiu, Ikrimë, Hakimi dhe Evzaiu – në bazë të këtij hadithi dhe haditheve të ngjashme me të – konsiderojnë, që namazin e xhumasë e ka obligim për ta falur secili, që nga xhamia në të cilën falet xhumaja banon aq larg sa që, pas faljes së xhumasë, deri natën mund të kthehet në shtëpi. Shafiu, Ahmed b. Hanbeli, Is'haku dhe tjerët, konsiderojnë, që namazin e xhuma e ka të obliguar vetëm ai që gjatë të premteve e dëgjon ezanin.

²⁴⁶ Ahmed b. Hasan b. Xhunejdi Ebu Hasan et-Tirmidhiu, në të vërtetë është njëri nga studentët e Ahmed b. Hanbelit. Ai njihej si një ekspert i shkëlqyer i hadithit. Prej tij, hadithe kanë marrë, ndër të tjerët, edhe Buhariu, Tirmidhiu dhe Ibn Huzejme. Ka vdekur në vitin 260 sipas hixhretit.

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَعِيدٍ الْمُقْبِرِيِّ . وَضَعَفَ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْقَطَّانُ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ سَعِيدٍ الْمُقْبِرِيَّ فِي الْحَدِيثِ . قَالَ وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ عَلَى مَنْ تَجِبُ الْجُمُعَةُ فَقَالَ بَعْضُهُمْ تَجِبُ الْجُمُعَةُ عَلَى مَنْ آوَاهُ اللَّيْلُ إِلَى مَنْزِلِهِ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ لَا تَجِبُ الْجُمُعَةُ إِلَّا عَلَى مَنْ سَمِعَ الذِّدَاءَ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

سَمِعْتُ أَحْمَدَ بْنَ الْحَسَنِ، يَقُولُ كُنَّا عِنْدَ أَحْمَدَ بْنِ حَنْبَلٍ فَذَكَرُوا عَلَى مَنْ تَجِبُ الْجُمُعَةُ فَلَمْ يَذْكُرْ أَحْمَدُ فِيهِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ شَيْئًا . قَالَ أَحْمَدُ بْنُ الْحَسَنِ فَقُلْتُ لِأَحْمَدَ بْنِ حَنْبَلٍ فِيهِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . فَقَالَ أَحْمَدُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قُلْتُ نَعَمْ .

502. Na ka treguar Haxhxhaxh b. Nusajriu – atë e ka informuar Muarik b. Abbad, ai ka transmetuar nga Abdullah b. Seid el-Makburiu, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Xhumanë është i obliguar ta falë çdonjëri që (pas faljes së saj) mund të kthehet në shtëpi deri në mbrëmje.” “Duke e dëgjuar këtë, Ahmed b. Hanbeli u hidhërua në mua dhe tha: ‘Kërko falje nga Sunduesi yt! Kërko falje nga Sunduesi yt!’” Ahmed b. Hanbeli ka vepruar kështu, sepse ai këtë hadith nuk e ka numëruar në asgjë, por atë e ka konsideruar të dobët për shkak të senedit.²⁴⁷

قَالَ أَحْمَدُ بْنُ الْحَسَنِ حَدَّثَنَا حَجَّاجُ بْنُ تُصَيْبٍ حَدَّثَنَا مُعَارِكُ بْنُ عَبَادٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَعِيدٍ الْمُقْبِرِيِّ عَنْ أَبِيهِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " الْجُمُعَةُ عَلَى مَنْ آوَاهُ اللَّيْلُ إِلَى أَهْلِهِ " . قَالَ فَغَضِبَ عَلَيَّ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ وَقَالَ لِي اسْتَغْفِرُ رَبَّكَ اسْتَغْفِرُ رَبَّكَ . قَالَ أَبُو عِيسَى إِنَّمَا فَعَلَ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ هَذَا لِأَنَّهُ لَمْ يَعُدَّ هَذَا الْحَدِيثَ شَيْئًا وَضَعَفَهُ لِخَالِ إِسْنَادِهِ .

356. Mbi kohën e xhumasë

باب مَا جَاءَ فِي وَقْتِ الْجُمُعَةِ

503. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Surejxh b. Numani,²⁴⁸ atë Fulejh b. Sulejmani, duke transmetuar nga Uthman b. Abdurrahman et-Tejmijje – që Enes b. Maliku, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e falte xhumanë kur dielli e kalonte zenitin.”²⁴⁹

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا سَرِيحُ بْنُ النُّعْمَانِ، حَدَّثَنَا فُلَيْحُ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ عُثْمَانَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ التَّيْمِيِّ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُصَلِّي الْجُمُعَةَ حِينَ تَمِيلُ الشَّمْسُ .

504. Na ka treguar Jahja b. Musa – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Fulejh b. Sulejmani, ai ka transmetuar nga Uthman b. Abdurrahman et-Tejmijje, e ai nga Enesi – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Seleme b. Ekveu,²⁵⁰ Xhabiri²⁵¹ dhe Zubejr b. Avami.²⁵² Hadithi i Enesit është hasen-sahih.²⁵³ Në pajtim me të, është edhe qëndrimi i

²⁴⁷ Ky hadith është i dobët, sepse në senedin e tij gjenden tre ravi të dobët: Haxhxhaxh b. Nusajri, Muarik b. Abbadi dhe Abdullah b. Seid el-Makburi. Ahmed b. Hanbeli ka kërkuar nga Ahmed b. Hasani, që të kërkoj falje nga Zoti i Madh, për shkak të asaj që ka transmetuar këtë hadith të dobët.

²⁴⁸ Surejxh b. Numan el-Xhevheri Ebu Hasan el-Bagdadi, është ravi i besueshëm. Ishte i parirë për të anashkaluar. Prejardhjen e ka nga Horasani. I ka takuar gjeneratës së dhjetë të ravive.

²⁴⁹ Neveviu, thotë: “Maliku, Ebu Hanife, Shafiu dhe shumica e dijetarëve tjerë nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, konsiderojnë, që nuk është e lejuar falja e xhumasë, vetëm se pasi që dielli të kalojë zenitin. Askush, përveç Ahmed b. Hanbelit dhe Is’hakut, nuk e konsiderojnë, që xhumaja mund të falet më përpara. Ata dy mendojnë, që xhumaja mund të falet edhe para se dielli të kalojë zenitin dhe për atë thirren në disa transmetime nga as’habët. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk është e besueshme. E besueshme është vetëm ajo në të cilën thirren shumica.”

²⁵⁰ Seleme b. Ekve, thotë: “Ne, me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e falnim xhumanë, më pastaj shpërndaheshim, e pranë murit ende nuk kishte hije, që të mund të fshiheshim.” (Buhariu dhe Muslimi)

shumicës së dijetarëve. Ata konsiderojnë, që koha e xhumasë është kur dielli e kalon zenitin, sikur në namazin e drekës. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe Is'hakut. Disa, mendojnë, që xhumaja, gjithashtu, do të kishte vlejtur, nëse do të falej edhe para se dielli ta kalonte zenitin. Ahmedi konsideron, që nuk do të duhej ta përsëriste as ai që do ta falte para se dielli ta kalonte zenitin.”

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا فُلَيْحُ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ عُثْمَانَ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ النَّيْمِيِّ، عَنْ أَنَسٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَهُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ سَلَمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ وَجَابِرِ بْنِ الزُّبَيْرِ بْنِ الْعَوَّامِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهُوَ الَّذِي أَجْمَعَ عَلَيْهِ أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ وَقْتُ الْجُمُعَةِ إِذَا زَالَتِ الشَّمْسُ كَوُفْتُ الطَّهْرِ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَرَأَى بَعْضُهُمْ أَنَّ صَلَاةَ الْجُمُعَةِ إِذَا صَلَّيْتَ قَبْلَ الزَّوَالِ أَنَّهَا تَجُوزُ أَيْضًا . وَقَالَ أَحْمَدُ وَمَنْ صَلَّاهَا قَبْلَ الزَّوَالِ فَإِنَّهُ لَمْ يَزَعْ عَلَيْهِ إِعَادَةٌ .

357. Mbi hutben në minber

باب مَا جَاءَ فِي الْخُطْبَةِ عَلَى الْمُنْبَرِ

505. Na ka treguar Ebu Hafs Amër b. Ali el-Fel-las – atë e kanë informuar Uthman b. Umeri dhe Jahja b. Kethir Ebu Gassan el-Anberi, atyre u ka treguar Muadh b. Ala, duke transmetuar nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në fillim hutben e ka mbajtur mbi trupin e drurit të palmës. Kur e ndërtoi minberin, trupi i palmës rënkonte. Rënkoj, gjithnjë, derisa nuk i është afuar i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe nuk e kishte përqafur atë. Atëherë, druri i palmës ndaloi së rënkuari.”²⁵⁴

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Enesi, Xhabiri, Sehël b. Sa’di, Ubejj b. Ka’bi, Ibn Abbasi, dhe Ummu Seleme. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-garib-sahih. Muadh b. Ala është nga Basra. Ai është vëllai i Ebu Amër b. Alaut.”

حَدَّثَنَا أَبُو حَفْصٍ، عُمَرُو بْنُ عَلِيٍّ الْفَلَّاسُ الصَّنِيفِيُّ حَدَّثَنَا عُثْمَانُ بْنُ عُمرَ، وَيَحْيَى بْنُ كَثِيرٍ أَبُو غَسَّانَ الْعَنْبَرِيُّ، قَالَا حَدَّثَنَا مُعَاذُ بْنُ الْعَلَاءِ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمرَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُخْطِبُ إِلَى جَذْعٍ فَلَمَّا أَخَذَ النَّبِيُّ ﷺ الْمُنْبَرَ حَنَّ الْجَذْعُ حَتَّى أَتَاهُ فَالْتَزَمَهُ فَسَكَنَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ وَجَابِرِ بْنِ سَعْدٍ وَأَبِي بِنِ كَعْبٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأُمِّ سَلَمَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ صَحِيحٌ . وَمُعَاذُ بْنُ الْعَلَاءِ هُوَ بَصْرِيُّ وَهُوَ أَخُو أَبِي عُمَرُو بْنِ الْعَلَاءِ .

358. Mbi uljen në mes dy hutbeve

باب مَا جَاءَ فِي الْجُلُوسِ بَيْنَ الْخُطْبَتَيْنِ

506. Na ka treguar Humejd b. Mes’ad el-Basri²⁵⁵ - atë e ka informuar Halid b. Harithi, atë Ubejdullah b. Umeri, duke transmetuar nga Nafiu – që Ibn Umeri ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i

²⁵¹ Xhabir b. Abdullahu, thotë: “Ne mblidheshim tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (për faljen e xhumasë) pasi që dielli kalonte zenitin, ndërsa ktheheshim në hijen pasuese.” (Muslimi dhe Nesaiu)

²⁵² Zubejr b. Avvami, thotë: :Jemi falur me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pastaj ktheheshim dhe i jepnim pushim deveve tona.” Hasani, gjithashtu, Ibn Ajjashi, thotë: “I kam thënë Xha’ferit: ‘Cila kohë ka qenë ajo?’ Ai tha: ‘Pasi që dielli kalon zenitin.’”

²⁵³ E shënojnë Buhariu, në *Sahih*, dhe Ebu Davudi, në *Sunen*.

²⁵⁴ Buhariu në *Sahih*, shënuar tregimin e plotë, mbi atë se si druri i palmës, mbi të cilin ka mbajtur hutben, ka rënkuar kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ndërtoi minberin. Mbi këtë ndodhi, hadithe janë shënuar edhe nga Ibn Maxhe, në *Sunen*, dhe Taberaniu, në *Mu’xhemul-Kebiru*.

²⁵⁵ Humejd b. Mes’ade el-Basri, është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së dhjetë të ravive.

Allahut qoftë mbi të), të premteve mbante hutbe pastaj ulej, pastaj përsëri ngrihej dhe vazhdonte të fliste.” Tirmidhiu thotë: “Ngjashëm siç e bëjnë atë sot.”²⁵⁶

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi, Xhabir b. Abdullahu dhe Xhabir b. Semure. Hadithi i Ibn Umerit, është hasen-sahih.²⁵⁷ Ky është qëndrimi të cilit i përmbahen dijetarët. Ata konsiderojnë, që me të ulurit duhet ndarë dy hutbe.”

حَدَّثَنَا حُمَيْدُ بْنُ مَسْعَدَةَ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا خَالِدُ بْنُ الْحَارِثِ، حَدَّثَنَا عُيَيْنَةُ بْنُ عُمَرَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يَخْطُبُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ ثُمَّ يَجْلِسُ ثُمَّ يَقُومُ فَيَخْطُبُ قَالَ مِثْلُ مَا تَفْعَلُونَ الْيَوْمَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَجَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهُوَ الَّذِي رَأَاهُ أَهْلُ الْعِلْمِ أَنَّ يَفْصِلَ بَيْنَ الْخُطْبَتَيْنِ بِجُلُوسٍ .

359. Mbi shkurtimin e hutbes

باب مَا جَاءَ فِي قَصْدِ الْخُطْبَةِ

507. Na ka treguar Kutejbe dhe Hennadi – ata i ka informuar Ebul-Ahvesi,²⁵⁸ ai transmeton nga Simak b. Harbi – që Xhabir b. Semure ka thënë: “Jam falur me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e namazi i tij edhe hutbeja e tij ishin me gjatësi mesatare.”²⁵⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ammar b. Jasiri dhe Ibn Ebu Evfai. Hadithi i Xhabir b. Semures është hasen-sahih.”²⁶⁰

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَهَنَادٌ، قَالَا حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ سِمَاكِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ جَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ، قَالَ كُنْتُ أَصَلِّيَ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فَكَانَتْ صَلَاتُهُ قَصْدًا وَخُطْبَتُهُ قَصْدًا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَمَّارِ بْنِ يَاسِرٍ وَابْنِ أَبِي أَوْفَى . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ جَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

360. Mbi recitimin mbi minber

باب مَا جَاءَ فِي الْقِرَاءَةِ عَلَى الْمُنْبَرِ

508. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Amër b. Dinari, ai nga Atai, ai nga Safvan b. Ja’la b. Umejje – që babai i Safvan b. Umejjes, ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin, kur në minber ka recituar: “Ata kanë për të thirrur: ‘O Malik!’”²⁶¹

²⁵⁶ Ky hadith udhëzon në atë, që duhet ulur në mes dy hutbeve. A është ajo vaxhib apo mustehab – ekziston mosmarrëveshje në mes dijetarëve islam. Shafi u konsideron, që ulja në mes dy hutbeve është vaxhib. Ai qëndrimin e vet e bazon në faktet, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atë rregullisht e ka praktikuar, ndërsa ka thënë: “Faluni ashtu siç më shini mua duke u falur.” Ebu Hanife, Maliku dhe të tjerët, konsiderojnë, që ulja në mes dy hutbeve është sunnet. Ata këtë e bazojnë, në të përmendurin dhe hadithet tjera.

²⁵⁷ E kanë shënuar, Ebu Davudi, në *Sunen*, përmes En-Nimjeriut, nga Nafiu, nga Abdullah b. Umeri.

²⁵⁸ Ebul-Ahvesi Selam b. Sulejm el-Kufi, sipas mendimit të Jahja b. Meinit, është ravi shumë i besueshëm dhe i sigurt.

²⁵⁹ E shënon Muslimi, në *Sahih*, nga Ammar b. Jasiri, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Njeriu e zgjatë namazin ndërsa e shkurton hutben, është domethënia e kuptimit të drejtë. Për atë shkak, zgjateni namazin, e shkurtojeni hutben.” Neveviu, në komentimin e *Sahihut* të Muslimit, pohon, që nuk ekziston asnjë kundërshti në mes këtij dhe hadithit të Xhabir b. Semures. Hadithi i Ammarit dëshiron të tregoj, që namazi duhet të jetë më i gjatë sesa hutbeja dhe jo që duhet të jetë i gjatë. Hadithi i Xhabirit tregon, që edhe njëri edhe tjetri duhet të jenë mesatar.

²⁶⁰ E shënojnë edhe Muslimi, në *Sahih*, Nesaiu dhe Ibn Maxhe, në *Sunene*.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre dhe Xhabir b. Semure. Hadithi i Ja’la b. Umejjes është hasen-garib-sahih.”²⁶² Ky, në të vërtetë, është hadithi të cilin e transmeton Ibn Ujejne. Dijetarët kanë zgjedhur qëndrimin, që imami në minber duhet të recitojë ajete kur’anore.”

Shafiu, thotë: “Nëse imami do të kishte mbajtur hutbe duke mos recituar në të asgjë nga Kur’ani, ai do të duhej ta përsëriste atë.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ عَمْرِو بْنِ دِينَارٍ، عَنْ عَطَاءٍ، عَنْ صَفْوَانَ بْنِ يَعْلَى بْنِ أُمَيَّةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ سَمِعْتُ النَّبِيَّ ﷺ يَقْرَأُ عَلَى الْمُنْبَرِ (وَيَادُوا يَا مَالِكُ) . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَجَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ يَعْلَى بْنِ أُمَيَّةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ وَهُوَ حَدِيثُ ابْنِ عُيَيْنَةَ . وَقَدْ اخْتَارَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ يَقْرَأَ الْإِمَامُ فِي الْخُطْبَةِ آيَا مِنَ الْقُرْآنِ . قَالَ الشَّافِعِيُّ وَإِذَا خَطَبَ الْإِمَامُ فَلَمْ يَقْرَأْ فِي خُطْبَتِهِ شَيْئًا مِنَ الْقُرْآنِ أَعَادَ الْخُطْبَةَ .

361. Mbi të drejtuarit kah imami derisa është duke e mbajtur hutben

باب مَا جَاءَ فِي اسْتِقْبَالِ الْإِمَامِ إِذَا خَطَبَ

509.-Na ka treguar Abbad b. Jakub el-Kufi – atë e ka informuar Muhammed b. Fadl b. Atijje, ai ka transmetuar nga Mensuri, ai nga Ibrahim, ai nga Alkame – që Abdullah b. Mes’udi, ka thënë: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) hipte në minber, ne me fytyrë ktheheshim drejt tij.”²⁶³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ibn Umeri. Hadithi i Mensurit, nuk na është i njohur, përveç nëpërmjet Muhammed b. Fadl b. Atijjes. Muhammed b. Fadl b. Atijje është ravi i dobët. Dijetarët e hadithit, konsiderojnë, që nuk i ka mbajtur në mend mirë hadithet. Sipas këtij, kanë vepruar as’habët. Ata konsiderojnë, që është mustehab kthimi kah imami, derisa është duke e mbajtur hutben. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Shafiut, Ahmedit dhe i Is’hakut. Mbi këtë temë, nuk ka ardhur asgjë e besueshme nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا عَبَادُ بْنُ يَعْقُوبَ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْفَضْلِ بْنِ عَطِيَّةَ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ عَلْقَمَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ إِذَا اسْتَوَى عَلَى الْمُنْبَرِ اسْتَقْبَلْنَاهُ بِوُجُوهِِنَا . قَالَ أَبُو عِيسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَحَدِيثُ مَنْصُورٍ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ مُحَمَّدِ بْنِ الْفَضْلِ بْنِ عَطِيَّةَ . وَمُحَمَّدُ بْنُ الْفَضْلِ بْنِ عَطِيَّةَ ضَعِيفٌ ذَاهِبُ الْحَدِيثِ عِنْدَ أَصْحَابِنَا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ

²⁶¹ *Ata do të thërrasin: “O Malik! (Më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!”, ndërsa Ai do të thotë: “Ju do të qëndroni përherë aty!”* [Ez-Zuhruf: 77]

Në bazë të këtij hadithi, dijetarët kanë vërtetuar, se është i lejuar, gjatë mbajtjes së hutbes, citimi i Kur’anit. Shafiu konsideron, se ajo është vaxhib, derisa, shumica atë nuk e konsiderojnë obligative. Gjithashtu, dijetarët kanë divergjenca në atë se në cilën hutbe mund të citohet Kur’ani? A duhet të citohet vetëm në të parën, apo vetëm në të dytën, apo ndoshta duhet të citohet në ndonjërin prej tyre – pavarësisht në cilën – ose Kur’ani, sipas nevojës mund të citohet në të dy hutbet. Varësisht nga nevoja, mund të citohet në të dyjat.

²⁶² E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, si dhe Ebu Davudi dhe Nesaiu, në *Sunene*.

²⁶³ Shënon Ibn Maxhe, në *Sunnen*, nga Adij b. Thabiti, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga gjyshi i vet, i cili ka thënë: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), hipte në minber, as’habët ktheheshin me fytyra drejt tij.”

Shënojnë Taberaniu në *Mu’xhemul-Vesit*, dhe Bejhekiu, në *Sunen*, se Ibn Umeri, ka thënë: “Kur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të premteve i afrohej minberit, u jepte selam atyre rreth vetes. Ndërsa kur hipte në minber, kthehej me fytyrë kah njerëzit.” “Nga këto hadithe” – thotë Mubarekfuri, se është sunnet, që gjatë mbajtjes së hutbes, imami të kthehet me fytyrë përballë njerëzve, sikur që është sunnet që edhe njerëzit gjatë mbajtjes së hutbes të kthehen me fytyrë në drejtim të imamit.” “Ata” – thotë Ebu Tajjibi – “nuk kanë për të bërë rrathë, rreth minberit, por ashtu siç janë duke ndenjur në safe, kanë për t’u kthyer me fytyrë në drejtim të Hatibit.”

مَنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ يَسْتَجِيبُونَ اسْتِيفَالَ الْإِمَامِ إِذَا خَطَبَ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَالشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَلَا يَصِحُّ فِي هَذَا الْبَابِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ شَيْءٌ .

362. Mbi dy rekate kur personi vjen derisa imami mban hutbe.

بَاب مَا جَاءَ فِي الرَّكْعَتَيْنِ إِذَا جَاءَ الرَّجُلُ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ

510. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, ai ka transmetuar nga Amër b. Dinari – që Xhabir b. Abdullahu, ka thënë: “Një ditë, derisa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbante hutbe, erdhi një njeri²⁶⁴ (dhe u ul). I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i tha: ‘A i ke falur (dy rekate)?’ ‘Jo.’ – u përgjigj ai. Në atë, ai tha: ‘Ngrihu dhe fali!’”²⁶⁵ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”²⁶⁶

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ دِينَارٍ، عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ بَيْنَا النَّبِيُّ ﷺ يَخْطُبُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ إِذْ جَاءَ رَجُلٌ فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " أَصَلَّيْتَ " . قَالَ لَا . قَالَ " فَمُفَارَعُكَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ أَصَحُّ شَيْءٍ فِي هَذَا الْبَابِ .

511. Na ka treguar Muhammed b. Ebu Umeri – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Muhammed b. Axhlani – që Ijad b. Abdullah b. Ebu Serhi, ka thënë: “Ebu Seid el-Hudriu, një të premtë ka hyrë (në xhami), derisa Mervani²⁶⁷ ishte duke e mbajtur hutben dhe kishte filluar të falet. Iu afruan rojet dhe i thanë të ulej. Ai refuzoi të ulej para se të falte (dy rekate). Pasi që i përfundoi, ata iu afruan dhe i thanë: ‘Allahu të mëshiroftë, kanë mundur të të rrahin?’ – ai në atë tha: “Nuk kam dashur t’i lë, pasi që kam parë diç nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).’ Pastaj, e përmendi, që një njeri, i veshur konsiderueshëm, modest, një të premtë (xhuma) erdhi (në xhami), derisa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbante hutbe, ai e urdhëroi që t’i falte dy rekate ende derisa ishte duke e mbajtur hutben.”

Ibn Ebu Umeri,²⁶⁸ thotë: “Ibn Ujejne i falte dy rekate kur vinte, derisa imami ishte duke mbajtur hutben, atë ua urdhëronte edhe të tjerëve. Ebu Abdurrahman el-Mukri²⁶⁹ e ka parë (duke vepruar ashtu).”

Ebu Isai, thotë: “E kam dëgjuar Ibn Ebu Umerin, kur ka treguar që Ibn Ujejne ka thënë: ‘Muhammed b. Axhlani është ravi i besueshëm dhe i sigurt. Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabiri, Ebu Hurejre dhe Sehl b. Sa’di. Hadithi i Ebu Seid el-Hudriut, është hasen-sahih.”²⁷⁰ Sipas këtij veprojne dijetarët, e ky është qëndrimi edhe i Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”²⁷¹

²⁶⁴ Ai ka qenë as’habi, Sulejk el-Gatafani.

²⁶⁵ Në *Sahihun* e Buhariut dhe Muslimit është shënuar hadithi i ardhshëm: “Kur ndonjëri nga ju vjen duke ecur në xhami, derisa imami është në minber, le t’i falë dy rekate.”

²⁶⁶ E shënojnë në *El-Kutubus-sitte*.

²⁶⁷ Merven b. Hakim b. Ebul-As Ebu Abdulmelik el-Amiri, është halife umejevit. Hilafetin e mori para fundit të vitit 64, sipas hixhretit dhe qëndroi në atë pozitë deri në vdekje. Ka vdekur në Damask në vitin 65 sipas hixhretit. Ka lindur në vitin e dytë sipas hixhretit, domethënë në kohën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), por të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e ka parë.

²⁶⁸ Ai është Muhammed b. Ebu Umeri, njëri nga mësuesit e Tirmidhiut.

²⁶⁹ Ai është mësuesi i Buharut.

²⁷⁰ E kanë shënuar të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ebu Davudit.

²⁷¹ Shafi, Ahmed b. Hanbeli dhe Is’haku, konsiderojnë, se është mustehab për atë që vjen në xhami, t’i falë dy rekate, te hijjetul-mesxhid. Sipas mendimit të tyre, do të ishte mekruh, për atë që para se t’i falë dy rekate të ulet. Ebu Hanife, Maliku, Lejthi, Eth-Thevriu dhe shumica e dijetarëve të tjerë, konsiderojnë, se nuk duhet të falen, por që duhet ulur për ta dëgjuar hutben. Ata mbështeten mbi hadithet, në të cilat urdhërohet heshtja gjatë mbajtjes së hutbes. Hadithet e përmendura më lartë, në të cilët i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut

Disa thonë: “Kur ndokush vjen (në xhami), derisa imami është duke e mbajtur hutben, le të ulet dhe të mos falë (asgjë).” Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe i dijetarëve të Kufës. Ndërkaq, mendimi i parë është më i drejtë.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَجَلَانَ، عَنْ عِيَّاضِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي سَرْحٍ، أَنَّ أَبَا سَعِيدٍ الْخُدْرِيَّ، دَخَلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَمَرَّوَانُ يَخْطُبُ فَقَامَ يُصَلِّيُ فَجَاءَ الْحَرَسُ لِيُجْلِسُوهُ فَأَبَى حَتَّى صَلَّى فَلَمَّا انْصَرَفَتْ أَتَيْنَاهُ فَقُلْنَا رَحِمَكَ اللَّهُ إِنْ كَادُوا لَيَقْعُوا بِكَ . فَقَالَ مَا كُنْتُ لِأَتْرُكَهُمَا بَعْدَ شَيْءٍ رَأَيْتُهُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ . ثُمَّ ذَكَرَ أَنَّ رَجُلًا جَاءَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِي هَيْئَةٍ بَذَّةٍ وَالنَّبِيُّ ﷺ يَخْطُبُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فَأَمَرَهُ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ وَالنَّبِيُّ ﷺ يَخْطُبُ . قَالَ ابْنُ أَبِي عُمَرَ كَانَ سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ يُصَلِّيُ رَكْعَتَيْنِ إِذَا جَاءَ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ وَكَانَ يَأْمُرُ بِهِ وَكَانَ أَبُو عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْمَقْرِيُّ يَرَاهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَسَمِعْتُ ابْنَ أَبِي عُمَرَ يَقُولُ قَالَ سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ كَانَ مُحَمَّدُ بْنُ عَجَلَانَ ثِقَةً مَأْمُومًا فِي الْحَدِيثِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَسَهْلِ بْنِ سَعْدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا دَخَلَ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ فَإِنَّهُ يَجْلِسُ وَلَا يُصَلِّي . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ .

512.- Na ka treguar Kutejbe, që Ala b. Halid el-Kureshi i ka thënë: “E kam parë Hasan el-Basriun, kur ka hyrë në xhami ditën e xhumasë, derisa imami ishte duke e mbajtur hutben, i fali dy rekate dhe pastaj u ul.” Ebu Isai, thotë: “Hasani atë e ka bërë duke e aplikuar hadithin. Ai këtë hadith e transmeton nga Xhabiri, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ . حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ حَدَّثَنَا الْعَلَاءُ بْنُ خَالِدٍ الْقُرَشِيُّ قَالَ رَأَيْتُ الْحَسَنَ الْبَصْرِيَّ دَخَلَ الْمَسْجِدَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ ثُمَّ جَلَسَ . إِنَّمَا فَعَلَ الْحَسَنُ اتِّبَاعًا لِلْحَدِيثِ وَهُوَ رَوَى عَنْ جَابِرٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ هَذَا الْحَدِيثُ .

363. Mbi mospëlqyeshmërinë e të folurit derisa imami është duke e mbajtur hutben

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الْكَلَامِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ

513. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa’di, ai ka transmetuar nga Ukajli, ai nga Zuhriu, ai nga Seid b. Musejebi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush i thotë (ndokujt) derisa imami është duke e mbajtur hutben: ‘Hesht!’ – ai ka gabuar.”²⁷²

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Ebu Avfi dhe Xhabir b. Abdullahu. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²⁷³ Sipas tij, veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që është mekruh për personin të flet derisa imami është duke e mbajtur hutben. Ata thonë: ‘Në rast se, ndokush tjetër flet ndonjë gjë, ai mund të paralajmërohet vetëm me ishare.’ Ata kanë divergjenca

qoftë mbi të), e ka urdhëruar njeriun përkatës, derisa ishte ende në minber, që të ngrihet dhe që t’i falë dy rekate, sqarojnë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka urdhëruar të ngrihet dhe t’i falë dy rekate, sepse ai njeri ishte i varfër dhe jashtëzakonisht keq i veshur, për ta parë njerëzit dhe për ta ndihmuar atë.” Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron se sqarimi i këtillë nuk ka mbështetje, sidomos kur merren parasysh hadithet, në të cilat i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), thotë: “Kur ndokush të premtë vjen në xhami, derisa imami është duke e mbajtur hutben, le t’i falë dy rekate.” Ai pajtohet me Tirmidhiun, se mendimi i parë është më i drejtë dhe më i argumentuar.

²⁷² Ai me atë gjest, sipas mendimit të disa dijetarëve, ka gabuar aq sa që e ka humbur vlerën e xhumasë. Dikush konsideron, që e ka shkatërruar xhumanë dhe do t’i shënohet vetëm si drekë. Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*, ka shënuar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush ndokujt i thotë (gjatë kohës së hutbes) hesht, ai ka folur – e kush fol, ai nuk ka xhuma!” E shënojnë Ebu Davudi, në *Sunen*, Ahmedi, në *Musned* dhe Bezzari, në *Musned* nga Ibn Abbasi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush fletë të premtën, kur imami mban hutben, ai është sikur gomari i cili bartë ngarkesën. E ai, i cili i thotë të heshtë, nuk ka xhuma.”

²⁷³ E shënojnë të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ibn Maxhes.

vetëm mbi çështjen e selamit dhe të përgjigjuri e atij që teshtinë: ‘Allahu të mëshiroftë!’ Disa i përmbahen asaj, që duhet përgjigjur në selam dhe t’i thuhet atij që teshtinë: ‘Allahu të mëshiroftë!’, derisa imami është duke e mbajtur hutben. Ky është qëndrimi i Ahmedit dhe i Is’hakut. Ndërsa, disa dijetarë nga gjenerata e tabi’inëve atë e konsiderojnë mekruh. Ky është mendimi i Shafiut.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ عُقَيْلٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " مَنْ قَالَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ أَنْصَتَ فَقَدْ لَعَا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ أَبِي أَوْفَى وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ كَرَهُوا لِلرَّجُلِ أَنْ يَتَكَلَّمَ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ وَقَالُوا إِنْ تَكَلَّمَ غَيْرُهُ فَلَا يُنْكَرُ عَلَيْهِ إِلَّا بِالْإِشَارَةِ . وَاخْتَلَفُوا فِي رَدِّ السَّلَامِ وَتَشْمِيَةِ الْعَاطِسِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ فَرَحَّصَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي رَدِّ السَّلَامِ وَتَشْمِيَةِ الْعَاطِسِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ وَهُوَ قَوْلُ أَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَكَرِهَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنَ التَّابِعِينَ وَغَيْرِهِمْ ذَلِكَ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ .

364. Mbi mospëlqyeshmërinë e hapërimit në mes njerëzve, gjatë ditës së premte

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ التَّخَطِّي يَوْمَ الْجُمُعَةِ

514. Na ka treguar Ebu Kurejbi – atë e ka informuar Rishdin b. Sa’di, ai ka transmetuar nga Zebban b. Faidi,²⁷⁴ ai nga Sehl b. Muadh b. Enes el-Xhuheni, ai nga babai i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush të premteve hapëron nëpër njerëz, ai me atë ia ka ndërtuar vetes urën për në Xhehennem.”²⁷⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Xhabiri. Hadithi i Sehl b. Muadh b. Enes el-Xhuheni është garib. Nuk e kemi të njohur, përveç nëpërmjet Rishdin b. Sa’dit.”²⁷⁶ Sipas tij veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që është mekruh që personi të premteve të hapëroj nëpër njerëz dhe ishin të rreptë në atë.²⁷⁷ Disa dijetarë nuk janë deklaruar mirë mbi Rishdin b. Sa’din. Atë e konsideronin si ravi të dobët, për shkak të të mbajturit të dobët në mend.”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا رَشْدِيُّ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ زَبَّانَ بْنِ فَائِدٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ مُعَاذٍ بْنِ أَنَسٍ الْجُهَنِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ تَخَطَّى رِقَابَ النَّاسِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ اتَّخَذَ جَسْرًا إِلَى جَهَنَّمَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَهْلِ بْنِ مُعَاذٍ بْنِ أَنَسٍ الْجُهَنِيِّ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ رَشْدِيِّ بْنِ سَعْدٍ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ كَرَهُوا أَنْ يَتَخَطَّى الرَّجُلُ رِقَابَ النَّاسِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَشَدُّوا فِي ذَلِكَ . وَقَدْ تَكَلَّمَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي رَشْدِيِّ بْنِ سَعْدٍ وَضَعْفُهُ مِنْ قِبَلِ حَفْظِهِ .

²⁷⁴ Zebban b. Faid Ebu Xhuvajn el-Masri, është ravi i dobët.

²⁷⁵ Ky hadith, ka të bëjë me ata persona, të cilët, të premteve ca më vonë vijnë në xhami, ndërsa dëshirojnë të falen në safet e para dhe hapërojnë nëpër njerëz për të arritur aty. Rregulla islame është që, ai që vjen i pari në xhami, ulet në saf të parë para minberit. Ai që vjen i dyti ulet nga ana e tij e djathtë. Ai që vjen i treti ulet nga ana e tij e majtë – dhe gjithnjë ashtu vazhdon, derisa nuk plotësohet safi. Në të njëjtën mënyrë plotësohen edhe safet e tjera. Nuk është e lejuar, që njerëzit të cilët vijnë të parët në xhami të ulen në safet e fundit duke i lënë vendet e zbrazura në safet e para, e as nuk është e lejuar, që ai i cili vjen më vonë, të shkoj nëpër njerëz në safet e para. Kush vepron ashtu, e ka ndërtuar për vete urën për në Xhehennem, siç e kanë kuptuar disa këtë hadith – ose nga ai ka për t’u ndërtuar ura për në Xhehennem, - siç konsiderojnë disa – e çfarë e vërteton edhe hadithi në vijim. “Kush hapëron nëpër vëllezërit e vet, Allahu i Lartësuar, në Ditën e Gjykimit ka për ta bërë urë në dyert e Xhehennemit!” [Musnedul-Firdevs]

²⁷⁶ Rishdin b. Sa’d, sipas vlerësimit të Ibn Haxher el-Askalanit, është ravi i dobët.

²⁷⁷ Ahmed b. Hanbeli konsideron se hapërimi nëpër njerëz të premteve është mekruh. Sipas mendimit të Shafiut, siç pohon Ebu Hamidi, ajo është haram. Neveviu këtë mendim të dytë e konsideron të zgjedhur për shkak të shumë haditheve të besueshme, mbi të cilët mbështetet. Në favor të asaj flasin fjalët e Ka’b b. El-Ahbarit, të cilat, nga ai i ka transmetuar El-Iraki: “Më tepër do të doja të mungoja në xhuma se të hapëroja nëpër njerëz.” Seid b. Musejjebi, thotë: “Më tepër do të dëshiroja ta falja xhumanë në gurërore sesa të ecja nëpër njerëz.” Iraki konsideron, se imami nuk e ka as haram as mekruh ta bëjë atë për të ardhur deri te minberi, përkatësisht mihrabi, nëse në mënyrë tjetër nuk mund të arrij deri aty. Gjithashtu, ajo nuk është haram e as mekruh për personin që dëshiron që ta plotësoj vendin e zbrazët në saf.

365. Mbi mospëlqyeshmërinë e të mbështjellit në rroba,²⁷⁸ derisa imami është duke e mbajtur hutben

بَاب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الْإِحْتِبَاءِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ

515. Na kanë treguar Muhammed b. Humejd er-Razi dhe Abbas b. Muhammed ed-Devri – ata i ka informuar Ebu Abdurrahman el-Mukri, ai ka transmetuar nga Seid b. Ebu Ejubi, atij i ka treguar Ebu Merhumi, duke transmetuar nga Sehl b. Muadhi, ai nga babai i vet – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka ndaluar të premtëve mbështjelljen me rroba, derisa imami është duke e mbajtur hutben.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.²⁷⁹ Emri i Ebu Merhumit është Abdurrahman b. Mejmoni. Disa dijetarë, mbështjelljen, të premtëve, derisa imami është duke e mbajtur hutben e konsiderojnë mekruh. Disa atë e lejojnë. Në mesin e tyre është Abdullah b. Umeri dhe të tjerët. Qëndrimin e këtillë e mbështesin Ahmedi dhe Is’haku. Ata në mbështjelljen e këtillë nuk shohin asgjë të keqe.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ حُمَيْدٍ الرَّازِيُّ، وَعَبَّاسُ بْنُ مُحَمَّدٍ الثُّورِيُّ، قَالَا حَدَّثَنَا أَبُو عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْمُفْرِيُّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي أَيُّوبَ، حَدَّثَنِي أَبُو مَرْحُومٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ مُعَاذٍ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ نَهَى عَنْ الْخُبُوءِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَأَبُو مَرْحُومٍ اسْمُهُ عَبْدُ الرَّحِيمِ بْنُ مَيْمُونٍ . وَقَدْ كَرِهَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ الْخُبُوءَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ وَرَخَّصَ فِي ذَلِكَ بَعْضُهُمْ مِنْهُمْ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَمْرِو وَغَيْرُهُ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ لَا يَرَيَانِ بِالْخُبُوءِ وَالْإِمَامِ يَخْطُبُ بَأْسًا .

366. Mbi mospëlqyeshmërinë e të ngriturit e dorës në minber

بَاب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ رَفْعِ الْأَيْدِي عَلَى الْمَنْبَرِ

516. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejme²⁸⁰ - që Husajni,²⁸¹ ka thënë: “E kam dëgjuar Umare b. Ruvejben,²⁸² kur, duke e parë Bishër b. Mervanin, se si duke e mbajtur hutben, gjatë leximit të lutjes, i qonte duart: ‘Allahu t’i shëmtotfë ato duar të vockla! E kam parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), që nuk bënte asgjë më tepër, përveç shqiptimit!’ Hushejme me gisht tregues tregoi mbi gojën.”²⁸³ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”²⁸⁴

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، أَخْبَرَنَا حُصَيْنٌ، قَالَ سَمِعْتُ عُمَارَةَ بْنَ، رُوَيْبَةَ النَّقَّيَّ، وَبِشْرَ بْنَ مَرْوَانَ، يَخْطُبُ فَرَفَعَ يَدَيْهِ فِي الدُّعَاءِ فَقَالَ عُمَارَةُ فَتَبَّحَ اللَّهُ هَاتَيْنِ الْيَدَيْنَيْنِ الْقَصِيرَتَيْنِ لَقَدْ رَأَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ وَمَا يَرِيدُ عَلَى أَنْ يَقُولَ هَكَذَا وَأَشَارَ هُشَيْمٌ بِالسَّبَابَةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

²⁷⁸ Të mbështjellit me rroba, nënkupton se personi të ulet duke i mbledhur këmbët duke i puthitur ato për stomaku, mandej i mbështjell edhe shpinën edhe këmbët në ndonjë rrobe apo pelerine, duke e bërë ashtu një lloj të mbështetëses. Ose të ulet mbi këmbë dhe një pjesë të turbanit ta vë nën këmbë, duke bërë një lloj mbështetje.

²⁷⁹ E kanë shënuar Ahmedi në *Musned* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

²⁸⁰ Hushejm b. Beshir el-Vasiti është ravi i sigurt dhe i besueshëm, por ka qenë i prirë për tedlis dhe ka transmetuar shumë hadithe-mursel.

²⁸¹ Husajn b. Abdurrahman es-Sulemi Ebu Hudhejl el-Kufi, është ravi i besueshëm. Kah fundi i jetës është bërë harrestar.

²⁸² Umare b. Ruvejbe Ebu Zubejr es-Sekafi është as’hab ,i cili më vonë është vendosur në Kufa.

²⁸³ Ky hadith na tregon, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me rastin e recitimit të lutjeve në minber, përgjatë hutbes, nuk i ka ngritur duart. Ka recituar lutjet, pa i ngritur duart.

²⁸⁴ E shënojnë edhe Ahmedi në *Musned*, Muslimi në *Sahih* dhe Nesaiu në *Sunen*.

367. Mbi ezanin për xhumanë

بَاب مَا جَاءَ فِي أَذَانِ الْجُمُعَةِ

517. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hammad b. Halid el-Hajjati, ai ka transmetuar nga Ibn Ebu Zi'be, ai nga Zuhriu – që Saib b. Jezidi,²⁸⁵ ka thënë: “Gjatë kohë së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Ebu Bekrit dhe Umerit, ezani recitohej atëherë, kur imami hipte në minber dhe kur namazi vendosej. Kur (në pushtet) erdhi Uthmani, ai e ka futur edhe ezanin e tretë, i cili thirrej në Ez-Zevra.”²⁸⁶ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ خَالِدٍ الْخَيَّاطُ، عَنْ ابْنِ أَبِي ذُنُبٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنِ السَّائِبِ بْنِ يَزِيدٍ، قَالَ كَانَ الْأَذَانُ عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ وَأَبِي بَكْرٍ وَعُمَرُ إِذَا خَرَجَ الْإِمَامُ وَإِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَمَّا كَانَ عُثْمَانُ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ زَادَ الْبِدَاءَ الثَّلَاثَ عَلَى الزُّوْرَاءِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

368. Mbi të biseduarit pas zbritjes së imamit nga minberi

بَاب مَا جَاءَ فِي الْكَلَامِ بَعْدَ نُزُولِ الْإِمَامِ مِنَ الْمِنْبَرِ

518. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Xherir b. Hazimi, ai ka transmetuar nga Thabiti – që Enes b. Maliku, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pas zbritjes nga minberi, bisedonte (me njerëzit) mbi nevojat (e tyre të përditshme).”²⁸⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith më është i njohur vetëm nëpërmjet Xherrir b. Hazimit. E kam dëgjuar Muhammedin (Buhariun), kur ka thënë: “Xherrir b. Hazimi ka bërë lëshime në këtë hadith. E besueshme është ajo, çfarë është transmetuar nga Thabiti, që Enes b. Maliku, ka thënë: “Tani më ishte thirrur ikameti për namaz, kur një njeri e kishte kapur të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) për dore dhe kishte filluar të fliste me të. Biseduan aq gjatë, sa që disa njerëz filluan të koten.”²⁸⁸ Muhammedi, thotë: “Ky është ai hadith.” Xherir b. Hazimi, (nganjëherë) ndoshta bënë lëshime, por është i sinqertë. Muhammedi (Buhariu) thotë: “Xherir b. Hazimi ka bërë lëshime në hadithin e Thabitit, të cilin e ka transmetuar nga Enesi, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë

²⁸⁵ Saib b. Jezid b. Seid Simame el-Kindi është as’hab i ri. Ka pasur vetëm shtatë vjet kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë në Haxhin Lamtumurës. Umeri e ka vendosur si administrator të tregut të medines. Ka vdekur në Medine në vitin 91 sipas hixhretit. Ai është as’habi i fundit i cili ka jetuar në Medine.

²⁸⁶ Gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Ebu Bekrit dhe Umerit, të premtëve, për namazin e xhumasë, thirrej vetëm një ezan dhe atë në xhami, pasi që imami hipte mbi minber dhe ikameti, para faljes së farzit të xhumasë. Kur Uthmani është bërë hafife, ai e vendosi edhe një ezan, i cili thirrej jashtë xhamisë në Ez-Zevre, para se të konstatohej ezani i mëparshëm. Buhariu konsideron, se Ez-Zevra është vendi në çarshinë Medinase jo larg xhamisë së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

Ibn Bettali, konsideron, se ez-Zevra, është një gur i madh, i cili gjendej në hyrje të xhamisë së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ibn Maxhe e shënon transmetimin, në të cilin, qëndron: “Uthmani e ka futur edhe një ezan që thirrej mbi shtëpinë Medinase, e cila quhej Ez-Zevra.” Uthmani, në të vërtetë e ka futur ezanin e dytë, i cili thirrej si i pari dhe atë jashtë xhamisë.

Në këtë transmetim, është përmendur si i plotë, sepse njëri nga ravitë e hadithit edhe i komenton për shkak të ngjashmërisë së tij, e ka quajtur ezan.

²⁸⁷ Abdurrahman el-Mubarekfuri thekson se, në veprën *El-Munteka*, ky hadith është shënuar në formën vijuese.” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), donte të zbriste nga minberi të premtëve, dikush iu afronte dhe e pyeste për ndonjë nevojë dhe i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), bisedonte mbi atë.

²⁸⁸ El-Mubarekfuri, thotë: “Gabimi i Xheririt pasqyrohet në atë, që në hadith ka shtuar fjalët: ‘Kur ka zbritur nga minberi...’ Kjo me siguri ka ndodhur gjatë jacisë dhe jo gjatë xhumasë.”

mbi të), ka thënë: “Kur thirret ikameti, ju mos u qoni, gjithnjë, derisa nuk më shihni.” Muhammedi, ka thënë (edhe këtë): “Transmetohet, që Hammad b. Zejdi ka thënë: ‘Ishim te Thabit el-Bunaniu, e Haxhxhaxh es-Savvafi, tregoi – duke transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Abdullah b. Ebu Katade, ai nga babai i vet – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘Kur thirret ikameti, ju mos u qoni, derisa nuk më shihni.’ Dhe Xheriri ka bërë lëshim, duke menduar që atë ua ka treguar Thabiti, duke transmetuar nga Enesi, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا جَرِيرُ بْنُ حَازِمٍ، عَنْ ثَابِتٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُكَلِّمُ بِالْحَاجَةِ إِذَا نَزَلَ عَنْ الْمِنْبَرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ جَرِيرِ بْنِ حَازِمٍ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَقُولُ وَهُمْ جَرِيرُ بْنُ حَازِمٍ فِي هَذَا الْحَدِيثِ وَالصَّحِيحُ مَا رَوَى عَنْ ثَابِتٍ عَنْ أَنَسٍ قَالَ أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَأَخَذَ رَجُلٌ بِيَدِ النَّبِيِّ ﷺ فَمَا زَالَ يُكَلِّمُهُ حَتَّى نَعَسَ بَعْضُ الْقَوْمِ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَالْحَدِيثُ هُوَ هَذَا . وَجَرِيرُ بْنُ حَازِمٍ رُبَّمَا يَهُمُّ فِي الشَّيْءِ وَهُوَ صَدُوقٌ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَهُمْ جَرِيرُ بْنُ حَازِمٍ فِي حَدِيثِ ثَابِتٍ عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا تَقُومُوا حَتَّى تَرَوْنِي " . قَالَ مُحَمَّدٌ وَيُرَوَّى عَنْ حَمَادِ بْنِ زَيْدٍ قَالَ كُنَّا عِنْدَ ثَابِتِ الْبُنَانِيِّ فَحَدَّثَ حَجَّاجُ الصَّوَّافِ عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي قَتَادَةَ عَنْ أَبِيهِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا تَقُومُوا حَتَّى تَرَوْنِي " . فَوَهُم جَرِيرُ فَظَنَّ أَنَّ ثَابِتًا حَدَّثَهُمْ عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ .

519. Na ka treguar Hasan b. Ali el-Halali – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma’meri, duke transmetuar nga Thabiti – që Enesi, ka thënë: “E kam parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se si bisedonte me një njeri, pasi që ishte thirrur ikameti për namaz. Qëndronte në mes tij dhe kibles. Pandërprerë fliste me të, sa që, disa vetë i pashë duke u kotur për shkak të qëndrimit të gjatë të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”²⁸⁹ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ الْخَلَّالُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ ثَابِتٍ، عَنْ أَنَسٍ، قَالَ لَقَدْ رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ بَعْدَ مَا تَقَامَ الصَّلَاةُ يُكَلِّمُهُ الرَّجُلُ يَقُومُ بَيْنَهُ وَبَيْنَ الْقِبْلَةِ فَمَا يَزَالُ يُكَلِّمُهُ فَلَقَدْ رَأَيْتُ بَعْضَنَا يَنْعَسُ مِنْ طَوْلِ قِيَامِ النَّبِيِّ ﷺ لَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

369. Mbi recitimën në namazin e xhumasë

باب مَا جَاءَ فِي الْقِرَاءَةِ فِي صَلَاةِ الْجُمُعَةِ

520. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hatim b. Ismaili,²⁹⁰ ai ka transmetuar nga Xhafer b. Muhammedi,²⁹¹ ai nga babai i vet – që Ubejdullah b. Ebu Rafiu, i mbrojturi i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mervani për gurvenator të vetin në Medine e ka emëruar Ebu Hurejren, ndërsa ai ka shkuar në Mekke. Të premtën, Ebu Hurejre na e fali (xhumanë) dhe (në rekatin e parë) e recitoi suren *El-Xhumu’a*, ndërsa në rekatin e dytë ‘*Kur të vij në hipokritët*.’²⁹² E arrita Ebu Hurejren – thotë Ubejdullahu – dhe thash: ‘Je duke i lexuar dy suret e njëjta të cilat Aliu i lexonte në Kufa!’” – Ebu Hurejre, në atë tha: ‘E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) kur i lexonte ato (në xhuma).”

²⁸⁹ Dikush, prapë, këto hadithe i ka marr si argument, që është e lejuar biseda, pasi që imami zbret të premtëve nga minberi – pasi që e ka lexuar hutben, e para faljes së farzit të xhumasë. Ebu Bekr Ibnul-Arebi, thotë: “Unë prap se prapë, mendoj që është më mirë që gjatë asaj kohe, të mos bisedohet, sepse ajo kohë mund të jetë në të cilën mund të pranohet lutja, për atë shkak, më mirë është të mos bisedohet.”

²⁹⁰ Hatim b. Ismail el-Medeni Ebu Ismail el-Harithi, është me prejardhje nga Kufa. Shquhet si ravi i sinqertë. I takon gjeneratës së tetë të ravive.

²⁹¹ Xhafer b. Muhammed b. Ali b. Husejn b. Ali b. Ebu Talib el-Hashimi, është fakih i njohur. Është ravi i sinqertë. Është i njohur si Xhafer es-Sadik.

²⁹² I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), zakonisht, në namazin e xhumasë ka recituar: në rekatin e parë suren *El-Xhumu’a*, e në të dytën suren *El-Munafikun*. Ose, në rekatin e parë suren *El-Ala*, e në të dytën suren *El-Gashije*.

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi, Nu'man b. Beshiri dhe Ebu Utbe el-Havlanii. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”²⁹³

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në xhuma ka recituar suren *Lavdëroje Emrin e Zotit tënd të Madhëruar*²⁹⁴ dhe *A ka arritur deri tek ti lajmi mbi fatkeqësinë e rëndë*²⁹⁵.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَاتِمُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، عَنْ جَعْفَرِ بْنِ مُحَمَّدٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي رَافِعٍ، مَوْلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ قَالَ اسْتُخْلِفَ مَرْوَانُ أَبَا هُرَيْرَةَ عَلَى الْمَدِينَةِ وَخَرَجَ إِلَى مَكَّةَ فَصَلَّى بِنَا أَبُو هُرَيْرَةَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فَقَرَأَ سُورَةَ الْجُمُعَةِ وَفِي السُّجْدَةِ الثَّانِيَةِ: (إِذَا جَاءَكَ الْمُؤَافِقُونَ) قَالَ عُبَيْدُ اللَّهِ فَأَذْرَكْتُ أَبَا هُرَيْرَةَ فَقُلْتُ لَهُ تَقْرَأُ بِسُورَتَيْنِ كَانَ عَلِيٌّ يَقْرَأُ بِهِمَا بِالْكُوفَةِ قَالَ أَبُو هُرَيْرَةَ إِنِّي سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقْرَأُ بِهِمَا. وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ وَالنُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ وَأَبِي عَنبَةَ الْخَوْلَانِيِّ. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَرَوَى عَنْ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يَقْرَأُ فِي صَلَاةِ الْجُمُعَةِ بِـ (سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى) وَ (هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْعَاشِيَةِ).

370. Mbi atë se çfarë recitohet të premteve në namazin e sabahut

بَاب مَا جَاءَ فِيمَا يَقْرَأُ بِهِ فِي صَلَاةِ الصُّبْحِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

521. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Sheriku, ai ka transmetuar nga Muhavvel b. Rashidi,²⁹⁶ ai nga Muslim el-Batini,²⁹⁷ ai nga Seid b. Xhubejri – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të premteve në namazin e sabahut e lexonte suren Tenzil, Es-Sexhde dhe El-Insan.”²⁹⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Sa'di, Ibn Mes'udi dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Ibn Abbasi është hasen-sahih.”²⁹⁹ Sufjan eth-Thevriu dhe të tjerët, kanë transmetuar nga Muhavveli.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا شَرِيكٌ، عَنْ مَخْوَلِ بْنِ رَاشِدٍ، عَنْ مُسْلِمِ الْبَطِينِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَقْرَأُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِي صَلَاةِ الْفَجْرِ * (تَنْزِيلُ) السُّجْدَةِ وَ (هَلْ أَتَى عَلَى الْإِنْسَانِ). قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ سَعْدِ بْنِ سَعْدٍ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَقَدْ رَوَاهُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَشُعْبَةُ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ مَخْوَلٍ.

371. Mbi namazin para dhe pas xhumasë

بَاب مَا جَاءَ فِي الصَّلَاةِ قَبْلَ الْجُمُعَةِ وَبَعْدَهَا

522. Na ka treguar Ibn Ebu Umeri – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Amër b. Dinari, ai nga Zuhriu, ai nga Salimi, ai nga babai i vet – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pas xhumasë i ka falur dy rekate.

²⁹³ E shënojnë të gjithë, në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut.

²⁹⁴ Sureja, *El-Ala*.

²⁹⁵ Sureja, *El-Gashije*.

²⁹⁶ Muhavvel b. Rashidi është ravi i besueshëm, disa e konsiderojnë shiit.

²⁹⁷ Muslim b. Imrani, por i thuhet edhe Ibn Ebu Imran el-Batini, është ravi i besueshëm. Nga ai, hadithe kanë marrë në *El-Kutubus-sitte*.

²⁹⁸ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në sabah, më së shpeshti, të premteve ka recituar: në rekatin e parë suren *Es-Sexhde*, e në të dytën suren *El-Insan*. Në hadithin, të cilin e shënon Taberani nga Ibn Mes'udi, qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjithmonë të premteve në sabah ka recituar dy sure. “Kjo” – e thotë Ibn Haxher el-Askalani – “tregon se të premteve në sabah është mustehab recitimi i këtyre dy sureve.”

²⁹⁹ E shënojnë, gjithashtu edhe Ahmedi në *Musned*, Muslimi në *Sahih* dhe Ebu Davudi e Nesaiu në *Sunene*.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Xhabiri. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.³⁰⁰ Gjithashtu, është transmetuar edhe nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri. Sipas tij veprojnë disa dijetarë. Ky është qëndrimi i Shafiut dhe i Ahmedit.

حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ عَمْرِو بْنِ دِينَارٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكَعَتَيْنِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَيْضًا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ .

523. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, ai ka transmetuar nga Nafiu – që Ibn Umeri, pasi që e falte xhumanë, shkonte në shtëpi dhe i falte dy rekate. Ka thënë: “Ashtu bënte i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّهُ كَانَ إِذَا صَلَّى الْجُمُعَةَ انْصَرَفَ فَصَلَّى سَجْدَتَيْنِ فِي بَيْتِهِ ثُمَّ قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَصْنَعُ ذَلِكَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

524. Na ka treguar Ibn Ebu Umeri – atij i ka treguar Sufjan b. Suhejl b. Ebu Salihu, ai ka transmetuar nga babai i vet, e ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush nga ju dëshiron të falet pas xhumasë, le t’i falë katër (rekate).”³⁰¹

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³⁰²

Na ka treguar Hasan b. Aliu, atë e ka informuar Ali b. El-Medini, që Sufjan b. Ujejne, ka thënë: “Ne Suhejl b. Ebu Salihun e numëronim në mesin e atyre, të cilët ishin të sigurt në hadith.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen, sipas tij veprojnë disa nga dijetarët.”

Transmetohet, që Abdullah b. Mes’udi i ka falur katër rekate para namazit të xhumasë dhe katër pas namazit të xhumasë.³⁰³

³⁰⁰ E shënojnë në *El-Kutubus-sitte*.

³⁰¹ Mbi atë, se sa sunnete duhet falur pas farzit të xhumasë, dijetarët islam kanë mendime të ndryshme. Umer b. Hattabi, Imran b. Husejni dhe En-Nehaiu, konsiderojnë, se duhet falur vetëm dy rekate, duke u mbështetur në hadithin e përmendur nga Ibn Umeri, ndërsa Ibn Mes’udi, Alkami, Is’haku dhe Ebu Hanife, konsiderojnë se duhet falur katër rekate, duke u mbështetur në hadithin e përmendur nga Ebu Hurejre. Aliu, Ebu Talibi, Ibn Umeri, Ebu Musa, Ata’i, Eth-Thevri dhe Ebu Jusufi, konsiderojnë, se duhet falur së paku dy rekate, e pas asaj edhe katër – gjithsej gjashtë, me atë që Ebu Jusufi, konsideron, se është mustehab të falurit e së pari katër rekateve, mandej dy. Qëndrimin e vet e bazojnë mbi transmetimin, të cilin e shënon Ebu Is’haku, që Ata’i ka thënë: “Me një rast, e fala xhumanë me Ibn Umerin dhe ai, pas farzit i fali dy rekate, mandej edhe katër rekate dhe shkoi.

³⁰² E shënojnë edhe Muslimi në *Sahihë* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

³⁰³ Shënojnë Abdurrezak dhe Taberaniu nga Ibn Mes’udi, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), para xhumasë, i falte nga katër reakte, por në senedin e këtij transmetimi, gjendet ndërprerja, andaj për atë shkak është daif. Shënon Ibn Maxhe në Sunnenin e vet, që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), edhe para xhumasë edhe pas saj i falte nga dy reakte sunnet.”

Ibn Tejmije, thotë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të premtëve, pas ezanit të thirrur – para farzit, nuk falte asgjë. Gjatë kohës së tij, nuk thirrej ezani për xhuma, derisa ai nuk hipte mbi minber për shkak të hutbes (ligjërimin). Atëherë, Bilali e thërriste ezanin, pastaj ai e mbante hutben, ashtu, që as ai, e as ndokush tjetër para farzit nuk falte asgjë. E as nuk ka transmetuar asnjëri, se ai ka falur diç në shtëpi. Ai, as nuk ka rekomanduar që para xhumasë duhet falur numër i caktuar i rekateve sunnet. Të tëra, që janë transmetuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë kuptim, është se ata që vinë në xhami më herët, të mos rrinë, por të falin namaz vullnetar aq sa munden. Ashtu transmetohet, se disa nga as’habët, të premtëve dilnin të falnin tetë, disa dhjetë e disa dymbëdhjetë rekate para ezanit. Disa i falin edhe më pak. Në bazë të të gjitha të përmendurave, shumica e ulemasë janë të pajtimit, që para xhumasë, nuk duhet falur kurrfarë sunneti, sepse nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk është transmetuar asgjë e besueshme në atë pikëpamje – as nga fjalët e as nga praktika (veprat).

Transmetohet që Ali b. Ebu Talibi, ka urdhëruar, që pas xhumasë të falen së pari dy rekate, ndërsa pastaj edhe katër rekate.

Sufjan eth-Thevriu dhe Ibn Maxhe i përmbahen qëndrimit të Ibn Mes'udit.

Is'haku, thotë: “Në rast se personi, sunetet e së premtes i falë në xhami, ka për t'i falur katër rekate. Ndërsa, nëse ato i fal në shtëpi, ka për t'i falur dy rekate.” Si argument (për këtë), ai paraqet që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pas xhumasë, në shtëpi i ka falur dy rekate, dhe fjalët e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Kush nga ju (do të dëshironte) të falet pas xhumasë, le t'i falë katër (rekate).”

Ebu Isai, thotë: “Ibn Umeri transmeton, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në shtëpi i ka falur dy rekate. Ndërsa, Ibn Umeri, pas të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) pas xhumasë, në xhami i ka falur dy rekate, ndërsa pas atyre dy rekateve, i ka falur edhe katër rekate. Na tregonte Ibn Ebu Umeri – atë e ka informuar Sufjani, ai ka transmetuar nga Xhurejxi – që Atai i ka thënë: “E kam parë Ibn Umerin, kur pas xhumasë i ka falur dy rekate, pastaj, pas tyre i ka falur edhe katër rekate.”

Na ka treguar Sa'd b. Abdurrahman el-Mahzumi – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne – që Amër b. Dinari, ka thënë: “Nuk kam parë, që ndokush i citon hadithet më mirë se Zuhriu dhe as nuk e kam parë askënd që dërhëmët për të janë të parëndësishëm sikurse për atë. Dërhëmët tek ai e kishin vlerën e bajgës.”

Ebu Isai, thotë: “E kam dëgjuar Ebu Umerin, kur ka thënë: “E kam dëgjuar Sufjan b. Ujejnen, kur ka thënë: “Amër b. Dinari, ka qenë më i moshuar sesa Zuhriu.”

حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ سُهَيْلِ بْنِ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ كَانَ مِنْكُمْ مُصَلِّيًا بَعْدَ الْجُمُعَةِ فَلْيُصَلِّ أَرْبَعًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ عَنْ سُفْيَانَ بْنِ عُيَيْنَةَ قَالَ كُنَّا نَعُدُّ سُهَيْلَ بْنَ أَبِي صَالِحٍ ثُبَّتًا فِي الْحَدِيثِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَرَوَى عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي قَبْلَ الْجُمُعَةِ أَرْبَعًا وَبَعْدَهَا أَرْبَعًا . وَقَدْ رَوَى عَنْ عَلِيٍّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَمَرَ أَنْ يُصَلِّيَ بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكْعَتَيْنِ ثُمَّ أَرْبَعًا . وَذَهَبَ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ إِلَى قَوْلِ ابْنِ مَسْعُودٍ . وَقَالَ إِسْحَاقُ إِنْ صَلَّيَ فِي الْمَسْجِدِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ صَلَّيَ أَرْبَعًا وَإِنْ صَلَّيَ فِي بَيْتِهِ صَلَّيَ رَكْعَتَيْنِ . وَاخْتَجَّ بِأَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُصَلِّي بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكْعَتَيْنِ فِي بَيْتِهِ وَحَدِيثِ النَّبِيِّ ﷺ " مَنْ كَانَ مِنْكُمْ مُصَلِّيًا بَعْدَ الْجُمُعَةِ فَلْيُصَلِّ أَرْبَعًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَابْنُ عُمَرَ هُوَ الَّذِي رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكْعَتَيْنِ فِي بَيْتِهِ وَابْنُ عُمَرَ بَعْدَ النَّبِيِّ ﷺ صَلَّيَ فِي الْمَسْجِدِ بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكْعَتَيْنِ وَصَلَّى بَعْدَ الرُّكْعَتَيْنِ أَرْبَعًا . حَدَّثَنَا بِذَلِكَ ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ ابْنِ جُرَيْجٍ، عَنْ عَطَاءٍ، قَالَ رَأَيْتُ ابْنَ عُمَرَ صَلَّيَ بَعْدَ الْجُمُعَةِ رَكْعَتَيْنِ ثُمَّ صَلَّيَ بَعْدَ ذَلِكَ أَرْبَعًا . حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْمَخْزُومِيُّ حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ عَنْ عُمَرُو بْنِ دِينَارٍ قَالَ مَا رَأَيْتُ أَحَدًا أَنْصَلَ لِلْحَدِيثِ مِنَ الزُّهْرِيِّ وَمَا رَأَيْتُ أَحَدًا الدَّنَانِيرُ وَالذَّرَاهِمَ أَهْوَنَ عَلَيْهِ مِنْهُ إِنْ كَانَتِ الدَّنَانِيرُ وَالذَّرَاهِمُ عِنْدَهُ بِمَنْزِلَةِ الْبَعْرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى سَمِعْتُ ابْنَ أَبِي عُمَرَ قَالَ سَمِعْتُ سُفْيَانَ بْنَ عُيَيْنَةَ يَقُولُ كَانَ عُمَرُو بْنُ دِينَارٍ أَسَنَ مِنَ الزُّهْرِيِّ

372. Mbi atë i cili arrin në një rekat të xhumasë

باب مَا جَاءَ فِيمَنْ أَذْرَكَ مِنَ الْجُمُعَةِ رَكْعَةً

525. Na kanë treguar Nasër b. Aliu, Seid b. Abdurrahmani dhe shumë të tjerë – atyre u ka treguar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Ebu Seleme, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush arrin në një rekat të namazit, ai ka arritur në namaz.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.³⁰⁴ Sipas këtij hadithi ka vepruar shumica e ulemasë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Ata thonë: “Kush arrin në një rekat të xhumasë, ai ka për ta falur edhe një rekat. Ndërsa, ai që (imamin dhe muktedirë) i takon në teshehud, ai ka për t’i falur katër rekate.” Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut, Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”³⁰⁵

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، وَسَعِيدُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ، وَاجِدٌ، قَالُوا حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَنْ أَذْرَكَ مِنَ الصَّلَاةِ رَكْعَةً فَقَدْ أَذْرَكَ الصَّلَاةَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ قَالُوا مَنْ أَذْرَكَ رَكْعَةً مِنَ الْجُمُعَةِ صَلَّيَ إِلَيْهَا أُخْرَى وَمَنْ أَذْرَكَهُمْ جُلُوسًا صَلَّيَ أَرْبَعًا . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

373. Mbi pushimin e pasdrekes të premtëve

باب مَا جَاءَ فِي الْقَائِلَةِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

526. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e kanë informuar Abdulaziz b. Ebu Hazimi dhe Abdullah b. Xhaferi, ata kanë transmetuar nga Ebu Hazimi – që Sehl b. Sa’di, ka thënë: “Ne, në kohën e të Dërguarit të Allahut, drekonim dhe pushonim vetëm pas xhumasë.”³⁰⁶

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Enes b. Maliku.³⁰⁷ Hadithi i Sehl b. Sa’dit është hasen-sahih.”³⁰⁸

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ أَبِي حَازِمٍ، وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنْ أَبِي حَازِمٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ مَا كُنَّا نَتَّعِدُ فِي عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ وَلَا نَقِيلُ إِلَّا بَعْدَ الْجُمُعَةِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

³⁰⁴ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

³⁰⁵ Sufjan eth-Thevriu, Ibn Mubareku, Shafi, Ahmedi dhe Is’haku, konsiderojnë, që në xhuma ka arritur ai i cili me imamin arrin ta falë madje vetëm një rekat të farzit. Ndërsa, ai që me imamin nuk i falë as një rekat farz të namazit, por atë e takon në teshehud – për të xhumaja ka kaluar dhe ai duhet të falë katër rekate të namazit të drekës. Ebu Hanife konsideron, që xhumanë ka arritur ta falë, secili që ka arritur të falë me imamin çfarëdo nga xhumaja, madje edhe nëse imamin e takon në teshehud. Sipas mendimit të tij, ai pasi që imami jep selam, vetëm ka për t’u ngritur dhe ka për t’i falur numrin e rekateve që i kanë kaluar. Nëse i ka kaluar një ka për ta falur plus një rekat. Nëse i kanë kaluar të dy rekatet, ka për t’i falur dy rekate – dhe pas asaj nuk ka për ta falur drekën fare. I pari, mendimin e vet, e mbështet mbi hadithin e përmendur, të cilin e shënon Ed-Darekutni me senedin nga Ebu Hurejre: “Kush të premtëve arrin në rukunë e rekatit të fundit, le ta falë më vonë edhe një. Por, nëse nuk arrin në rekatit e fundit, le t’i falë katër rekate të drekës.” Të dytë, qëndrimin e mbështesin në hadithin me domethënie të përgjithshme, i cili është shënuar në *El-Kutubus-Sitte*. “Atë që e arrini nga namazi, atë faleni. Ndërsa ajo që kalon, plotësojeni atë duke u falur.” Abdurrahman el-Mubarekfuri konsideron se Ebu Hanifja ka të drejtë.

³⁰⁶ Sipas mendimit të Abdurrahman el-Mubarekfurit, as’habët, në kohën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk drekonin e as nuk pushonin para xhumasë, për shkak se të premtëve dilnin shumë herët në xhami dhe nuk ktheheshin derisa e falnin xhumanë.

³⁰⁷ E shënon Ahmedi në *Musned* dhe Buhariu në *Sahih*, që Enes b. Maliku, ka thënë: “Ne në kohën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me të e falnim xhumanë, pastaj ktheheshim në shtëpi dhe pushonim.”

³⁰⁸ E shënojnë, në *El-Kutubus-sitte*.

374. Ai që gjatë xhumasë kotet, le ta ndërrojë vendin

بَاب مَا جَاءَ فِيْمَنْ نَعَسَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ أَنَّهُ يَتَحَوَّلُ مِنْ مَجْلِسِهِ

527. Na ka treguar Ebu Seid el-Eshexh – atë e kanë informuar Abd b. Sulejmani dhe Ebu Halid el-Ahmeri, ata kanë transmetuar nga Muhammed b. Is’haku, ai nga Nafi’u, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Nëse ndonjëri prej jush kotet të premtëve, le të zhvendoset në vend tjetër.”³⁰⁹

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³¹⁰

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ الْأَشْجِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ بَنٍ سُلَيْمَانَ، وَأَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرُ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِسْحَاقَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا نَعَسَ أَحَدُكُمْ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فَلْيَتَحَوَّلْ مِنْ مَجْلِسِهِ ذَلِكَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

375. Mbi udhëtimin të premtëve

بَاب مَا جَاءَ فِي السَّفَرِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

528. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga Haxhxhaxhi,³¹¹ ai nga Hakemi³¹², ai nga Miksemi³¹³ - që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka dërguar Abdullah b. Revahun³¹⁴ në ballë të një batalioni. Kjo ka ndodhur të premtën. Bashkudhëtarët e tij janë nisur herët për rrugë. Abdullah b. Revahu, tha: ‘Unë kam për të mbetur ca, që së bashku me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ta fali xhumanë, pastaj kam për t’ju bashkangjitur.’ – tha ai. Pasi që është falur me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai e shikoi dhe i tha: ‘Çfarë të ndaloj, që në sot në mëngjes të udhëtosh me bashkudhëtarët e tu.’ ‘Kam pasur dëshirë që të falem me ty, e pas asaj t’iu bashkëngjitëm atyre.’ – ai tha. I Dërguari në atë tha: “Sikur ta ndaja çdo gjë që është mbi Tokë, nuk do të mund ta arrish vlerën (rëndësinë) e shkuarjes së tyre të hershme.”³¹⁵

Ebu Isai thotë: “Këtë hadith e kemi të njohur vetëm në këtë formë.”

Ali b. Medini, thotë: “Jahja b. Seidi ka treguar, që Shu’be ka thënë: ‘Hakemi nga Miksemi i ka dëgjuar vetëm pesë hadithe.’ Pastaj, Shu’be i ka numëruar ato dhe ky hadith nuk ishte në mesin e të numëruarve. Si duket, Hakemi nuk e ka dëgjuar këtë hadith nga Miksemi.”

³⁰⁹ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*, qëndron: “Nëse dikush nga ju kotet të premtëve në xhuma, le ta ndërrojë vendin.” Urtësia e ndërrimit të vendit me vendin tjetër qëndron në atë, që me ndërrimin e vendit mënjanohej të koturit.

³¹⁰ E shënojnë, Ahmedi në *Musned* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

³¹¹ Haxhxhaxh b. Erta’t el-Kufi, është kadi dhe dijetarë i shquar i fikhut. Si ravi, është i sinqertë, por ka anuar kah tedlisi dhe gabonte. I ka takuar gjeneratës së shtatë të ravive të hadithit.

³¹² Hakim b. Utejbe Ebu Muhammed el-Kindi el-Kufi, është ravi i besueshëm dhe i sigurt, përveç se ndonjëherë anonte kah tedlisi.

³¹³ Miksem b. Buxhre Ebu Kasimi, ka qenë i mbrojturi i Abdullah b. Harithit, dikush thotë, Ibn Abbasi. Është ravi i sinqertë. Buhariu nga ai transmeton vetëm një hadith.

³¹⁴ Abdullah b. Revaha el-Ensari el-Hazrexhi, është as’hab i njohur dhe udhëheqës ushtarak. Ka marr pjesë në shumë betejat: në Bedr, Uhud, Hendek. Është vrarë në Betejën në Muta, si kryekomandant i ushtrisë islame, në vitin e 8 sipas hixhretit.

³¹⁵ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), detashmentin (aradhën) e përmendur, e ka dërguar në luftë. Abdullah b. Revaha ka konsideruar, që më mirë është ta falë xhumanë dhe pastaj t’u bashkohet atyre. Megjithatë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur e ka parë, i ka thënë, a do të ishte më mirë, sikur të shkoje me ta apo të qëndroje ta falje xhumanë. Ata kanë shkuar në luftë, ndërsa nxitimi për në luftë është më i mirë, se çdo vepër tjetër.

Dijetarët janë ndarë, në pikëpamje të udhëtimit të premtëve. Disa në udhëtimin e ndokujt të premtëve, nuk shohin asgjë të keqe, në rast se është nisur para kohës së namazit.³¹⁶ Bile disa thonë: “Në rast se agon (në shtëpi të premtën), nuk duhet të nisësh në udhëtim pa e falur namazin e xhumasë.”³¹⁷

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْحَجَّاجِ، عَنِ الْحَكَمِ، عَنْ مُقْسِمٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ بَعَثَ النَّبِيُّ ﷺ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ رَوَاحَةَ فِي سَرِيَّةٍ فَوَافَقَ ذَلِكَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فَعَدَا أَصْحَابُهُ فَقَالَ اتَّخَلَّفْتُ فَأُصَلِّيَ مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ ثُمَّ أَلْحَقَهُمْ . فَلَمَّا صَلَّى مَعَ النَّبِيِّ ﷺ رَأَاهُ فَقَالَ " مَا مَنَعَكَ أَنْ تَغْدُوَ مَعَ أَصْحَابِكَ " . فَقَالَ أَرَدْتُ أَنْ أَصَلِّيَ مَعَكَ ثُمَّ أَلْحَقَهُمْ . قَالَ " لَوْ أَنْفَقْتَ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا مَا أُنَزِّلُكَ فَضْلَ غَدَوَتِهِمْ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . قَالَ عَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ قَالَ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ قَالَ شُعْبَةُ لَمْ يَسْمَعْ الْحَكَمَ مِنْ مُقْسِمٍ إِلَّا خُمُسَةَ أَحَادِيثَ . وَعَدَّهَا شُعْبَةُ وَلَيْسَ هَذَا الْحَدِيثُ فِيهَا عَدَّ شُعْبَةُ فَكَانَ هَذَا الْحَدِيثُ لَمْ يَسْمَعْهُ الْحَكَمُ مِنْ مُقْسِمٍ . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي السَّفَرِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فَلَمْ يَرِ بَعْضُهُمْ بِأَسَا بَلَنْ يَخْرُجَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِي السَّفَرِ مَا لَمْ تَحْضُرِ الصَّلَاةَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا أَصْبَحَ فَلَا يَخْرُجُ حَتَّى يُصَلِّيَ الْجُمُعَةَ .

376. Mbi përdorimin e misvakut dhe parfumit të premtëve

بَابُ مَا جَاءَ فِي السَّوَاكِ وَالطِّيبِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ

529. Na ka treguar Ali b. Hasan el-Kufi³¹⁸ - atë e ka informuar Ebu Jahja Ismail b. Ibrahim et-Tejmiu, ai ka transmetuar nga Jezid b. Ebu Zijadi, ai nga Abdurrahman b. Ebu Lejli, ai nga Berra b. Azibi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Muslimanët e kanë të obliguar që të premtëve të lahen. Secili nga ju le të parfumohet me parfumin që e përdor familja e tij, nëse nuk ka për të pasur parfum, uji për të është parfum.”³¹⁹

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi dhe një shejh ensarijas.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ الْحُسَيْنِ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو يَحْيَى، إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ النَّيْمِيُّ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي زَيْدٍ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى، عَنِ الْبَرَاءِ بْنِ عَازِبٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " حَقٌّ عَلَى الْمُسْلِمِينَ أَنْ يَغْتَسِلُوا يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَلِيَمْسَ أَحَدُهُمْ مِنْ طِيبٍ أَهْلُهُ فَإِنْ لَمْ يَجِدْ فَأَلْمَاءُ لَهُ طِيبٌ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَشَيْخٍ مِنَ الْأَنْصَارِ .

530. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Zijadi – ngjashëm me kuptimin e hadithit të mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Berras është hasen, ndërsa transmetimi i Hushejmit është më i mirë se transmetimi i Ismail b. Ibrahim b. Tejmijses, sepse Ismail b. Ibrahim et-Tejmijje është konsideruar ravi i dobët.”

³¹⁶ Shafi, shënon, që Umeri e ka parë një njeri, i cili përgatitej për udhëtim. E ka dëgjuar atë, që thoshte: “Sikur të mos ishte e premtë, unë do të nisesha.” – Umeri i tha: “Ti shko, e premtja nuk është pengese për udhëtim.” Seid b. Mensuri transmeton nga Salih b. Kejsani, që Ubejde b. Xherrahi, udhëtonte të premtën dhe nuk pritke për ta falur xhumanë.

³¹⁷ El-Mubarekfuri, thotë: “Nuk është e lejuar, që të premtëve të udhëtohet, pasi që dielli e kalon zenitin, vetëm nëse gjatë rrugës ka ku ta falë xhumanë.” Ebu Hanife dhe Maliku, konsiderojnë, që është i lejuar udhëtimi të premtëve, para se dielli të kalojë zenitin. Shafi ka dy qëndrime mbi këtë pikëpamje. Më e drejta është, që ai nuk është i lejuar. Gjithashtu, edhe Ahmedi konsideron, që nuk është i lejuar udhëtimi të premtëve as para zevalit, vetëm nëse ka të bëjë me udhëtimin për në luftë.

³¹⁸ Në këtë gjeneratë të ravive, ekzistojnë tre ravi me këtë emër: Ali b. Hasan b. Sulejman el-Kufi Ebu Hasani, i njohur si Ebu Sha'sa, Ali b. Hasan el-Kufi, i cili hadithet i ka transmetuar nga Abdurrahman b. Sulejmani dhe Muafa b. Imrani, e nga ai Nesaiu dhe Ali b. Hasan el-Kufi, i cili ka transmetuar hadithe nga Ismail b. Ibrahim et-Tejmiu, e nga ai Tirmidhiu.

³¹⁹ Tibi, thotë: “Muslimani është i obliguar të lahet, të parfumohet, që nga ai ta mënjanojë papastërtinë dhe aromën e keqe. Nëse nuk ka parfum, i mjafton edhe uji për t'i larguar ato.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي زَيْدٍ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ الْبَرَاءِ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَرَوَايَةُ هُشَيْمٍ أَحْسَنُ مِنْ رَوَايَةِ إِسْمَاعِيلَ بْنِ إِبْرَاهِيمَ التَّمِيمِيِّ . وَإِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ التَّمِيمِيُّ يُضَعَّفُ فِي الْحَدِيثِ . أَبْوَابُ الْعِيدَيْنِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ .

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit

Kapitulli mbi bajramet

أَبْوَابُ الْعِيدَيْنِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

377. Mbi ecjen gjatë Bajramit

بَاب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ يَوْمِ الْجُمُعَةِ

531. Na ka treguar, Ismail b. Musa – atë e ka informuar Sheriku,³²⁰ duke transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Harithi – që Aliu ka thënë: “Është sunnet, që të shkosh në Bajram duke ecur dhe të hash diçka para se të dalësh (nga shtëpia).”³²¹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen. Sipas tij veprojnë shumica e dijetarëve. Ata i mbahen asaj, që në ditën e Bajramit është bukur që personi të shkojë duke ecur dhe që të mos shkoj mbi të shaluarën ose me ndonjë mjet transportues, përveç në raste urgjente.”

حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ مُوسَى الْفَرَارِيُّ، حَدَّثَنَا شَرِيكٌ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنِ الْحَارِثِ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ، قَالَ مَنْ السُّنَّةُ أَنْ تَخْرُجَ، إِلَى الْعِيدِ مَاشِيًا وَأَنْ تَأْكُلَ شَيْئًا قَبْلَ أَنْ تَخْرُجَ. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ. وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ يَسْتَجِبُونَ أَنْ يَخْرُجَ الرَّجُلُ إِلَى الْعِيدِ مَاشِيًا وَأَنْ يَأْكُلَ شَيْئًا قَبْلَ أَنْ يَخْرُجَ لِصَلَاةِ الْفُطْرِ. قَالَ أَبُو عِيسَى وَيُسْتَحَبُّ أَنْ لَا يَرْكَبَ إِلَّا مِنْ عُذْرِ.

378. Mbi namazin e Bajramit para hutbes

بَاب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ قَبْلَ الْخُطْبَةِ

532. Na ka treguar Muhammed b. Musena – atë e ka informuar Ebu Usama, ai ka transmetuar nga Ubejdullahu,³²² ai nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Ebu Bekri dhe Umeri, namazin e Bajramit e falnin para hutbes, e pastaj mbanin hutben.”³²³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, hadithe janë transmetuar edhe nga Xhabiri dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”³²⁴ Sipas tij kanë vepruar dijetarët nga gjenerata e as’habëve dhe të

³²⁰ Sherik b. Abdullah el-Kufi en-Nahi, është ravi i sinqertë, por shumë gabonte gjatë transmetimit. Që nga momenti, kur është bërë kadi i Kufës, të mbajturit në mend të tij është çrregulluar.

³²¹ Shumica e dijetarëve islam, konsiderojnë, që është mustehab të ecet në këmbë gjatë bajramit të ramazanit, para se të falet ai, është mustehab të qenit agjërueshëm.

³²² Ubejdullah b. Umer b. Hafs el-Umeri el-Medeni, është ravi i besueshëm dhe i sigurt.

³²³ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunen*, që Ibn Abbasi ka thënë: “Kam marr pjesë në bajram me të dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Ebu Bekrin, Umerin dhe Uthmanin – dhe të gjithë ata, namazin e kanë falur para hutbes.”

³²⁴ E shënojnë, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ebu Davudit.

tjerët. Ata thonë, që namazin e bajramit duhet falur para hutbes. Ndërsa, tregohet që Mervan b. Hakemi, së pari ka mbajtur hutben, pastaj ka falur namazin.”³²⁵

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى، حَدَّثَنَا أَبُو أُسَامَةَ، عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ، هُوَ ابْنُ عُمَرَ بْنِ حَفْصِ بْنِ عَاصِمِ بْنِ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَأَبُو بَكْرٍ وَغُمَرُ يُصَلُّونَ فِي الْعِيدَيْنِ قَبْلَ الْخُطْبَةِ ثُمَّ يَخْطُبُونَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ صَلَاةَ الْعِيدَيْنِ قَبْلَ الْخُطْبَةِ . وَيُقَالُ إِنَّ أَوَّلَ مَنْ خَطَبَ قَبْلَ الصَّلَاةِ مَرْوَانُ بْنُ الْحَكَمِ .

379. Mbi atë që namazet e Bajramit falen pa ezan dhe pa kiamet

باب مَا جَاءَ أَنَّ صَلَاةَ الْعِيدَيْنِ بِغَيْرِ أَذَانٍ وَلَا إِقَامَةٍ

533. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebul Ahvesi, duke transmetuar nga Semak b. Harbi – që Xhabir b. Semure, ka thënë: “Me të Dërguarin, shumë herë i kam falur namazet e Bajramit, pa ezan dhe pa kiamet.”³²⁶

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabir b. Abdullahu dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Xhabir b. Semures është hasen-sahih.”³²⁷ Sipas tij kanë vepruar gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Ata konsiderojnë, që për namazet e Bajrameve nuk duhet thirrur ezani as ikameti, as për çfarëdo lloj namazi tjetër vullnetar.”³²⁸

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ سِمَاكِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ جَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ، قَالَ صَلَّيْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ الْعِيدَيْنِ غَيْرَ مَرَّةٍ وَلَا مَرَّتَيْنِ بِغَيْرِ أَذَانٍ وَلَا إِقَامَةٍ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ جَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّهُ لَا يُؤَدَّنُ لِصَلَاةِ الْعِيدَيْنِ وَلَا لِشَيْءٍ مِنَ النَّوَافِلِ .

380. Mbi recitimin gjatë dy Bajrameve

باب مَا جَاءَ فِي الْقِرَاءَةِ فِي الْعِيدَيْنِ

534. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avvani,³²⁹ ai ka transmetuar nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri, ai nga babai i vet, ai nga Habib b. Salimi – që Nu’man b. Beshiri, ka thënë:

³²⁵ Shënon Muslimi, në Sahihun e vet, që Ebu Seidi, ka thënë: “I pari, që ka filluar me mbajtjen e hutbes, para namazit të bajramit, ka qenë Mervan b. Hakimi dhe ishte ngritur një muhadith dhe ia kishte tërhequr vërejtjen.” Disa thonë, që i pari, mbajtjen e hutbes para namazit të bajramit, e ka futur Uthman b. Affani. Ibn Mundhiri transmeton, me sened të besueshëm, që Hasan el-Basriu, ka thënë: “Uthmani e mbante hutben, ashtu siç ka qenë zakoni (pas namazit të bajramit) dhe duke e vërejtur që disa njerëz nuk arrijnë në namaz, e ka futur hutben para namazit.” Disa e marrin, që Muaviu e ka futur i pari ligjërimin para namazit. Shafiu, nga Abdullah b. Jezidi, ka shënuar hadithin e ngjashëm me atë të Ibn Abbasit, vetëm se ka shtuar: “Mandej, Muaviu e futi hutben para faljes së namazit.”

³²⁶ Abdurrahman el-Mubarekfuri, thotë: “Ky hadith është argument i qartë që për namazin e bajramit nuk është i nevojshëm as ezani, e as ikameti.”

³²⁷ Atë e kanë shënuar edhe nga Ahmedi, në *Musned*, Muslimi në *Sahih* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

³²⁸ Iraki thotë: “Këtë qëndrim e mbështesin të gjithë dijetarët.” Ndërsa Ibn Kudame thotë: “Nuk na është e njohur, që ndokush tjetër ka pas qëndrim tjetër, përveç që transmetohet, se Ibn Zubejri, për namazin e bajramit e ka thirrur ezanin dhe ikametin.” Ibnu Ebu Shejbe, shënon në *Musannef*, me sened të besueshëm, që Sejdi b. Musejjebi, ka thënë: “I pari Muaviu e ka sjellë thirrjen e ezanit në namazin e bajramit.”

³²⁹ Ebu Avane Veddah b. Abdullah el-Jeshkeri el-Vasiti, është ravi i besueshëm dhe i sigurt. Shquhet si dijetarë i hadithit.

“I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Bajramet dhe në xhumatë recitonte *Sebbih – hisme rabbikel a’la* dhe *Hel etake hadithul-gashije*. Ndonjëherë, ndodhte (Bajrami dhe Xhumaja) të bëheshin në të njëjtën ditë dhe ai i recitonte gjatë tyre.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Vakidi, Semura b. Xhundubi dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Nu’mān b. Beshirit është hasen-sahih.³³⁰ Ashtu transmetojnë, Sufjan eth-Thevriu dhe Mis’ari nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri, ngjashëm me hadithin e Ebu Avvanit. Transmetimet e Ibn Ujejes dallojnë. Është transmetuar nga ai – ai nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri, ai nga babai i vet, ai nga Habib b. Salimi, ai nga babai i vet – ai nga Nu’mān b. Beshiri. Nuk dihet, që Habib b. Salimi ka transmetuar hadithe nga babai i vet. Habib b. Salimi, ka qenë i mbrojturi i Nu’mān b. Beshirit dhe ai nga Nu’mān b. Beshiri ka transmetuar shumë hadithe. Ndërsa, është transmetuar edhe nga Ibn Ujeje – ai nga Ibrahim b. Muhammed b. Munteshiri – ngjashëm me transmetimet e këtyre. Është transmetuar, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në namazin e Bajramit ka recituar suren *Kaf* dhe *Ikterebetis sa’atu*. Kështu thotë Shafiu.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ مُحَمَّدٍ بْنِ الْمُثَنِّسِرِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ سَالِمٍ، عَنِ النُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَقْرَأُ فِي الْعِيدَيْنِ وَفِي الْجُمُعَةِ بِ (سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى) وَ (هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْعَاشِيَةِ) وَرَبَّمَا اجْتَمَعَا فِي يَوْمٍ وَاحِدٍ فَيَقْرَأُ بِهِمَا. قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي وَاقِدٍ وَسَمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ النُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَهَكَذَا رَوَى سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَمِسْعَرٌ عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ مُحَمَّدٍ بْنِ الْمُثَنِّسِرِ نَحْوَ حَدِيثِ أَبِي عَوَانَةَ. وَأَمَّا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ فَيُخْتَلَفُ عَلَيْهِ فِي الرِّوَايَةِ يُرَوَى عَنْهُ عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ مُحَمَّدٍ بْنِ الْمُثَنِّسِرِ عَنْ أَبِيهِ عَنْ حَبِيبِ بْنِ سَالِمٍ عَنْ أَبِيهِ عَنِ النُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ. وَلَا نَعْرِفُ لِحَبِيبِ بْنِ سَالِمٍ رِوَايَةً عَنْ أَبِيهِ. وَحَبِيبُ بْنُ سَالِمٍ هُوَ مَوْلَى النُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ وَرَوَى عَنِ النُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ أَحَادِيثَ. وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ عُيَيْنَةَ عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ مُحَمَّدٍ بْنِ الْمُثَنِّسِرِ نَحْوَ رِوَايَةِ هَؤُلَاءِ. وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يَقْرَأُ فِي صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ بِ (اِقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ) وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ.

535. Na ka treguar Is’hak b. Musa b. Ensari – atë e ka informuar Ma’n b. Isai, atë Maliku, duke transmetuar nga Damre b. Seid el-Mazini, ai nga Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe – që Umer b. Hattabi e ka pyetur Ebu Vakid el-Lejthen, se çfarë ka recituar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në Bajramin e Ramazanit dhe të Kurban Bajramit, ai ka thënë: “Recitonte suren *Kaf vel-Kur’anil mexhid* dhe *Vakterebetis-sa’atu venshekkal-kameru*.”³³¹

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنُ بْنُ عِيسَى، حَدَّثَنَا مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ، عَنْ صَمُرَةَ بْنِ سَعِيدٍ الْمَازِنِيِّ، عَنْ عُيَيْنَةَ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُثَيْبَةَ، أَنَّ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ، سَأَلَ أَبَا وَاقِدٍ اللَّيْثِيَّ مَا كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَقْرَأُ بِهِ فِي الْفِطْرِ وَالْأَضْحَى قَالَ كَانَ يَقْرَأُ بِ (ق وَالْقُرْآنِ الْمَجِيدِ) (اِقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَأَنْشَقَّ الْقَمَرُ). قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ.

536. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ibn Ujeje, duke transmetuar nga Damre b. Seidi me këtë sened – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai thotë: “Emri i Ebu Vahid el-Lejthit është Harith b. Avf.”

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ صَمُرَةَ بْنِ سَعِيدٍ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ. قَالَ أَبُو عِيسَى وَأَبُو وَاقِدٍ اللَّيْثِيُّ اسْمُهُ الْحَارِثُ بْنُ عَوْفٍ.

³³⁰ E ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

³³¹ Neveviu thotë: “Ndonjëherë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në bajrame recitonte *Kaf* dhe *Vakterebetis-sa’atu*, e ndonjëherë *Sebbih-isme* dhe *Gashije*.”

381. Mbi tekbiret në dy Bajramet

باب مَا جَاءَ فِي التَّكْبِيرِ فِي الْعِيدَيْنِ

537. Na kanë treguar Muslim b. Amri dhe Ebu Amër el-Hadha el-Medini – ata i ka informuar Abdullah b. Nafiu, ai ka transmetuar nga Kethir b. Abdullahu,³³² ai nga babai i vet,³³³ ndërsa ai nga gjyshi i vet,³³⁴ - që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në ditën e Bajramit i shqiptonte shtatë tekbire para recitimit në rekatin e parë dhe pesë tekbire para recitimit në rekatin e dytë.”³³⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Ibn Umeri dhe Abdullah b. Amëri. Hadithi i gjyshit të Kethirit është hasen.³³⁶ Kjo është më së bukur, që është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi këtë temë. Ndërsa, emri i tij është Amër b. Avf el-Muzeni. Sipas kësaj, kanë vepruar disa dijetarë nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerë. Kështu është transmetuar, që Ebu Hurejre në Medine është falur ngjashëm me këtë namaz. Kështu është qëndrimi edhe i medinasve, ndërsa ashtu thonë edhe Malik b. Enesi, Shafiu, Ahmed dhe Is’haku.”

Është transmetuar, që Ibn Mes’udi mbi tekbiret e dy Bajrameve ka thënë: “Nëntë tekbire në rekatin e parë dhe pesë tekbire para recitimit në rekatin e dytë. Ka për të filluar me recitimin, pastaj ka për t’i shqiptuar katër tekbire me atë nga rukuja.” Ngjashëm me këtë, është transmetuar nga shumë as’habë. Ky edhe është qëndrimi edhe i dijetarëve të Kufës, ndërsa, kështu mendon edhe Sufjan eth-Thevriu.

حَدَّثَنَا مُسْلِمُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي النَّبِيَّةِ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ نَافِعٍ الصَّانِعِيُّ، عَنْ كَثِيرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَبَّرَ فِي الْعِيدَيْنِ فِي الْأُولَى سَبْعًا قَبْلَ الْقِرَاءَةِ وَفِي الْآخِرَةِ خَمْسًا قَبْلَ الْقِرَاءَةِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ جَدِّ كَثِيرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ وَهُوَ أَحْسَنُ شَيْءٍ رُوِيَ فِي هَذَا الْبَابِ عَنِ النَّبِيِّ عَلَيْهِ السَّلَامُ وَاسْمُهُ عَمْرُو بْنُ عَوْفٍ الْمُرْنِيُّ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ . وَهَكَذَا رُوِيَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ أَنَّهُ صَلَّى بِالْمَدِينَةِ نَحْوَ هَذِهِ الصَّلَاةِ وَهُوَ قَوْلُ أَهْلِ الْمَدِينَةِ . وَبِهِ يَقُولُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَرُوِيَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ أَنَّهُ قَالَ فِي التَّكْبِيرِ فِي الْعِيدَيْنِ تِسْعَ تَكْبِيرَاتٍ فِي الرُّكْعَةِ الْأُولَى خَمْسًا قَبْلَ الْقِرَاءَةِ وَفِي الرُّكْعَةِ الثَّانِيَةِ يَبْدَأُ بِالْقِرَاءَةِ ثُمَّ يَكْبُرُ أَرْبَعًا مَعَ تَكْبِيرَةِ الرُّكُوعِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ غَيْرِ وَاحِدٍ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ هَذَا وَهُوَ قَوْلُ أَهْلِ الْكُوفَةِ وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ .

³³² Kethir b. Abdullah b. Amr b. As el-Muzeni el-Medeni, sipas mendimit të Ibn Haxherit, është ravi i dobët. Disa e përshkruajnë si gënjeshtar.

³³³ Babai i tij, quhej Abdullah b. Amr b. As, i cili, sipas Ibn Haxherit është ravi i pranueshëm. Ibn Hibbani, atë e konsideron të besueshëm.

³³⁴ Gjyshi i tij quhej Amr b. As el-Muzeni Ebu Abdullah. Ai ka qenë as’hab i shquar.

³³⁵ Hanbeli, Maliku dhe Shafiu, kanë vërtetuar, që është sunnet te namazet e bajramit, shqiptimi i dymbëdhjetë tekbireve dhe atë në rekatin e parë, para bërjes së shtatë tekbireve, duke mos e llogaritur atë fillestarin dhe pesë në rekatin e dytë, gjithashtu para këndimit, duke mos e llogaritur tekbirin të cilin e ka shqiptuar gjatë shkuarjes nga kijami në ruku. Ruffjan eth-Thevriu dhe Ebu Hanife, konsiderojnë, se është sunnet shqiptimi i gjithsejtë tetë tekbireve gjatë namazit të bajramit: katër në rekatin e parë - para këndimit, duke e llogaritur atë fillestar gjatë katër në rekatin e dytë - pas përfundimit të këndimit dhe atë, duke e llogaritur edhe atë që shqiptohet gjatë shkuarjes në ruku. Ata, mendimin e vet e bazojnë në disa esere, ja njëra prej tyre. Taberani në Mu’xhemil-Kebir, ka shënuar që Kirdevsi ka thënë: “Pas jacisë Velidi e ka dërguar një njeri tek Abdullah b. Mes’udi, Hudhejfe, Ebu Musa el-Esh’ari dhe Ebu Mes’udi për t’i pyetur, se si falet namazi i bajramit. Ata kanë thënë: “Pyete Abdurrahmanin.” Ai ka shkruar dhe e ka pyetur, ndërsa ai ka thënë ‘Kur lidhesh për namaz, duhet shqiptuar katër tekbire, mandej duhet shqiptuar Fatihanë dhe një sure.’” Në rekatin e dytë duhet shqiptuar katër tekbire, pasi që këndohet Fatihaja dhe një sure.”

³³⁶ Shumica pajtohen me vlerësimin e këtij hadithi, nga Tirmidhiu. Ata konsiderojnë, se ky hadith është i dobët, sepse në senedin e tij gjendet raviu Kethir b. Abdullah b. Amër b. Avf, i cili është i dobët. Ndërkaq, Neveviu thekson, se Tirmidhiu këtë hadith e ka vlerësuar të mirë, sepse ka ardhur në disa transmetime të cilat, edhe pse janë të dobëta, e ngritin atë mbi shkallën haseni-li-gajrihi.

382. Nuk ka (kurrfarë) namazi as para as pas namazit të Bajramit

بَاب مَا جَاءَ لَا صَلَاةَ قَبْلَ الْعِيدِ وَلَا بَعْدَهَا

538. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë e ka informuar Shu'be, atë Adij b. Thabiti, atë Seid b. Xhubejri, atë Ibn Abbasi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në ditën e Bajramit të Ramazanit i ka falur dy rekate (të namazit të Bajramit). Ibn Abbasi, thotë: “Ai, as para as pas tyre nuk falte asgjë tjetër.”³³⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Amri dhe Ebu Seidi. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.³³⁸ Sipas tij veprojnë disa dijetarë nga gjenerata e as'habëve dhe të tjerë. Në pajtim me atë është edhe qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe i Is'hakut. Disa dijetar nga gjenerata e as'habëve dhe të tjerët, konsiderojnë që edhe para Bajramit edhe pas Bajramit mund të falen edhe namaze të tjera. Ndërkaq, mendimi i parë është më i drejtë.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، قَالَ أَنْبَأَنَا شُعْبَةُ، عَنْ عَدِيِّ بْنِ ثَابِتٍ، قَالَ سَمِعْتُ سَعِيدَ بْنَ جُبَيْرٍ، يُحَدِّثُ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ خَرَجَ يَوْمَ الْفِطْرِ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ ثُمَّ لَمْ يُصَلِّ قَبْلَهَا وَلَا بَعْدَهَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَأَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَغَيْرِهِمْ وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَدْ رَأَى طَائِفَةٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ الصَّلَاةَ بَعْدَ صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ وَقَبْلَهَا مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ .

539. Na ka treguar Husejn b. Hurejth Ebu Ammari – atë e ka informuar Vekiu, ai ka transmetuar nga Eban b. Abdullah el-Bexheli, ai nga Ebu Bekër b. Hafsi, ndërsa, e ai është i biri i Umer b. Sa'd b. Ebu Vekkasit – që Ibn Umeri ka dalur në ditën e Bajramit, por as para as pas namazit të Bajramit nuk fali asgjë, duke theksuar, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) bënte ashtu. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا أَبُو عَمَّارٍ الْحُسَيْنِيُّ بْنُ حَرْبٍ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ أَبَانَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْبَجَلِيِّ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ بْنِ حَفْصٍ، وَهُوَ ابْنُ عُمَرَ بْنِ سَعْدٍ بْنِ أَبِي وَقَّاصٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّهُ خَرَجَ فِي يَوْمِ عِيدٍ فَلَمْ يُصَلِّ قَبْلَهَا وَلَا بَعْدَهَا وَذَكَرَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ فَعَلَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

383. Mbi daljen e grave në namazin e Bajramit

540. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, atë Mensuri, ndërsa ai është i biri i Zadhanit, ai ka transmetuar nga Ibn Sirini – që Ummu Atijj, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në ditën e Bajramit i nxirrte vajzat, vajzat e vogla, madje edhe ato vajza, që kurrë nuk dalin nga shtëpitë dhe gratë që ishin në ciklin menstrual. Gratë në ciklin menstrual nuk hynin në Musalë, ndërsa merrnin pjesë në lutjen e muslimanëve. Njëra nga ato ka thënë: ‘I

³³⁷ Ibn Hemmami, konsideron, që negacioni në hadithin e cekur, ka të bëjë me faljen në xhami ose në musallë, e jo në vende të tjera. Pra, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), as në xhami e as në musallë, as para e as pas Bajramit, nuk ka falur kurrfarë nafile. Nga disa transmetime mund të shihet, se i ka falur në shtëpi. Ibn Maxhe shënon nga Ebu Seid el-Hudriu, këtë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në shtëpi i falte dy rekate (nafile).” Ibn Haxheri konsideron, se senedi i këtij hadithi është i mirë, derisa Hakimi këtë transmetim e konsideron të besueshëm.

³³⁸ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

Dërguari i Allahut, nëse njëra nga ne nuk ka për të pasur mbulesë?’ Ai në atë tha: ‘Le t’ia huazojë motra e vet njërën nga mbulesat e saja.’”³³⁹

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، أَخْبَرَنَا مَنْصُورٌ، وَهُوَ ابْنُ زَادَانَ عَنْ ابْنِ سِيرِينَ، عَنْ أُمِّ عَطِيَّةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يُخْرِجُ الْأَبْكَارَ وَالْعَوَاتِقَ وَذَوَاتِ الْخُدُورِ وَالْخِيَصَ فِي الْعِيدَيْنِ فَأَمَّا الْخِيَصُ فَيَعْتَزِلُنَ الْمُصَلَّى وَيَشْهَدْنَ دَعْوَةَ الْمُسْلِمِينَ قَالَتْ إِحْدَاهُنَّ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنْ لَمْ يَكُنْ لَهَا جَلَبَابٌ قَالَ " فَلْتَعْرِضْهَا أَخْتُهَا مِنْ جَلَابِيبِهَا " .

541. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, ai ka transmetuar nga Hisham b. Hassani, ai nga Hafsa, e bija e Sirinit, ndërsa ajo nga Ummu Atijja – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi dhe Xhabiri. Hadithi i Ummu Atijjes është hasen-sahih.³⁴⁰ Disa dijetarë, duke iu përmbajtur këtij hadithi ua lejojnë grave që në ditën e Bajramit të vinë në xhami ose në Musalë, derisa disa të tjerë atë e konsiderojnë të papëlqyer.”

Transmetohet, që Ibn Mubareku ka thënë: “Unë e urrej, që gratë në kohën e sotme në ditën e Bajramit të shkojnë në xhami. Në rast se edhe përkundër kësaj gruaje insiston të shkoj në xhami, le ta lejon atë bashkëshorti i vet, por me rroba të vjetra. Në rast se ajo e refuzon atë, bashkëshorti ka të drejtë që t’ia ndalojë shkuarjen.”

Transmetohet, që Aishja ka thënë: “Kur ka parë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se çfarë novacione kanë futur gratë, ai ua ndalonte atyre shkuarjen në xhami, sikurse që u është ndaluar grave izraelite.”³⁴¹

Transmetohet, që Sufjan eth-Thevriu, e ka urryer, që gratë në kohën e tij të shkonin në xhami për namazin e Bajramit.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، عَنْ هِشَامِ بْنِ حَسَّانَ، عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ، عَنْ أُمِّ عَطِيَّةَ، بِخَوِّهِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، وَجَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيَسَى حَدِيثُ أُمِّ عَطِيَّةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا الْحَدِيثِ وَرَخَّصَ لِلنِّسَاءِ فِي الْخُرُوجِ إِلَى الْعِيدَيْنِ وَكَرِهَهُ بَعْضُهُمْ وَرَوَى عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْمُبَارَكِ أَنَّهُ قَالَ أَكْرَهُ الْيَوْمَ الْخُرُوجَ لِلنِّسَاءِ فِي الْعِيدَيْنِ فَإِنْ أَبَتْ الْمَرْأَةُ إِلَّا أَنْ تَخْرُجَ فَلْيَأْذَنْ لَهَا زَوْجُهَا أَنْ تَخْرُجَ فِي أَطْمَارِهَا الْخُلْقَانِ وَلَا تَتَزَيَّنَ فَإِنْ أَبَتْ أَنْ تَخْرُجَ كَذَلِكَ فَلِلزَّوْجِ أَنْ يَمْنَعَهَا عَنِ الْخُرُوجِ . وَيُرَوَّى عَنْ عَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا قَالَتْ لَوْ رَأَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ مَا أَحْدَثَ النِّسَاءُ لَمَنْعَهُنَّ الْمَسْجِدَ كَمَا مَنَعَتْ نِسَاءَ بَنِي إِسْرَائِيلَ . وَيُرَوَّى عَنْ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ أَنَّهُ كَرِهَ الْيَوْمَ الْخُرُوجَ لِلنِّسَاءِ إِلَى الْعِيدِ .

³³⁹ Ky hadith, është argument i qartë për gratë, pa e pasur parasysh moshën, që e kanë të lejuar, që në Ditën e Bajramit të shkojnë në musallë ose në xhami. Ebu Hamidi dhe Xhurxhani, konsiderojnë, që ajo është mustehab Ebu Hanife dhe Ibn Hemmami, konsiderojnë, se gratë e vjetra e kanë të lejuar vetë, derisa të rejtat dhe vajzat shkuarjen në xhami për Bajram e kanë të ndaluar – mekruh që të mos bëhen shkaktare të skenave të padëshiruara dhe të sprovave. Ahme b. Hanbeli, konsideron, se, të gjithë e kanë të lejuar, pa pasur parasysh moshën madhore dhe që atë e kanë mustehab. Rufjan eth-Thevriu, Ibn Mubareku, Maliku dhe Ebu Jusufi, që për të gjitha gratë, pa dallim moshe, është mekruh, që për Bajram të shkojnë në xhami apo në musallë – çka bie ndesh me shumë transmetime të besueshme. Kadi Ijadi, ka transmetuar, që Ebu Bekri, Aliu dhe Umeri konsideronin, që gratë e kanë të drejtë, nëse dëshirojnë, në Bajram të shkojnë në xhami.

³⁴⁰ Është shënuar, në *El-Kutubus-sitte*.

³⁴¹ E shënon Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*. Disa në bazë të këtyre fjalëve të Aishes, kanë vërtetuar, që gratë, në përgjithësi edhe gjatë bajramit, edhe pas bajramit, e kanë të ndaluar të shkojnë në xhami.

384. Mbi shkuarjen e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në Bajram, nëpër njëren rrugë dhe kthimin e tij nëpër një rrugë tjetër

باب مَا جَاءَ فِي خُرُوجِ النَّبِيِّ ﷺ إِلَى الْعِيدِ فِي طَرِيقٍ وَرُجُوعِهِ مِنْ طَرِيقٍ آخَرَ

542. Na kanë treguar Abdul A'la b. Vasil b. Abdul A'la el-Kufi dhe Ebu Zur'a – ata i ka informuar Muhammed b. Salt, ai ka transmetuar nga Fulejh b. Sulejmani, ai nga Seid b. Harithi – që Ebu Hurejre, ka thënë: “Në rast se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në Bajram shkonte nëpër njëren rrugë, kthehej nëpër një rrugë tjetër.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Umeri dhe Ebu Rafiu. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-garib.³⁴² Këtë hadith Ebu Tumejli dhe Junus b. Muhammedi, e kanë transmetuar nga Fulejh b. Sulejmani, ai nga Seid b. Harithi, e ai nga Xhabir b. Abdullahu. Disa dijetarë, konsiderojnë që për imamin është mustehab (e pëlqyer) që nëse shkon nëpër njëren, të kthehet nëpër rrugën tjetër, duke vepruar sipas këtij hadithi. Ky është qëndrimi i Shafiut.³⁴³ Hadithi i Xhabirit duket më i besueshëm.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ الْأَعْلَى بْنُ وَاصِلٍ بْنُ عَبْدِ الْأَعْلَى الْكُوفِيُّ، وَأَبُو زُرْعَةَ قَالَ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الصَّلْتِ، عَنْ فُلَيْحِ بْنِ سُلَيْمَانَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْحَارِثِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا خَرَجَ يَوْمَ الْعِيدِ فِي طَرِيقٍ رَجَعَ فِي غَيْرِهِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ وَأَبِي رَافِعٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَرَوَى أَبُو ثُمَيْلَةَ وَيُونُسُ بْنُ مُحَمَّدٍ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ فُلَيْحِ بْنِ سُلَيْمَانَ عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْحَارِثِ عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ . قَالَ وَقَدْ اسْتَحَبَّ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ لِلْإِمَامِ إِذَا خَرَجَ فِي طَرِيقٍ أَنْ يَرْجِعَ فِي غَيْرِهِ اتِّبَاعًا لِهَذَا الْحَدِيثِ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ . وَحَدِيثُ جَابِرٍ كَأَنَّهُ أَصَحُّ .

385. Mbi ngrënien para shkuarjes në Bajramin e Ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي الْأَكْلِ يَوْمَ الْفِطْرِ قَبْلَ الْخُرُوجِ

543. Na ka treguar Hasan b. Sabbah el-Bezzari – atë e ka informuar Abdussamed b. Abdulvarithi, ai ka transmetuar nga Thevab b. Utbe,³⁴⁴ ai nga Abdullah b. Burejde – që babai i Abdullah b. Burejdes, ka thënë: “I Dërguari i Allahut nuk shkonte në ditën e Bajramit të Ramazanit, derisa nuk hante diç. Dhe në ditën e Bajramit të Kurbanit, nuk hante asgjë, derisa nuk e falte atë.”³⁴⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu dhe Enesi. Hadithi i Burejde b. Husajb el-Eslemiut, është garib.³⁴⁶ Muhammedi (Buhariu), thotë: ‘Nuk më është e njohur që Thevab b. Utbe e ka transmetuar ndonjë hadith tjetër përveç këtij.’ Disa dijetarë, konsiderojnë, që

³⁴² E kanë shënuar Ahmedi në *Musned*, Daremiu në *Sunen*, Ibn Hibbani në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*.

³⁴³ Ebu Hanife dhe shumica e dijetarëve, konsiderojnë, që është mustehab edhe për imamin edhe për xhematin, që në Bajram të shkojnë me njëren rrugë, e të kthehen me rrugë tjetër. Se në çfarë fshihet urtësia e shkuarjes së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me njëren dhe kthimin e tij me rrugë tjetër, është diskutabile në mesin e dijetarëve. Kadi Abdulvehab el-Maliki, i cekë rreth njëzet mendime të ndryshme, nga të cilat këtu kemi për t'i përmendur vetëm disa: - që dy rrugët, të dëshmojnë për të në Ditën e Gjykimit; - që të dëshmonin njerëzit dhe xhinët, të cilët banonin pranë atyre rrugëve; - që rrugës t'i vizitonte të afërmit e gjallë dhe të vdekur si dhe miqtë; - që banorët, të cilët jetonin pranë atyre rrugëve t'ua uronte Bajramin dhe të kërkonte bereqet nga Allahu i Lartësuar për ata.

³⁴⁴ Sevak b. Utbe është ravi makbul. I takonte gjeneratës së gjashtë. Nga ai, në *El-Kutubus-sitte*, përveç këtij nuk është shënuar asnjë hadith tjetër.

³⁴⁵ Buhariu shënon, që Enesi ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk shkonte në bajram të ramazanit, derisa nuk i hante disa hurme.”

³⁴⁶ E kanë shënuar Ahmed b. Hanbeli në *Musned* dhe Ibn Hibbani në *Sahih*. Shevkani, në veprën *Nejlul-Evtar*, thotë: “Gjithashtu, atë e kanë shënuar edhe Ibn Hibbani, El-Darekutni, Hakimi dhe Bejhekiu. El-Darekutni atë e vlerëson si sahih.

është mustehab që të mos dilet në ditën e Bajramit të Ramazanit, pa ngrënë diçka, sikur që është mustehab, që ato të jenë hurme. Ndërsa, në ditën e Bajramit të Kurbanit, është mustehab të mos hahet asgjë derisa nuk kthehet.”

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ الصَّبَّاحِ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الصَّمَدِ بْنُ عَبْدِ الْوَارِثِ، عَنْ ثَوَابِ بْنِ عُثْبَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بُرَيْدَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ لَا يَخْرُجُ يَوْمَ الْفِطْرِ حَتَّى يَطْعَمَ وَلَا يَطْعَمَ يَوْمَ الْأَضْحَى حَتَّى يُصَلِّيَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَأَنْسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ بُرَيْدَةَ بْنِ حُصَيْنٍ الْأَسْلَمِيِّ حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَقَالَ مُحَمَّدٌ لَا أَعْرِفُ لثَوَابِ بْنِ عُثْبَةَ غَيْرَ هَذَا الْحَدِيثِ . وَقَدْ اسْتَحَبَّ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ لَا يَخْرُجَ يَوْمَ الْفِطْرِ حَتَّى يَطْعَمَ شَيْئًا وَيُسْتَحَبُّ لَهُ أَنْ يُفْطِرَ عَلَى ثَمَرٍ وَلَا يَطْعَمَ يَوْمَ الْأَضْحَى حَتَّى يَرْجِعَ .

544. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hushejmi, duke transmetuar nga Muhammed b. Is’haku, ai nga Hafs b. Ubejdullah b. Enesi – që Enes b. Maliku, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në ditën e Bajramit të Ramazanit në mëngjes, para se të dilte në Musalë, i hante disa hurme.”³⁴⁷ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih-garib.”³⁴⁸

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِسْحَاقَ، عَنْ حَفْصِ بْنِ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ أَنْسٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُفْطِرُ عَلَى ثَمَرَاتٍ يَوْمَ الْفِطْرِ قَبْلَ أَنْ يَخْرُجَ إِلَى الْمُصَلَّى . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ صَحِيحٌ .

³⁴⁷ Në transmetimin, të cilin e kanë shënuar Ibn Hibbani dhe Hakimi, qëndron: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk dilte në namazin e bajramit të ramazanit, derisa nuk i hante disa hurme, tri, pesë, shatë, ose më pak ose më shumë se ato.”

³⁴⁸ E ka shënuar Buhariu në *Sahih*, nëpërmjet Hushejmit, nga Ubejdullah b. Ebu Bekri b. Enesi, e ai nga Enes b. Maliku.

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit

Kapitulli mbi udhëtimin

أَبْوَابُ السَّفَرِ

386. Shkurtimi i namazit gjatë udhëtimit

بَابُ مَا جَاءَ فِي التَّقْصِيرِ فِي السَّفَرِ

545. Na ka treguar Abdullah b. Abdulhakem el-Verrak el-Bagdadi³⁴⁹ - atë e ka informuar Jahja b. Sulejm, duke transmetuar nga Ubejdullahu,³⁵⁰ ai nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “Kam udhëtuar me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Ebu Bekrin, Umerin dhe Uthmanin, ata drekën dhe ikindinë e falnin nga dy rekate (fard). Ata, as para as pas, nuk falnin asgjë tjetër.”³⁵¹ Abdullahu, ka thënë: “Sikur të mund të zgjedhja se a t’i fali fardet në tërësi ose, ti fali sunnetet, para ose pas tyre, më tepër do të dëshiroja që t’i falja fardet në tërësi.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Umeri, Aliu, Ibn Abbasi, Enesi, Imran b. Husejni dhe Aishja. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-garib dhe, nuk na është i njohur përveç nëpërmjet Jahja b. Sulejmanit ngjashëm me këtë.”

Muhamed b. Ismaili, thotë: “Ky hadith është transmetuar nga Ubejdullah b. Umeri, ai nga një njeri, nga fisi i Surakës, ndërsa ai nga Ibn Umeri.

Ebu Isai, thotë: “Është transmetuar nga Atijje el-Avfui, nëpërmjet Ibn Umerit, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë udhëtimit (sunnetet) i ka falur edhe para edhe pas (fardit). Ndërsa, është transmetuar me rrugë të besueshme, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë udhëtimit i ka shkurtuar (namazet). Të njëjtën e kanë bërë Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani në fillim të hilafetit të vet. Sipas kësaj kanë vepruar shumica e dijetarëve nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Ndërsa, është transmetuar që Aishja, gjatë udhëtimit, e ka falur namazin e plotë. Ndërkaq, duhet trajtuar sipas asaj që është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe as’habët. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut, meqë edhe Shafiu thotë që shkurtimi

³⁴⁹ Abdulvehab b. Abdulhakim el-Verrak el-Bagdadi, është nxënësi i Ahmed b. Hanbelit. Ai hadithet i ka transmetuar nga Jahja b. Seid el-Emeviu dhe Muadh b. Muadhi, derisa nga ai hadithe kanë marrë Ebu Davudi et-Tajalisi, Tirmidhiu dhe Nesaiu. Nesaiu dhe El-Darekutni e konsiderojnë si ravi të besueshëm. Ka vdekur në vitin 251 sipas hixhretit.

³⁵⁰ Ubejdullahu është i biri i Umer el-Umerit. Është ravi i sigurt.

³⁵¹ Në transmetimin e Buhariut dhe Muslimit, të këtij hadithi, qëndron, se Ibn Umeri, ka thënë: “Kam udhëtuar me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai gjatë udhëtimit nuk ka falur më shumë se dy rekate. Gjithashtu, as Ebu bekri, Umer dhe as Uthmani.”

(i namazit) gjatë udhëtimit është lehtësim – po nëse ndokush do ta falte edhe namazin e plotë, ai do t’i vlente.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ بْنُ عَبْدِ الْحَكَمِ الْوَرَّاقُ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سُلَيْمٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ سَافَرْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ وَأَبِي بَكْرٍ وَعُمَرُ وَعُثْمَانُ فَكَانُوا يُصَلُّونَ الظُّهْرَ وَالْعَصْرَ رَكْعَتَيْنِ رَكْعَتَيْنِ لَا يُصَلُّونَ قَبْلَهَا وَلَا بَعْدَهَا . وَقَالَ عَبْدُ اللَّهِ لَوْ كُنْتُ مُصَلِّيًا قَبْلَهَا أَوْ بَعْدَهَا لَأَتَمَمْتُهَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ وَعَلِيٍّ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَنْسٍ وَعِمْرَانَ بْنِ حُصَيْنٍ وَعَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ يَحْيَى بْنِ سُلَيْمٍ مِثْلَ هَذَا . قَالَ مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ عَنْ رَجُلٍ مِنْ آلِ سُرَاقَةَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رَوَى عَنْ عَطِيَّةَ الْعُوفِيِّ عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَتَطَوَّعُ فِي السَّفَرِ قَبْلَ الصَّلَاةِ وَبَعْدَهَا . وَقَدْ صَحَّ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يَقْصُرُ فِي السَّفَرِ وَأَبُو بَكْرٍ وَعُمَرُ وَعُثْمَانُ صَدْرًا مِنْ خِلَافَتِهِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ . وَقَدْ رَوَى عَنْ عَائِشَةَ أَنَّهَا كَانَتْ تُتِمُّ الصَّلَاةَ فِي السَّفَرِ . وَالْعَمَلُ عَلَى مَا رَوَى عَنْ النَّبِيِّ ﷺ وَأَصْحَابِهِ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ إِلَّا أَنَّ الشَّافِعِيَّ يَقُولُ التَّقْصِيرُ رُخْصَةٌ لَهُ فِي السَّفَرِ فَإِنْ أَتَمَّ الصَّلَاةَ أَجْزَأَ عَنْهُ .

546. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, atë Ali b. Zejd b. Xhud’ani – që Ebu Nadri, ka thënë: “Është pyetur Imran b. Husajni mbi namazin e udhëtarit, ai ka thënë: “Kam udhëtuar me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe (fardet) i falte nga dy rekate. Por, kam udhëtuar në haxh edhe me Ebu Bekrin, e edhe ai (fardet) i falte nga dy rekate. Edhe me Umerin, edhe ai (fardet) i falte nga dy rekate. Edhe me Uthmanin, deri në vitin e gjashtë ose të tetë të hilafetit të tij, edhe ai (fardet) i falte nga dy rekate.”³⁵² Ebu Is’haku thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³⁵³

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، أَخْبَرَنَا عَلِيُّ بْنُ زَيْدٍ بْنُ جُدْعَانَ الْفَرَسِيُّ، عَنْ أَبِي نَضْرَةَ، قَالَ سَأَلَ عِمْرَانُ بْنُ حُصَيْنٍ عَنْ صَلَاةِ الْمُسَافِرِ، فَقَالَ حَجَّجْتُ مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ وَحَجَّجْتُ مَعَ أَبِي بَكْرٍ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ وَمَعَ عُمَرَ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ وَمَعَ عُثْمَانَ سِتًّا سِتِّينَ مِنْ خِلَافَتِهِ أَوْ ثَمَانِي سِتِّينَ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

547. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Muhammed b. El-Munkediri dhe Ibrahim b. Mejseri – që Enes b. Maliku, ka thënë: “Ne, me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), fardin e drekës në Medine i kemi falur katër, ndërsa fardin e ikindisë në Dhul-Hulejfe dy rekate.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është sahih.”³⁵⁴

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ، وَإِبْرَاهِيمَ بْنِ مَيْسَرَةَ، سَمِعَا أَنَسَ بْنَ مَالِكٍ، قَالَ صَلَّيْنَا مَعَ النَّبِيِّ ﷺ الظُّهْرَ بِالْمَدِينَةِ أَرْبَعًا وَبِذِي الْحُلَيْفَةِ الْعَصْرَ رَكْعَتَيْنِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ .

548. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hushejmi, ai ka transmetuar nga Mensur b. Zadhani, ai nga Ibn Sirini – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nga Medina shkonte në drejtim të Mekës, nuk kishte frikë nga askush, përveç nga Sunduesi i Botëve dhe namazet (fard) i falte nga dy rekate.”³⁵⁵ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është sahih.”³⁵⁶

³⁵² Neveviu thotë: “Uthmani, pasi që është bërë halife, gjashtë vite gjatë udhëtimit të tij ka falur namaze të shkurtra. Më pastaj, në Mine ka falur namazin e plotë.” El-Mubarekfuri tregon që shumë dijetarë, kanë deklaruar, që atë Uthmani e ka bërë vetëm një herë në Mine.

³⁵³ Në senedin e këtij hadithi, gjendet Alija b. Zejd b. Xhed’ani, i cili, sipas vlerësimit të Ibn Haxherit, është ravi i dobët. Tirmidhiu, atë e ka konsideruar ravi të mirë. Përveç kësaj, ky hadith ka ardhur në shumë transmetime të cilat e fuqizojnë atë.

³⁵⁴ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

³⁵⁵ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë udhëtimit, përherë i shkurtonte namazet katër trekatëshe. Ibn Kajimi, thotë, se nuk është vërtetuar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) gjatë udhëtimit ndonjëherë e ka falur namazin e plotë. Prandaj, disa dijetarë, siç janë as’habët Umeri, Aliu, Ibn Umeri, Ibn Abbasi, tabi’inët Umer b. Abdulazizi, Katade dhe Hasan el-Basri, mandej imami Ebu Hanife, konsiderojnë, që shkurtimi i namazit gjatë udhëtimit është sunnet i vërtetuar, derisa Ahmed dhe Shafi, konsiderojnë, që gjatë udhëtimit është e lejuar falja edhe e namazit të plotë edhe të shkurtuar, por më mirë është shkurtimi i tij.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، عَنْ مَنُصُورِ بْنِ زَادَانَ، عَنْ ابْنِ سِيرِينَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ خَرَجَ مِنَ الْمَدِينَةِ إِلَى مَكَّةَ لَا يَخَافُ إِلَّا اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ.

387. Mbi kohëzgjatjen e shkurtimit të namazit

باب مَا جَاءَ فِي كَمْ تُقْصَرُ الصَّلَاةُ

549. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Hushejmi, atë Jahja b. Ebu Is'hak el-Hadremi – që Enes b. Maliku, ka thënë: “U nisëm me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) nga Medina në drejtim të Mekës dhe namazet (katër rekateshe) i falte nga dy rekate.” Thotë, Jahjai: “I thash Enesit: ‘Sa kohë ka qëndruar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në Meke?’ ‘Dhjetë ditë.’ – u përgjigj ai.”³⁵⁷

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi dhe Xhabiri. Hadithi i Enesit është hasen-sahih.”³⁵⁸

Ibn Abbasi transmeton, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në disa udhëtime qëndronte nëntëmbëdhjetë ditë dhe i falte nga dy rekate. Ai thotë: “Ne, nëse do të kishim qëndruar nëntëmbëdhjetë ditë, ne i shkurtonim namazet. Ndërkaq, nëse do të kishim mbetur më tepër se aq, i falnim namazet e plotë.”

Transmetohet, që Aliu ka thënë: “Kush qëndron dhjetë ditë, duhet t’i falë namazet e plotë.”

Transmetohet që Ibn Umeri ka thënë: “Kush qëndron pesëmbëdhjetë ditë, ai duhet ta falë namazin e plotë. Ndërsa, është transmetuar nga ai edhe dymbëdhjetë ditë.”

Transmetohet, që Seid b. Musejjebi, ka thënë: “Nëse ka për të qëndruar katër ditë, ka për t’i falur katër rekate.” Atë, nga ai e ka transmetuar Katade dhe Ata el-Horasani. Nga ai transmeton edhe Davud b. Ebu Hindi, të kundërtën e kësaj. Dijetarët, pastaj janë ndarë mbi atë.

Sufjan eth-Thevriu dhe dijetarët Kufjanë, e kanë caktuar (deri) pesëmbëdhjetë ditë dhe kanë thënë: “Kush synon të mbetet pesëmbëdhjetë ditë, ai ka për ta falur namazin e plotë.”

Evzaiu, thotë: “Kush synon të mbetet dymbëdhjetë ditë, ai ka për ta falur namazin e plotë.”

Maliku, Shafiu dhe Ahmedi thonë: “Nëse e ka ndërmend të mbetet katër ditë, ka për të falur namazin e plotë.”

³⁵⁶ Ibn Haxher el-Askalani, në veprën *Fet'hul-Bari*, tregon, që Nesaiu këtë hadith e ka vlerësuar sahih.

³⁵⁷ Se sa ditë udhëtari ka për ta shkurtuar namazin, në rast se në një vend e ka për qëllim të qëndrojë një kohë të gjatë – është diskutabile në mesin e dijetarëve islam. Shafiu, Ahmedi dhe Maliku, konsiderojnë, që udhëtari, nëse në një vend mendon për të qëndruar tre ditë, ka për ta shkurtuar namazin. Ndërkaq, nëse mendon të qëndrojë më tepër se tre ditë, duke mos e larguar ditën e shkuarjes, duhet ta falë namazin e plotë. Ebu Hanife konsideron, se nëse udhëtari e ka për qëllim të qëndrojë në një vend më pak se pesëmbëdhjetë ditë, ka për t’i falur namazet e shkurtuara. Në rast se qëndron, më tepër se pesëmbëdhjetë ditë, ka për t’i falur namazet e plotë. Ali b. Ebu Talibi konsideron se, udhëtari ka për t’i shkurtuar namazet, nëse në ndonjë vend, e ka për qëllim të qëndrojë më pak se dhjetë ditë. Në rast se mendon të qëndroj më tepër, ka për t’i falur namazet e plotë. Ibn Abbasi dhe Is'hak b. Rahivejh, konsiderojnë, që udhëtari ka për t’i shkurtuar namazet, në rast se në ndonjë vend, e ka për qëllim të qëndrojë më pak se nëntëmbëdhjetë ditë – por nëse mbete më tepër se aq, ka për ta falur namazin e plotë. Të gjithë janë të pajtimt, që namazet mund t’i shkurtojnë pa kufi, në rast se nuk ka për qëllim të qëndrojë më gjatë se tre, dhjetë, pesëmbëdhjetë ose nëntëmbëdhjetë ditë, por për shkak të natyrës së punës i është detyruar në zgjatjen e afatit të qëndrimit.

³⁵⁸ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*, si dhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

Is'haku konsideron, që meth'hebi më i drejtë është ai i cili thirret në hadithin e Ibn Abbasit. Ai thotë: “Ai e ka transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndërsa pas vdekjes së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai edhe vepronte sipas tij.” Nëse synon të qëndroj dymbëdhjetë ditë ka për ta falur namazin e plotë.”

Pastaj, dijetarët janë pajtuar, që udhëtari ka për ta shkurtuar namazin vazhdimisht, nëse me nijet nuk e ka precizuar kohën e qëndrimit të vet, madje nëse ka për të mbetur edhe një vit.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا هُشَيْمٌ، أَخْبَرَنَا يَحْيَى بْنُ أَبِي إِسْحَاقَ الْخَضْرَمِيُّ، حَدَّثَنَا أَنَسُ بْنُ مَالِكٍ، قَالَ خَرَجْنَا مَعَ النَّبِيِّ ﷺ مِنَ الْمَدِينَةِ إِلَى مَكَّةَ فَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ . قَالَ قُلْتُ لِأَنْسٍ كَمْ أَقَامَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ بِمَكَّةَ قَالَ عَشْرًا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ وَجَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ أَقَامَ فِي بَعْضِ أَسْفَارِهِ تِسْعَ عَشْرَةَ يُصَلِّي رَكْعَتَيْنِ . قَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ فَتَحْنُ إِذَا أَقَمْنَا مَا بَيْنَنَا وَبَيْنَ تِسْعَ عَشْرَةَ صَلَّيْنَا رَكْعَتَيْنِ وَإِنْ رَدْنَا عَلَى ذَلِكَ أَتَمَمْنَا الصَّلَاةَ . وَرَوَى عَنْ عَلِيٍّ أَنَّهُ قَالَ مَنْ أَقَامَ عَشْرَةَ أَيَّامٍ أَتَمَّ الصَّلَاةَ . وَرَوَى عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّهُ قَالَ مَنْ أَقَامَ خَمْسَةَ عَشَرَ يَوْمًا أَتَمَّ الصَّلَاةَ . وَقَدْ رَوَى عَنْهُ ثَنَّثِي عَشْرَةَ . وَرَوَى عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ أَنَّهُ قَالَ إِذَا أَقَامَ أَرْبَعًا صَلَّي أَرْبَعًا . وَرَوَى عَنْهُ ذَلِكَ قَتَادَةُ وَعَطَاءُ الْخِرَاسَانِيُّ . وَرَوَى عَنْهُ دَاوُدُ بْنُ أَبِي هِنْدٍ خِلَافَ هَذَا . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ بَعْدَ فِي ذَلِكَ فَأَمَّا سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَأَهْلُ الْكُوفَةِ فَذَهَبُوا إِلَى تَوْقِيتِ خَمْسَ عَشْرَةَ وَقَالُوا إِذَا أَجْمَعَ عَلَى إِقَامَةِ خَمْسَ عَشْرَةَ أَتَمَّ الصَّلَاةَ . وَقَالَ الْأَوْزَاعِيُّ إِذَا أَجْمَعَ عَلَى إِقَامَةِ ثَنَّثِي عَشْرَةَ أَتَمَّ الصَّلَاةَ . وَقَالَ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ إِذَا أَجْمَعَ عَلَى إِقَامَةِ أَرْبَعَةٍ أَتَمَّ الصَّلَاةَ . وَأَمَّا إِسْحَاقُ فَرَأَى أَقْوَى الْمَذَاهِبِ فِيهِ حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ قَالَ لِأَنَّهُ رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ ثُمَّ تَأَوَّلَهُ بَعْدَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا أَجْمَعَ عَلَى إِقَامَةِ تِسْعَ عَشْرَةَ أَتَمَّ الصَّلَاةَ . ثُمَّ أَجْمَعَ أَهْلُ الْعِلْمِ عَلَى أَنَّ الْمُسَافِرَ يَقْصُرُ مَا لَمْ يُجْمَعْ إِقَامَةٌ وَإِنْ أَتَى عَلَيْهِ سِتُونَ .

550. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga Asim Ahveli, ai nga Ikrime – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, në udhëtim mbeti nëntëmbëdhjetë ditë, dhe i falte nga dy rekate.” Ibn Abbasi thotë: “Ne deri nëntëmbëdhjetë ditë i falim nga dy rekate. Në rast se mbesim më gjatë se aq, atëherë i falim nga katër rekate.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib-sahih.”³⁵⁹

حَدَّثَنَا هَنَادُ بْنُ السَّرِيِّ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ سَافَرَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ سَفَرًا فَصَلَّى تِسْعَةَ عَشَرَ يَوْمًا رَكْعَتَيْنِ رَكْعَتَيْنِ . قَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ فَتَحْنُ نُصَلِّي فِيمَا بَيْنَنَا وَبَيْنَ تِسْعَ عَشْرَةَ رَكْعَتَيْنِ رَكْعَتَيْنِ فَإِذَا أَقَمْنَا أَكْثَرَ مِنْ ذَلِكَ صَلَّيْنَا أَرْبَعًا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

388. Mbi namazin vullnetar gjatë udhëtimit

باب مَا جَاءَ فِي التَّطَوُّعِ فِي السَّفَرِ

551. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa'di, ai ka transmetuar nga Safvan b. Sulejmani, ai nga Ebu Busra el-Gifari³⁶⁰ - që Berra b. Azibi, ka thënë: “Isha në shoqëri me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në tetëmbëdhjetë udhëtime. Nuk e kam parë, që ndonjëherë, pasi që dielli e kalonte zenitin para fardit të drekës, e ka lënë pa i falur dy rekate (sunset).”³⁶¹

³⁵⁹ E shënojnë edhe Buhariu në *Sahihë*, Ahmed i në *Musned* dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

³⁶⁰ Ebu Busre el-Gifari, është tabi'in, emri i të cilit nuk është i njohur. I ka takuar gjeneratës së katërt të ravive. Ibn Hibbani e ka konsideruar, si ravi të besueshëm të hadithit. Nga ai, vetëm Safvan b. Sulejmi ka transmetuar hadithe. Në *El-Kutubus-sitte*, nga ai është shënuar vetëm ky hadith. Dhe atë, e shënon Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. Shumë e kanë përzier me Ebu Basre el-Gifariun, as'habin i cili quhej Humejl.

³⁶¹ Dijetarët, të cilët konsiderojnë, që sunneti mund të falet përgjatë udhëtimit, me këtë hadith, atë e argumentojnë.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ibn Umeri. Hadithi i Beraut është garib.”³⁶² Për të, e kam pyetur Muhammedin (Buhariun), ai nuk e njihte atë, përveç nëpërmjet Lejth b. Sa’dit, ndërsa nuk e dinte as emrin e Ebu Busra el-Gifarit. Ai megjithatë, atë e konsideronte hasen.”

Ibn Umeri, transmeton që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë udhëtimit, nuk falte kurrfarë nafile, as para e as pas namazit (fard).³⁶³ Nga ai është transmetuar edhe, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë udhëtimit ka falur nafile. E më vonë, dijetarët pas të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), janë ndarë mbi atë. Disa as’habë konsiderojnë, që personi gjatë udhëtimit mund t’i falë namazet vullnetare. Ky është qëndrimi i Ahmedit dhe i Is’hakut. Disa dijetarë konsiderojnë, që personi gjatë udhëtimit nuk duhet të falë kurrfarë namazi vullnetar, as para e as pas namazit fard.³⁶⁴ Kjo do të thotë, që ai i cili nuk i falë namazet vullnetare gjatë udhëtimit, e pranon lehtësimin, derisa ai, që i falë ato, për atë ka dobi të madhe. Ky është qëndrimi i shumicës së dijetarëve. Ata e konsiderojnë të drejtë faljen e namazeve vullnetare gjatë udhëtimit.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ صَفْوَانَ بْنِ سُلَيْمٍ، عَنْ أَبِي بُسْرَةَ الْغَفَارِيِّ، عَنْ الْبَرَاءِ بْنِ عَازِبٍ، قَالَ صَحِبْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ ثَمَانِيَةَ عَشَرَ سَفَرًا فَمَا رَأَيْتُهُ تَرَكَ الرَّكْعَتَيْنِ إِذَا رَاعَتِ الشَّمْسُ قَبْلَ الظُّهْرِ . وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ الْبَرَاءِ حَدِيثٌ غَرِيبٌ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْهُ فَلَمْ يَعْرِفْهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ اللَّيْثِ بْنِ سَعْدٍ وَلَمْ يَعْرِفْ اسْمَ أَبِي بُسْرَةَ الْغَفَارِيِّ وَرَأَاهُ حَسَنًا . وَرَوَى عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ لَا يَتَطَوَّعُ فِي السَّفَرِ قَبْلَ الصَّلَاةِ وَلَا بَعْدَهَا . وَرَوَى عَنْهُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ كَانَ يَتَطَوَّعُ فِي السَّفَرِ . ثُمَّ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ بَعْدَ النَّبِيِّ ﷺ فَرَأَى بَعْضُ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّ يَتَطَوَّعُ الرَّجُلُ فِي السَّفَرِ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَلَمْ تَرَ طَائِفَةً مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ يُصَلِّيَ قَبْلَهَا وَلَا بَعْدَهَا . وَمَعْنَى مَنْ لَمْ يَتَطَوَّعْ فِي السَّفَرِ قَبْلَ الرَّحْصَةِ وَمَنْ تَطَوَّعَ فَلَهُ فِي ذَلِكَ فَضْلٌ كَثِيرٌ . وَهُوَ قَوْلُ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ يَخْتَارُونَ التَّطَوُّعَ فِي السَّفَرِ .

552. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Hafs b. Gijathi, ai ka transmetuar nga Haxhxhaxhi, ai nga Atijje – që Ibn Umeri ka thënë: “Gjatë udhëtimit me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) drekën e falmim nga dy rekate, e pas saj edhe dy rekate (sunnat).”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen, atë e ka transmetuar edhe Ibn Lejl nga Atijje dhe Nafiu, ndërsa ai nga Ibn Umeri.

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا حَفْصُ بْنُ غِيَاثٍ، عَنْ الْحَجَّاجِ، عَنْ عَطِيَّةَ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ صَلَّيْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ الظُّهْرَ فِي السَّفَرِ رَكْعَتَيْنِ وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَاهُ ابْنُ أَبِي لَيْلَى عَنْ عَطِيَّةَ وَنَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ .

553. Na ka treguar Muhammed b. Ubejd el-Muharibi – atë e ka informuar Ali b. Hashimi, ai ka transmetuar nga Ebu Ebu Lejli, ai nga Atijje dhe Nafiu – që Ibn Umeri ka thënë: “Me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) jam falur edhe në shtëpi edhe gjatë udhëtimit. Me të, në shtëpi, i falja katër rekate të namazit fard të drekës, pas tyre dy rekate (sunnat). Gjatë udhëtimit, me të e falja drekën nga dy rekate, pas tyre dy rekate (sunnat). Edhe ikindinë dy rekate, pas tyre ai nuk falte

³⁶² E ka shënuar, Ebu Davudi në *Sunen* dhe nuk e ka shqiptuar asnjë gjykim mbi të.

³⁶³ Këtë hadith, e kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi nga Hafs b. Asimi, i cili, ka thënë: “Kam udhëtuar me Ibn Umerin, për në Mekke. Gjatë udhëtimit, ai drekën na e fali dy rekate. Duke arritur në vendin e pushimit të tij, i pa disa njerëz duke u falur. Pyeti: “Çfarë janë duke bërë këta?” “Janë duke e madhëruar Allahun! – thash, ndërsa ai në atë tha: “Sikur të kisha dashur (ende) ta madhëroja Allahun, unë atëherë do ta kisha falur namazin e plotë. Kam udhëtuar me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai gjatë udhëtimit nuk falte më tepër se dy rekate. Gjithashtu, ashtu bënin edhe Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani.”

³⁶⁴ El-Mubarekfuri, konsideron, se këtu nën nocionin namaz vullnetar mendohet mbi namazet sunnet. Neveviu thotë, që dijetarët janë të pajtimt, që në përgjithësi, nafilet mund të falen gjatë udhëtimit, ndërsa kanë divergjenca në pikëpamje të namazeve sunnet. Ibn Umeri dhe të tjerët, gjatë udhëtimit, ata i linin. Shafi'u dhe shumica e dijetarëve, konsiderojnë, se është mustehab falja e tyre. Abdurrahman el-Mubarekfuri, thotë: “Sipas meje, më i drejtë është qëndrimi se ajo t’i lihet vullnetit të udhëtarit. Në rast se dëshiron, mund t’i fali ato. Po, nëse nuk dëshiron, nuk është i obliguar.”

asgjë. Akshamin, në shtëpi dhe gjatë udhëtimit, njëjtë, nga tre rekate – ai nuk shkurtuhej as në shtëpi e as gjatë udhëtimit, sepse ai është vitri ditor. Pas asaj i falja dy rekate (sunnat).”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. E kam dëgjuar Muhammedin kur ka thënë: ‘Ibn Ebu Lejli nuk ka transmetuar hadith që më ka pëlqyer më shumë sesa ky.’”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عُبَيْدٍ الْمَحَارِبِيُّ، - يَعْنِي الْكُوفِيُّ حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ هَاشِمٍ، عَنْ ابْنِ أَبِي لَيْلَى، عَنْ عَطِيَّةَ، وَنَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ صَلَّيْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فِي الْخَضِرِ وَالسَّفَرِ فَصَلَّيْتُ مَعَهُ فِي الْخَضِرِ الظُّهْرَ أَرْبَعًا وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ وَصَلَّيْتُ مَعَهُ فِي السَّفَرِ الظُّهْرَ رَكْعَتَيْنِ وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ وَالْعَصْرَ رَكْعَتَيْنِ وَلَمْ يُصَلِّ بَعْدَهَا شَيْئًا وَالْمَغْرِبَ فِي الْخَضِرِ وَسَوَاءٌ ثَلَاثَ رَكْعَاتٍ لَا تَنْقُصُ فِي الْخَضِرِ وَلَا فِي السَّفَرِ وَهِيَ وَثَرُ النَّهَارِ وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ. سَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَقُولُ مَا رَوَى ابْنُ أَبِي لَيْلَى حَدِيثًا أَعْجَبَ إِلَيَّ مِنْ هَذَا وَلَا أُرْوَى عَنْهُ شَيْئًا.

389. Mbi bashkimin e dy namazeve gjatë udhëtimit

باب مَا جَاءَ فِي الْجَمْعِ بَيْنَ الصَّلَاتَيْنِ

554. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa'di, ai ka transmetuar nga Jezid b. Ebu Habibi, ai nga Tufejli³⁶⁵ - që Muadh b. Xhebeli, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), praktikonte që gjatë Ekspeditës në Tebuk,³⁶⁶ në rast se nisej për udhëtim (nga vendi i qëndrimit), para se dielli ta kalonte zenitin, ai e pezullonte drekën deri në ikindi, pastaj i falte së bashku me ikindinë. Në rast se, në udhëtim nisej pasi që dielli e ka kaluar zenitin, ai nxitonte me ikindinë dhe atë e falte së bashku me namazin e drekës. Pas asaj, nisej për në rrugë. Gjithashtu, në rast se nisej në udhëtim para perëndimit të diellit, e pezullonte akshamin deri në jaci dhe e falte së bashku me jacinë. Në rast se nisej pas perëndimit të diellit, ai e nxitonte jacinë, dhe e falte atë së bashku me akshamin.”³⁶⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Ibn Umeri, Enesi, Abdullah b. Amri, Aishja, Ibn Abbasi, Usama b. Zejdi dhe Xhabiri. Këtë hadith e ka transmetuar Ali b. El-Medini nga Ahmed b. Hanbeli, ndërsa ai nga Kutejbe. Hadithi i Muadhit, është hasen-garib, atë e ka transmetuar vetëm Kutejbe. Nuk na është e njohur që e ka transmetuar ndokush tjetër atë nga Lejthi. Hadithi i Lejthit nga Jezid b. Ebu Habibi, ai nga Tufejli, ai nga Muadhi, është garib. Dijetarët e kanë të njohur hadithin e Muadhit, të cilin Ebu Zubejri e ka transmetuar nga Ebu Tufejli. Në të qëndron, që Muadhi, ka thënë: ‘I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) gjatë ekspeditës në Tebuk, i bashkonte drekën me ikindinë dhe akshamin me jacinë.’ E kanë transmetuar edhe Kurre b. Halidi, Sufjan eth-Thevriu, Maliku dhe shumë të tjerë, nga Ebu Zubejr el-Mekkijj. Në pajtim me këtë hadith, Shafi'u, Ahmedi dhe Is'haku, thonë: ‘Nuk pengon, që gjatë udhëtimit, të bashkohen dy namaze, në kohën e njërit prej tyre.’”³⁶⁸

³⁶⁵ Ebu Tufejl Amir, por e kanë quajtur edhe Amr b. Vasile b. Abdullah el-Lejthi. Ka lindur në Betejën e Uhudit. E ka parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), andaj e konsiderojnë as'hab. Ka transmetuar hadithe edhe nga Ebu Bekri, Umeri dhe as'habët tjerë pas tij. Ai është as'habi i fundit, ka vdekur në vitin 110 sipas hixhretit.

³⁶⁶ Tebuju i sotëm është qytet në afërsi të kufirit saudiano-jordanez. Është larg nga Medina, për rreth 600 km.

³⁶⁷ Udhëtari, ka edhe një lehtësim tjetër, e ai është, derisa është në udhëtim, mund t'i bashkojë namazin e drekës me të ikindisë dhe të akshamit me të jacinë. Ai atë, mund ta bëjë në dy mënyra: 1) duke e falur ikindinë së bashku me drekën në kohën e drekës, e jacinë e bashkon me akshamin në kohën e akshamit (xhemu't-takdim); 2) e shtyen namazin e drekës dhe e bashkon atë me të ikindisë në kohën e ikindisë, dhe e shtyen akshamin dhe e bashkon me namazin e jacinë në kohën e jacinë (xhemu't-te'hir).

³⁶⁸ Ebu Hanife, konsideron, që namazet mund të bashkohen vetëm në Arafat dhe atë drekën me ikindinë dhe në Muzdelife, akshamin me jacinë. Në udhëtimet tjera, sipas mendimit të tyre, namazi nuk mund të bashkohet.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ، عَنْ أَبِي الطُّفَيْلِ، هُوَ عَامِرُ بْنُ وَاثِلَةَ عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ فِي غَزْوَةِ ثُبُوكَ إِذَا ارْتَحَلَ قَبْلَ زَيْغِ الشَّمْسِ أَخَّرَ الظُّهْرَ إِلَى أَنْ يَجْمَعَهَا إِلَى الْعَصْرِ فَيُصَلِّيهِمَا جَمِيعًا وَإِذَا ارْتَحَلَ بَعْدَ زَيْغِ الشَّمْسِ عَجَّلَ الْعَصْرَ إِلَى الظُّهْرِ وَصَلَّى الظُّهْرَ وَالْعَصْرَ جَمِيعًا ثُمَّ سَارَ وَكَانَ إِذَا ارْتَحَلَ قَبْلَ الْمَغْرِبِ أَخَّرَ الْمَغْرِبَ حَتَّى يُصَلِّيَهَا مَعَ الْعِشَاءِ وَإِذَا ارْتَحَلَ بَعْدَ الْمَغْرِبِ عَجَّلَ الْعِشَاءَ فَصَلَّاهَا مَعَ الْمَغْرِبِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَابْنِ عُمَرَ وَأَنَسٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ وَعَائِشَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَسَامَةَ بْنِ زَيْدٍ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ .

قَالَ أَبُو عِيسَى وَالصَّحِيحُ عَنْ أُسَامَةَ . وَرَوَى عَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ عَنْ أَحْمَدَ بْنِ حَنْبَلٍ عَنْ قُتَيْبَةَ هَذَا الْحَدِيثِ . وَحَدِيثُ مُعَاذٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ تَقَرَّدَ بِهِ قُتَيْبَةُ لَا نَعْرِفُ أَحَدًا رَوَاهُ عَنِ اللَّيْثِ غَيْرَهُ . وَحَدِيثُ اللَّيْثِ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ عَنْ أَبِي الطُّفَيْلِ عَنْ مُعَاذٍ حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَالْمَعْرُوفُ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ حَدِيثُ مُعَاذٍ مِنْ حَدِيثِ أَبِي الرَّبِيعِ عَنْ أَبِي الطُّفَيْلِ عَنْ مُعَاذٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ جَمَعَ فِي غَزْوَةِ ثُبُوكَ بَيْنَ الظُّهْرِ وَالْعَصْرِ وَبَيْنَ الْمَغْرِبِ وَالْعِشَاءِ . رَوَاهُ قُرَّةُ بْنُ خَالِدٍ وَسُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَمَالِكٌ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ أَبِي الرَّبِيعِ الْمَكِّيِّ . وَبِهَذَا الْحَدِيثِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ . وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ يَقُولَانِ لَا بَأْسَ أَنْ يَجْمَعَ بَيْنَ الصَّلَاتَيْنِ فِي السَّفَرِ فِي وَقْتٍ إِحْدَاهُمَا .

555. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Abde, ai ka transmetuar nga Ubejdullah b. Umeri, ai nga Nafiu – që Ibn Umeri, kishte qenë i thirrur, për ta ndihmuar njerë të bashkëshortet e veta.³⁶⁹ Nxitoi, duke e pezulluar akshamin, derisa nuk është larguar të kuqërremtit në qiell, pastaj zbriti dhe e bashkoi (akshamin me jacinë). Pas asaj, ai i informoi të pranishmit, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) bënte ashtu, në rast se do të ishte i detyruar për të udhëtuar diku me shpejtësi. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³⁷⁰

حَدَّثَنَا هَنَادُ بْنُ السَّرِيِّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّهُ اسْتُغِيثَ عَلَى بَعْضِ أَهْلِهِ فَجَدَّ بِهِ السَّيْرُ فَأَخَّرَ الْمَغْرِبَ حَتَّى غَابَ الشَّفَقُ ثُمَّ نَزَلَ فَجَمَعَ بَيْنَهُمَا ثُمَّ أَخْبَرَهُمْ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يَفْعَلُ ذَلِكَ إِذَا جَدَّ بِهِ السَّيْرُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَحَدِيثُ اللَّيْثِ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

390. Mbi namazin për kërkimin e shiut

باب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْإِسْتِسْقَاءِ

556. Na ka treguar Jahja b. Musai – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma’meri, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Abbad b. Temimi – që xhaxhai i Abbad b. Temimit ka thënë: “Një ditë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) doli me njerëzit, për të bërë lutje për shi. Me ta i fali dy rekate, duke recituar me zë. Pastaj e rrotulloi pelerinën,³⁷¹ i ngriti duart dhe duke u kthyer në drejtim të kibles, lutej për të rënë shi.”³⁷²

³⁶⁹ Abdullah b. Umeri, ka qenë jashtë Medines, kur i ka ardhur një njeri dhe e ka lajmëruar, që gruaja e tij, Safija bint Ebu Ubejd, ka vdekur. Ai, menjëherë ka udhëtuar duke e pezulluar akshamin, i cili nuk e ka falur deri në kohë të jacinës dhe pastaj e ka bashkuar me jacinë.

³⁷⁰ E kanë shënuar edhe Buhariu, Ebu Davudi dhe Nesaiu.

³⁷¹ E ka kthyer mantelin, ashtu që skajin e tij të majtë e ka vënë mbi krahun e djathtë, ndërsa, skajin e tij të djathtë mbi krahun e majtë, me këtë duke simbolizuar mbi nderimin e gjendjes së tanishme.

³⁷² Ky hadith, është argument, se gjatë lutjes së shiut, të falen dy rekate, është sunnet. Ashtu mendojnë Shafiu, Ahmedi, Maliku dhe shumica e ulemasë. Ebu Hanife, konsideron, se gjatë lutjes së shiut nuk është e nevojshme falja e dy rekateve. Ai, thotë: “Nuk është sunnet, gjatë lutjes së shiut, të falen dy rekate. Ai, thotë: “Nuk është sunnet, që gjatë lutjes së duasë, të falen dy rekate me xhemat. Nëse njerëzit dëshirojnë të falen individualisht, atë e kanë të lejuar. Sipas tij, duaja e shiut, përbëhet ekskluzivisht nga istigfari. Si argument ndaj këtij qëndrimi, ai i cekë këto ajete: “*që Ai t’ju dërgojë shi të bollshëm, t’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!*” [Nuh; 10-11]. Ai thotë: Këtu, kusht për lëshimin e shiut, është përmendur të kërkuarit e faljes, e jo namazi. Sa i përket haditheve, në të cilët është përmendur namazi, gjatë lutjes së shiut, mund të thonë “thotë Ebu Hanife” që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ndonjëherë namaz ka falur e ndonjëherë jo – çka tregon se nuk është i obliguar të falet.” Qëndrimi i shumicës së dijetarëve islam, që gjatë lutjes së shiut, është sunnet falja e dy rekateve, prap është më i drejtë dhe më i argumentuar, sepse është i bazuar në hadithe të shumta të besueshme.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi, Ebu Hurejre, Enesi dhe Ebu Lahmi. Hadithi i Abdullah b. Zejdit është hasen-sahih.³⁷³ Sipas tij veprojnë dijetarët, por në pajtim me të janë edhe qëndrimet e Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut. Emri i xhaxhait të Abbad b. Temimit është Abdullah b. Zejd b. Asim el-Mazini.”

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ عَبْدِ بْنِ تَمِيمٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ خَرَجَ بِالنَّاسِ يَسْتَسْقِي فَصَلَّى بِهِمْ رَكْعَتَيْنِ جَهَرَ بِالْقِرَاءَةِ فِيهِمَا وَحَوَّلَ رِجْلَهُ وَرَفَعَ يَدَيْهِ وَاسْتَسْقَى وَاسْتَقْبَلَ الْقِبْلَةَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَأَنَسٍ وَأَبِي الْلَحْمِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ زَيْدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَعَلَى هَذَا الْعَمَلِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَعُمَرُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ زَيْدٍ بْنُ عَاصِمٍ الْمَازِنِيُّ .

557. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Halid b. Jezidi, ai nga Seid b. Ebu Hilali, ai nga Jezid b. Abdullahu, ai nga Umejri, i të mbrojturit të Ebu Lahmit – që Ebu Lahmi, e ka parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), te vendi Ahxharul–zejt,³⁷⁴ se si e recitonte duanë për shiun. Duanë e recitonte duke i ngritur duart.³⁷⁵

Ebu Isai thotë: “Në këtë hadith, Kutejbe ka thënë: ‘Nga Ebu Lahmi’. Nuk na është e njohur, që ai, të ketë transmetuar ndonjë hadith tjetër nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). I mbrojturi i Umer Ebu Lahmit, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka transmetuar shumë hadithe dhe ishte as’hab.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ خَالِدِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي هِلَالٍ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ عُمَيْرٍ، مَوْلَى أَبِي الْلَحْمِ عَنْ أَبِي الْلَحْمِ، أَنَّهُ رَأَى رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عِنْدَ أَحْجَارِ الرَّبِّ يَسْتَسْقِي وَهُوَ مُقْبِعٌ بِكَفَيْهِ يَدْعُو . قَالَ أَبُو عِيسَى كَذَا قَالَ قُتَيْبَةُ فِي هَذَا الْحَدِيثِ عَنْ أَبِي الْلَحْمِ وَلَا نَعْرِفُ لَهُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ إِلَّا هَذَا الْحَدِيثَ الْوَاحِدَ وَعُمَيْرٌ مَوْلَى أَبِي الْلَحْمِ قَدْ رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَحَادِيثَ وَلَهُ صُحْبَةٌ .

558. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hatim b. Ismaili, ai ka transmetuar nga Hisham b. Ismaili, ai ka transmetuar nga Hisham b. Is’haku, ndërsa ai është i biri i Abdullah b. Kinanes – që babai i Hisham b. Is’hakut, ka thënë: “Më dërgoi Velid b. Ukbe, emiri i Medines, për ta pyetur Ibn Abbasin mbi duanë e shiut të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Erdha tek ai, e ai më tha: “I Dërguari i Allahut, dilte me rrobat e përditshme, i nënshtuar me frikërespekt dhe ashtu vinte në musalë. Ai nuk mbante hutbe, sikur që është kjo e juaja,³⁷⁶ por pandërprerë me përlulje recitonte duanë, e madhëronte Allahun e Lartësuar dhe i falte dy rekate, ashtu siç i falte për Bajram.”³⁷⁷ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³⁷⁸

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا خَاتِمُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ إِسْحَاقَ، وَهُوَ ابْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ كَثَّانَةَ عَنْ أَبِيهِ، قَالَ أُرْسِلَنِي الْوَلِيُّ بْنُ عُفَيْةَ وَهُوَ أَمِيرُ الْمَدِينَةِ إِلَى ابْنِ عَبَّاسٍ أَسْأَلُهُ عَنْ اسْتِسْقَاءِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَاتَّبَعْتُهُ فَقَالَ إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ خَرَجَ مُتَبَدِّلًا مُتَوَاضِعًا مُتَضَرِّعًا حَتَّى أَتَى الْمُصَلَّى فَلَمْ يَخْطُبْ خُطْبَتَكُمْ هَذِهِ وَلَكِنْ لَمْ يَزَلْ فِي الدُّعَاءِ وَالتَّضَرُّعِ وَالتَّكْبِيرِ وَصَلَّى رَكْعَتَيْنِ كَمَا كَانَ يُصَلِّي فِي الْعِيدِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

³⁷³ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*, Ahmedi, në Musned dhe Ebu Davudi dhe Nesaiu, në *Sunen*.

³⁷⁴ Vendin në Medine, në të cilin ishte një grumbull i gurëve të zi, të cilët aq shumë shkëlqenin, sikur të ishin lyer me vaj.

³⁷⁵ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ebu Davudi, në *Sunen*, qëndron, që e ka parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se si, duke qëndruar në këmbë, e shqiptonte duanë e shiut, duke i ngritur duart lart, mbi kokë. Këtë hadith, Ebu Hanife e ka përdorur, si argument për qëndrimin e vet, sepse, në të, nuk e ka përmendur namazin, por vetëm duanë.

³⁷⁶ Ahmed b. Hanbeli, nga kjo, nxjerr përfundim, që nuk është sunnet mbajtja e hutbes gjatë duasë për shiun. El-Mubarekfuri, thotë: “Ne nga kjo, kuptojmë, që ai atëherë ka mbajtur hutbe por vetëm një, e jo dy siç e bënë atë të premtëve dhe barjameve.” Me këtë, është i pajtimt edhe Ebu Jusufi, derisa Muhammedi konsideron, që gjatë duasë së shiut, duhet bërë dy hutbe.

³⁷⁷ Në bazë të këtij hadithi, shumica e dijetarëve konsideron, që namazi gjatë lutjes për shiun, falet në të njëjtën mënyrë, si i bajramit, përveç se, te ky namaz, nuk shqiptohen tekbiret si te bajrami. Shafi, konsideron, që gjatë atij namazi, në të, në të njëjtën mënyrë, shqiptohen edhe tekbiret.

³⁷⁸ E shënojnë edhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunen*, Ibn Haxheri në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*.

559. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Hisham b. Is'hak b. Abdullah b. Kinani, ai nga babai i vet – hadithin e ngjashëm me të mëparshmin, duke e shtuar aty (fjalën) me *frikërespekt*.

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.” Shafiut thotë:”

Shafiut thotë: “Namazi me rastin e duasë për shiun, duhet falur ngjashëm me namazin e dy Bajrameve. Në rekatin e parë shqiptohen shtatë tekbiere, ndërsa në të dytin pesë tekbiere.” Si argument për të, ka cekur hadithin e Ibn Abbasit.”

Ebu Isai, thotë: “Transmetohet, që Malik b. Enesi, ka thënë: “Në namazin e lutjes për shiun nuk kanë për t'u shqiptuar tekbiere, siç shqiptohen në namazin e dy Bajrameve.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ إِسْحَاقَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ كِنَانَةَ، عَنْ أَبِيهِ، فَذَكَرَ نَحْوَهُ وَزَادَ فِيهِ مَتَحَسِّبًا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ قَالَ يُصَلِّي صَلَاةَ الْإِسْتِسْقَاءِ نَحْوَ صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ يُكَبِّرُ فِي الرُّكْعَةِ الْأُولَى سُبْعًا وَفِي الثَّانِيَةِ خَمْسًا وَاحْتَجَّ بِحَدِيثِ ابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى عَنْ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ أَنَّهُ قَالَ لَا يُكَبِّرُ فِي صَلَاةِ الْإِسْتِسْقَاءِ كَمَا يُكَبِّرُ فِي صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ .

391. Mbi namazin El-Kusuf (namazi i Eklipsit)³⁷⁹

بَاب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْكُسُوفِ

560. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Jahja b. Seidi, ai ka transmetuar nga Sufjani, ai nga Habib b. Ebu Thabiti, ai nga Tavusi, ai nga Ibn Abbasi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka falur namaz gjatë eklipsit. Recitonte (Kur'an) pastaj shkante në ruku. Pastaj (pas kthimit nga rukuja) vazhdonte me recitim e Kur'anit, pastaj prapë shkante në ruku. Pastaj (pas kthimit nga rukuja) vazhdonte me recitim e Kur'anit, pastaj prapë shkante në ruku. Pas asaj i bënte dy sexhde. Në rukunë e dytë vepronte në të njëjtën mënyrë.³⁸⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Aishja, Abdullah b. Amri, Numan b. Beshiri, Mugire b. Shu'be, Ebu Mes'udi, Ebu Bekri, Semure, Ibn Mes'udi, Esmā, e bija e Ebu Bekrit, Ibn Umeri, Kabis el-Hilali, Xhabir b. Abdullahut, Ebu Musai, Abdurrahman b. Semure dhe Ubejj b. Ka'bi. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.”³⁸¹

Ibn Abbasi transmeton, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë eklipsit e falte namazin me katër ruku dhe sexhde.³⁸² Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe i Is'hakut.

³⁷⁹ Ibn Haxher el-Askalani, në komentimin e *Sahih Fet'hul Bari* të Buhariut, thotë: “Juristët shariatik, zakonisht e përdorin fjalën *kusuf* për eklipsin e Diellit, ndërsa fjalën *husuf* për eklipsin e Hënës.

³⁸⁰ Në këtë hadith qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në një rekat në namaz, gjatë eklipsit të Diellit ose të Hënës, i bënte nga tre kijame dhe tre ruku e dy sexhde. Në transmetimin e të njëjtat hadith nga Muslimi, qëndron se i ka bërë katër kijame dhe ruku dhe dy sexhde, ndërsa në transmetimin të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, në *Sahih*, nga Ibn Abbasi, qëndron se i ka bërë nga dy kijame, dy ruku dhe dy sexhde.

Hadithin të cilin e shënon Buhariu dhe Muslimi është më i besueshëm. Sa i përket haditheve të përmendura, të cilët i transmetojnë, Tirmidhiu dhe Muslimi, ata i ka transmetuar Habib b. Ebu Thabiti, nga Tavusi, ndërsa, ai nga Ibn Abbas. Ibn Haxheri, në veprën *Telhisul-Habir*, cekë, që Ibn Hibbani, në *Sahih*, ka thënë, se janë më të besueshëm sepse i transmeton Habib b. Ebu Thabiti nga Tavusi, sepse ai nuk i ka dëgjuar hadithet nga Tavusi.”

³⁸¹ Më herët, kemi përmendur, që Ibn Hibbani dhe Bejhekiu, atë e vlerësojnë si daif.

³⁸² Këtë hadith, e kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*. Në pajtim me të, është edhe qëndrimi i shumicës së dijetarëve islam, të cilët mendojnë, se namazi, gjatë eklipsit të Diellit, ose të Hënës, përbëhet nga dy

Dijetarët, janë ndarë në pikëpamje të recitimit gjatë namazit, i cili falet me rastin e eklipsit. Disa konsiderojnë, duke e pasur parasysh që është ditë, duhet recituar pa zë (në vete). Disa konsiderojnë që në atë namaz duhet recituar me zë sikur në namazin e Bajramit dhe të xhumasë. Qëndrimin e këtillë e mbështesin, Maliku, Ahmedit dhe Is'haku. Ata konsiderojnë, që në këtë namaz duhet recituar me zë. Shafi'u thotë: "Nuk duhet recituar me zë." Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me rrugë të besueshme, janë transmetuar dy mënyrat.

Është transmetuar besueshëm, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) këtë namaz e ka falur nga katër ruku dhe sexhde. Gjithashtu, është transmetuar besueshëm, që ai (i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), këtë namaz e ka falur me gjashtë ruku dhe katër sexhde. Të tëra këto, sipas mendimit të dijetarëve, janë të lejuara. Sa ruku kanë për t'u bërë varet nga gjatësia e eklipsit. Nëse eklipsi zgjatë më gjatë, atëherë është e lejuar për të bërë gjashtë ruku dhe katër sexhde. Nëse i bënë katër ruku dhe katër sexhde dhe reciton më gjatë, edhe ajo është e lejuar.

Dijetarët e hadithit, transmetojnë, që namazi gjatë eklipsit të Diellit dhe të Hënës falet me xhemat.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ أَبِي ثَابِتٍ، عَنْ طَاوُسٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ صَلَّى فِي كُسُوفٍ قَرَأَ ثُمَّ رَكَعَ ثُمَّ قَرَأَ ثُمَّ رَكَعَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ ثُمَّ سَجَدَ سَجْدَتَيْنِ وَالْأُخْرَى مِثْلَهَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَعَائِشَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَالنُّعْمَانِ بْنِ بَشِيرٍ وَالْمُغِيرَةَ بْنَ شُعْبَةَ وَأَبِي مَسْعُودٍ وَأَبِي بَكْرَةَ وَسَمُرَةَ وَأَبِي مُوسَى الْأَشْعَرِيَّ وَابْنَ مَسْعُودٍ وَأَسْمَاءَ بِنْتُ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ وَابْنَ عُمَرَ وَقَبِيصَةَ الْهَلَالِيِّ وَجَابِرَ بْنَ عَبْدِ اللَّهِ وَعَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ سَمُرَةَ وَأَبِي بَكْرٍ الْكَلْبِيِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ صَلَّى فِي كُسُوفٍ أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . قَالَ وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْقِرَاءَةِ فِي صَلَاةِ الْكُسُوفِ فَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ يُسَبِّرَ بِالْقِرَاءَةِ فِيهَا بِالنَّهَارِ . وَرَأَى بَعْضُهُمْ أَنْ يَجْهَرَ بِالْقِرَاءَةِ فِيهَا كَنَحْوِ صَلَاةِ الْعِيدَيْنِ وَالْجُمُعَةِ وَبِهِ يَقُولُ مَالِكٌ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ يَرَوْنَ الْجَهْرَ فِيهَا . وَقَالَ الشَّافِعِيُّ لَا يَجْهَرُ فِيهَا . وَقَدْ صَحَّ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ كَلَّمَا الرَّوَائِثَيْنِ صَحَّ عَنْهُ أَنَّهُ صَلَّى أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ . وَصَحَّ عَنْهُ أَيْضًا أَنَّهُ صَلَّى سِتَّ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ . وَهَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ جَائِزٌ عَلَى قَدْرِ الْكُسُوفِ إِنْ تَطَاوَلَ الْكُسُوفُ فَصَلَّى سِتَّ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ فَهُوَ جَائِزٌ وَإِنْ صَلَّى أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ وَأَطَالَ الْقِرَاءَةَ فَهُوَ جَائِزٌ . وَيَرَوْنَ أَصْحَابُنَا أَنْ تُصَلَّى صَلَاةُ الْكُسُوفِ فِي جَمَاعَةٍ فِي كُسُوفِ الشَّمْسِ وَالْقَمَرِ .

561. Na ka treguar Muhammed b. Abdulmelik b. Ebu Shevarib – atë e ka informuar Jezid b. Zurej, atë Ma'meri, duke transmetuar nga Zuhriu, ai nga Urve – që Aishja, ka thënë: "Gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), u bë errësimi i Diellit. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka falur namaz me xhemat. Në kijam recitoi (Kur'an) gjatë. Pastaj shkoi në ruku dhe u ndal shumë gjatë. Pastaj e ngriti kokën nga rukuja dhe vazhdoi gjatë me recitim. Në të vërtetë, ca më shkurt, në krahasim me recitim e parë. Pastaj, përsëri shkoi në ruku dhe mbeti gjatë në ruku, megjithatë, ca më shkurt në krahasim me rukunë e parë. Pas asaj, e ngriti kokën nga rukuja, pastaj shkoi në sexhde. Ashtu veproi edhe në rekatin e dytë." Ebu Isai thotë: "Ky hadith është hasen-sahih."³⁸³

Në pajtim me këtë hadith, janë edhe qëndrimet e Shafiut, Ahmedit dhe Is'hakut. Ata konsiderojnë, që namazi me rastin e eklipsit përbëhet nga katër ruku dhe sexhde.³⁸⁴ Shafi'u thotë: "Në rekatin e parë

rekate, secili rekat nga dy kijame, dy kiraete, dy ruku dhe dy sexhde. Ibn Tejmijje, në veprën *Et-Tevesulu vel-Vesiletu*, duke i sqaruar hadithet, në të cilët qëndron, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në çdo rekat, në namazin, gjatë eklipsit të Diellit, i ka bërë nga dy, ose katër ruku, thotë: "Është e drejtë vetëm ajo, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë namaz, i ka bërë vetëm nga dy ruku gjatë secilit rekat. Ai, namazin, me rastin e zënies së Diellit, e falte vetëm një herë në jetë dhe atë, ditën kur i ka vdekur i biri i tij Ibrahimit dhe në të, në çdo rekat i ka bërë vetëm dy ruku." Me këtë janë të pajtimit edhe Shafi'u, Buhariu dhe Ahmed b. Hanbeli.

³⁸³ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

³⁸⁴ Siç e kemi përmendur, Shafi'u, Ahmedit, Is'haku dhe shumë dijetarë të tjerë, konsiderojnë, se namazi gjatë eklipsit të Diellit dhe të Hënës, përbëhet nga katër ruku, nga dy, në secilin rekat. Ebu Hanifë, konsideron, se ky

recitohet Fatihaja dhe (Kur'ani) me gjatësi të sures El-Bekare. Në rast se eklipsi shfaqet gjatë ditës, atëherë duhet recituar në vete (pa zë). Pastaj shkohet në ruku, në ruku duhet mbetur gjatë. Përafërsisht, aq sa ka zgjatur recitimi. Pastaj duke e shqiptuar tekbinin, ngrihet nga rukuja, duke u drejtuar, duhet vazhduar me recitim dhe atë: Fatihanë, dhe nga (Kur'ani) sa është sureja Ali-Imran. Pastaj, përsëri shkohet në ruku dhe mbetet aq sa ka zgjatur recitimi. Pastaj duhet ngritur nga rukuja dhe duhet thënë *SemiAllahu limen Hamideh*, pastaj duhet rënë në sexhde dhe duhet bërë dy sexhde të plota, duke u ndalur në secilën, aq sa është ndalur në ruku. Pastaj, pas ngritjes (në rekatën e dytë) duhet recituar Fatihanë dhe (nga Kur'ani) aq sa është sureja En-Nisa, pastaj duhet shkuar në ruku, duke u ndalur aq sa ka zgjatur recitimi. Pastaj ngrihet nga rukuja duke bërë tekbinin, duke u drejtuar, duke qëndruar në këmbë duhet recituar (edhe) aq sa është sureja El-Maide, pastaj duhet bërë rukuja, duhet ndalur në të, sa ka zgjatur recitimi, pastaj duhet ngritur duke e shqiptuar *SemiAllahu limen hamideh*, pastaj duhet bërë dy sexhde dhe pasi që recitohet *Et-Tehijati* dhe *Salavatet* duhet dhënë selam.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ أَبِي الشَّوَّارِبِ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، حَدَّثَنَا مَعْمَرٌ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ عُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّهَا قَالَتْ خَسَفَتِ الشَّمْسُ عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَصَلَّى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ بِالنَّاسِ فَأَطَالَ الْقِرَاءَةَ ثُمَّ رَكَعَ فَأَطَالَ الرُّكُوعَ ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ فَأَطَالَ الْقِرَاءَةَ وَهِيَ دُونَ الْأُولَى ثُمَّ رَكَعَ فَأَطَالَ الرُّكُوعَ وَهُوَ دُونَ الْأُولَى ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ فَسَجَدَ ثُمَّ فَعَلَ مِثْلَ ذَلِكَ فِي الرَّكْعَةِ الثَّانِيَةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَبِهِذَا الْحَدِيثِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ يَرَوْنَ صَلَاةَ الْكُسُوفِ أَرْبَعَ رَكَعَاتٍ فِي أَرْبَعِ سَجَدَاتٍ . قَالَ الشَّافِعِيُّ يَفْرَأُ فِي الرَّكْعَةِ الْأُولَى بِأَمِّ الْقُرْآنِ وَنَحْوًا مِنْ سُورَةِ الْبَقَرَةِ سِرًّا إِنْ كَانَ بِالنَّهَارِ ثُمَّ رَكَعَ رُكُوعًا طَوِيلًا نَحْوًا مِنْ قِرَاءَتِهِ ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ بِتَكْبِيرٍ وَتَبَتِ قَائِمًا كَمَا هُوَ وَقَرَأَ أَيْضًا بِأَمِّ الْقُرْآنِ وَنَحْوًا مِنْ آلِ عِمْرَانَ ثُمَّ رَكَعَ رُكُوعًا طَوِيلًا نَحْوًا مِنْ قِرَاءَتِهِ ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ ثُمَّ قَالَ " سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ " . ثُمَّ سَجَدَ سَجْدَتَيْنِ تَامَتَيْنِ وَيُؤَيِّمُ فِي كُلِّ سَجْدَةٍ نَحْوًا مِمَّا أَقَامَ فِي رُكُوعِهِ ثُمَّ قَامَ فَقَرَأَ بِأَمِّ الْقُرْآنِ وَنَحْوًا مِنْ سُورَةِ الْبَقَرَةِ ثُمَّ رَكَعَ رُكُوعًا طَوِيلًا نَحْوًا مِنْ قِرَاءَتِهِ ثُمَّ رَفَعَ رَأْسَهُ بِتَكْبِيرٍ وَتَبَتِ قَائِمًا ثُمَّ قَرَأَ نَحْوًا مِنْ سُورَةِ الْمَائِدَةِ ثُمَّ رَكَعَ رُكُوعًا طَوِيلًا نَحْوًا مِنْ قِرَاءَتِهِ ثُمَّ رَفَعَ فَقَالَ " سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ " . ثُمَّ سَجَدَ سَجْدَتَيْنِ ثُمَّ تَشَهُّدَ وَسَلَّمَ .

392. Si recitohet në namaz gjatë eklipsit

باب مَا جَاءَ فِي صِفَةِ الْقِرَاءَةِ فِي الْكُسُوفِ

562. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, atë Sufjani, ai ka transmetuar nga Esved b. Kajsij,³⁸⁵ ai nga Tha'lebe b. Ibadi³⁸⁶ - që Semure b. Xhundubi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) është falur gjatë eklipsit (duke recituar në vete) ashtu që nuk ia kemi dëgjuar zërin.”³⁸⁷

lloj i namazit, falet sikur namazet e tjera. Domethënë, përbëhet nga dy rekate, ndërsa në secilin bëhet nga një kijam, një të kënduar, një ruku dhe dy sexhde. Ebu Hanife, qëndrimin e vet e bazon mbi hadithin, të cilin e shënon Ibn Hibbani, në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*, nga Ebu Bekri, në të cilin qëndron: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë eklipsit të Diellit dhe të Hënës, e falte namazin e ngjashëm me namazin tuaj.” Në transmetimin e Nesaiut, qëndron: “Ngjashëm, siç faleni ju.” Ibn Hibbani dhe Bejhekiu këtë, e kanë komentuar kështu: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ua falte namazin, ngjashëm me namazin tuaj, të cilin e falni gjatë eklipsit të Diellit. Ose, siç e falni ju atë, gjatë eklipsit të Diellit ose të Hënës.”

“Qëndrimi i shumicës së dijetarëve islam, ndaj mendimit të El-Mubarekfurit është më i drejtë dhe më i besueshëm, sepse bazohet mbi shumë hadithe të besueshme.

³⁸⁵ Esved b. Kajs el-Abi el-Kufi Ebu Kajs është ravi i besueshëm. I takonte gjeneratës së katër të ravive.

³⁸⁶ Tha'lebe b. Ibad el-Abdu el-Basri, siç qëndron në *Tekrib*, është i vlerësuar si ravi makbul. Dhehebi, në veprën *Mizanul-I'tidal*, thotë që ai është tabi'inë dhe që hadithet i ka dëgjuar nga Semure b. Xhundubi. Esed i nga ai e ka transmetuar hadithin diç më të gjatë mbi namazin gjatë eklipsit të Hënës. Ibn Hatim thotë: “Që Tha'lebe nuk është i njohur.”

³⁸⁷ Në bazë të këtij dhe disa haditheve të tjerë, siç thekson Ibn Haxheri, në veprën *Fet'hul Bari*, Ebu Hanife, Shafi'u, sipas disa rivajeteve, edhe Maliku, kanë caktuar, që në namazin gjatë eklipsit të Diellit, duhet shqiptuar

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Aishja. Hadithi i Semure b. Xhundubit është hasen-sahih-garib.³⁸⁸ Disa dijetarë, e kanë marr qëndrim, në pajtim me këtë hadith. I tillë është edhe qëndrimi i Shafiut.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنِ الْأَسْوَدِ بْنِ قَيْسٍ، عَنْ ثَعْلَبَةَ بْنِ عِبَادٍ، عَنْ سَمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ، قَالَ صَلَّى بِنَا النَّبِيِّ ﷺ فِي كُسُوفٍ لَا نَسْمَعُ لَهُ صَوْتًا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَمُرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ .

563. Na ka treguar Ebu Bekër Muhammed b. Ebani – atë e ka informuar Ibrahim b. Sadeku, ai ka transmetuar nga Sufjan b. Husejni, ai nga Zuhriu, ai nga Urve – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka falur namaz gjatë eklipsit, dhe në të recitonte me zë.”³⁸⁹

Ebbu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”³⁹⁰ Ebu Is’hak el-Fezariu, nga Sufjan b. Husejni, ka transmetuar ngjashëm. Në pajtim me këtë (hadith), janë qëndrimet e Malikut, Ahmedit dhe të Is’hakut.”

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ، مُحَمَّدُ بْنُ أَبِي حَنْدَلَةَ، حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ صَدَقَةَ، عَنْ سُفْيَانَ بْنِ حُسَيْنٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ عُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى صَلَاةَ الْكُسُوفِ وَجَهَرَ بِالْقِرَاءَةِ فِيهَا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَرَوَاهُ أَبُو إِسْحَاقَ الْقَرَارِيُّ عَنْ سُفْيَانَ بْنِ حُسَيْنٍ نَحْوَهُ . وَبِهَذَا الْحَدِيثِ يَقُولُ مَالِكٌ بْنُ أَنَسٍ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

393. Mbi namazin me rastin e frikës³⁹¹

بَاب مَا جَاءَ فِي صَلَاةِ الْخَوْفِ

564. Na ka treguar Muhammed b. Abdulmelik b. Ebush-Shevarib – atë e ka informuar Jezid b. Zurej, atë Ma’meri, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Salimi – që babai i Salimit, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), namazin me rastin e frikës e falte, ashtu që një rekat e falte me njërin grup, derisa grupi tjetër ishte përballë armikut. Pastaj, këta shkonin dhe qëndronin në

në vete, derisa, në namazin gjatë eklipsit të Hënës, duhet shqiptuar me zë. Neveviu, në komentimin e *Sahihut* të Muslimit, thotë: “Medh’hebi jonë, si dhe medh’hebi i Malikut, Ebu Hanifes, Lejth b. Sa’dit dhe i shumicës së dijetarëve, është, që në namazin gjatë eklipsit të Diellit duhet shqiptuar në vete, ndërsa në namazin, gjatë eklipsit të Hënës, me zë.”

³⁸⁸ Këtë hadith e kanë shënuar Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunenë*, ndërsa Ibn Hibbani në *Sahih* dhe Hakimi në *Musned*, si dhe e kanë vlerësuar të besueshëm. Ibn Haxheri, thotë, që Ibn Hazmi, këtë hadith e ka shënuar si hadith me një të metë të mbuluar, sepse transmetohet nga Tha’lebe b. Ibad, i cili, sipas mendimit të tij, është ravi-mexhhul. Edhe Ali b. Mednin e konsideron mexhhul.

³⁸⁹ Në bazë të këtij hadithi dhe haditheve të tjera të besueshme, Ahmedit, Is’haku, sipas disa rivajeteve edhe Malikut, konsiderojnë, se në namaz, me rastin e eklipsit të Diellit dhe të Hënës, duhet recituar me zë. Abdurahman el-Mubarekfuri, këtë mendim e veçon si të drejtë sepse: 1. Është më i bazuar, 2. Sepse në ato transmetime është theksuar qartë, se duhet lexuar me zë, derisa në transmetimet, në të cilat përmendet të kënduarit në vete, atë nuk e thekson, por as’habi Semure b. Xhundubi thotë, se ata nuk e kanë dëgjuar zërin e të Dërguarit, gjë që, nga ana tjetër, përjashtohet mundësia, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka lexuar me zë, por mund të kuptojmë, se ata janë falur në safet e fundit, prandaj në këtë namaz nuk e kanë dëgjuar zërin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Në transmetimin e Mebsutiut qëndron: “Arritëm në xhami, xhamia tani më ishte mbushur.”

³⁹⁰ E shënon Tahaviu.

³⁹¹ Këtu mendohet në përgjithësi mbi mënyrën e faljes së namazeve të obliguara në situatat kur ekziston rreziku dhe frika nga armiku, ndërsa në veçanti në kushtet e luftës në front, kur nuk është duke u zhvilluar ende ofensiva dhe sulmi. Gjatë kohës së sulmit dhe ofensivës, secili duhet falur për vete, ashtu siç mundet duke u kthyer andej ka është i obliguar.”

vendin e tyre, e ata vinin dhe me ta e falte rekatin e dytë. Pastaj jepte selam, mandej edhe këta edhe ata e falnin edhe nga një rekat (të vetëm).³⁹²

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ أَبِي الشَّوَارِبِ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، حَدَّثَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ صَلَّى صَلَاةَ الْخَوْفِ بِإِخْدَى الطَّائِفَتَيْنِ رُكْعَةً وَالطَّائِفَةَ الْأُخْرَى مُوَاجِهَةً الْعَدُوِّ ثُمَّ انْصَرَفُوا فَقَامُوا فِي مَقَامٍ أُولَئِكَ وَجَاءَ أُولَئِكَ فَصَلَّى بِهِمْ رُكْعَةً أُخْرَى ثُمَّ سَلَّمَ عَلَيْهِمْ فَقَامَ هَؤُلَاءِ فَقَضَوْا رُكْعَتَهُمْ وَقَامَ هَؤُلَاءِ فَقَضَوْا رُكْعَتَهُمْ .

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabiri, Hudhejfe, Zejd b. Thabiti, Ibn Abbasi, Ebu Hurejre, Ibn Mes’udi, Sehl b. Ebu Hasmai, Ebu Ajjash ez-Zureki, i cili quhet Zejd b. Samiti dhe Ebu Bekri. Malik b. Enesi, në pikëpamje të namazit në rast të frikës, qëndrimin e vet e ka formuluar në frymën e hadithit të Sehl b. Ebu Hasames. E ai është qëndrimi i Shafiut.”

Ahmedi, thotë: “Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), namazi në rast të frikës është transmetuar në disa mënyra. Mua, mbi këtë temë më është njohur vetëm një hadith i besueshëm. Konsideroj, që ai është hadithi i Sehl b. Ebu Hasames.”

Is’hak b. Ibrahim, thotë: “Janë shënuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi namazin me rastin e frikës, shumë transmetimet. Mendoj, që të gjitha mënyrat që janë transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), janë të mundura edhe të lejuara, përshtatshmërisht me shkallën e rrezikshmërisë dhe të frikës. Ne, nuk mund ta ndajmë hadithin e Sehl b. Ebu Hasamit si më të besueshëm në krahasim me transmetimet tjera. Dhe hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih. Atë e ka transmetuar, Musa b. Ukbe, nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e tij.”

قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى مُوسَى بْنُ عُقْبَةَ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ مِثْلَ هَذَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ وَحُذَيْفَةَ وَزَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَسَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ وَأَبِي عِيَّاشٍ الزُّرَقِيُّ وَاسْمُهُ زَيْدُ بْنُ صَامِتٍ وَأَبِي بَكْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ ذَهَبَ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ فِي صَلَاةِ الْخَوْفِ إِلَى حَدِيثِ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ . وَقَالَ أَحْمَدُ قَدْ رَوَى عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ صَلَاةَ الْخَوْفِ عَلَى أَوْجِهِ وَمَا أَعْلَمَ فِي هَذَا الْبَابِ إِلَّا حَدِيثًا صَحِيحًا وَأَخْتَارُ حَدِيثَ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ . وَهَكَذَا قَالَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ قَالَ تَبَيَّنَتِ الرِّوَايَاتُ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي صَلَاةِ الْخَوْفِ . وَرَأَى أَنَّ كُلَّ مَا رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي صَلَاةِ الْخَوْفِ فَهُوَ جَائِزٌ وَهَذَا عَلَى قَدْرِ الْخَوْفِ . قَالَ إِسْحَاقُ وَلَسْنَا نَخْتَارُ حَدِيثَ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ عَلَى غَيْرِهِ مِنَ الرِّوَايَاتِ .

³⁹² Nga këto dhe hadithet e tjera, mund të konkludohet se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) namazet katër trekateshe në situata kur ka ekzistuar frika nga armiku, sidomos në front e ka falur atë të shkurtuar. Së pari me të falej një grup dhe atë vetëm një rekat, ata shkonin në vijë dhe vinte grupi tjetër dhe falte rekatin e dytë me të. Pastaj, edhe grupi i parë edhe i dyti e falnin një rekat namaz (të mbetur) vetmas.

Kur dhe në cilën mënyrë ato dy grupe e falin edhe rekatin e dytë është diskutabile në mesin e vet dijetarëve.

Disa konsiderojnë, se pasi që imami e falë një rekat me grupin e parë, ka për të pritur që ai vetmas ta fal edhe një rekat dhe shkon në pozitë, pastaj me grupin e dytë e falë rekatin e dytë. Do të pres me selamin derisa grupi i dytë e falë rekatin e dytë, e ai së bashku me ta do të jap selam.

Dikush thotë që grupi i parë, pasi që me immin e falë një rekat, do të shkoj në pikë, e do të vijnë të tjerët dhe me imamin do të falin rekatin e dytë. Kur imami jep selam, këta do të ngriten dhe do ta falin edhe një rekat, pastaj përsëri kanë për të shkuar dhe zëvendësuar grupin e parë, që edhe ata, të falnin edhe një rekat.

Disa thonë, që imami me secilin grup ka për t’i falur nga dy rekate, rekatet e para kanë për të qenë farz për imamin, ndërsa dy të tjerat nafile. Në këtë mënyrë, asnjë grup, nuk ka për të pasur nevojë për të falur asgjë (më pas).

Disa thonë se grupi i parë, pasi që me imamin e falë një rekat, ka për të shkuar në pozitë, mandej kanë për të ardhur ata tjerët dhe kanë për ta falur me imamin rekatin e dytë. Kur e falin atë rekat, kanë për të shkuar dhe për t’i zëvendësuar grupin e parë derisa ai grup e falë rekatin e dytë. Kur e kryejnë faljen, atëherë ata e zëvendësojnë grupin e dytë që edhe ata ta falin rekatin e dytë.

Sa i përket farzit të akshamit, sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe të Malikut, imami me grupin e parë ka për t’i falur dy rekate, ndërsa me grupin e dytë një rekat. Shafi u dhe Ahmedi konsiderojnë, se mundet të veprohet edhe e kundërta e kësaj – me grupin e parë ka për të falur një rekat, ndërsa me dytin dy rekate. Falja e rekateve të mbetura shkon në të njëjtën mënyrë sikurse edhe te namazet dy rekateshe.

565. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Jahja b. Seid el-Kattani, atij i ka treguar Jahja b. Seid el-Ensari, ai ka transmetuar nga Kasim b. Muhammedi, ai nga Salih b. Havvat b. Xhubejri – që Sehl b. Ebu Hasemi, duke folur mbi namazin me rastin e frikës, ka thënë: “Imami do të qëndroj i kthyer në drejtim të kibles. Një grup do të qëndroi me të, ndërsa grupi tjetër do të qëndroj përballë armikut. Ai me ata, ka për ta falur një rekat, ndërsa një rekat ata kanë për ta falur vet dhe kanë për t’i bërë dy sexhde në vendin e vet. Pastaj, ata kanë për të shkuar në vendin e tyre, ndërsa ata kanë për të ardhur dhe kanë për ta falur me të një rekat dhe kanë për t’i bërë dy sexhde. Ai ka për t’i falur dy, ndërsa ata nga një rekat. Pastaj, ata kanë për ta falur (edhe) një rekat dhe kanë për t’i bërë dy sexhde (në vendin e vet).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْقَطَّانُ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيُّ، عَنْ الْقَاسِمِ بْنِ مُحَمَّدٍ، عَنْ صَالِحِ بْنِ خَوَاتِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ، أَنَّهُ قَالَ فِي صَلَاةِ الْخَوْفِ قَالَ يَقُومُ الْإِمَامُ مُسْتَقْبِلَ الْقِبْلَةِ وَتَقُومُ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ مَعَهُ وَطَائِفَةٌ مِنْ قِبَلِ الْعَدُوِّ وَوُجُوهُهُمْ إِلَى الْعَدُوِّ فَيَرْكَعُ بِهِمْ رُكْعَةً وَيَرْكَعُونَ لَأَنْفُسِهِمْ رُكْعَةً وَيَسْجُدُونَ لَأَنْفُسِهِمْ سَجْدَتَيْنِ فِي مَكَانِهِمْ ثُمَّ يَذْهَبُونَ إِلَى مَقَامِ أُولَئِكَ وَيَجِيءُ أُولَئِكَ فَيَرْكَعُ بِهِمْ رُكْعَةً وَيَسْجُدُ بِهِمْ سَجْدَتَيْنِ فَهِيَ لَهُ ثِنْتَانِ وَلَهُمْ وَاحِدَةٌ ثُمَّ يَرْكَعُونَ رُكْعَةً وَيَسْجُدُونَ سَجْدَتَيْنِ .

566. Muhammed b. Beshshari, thotë: “E pyeta Jahja b. Seidin, mbi këtë hadith, ai më tregoi, duke transmetuar nga Shu’be, ai nga Abdurrahman b. Kasimi, ai nga babai i vet, ai nga Salih b. Havvati, ai nga Sehl b. Ebu Hasemiu, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e Jahja b. Seid el-Ensarit. Ai më tha: ‘Shënoje atë afër tij. Unë nuk e kam mbajtur në mend, por është i njëjtë sikur hadithi i Jahja b. Seid el-Ensariut.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Jahja b. Seid el-Ensari, duke e transmetuar atë nga Kasim b. Muhammedi, nuk e lidh për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Nxënësit e Jahja b. Seidit, e kanë transmetuar si mevkuf, ndërsa për të Dërguarin, atë e ka lidhur Shu’be, duke transmetuar nga Abdurrahman b. Kasim b. Muhammedi.”

قَالَ أَبُو عِيسَى قَالَ مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ سَأَلْتُ يَحْيَى بْنَ سَعِيدٍ عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ، فَحَدَّثَنِي عَنْ شُعْبَةَ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ الْقَاسِمِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ صَالِحِ بْنِ خَوَاتِ، عَنْ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْظَلَةَ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ بِمِثْلِ حَدِيثِ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ . وَقَالَ لِي يَحْيَى الْكُتَيْبِيُّ إِلَى جُنْبِهِ وَلَسْتُ أَحْفَظُ الْحَدِيثَ وَلَكِنَّهُ مِثْلُ حَدِيثِ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . لَمْ يَرْفَعْهُ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيُّ عَنْ الْقَاسِمِ بْنِ مُحَمَّدٍ وَهَكَذَا رَوَى أَصْحَابُ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ مُؤَفَّوفاً وَرَفَعَهُ شُعْبَةُ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ الْقَاسِمِ بْنِ مُحَمَّدٍ .

567. Ka transmetuar, Malik b. Enes – atij ia ka transmetuar Jezid b. Rumani, atij Salih b. Havvati, ai nga ndokush i cili ka falur namaz me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me rastin e namazit të frikës – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Në pajtim me të janë qëndrimet e Malikut, Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me secilin nga dy grupet ka falur nga një rekat. Ashtu i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i falte dy, ndërsa ata një rekat. Ebu Isai thotë se emri i Ebu Ajash Zurekiut është Zejd b. Samit.

وَرَوَى مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ رُومَانَ، عَنْ صَالِحِ بْنِ خَوَاتِ، عَمَّنْ صَلَّى مَعَ النَّبِيِّ ﷺ صَلَاةَ الْخَوْفِ فَذَكَرَ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَبِهِ يَقُولُ مَالِكٌ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَرَوَى عَنْ غَيْرِ وَاحِدٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى بِأَحَدِي الطَّائِفَتَيْنِ رُكْعَةً رُكْعَةً فَكَانَتْ لِلنَّبِيِّ ﷺ رُكْعَتَانِ وَلَهُمْ رُكْعَةٌ رُكْعَةً . قَالَ أَبُو عِيسَى أَبُو عَبَّاسٍ الرَّقْفِيُّ اسْمُهُ زَيْدُ بْنُ صَامِتٍ .

394. Mbi sexhdet në Kur'an

باب مَا جَاءَ فِي سُجُودِ الْقُرْآنِ

568. Na ka treguar Sufjan b. Vakiu – atë e ka informuar Abdullah b. Vehbi, ai ka transmetuar nga Amër b. Harithi, ai nga Seid b. Ebu Hilali, ai nga Umer ed-Dimeshki,³⁹³ ai nga Ummu Derda – që Ebu Derda, ka thënë: “Me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i kam bërë njëmbëdhjetë sexhde, në mesin e të cilave është edhe ajo nga sureja En-Nexhm.”³⁹⁴

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Ibn Abbasi, Ebu Hurejre, Ibn Mes’udi, Zejd b. Thabiti dhe Amr b. Asi. Hadithi i Ebu Derdas është garib, nuk na është i njohur përveç, nëpërmjet Seid b. Ebu Hilalit, nga Umer ed-Dimeshki.”³⁹⁵

حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ وَكِيعٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ وَهْبٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي هِلَالٍ، عَنْ عُمَرَ الدِّمَشْقِيِّ، عَنْ أُمِّ الدَّرْدَاءِ، عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، قَالَ سَجَدْتُ مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ إِحْدَى عَشْرَةَ سَجْدَةً مِنْهَا الَّتِي فِي النَّجْمِ .

قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيِّ بْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَزَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ وَعَمْرِو بْنِ الْعَاصِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي الدَّرْدَاءِ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ سَعِيدِ بْنِ أَبِي هِلَالٍ عَنْ عُمَرَ الدِّمَشْقِيِّ .

569. Na ka treguar Abdullah b. Abdurrahmani – atë e ka informuar Abdullah b. Salih, atë Lejth b. Sa’di, ai ka transmetuar nga Halid b. Jezidi, ai nga Seid b. Ebu Hilali – që Umeri, i biri i Hajjan ed-Dimeshkit ka thënë: “E kam dëgjuar atë që më ka informuar nga Ummu Derda, ndërsa ajo ka transmetuar nga Ebu Derda: ‘Me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i kam bërë njëmbëdhjetë sexhde, në mesin e të cilave është edhe ajo nga sureja En-Nexhm.’”³⁹⁶

Ebu Isai thotë: “Kjo është më e besueshme se hadithi i Sufjan b. Vekiut, nga Abdullah b. Vehbiu.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ صَالِحٍ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ خَالِدِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي هِلَالٍ، عَنْ عُمَرَ، وَهُوَ ابْنُ حَبَّانَ الدِّمَشْقِيِّ قَالَ سَمِعْتُ مُخْبِرًا، يُخْبِرُ عَنْ أُمِّ الدَّرْدَاءِ، عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَهُ بَلْفَظِهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ سُفْيَانَ بْنِ وَكِيعٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ وَهْبٍ .

³⁹³ Umer b. Hajjani ed-Dimashki, sipas Ibn Haxher el-Askalanit, është ravi i panjohur.

³⁹⁴ Ekzistojnë ajete të caktuara, në të cilat kërkohet bërja e sexhdes. Ky lloj i sexhdes quhet sexhde-tilavet, e përbëhet vetëm nga një sexhde. Kur, gjatë leximit të Kur’anit lexohet ajeti i caktuar, duhet bërë sexhde, e cila sipas mendimit të Ebu Hanifes, është vaxhib, ndërsa sipas mendimit të dijetarëve të tjerë, është sunnet. Ajetet, të cilat përmbajnë urdhëresën për të bërë sexhde, sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe të Shafiut në Kur’an janë katërmëdhjetë, ndërsa sipas mendimit të Ahmedit dhe të Malikut, pesëmbëdhjetë.

Mbi këtë dhe hadithin në vijim, Ebu Derda thekson, se me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) duke lexuar dhe duke dëgjuar Kur’an, ka bërë njëmbëdhjetë sexhde. Abdurrahman el-Mubarekfuri konsideron, se ajo që Ebu Derda me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka bërë njëmbëdhjetë sexhde, nuk do të thotë se në Kur’an janë aq. Në hadithe të tjera, të cilët janë shumë më të besueshëm, nga të përmendurit, përmenden katërmëdhjetë, përkatësisht pesëmbëdhjetë sexhde. Përveç kësaj, të dy hadithet janë daif dhe mbi ta nuk mund të bazohet asnjë dispozitë.

³⁹⁵ El-Mubarekfuri, konsideron, që ky hadith është daif, për shkak që, në senedin e tij gjendet ravi Umer el-Dimashki, i cili është mexh’hul, e çdo hadith në senedin e të cilit gjendet ravi i panjohur, konsiderohet i dobët.

³⁹⁶ Edhe ky hadith është i dobët, sepse edhe në senedin e tij gjenden dy ravi të panjohur, Umer Ed-Dimashki dhe ai për të cilin Umer Ed-Dimashki ka thënë që e ka dëgjuar atë, i cili e ka lajmëruar duke transmetuar nga Ummu Derda. Ai, dikush, është i panjohur, sepse Umeri nuk ia ka përmendur emrin.

395. Mbi shkuarjen e gruas në xhami

باب مَا جَاءَ فِي خُرُوجِ النِّسَاءِ إِلَى الْمَسَاجِدِ

570. Na ka treguar, Nasr b. Aliu – atë e ka informuar Isa b. Junusi,³⁹⁷ ai ka transmetuar nga A'meshi – që Muxhahidi ka thënë: “Ishim tek Ibn Umeri, ai tregoi që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘Lejoni gratë që natën të shkojnë në xhami.’ I biri³⁹⁸ i tij, në atë tha: ‘Pasha Allahun, nuk kemi për t’i lejuar, që në to të bëjnë marrëzira!’ - ndërsa ai tha: “Allahu të dhëntë këtë dhe këtë,³⁹⁹ unë të them, që ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndërsa ti thua nuk kemi për t’i lejuar!”⁴⁰⁰

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Zejnebja bashkëshortja e Abdullah b. Mes’udit, dhe Zijad b. Hallidi. Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih.”⁴⁰¹

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا عِيسَى بْنُ يُونُسَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ مُجَاهِدٍ، قَالَ كُنَّا عِنْدَ ابْنِ عُمَرَ فَقَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " اِيْذْنُوا لِلنِّسَاءِ بِاللَّيْلِ إِلَى الْمَسَاجِدِ " . فَقَالَ ابْنُهُ وَاللَّهِ لَا نَأْذُنُ لَهُنَّ يَتَخَذْنَ دَعْلًا . فَقَالَ فَعَلَ اللَّهُ بِكَ وَفَعَلَ أَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَتَقُولُ لَا نَأْذُنُ لَهُنَّ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَرَبِيعَةَ الْأُمَّاءِ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَزَيْدِ بْنِ خَالِدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

396. Mbi mospëlqyeshmërinë e të pështynit në xhami

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الْبِرَاقِ فِي الْمَسْجِدِ

571. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Jahja b. Seidi, ai ka transmetuar nga Suffjani, ai nga Mensuri⁴⁰², ai nga Rib’ijj b. Hirashi,⁴⁰³ ai nga Tarik b. Abdullah el-Muharibi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur je në namaz, mos pështy në anën e djathtë, por prapa vetes ose në anën e majtë, ose nën thembrën tënde të majtë.”⁴⁰⁴

³⁹⁷ Isa b. Junus b. Ebu Is’hak es-Sebijji është vëllai i Israil el-Kufit. Shquhej si ravi i besueshëm dhe besnik.

³⁹⁸ Mundhiri konsideron, që këtu është fjala, mbi të birin e Ibn Umerit, Bilalin, derisa, disa supozojnë që ka të bëjë me Zekidin.

³⁹⁹ Në transmetimin e Muslimit, të këtij hadithi nga Bilali, qëndron, që Ibn Umeri e ka qortuar të birin e vet ashpër për shkak të fjalëve, me të cilat e kundërshtonte të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁴⁰⁰ Për gratë, është më mirë që të falen në shtëpi. Ebu Davudi, në *Sunen*, shënon nga Ibn Umeri, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos i ndaloni gratë të shkojnë në xhami, por për ato është më mirë të falen në shtëpinë e vet? Shënojnë Ahmedi në *Musned* dhe Taberaniu në *Mu’xhemul-kebir*, që Ummu Humejd es-Seidijje ka ardhur tek i Dërguari i Allahut dhe ka thënë “I Dërguari i Allahut, unë kam dëshirë që namazin ta fali me ty.” “Ai i tha: “E ke të ditur, që namazin të cilin e bënë në dhomë, është më i mirë se namazi, të cilin e bënë në paradhomë. Ndërsa, namazi të cilin e bënë në paradhomë, është më i mirë sesa ai të cilin e bënë në shtëpi. Namazi në shtëpi, është më i mirë, se namazi, të cilin e bënë në xhaminë e lagjes. Namazi, të cilin e bënë në xhaminë e lagjes, është më i mirë, se ai të cilin e bënë në xhaminë qendrore.” Ndërkaq, gratë nëse dëshirojnë, mund të falen në xhami, me kusht, që t’i përmbahen normave të caktuara të sjelljes, siç janë: që të mos shminkohen dhe të mos parfumohen, të mos stolisen kur shkojnë në xhami, që gjatë shkuarjes dhe kthimit nga xhamia, të mos përzihen me meshkuj, që me sjelljen e tyre të mos nxisin imoralitet dhe të ngjashme.

⁴⁰¹ E shënon, Buhariu, në formë diç më të shkurtër, e Muslimi në formë më të gjatë.

⁴⁰² Mensur b. Mu’temir El-Kufi, është ravi i besueshëm dhe i sigurt.

⁴⁰³ Rib’ijj Hirash el-Kufi u përket muhadremëve (njerëzve që kanë jetuar në kohën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), por, nuk e kanë parë atë dhe as nuk janë takuar me të). Shquhet si ravi i besueshëm dhe i nënshtruar.

⁴⁰⁴ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Buhariu, nga Ebu Hurejre, qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndokush nga ju hyn në namaz, të mos pështy para

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi, Ibn Umeri, Enesi dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Tarikut është hasen-sahih.⁴⁰⁵ Sipas tij, sillen dijetarët. E kam dëgjuar Xharudin, duke treguar: “E kam dëgjuar Vakiun, kur ka thënë: “Rib’ijj b. Hirashi në islam nuk ka gënjyer kurrë.” Abdurrahman b. Mehdiu, ka thënë: “Mensur b. Mu’temir, është në mesin e dijetarëve më të sigurt Kufjan.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ رَبِيعِ بْنِ جَرَّاشٍ، عَنْ طَارِقِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْمُحَارِبِيِّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا كُنْتَ فِي الصَّلَاةِ فَلَا تَبْزُقْ عَنْ يَمِينِكَ وَلَكِنْ خُلْفَكَ أَوْ تَلْقَاءَ شِمَالِكَ أَوْ تَحْتَ قَدَمِكَ الْيُسْرَى " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَابْنِ عُمَرَ وَأَنْسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ طَارِقٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ . قَالَ وَسَمِعْتُ الْجَارُودَ يَقُولُ سَمِعْتُ وَكِيعًا يَقُولُ لَمْ يَكْذِبْ رَبِيعُ بْنُ جَرَّاشٍ فِي الْإِسْلَامِ كُذِبَهُ . قَالَ وَقَالَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مُهْدِيٍّ أَثْبَتَ أَهْلُ الْكُوفَةِ مَنْصُورُ بْنُ الْمُعْتَمِرِ .

572. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avani, ai ka transmetuar nga Katade, ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Të pështynit nëpër xhami është mëkat, ndërsa shpagimi për atë është që ajo pështymë të mbulohej (të pastrohet).” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁰⁶

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " الْبُزَاقُ فِي الْمَسْجِدِ خَطِيئَةٌ وَكَفَّارَتُهَا دَفْنُهَا " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

397. Mbi sexhdet në suret Izes-semaun-shekkat dhe Ikre bismi Rrabbike-ledhi haleka

بَاب مَا جَاءَ فِي السَّجْدَةِ فِي (اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ) وَ (إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ)

573. Na ka treguar Kutejbe b. Seidi – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, duke transmetuar nga Ejub b. Musai, ai nga Ata b. Minai⁴⁰⁷ - që Ebu Hurejre, ka thënë: “Ne, me të Dërguarin e Allahut bënim sexhde në Suret *Ikre bismi Rrabbike-ledhi haleka* dhe *Idhas-semau-nshekkat*.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ أَيُّوبَ بْنِ مُوسَى، عَنْ عَطَاءِ بْنِ مِينَاءَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ سَجَدْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي (اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ) وَ (إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ)

574. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Sufjani, ai ka transmetuar nga Jahja b. Seidi, ai nga Ebu Bekër b. Muhammed b. Amër b. Hazmi, ai nga Umer b. Abdulazizi, ai nga Ebu Bekr b. Abdurrahman b. Harith b. Hishami, ai nga Ebu Hurejre, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – sikurse hadithi i mëparshëm.

vetes, sepse është i kthyer kah Allahu dhe flet me të, derisa është në namaz. Të mos pështyj as në anën e djathtë, sepse në anën e djathtë është melaikja. Nëse është i detyruar të pështyj, le të pështyj prapa vetes, nëse nuk është askush duke u falur prapa tij.” Hattabi, thotë: “Nëse ndokush është duke u falur prapa tij, ose nga ana e tij e majtë, të mos pështyj në asnjë anë, por nën thembrën e majtë të këmbës së vet.”

Ndonjëherë, personi është i detyruar, derisa është në namaz, ta hedhë pështymën, sepse i është grumbulluar aq shumë, sa që nuk mund të lexoj. Në kushtet tona, personi, atë ka për ta bërë ashtu, duke e nxjerr faculetën nga xhepi dhe duke e hequr pështymën në të. Në kohën e të Dërguarit, xhamitë nuk kanë qenë të shtruara, por namazi falej në tokë, përkatesisht mbi rërë. Prandaj, i Dërguari i Allahut i ka lejuar as’habët që nëse kanë qenë të detyruar, mund të pështynë në xhami, prapa vetes, në anën e majtë, ose nën këmbën e majtë. Ai ka theksuar, që ajo mund të bëhet vetëm në nevojë, por që pështymja në xhami, për shkak të domosdoshmërisë, mëkatit e tillë mund ta shpaguej, vetëm duke e propozur pështymën në tokë ose në rërë, që të mos mbetet në sipërfaqe.

⁴⁰⁵ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

⁴⁰⁶ E shënojnë edhe Buhariu edhe Muslimi në *Sahihë*.

⁴⁰⁷ Ata b. Mina është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së tretë të ravive të hadithit.

Ebu Isai, thotë: “Në senedin e këtij hadithi, katër tabi’inë e transmetojnë njëri nga tjetri.⁴⁰⁸ Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.⁴⁰⁹ Sipas tij veprojnë shumica e dijetarëve. Ata konsiderojnë, që duhet bërë sexhde në suret *Idhas-semaun-shekkat* dhe *Ikre bismi Rrabbike-ledhi haleka*.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ بْنُ مُحَمَّدٍ، هُوَ ابْنُ عُمَرَ بْنِ حَزْمٍ عَنْ عُمَرَ بْنِ عَبْدِ الْعَزِيزِ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ الْحَارِثِ بْنِ هِشَامٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِثْلَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ يَرَوْنَ السُّجُودَ فِي (إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ) وَ (اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ) . وَفِي هَذَا الْحَدِيثِ أَرْبَعَةٌ مِنَ التَّابِعِينَ بَعْضُهُمْ عَنْ بَعْضٍ .

398. Mbi sexhdet në suren *En-Nexhm*

باب مَا جَاءَ فِي السُّجْدَةِ فِي النَّجْمِ

575. Na ka treguar Harun b. Abdullah el-Bezzari – atë e ka informuar Abdussamed b. Abdulvarith, atë babai i tij, ai ka transmetuar nga Ejubi, ai nga Ikrimë – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka bërë sexhde duke recituar atë d.m.th. suren *En-Nexhm*, ndërsa atë të njëjtën e kanë bërë edhe muslimanët edhe xhinët edhe njerëzit.”⁴¹⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Mes’udi dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih. Sipas tij veprojnë disa dijetarë, të cilët pretendojnë që ekziston sexhdeja në suren *En-Nexhm*. Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve, konsiderojnë, që në suret *El-Mufesal* nuk ka sexhde. Ky është qëndrimi edhe i Malik b. Enesit. Ndërkaq, mendimi i parë është më i drejtë. Atë e mbështesin *Eth-Thevriu*, *Ibn Mubareku*, *Shafiu*, *Ahmedi* dhe *Is’haku*.

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الْبَزْازِيُّ الْبَغْدَادِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الصَّمَدِ بْنُ عَبْدِ الْوَارِثِ، حَدَّثَنَا أَبِي، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ سَجَدَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فِيهَا - يَغْنِي النَّجْمَ - وَالْمُسْلِمُونَ وَالْمُشْرِكُونَ وَالْجِنُّ وَالْإِنْسُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ يَرَوْنَ السُّجُودَ فِي سُورَةِ النَّجْمِ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ لَيْسَ فِي الْمَفْصَلِ سَجْدَةٌ . وَهُوَ قَوْلُ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ وَبِهِ يَقُولُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ .

⁴⁰⁸ Këta janë, katër tabi’inët e tjerë: Jahja b. Seidi, Ebu Bekër b. Muhammed b. Amr b. Hazëm, Umer b. Abdulaziz dhe Ebu Bekër b. Abdurrahman b. Harith b. Hisham.

⁴⁰⁹ E kanë shënuar, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut.

⁴¹⁰ Kjo ka ndodhur në Mekke, në Haremish-sherif. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e lexonte suren *En-Nexhm*. Kur e lexoi ajetin e fundit, e bëri sexhden. atë e bënë të gjithë ata që ishin me të në Harem, si muslimanët ashtu edhe idhujtarët, njerëzit dhe xhinët. Duke u përpjekur ta sqaronte se përse mushkrikët kanë bërë sexhde me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Kermani i paraqet tre shkaqe të mundura.

a) Sepse kjo ka qenë sexhdeja e parë e shpallur, mushrikët duke bërë sexhde dëshironin t’i tregonin se janë më të mirë se muslimanët, sepse ata i bëjnë sexhde Zotit të tyre, ndërsa muslimanët nuk dëshirojnë t’i bëjnë idhujve të tyre;

b) Mushrikët, pavetëdije kundër vullnetit personal, spontanisht me muslimanët kanë rënë në sexhde; Mushrikët kishin frikë nga muslimanët, në rast se nuk do ta kishin bërë atë. Këtë, Ibn Haxher el-Askalani e përjashton si shkak i mundshëm, sepse në atë kohë muslimanët numerikisht ishin të pakët.

399. Mbi atë i cili e reciton suren En-Nexhm dhe nuk e bënë sexhden

باب مَا جَاءَ مَنْ لَمْ يَسْجُدْ فِيهِ

576. Na ka treguar, Jahja b. Musai – atë e ka informuar Vekiu, ai ka transmetuar nga Ibn Ebu Zi'biu,⁴¹¹ ai nga Jezid b. Abdullah b. Kusejti,⁴¹² ai nga Ata b. Jesari – që Zejd b. Thabiti ka thënë: “Ia recitova suren En-Nexhm të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe ai nuk bëri sexhde në të.”⁴¹³

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Zejd b. Thabitit është hasen-sahih.”

Disa dijetarë, këtë hadith e kanë sqaruar, duke thënë se, i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) nuk ka bërë sexhde, sepse Zejd b. Thabiti, i cili ka lexuar Kur'an, nuk e ka bërë atë, prandaj, për shkak të asaj nuk e ka bërë as ai.”⁴¹⁴

Ata kanë thënë: “Sexhdeja është vaxhib për atë i cili e dëgjon atë, nuk lejohet që ajo të anashkalohej.”⁴¹⁵

Disa thonë: “Në rast se personi i cili nuk ka avdes dhe e dëgjon sexhden, atë ka për ta bërë pasi të merr avdest.” Ky është qëndrimi i Sufjanit dhe i dijetarëve të Kufës. Ndërsa, kështu konsideron edhe Is'haku.

Disa dijetarë, konsiderojnë, që sexhdeja nuk është e obliguar⁴¹⁶ dhe që atë ka për ta bërë ai i cili gjurmon pas fadileteve të saja. Ata thonë: “Atë ka për ta bërë, ai që dëshiron. Ata me qëndrim të këtyllë thirren mbi hadithin – merfu të Zejd b. Thabitit: “Ia recitova suren En-Nexhm të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ai nuk bëri sexhde. Sikur sexhdja të ishte e obliguar,” – pohojnë ata -, “i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk do ta anashkalonte për t'ia tërhequr vërejtjen Zejdit, që ta bënte atë, por edhe ai vet do ta kishte bërë atë.” Ata thirren edhe mbi

⁴¹¹ Muhammed b. Abdurrahman b. Mugire b. Harith Ibn Ebul Zib el-Kureshi el-Medeni, është ravi i besueshëm. Shquhet si njohës i madh i të drejtave sheriatike.

⁴¹² Jezid b. Abdullah b. Kusejt, është ravi i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së katër të ravive.

⁴¹³ Këtë hadith e marrin si argument, pasuesit e shkollës të jurisprudencës malikite, të cilët konsiderojnë, që në suren El-Mufessal nuk ka sexhde. Ebu Thevriu, me këtë sure, argumenton, që në suren En-Nexhm, nuk ekziston sexhdeja, derisa Ibn Haxheri, konsideron, se mos-bërja e sexhdes tilavet, pas leximit të kësaj sureje, në këtë rast, nuk do të thotë, se në të nuk ekziston sexhdeja. Ndoshta, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), këtë herë nuk e ka bërë sexhde-tilavetin, sepse ndoshta, në atë moment, nuk ka pasur avdes apo është gjendur në kohën, në të cilën bërja e sexhdes është mekruh, ose ndoshta atë e ka lënë me qëllim, që me atë t'u tregonte se ajo nuk është e obliguar, siç pohon Shafiu.

⁴¹⁴ El-Mubarekfuri, konsideron, se ai që lexon Kur'an në bërjen e sexhde tilavet, është imam i atyre që janë duke e dëgjuar atë. Pasi që Zejd b. Thabiti, si imam, nuk e ka bërë sexhde-tilavetin, nuk e ka bërë as i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). El-Mubarekfuri, kur e pohon këtë, ai mbështetet në hadithet në vijim: Temim b. Hazlemi thotë: “Si djalë i ri, i lexoja Kur'an Abdullah b. Mes'udit. Pasi, pas sexhdes së lexuar nuk e bëra sexhdenë, Abdullahu më tha: “Bëje sexhden, sepse në atë ti je imam.” (Buhariu) Ibn Ebu Shejbe shënon, me sened nga Zejd b. Esleme: “Një djalosh, tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), lexonte Kur'an. Kur e ka lexuar sexhden, priste, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të bënte sexhde. Pasi që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e bëri sexhden, ai tha: “O i Dërguar i Allahut, a nuk ekziston sexhdeja në këtë sure?” “Ekziston.” – tha i Dërguari i Allahut - “por në të, ti je imam. Sikur ta kishe bërë ti sexhden edhe ne do ta kishim bërë atë.”

⁴¹⁵ Ebu Hanifë konsideron, që është vaxhib bërja e sehvi-sexhdes edhe për atë, i cili lexon Kur'an edhe për atë i cili e dëgjon atë. Mendimin e vet e bazon në ajetin “*përveç atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të shpërblehen pandërprerë.*” (El-Inshikak: 25) “*Kurrsesi mos iu nënshiro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!*” (El-Alak: 19)

⁴¹⁶ Shafiu, Maliku, Ahmed b. Hanbeli, Is'haku, Evzaiu dhe Davudi konsiderojnë, që bërja e sexhdes-tilavet është sunnet. Ata mbështeten mbi hadithin e përmendur, të Zejd b. Thabitit.

hadithin e Umerit, në të cilin qëndron se ai mbi minber e ka recituar sexhden, mandej ka zbritur nga minberi dhe e ka bërë. Pastaj të premtën e dytë, përsëri e ka recituar atë dhe, derisa njerëzit bëheshin gati për ta bërë atë, ai ka thënë: “Atë nuk e kemi të obliguar, përveç nëse dëshirojmë.” Prandaj, nuk e ka bërë, por as xhematit nuk e kanë bërë. Disa dijetarë e kanë pranuar këtë mendim. Ky është qëndrimi i Shafiut dhe i Ahmedit.

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ ابْنِ أَبِي ذُنَيْبٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ قُسَيْطٍ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ، قَالَ قَرَأْتُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ النِّجْمَ فَلَمْ يَسْجُدْ فِيهَا . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَتَأْوِيلُ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ هَذَا الْحَدِيثُ فَقَالَ إِنَّمَا تَرَكَ النَّبِيُّ ﷺ السُّجُودَ لِأَنَّ زَيْدَ بْنَ ثَابِتٍ حِينَ قَرَأَ فَلَمْ يَسْجُدْ لَمْ يَسْجُدِ النَّبِيُّ ﷺ . وَقَالُوا السُّجُودُ وَاجِبَةٌ عَلَى مَنْ سَمِعَهَا فَلَمْ يَرْجِعُوا فِي تَرْكِهَا . وَقَالُوا إِنْ سَمِعَ الرَّجُلُ وَهُوَ عَلَى غَيْرِ وَضُوءٍ فَإِذَا تَوَضَّأَ سَجَدَ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ وَبِهِ يَقُولُ إِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِنَّمَا السُّجُودُ عَلَى مَنْ أَرَادَ أَنْ يَسْجُدَ فِيهَا وَالتَّمَسُّ فَضْلُهَا وَرَخَّصُوا فِي تَرْكِهَا إِنْ أَرَادَ ذَلِكَ . وَاحْتَجُّوا بِالْحَدِيثِ الْمَرْفُوعِ حَدِيثِ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ حَيْثُ قَالَ قَرَأْتُ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ النِّجْمَ فَلَمْ يَسْجُدْ فِيهَا . فَقَالُوا لَوْ كَانَتْ السُّجُودُ وَاجِبَةً لَمْ يَتْرُكِ النَّبِيُّ ﷺ زَيْدًا حَتَّى كَانَ يَسْجُدُ وَيَسْجُدُ النَّبِيُّ ﷺ . وَاحْتَجُّوا بِحَدِيثِ عُمَرَ أَنَّهُ قَرَأَ سَجْدَةً عَلَى الْمُنْبَرِ فَزَلَّ فَسَجَدَ ثُمَّ قَرَأَهَا فِي الْجُمُعَةِ الثَّانِيَةِ فَتَهَيَّأَ النَّاسُ لِلْسُّجُودِ فَقَالَ إِنَّهَا لَمْ تُكْتَبْ عَلَيْنَا إِلَّا أَنْ نَشَاءَ . فَلَمْ يَسْجُدْ وَلَمْ يَسْجُدُوا . فَذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ .

400. Mbi sexhden në suren Sad

باب مَا جَاءَ فِي السَّجْدَةِ فِي ص

577. Na ka treguar Ibn Umeri – atë e ka informuar Sufjani, ai ka transmetuar nga Ejubi, ai nga Ikrimë – që Ibn Abbasi, ka thënë: “E kam parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) kur ka bërë sexhde në suren Sa’d.”⁴¹⁷ Ibn Abbasi, ka thënë: “Ajo nuk i takon radhës së sexhdeve të obliguara.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴¹⁸

Në këtë, janë ndarë dijetarët nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Disa konsiderojnë, që në suren Sa’d duhet bërë sexhde. Ky është mendimi i Sufjanit, Ibn Mubarekut, Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut. Disa thonë, që ajo sexhde e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë sexhdeja e pendimit dhe në të nuk janë duke e parë sexhden tilavet.

حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ رَأَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَسْجُدُ فِي ص . قَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ وَلَيْسَتْ مِنْ عَزَائِمِ السُّجُودِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَاحْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي ذَلِكَ فَزَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ يَسْجُدَ فِيهَا . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِنَّهَا تَوْبَةُ نَبِيِّ وَلَمْ يَرَوْا السُّجُودَ فِيهَا .

401. Mbi sexhden në suren Haxhxxh

باب مَا جَاءَ فِي السَّجْدَةِ فِي الْحَجِّ

578. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ibn Lehiu,⁴¹⁹ ai ka transmetuar nga Mushreh b. Ha’ani⁴²⁰ - që Ukbe b. Amiri, ka thënë: “Unë thash: “O i Dërguari i Allahut, a dallohet sureja Haxhxxh

⁴¹⁷ Në bazë të këtij hadithi, Sufjan eth-Thevriu, Ibn Mubareku, Shafiut, Ahmedit, Is’haku dhe Ebu Hanife, e kanë vërtetuar, që në suren Sa’d ekziston sexhdja. Ibn Mes’udi, Ata’ dhe Alkami, konsiderojnë, që në suren Sa’d nuk ekziston sexhdja, por që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atë sexhde e ka bërë për shkak të teubes ose falënderimit për shkak të Allahut të Lartësuar – sexhdetush-shukr.

⁴¹⁸ Atë e shënojnë, Buhariu në *Sahih*, Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

⁴¹⁹ Abdullah b. Lehi, është ravi i dobët.

me atë që i përmban dy sexhde?” “Po.” – tha ai: “Dhe të mos e recitoj ai që nuk i bënë dy sexhde.” Ebu Isai thotë: “Senedi i këtij hadithi nuk është i fuqishëm.”⁴²¹

Në këtë, janë ndarë dijetarët. Është transmetuar, që Umer b. Hattabi dhe Ibn Umeri kanë thënë: “Sureja HaxhXH dallohet me dy sexhde.” Kështu mendojnë Ibn Mubareku, Shafi'u, Ahmedi dhe Is'haku.

Disa, siç janë, Sufjan eth-Thevriu, Maliku dhe dijetarët e Kufes, konsiderojnë, që në të është vetëm një sexhde.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا ابْنُ لَهْيَعَةَ، عَنْ مِشْرِحِ بْنِ هَاعَانَ، عَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ، قَالَ قُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ فَصَلَّاتُ سُورَةِ الْحَجِّ بَأَنِّ فِيهَا سَجْدَتَيْنِ قَالَ " نَعَمْ وَمَنْ لَمْ يَسْجُدْهُمَا فَلَا يَقْرَأَهُمَا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ لَيْسَ إِسْنَادُهُ بِذَلِكَ الْقَوِيِّ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي هَذَا فَرَوَى عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ وَابْنَ عُمَرَ أَنََّّهُمَا قَالَا فَصَلَّاتُ سُورَةِ الْحَجِّ بَأَنِّ فِيهَا سَجْدَتَيْنِ . وَبِهِ يَقُولُ ابْنُ الْمُبَارَكِ وَالسَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَرَأَى بَعْضُهُمْ فِيهَا سَجْدَةً وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَمَالِكٍ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ .

402. Mbi atë se çfarë shqiptohet në sexhdet për recitimn e Kur'anit

باب مَا يَقُولُ فِي سُجُودِ الْقُرْآنِ

579. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Muhammed b. Jezid b. Hunejthi,⁴²² atë Hasan b. Muhammed b. Ubejdullah b. Ebu Jezidi, atë Ibn Xhurejxhi, atë Ubejdullah b. Ebu Jezidi – që Ibn Abbasi, ka thënë: “Erdhi një njeri⁴²³ tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: “I Dërguari i Allahut, mbrëmë, derisa isha duke fjetur, në ëndërr pashë që isha duke u falur prapa një druri. E bëra sexhden,⁴²⁴ por, edhe druri duke më pasuar mua, e bëri sexhde. E dëgjova se si fliste (në sexhde): “*O Allah, ma shëno atë te Ti në veprat e mira! Largoje, përmes saj, barën (mëkatet) nga unë! Ma bëjë atë te Ti thesar dhe pranoje nga unë, siç e ke pranuar nga rob i Yt Davudi.*” Hasani, thotë: “Mua më ka treguar Ibn Xhurejxhi: “Mua, më ka treguar gjyshi yt⁴²⁵, që Ibn Abbasi, ka thënë: ‘I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e recitoi ajetin në sexhde, e pastaj bëri sexhden. E kam dëgjuar që në të, shqiptonte mu ashtu siç e ka informuar ai njeri – atë çfarë ka shqiptuar ai druri.’”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Seidi. Ky hadith është garib.”⁴²⁶ Ne, nga Ibn Abbasi, atë e njohim vetëm në këtë formë.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَزِيدَ بْنِ خُنَيْسٍ، حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ مُحَمَّدٍ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي يَزِيدَ، قَالَ قَالَ لِي ابْنُ جُرَيْجٍ يَا حَسَنُ أَخْبَرَنِي عَبْدُ اللَّهِ بْنُ أَبِي يَزِيدَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ جَاءَ رَجُلٌ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّي رَأَيْتُنِي اللَّيْلَةَ وَأَنَا نَائِمٌ كَأَنِّي أَصَلِّيَ خَلْفَ شَجَرَةٍ فَسَجَدْتُ فَسَجَدَتِ الشَّجَرَةُ لِسُجُودِي فَسَمِعْتُهَا وَهِيَ تَقُولُ اللَّهُمَّ اكْتُبْ لِي بِهَا عِنْدَكَ أَجْرًا وَصَنَعْتُ عَنِّي بِهَا وَرَرًا وَاجْعَلْهَا لِي عِنْدَكَ ذُخْرًا

⁴²⁰ Mishreh b. Hasan, është tabi'inë. Ibn Haxheri, atë e konsideron ravi të kënaqshëm. Dhehebi, në veprën *Mizan*, thotë, që është ravi i sinqertë.

⁴²¹ Sepse, në të gjendet raviu i dobët, Ibn Lehi. Ndërkaq, këtë hadith të njëjtë, e shënon Hakimi në *Mustedrek*, me sened të besueshëm.

⁴²² Muhammed b. Jezid b. Hunejsi, sipas vlerësimit të Ibn Haxherit, është ravi, i cili është i kënaqshëm. Ibn Hibbani, atë e radhit në ravitë e besueshëm.

⁴²³ Ai ka qenë Ebu Seid el-Hudriu.

⁴²⁴ Ebu Mubarekfuri, thotë: “Ekziston mundësia, që kjo ka të bëjë me sexhden e namazit, por, shumë më e sigurt është, që fjala është mbi sexhden-tilavet, të cilën e ka bërë, pasi që ka lexuar ajetin sexhde nga sureja sa’d.

⁴²⁵ I cili quhej Abdullah b. Ebu Zejd.

⁴²⁶ E kanë shënuar edhe Ibn Hibbani në *Sahih*, Hakimi në *Mustedrek* dhe Ibn Maxhe në *Sunen*. Dhehebi, atë e konsideron të besueshëm, derisa Ukajli e konsideron hadith të dobët, sepse në senedin e tij gjendet raviu Hasan b. Muhammed b. Ubejdullah b. Ebu Zejd, gjendja e të cilit nuk është e njohur.

وَتَقَبَّلَهَا مِنِّي كَمَا تَقَبَّلَتْهَا مِنْ عَبْدِكَ دَاوُدَ . قَالَ الْحَسَنُ قَالَ لِي ابْنُ جُرَيْجٍ قَالَ لِي جَدُّكَ قَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ فَقَرَأَ النَّبِيُّ ﷺ سَجْدَةً ثُمَّ سَجَدَ . قَالَ فَقَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ فَسَمِعْتُهُ وَهُوَ يَقُولُ مِثْلَ مَا أَخْبَرَهُ الرَّجُلُ عَنْ قَوْلِ الشَّجَرَةِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ حَدِيثِ ابْنِ عَبَّاسٍ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

580. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Abdulvehab es-Sekafi, atë e ka informuar Halid el-Hadha, ai ka transmetuar nga Ebu Aliu – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbi sexhden kur’anore gjatë natës, thoshte: “Fytyra ime i ka ra në sexhde Atij që atë e ka krijuar dhe ia dha të dëgjuarit dhe të parit, me Mundësinë dhe Fuqinë e Tij!” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴²⁷

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ النَّخَعِيُّ، حَدَّثَنَا خَالِدُ الْحَذَّاءُ، عَنْ أَبِي الْعَالِيَةِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ فِي سُجُودِ الْقُرْآنِ بِاللَّيْلِ " سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ بِحَوْلِهِ وَقُوَّتِهِ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

403. Mbi atë, të cilit, i ka ikur vitri i natës dhe ai e ka kompensuar atë, duke e bërë gjatë ditës

باب مَا ذَكَرَ فِيمَنْ فَاتَهُ حَرْبُهُ مِنَ اللَّيْلِ فَقَضَاهُ بِالنَّهَارِ

581. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Safvani, ai ka transmetuar nga Junusi,⁴²⁸ ai nga Ibn Shihabi, që atë e kanë informuar Saib b. Jezidi dhe Ubejdullahu,⁴²⁹ duke transmetuar nga Abdurrahman b. Abdul-Kariu, ai nga Umer b. Hattabi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush fle dhe nuk e reciton një fragment (nga Kur’ani), ose një pjesë të tij (të cilën rregullisht e ka praktikuar) ta lexojë natën dhe atë e lexon në mes namazit të sabahut dhe të drekës, ka për t’iu shënuar sikur ta kishte recituar atë gjatë natës.”⁴³⁰

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴³¹ Emri i Ebu Safvanit është Abdullah b. Seid el-Mekki,⁴³² nga ai hadithe kanë transmetuar Humejdi dhe njerëzit tjerë të mëdhenj.”⁴³³

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو صَفْوَانَ، عَنْ يُونُسَ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ الزُّهْرِيِّ، أَنَّ السَّائِبَ بْنَ يَزِيدَ، وَعُيَيْنَةَ اللَّهَ بْنَ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُثْمَةَ بْنَ مَسْعُودٍ، أَخْبَرَاهُ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَبْدِ الْقَارِيِّ، قَالَ سَمِعْتُ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ، يَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ نَامَ عَنْ حَرْبِهِ أَوْ عَنْ شَيْءٍ مِنْهُ فَقَرَأَهُ مَا بَيْنَ صَلَاةِ الْفَجْرِ وَصَلَاةِ الظُّهْرِ كُتِبَ لَهُ كَأَنَّمَا قَرَأَهُ مِنَ اللَّيْلِ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَأَبُو صَفْوَانَ اسْمُهُ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ سَعِيدٍ الْمَكِّيُّ وَرَوَى عَنْهُ الْخُمَيْدِيُّ وَكِبَارُ النَّاسِ .

⁴²⁷ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Bejhekiu në *Sunenë* dhe Hakimi në *Mustedrek*. Ibn Sekeni, atë e vlerëson të besueshëm.

⁴²⁸ Junus b. Jezidi.

⁴²⁹ Ubejdullah b. Umer b. Hafs b. Asim b. Umeri b. Hatabi el-Umari, është ravi i besueshëm i sigurt i hadithit.

⁴³⁰ Disa persona, praktikojnë bërjen e përditshme të diçkaje jo-obligative, si është falja e numrit të caktuar të rekateve apo leximin nga Kur’ani dhe të ngjashme. Ajo vepër, jo e obliguar, të cilën ndokush e praktikon rregullisht, quhet vird. Në këtë hadith, Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka shpjeguar, që ajo, çfarë praktikohet natën, në rast se i kalon pa e bërë , mund ta kompensojë ditën. Analogjikisht me atë edhe ajo që praktikohet të bëhet ditën, në rast se lëshohet pa e bërë, mund të kompensohet natën. Shënon Muslimi në *Sahih* dhe Tirmidhiu në *Xhami*, që Aishja ka thënë: “Në rast se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për shkak të përgjumurit ose sëmundjes, nuk ka mundur ta falte namazin e natës, ai ditën i falte dymbëdhjetë rekate.”

⁴³¹ E kanë shënuar të gjithë, në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut.

⁴³² Ebu Safvani, Abdullah b. Seidi el-Meki, sipas mendimit të Ibn Haxherit, është i besueshëm. I takonte gjeneratës së nëntë të ravive.

⁴³³ Siç janë, Ali b. Medini, Ahmed b. Hanbeli dhe të tjerët.

404. Paralajmërimi i rreptë, ndaj atij që e ngrit kokën para imamit

بَاب مَا جَاءَ مِنَ التَّشْدِيدِ فِي الَّذِي يَرْفَعُ رَأْسَهُ قَبْلَ الْإِمَامِ

582. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, duke transmetuar nga Muhammed b. Zijadi,⁴³⁴ ndërsa, ai në të vërtetë është Ebu Harith el-Basriu, ai nga Ebu Hurejre – që Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Vallë, a nuk është duke u frikësuar ai, që e ngrit kokën para imamit, që Allahu të mos ia shndërroj atë në kokë gomari.”⁴³⁵

Kutejbe, duke transmetuar nga Hammadi, thotë, që Muhammed b. Zijadi, ka thënë: “Ai fjalë për fjalë ka thënë: ‘Vallë, a nuk është duke u frikësuar?’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴³⁶ Muhammed b. Zijadi nga Basra është ravi i besueshëm. Kunja e tij (sipas fëmijës) është Ebu Harith.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ زَيْدٍ، وَهُوَ أَبُو الْخَارِثِ الْبَصْرِيُّ ثَقَّةٌ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ مُحَمَّدٌ ﷺ " أَمَا يَخْشَى الَّذِي يَرْفَعُ رَأْسَهُ قَبْلَ الْإِمَامِ أَنْ يَحُولَ اللَّهُ رَأْسَهُ رَأْسَ جَمَارٍ " . قَالَ قُتَيْبَةُ قَالَ حَمَّادٌ قَالَ لِي مُحَمَّدُ بْنُ زَيْدٍ وَإِنَّمَا قَالَ " أَمَا يَخْشَى " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَمُحَمَّدُ بْنُ زَيْدٍ هُوَ بَصْرِيُّ ثَقَّةٌ وَيُكْنَى أَبُو الْخَارِثِ .

405. Mbi atë që i ka falur fardet dhe pastaj përsëri u bëhet imam njerëzve

بَاب مَا جَاءَ فِي الَّذِي يُصَلِّي الْفَرِيضَةَ ثُمَّ يَوْمُ النَّاسِ بَعْدَ مَا صَلَّى

583. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, ai ka transmetuar, nga Amr b. Dinari – që Xhabir b. Abdullahu, ka thënë: “Muadh b. Xhebeli (nganjëherë) e falte akshamin me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pastaj kthehej te populli i vet dhe falej me të si imam i tyre.”⁴³⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴³⁸ Sipas këtij kanë vepruar kolegët tanë (dijetarët e hadithit), Shafiu, Ahmedi dhe Is’haku.⁴³⁹ Ata, kanë thënë: “Në rast se ndokush, pasi që e ka falur namazin fard, përsëri falet si imam, namazi i atyre, të cilët falen pas tij, është i drejtë.” Ata me qëndrim të këtille, thirren mbi hadithin e Xhabirit, në të cilin është përmendur rasti i Muadhit, ndërsa ai është i besueshëm dhe në shumë mënyra është transmetuar nga Xhabiri. Është transmetuar, që Ebu Derda është pyetur mbi njeriun, i cili ka hyrë në xhami, derisa njerëzit kanë qenë në namazin e

⁴³⁴ Muhammed b. Zijad el-Xhumehi Ebu Harith el-Basriu, është i sigurt dhe ravi i besueshëm. Ndonjëherë, transmetonte hadithe mursal. I takonte ravive të *El-Kutubus-sitte*.

⁴³⁵ Ky hadith përmban vërejtjen e ashpër, për ata të cilët, pas rukusë dhe sexhdes, e ngritin kokën para imamit.

⁴³⁶ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahih*, Ebu Davudi në *Sunen*.

⁴³⁷ Në transmetimin e Muslimit, të këtij hadithi, të cilin ai nëpërmjet Mensurit e transmeton nga Umeri, qëndron, që Muadhi, me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka falur namazin e jacisë dhe pastaj i është kthyer popullit të vet dhe me ta përsëri e ka përsëritur atë namaz dhe e ka falur duke qenë imam. Pa pasur parasysh, se a bëhej fjalë mbi namazin e akshamit apo jacisë, me rëndësi është, që ai namazin e njëjtë e ka falur dy herë. Herën e parë si muktedi, me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe herën e dytë si imam. Kjo i përjashton supozimet e disa dijetarëve të cilët thotë, që ai atëherë i ka falur dy namaze të ndryshme.

⁴³⁸ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahih*.

⁴³⁹ Sipas mendimit të Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut, nëse personi e fal namazin farz me imamin, i cili është duke falur nafile, namazi i tij do të jetë i mirë. Ata thirren mbi hadithin e Muadhit. Ai, sipas tyre, namazin e parë (të cilin e ka falur me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)) ka bërë nijet si farz, ndërsa të dytin (të cilin ai e ka falë si imam) si nafile. Këtë e vërteton transmetimi i këtij hadithi, të cilin e kanë shënuar Abdurrezaku, Shafiu, Tahaviu dhe Ed-Darekutni, nëpërmjet Ibn Xhurejxhit, nga Xhabiri, e në të cilin qëndron shtesa: “Ai për të është nafile, e për ata farz.”

ikindisë. Duke menduar, se ata janë duke e falur namazin e drekës, ai ishte vendosur pas tyre. Ai tha: ‘Namazi i tij është i vlefshëm.’”

Disa dijetarë Kufjanë, kanë thënë: “Në rast se ndokush vendoset pas imamit, i cili është duke e falur ikindinë, duke menduar se është duke e falur drekën, namazi i atyre që vendosen pas tij do të ishte i pavlefshëm, në rast se nijeti i imamit dhe i muktediut dallojnë.”⁴⁴⁰

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ دِينَارٍ، عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، أَنَّ مُعَاذَ بْنَ جَبَلٍ، كَانَ يُصَلِّي مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ الْمَغْرِبَ ثُمَّ يَرْجِعُ إِلَى قَوْمِهِ فَيُؤْمُهُمْ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَصْحَابِنَا الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ قَالُوا إِذَا أَمَّ الرَّجُلُ الْقَوْمَ فِي الْمَكْنُونَةِ وَقَدْ كَانَ صَلَاةً قَبْلَ ذَلِكَ أَنَّ صَلَاةَ مَنْ أَنْتُمْ بِهِ جَائِزَةٌ . وَاحْتَجُّوا بِحَدِيثِ جَابِرٍ فِي قِصَّةِ مُعَاذٍ وَهُوَ حَدِيثٌ صَحِيحٌ وَقَدْ رُوِيَ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ عَنْ جَابِرٍ . وَرُوِيَ عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ أَنَّهُ سُئِلَ عَنْ رَجُلٍ دَخَلَ الْمَسْجِدَ وَالْقَوْمُ فِي صَلَاةِ الْعَصْرِ وَهُوَ يَحْسِبُ أَنَّهَا صَلَاةَ الظُّهْرِ فَأَنْتَمَ بِهِمْ قَالَ صَلَاتُهُ جَائِزَةٌ . وَقَدْ قَالَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْكُوفَةِ إِذَا أَنْتُمْ قَوْمٌ بِإِمَامٍ وَهُوَ يُصَلِّي الْعَصْرَ وَهُمْ يَحْسِبُونَ أَنَّهَا الظُّهْرَ فَصَلَّى بِهِمْ وَاقْتَدَوْا بِهِ فَإِنَّ صَلَاةَ الْمُقْتَدِي قَاسِدَةٌ إِذَا اخْتَلَفَ نِيَّةُ الْإِمَامِ وَنِيَّةُ الْمَأْمُومِ .

406. Mbi lehtësimin, në pikëpamje të bërjes sexhde mbi rroba gjatë vapës së madhe ose të ftohtit

باب مَا ذُكِرَ مِنَ الرُّخْصَةِ فِي السُّجُودِ عَلَى التُّوبِ فِي الْحَرِّ وَالْبَرْدِ

584. Na ka treguar Ahmed b. Muhammedi – atë e ka informuar Abdullah b. Mubareku, atë Halid b. Abdurrahmani, atij i ka treguar Galib el-Kattani,⁴⁴¹ duke transmetuar nga Bekër b. Abdullah el-Muzeniu – që Enes b. Maliku, ka thënë: “Ne e kemi bërë praktikë, kur e falnim drekën me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë vapës së madhe, që sexhden ta bënim mbi rroba, për ta mbrojtur fytyrën tonë nga të nxehtit përcëllues.”⁴⁴²

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁴³ Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabir b. Abdullahu dhe Ibn Abbasi. Ndërsa, e ka transmetuar edhe Vekiu nga Halid b. Abdurrahmani.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مُحَمَّدٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ، أَخْبَرَنَا خَالِدُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، قَالَ حَدَّثَنِي غَالِبُ الْقَطَّانُ، عَنْ بَكْرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْمُرْنَبِيِّ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ كُنَّا إِذَا صَلَّيْنَا خَلْفَ النَّبِيِّ ﷺ بِالطَّاهِرِ سَجَدْنَا عَلَى ثِيَابِنَا اتِّقَاءَ الْحَرِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَابْنِ عَبَّاسٍ . وَقَدْ رَوَى وَكِيعٌ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ خَالِدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ .

⁴⁴⁰ Sipas mendimit të Ebu Hanifes, nëse muktediu do ta falte namazin tjetër nga ai të cilin e falë imami, namazi i tillë nuk do të ishte i mjaftueshëm, sepse qëllimet e tyre dallohen. Buhariu dhe Muslimi shënojnë nga Ebu Hurejre që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Imami është për shkak të asaj që të falet me të. Andaj mos veproni ndryshe nga ai.”

⁴⁴¹ Galib b. Hitaf Ebu Sulejman b. Ebu Gajlan, El-Basriu është ravi i besueshëm i hadithit. Ashtu e kanë vlerësuar Ahmed b. Hanbeli dhe Jahja b. Meini.

⁴⁴² Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ebu Davudi në *Sunen*, qëndron: “Ne, duke e falur drekën me të dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), praktikonim, që për shkak të vapës së madhe, nuk ishim në gjendje që ta lëshojmë fytyrën mbi tokë, andaj vendosnim diç nga rrobat tona.” Në bazë të këtij hadithi, Ebu Hanife dhe shumica e dijetarëve islam, kanë vendosur, që është e lejuar bërja e sexhdes mbi robe. Kjo është në kundërshtim me qëndrimin e shiitëve, sipas të cilëve sexhdja nuk mund të bëhet, mbi asgjë tjetër, përveç mbi tokë.

⁴⁴³ E kanë shënuar, në *El-Kutubus-sitte*.

407. Mbi atë që në xhami, është mustehab të ndenjurit nga sabahu deri te shfaqja e diellit

باب ذِكْرُ مَا يُسْتَحَبُّ مِنَ الْجُلُوسِ فِي الْمَسْجِدِ بَعْدَ صَلَاةِ الصُّبْحِ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ

585. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebul-Ahvesi, duke transmetuar nga Simaku – që Xhabir b. Semure, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pasi që e falte namazin e sabahut, qëndronte në xhami, në vendin ku është falur, deri sa shfaqej dielli.”⁴⁴⁴ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁴⁵

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ سِمَاكِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ جَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا صَلَّى الْفَجْرَ قَعَدَ فِي مُصَلَّاهُ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

586. Na ka treguar Abdullah b. Muavi el-Xhumeh el-Basriu⁴⁴⁶ – atë e ka informuar Abdulaziz b. Muslimi, atë Ebu Zilali, ndërsa ai ka transmetuar nga Enesi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush e falë sabahun me xhematë, pastaj ulet për të bërë dhikër Allahun derisa nuk lind dielli, pastaj ngrihet dhe i falë dy rekate – ka për ta pasur shpërblimin sikur ta kishte kryer haxhin dhe umren.” Enesi thotë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Të plota, të plota, të plota!”⁴⁴⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib. E kam pyetur Muhammed b. Ismailin për Ebu Dhilalin, ai tha: ‘Ai është mesatar në hadith. Muhammedi thotë, që emri i tij është Hilal.’”

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُعَاوِيَةَ الْجُمَحِيُّ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُسْلِمٍ، حَدَّثَنَا أَبُو ظِلَالٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَلَّى الْغَدَاةَ فِي جَمَاعَةٍ ثُمَّ قَعَدَ يَذْكُرُ اللَّهَ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ ثُمَّ صَلَّى رَكْعَتَيْنِ كَانَتْ لَهُ كَأَجْرُ حَجَّةٍ وَعُمْرَةٍ " . قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " تَامَّةٌ تَامَّةٌ تَامَّةٌ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدَ بْنَ إِسْمَاعِيلَ عَنْ أَبِي ظِلَالٍ فَقَالَ هُوَ مُقَارِبُ الْحَدِيثِ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَأَسْمُهُ هِلَالٌ .

408. Mbi të kthyerit gjatë namazit

باب مَا ذُكِرَ فِي الْإِثْفَاتِ فِي الصَّلَاةِ

587. Na kanë treguar Mahmud b. Gajlani dhe të tjerët – ata i ka informuar Fadl b. Musai, ai ka transmetuar nga Abdullah b. Seid b. Ebu Hindi, ai nga Thevr b. Zejdi, ai nga Ikrime – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në namaz me sy shikonte djathtas dhe majtas, duke mos e kthyer qafën prapa.”⁴⁴⁸

⁴⁴⁴ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Taberaniu në *Mu'xhemul Kebiru*, qëndron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), qëndronte në xhami, aty ku falej dhe bënte dhikër gjithnjë, derisa dielli lindte. Ky hadith, tregon, që është mustehab, pas sabahut, qëndrimi në xhami dhe bërja e dhikrit deri te lindja e diellit.

⁴⁴⁵ E shënojnë Muslimi në *Sahih*, dhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunenë*.

⁴⁴⁶ Abdullah b. Muavi el-Xhumehi, është ravi i besueshëm. I takonte gjeneratës së dhjetë të ravive.

⁴⁴⁷ Taberaniu në *Mu'xhemul Kebiru*, shënon me sened nga Ebu Uname, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush e falë me xhemat namazin e sabahut, pastaj ulet dhe bënë dhikër deri te lindja e diellit, e pas asaj i fal dy rekate, ka për t'u kthyer me shpërblimin sikur ta kishte kryer haxhin dhe umren.” Mundhiri, në *Et-Tergibu* thotë, që senedi i këtij hadithi është i mirë.

⁴⁴⁸ Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është kthyer gjatë faljes së namazit nafie. Ibn Maliku konsideron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është kthyer gjatë namazit disa herë, që pasuesve t'u tregonte, që të kthyerit gjatë namazit, nëse personi nuk është kthyer me kraharor prej kibles, nuk e prish namazin.

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është garib.”⁴⁴⁹ Vekiu, në transmetime (të këtij hadithi) nuk pajtohet me Fadl b. Musaun.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، وَغَيْرُهُ، وَاجِدٌ، قَالُوا حَدَّثَنَا الْفَضْلُ بْنُ مُوسَى، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَعِيدٍ بْنِ أَبِي هَنْدٍ، عَنْ ثَوْرٍ بْنِ زَيْدٍ، عَنْ عِكْرِمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يُلْحِظُ فِي الصَّلَاةِ يَمِينًا وَشِمَالًا وَلَا يَلْوِي عَنْقَهُ خَلْفَ ظَهْرِهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَقَدْ خَالَفَ وَكَيْعُ الْفَضْلُ بْنُ مُوسَى فِي رَوَايَتِهِ .

588. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, ai ka transmetuar nga Abdullah b. Seid b. Ebu Hindi – që disa, nga nxënësit e Ikrimës, kanë thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), shikonte nën sy në namaz.” Ngjashëm ka përmendur, në hadithin e mëparshëm. Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Enesi dhe Aishja.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكَيْعٌ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَعِيدٍ بْنِ أَبِي هَنْدٍ، عَنْ بَعْضِ أَصْحَابِ عِكْرِمَةَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُلْحِظُ فِي الصَّلَاةِ . فَذَكَرَ نَحْوَهُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ وَغَايِشَةَ .

589. Na ka treguar Muslim b. Hatim el-Basr Ebu Hatimi – atë e ka informuar Muhammed b. Abdullah el-Ensari, ai ka transmetuar nga babai i tij, ai nga Ali b. Zejdi, ai nga Seid b. Musejebi – që Enesi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (me një rast), më tha: “Djaloshi im, ke kujdes nga të kthyerit në namaz, sepse të kthyerit në namaz është shkatërrim. Në rast se do të jesh i detyruar për ta bërë atë, atëherë, atë bëje gjatë namazeve vullnetare, e jo te namazet e obliguara.”⁴⁵⁰ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا أَبُو حَاتِمٍ، مُسْلِمُ بْنُ حَاتِمِ الْبَصْرِيِّ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الْأَنْصَارِيُّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ زَيْدٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، قَالَ قَالَ أَنَسُ بْنُ مَالِكٍ قَالَ لِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " يَا بُنَيَّ إِنَّكَ وَالْإِنْفَاتِ فِي الصَّلَاةِ فَإِنَّ الْإِنْفَاتِ فِي الصَّلَاةِ هَلَكَةٌ فَإِنْ كَانَ لَا بُدَّ فَبِالنَّطُوعِ لَا فِي الْفَرِيضَةِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

590. Na ka treguar Salih b. Abdullahu – atë e ka informuar Ebul-Ahvesi, ai ka transmetuar nga Esh’as b. Ebu Sha’sai, ai nga babai i vet, ai nga Mesruku – që Aishja, ka thënë: “E kam pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi të kthyerit në namaz, ai tha: ‘Ajo do të thotë rrëmbim, ajo çfarë mundet shejtani të rrëmbejë nga namazi i njeriut.’”⁴⁵¹ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”⁴⁵²

حَدَّثَنَا صَالِحُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ أَشْعَثَ بْنِ أَبِي الشَّعْثَاءِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ مَسْرُوقٍ، عَنْ غَايِشَةَ، قَالَتْ سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنْ الْإِنْفَاتِ فِي الصَّلَاةِ قَالَ " هُوَ اخْتِلَافُ الشَّيْطَانِ مِنْ صَلَاةِ الرَّجُلِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

409. Si duhet vepruar ai, i cili imamin e zë në sexhde

باب مَا ذَكَرَ فِي الرَّجُلِ يُدْرِكُ الْإِمَامَ وَهُوَ سَاجِدٌ كَيْفَ يَصْنَعُ

⁴⁴⁹ Këtë hadith, e ka shënuar Hakimi në *Mustedrek*, duke theksuar, që i plotëson kriteret e Buhariut dhe Muslimit. Neveviu, pohon, që ky sened i hadithit është i besueshëm.

⁴⁵⁰ Ibn Haxheri, konsideron, që ekzistojnë shumë hadithe, të cilat, me të vërtetë, nuk i plotësojnë kushtet e Buhariut dhe Muslimit, nga çka mund të arrijmë në përfundim, që të kthyerit gjatë namazit është mekruh. Ibn Huzejme në *Sahih*, dhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, shënojnë nga Ebu Dherre, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Allahu i Lartësuar me Fytrën e Vet i është kthyer rob i vet (gjersa ai është në namaz), gjithnjë, derisa rob nuk fillon të kthehet. Por kur ai fillon të kthehet (gjatë namazit) edhe Allahu i Lartësuar kthehet prej tij.”

⁴⁵¹ Në bazë të këtij dhe haditheve të tjerë, shumica e dijetarëve islam, kanë marrë vendim, që çdo kthim gjatë namazit, në rast se gjatë asaj nuk është kthyer edhe kraharori nga kibla, është mekruh-tenzihen. Megjithatë, në rast se, kraharori kthehet nga kibla, namazi duhet përsëritur.

⁴⁵² Atë e shënojnë edhe Ahmed, Buhariu, Nesaiu dhe Ebu Davudi.

591. Na ka treguar Hisham b. Junus el-Kufi, atë e ka informuar El-Muharibi, ai ka transmetuar nga Haxhxhaxh b. Erta'ti, ai nga Is'haku, ai nga Hubejre, ndërsa ai nga Aliu; ndërsa e ka transmetuar edhe Amër b. Murre, nga Ibn Ebu Lejli dhe Muadh b. Xhebeli – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndokush nga ju vjen në namaz, e imami është në gjendje të caktuar, le ta pasojë dhe le ta bëjë atë çfarë bënë imami.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib. Nuk na është e njohur, që atë e ka transmetuar ndokush me sened, përveç në këtë mënyrë. Sipas këtij hadithi, veprojnë dijetarët. Ata, thonë: “Kur personi vjen, e imami është në sexhde, le të shkojë edhe ai në sexhde – megjithatë, nuk konsiderohet që ka arritur për ta falur atë rekatë, nëse nuk e ka bërë rukunë me imamin.”

Abdullah b. Mubareku, konsideron, që personi duhet të shkojë në sexhde me imam. Është përmendur që disa kanë thënë: “Ndoshta ai person as nuk ka për ta ngritur kokën nga sexhdja, e kanë për t’iu falur mëkate.”

حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ بُرَيْسٍ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا الْمُحَارِبِيُّ، عَنِ الْحَجَّاجِ بْنِ أَرْطَاةَ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ هُبَيْرَةَ بْنِ يَرِيمَ، عَنْ عَلِيٍّ، وَعَنْ عَمْرِو بْنِ مُرَّةَ، عَنْ ابْنِ أَبِي لَيْلَى، عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ، قَالَ قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " إِذَا أَتَى أَحَدُكُمْ الصَّلَاةَ وَالْإِمَامَ عَلَى حَالٍ فَلْيَصْنَعْ كَمَا يَصْنَعُ الْإِمَامُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْلَمُ أَحَدًا أَسْنَدَهُ إِلَّا مَا رَوَى مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ . قَالُوا إِذَا جَاءَ الرَّجُلُ وَالْإِمَامُ سَاجِدًا فَلْيَسْجُدْ وَلَا تُجْزِئُهُ تِلْكَ الرَّكْعَةُ إِذَا فَاتَهُ الرُّكُوعُ مَعَ الْإِمَامِ وَاخْتَارَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ أَنْ يَسْجُدَ مَعَ الْإِمَامِ وَذَكَرَ عَنْ بَعْضِهِمْ فَقَالَ لَعَلَّهُ لَا يَرْفَعُ رَأْسَهُ فِي تِلْكَ السَّجْدَةِ حَتَّى يُعْقَرَ لَهُ .

410. Mbi atë që nuk është e pëlqyer, që njerëzit ta presin imamin në këmbë

باب كَرَاهِيَةِ أَنْ يَنْتَظِرَ النَّاسُ الْإِمَامَ وَهُمْ قِيَامٌ عِنْدَ افْتِتَاحِ الصَّلَاةِ

592. Na ka treguar Ahmed b. Muhammed,⁴⁵³ atë e ka informuar Abdullah b. Mubareku, atë Ma'meri, ai ka transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Abdullah b. Ebu Katade, e ai nga babai i vet, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nëse ikameti do të ketë qenë i thirrur, ju mos u qoni derisa nuk më shihni mua.”⁴⁵⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Enesi. Ndërkaq, ai nuk është i ruajtur. Hadithi i Ebu Katase është hasen-sahih.⁴⁵⁵ Disa dijetarë, nga gjenerata e as'habëve dhe të tjerët, konsiderojnë, se është mekruh, që njerëzit ta presin imamin në këmbë. Disa, thonë: “Nëse imami është në xhami dhe fillon thirrja e ikametit, le të ngrihen njerëzit kur muezini e shqipton *kad kametis-salatu*.” Ky është qëndrimi i Ibn Mubarekut.”

⁴⁵³ Ahmed b. Muhammed b. Musa Ebu Abbas es-Sinsari, është hafiz i njohur i hadithit. Më tepër është i njohur sipas pseudonimit Ibn Merdivejh sesa sipas emrit. I takon kategorisë së ravive më të besueshëm.

⁴⁵⁴ Gjatë përdorimit të këtij hadithi, duhet pasur parasysh dy momente të ndryshme.

a) Momenti, kur imami nuk gjendet në xhami. Me këtë rast, nëse ka qenë i thirrur ikameti, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, nuk duhet ngritur, derisa nuk vërehet imami, që njerëzit të mos jenë të detyruar, që pas kiametit të thirrur, të prisnin imamin në këmbë, nëse ky do të vonohej.

b) Kur imami gjendet në xhami, e ikameti është thirrur – është diskutabile se kur njerëzit duhet të ngriten në këmbë, për shkak të faljes së përbashkët. Sipas mendimit të shumicës, nuk do të ngriten, derisa muezini nuk mbaron së kënduari ikametin. Seid b. Musejjebi, thotë: “Kur muezini thotë Allahu Ekber, janë të obliguar të ngriten. Kur thotë Hajje ales-salati, duhet të fillojnë të radhiten në safe. Kur muezini thotë La ilahe il-lallah, imami ka për ta shqiptuar tekbinin fillestar.

Sipas mendimit të Ebu Hanifes, do të ngriten kur muezini e shqipton Hajje alel-felah. Ndërsa, kur muezini thotë Kad kametis-salati, imami do të shqiptojë tekbinin fillestar.

⁴⁵⁵ E kanë shënuar, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Ibn Maxhes.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مُحَمَّدٍ، أَخْبَرَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي قَتَادَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا أَقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا تَقُومُوا حَتَّى تَرَوْنِي خَرَجْتُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ وَحَدِيثِ أَنَسٍ غَيْرُ مَحْفُوظٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي قَتَادَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ كَرِهَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنْ يَنْتَظِرَ النَّاسُ الْإِمَامَ وَهُمْ قِيَامٌ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا كَانَ الْإِمَامُ فِي الْمَسْجِدِ فَأَقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَإِنَّمَا يَقُومُونَ إِذَا قَالَ الْمُؤَذِّنُ قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ . وَهُوَ قَوْلُ ابْنِ الْمُبَارَكِ .

411. Recitimi i Et-Tehijjatit dhe i salavateve mbi të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përpara lutjes

باب مَا ذَكَرَ فِي التَّنَاءِ عَلَى اللَّهِ وَالصَّلَاةِ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ قَبْلَ الدُّعَاءِ

593. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar, Jahja b. Ademi,⁴⁵⁶ atë Ebu Bekër b. Ajjashi,⁴⁵⁷ ai transmeton nga Asimi,⁴⁵⁸ ai nga Zirra⁴⁵⁹ - që Abdullahu,⁴⁶⁰ ka thënë: “Jam falur (me një rast) me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e me të ishin Ebu Bekri dhe Umeri. Kur u ula, fillova ta recitoja Et-Tehijjain, pas asaj dërgova salavate mbi të Dërguarin, pastaj fillova të lutesha për vete. Duke më dëgjuar, i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) tha: “Kërko, do të të jepet! Kërko, do të të jepet!”⁴⁶¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Fedal b. Ubejde. Hadithi i Abdullahut është hasen-sahih.⁴⁶² Ahmed b. Hanbeli, këtë hadith, nga Jahja b. Ademi, e ka transmetuar në version më të shkurtuar.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ آدَمَ، حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ عَيَّاشٍ، عَنْ عَاصِمٍ، عَنْ زُرَّ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ كُنْتُ أَصَلِّي وَالنَّبِيُّ ﷺ وَأَبُو بَكْرٍ وَعُمَرُ مَعَهُ فَلَمَّا جَلَسْتُ بَدَأْتُ بِالتَّنَاءِ عَلَى اللَّهِ ثُمَّ الصَّلَاةِ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ ثُمَّ دَعَوْتُ لِنَفْسِي فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " سَلْ تَعْطُكَ سَلْ تَعْطُكَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ فَضَالَةَ بْنِ عُيَيْدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا الْحَدِيثُ رَوَاهُ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ عَنْ يَحْيَى بْنِ آدَمَ مُخْتَصَرًا .

⁴⁵⁶ Jahja b. Adem b. Sulejman el-Kufi Ebu Zekerija, është ravi i besueshëm dhe hafiz i hadithit. I ka takuar gjeneratës së nëntë të ravive. Ka vdekur në vitin 203 sipas hixhretit.

⁴⁵⁷ Ebu Bekr b. Ajjash el-Esedi el-Kufi, është ravi i besueshëm dhe i nënshtruar. Në pleqëri mbante keq në mend. I takonte gjeneratës së shtatë të ravive. E ka shkruar veprën *Es-Sahih*. Dijetarët janë ndarë në pikëpamje të emrit të tij. Ibn Haxheri thotë, që mendimi më i drejtë është i atyre, që pohojnë, që ai assesi nuk ka emër, por vetëm që ka pseudonim sipas fëmijës, përmes së cilit është i njohur.

⁴⁵⁸ Asim b. Behdele, është ravi i singertë. Ai është imam i njohur në kiraet. Ne në Bosne dhe Hercegovinë dhe Kosovë, gjatë leximit të Kur'anit e pasojmë kiraetin e tij. Nga ai janë shënuar hadithet në *Sahihun* edhe të Buhariut edhe të Muslimit.

⁴⁵⁹ Zir b. Hubejsh është i besueshëm dhe shumë ravi i shquar. Ai u takonte muhadremineve.

⁴⁶⁰ Abdullah b. Mes'udi, është as'hab i njohur.

⁴⁶¹ Shënojnë Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunenë*, me sened që Fedal b. Ubejd, ka thënë: “Një ditë, derisa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ishte duke ndenjur ende në xhami, erdhi një njeri dhe filloi të falet. Sa u ul, tha: “O Allah, më fal! O Allah më mëshiro!” Në atë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tha: “O falës, ke nxituar! Kur ulesh në namaz, së pari lexoje Et-Tehijjatu dhe salavatet mbi mua, e pastaj drejto lutjen dhe lutu.” Mandej, erdh një njeri tjetër, i cili, pasi që u fal dhe u ul, e lexoi et-Tehijjatu dhe salavatet mbi të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Atij i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i tha: “O falës, tani lutu, ka për të t’u dëgjuar lutja.”

⁴⁶² Atë e ka shënuar edhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

412. Mbi parfumin e xhamisë

باب مَا ذُكِرَ فِي تَطْيِيبِ الْمَسَاجِدِ

594. Na ka treguar Muhammed b. Hatim el-Bagdadi⁴⁶³ - atë e ka informuar Amir b. Salih ez-Zubejri,⁴⁶⁴ atë Hisham b. Urve, ai e ka transmetuar nga babai i vet – që Aishja ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, që në vendbanimet dhe në lagje të ndërtohen xhamitë,⁴⁶⁵ që ato të pastrohen dhe të parfumohen.”⁴⁶⁶

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ حَاتِمٍ الْمُؤَدَّبُ الْبَغْدَادِيُّ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَامِرُ بْنُ صَالِحٍ الزُّبَيْرِيُّ، هُوَ مِنْ وَلَدِ الزُّبَيْرِ حَدَّثَنَا هِشَامُ بْنُ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ أَمَرَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ بِنَاءَ الْمَسَاجِدِ فِي الدُّورِ وَأَنْ تُنْظَفَ وَتُطَيَّبَ .

595. Na ka treguar Hennadi – atë e kanë informuar Abdiu dhe Vekiu, ata dy kanë transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, pastaj e ka përmendur hadithin të ngjashëm me të mëparshmin. Ky hadith është më i besueshëm sesa i pari.⁴⁶⁷

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا عَبْدُهُ، وَوَكِيُّ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ أَمَرَ فَذَكَرَ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا أَصَحُّ مِنَ الْحَدِيثِ الْأَوَّلِ .

596. Na ka treguar Ibn Ebu Umeri – atë e ka informuar, Sufjan b. Ujejne, duke transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, pastaj e ka përmendur hadithin e ngjashëm me të mëparshmin. Ky hadith është më i besueshëm sesa i pari.

Sufjani, thotë: “Ndërtimi i xhamive në vendbanimet, e ka kuptimin e të ndërtuarit të xhamive në fiset.”

حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ أَمَرَ فَذَكَرَ نَحْوَهُ . قَالَ سُفْيَانُ قَوْلُهُ " بِنَاءَ الْمَسَاجِدِ فِي الدُّورِ " . يَعْنِي الْقَبَائِلَ .

⁴⁶³ Muhammed b. Hatim Ebu Xha'fer el-Horasan el-Bagdadi, është ravi i besueshëm. Nga ai, nga dijetarët e njohur, hadithe kanë transmetuar, Tirmidhiu dhe Nesaiu.

⁴⁶⁴ Amir b. Salih b. Abdullah b. Urve b. Zubejr el-Kurejshi ez-Zubejri është i vlerësuar si hadith-metrukul. Pra, ai është ravi, hadithet e të cilit refuzohen. Ibn Meini shkon madje aq larg, saqë e konsideron edhe gënjeshtar. I takonte gjeneratës së tetë të ravive.

⁴⁶⁵ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar që kudo që ka mundësi, në çdo vendbanim dhe në çdo mëhallë, të ndërtohen xhamitë, që njerëzit në to të kryenin namazet e përbashkëta. Asai thotë: “Umer b. Hattabi urdhëronte, çdoherë kur fitohej ndonjë krahinë, që në çdo lagje të ndërtoheshin xhamitë. Ai e ndalonte që në një mëhallë të ndërtoheshin dy xhami, që xhemati të mos shpërndahen dhe ta ndajnë xhematin.”

⁴⁶⁶ Ky dhe hadithet që pasojnë, udhëzojnë, që është mustehab, që kohë pas kohe, xhamitë të pastrohen dhe të parfumohen. Kjo është më së miri të bëhet në vigjilje të xhumasë, ose të xhumanë. Abdullah b. Umeri, gjatë Hilafetit të Umer b. Hattabit, praktikonte parfumin e xhamisë, atëherë kur Umeri hipte mbi minber dhe ulej. Sha'bi, konsideron, që pastrimi dhe parfumimi i xhamive është sunnet.

⁴⁶⁷ Ky hadith edhe pse është mursal, sepse në senedin e tij nuk përmendet Aishja, është më i besueshëm sesa i pari, sepse në senedin e hadithit të parë gjendet Amir b. Sariji, e ai është ravi i dobët.

413. Mbi atë që edhe namazi i natës, por edhe namazi i ditës, të falen dy nga dy (rekate)

باب مَا جَاءَ أَنَّ صَلَاةَ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مَثْنَى مَثْنَى

597. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdi, atë Shu'be, duke transmetuar nga Ja'la b. Atai, ai nga Ali el-Ezdiu,⁴⁶⁸ ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Edhe namazi i natës edhe ai i ditës falen dy nga dy (rekate).”⁴⁶⁹

Ebu Isai, thotë: “Nxënësit e Shu'bes, janë ndarë, në pikëpamje të transmetimit të hadithit nga Ibn Umeri. Atë, disa e transmetojnë si merfu', ndërsa disa si mevku'f.”

Është transmetuar nga Abdullah el-Umeri,⁴⁷⁰ ai nga Nafiu, ai nga Ibn Umer, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me këtë. Është e besueshme ajo që transmetohet nga Ibn Umeri, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Edhe namazi i natës po edhe namazi i ditës falen dy nga dy (rekate).” Transmetuesit e besueshëm, kanë transmetuar hadithin nga Abdullah b. Umeri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), por në të nuk e kanë përmendur edhe namazin e ditës. Është transmetuar nga Ubejdullahu, nëpërmjet Nafiut, që Ibn Umeri, natën i ka falur rekatet dy nga dy, ndërsa ditën nga katër.

Dijetarët, janë ndarë në atë pikëpamje, disa i mbahen asaj, që edhe namazin e natës edhe namazin e ditës duhet falur dy nga dy rekate. Ky është qëndrimi i Shafiut dhe i Ahmedit.⁴⁷¹ Disa konsiderojnë, që namazin e natës duhet falur dy nga dy rekate, ndërsa nafilet e ditës nga katër rekate, sikurse sunnetin e namazit të drekës para farzit. Ky, është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut dhe i Is'hakut.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ يَعْلَى بْنِ عَطَاءٍ، عَنْ عَلِيِّ الْأُرْدِيِّ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " صَلَاةُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مَثْنَى مَثْنَى " . قَالَ أَبُو عِيسَى اخْتَلَفَ أَصْحَابُ شُعْبَةَ فِي حَدِيثِ ابْنِ عُمَرَ فَرَفَعَهُ بَعْضُهُمْ وَأَوْقَفَهُ بَعْضُهُمْ . وَرُوي عَنْ عَبْدِ اللَّهِ الْعُمَرِيِّ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوُ هَذَا . وَالصَّحِيحُ مَا رُوي عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " صَلَاةُ اللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى " . وَرَوَى الْيَقَاتُ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ وَلَمْ يَذْكُرُوا فِيهِ صَلَاةَ النَّهَارِ . وَقَدْ رُوي عَنْ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّهُ كَانَ يُصَلِّي بِاللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى وَبِالنَّهَارِ أَرْبَعًا . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي ذَلِكَ فَرَأَى بَعْضُهُمْ أَنَّ صَلَاةَ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ مَثْنَى مَثْنَى . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ صَلَاةُ اللَّيْلِ مَثْنَى مَثْنَى وَرَأَوْا صَلَاةَ النَّطْوُعِ بِالنَّهَارِ أَرْبَعًا مِثْلَ الْأَرْبَعِ قَبْلَ الظُّهْرِ وَغَيْرَهَا مِنْ صَلَاةِ النَّطْوُعِ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَإِسْحَاقَ .

⁴⁶⁸ Ali el-Ezdi, është i biri i Abdullah el-Barikut. Ai është ravi i sinqertë, i cili ndonjëherë gabonte. I takonte gjeneratës së tretë të ravive.

⁴⁶⁹ Abdullah b. Umeri sqaroi, se çfarë kuptimi kanë fjalët, dy nga dy rekate. Muslimi në Sahih, shënon se Ukbe b. Hurejth, e ka pyetur Ibn Umerin mbi kuptimin e fjalëve dy nga dy rekate. Ai është përgjigjur: “E kanë kuptimin, që pas çdo dy rekati, jepet selami.” Me këtë sqarim, e ka përgënjeshtuar mendimin e disa dijetarëve të shkollës së jurisprudencës hanefite, të cilët mendojnë, se fjalët dy nga dy rekate, e kanë kuptimin, që pas çdo dy rekateve, duhet ulur në teshehud. Sepse nuk ka dyshim, që raviu, i cili këtë hadith e transmeton drejtpërdrejt nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më së miri e njeh kuptimin e tij.

⁴⁷⁰ Abdullah el-Umeri, me të vërtetë është Abdullah b. Umer b. Hafs b. Asim b. Umer b. Hattab el-Medeni. Ai ka qenë jashtëzakonisht i përlurur, por edhe ravi i dobët.

⁴⁷¹ Shafiut dhe shumica e dijetarëve islam, në bazë të këtij hadithi, të cilin e ka transmetuar Ezdi nga Ibn Umeri, kanë vërtetuar, që edhe nafilen e natës edhe të ditës është më mirë të falen dy nga dy rekate, ashtu që, pas çdo dy rekati të jepet selami.

Sufjan eth-Thevriu dhe Ibn Mubareku, konsiderojnë, që gjatë nafileve të natës, është më mirë të jepet selami pas çdo dy rekateve, derisa gjatë nafileve të ditës, është mirë të jepet selami pas çdo katër rekateve. Mendimin e vet e bazojnë në hadithin, të cilin e transmeton Nafiu nga Ibn Umeri, e në të cilin qëndron: “Ibn Umeri, nafilet e natës i falte dy nga dy rekate, derisa nafilet e ditës nga katër rekate.”

414. Si i falte nafilet e ditës i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)

بَابُ كَيْفَ كَانَ تَطَوُّعُ النَّبِيِّ ﷺ بِالنَّهَارِ

598. Na ka treguar Muhammed b. Gajlani – atë e ka informuar Vehb b. Xheriri, atë Shu'be, ai ka transmetuar nga Ebu Is'haku – që Asim b. Damre,⁴⁷² ka thënë: “E kemi pyetur Aliun mbi namazin (vullnetar) ditor të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Ju nuk jeni në gjendje ta bëni atë rregullisht.” Ne thamë: “Ti na informo, ne kemi për të bërë aq sa mundemi nga ajo.” Ai në atë, tha: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pasi që Dielli ngrihej (nga ana e lindjes), aq sa është larg (nga ana e perëndimit) në kohën e namazit,⁴⁷³ të ikindisë, i falte dy rekate.⁴⁷⁴ Ndërsa, kur dielli ngrihej nga ana (e lindjes), aq sa është larg (nga perëndimi) në kohën e namazit të drekës, ai i falte katër rekate. Para fardit të drekës ai i falte katër rekate. Pas çdo dy rekateve, jepte selam,⁴⁷⁵ mbi melaiket e afërta, lajmëtarët e fesë, të dërguarit, muslimanët dhe mbi mu'minët, të cilët janë duke i pasuar.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيلَانَ، حَدَّثَنَا وَهْبُ بْنُ جَرِيرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ، قَالَ سَأَلْنَا عَلِيًّا عَنْ صَلَاةِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ مِنَ النَّهَارِ فَقَالَ إِنَّكُمْ لَا تُطِيقُونَ ذَلِكَ . فَعُلْنَا مَنْ أَطَاعَ ذَلِكَ مَثًا . فَقَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ إِذَا كَانَتِ الشَّمْسُ مِنْ هَا هُنَا كَهَيْئَتِهَا مِنْ هَا هُنَا عِنْدَ الْعَصْرِ صَلَّى رَكْعَتَيْنِ وَإِذَا كَانَتِ الشَّمْسُ مِنْ هَا هُنَا كَهَيْئَتِهَا مِنْ هَا هُنَا عِنْدَ الظُّهْرِ صَلَّى أَرْبَعًا وَصَلَّى أَرْبَعًا قَبْلَ الظُّهْرِ وَبَعْدَهَا رَكْعَتَيْنِ وَقَبْلَ الْعَصْرِ أَرْبَعًا يَفْصِلُ بَيْنَ كُلِّ رَكْعَتَيْنِ بِالتَّسْلِيمِ عَلَى الْمَلَائِكَةِ الْمُقَرَّبِينَ وَالنَّبِيِّينَ وَالْمُرْسَلِينَ وَمَنْ تَبِعَهُمْ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ .

599. Na ka treguar Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Muhammed b. Xha'feri, atë Shu'be, ai ka transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Asim b. Damre, ai nga Aliu, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e mëparshëm. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen.”⁴⁷⁶ Is'hak b. Ibrahim, thotë: “Kjo është më e mira që është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbi nafilet ditore.”

Transmetohet, që Ibn Mubareku këtë hadith e ka konsideruar të dobët: “Sipas mendimit tonë, vetëm ai është i dobët.”

Ebu Isai, thotë: “Ngjashëm me këtë, Allahu e di më së miri, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk transmetohet me rrugë tjetër, përveç nëpërmjet Asim b. Damres nga Aliu, ndërsa Asim b. Damre, sipas mendimit të disa dijetarëve të hadithit, është ravi i besueshëm.”

Ali b. Medini thotë, që Jahja b. Seid el-Kattani, ka thënë, që Sufjani ka treguar: “Për ne, vlera e hadithit të Asim b. Damres në krahasim me hadithin e Harithit, ka qenë mirë e njohur.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَالَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ أَحْسَنُ شَيْءٍ رُوِيَ فِي تَطَوُّعِ النَّبِيِّ ﷺ فِي النَّهَارِ هَذَا . وَرُوِيَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ

⁴⁷² Sipas mendimit të Ibn Haxher el-Askalanit, Asim b. Damre es-Seluli el-Kufi, është transmetues i besueshëm i hadithit.

⁴⁷³ Kur dielli pas lindjes ngritej për një ose dy harqe, kalonte koha kur është mekruh për t'u falur.

⁴⁷⁴ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), rregullisht në atë kohë, e falte namazin, të cilin disa e quajnë salatut-istishrak, e disa salatut-dahvetis-sugra, e i cili përbëhet nga dy rekate, më vonë i falte katër rekate namaz, i cili quhej salatut-duha, ose salatut-dahvetil-kubra.

⁴⁷⁵ Sipas mendimit të Ibn Haxher el-Mekkit, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pas çdo dy rekateve, jepte selam, ndërsa shqiptimin e tekstit të shqiptuar të selamit e kishte dedikuar t'u drejtonte melaiket, që ishin pranë tij, lajmëtarëve të fesë, të dërguarve dhe robërve të mirë. Begaviu konsideron, se nën nocionin selam, nuk mendohet mbi dhënien e selamit, por mbi teshehud, çka domethënë se i Dërguari i Allahut i falte katër rekate, duke u ulur pas çdo dy reakteve në teshehud, ndërsa pas çdo katër rekateve jepte selam.

⁴⁷⁶ E kanë shënuar Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

الْمُبَارَكُ أَنَّهُ كَانَ يُضَعِّفُ هَذَا الْحَدِيثَ . وَإِنَّمَا ضَعَّفَهُ عِنْدَنَا وَاللَّهُ أَعْلَمُ لِأَنَّهُ لَا يُرَوَّى مِثْلُ هَذَا عَنِ النَّبِيِّ ﷺ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ عَنْ عَلِيٍّ . وَعَاصِمٌ بْنُ ضَمْرَةَ هُوَ ثِقَةٌ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ . قَالَ عَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ قَالَ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْقَطَّانُ قَالَ سَفِيَانُ كُنَّا نَعْرِفُ فَضْلَ حَدِيثِ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ عَلَى حَدِيثِ الْحَارِثِ .

415. Mbi mospëlqimin e të falurit me mbulesat e grave

باب فِي كَرَاهِيَةِ الصَّلَاةِ فِي لُحْفِ النِّسَاءِ

600. Na ka treguar Muhammed b. Abdul A'la – atë e ka informuar Halid b. Harithi,⁴⁷⁷ ai ka transmetuar nga Esh'asi, e ai është i biri i Abdulmelikut,⁴⁷⁸ ai nga Muhammed b. Sirini, ai nga Abdullah b. Shekiku⁴⁷⁹ - që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (kurrë) nuk është falur me mbulesat e grave të veta.”⁴⁸⁰ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁸¹ Në atë kuptim nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është transmetuar edhe lehtësimi.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْأَعْلَى، حَدَّثَنَا خَالِدُ بْنُ الْحَارِثِ، عَنْ أَشْعَثَ، وَهُوَ ابْنُ عَبْدِ الْمَلِكِ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ شَقِيقٍ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ لَا يُصَلِّي فِي لُحْفِ نِسَائِهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رُخْصَةً فِي ذَلِكَ .

416. Çka është e lejuar nga lëvizjet dhe veprimet gjatë faljes së nafileve

باب ذَكَرَ مَا يَجُوزُ مِنَ الْمَشْيِ وَالْعَمَلِ فِي صَلَاةِ النَّطَوُعِ

601. Na ka treguar Ebu Seleme Jahja b. Halef – atë e ka informuar Bishr b. Mufeddal, ai ka transmetuar nga Burud b. Sinani,⁴⁸² ai nga Zuhriu, ai nga Urve – që Aishja ka treguar: “Me një rast kam ardhur në shtëpi. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ishte duke u falur në shtëpi, derisa dyert ishin të mbyllura. Atëherë, ai (pa e ndërprerë namazin) u afrua, ma hapi derën dhe pastaj përsëri u kthye në vendin e vet. Ka përshkruar që dyert gjendeshin në drejtim të kibles.”⁴⁸³ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁸⁴

حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ، يَحْيَى بْنُ خَلْفٍ حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ الْمُفَضَّلِ، عَنْ بُرْدِ بْنِ سِنَانٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ غُرُورَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ جِئْتُ وَرَسُولُ اللَّهِ ﷺ يُصَلِّي فِي الْبَيْتِ وَالْبَابُ عَلَيْهِ مُغْلَقٌ فَمَشَى حَتَّى فَتَحَ لِي ثُمَّ رَجَعَ إِلَى مَكَانِهِ . وَوَصَفَتِ الْبَابَ فِي الْقِبْلَةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

⁴⁷⁷ Halid b. Harith b. Ubejd b. Selim el-Huxhejni Ebu Uthman el-Basriu, është ravi i besueshëm dhe i sigurt.

⁴⁷⁸ Esh'as b. Abdulmelik el-Humrani Ebu Hani El-Basriu, është ravi dhe fakih i besueshëm.

⁴⁷⁹ Abdullah b. Shekik el-Ukajli, është i besueshëm. I takonte gjeneratës së tretë të ravive.

⁴⁸⁰ Sipas mendimit të Abdurrahman el-Mubarekfurit, ky hadith është argument, që meshkujt është mekruh të falen me rroba femrash. Gjithashtu, kjo është mekruh për ta edhe pas namazit.

⁴⁸¹ E kanë shënuar edhe Ahmedi në *Musned*, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

⁴⁸² Burud b. Sinan ed-Dimashki, ka qenë i mbrojturi i kurejshitëve. Ka jetuar në Basra. Shquhet si ravi i sinqertë, i cili anonte kah kaderitë. Nesaiu, Ebu Hatim dhe Ibn Meini, e vlerësojnë si ravi të besueshëm.

⁴⁸³ Ky hadith është argument, që gjatë namazit vullnetar janë të lejuara disa veprime, që nuk e prishin namazin. Ato nuk janë të lejuara kur bëhen gjatë namazit të obliguar. Më konkretisht, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), siç qëndron në transmetimin e Nesaiut, i ka bërë disa hapa, i është afruar dyerve dhe ia ka hapur Aishes dhe përsëri është kthyer në vendin e vet të mëparshëm, e që nuk e ka vënë në pyetje namazin. Me të vërtetë, dyert, siç përshkruan Aishja, kanë qenë përpara tij, në drejtim të kibles, ashtu që ky është argument që kraharori, gjatë atij akti, nuk kthehej nga kibla.

⁴⁸⁴ E kanë shënuar, Ahmedi në *Musned*, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

417. Mbi recitimën e dy sureve në një rekat

باب ما ذكر في قراءة سورتين في ركعة

602. Na ka treguar, Muhammed b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, atë Shu'be, duke transmetuar nga A'meshi – që Ebu Vaili ka thënë: “Një njeri⁴⁸⁵ e pyeti Abdullahun:⁴⁸⁶ ‘A duhet të shqiptohet këtu *gajri asin* apo *gajri jasin*?’”⁴⁸⁷ – e ai tha: ‘Vallë, a din ti ta recitosh tërë Kur'anin, përveç (kësaj)?’ ‘Po, di’ – tha ai, ndërsa Abdullahu në atë tha: ‘Me të vërtetë, disa njerëz, atë e recitojnë duke i shpërndajné fjalët e tij (duke mos menduar mbi domethënien e tyre), siç i shpërndajnë hurmet e kalbura, e ai (recitimi), nuk e kalon as fytyrën (e lëre më të arrij deri te zemra e tyre). Unë i njoh suret e ngjashme, të cilat i Dërguari i Allahu (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i recitonte nga dy së bashku.’ Ne e urdhëruam Alkamin,⁴⁸⁸ – thotë Ebu Vaili – ‘dhe ai e pyeti mbi ato, e ai tha: ‘Janë njëzet sure nga grupi El-Mufessal. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) gjithnjë, i recitonte nga dy (prej tyre) në një rekat.’”⁴⁸⁹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁹⁰

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، قَالَ أَنْبَأَنَا شُعْبَةُ، عَنْ الْأَعْمَشِ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا وَائِلٍ، قَالَ سَأَلَ رَجُلٌ عَبْدَ اللَّهِ عَنْ هَذَا الْحَرْفِ (غَيْرِ آسِينَ) أَوْ يَاسِينَ قَالَ كُلُّ الْقُرْآنِ قَرَأْتُ غَيْرَ هَذَا الْحَرْفِ قَالَ نَعَمْ . قَالَ إِنَّ قَوْمًا يَقْرَءُونَهُ يَنْتَرُونَهُ نَتَرُ الدَّقْلَ لَا يُجَاوِرُ تَرَاقِيهِمْ إِنِّي لَأَعْرِفُ السُّورَ النَّظَائِرَ الَّتِي كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَقْرَأُ بَيْنَهُنَّ . قَالَ فَأَمَرْنَا عُلَقَمَةَ فَسَأَلَهُ فَقَالَ عَشْرُونَ سُورَةً مِنَ الْمُفَصَّلِ كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقْرَأُ بَيْنَ كُلِّ سُورَتَيْنِ فِي رَكْعَةٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

418. Mbi vlerat e nisjes për në xhami dhe shpërblimit për çdo hap

باب ما ذكر في فضل المشي إلى المسجد وما يُكْتَبُ لَهُ مِنَ الْأَجْرِ فِي خُطَاةٍ

603. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi,⁴⁹¹ atë e ka lajmëruar Shu'be, duke transmetuar nga A'meshi, ai ka dëgjuar nga Zekvani,⁴⁹² ai ka transmetuar nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur një person merr avdes bukur, pastaj del (nga shtëpia) dhe niset për në namaz (në xhami), e atë asgjë nuk e ka shtyrë për të dal përveç namazit – nuk ka për ta bërë asnjë hap, e që Allahu me atë të mos ia ngritë shkallën apo të mos ia heq mëkatet.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁴⁹³

⁴⁸⁵ Sipas mendimit të Abdurrahman el-Mubarekfurit, ai ka qenë Melik b. Sinan el-Buxheli.

⁴⁸⁶ Abdullah b. Mes'udi, është as'hab i njohur, i cili i transmeton rreth dy mijë hadithe.

⁴⁸⁷ E ka pyetur atë, se a është fjala *asin* në ajetin 15 në sures Muhammed dhe a duhet shqiptuar me jaj apo hemze.

⁴⁸⁸ Alkam b. Kajsi b. Malik en-Nehaiu.

⁴⁸⁹ Ky hadith është argument, që mund të lexohen nga dy sure në një rekat. Sipas mendimit të Ibn Mes'udit, siç atë e cekë el-Mubarekfuri, i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në një rekat i lexonte suret: er-Rahman dhe en-Nexhm, Ikterebetisa'atuu dhe el-Hakka, Et-Tur dhe Edh-Dharijat, El-Vakia dhe Nun, El-Mearixh dhe En-Naziat, Vejlulil-Mutaffifine dhe Abese, El-Muddeththir dhe El-Muzemmil, El-Insan dhe La uksimu, Amme dhe El-Murselat, ed-Duhan dhe Idhash-shemsu kuvviret.

⁴⁹⁰ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

⁴⁹¹ Ebu Davud et-Tajalisi.

⁴⁹² Zekvan është Ebu Sari es-Sem'an ez-Zejjat el-Medeni. Shquhet si i besuar dhe ravi i sigurt. I ka takuar gjeneratës së tretë të ravive. Ka vdekur në vitin 101 sipas hixhretit.

⁴⁹³ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Nesaiu në *Sunene*.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، قَالَ أَنْبَأَنَا شُعْبَةُ، عَنْ الْأَعْمَشِ، سَمِعَ دَكْوَانَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا تَوَضَّأَ الرَّجُلُ فَأَحْسَنَ الْوُضُوءَ ثُمَّ خَرَجَ إِلَى الصَّلَاةِ لَا يُخْرِجُهُ أَوْ قَالَ لَا يَنْهَرُهُ إِلَّا إِيَّاهَا لَمْ يَخْطُ خُطْوَةً إِلَّا رَفَعَهُ اللَّهُ بِهَا دَرَجَةً أَوْ حَطَّ عَنْهُ بِهَا خَطِيئَةٌ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

419. Mbi atë që sunneti pas akshamit është më mirë të falet në shtëpi

باب مَا ذَكَرَ فِي الصَّلَاةِ بَعْدَ الْمَغْرِبِ أَنَّهُ فِي الْبَيْتِ أَفْضَلُ

604. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Ibrahim b. Ebu Veziri,⁴⁹⁴ atë Muhammed b. Musai, ai ka transmetuar nga Sa'd b. Is'hak b. Ka'b b. Uxhre, ai nga babai i vet – që gjyshi i Sa'd b. Is'hak b. Ka'b b. Uxhres, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (me një rast) e ka falur akshamin në xhaminë e Benu Abdul-Eshhelit. Pas asaj, njerëzit ishin ngritur për ta falur sunnetin, ndërsa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), u tha: “Atë namaz (sunnet) faleni në shtëpi.”⁴⁹⁵

Ebu Is'haku, thotë: “Ky hadith është garib,⁴⁹⁶ e kemi të njohur vetëm në këtë formë. E besueshme është ajo, që është transmetuar nga Ibn Umeri: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), dy rekate pas akshamit i falte në shtëpinë e vet.” Ndërsa, është transmetuar edhe nga Hudhejfe, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, pasi që e fali akshamin, ai vazhdoi të falej (namaz vullnetar) në xhami deri në jaci. Në këtë hadith është argumenti, që me atë rast i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), edhe dy rekate (të sunnetit të akshamit) i ka falur në xhami.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَسَّارَ، حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ أَبِي الْوَزِيرِ الْبَصْرِيُّ، ثِقَةً حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ مُوسَى، عَنْ سَعْدِ بْنِ إِسْحَاقَ بْنِ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، قَالَ صَلَّى النَّبِيُّ ﷺ فِي مَسْجِدِ بَنِي عَبْدِ الْأَشْهَلِ الْمَغْرِبِ فَقَامَ نَاسٌ يَتَنَقَّلُونَ فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " عَلَيْكُمْ بِهَذِهِ الصَّلَاةِ فِي الْبُيُوتِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ حَدِيثِ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَالصَّحِيحُ مَا رَوَى عَنْ ابْنِ عُمرَ قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يُصَلِّي الرُّكْعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرِبِ فِي بَيْتِهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رَوَى عَنْ حُدَيْفَةَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى الْمَغْرِبَ فَمَا زَالَ يُصَلِّي فِي الْمَسْجِدِ حَتَّى صَلَّى الْعِشَاءَ الْآخِرَةَ . فِي هَذَا الْحَدِيثِ دَلَالَةٌ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَلَّى الرُّكْعَتَيْنِ بَعْدَ الْمَغْرِبِ فِي الْمَسْجِدِ .

420. Mbi larjen, pasi që personi e pranon islamin

باب مَا ذَكَرَ فِي الْإِغْتِسَالِ عِنْدَمَا يُسَلِّمُ الرَّجُلُ

605. Na ka treguar Bundari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdi, atë Sufjani, ai ka transmetuar nga Egarr b. Sabbahu,⁴⁹⁷ ai nga Halife b. Husajni⁴⁹⁸ - që i Dërguari (paqja dhe bekimi i

⁴⁹⁴ Ibrahim b. Umer b. Mutrif el-Hashimi Ebu Is'hak b. Ebu Vezir el-Meki, jetonte në Basra. Shquhej si ravi i sinqertë. I takonte gjeneratës së nëntë të ravive.

⁴⁹⁵ Sipas mendimit të el-Mubarekfurit, nga ky hadith, mund të arrijmë në përfundim, që për atë i cili e ka ndërmend që pas akshamit të shkojë në shtëpi, është më mirë, që sunnetet e akshamit t'i falë në shtëpi, ndërsa, ai i cili e ka ndërmend që pas akshamit të mbetet në xhami, siç qëndron në hadithin e Hudhejfes, të njëjtat t'i falë në xhami.

⁴⁹⁶ Këtë hadith, e shënon Nesaiu në *Sunen*. Në senedin e tij gjendet ravi anonim, Is'hak b. Ka'bi.

⁴⁹⁷ Egarr b. Sabbah et-Temimi el-Kufi, është ravi i besueshëm. Të besueshëm e kanë vlerësuar Jahja b. Meini dhe Nesaiu.

⁴⁹⁸ Halifa b. Husejn b. Kajs b. Asim et-Temimi el-Munkiri, sipas mendimit të Nesaiut është ravi i besueshëm.

Allahut qoftë mbi të), Kajs b. Asimin,⁴⁹⁹ pasi që e ka pranuar Islamin, e ka urdhëruar të lahej, me ujë dhe lotos.”⁵⁰⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Hurejre. Ky hadith është hasen⁵⁰¹ dhe na është i njohur, vetëm në këtë formë. Sipas tij vepronin dijetarët. Ata thonë, që personi i cili e pranon islamin është mustehab të lahet dhe t’i lajë rrobat.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ الْأَعْرَبِيِّ بْنِ الصَّبَّاحِ، عَنْ خَلِيفَةَ بْنِ حُصَيْنٍ، عَنْ قَيْسِ بْنِ عَاصِمٍ، أَنَّهُ أَسْلَمَ فَأَمَرَهُ النَّبِيُّ ﷺ أَنْ يَغْتَسِلَ بِمَاءٍ وَسِدْرٍ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ يَسْتَجِبُونَ لِلرَّجُلِ إِذَا أَسْلَمَ أَنْ يَغْتَسِلَ وَيَغْسِلَ ثِيَابَهُ .

421. Mbi tesmijen, gjatë hyrjes në hapësirën ku çlirohet ndokush

بَاب مَا ذَكَرَ مِنَ التَّسْمِيَةِ عِنْدَ دُخُولِ الْخَلَاءِ

606. Na ka treguar Muhammed b. Humejd er-Razi⁵⁰² - atë e ka informuar Hakem b. Beshir b. Selmani, atë Hal-lad es-Saffari,⁵⁰³ ai ka transmetuar nga Hakem b. Abdullah en-Nasriu, ai nga Ebu Is’haku, ai nga Ebu Xhuhajfiu, e ai nga Ali b. Ebu Talibi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Perdja në mes shikimit të xhinnit dhe vendeve të turpshme të trupit të njeriut, është që ndokush nga ju, para se të hyjë në tualet, të thotë: ‘Bismil-lah / Në emër të Allahut!’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib,⁵⁰⁴ por na është i njohur vetëm në këtë formë. Senedi i tij nuk është aq i fuqishëm. Mbi këtë, diç transmeton edhe Enesi nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ حُمَيْدٍ الرَّازِيُّ، حَدَّثَنَا الْحَكَمُ بْنُ بَشِيرٍ بْنُ سَلْمَانَ، حَدَّثَنَا خَلَادُ الصَّفَّارُ، عَنْ الْحَكَمِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ النَّصْرِيِّ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ أَبِي جَحْفَةَ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " سَتَرٌ مَا بَيْنَ أَعْيُنِ الْجَنِّ وَعَوْرَاتِ بَنِي آدَمَ إِذَا دَخَلَ أَحَدُهُمُ الْخَلَاءَ أَنْ يَقُولَ بِسْمِ اللَّهِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَإِسْنَادُهُ لَيْسَ بِذَلِكَ الْقَوِي . وَقَدْ رَوَى عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَشْيَاءَ فِي هَذَا .

422. Në Ditën e Gjykimit, gjurmët e sexhdes dhe të pastrimit do të jenë shenja të këtij ummeti

بَاب مَا ذَكَرَ مِنْ سِيمَا هَذِهِ الْأُمَّةِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنْ أَثَارِ السُّجُودِ وَالطُّهُورِ

607. Na ka treguar Ebu Velid ed-Dimeshki – atë e ka informuar Velid b. Muslimi, atë Safvan b. Amër,⁵⁰⁵ atë Jezid b. Humejr, duke transmetuar nga Abdullah b. Busra – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Pasuesit e mi, në Ditën e Gjykimit, do t’i kenë fytyrat e

⁴⁹⁹ Kajs b. Asim b. Sinan b. Halid el-Munkiri, është as’hab i njohur.

⁵⁰⁰ Ky hadith është argument, që personi, i cili e pranon islamin, duhet të lahet. Disa konsiderojnë, që ajo është vaxhib, derisa shumica e dijetarëve, që ajo për të është mustehab.

⁵⁰¹ E kanë shënuar edhe Ibn Hibban dhe Ibn Huzejme në *Sahihë*, Ahmedi në *Musned*, dhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

⁵⁰² Muhammed b. Humejd el-Razi, sipas vlerësimit të Mubarekfurit është ravi i dobët. Ndërsa, Jahja b. Meini, mbi të kishte mendim të mirë.

⁵⁰³ Hal-lad b. Isa – ose b. Muslim – el-Abdi Ebu Muslim el-Kufi, sipas mendimit të Jahja b. Meinit, është ravi i besueshëm.

⁵⁰⁴ E kanë shënuar, Ahmedi në *Musned*, Ibn Maxhe në *Sunen*. El-Menaviu, konsideron, që senedi i këtij hadithi është i besueshëm.

⁵⁰⁵ Safvan b. Amr es-Sekseki Ebu Amr el-Humsi, është ravi i sigurt. Ebu Hatimi, e ka vlerësuar si të besueshëm. Nga ai, Muslimi ka shënuar një hadith.

ndritshme nga gjurmët e sexhdes dhe duart e këmbët e bardha nga marrja e avdesit.”⁵⁰⁶ Ebu Isai thotë: “Ky hadith, me këtë rrugë, nëpërmjet Abdullah b. Busrasë, është hasen-sahih-garib.”

حَدَّثَنَا أَبُو الْوَلِيدِ، أَحْمَدُ بْنُ بَكَّارٍ الدَّمَشَقِيُّ حَدَّثَنَا الْوَلِيدُ بْنُ مُسْلِمٍ، قَالَ قَالَ صَفْوَانُ بْنُ عَمْرٍو أَخْبَرَنِي يَزِيدُ بْنُ خُمَيْرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بُسْرِ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " أُمَّتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ غُرٌّ مِنَ السُّجُودِ مُحَجَّلُونَ مِنَ الْوُضُوءِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بُسْرِ .

423. Cilat nga pjesët e djathta të trupit gjatë larjes është mustehab të lahen

باب ما يُسْتَحَبُّ مِنَ التَّيْمَنِ فِي الطُّهُورِ

608. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebul-Ahvesi, duke transmetuar nga Esh’as b. Ebu Sha’si, ai nga babai i vet, ai nga Mestruku – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me të vërtetë kishte dëshirë të fillonte me pjesët e djathta të trupit dhe me anën e djathtë, gjatë pastrimit, kur lahej apo kur merrte avdes, gjatë pastrimit kur i krihte flokët dhe mjekrën, gjatë mbathjes dhe kur i vishte të mbathurat.” Ebu Isai, thotë: “Emri i Ebu Sha’ses është Sulejman b. Esved el-Muharibi. Ky hadith është hasen-sahih.”⁵⁰⁷

حَدَّثَنَا هَنَّاذٌ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ أَشْعَثَ بْنِ أَبِي الشَّعْثَاءِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ مَسْرُوقٍ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يُحِبُّ التَّيْمَنَ فِي طُهُورِهِ إِذَا تَطَهَّرَ وَفِي تَرَجُّلِهِ إِذَا تَرَجَّلَ وَفِي انْتِعَالِهِ إِذَا انْتَعَلَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو الشَّعْثَاءِ اسْمُهُ سُلَيْمٌ بْنُ أَسْوَدَ الْمُحَارِبِيُّ .

422. Sa ujë mjafton për marrjen e avdesit

باب قَدْرُ مَا يُجْزَى مِنَ الْمَاءِ فِي الْوُضُوءِ

609. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Sheriku,⁵⁰⁸ ai nga Abdullah b. Isai,⁵⁰⁹ ai nga Ibn Xhebri,⁵¹⁰ ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për avdes mjaftojnë dy ritle ujë.”⁵¹¹

⁵⁰⁶ Muslimi në Sahihun e vet, shënon nga Ebu Hurejre, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, ka thënë: “Kisha dashur sikur të ishim në gjendje për t’i parë vëllezërit tanë.” “Vallë, a nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguar i Allahut?” – me zë të lartë thanë të pranishmit. “Ju jeni shokët e mi.” – tha i Dërguari i Allahut – “Unë do të kisha dëshiruar, që të kishit mundësi t’i shihni ata vëllezër tanë, që ende nuk kanë lindur, të cilët më vonë kanë për të ardhur në këtë botë.” “E si ke për t’i njohur pasuesit tu, o i Dërguar i Allahut, cilët kanë për të ardhur pas teje?” – përsëri thanë të pranishmit. Ai në atë tha: “Çfarë mendoni, sikur ndonjëri nga ju ta kishte një kalë me shenjë të bardhë në ballë dhe këmbë në mesin e kuajve një ngjyrësh – a do ta kishit mundur ta njihnit atë!” “Po.” Thanë të pranishmit, ndërsa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në atë tha: “Ta keni të ditur, se të gjithë pasuesit e mi, kanë për t’i pasur fytyrat e ndritura nga gjurmët e sexhdes dhe duart dhe këmbët e bardha nga marrja e abdesit. Ja, sipas atyre shenjave kam për t’i njohur, mandej kanë për të pirë nga Burimi.” Në transmetimin e këtij hadithi, nga Ibn Maxhe, qëndron: “Vetëm pasuesit e mi kanë për t’i pasur shenjat e këtyrë.”

⁵⁰⁷ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁵⁰⁸ Sherik b. Abdullah el-Kufi, qëpari ka qenë kadi i vasifisë dhe pastaj i kufës. Si ravi është i sinqertë edhe pse shumë gabonte gjatë transmetimit të haditheve. Pasi që është bërë kadi, memoria e tij dukshëm është dobësuar. Ka qenë jashtëzakonisht i ndershem dhe i shquar.

⁵⁰⁹ Abdullah b. Isa b. Abdurrahman b. Ebu Lejl el-Ensari Ebu Muhammed el-Kufi, është ravi i besueshem. Anonte pak kah shiizmi.

⁵¹⁰ Abdullah b. Abdullah b. Xhebr, është ravi i besueshem i hadithit.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib,⁵¹² nuk na është i njohur përveç nëpërmjet Sherikut dhe atë kështu fjalë për fjalë. Ka transmetuar Shu’be nga Abdullah b. Abdullah b. Xhebri, e ai nga Enes b. Maliku, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka marr avdes me një mekuk ujë,⁵¹³ ndërsa lahej me pesë mekuk ujë.”

حَدَّثَنَا هَنَّاذٌ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ شَرِيكِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عِيسَى، عَنْ ابْنِ جَبْرِ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " يُجْزَى فِي الْوُضُوءِ رَطْلَانِ مِنْ مَاءٍ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ شَرِيكِ عَلَى هَذَا اللَّفْظِ . وَرَوَى شُعْبَةُ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ جَبْرِ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يَتَوَضَّأُ بِالْمَكُوكِ وَيَغْتَسِلُ بِخَمْسَةِ مَكَاكِي .

425. Mbi spërkatjen e rrobave të urinuara nga i porsalinduri

باب مَا ذَكَرَ فِي نَضْحِ بَوْلِ الْغُلَامِ الرَّضِيعِ

610. Na ka treguar Bundari – atë e ka informuar Muadh b. Hishami,⁵¹⁴ atij i ka treguar babai,⁵¹⁵ duke transmetuar nga Katade, ai nga Ebu Harb b. Esvedi, ai nga babai i vet, ai nga Ali b. Ebu Talibi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbi urinën e të porsalindurit ka thënë: “Spërkatet me ujë mbi urinën e të porsalindurit mashkull, ndërsa urina e të porsalindurit femër ka për t’u larë.”⁵¹⁶ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen. Hisham ed-Destevai, këtë hadith nga Katade e transmeton si merfu’, derisa Seid b. Ebu Arubi nga Katade, e transmeton si mevkuf.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا مُعَاذُ بْنُ هِشَامٍ، حَدَّثَنِي أَبِي، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ أَبِي حَرْبٍ بْنِ أَبِي الْأَسْوَدِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ فِي بَوْلِ الْغُلَامِ الرَّضِيعِ " يُنْضَحُ بَوْلُ الْغُلَامِ وَيُغْسَلُ بَوْلُ الْجَارِيَةِ " . قَالَ قَتَادَةُ وَهَذَا مَا لَمْ يَطْعَمَا فَإِذَا طَعَمَا غُسِلَا جَمِيعًا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . رَفَعَ هِشَامُ الدَّسْتَوَائِي هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ قَتَادَةَ وَأَوْفَقَهُ سَعِيدُ بْنُ أَبِي عَرُوبَةَ عَنْ قَتَادَةَ وَلَمْ يَرْفَعْهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

426. Mbi lehtësimin për xhunubin, i cili mund të ha dhe të fle, nëse merr avdes

باب مَا ذَكَرَ فِي الرُّخْصَةِ لِلْجُنُبِ فِي الْأَكْلِ وَالنَّوْمِ إِذَا تَوَضَّأَ

611. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Kabisi,⁵¹⁷ ai ka transmetuar nga Hammad b. Seleme, ai nga Ata el-Horasi, ai nga Jahja b. Ja’meri – që Ammari, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi

⁵¹¹ Nga ky hadith, mund të përfundohet, që këto dy ritle të ujit (815 gram) janë tërësisht të mjaftueshme për të marr abdest bukur dhe me përpikëri, e që kjo, të mos konsiderohet shpërdorim i ujit, i cili është mekruh. Nga hadithi, të cilin e shënon Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*, nga Ummu Ammare, e bija e Ka’bit, jemi duke e parë, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndonjëherë ka marr abdest me dy të tretat e mudit. Kjo domethënë, që abdesti, mund të merret edhe me sasi më të vogël të ujit. Shiko përmbledhjen e haditheve të Tirmidhiut, libri i I, faqe 158.

⁵¹² Ngjashëm kanë shënuar Ahmedi, në *Musned* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

⁵¹³ Neveviu thotë: “Këtu *mekuk* i të dërguarit, e ka domethënien e *muddit*, ndërsa *muddi* është ena, e cila, sipas mendimit të Ebu Hanifes përmbanë dy ritle të ujit.

⁵¹⁴ Muadh b. Hishami b. Ebu Abdullah ed-Destevai el-Basri, ka jetuar në Jemen. Është ravi i sinqertë, por ndonjëherë gabonte. Ka vdekur në vitin 200 sipas hixhretit.

⁵¹⁵ Ky është Hisham b. Ebu Abdullah Senber Ebu Bekr el-Basri el-Destevai. Ai është ravi i besueshëm dhe i sigurt. Dyshohej, që anonte kah kaderitë. I takonte gjeneratës së shtatë të ravive.

⁵¹⁶ Shiko më zgjerimisht, në përmbledhjen e hadithit, të Tirmidhiut, libri 1 faqe 182.

⁵¹⁷ Ka’bis b. Ukbe b. Muhammed b. Sufjan es-Suvai Ebu Amir el-Kufi, është ravi i sinqertë. Nga ai, hadithe kanë marr Buhariu, Ez-Zuheli dhe të tjerët.

i Allahut qoftë mbi të), e ka lejuar xhunubin, që nëse ai e dëshiron atë, të ha e të fle, nëse merr avdes, ashtu siç e merr atë për namaz.”⁵¹⁸ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁵¹⁹

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا قَبِيصَةُ، عَنْ حَمَّادِ بْنِ سَلَمَةَ، عَنْ عَطَاءِ الْخُرَّاسِيِّ، عَنْ يَحْيَى بْنِ يَعْمَرٍ، عَنْ عَمَّارٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ رَخَّصَ لِلْجُنُبِ إِذَا أَرَادَ أَنْ يَأْكُلَ أَوْ يَشْرَبَ أَوْ يَنَامَ أَنْ يَتَوَضَّأَ وَضُوءَهُ لِلصَّلَاةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

427. Mbi vlerat e namazit

باب مَا ذُكِرَ فِي فَضْلِ الصَّلَاةِ

612. Na ka treguar Abdullah b. Zijadi⁵²⁰ - atë e ka informuar Ubejdullah b. Musa,⁵²¹ atë Galib Ebu Bishër, ai ka transmetuar nga Ejub b. Aiz et-Taiju, ai nga Kajs b. Muslimi, ai nga Tarik b. Shihabi – që Ka’b b. Uxhre, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më ka thënë: “Kërkoj mbrojtje nga Allahu për ty, o Ka’b, i biri i Uxhres, nga sunduesi i cili ka për t’u shfaqur pas meje!”⁵²² Ai i cili ka për të shkuar tek ata, i cili ka për t’i vërtetuar të pavërtetat e tyre dhe ka për t’i ndihmuar në tirani – ai nuk më takon mua, e as unë nuk i takoj atij dhe nuk ka as për t’iu afruar Burimit!⁵²³ Ndërkaq, ai i cili nuk ka për të shkuar tek ata, ose ka për të shkuar, por nuk ka për t’ua vërtetuar të pavërtetat dhe nuk ka për t’i ndihmuar në tirani – ai më takon mua dhe unë i takoj atij dhe ka për t’iu afruar Burimit. O, Kab, i biri i Uxhres, namazi është dëshmi,⁵²⁴ asgjërimi është mburojë e pathyeshme,⁵²⁵ ndërsa sadakaja i shuan mëkatet, sikurse uji që e shuan zjarrin! O, Kab, i biri i Uxhres, me të vërtetë, çdo mish që është zhvilluar nga harami ka për t’u djegur në zjarrin e xhehenemit!”

⁵¹⁸ Personi i papastër, mundet të hajë, të pijë, apo të flejë, nëse më parë ka marr abdes. Me të vërtetë, është më mirë ta bëjë atë kur është i larë. Neveviu thotë, që dijetarët janë unik mbi atë, që marrja e avdesit për personin xhunub, i cili dëshiron të hajë, të pijë, nuk është e obliguar, por mustehab. Ibn Sejjidinas, në komentuarin e përmbledhjes së haditheve të Tirmidhiut, e transmeton qëndrimin e Ibn Umerit, i cili konsideron, se marrja e avdesit, në atë situatë, është vaxhib. Sa i përket personit xhunub, i cili dëshiron të flejë, dhahiritë dhe Ibn Habibi, konsiderojnë, se marrja e avdesit, para fjetjes, është vaxhib. Ata, këtë qëndrim e mbështesin mbi hadithin, të cilin e shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, nga Umer b. Hattabi, në të cilin qëndron, se ai ia ka përmendur të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se shpesh herë është xhunub gjatë natës dhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i ka thënë: “Laje organin gjenital, mandej merr abdes dhe fli.” Ndërsa, shumica e dijetarëve, konsiderojnë, se marrja e avdesit për xhunubin nuk është vaxhib, por mustehab. Ata, mendimin e vet, e bazojnë, mbi hadithin, të cilin e shënojnë Ebu Davudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, në *Sahihë*. Në atë hadith qëndron, se Ibn Umeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “A mundet që ndonjëri prej nesh të flejë xhunub?” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “Mundet, por së pari, nëse dëshiron le të merr abdes.”

⁵¹⁹ E kanë shënuar, Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*. Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, shënojnë nga Aishja këtë: “Në rast se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), bëhej xhunub dhe dëshironte të hante ose të flinte, merrte abdest, ashtu siç e merrte për namaz.”

⁵²⁰ Abdullah b. Hakim b. Ebu Zijad el-Kutvani el-Kufi, është njëri nga mësuesit e Tirmidhiut.

⁵²¹ Ubejdullah b. Musa el-Abesi el-Kufi, është ravi i besueshëm. Nga ai hadithe kanë shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

⁵²² Fjala ka të bëjë, për të gjithë sundimtarët, të cilët kanë për të poseduar dy veçori: kanë për të folur të pavërtetën dhe kanë për të qenë zullumqarë dhe kanë për të bërë padrejtësi.

⁵²³ Ky është burimi i njohur i Xhennetit, Kevther, tek i cili ka për të ardhur secili pasues i Muhammedit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Këtij burimi nuk ka për t’mundur t’i afrohet askush, që nuk i takon ummetit të Muhammedit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁵²⁴ Namazi, do të jetë argument, që ai, i cili e ka kryer atë, është mu’minë.

⁵²⁵ Agjërimi, është mburojë nga mëkatet.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib⁵²⁶ dhe nuk na është i njohur vetëm se në këtë mënyrë. E kam pyetur Muhammedin (Buhariun), mbi këtë hadith, ai nuk e njihje ndryshe, përveç nëpërmjet Ubejdullah b. Musait dhe atë e konsideronte shumë të çuditshme.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ أَبِي زِيَادٍ الْقَطَوَانِيُّ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا عُبيدُ اللَّهِ بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا غَالِبٌ أَبُو بَشِيرٍ، عَنْ أَيُّوبَ بْنِ عَائِذٍ الطَّائِي، عَنْ قَيْسِ بْنِ مُسْلِمٍ، عَنْ طَارِقِ بْنِ شِهَابٍ، عَنْ كَعْبِ بْنِ عُجْرَةَ، قَالَ قَالَ لِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَعِدْكَ بِاللَّهِ يَا كَعْبُ بْنُ عُجْرَةَ مِنْ أَمْرَاءَ يَكُونُونَ مِنْ بَعْدِي فَمَنْ غَشِيَ آبَاءَهُمْ فَصَدَّقَهُمْ فِي كَذِبِهِمْ وَأَعْلَاهُمْ عَلَى ظُلْمِهِمْ فَلَيْسَ مِنِّي وَلَسْتُ مِنْهُ وَلَا يَرُدُّ عَلَى الْحَوْضِ وَمَنْ غَشِيَ آبَاءَهُمْ أَوْ لَمْ يَغْشَ فَلَمْ يُصَدِّقَهُمْ فِي كَذِبِهِمْ وَلَمْ يُعْلَهُمْ عَلَى ظُلْمِهِمْ فَهُوَ مِنِّي وَأَنَا مِنْهُ وَسِيرِدُ عَلَى الْحَوْضِ يَا كَعْبُ بْنُ عُجْرَةَ الصَّلَاةُ بَرَهَانٌ وَالصَّوْمُ جَنَّةٌ حَصِينَةٌ وَالصَّدَقَةُ تُطْفِئُ الْخَطِيئَةَ كَمَا يُطْفِئُ الْمَاءُ النَّارَ . يَا كَعْبُ بْنُ عُجْرَةَ إِنَّهُ لَا يَرِيبُ لَحْمٌ ثَبَتَ مِنْ سَخْتِ إِلَّا كَانَتْ النَّارُ أَوَّلَى بِهِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ عُبيدِ اللَّهِ بْنِ مُوسَى . وَأَيُّوبُ بْنُ عَائِذٍ الطَّائِي بَضْعَفٌ وَيُقَالُ كَانَ يَرَى رَأَى الْإِزْجَاءَ . وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ فَلَمْ يَعْرِفْهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ عُبيدِ اللَّهِ بْنِ مُوسَى وَاسْتَعْرَبَهُ جَدًّا .

613. Muhammedi, ka thënë: “Na ka treguar Ibn Numejr këtë, duke transmetuar nga Ubejdullah b. Musai, ai nga Galibi.”

وَقَالَ مُحَمَّدٌ حَدَّثَنَا ابْنُ نُمَيْرٍ، عَنْ عُبيدِ اللَّهِ بْنِ مُوسَى، عَنْ غَالِبٍ، بِهَذَا .

428. Edhe një kapitull mbi temë të njëjtë

614. Na ka treguar Musa b. Abdurrahman el-Kufi⁵²⁷ - atë e ka informuar Zejd b. Hubabi , atë Muavi b. Salihi – që Sulejm b. Amiri,⁵²⁸ ka thënë: “E kam dëgjuar Ebu Umamen, kur ka thënë: ‘E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur në ligjërimin e Haxhit Lamtumirës ka thënë: ‘Kenë frikë Allahun, Sundimtarin tuaj! Falini pesë vaktet e namazit tuaj! Agjëroni muajin tuaj (të ramazanit)! Jepni zekatin për pasurinë tuaj! Nënshetrohuni përfaqësuesve tuaj – keni për të hyrë në Xhennetin e Sundimtarit tuaj!’”⁵²⁹

Sulejm b. Amiri, thotë: “I kam thënë Ebu Umames: “Sa vite ka prej kur e ke dëgjuar këtë hadith?!” ‘E kam dëgjuar atë kur i kam pasur tridhjetë vjet.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁵³⁰

حَدَّثَنَا مُوسَى بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا زَيْدُ بْنُ الْحُبَابِ، أَخْبَرَنَا مُعَاوِيَةُ بْنُ صَالِحٍ، حَدَّثَنِي سُلَيْمُ بْنُ عَامِرٍ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا أَمَامَةَ، يَقُولُ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَخْطُبُ فِي حَجَّةِ الْوَدَاعِ فَقَالَ " اتَّقُوا اللَّهَ رَبَّكُمْ وَصَلُّوا خُمُسَكُمْ وَصُومُوا شَهْرَكُمْ وَأَدُّوا زَكَاةَ أَمْوَالِكُمْ وَأَطِيعُوا إِذَا أَمَرَكُمْ تَدْخُلُوا جَنَّةَ رَبِّكُمْ " . قَالَ فَقُلْتُ لِأَبِي أَمَامَةَ مُنْذُ كَمْ سَمِعْتُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ هَذَا الْحَدِيثِ قَالَ سَمِعْتُهُ وَأَنَا ابْنُ ثَلَاثِينَ سَنَةً . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁵²⁶ E ka shënuar Nesaiu në *Sunen*.

⁵²⁷ Musa b. Abdurrahman b. Seid b. Mesruk el-Kindi Ebu Isa el-Kufi, është njëri nga mësuesit e Tirmidhiut. Ibn Haxheri thotë, që ka qenë i besueshëm dhe që i ka takuar gjeneratës së njëmbëdhjetë të ravive.

⁵²⁸ Sulejm b. Amir el-Kilai el-Hunsi është ravi i besueshëm. I takonte gjeneratës së tretë të ravive. Ka vdekur në vitin 130 sipas hixhretit.

⁵²⁹ Ebu Jusuf el-Zejlei, në veprën *Nasbur-raje-ehadisil-Hidaje*, përmend hadithin të cilin e ka shënuar Taberaniu në veprën *Musnedush-shamijin*, nga Ebu Derda: “Bëhuni të sinqertë, gjatë ibadetit ndaj Sundesit tuaj! Falini pesë namazet e juaja, jepni zekatin për pasurinë tuaj, agjëroni muajin tuaj të ramazanit, vizitoheni shtëpinë e Zotit tuaj – keni për të hyrë në Xhennetin e Sundesit tuaj.”

⁵³⁰ E kanë shënuar, Ibn Hibbani, në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*, Hakimi thotë, që ky hadith, sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit është i besueshëm.

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit

Kapitulli mbi Zekatin

كتاب الزكاة

عن رسول الله ﷺ

Nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)

1. Paralajmërim i ashpër, i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për mosdhënien e zekatit

باب مَا جَاءَ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي مَنَعِ الزَّكَاةِ مِنَ التَّشْدِيدِ

615. Na ka treguar Hennad b. Serijj – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Ma'rur b. Suvejdi⁵³¹ - që Ebu Dherre,⁵³² ka thënë: “Me një rast, erdha te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), derisa ishte duke ndenjtur në freskinë e Kabes. Duke më parë se jem duke shkuar kah ai, tha: “Pasha Sunduesin e Kabes, ata, në Ditën e Gjykimit kanë me qenë humbësit më të mëdhenj!” Duke menduar, se diç i është shpallur, në lidhje me mua, thash: “Do ta kisha dhënë edhe babanë edhe nënën për ty, cilët janë ata?” Në atë, i Dërguari i Allahut tha: “Të tillët janë ata, që kanë më së tepërmi (pasuri), duke i përjashtuar ata që kanë bërë kështu dhe kështu, duke ndarë para vetes, në anën e djathtë dhe në të majtën.” Pastaj tha: “Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, asnjë person nuk ka për të vdekur, duke lënë pas vete devetë dhe lopët e për të cilat nuk ka dhënë zekat, e që të mos i vijnë në Ditën e Gjykimit, më të shëndosha dhe më të trasha se që kanë qenë, ta shkelin atë me këmbë dhe ta therin me brirë! Çdoherë kur përfundon ajo e fundit, ka për t'u kthyer ajo e para – dhe ashtu, gjithnjë, derisa nuk gjykohen të gjithë njerëzit.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, njëkohësisht me të mëparshmin, nga Ali b. Ebu Talibi, i cili ka thënë: “I mallkuar është, secili që refuzon të jap zekat!” – Nga Kabise b. Hubi, ai nga babai i vet, Xhabir b. Abdullahu dhe Abdullah b. Mes'udi. Hadithi i Ebu

⁵³¹ Ma'rur b. Suvejd Ebu Umejje el-Esedi el-Kufi është ravi i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së dytë të transmetuesve të hadithit. Ka jetuar 120 vjet.

⁵³² Emri i Ebu Dherre el-Gidarit, është, Xhundub b. Xhunade ose Xhundub b. Seken. Ai është as'hab i njohur. Islamit e ka pranuar derisa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë ende në Mekke. Disa biografi, pohojnë se i pesti e ka pranuar islamit. Pasi që e ka pranuar Islamit, është kthyer në vendlindje. Pas betejës së Hendekut, është shpërngulur në Medine. Ka banuar në vendin Rebza pranë Medines. Ka vdekur vitin 32 sipas hixhretit, në kohën e hilafetit të Uthmanit. Dhehebiu pohon se me dituri mund të krahasohet me Abdullah b. Mes'udin.

Dherres është hasen-sahih.⁵³³ Emri i Ebu Dherres, është Xhundub b. Seken, por është thënë Ibn Xhunade.”

حَدَّثَنَا هَنَادُ بْنُ السَّرِيِّ التَّمِيمِيُّ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنِ الْمَعْرُورِ بْنِ سُوَيْدٍ، عَنْ أَبِي ذَرٍّ، قَالَ جِئْتُ إِلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ وَهُوَ جَالِسٌ فِي ظِلِّ الْكَعْبَةِ . قَالَ فَرَأَنِي مُقْبِلًا فَقَالَ " هُمُ الْأَخْسَرُونَ وَرَبِّ الْكَعْبَةِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ " . قَالَ فَقُلْتُ مَا لِي لَعَلَّهُ أَنْزَلَ فِيَّ شَيْءً . قَالَ قُلْتُ مَنْ هُمْ فِدَاكَ أَبِي وَأُمِّي . فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " هُمُ الْأَخْسَرُونَ إِلَّا مَنْ قَالَ هَكَذَا وَهَكَذَا " . فَحُتْنَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَعَنْ بَيْمِيهِ وَعَنْ شِمَالِهِ . ثُمَّ قَالَ " وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَا يَمُوتُ رَجُلٌ فَيَدْعُ إِبِلًا أَوْ بَقَرًا لَمْ يُؤَدِّ زَكَاتَهَا إِلَّا جَاءَتْهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أُعْظِمَ مَا كَانَتْ وَأَسْمَنَتْ تَطَوُّهُ بِأَخْفَافِهَا وَتَنْتَطَحُهُ بِفُرُونِهَا كُلَّمَا نَفَذَتْ أَحْرَاهَا عَادَتْ عَلَيْهِ أَوْلَاهَا حَتَّى يُقْضَى بَيْنَ النَّاسِ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ مِثْلُهُ . وَعَنْ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ لَعَنَ مَانِعَ الصَّدَقَةِ . وَعَنْ قَبِيصَةَ بْنِ هُلُبٍ عَنْ هُلُبٍ عَنْ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي ذَرٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَاسْمُ أَبِي ذَرٍّ جُنْدُبُ بْنُ السَّكَنِ وَيُقَالُ ابْنُ جُنَادَةَ .

616. Na ka treguar Abdullah b. Muniri, duke transmetuar nga Ubejdullah b. Musai, ai nga Sufjan eth-Thevriu, ai nga Hakim b. Dejlemi – që Dahak b. Muzahimi,⁵³⁴ ka thënë: “Të pasur konsiderohen të gjithë ata, që posedojnë dhjetëmijë (dërhëm).” Dhe thotë se Abdullah bin Munir Mervezi është njeri i sinqertë.

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُنِيرٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مُوسَى عَنْ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ عَنْ حَكِيمِ بْنِ الدَّيْلَمِ عَنِ الصَّخَّائِ بْنِ مُزَاحِمٍ قَالَ الْأَكْثَرُونَ أَصْحَابُ عَشْرَةِ آلَافٍ . قَالَ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ مُنِيرٍ مَرْوَزِيُّ رَجُلٌ صَالِحٌ .

2. Kur e paguan zekatin e ke përmbushur atë që kërkohet nga ti

بَابُ مَا جَاءَ إِذَا أُدِّيَتْ الزَّكَاةُ فَقَدْ قُضِيََتْ مَا عَلَيْكَ

617. Na ka treguar Umer b. Hafs esh-Shejbani, atë e ka informuar Abdullah b. Vehbi, atë Amr b. Harithi, ai ka transmetuar nga Derraxhi,⁵³⁵ ai nga Ibn Huxhejri,⁵³⁶ ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur e paguan zekatin për pasurinë, e ke përmbushur atë që kërkohet nga ti.”⁵³⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”⁵³⁸

Është transmetuar, në shumë mënyra, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka përmendur zekatin. Një njeri e kishte pyetur: “O i Dërguar i Allahut, a jam i obliguar të jap diçka më tepër nga pasuria, përveç zekatit?” “Jo.” – u përgjigj ai – “përveç se ta bësh atë vullnetarisht.”

Ebu Isai, thotë: “Ibn Huxhejre është Abdurrahman b. Huxhejr el-Basri.”

حَدَّثَنَا عُمَرُ بْنُ حَفْصٍ الشَّيْبَانِيُّ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ وَهْبٍ، أَخْبَرَنَا عَمْرُو بْنُ الْحَارِثِ، عَنْ دَرَّاجٍ، عَنْ ابْنِ حُجْرَةَ، هُوَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ حُجْرَةَ الْمِصْرِيُّ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " إِذَا أُدِّيَتْ زَكَاةُ مَالِكَ فَقَدْ قُضِيََتْ مَا عَلَيْكَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى . هَذَا

⁵³³ E kanë shënuar edhe Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁵³⁴ Dahak b. Muzahim Ebu Kasim el-Hilali el-Horasani, është tabi'in i njohur. Hadithet i transmetonte nga Ebu Hurejre, Ibn Abbasi dhe nga as'habët e tjerë. Sejid b. Xhubejri pohon, që ai nuk është takuar me Ibn Abbasin. Ahmed b. Hanbeli, Jahja b. Meini dhe Ebu Zur'a, e vlerësojnë si ravi të besueshëm. Ibn Hibbani, thotë: “Të gjitha që ai ka transmetuar, duhet të verifikohen.” Shquhej si njohës i jashtëzakonshëm i *tefsirit*. Ka vdekur në vitin 105 sipas hixhretit.

⁵³⁵ Deraxh b. Sem'an Ebu Semh. Disa thonë, që emri i tij është Abdurrahman, ndërsa pseudonimi Derraxh. Jahja b. Meini, e konsideron të besueshëm, ndërsa ed-Darekutni si ravi të dobët. Ebu Davudi thotë: “Të gjitha hadithet i ka të qëndrueshme, përveç atyre të cilët i transmeton nga Ebul-Hejthemi.”

⁵³⁶ Abdurrahman b. Huxhejre, është ravi i besueshëm.

⁵³⁷ Ebu Tajjib es-Sindi thotë, që nga ky hadith mund të përfundojmë që, përveç zekatin nuk ekziston ndonjë mënyrë e obliguar e ndarjes së pasurisë.

⁵³⁸ E kanë shënuar, Hakimi, në *Mustedrek* dhe Ibn Maxhe, në *Sunen*. Hakimi e konsideron, si hadith të besueshëm, sipas kritereve të Hibbanit.

حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَقَدْ رُوِيَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ أَنَّهُ ذَكَرَ الزَّكَاةَ . فَقَالَ رَجُلٌ يَا رَسُولَ اللَّهِ هَلْ عَلَيَّ غَيْرُهَا فَقَالَ " لَا إِلَّا أَنْ تَتَطَوَّعَ " .

618. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili⁵³⁹ - atij i ka treguar Ali b. Abdulhamid el-Kufi, atij Sulejman b. Mugire, duke transmetuar nga Thabiti⁵⁴⁰ - që Enesi ka thënë: “Dëshironim, që ndonjë beduin i zgjuar të fillonte ta pyeste të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), derisa edhe ne ishim tek ai.”⁵⁴¹ Kështu, një ditë derisa ishim me të, erdhi një beduin,⁵⁴² u ul në gjunjë përpara të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: “O, Muhammed, përfaqësuesi yt erdhi te ne dhe na tregoi që je duke pohuar, që të ka dërguar Allahu (si të Dërguarin e Vet)?” “Po, pohoj.” – tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai, në atë tha: “Pash Atë, i Cili i ka ngritur qiejt, e ka shtruar Tokën dhe i ka ngritur kodrat, a të ka dërguar Allahu?” “Po.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai vazhdoi: “Përfaqësuesi yt na thotë, që je duke pohuar, se jemi të obliguar që çdo ditë dhe natë t’i falim pesë namaze?” “Po.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai në atë tha: “Pash Atë, i Cili të ka dërguar, a ta ka urdhëruar Allahu atë?” – dhe vazhdoi: “Përfaqësuesi yt, na thotë, se je duke pohuar që jemi të obliguar të agjërojmë një muaj në vit?” “Të vërtetën e ka thënë.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ai në atë tha: “Pash Atë, i Cili të ka dërguar, a të urdhëroi Allahu atë?” “Po.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai, vazhdoi: “Përfaqësuesi yt, na thotë që je duke pohuar, se jemi të obliguar, që nga pasuria jonë të ndajmë zekat?” “Të vërtetën e ka thënë.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ai në atë tha: “Pash Atë, i Cili të ka dërguar, a të ka urdhëruar atë Allahu?” “Po, Ai më ka urdhëruar.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai vazhdoi: “Përfaqësuesi yt, thotë që je duke pohuar, që jemi të obliguar për ta vizituar shtëpinë e Allahut, ai i cili ka mundësi?” “Po.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai në atë tha: “Pash Atë i Cili të ka dërguar, a të urdhëroi Allahu atë?” “Po.” – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Pas asaj, beduini tha: “Pasha Atë, i Cili të ka dërguar me të vërtetën, unë nga këto, nuk kam për të lënë asgjë, e as nuk kam për të shtuar asgjë!”⁵⁴³ – pastaj shkoi. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “Nëse beduini e ka folur të vërtetën, ka për të hyrë në Xhennet.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith, në këtë formë, është hasen-garib,⁵⁴⁴ ndërsa është i transmetuar edhe në një mënyrë tjetër, nëpërmjet Enesit, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). E kam dëgjuar Muhammed b. Ismailin, kur ka thënë: ‘Disa dijetarë të hadithit, konsiderojnë që leximi (bashkëbisedimi) dhe të paraqiturit përball dijetarit, është sikurse të dëgjuarit. Ata si argument për atë,

⁵³⁹ Ebu Abdullah Muhammed b. Ismail b. Ibrahim el-Xhufi el-Buhariu, është dijetar i shquar i hadithit dhe mësuesi i Tirmidhiut. Është shkrimtar i veprës së njohur *Xhamius-sahih*. Ka lindur në vitin 194, ndërsa ka vdekur në vitin 256 sipas hixhretit.

⁵⁴⁰ Thabit b. Eslem el-Bunani el-Basri, është njeri i besueshëm dhe jashtëzakonisht i përlurur. I takonte gjeneratës së katër të ravive.

⁵⁴¹ Ibn Haxheri, në veprën *Fet’hul-Bari*, thekson se në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e transmeton Musa b. Ismaili, nga Enes b. Maliku, në fillim të hadithit, qëndron, se Enesi ka thënë: “Me Kur’an, na është ndaluar që të pyesim të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe gëzoheshim kur vinte ndonjë beduin i mençur që nuk dinte për atë ndalesë dhe të fillonte ta pyeste të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në prezencën tonë.” El-Mubarekfuri mendon, në ndalesën e të pyeturit, e cila qëndron në ajet: “*O besimtarë! Mos pyesni për gjëra, që, sikur t’ju thuheshin haptazi, nuk do t’ju pëlqenin e, nëse do të pyesnit për to kur ju shpallet Kurani, do t’ju bëheshin të qarta. Allahu jua ka falur kërshtërinë. Se Allahu është Falës dhe i Butë.*” [El-Maide: 101]

⁵⁴² Damam b. Tha’lebe.

⁵⁴³ Pasha Allahun, të gjitha që i kam të obliguara, kam për t’i kryer rregullisht dhe asgjë prej tyre kurrë nuk kam për të lëshuar! Por, përveç atyre, kurrfarë ibadeti vullnetar nuk kam për ta praktikuar.

⁵⁴⁴ E ka shënuar Buhariu në *Sahih*, pa sened (mul-lak). E ka përjashtuar senedin, sepse në të gjendet Sulejman b. Mugire, i cili sipas mendimit të tij, nuk është transmetues i fuqishëm, që t’ma tërhiqte vëmendjen.

e cekin shembullin, ku beduini ia ka paraqitur (atë çfarë ka pasur) të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndërsa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ia ka lejuar atë.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ عَبْدِ الْحَمِيدِ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا سُلَيْمَانُ بْنُ الْمُغِيرَةِ، عَنْ ثَابِتٍ، عَنْ أَنَسٍ، قَالَ كُنَّا نَتَمَتَّى أَنْ يَأْتِيَ، الْأَعْرَابِيُّ الْعَاقِلُ فَيَسْأَلُ النَّبِيَّ ﷺ وَنَحْنُ عِنْدَهُ فَيَبْنِئُ نَحْنُ عَلَى ذَلِكَ إِذْ أَتَاهُ أَعْرَابِيٌّ فَجَنَّا بَيْنَ يَدَيْ النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَ يَا مُحَمَّدُ إِنَّ رَسُولَكَ أَتَانَا فَرَعِمَ لَنَا أَنْتَ تَزْعُمُ أَنَّ اللَّهَ أَرْسَلَكَ . فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَيَالَّذِي رَفَعَ السَّمَاءَ وَبَسَطَ الْأَرْضَ وَنَصَبَ الْجِبَالَ اللَّهُ أَرْسَلَكَ فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَإِنَّ رَسُولَكَ زَعَمَ لَنَا أَنْتَ تَزْعُمُ أَنَّ عَلَيْنَا خَمْسَ صَلَوَاتٍ فِي الْيَوْمِ وَاللَّيْلَةِ . فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَيَالَّذِي أَرْسَلَكَ اللَّهُ أَمَرَكَ بِهَذَا قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَإِنَّ رَسُولَكَ زَعَمَ لَنَا أَنْتَ تَزْعُمُ أَنَّ عَلَيْنَا فِيهِ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ " صَدَقَ " . قَالَ فَيَالَّذِي أَرْسَلَكَ اللَّهُ أَمَرَكَ بِهَذَا قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَإِنَّ رَسُولَكَ زَعَمَ لَنَا أَنْتَ تَزْعُمُ أَنَّ عَلَيْنَا الرِّكَاتَةَ . فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " صَدَقَ " . قَالَ فَيَالَّذِي أَرْسَلَكَ اللَّهُ أَمَرَكَ بِهَذَا فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَإِنَّ رَسُولَكَ زَعَمَ لَنَا أَنْتَ تَزْعُمُ أَنَّ عَلَيْنَا الْحَجَّ إِلَى الْبَيْتِ مِنْ اسْتِطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا . فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . قَالَ فَيَالَّذِي أَرْسَلَكَ اللَّهُ أَمَرَكَ بِهَذَا فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " نَعَمْ " . فَقَالَ وَالَّذِي بَعَثَكَ بِالْحَقِّ لَا أَدْعُ مِنْهُمْ شَيْئًا وَلَا أَجَاوِزُهُنَّ . ثُمَّ وَثَبَ فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " إِنَّ صَدَقَ الْأَعْرَابِيُّ دَخَلَ الْجَنَّةَ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَقَدْ رَوَى مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ عَنْ أَنَسٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . سَمِعْتُ مُحَمَّدَ بْنَ إِسْمَاعِيلَ يَقُولُ قَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ فَهَذَا الْحَدِيثُ أَنَّ الْقِرَاءَةَ عَلَى الْعَالِمِ وَالْعُرْضُ عَلَيْهِ جَائِزٌ مِثْلُ السَّمَاعِ . وَاحْتَجَّ بِأَنَّ الْأَعْرَابِيَّ عَرَضَ عَلَى النَّبِيِّ ﷺ فَأَقَرَّ بِهِ النَّبِيُّ ﷺ .

3. Mbi zekatin për ari dhe argjend

باب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ الذَّهَبِ وَالْوَرِقِ

619. Na ka treguar Muhammed b. Abdulmelik b. Ebush-Shevarib – atë e ka informuar Ebu Avan, ai ka transmetuar nga Ebu Is’haku, ai nga Asim b. Damre, e ai nga Aliu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Unë ua kam falur zekatin për kuajt dhe për robërit.⁵⁴⁵ Prandaj, jepni zekat për argjend dhe atë në çdo dyzet derhem një derhem. Në njëqind e nëntëdhjetë derhem, mua nuk më takon asgjë.⁵⁴⁶ Ndërkaq, nëse e arrin dyqind derhem, atëherë pesë derhem i takojnë (zekatit).”⁵⁴⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Bekër Es-Sidiku dhe Amr b. Hamzai. Këtë hadith, e kanë transmetuar A’meshi, Ebu Avani dhe të tjerët, nga Ebu Is’haku, ai nga Asim b. Damreu, ai nga Aliu. Ndërsa, e kanë transmetuar edhe Sufjan eth-Thevriu, Ibn Ujejne dhe shumë të tjerë nga Ebu Is’haku, ai nga Harithi, ndërsa ai nga Aliu. E kam pyetur Muhammed b. Ismailin, mbi këtë hadith, ai më tha: ‘Këto dy rrugë, nëpërmjet Ebu Is’hakut, sipas meje janë të besueshme. Ekziston mundësia që ai këtë hadith e transmeton nga ata të dytë.’”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ أَبِي الشَّوَارِبِ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " قَدْ عَفَوْتُ عَنْ صَدَقَةِ الْخَيْلِ وَالرَّقِيقِ فَهَاتُوا صَدَقَةَ الرِّقَةِ مِنْ كُلِّ أَرْبَعِينَ دِرْهَمًا دِرْهَمًا وَلَيْسَ فِي تِسْعِينَ وَمِائَةٍ شَيْءٌ فَإِذَا بَلَغْتَ مِائَتَيْنِ فَفِيهَا خَمْسَةُ الدَّرَاهِمِ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ وَعَمْرِو بْنِ حَرْمٍ . قَالَ أَبُو عِيْسَى رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ الْأَعْمَشُ وَأَبُو عَوَانَةَ وَغَيْرُهُمَا عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ عَنْ عَاصِمِ بْنِ ضَمْرَةَ عَنْ عَلِيٍّ وَرَوَى سَفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ عُيَيْنَةَ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ عَنْ الْحَارِثِ عَنْ عَلِيٍّ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ فَقَالَ كِلَاهُمَا عِنْدِي صَحِيحٌ عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ يُحْتَمَلُ أَنْ يَكُونَ رَوَى عَنْهُمَا جَمِيعًا .

⁵⁴⁵ Të cilat, nuk janë të dedikuara për tregti, por, iu shërbejnë për nevojat personale.

⁵⁴⁶ E ka përmendur njëqind e nëntëdhjetë, sepse ajo është dhjetëshja e fundit para dyqindëshit. Qëllimi i tij ka qenë, që të tregonte mbi atë, që nuk ka zekat për argjend, për atë që ka më pak se dyqind derhemë. Kur vlera e tij arrin dyqind derhemë dhe i realizon kushtet e nisabit, në emër të zekatit jepen 2.5 përqind.

⁵⁴⁷ Sipas mendimit të Ibn Haxherit, këtë hadith e ka shënuar edhe Ebu Davudi në *Sunen*, me sened të mirë.

4. Mbi zekatin për deve dhe bagëtitë e imta

باب ما جاء في زكاة الإبل والغنم

620. Na kanë treguar, Zijad b. Ejjub el-Bagdadi, Ibrahim b. Abdullah el-Hirevi dhe Muhammed b. Kjamil el-Mervezi (të njëjtin kuptim) – ata i ka informuar Abbad b. Avvami, duke transmetuar nga Sufjan b. Husejni, ai nga Zuhriu, ai nga Salimi, ai nga babai i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka dhënë të shkruhet kitabi (libri) mbi zekatin dhe e ka vendos në këllëf, afër shpatës së vet.⁵⁴⁸ Ndërkaq, ai deri në vdekje nuk ua ka publikuar mbledhësve të zekatit. Pasi që është shpërngulur në Ahiret, sipas tij ka vepruar Ebu Bekri, pas tij edhe Umeri deri në vdekje. Në të qëndronte: “Për pesë deve, një dele.”⁵⁴⁹ Për dhjetë deve, dy dele. Për pesëmbëdhjetë deve, tri dele. Për njëzet deve, katër dele. Që nga njëzet e pesë deve deri tridhjetë e pesë deve, duhet dhënë një deve femër, e cila i ka mbushur një vit dhe ka hyrë në vitin e dytë.⁵⁵⁰ Nëse ka më tepër se aq – deri në dyzet e pesë – duhet dhënë devenë femër e cila i ka mbushur dy dhe ka hyrë në vitin tretë. Nëse ka më tepër se aq - deri në gjashtëdhjetë – një deve e cila i ka mbushur tre dhe ka hyrë në vitin e katërt. Nëse ka më tepër se aq, deri në shtatëdhjetë e pesë – një deve e cila i ka mbushur katër vjet dhe ka hyrë në vitin e pestë. Nëse ka më tepër se aq – deri në nëntëdhjetë – dy deve femra të cilat i kanë mbushur nga dy dhe kanë hyrë në vitin e tretë. Nëse ka më tepër se aq – deri në njëqind e njëzet – dy deve të cilat i kanë mbushur tre dhe kanë hyrë në vitin e katërt. Por, nëse tejkalohe shifra nga njëqind e njëzet, për çdo pesëdhjetë deve - një deve, e cila i ka mbushur tre dhe ka hyrë në vitin e katërt, ndërsa, për çdo dyzet deve, një deve femër, e cila i ka mbushur dy dhe ka hyrë në vitin e tretë. Ndërsa, sa u përket bagëtime të imta (berrave), çdo njeri që ka nga dyzet e deri njëqind e njëzet kokë, ka për të dhënë nga një dele. Cili ka më tepër se aq – deri dyqind kokë – ka për të dhënë dy dele. Cili ka më tepër se aq – deri treqind kokë – ka për të dhënë tri dele. Nëse ka për t’i pasur më tepër se treqind, për çdo njëqind që pasojnë ka për të dhënë nga një dele. Më tepër se tre dele - nuk ka për t’i dhënë, gjithnjë, derisa nuk ka për t’i pasur katërqind. Nuk kanë për t’i mbushur tufat e ndara, as nuk kanë për t’u ndarë tufat që janë bashkë, nga frika që të mos u dal zekati më tepër.⁵⁵¹ Ata të cilët i kanë përzier tufat për zekat, kanë për të dhënë secili aq sa posedon. Në emër të zekatit nuk ka për t’u pranuar ajo që është shumë e vjetër,⁵⁵² e as ajo që ka të meta.”

Zuhriu, thotë: “Kur mbledhësi i zekatit vjen te pronari i pasurisë, për ta marr zekatin, së pari ka për t’i ndarë bagëtinë e imtë, në tre pjesë: Një pjesë janë ata më të mirët, pjesa e dytë janë ata të mesmit dhe pjesa e tretë më të këqijtë. Mbledhësi, në emër të zekatit, ka për të marr nga pjesa e mesme.” Zuhriu, këtu nuk i ka përmendur bagëtitë.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Bekër es-Siddiku, Behz b. Hakimi, nga babai i tij, ndërsa ai nga ai nga gjyshi i tij, Ebu Dherri dhe Enesi. Hadithi i Ibn Umerit është hasen. Sipas këtij hadithi, kanë vepruar shumica e juristëve islam. Junus b. Jezidi dhe shumë të

⁵⁴⁸ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, që të shkruhet libri mbi dispozitat e zekatit. Ai, atë libër e ka vënë në këllëf të shpatës së vet, me qëllim, që kur i jepej rasti për atë, t’i tubonte të gjithë mbledhësit e zekatit dhe t’ua publikonte atë. Mu pas vdekjes së tij, ai libër është gjetur në këllëfin e shpatës së tij.

⁵⁴⁹ Për pesë deve, duhet dhënë një dele, në emër të zekatin, në dhjetë dy dele – dhe ashtu me radhë, siç është e sqaruar në këtë hadith.

⁵⁵⁰ Ai, i cili posedon njëzet e pesë, deri tridhjetë e pesë dele, është i obliguar, që në emër të zekatin të japë një deve femër, e cila i ka mbushur një vit dhe ka hyrë në vitin e dytë.

⁵⁵¹ Nuk është e lejuar, për shembull, që tre posedues të dyzet deleve, për të cilat janë të detyruar, që secili të jep nga një qengj, para ardhjes së mbledhësit të zekatit, t’i bashkojnë kopetë në një, që për njëqind e nëntëdhjetë dele të tretë të japin vetëm një qengj.

⁵⁵² Mbi kafshën shumë të moshuar, mendohet mbi kafshën, e cila, për shkak të vjetërsisë, i ka humbur dhëmbët.

tjerë, këtë hadith e kanë transmetuar nga Zuhriu, ndërsa ai nga Salimi dhe nuk e kanë lidhur atë për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Për të e ka lidhur Sufjan b. Husejini.”

حَدَّثَنَا زِيَادُ بْنُ أَبِي أَيُّوبَ الْبَغْدَادِيُّ، وَإِبْرَاهِيمُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الْهَرَوِيُّ، وَمُحَمَّدُ بْنُ كَامِلٍ الْمَرْزُوقِيُّ الْمَعْنَى، وَاجِدٌ، قَالُوا حَدَّثَنَا عَبْدُ بْنُ الْعَوَّامِ، عَنْ سُفْيَانَ بْنِ حُسَيْنٍ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ أَبِيهِ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَتَبَ كِتَابَ الصَّدَقَةِ فَلَمْ يُخْرِجْهُ إِلَى عَمَّالِهِ حَتَّى قُبِضَ فَقَرَنَهُ بِسَيْفِهِ فَلَمَّا قُبِضَ عَمَلُ بِهِ أَبُو بَكْرٍ حَتَّى قُبِضَ وَعُمَرُ حَتَّى قُبِضَ وَكَانَ فِيهِ " فِي خُمْسٍ مِنَ الْإِبِلِ شَاةٌ وَفِي عَشْرِ شَاتَانِ وَفِي خُمْسٍ عَشْرَةَ ثَلَاثَ شِيَاهٍ وَفِي عَشْرِينَ أَرْبَعًا شِيَاهٍ وَفِي خُمْسٍ وَعَشْرِينَ بَنْتُ مَخَاضٍ إِلَى خُمْسٍ وَثَلَاثِينَ فَإِذَا زَادَتْ فِيهَا ابْنَةُ لَبُونٍ إِلَى خُمْسٍ وَأَرْبَعِينَ فَإِذَا زَادَتْ فِيهَا حَقَّةٌ إِلَى سِتِّينَ فَإِذَا زَادَتْ فِيهَا جَذَعَةٌ إِلَى خُمْسٍ وَسَبْعِينَ فَإِذَا زَادَتْ فِيهَا ابْنَةُ لَبُونٍ إِلَى تِسْعِينَ فَإِذَا زَادَتْ فِيهَا حَقَّتَانِ إِلَى عَشْرِينَ وَمِائَةٍ فَإِذَا زَادَتْ عَلَى عَشْرِينَ وَمِائَةٍ فِي كُلِّ خُمْسِينَ حَقَّةٌ وَفِي كُلِّ أَرْبَعِينَ ابْنَةُ لَبُونٍ . وَفِي الشَّاءِ فِي كُلِّ أَرْبَعِينَ شَاةٌ إِلَى عَشْرِينَ وَمِائَةٍ فَإِذَا زَادَتْ فَشَاتَانِ إِلَى مِائَتَيْنِ فَإِذَا زَادَتْ فَثَلَاثُ شِيَاهٍ إِلَى ثَلَاثِمِائَةٍ شَاةٌ فَإِذَا زَادَتْ عَلَى ثَلَاثِمِائَةٍ شَاةٌ فِي كُلِّ مِائَةٍ شَاةٌ ثُمَّ لَيْسَ فِيهَا شَيْءٌ حَتَّى تَبْلُغَ أَرْبَعِمِائَةٍ وَلَا يَجْمَعُ بَيْنَ مُتَفَرِّقٍ وَلَا يُفَرِّقُ بَيْنَ مُجْتَمِعٍ مَخَافَةَ الصَّدَقَةِ وَمَا كَانَ مِنْ خَلِيطَيْنِ فَإِنَّهُمَا يَتَرَاوَعَانِ بِالسَّوِيَّةِ وَلَا يُؤْخَذُ فِي الصَّدَقَةِ هَرَمَةٌ وَلَا ذَاتُ عَيْبٍ " . وَقَالَ الزُّهْرِيُّ إِذَا جَاءَ الْمُصَدِّقُ فَسَمِ الشَّاءَ أَثَلَاثًا ثَلَاثَ خِيَارٍ وَثَلَاثَ أَوْسَاطٍ وَثَلَاثَ شِرَازٍ وَأَخَذَ الْمُصَدِّقُ مِنَ الْوَسْطِ . وَلَمْ يَذْكُرِ الزُّهْرِيُّ الْبَقَرِ . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ وَبَهْرِ بْنِ حَكِيمٍ عَنْ أَبِيهِ عَنْ جَدِّهِ . وَأَبِي ذَرٍّ وَأَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ عَامَّةِ الْفُقَهَاءِ . وَقَدْ رَوَى يُونُسُ بْنُ يَزِيدَ وَغَيْرٌ وَاجِدٌ عَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ سَالِمٍ هَذَا الْحَدِيثَ وَلَمْ يَرْفَعُوهُ وَإِنَّمَا رَفَعَهُ سُفْيَانُ بْنُ حُسَيْنٍ .

5. Mbi zekatin për lopë dhe për (bagëti të trashë)

باب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ الْبَقَرِ

625. Na kanë treguar Muhammed b. Ubejd el-Muharibi dhe Ebu Seid el-Eshexhxi – ata i ka informuar Abduselam b. Harbi, ai ka transmetuar nga Husajfi,⁵⁵³ ai nga Ebu Ubejde,⁵⁵⁴ ai nga Abdullah b. Mes’udi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për tridhjetë kokë gjedhë, një mëz ose një mështjerrë, të cilët e kanë mbushur një vit dhe kanë hyrë në vitin e dytë. Por, për çdo dyzet gjedhë, një mëz ose mështjerre, të cilët i kanë mbushur dy vite dhe kanë hyrë në vitin e tretë.”⁵⁵⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi nga Muadh b. Xhebeli. Ashtu, Abduselam b. Harbi ka transmetuar nga Husajfi. Ndërsa, Abduselami është ravi i besueshëm dhe hafiz i hadithit. Sheriku këtë hadith e ka transmetuar nga Husajfi, ai nga Ebu Ubejde, e ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Abdullahu. Ndërkaq, Ebu Ubejde b. Abdullahu nuk ka dëgjuar hadithe nga babai i vet.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عُيَيْنَةَ الْمُحَارِبِيُّ، وَأَبُو سَعِيدٍ الْأَشْجِيُّ قَالَا حَدَّثَنَا عَبْدُ السَّلَامُ بْنُ حَرْبٍ، عَنْ خُصَيْفٍ، عَنْ أَبِي عُيَيْنَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " فِي ثَلَاثِينَ مِنَ الْبَقَرِ تَبِيعٌ أَوْ تَبِيعَةٌ وَفِي أَرْبَعِينَ مِئْتَةٌ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَكَذَا رَوَاهُ عَبْدُ السَّلَامِ بْنُ حَرْبٍ عَنْ خُصَيْفٍ وَعَبْدُ السَّلَامِ ثَقَّةٌ حَافِظٌ . وَرَوَى شَرِيكَ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ خُصَيْفٍ عَنْ أَبِي عُيَيْنَةَ عَنْ أُمِّهِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ . وَأَبُو عُيَيْنَةَ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ لَمْ يَسْمَعْ مِنْ عَبْدِ اللَّهِ .

622. Na ka treguar, Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Sufjani, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Ebu Vaili, ai nga Mesruku – që Muadh b. Xhebeli, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më dërgoi në Jemen dhe më urdhëroi që për çdo tridhjetë gjedhe, ta marr një mëz ose një mështjerre, të cilët e kanë mbushur një vit dhe kanë hyrë në vitin e dytë. Për çdo dyzet gjedhe, një mëz ose një mështjerre, të cilët i kanë mbushur dy vite dhe kanë

⁵⁵³ Husa’jf b. Abdurrahman el-Xhezeri e kishte memorien e dobët. Para fundit të jetës, është bërë harrestar. I takonte gjeneratës së pestë të ravive.

⁵⁵⁴ Ebu Ubejde Amir b. Abdullah b. Mes’ud el-Kufi, është transmetues i njohur. I takonte gjeneratës së tretë të ravive. Disa mendojnë, që nuk ka dëgjuar hadithe nga babai i vet.

⁵⁵⁵ Me këtë dhe hadithet e tjera në vijim, është caktuar nisabi i zekatin, për kafshët e trasha. Ajo përmban tridhjetë gjedhë. Pra, kush posedon tridhjetë gjedhë, duke i përmbushur edhe disa kushte, i nënshtrohet obligimit të zekatit – edhe atë, një viç një vjeçar. Nëse posedon 4 gjedhë, është i obliguar, që në emër të zekatin të japë një viç dy vjeçar.

hyrë për vitin e tretë. Ndërsa, nga çdo mashkull të moshës madhore, në emër të tatimit,⁵⁵⁶ një dinar ose si kundërvlerë rroba mehafirase.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.⁵⁵⁷ Disa, këtë hadith e kanë transmetuar nga Sufjani, ai nga A’meshi, ai nga Ebu Vaili, ndërsa ai nga Mesruku. Në të qëndron: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka dërguar Muadhin në Jemen dhe e ka urdhëruar që t’i marr...” Kjo është më e besueshme.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيَالَانَ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا سُفْيَانُ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي وَائِلٍ، عَنْ مَسْرُوقٍ، عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ، قَالَ بَعَثَنِي النَّبِيُّ ﷺ إِلَى الْيَمَنِ فَأَمَرَنِي أَنْ أَخَذَ مِنْ كُلِّ ثَلَاثِينَ بَقْرَةً تَبِيعًا أَوْ تَبِيعَةً وَمِنْ كُلِّ أَرْبَعِينَ مِئْتَةً وَمِنْ كُلِّ حَالِمٍ دِينَارًا أَوْ عِدْلَهُ مَعَاوَرًا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَرَوَى بَعْضُهُمْ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ سُفْيَانَ عَنِ الْأَعْمَشِ عَنْ أَبِي وَائِلٍ عَنْ مَسْرُوقٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ بَعَثَ مُعَاذًا إِلَى الْيَمَنِ فَأَمَرَهُ أَنْ يَأْخُذَ . وَهَذَا أَصَحُّ .

623. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Muhammed b. Xhaferi, atë Shu’be – që Amr b. Murre, ka thënë; “E pyeta Ebu Ubejden: “A mbanë në mend diç nga Abdullahu?” “Jo.” – u përgjigj ai.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ حَدَّثَنَا شُعْبَةُ عَنْ عَمْرِو بْنِ مُرَّةٍ قَالَ سَأَلْتُ أَبَا عُبَيْدَةَ بْنَ عَبْدِ اللَّهِ هَلْ تَذْكُرُ مِنْ عَبْدِ اللَّهِ شَيْئًا قَالَ لَا .

6. Është e papëlqyer marrja e pasurisë më të mirë në emër të zekatit

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ أَخْذِ خِيَارِ الْمَالِ فِي الصَّدَقَةِ

624. Na ka treguar Ebu Kurejbe – atë e ka informuar Vekiu, atë Zekerija b. Is’hak el-Mekki, atë Jahja b. Abdullah b. Sajfi,⁵⁵⁸ ai ka transmetuar nga Ebu Ma’bedi, ai nga Ibn Abbasi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke e dërguar Muadhin në Jemen,⁵⁵⁹ ka thënë: “Ti, je duke shkuar te populli, i cili është pasues i Librit të Shpallur. Së pari thirri ata të dëshmojnë që vetëm Allahu është Zot dhe që unë jam i Dërguar i Tij. Nëse e pranojnë atë, atëherë, mësoji atë që Allahu na ka obliguar me pesë namaze gjatë ditës dhe gjatë natës. Nëse edhe atë e pranojnë, atëherë mësoji ata, që Allahu na ka obliguar të japim zekat për pasurinë, i cili merret nga të pasurit e tyre dhe u ndahet të varfërve të tyre. Nëse edhe atë e pranojnë, mos merr nga pasuria e tyre më e mirë. Ke kujdes nga duaja e atij mbi të cilin është bërë dhunë, sepse në mes saj dhe Allahut, nuk ka kurrfarë pengese.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Sunabihijji. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.⁵⁶⁰ Emri i të mbrojturit të Ibn Abbasit, Ebu Ma’bedit është Nafiz.”⁵⁶¹

⁵⁵⁶ Tatimi ose xhizja, janë marr nga jomyslimanët, të cilët jetonin në shtetin islam. Nga hadithi arrihet konkludimi, që tatimi ka qenë me vlerë të një dinari për personin mashkull të moshës madhore ose në kundërvlerë natyrale. Duke e dhënë tatimin, jomyslimanët nuk ishin të obliguar të shërbejnë shërbimin ushtarak në shtetin islam dhe të luftojnë. Muslimanët e kanë pasur si obligim, që në rast lufte t’i mbronin dhe t’i ruanin ata si fëmijët e vet dhe pasurinë e vet.

⁵⁵⁷ Ka shënuar Malik b. Enesi në *Muvetta*.

⁵⁵⁸ Jahja b. Abdullah b. Sa’jfi, në të vërtetë, është Jahja b. Abdullah b. Muhammed b. Jahja b. Sa’jfi el-Mekki. Sipas vlerësimit të Ibn Haxherit, është i besueshëm. I takonte gjeneratës së katërt të ravive.

⁵⁵⁹ I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka dërguar Muadh b. Xhebelin në Jemen si guvernator dhe kadi.

⁵⁶⁰ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁵⁶¹ Ebu Ma’bedi, emri i të cilit është Nafidh, sipas mendimit të Ibn Haxherit është ravi i besueshëm. I takonte gjeneratës së katër të transmetuesve të hadithit. Ka vdekur në vitin 104 sipas hixhretit.

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا بْنُ إِسْحَاقَ الْمَكِّيُّ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ صَيْفِيٍّ، عَنْ أَبِي مَعْبُدٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ بَعَثَ مُعَاذًا إِلَى الْيَمَنِ فَقَالَ لَهُ " إِنَّكَ تَأْتِي قَوْمًا أَهْلَ كِتَابٍ فَأَدْعُهُمْ إِلَى شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنِّي رَسُولُ اللَّهِ فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لِذَلِكَ فَأَعْلِمُهُمْ أَنَّ اللَّهَ افْتَرَضَ عَلَيْهِمْ خُمْسَ صُلُواتٍ فِي الْيَوْمِ وَاللَّيْلَةِ فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لِذَلِكَ فَأَعْلِمُهُمْ أَنَّ اللَّهَ افْتَرَضَ عَلَيْهِمْ صَدَقَةً فِي أَمْوَالِهِمْ تُؤْخَذُ مِنْ أَغْنِيائِهِمْ وَتُرَدُّ عَلَى فُقَرَائِهِمْ فَإِنْ هُمْ أَطَاعُوا لِذَلِكَ فَإِيَّاكَ وَكَرَائِمَ أَمْوَالِهِمْ وَاتَّقِ دَعْوَةَ الْمَظْلُومِ فَإِنَّهَا لَيْسَ بَيْنَهَا وَبَيْنَ اللَّهِ حِجَابٌ " . وَفِي الْبَابِ عَنِ الصَّنَائِجِيِّ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو مَعْبُدٍ مَوْلَى ابْنِ عَبَّاسٍ اسْمُهُ نَافِدٌ .

7. Mbi zekatin për të mbjellat, frutat dhe grurin (të lashtat)

باب ما جاء في صدقة الزرع والتمر والخبوب

625. Na ka treguar Kutejbe, atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi, ai ka transmetuar nga Amr b. Jahja el-Mazini, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Ebu Seid el-Hudriu – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka zekat për deve, nëse janë më pak se pesë zevd.⁵⁶² E as nuk ka zekat për monedha të argjendta, nëse ka më pak okë.⁵⁶³ As nuk ka zekat për fruta dhe grurë, nëse ka më pak se pesë ngarkesa.”⁵⁶⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi nga Ebu Hurejre, Ibn Umeri, Xhabiri dhe Abdullah b. Amri!”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ يَحْيَى الْمَازِنِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " لَيْسَ فِيمَا دُونَ خُمُسٍ دُونَ صَدَقَةٍ وَلَيْسَ فِيمَا دُونَ خُمُسَةٍ أَوْسَقُ صَدَقَةٍ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَجَابِرٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو .

626. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehhdii, atë e kanë informuar, Sufjani, Shu'be dhe Malik b. Enesi, duke transmetuar nga Amr b. Jahjai, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Seid el-Hudriu, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – ngjashëm me hadithin e Abdulazizit nga Amr b. Jahjai.

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Seidit është hasen-sahih.⁵⁶⁵ Nga ai është transmetuar në disa transmetime. Sipas këtij ka vepruar ulemaja. Ata konsiderojnë, që nuk ka zekat për atë që është më pak se pesë ngarkesa. Një ngarkesë ka gjashtëdhjetë sa'a. Pesë ngarkesa bëjnë treqind sa'a. Sa'i i të Dërguarit përmbante 5.3 ritle. Sa'i i Kufës përmbante tetë ritle. Për atë që është nën pesë ngarkesa, nuk ka zekat. Një okë është barazi me dyzet dërhëm, ndërsa pesë okë është barazi me dyqind dërhëm. Në atë që është nën pesë zevde, do të thotë më pak se pesë deve, nuk ka zekat. Por, nëse janë njëzet e pesë deve, për te duhet dhënë një deve femër, e cila e ka mbushur një vit dhe ka hyrë në vitin e dytë. Nën njëzet e pesë deve, për çdo pese deve duhet dhënë një dele në emër të zekatit.”

⁵⁶² Në gjuhën arabe, fjala zevd, sipas mendimit të shumicës, siç pohon Ibn Haxheri, e simbolizon numrin tre deri në dhjetë. Ndërkaq, konkretisht, në rastin zevd, do të thotë (kohë) copë. Pra, nuk i nënshtrohet zekatit ai i cili ka më pak se pesë (krerë) copë, d.m.th., siç qëndron në transmetimin e këtij hadithi të Buhariu dhe te të tjerët.

⁵⁶³ Gjithashtu, nuk i nënshtrohet obligimit të dhënies së zekatit për monedha të argjendta, ai i cili ka më pak se pesë okë. Vlera e një oke është dyzet dërhëm. Domethënë, obligimit të zekatit i nënshtrohet vetëm ai, që ka dyqind ose më tepër dërhëm, monedha të argjendta. Ky është *nisabi* për argjend.

⁵⁶⁴ Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, *nisabi* për prodhimet bujqësore-prodhimet e të lashtave, që mund të deponohen, siç janë gruri dhe stafidhet, është pesë ngarkesa. Secili, që i gjen pesë ngarkesa dhe më tepër, të prodhimeve të tilla, është i obliguar të jep zekat. Ai, që ka më pak se aq, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, nuk është i obliguar të jep zekat. Sipas mendimit të Ebu Hanifes, zekatin është i obliguar ta jap secili që ka prodhime bujqësore, pa e pasur parasysh se a ka më tepër ose më pak se pesë ngarkesa.

⁵⁶⁵ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، وَشُعْبَةُ، وَمَالِكُ بْنُ أَنَسٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ يَحْيَى، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ حَدِيثِ عَبْدِ الْعَزِيزِ عَنْ عَمْرِو بْنِ يَحْيَى. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَقَدْ رُوِيَ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ عَنْهُ. وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ لَيْسَ فِيهَا دُونَ خُمُسَةِ أَوْسُقِ صَدَقَةٍ. وَالْأَوْسُقُ سِتُّونَ صَاعًا وَخُمُسُهُ أَوْسُقٌ ثَلَاثُمِائَةٍ صَاعٍ وَصَاعُ النَّبِيِّ ﷺ خُمُسُهُ أَرْطَالٌ وَثَلَاثُ وَصَاعُ أَهْلِ الْكُوفَةِ ثَمَانِيَةُ أَرْطَالٍ. وَلَيْسَ فِيهَا دُونَ خُمُسِ أَوْاقٍ صَدَقَةٍ وَالْأَوْاقَةُ أَرْبَعُونَ دِرْهَمًا وَخُمُسُ أَوْاقٍ مِائَتَا دِرْهَمٍ. وَلَيْسَ فِيهَا دُونَ خُمُسِ دَوْدٍ صَدَقَةٍ يَغْنِي لَيْسَ فِيهَا دُونَ خُمُسِ مِنَ الْإِبِلِ صَدَقَةً فَإِذَا بَلَغَتْ خُمُسًا وَعِشْرِينَ مِنَ الْإِبِلِ فِيهَا بُنْتُ مَخَاضٍ وَفِيهَا دُونَ خُمُسِ وَعِشْرِينَ مِنَ الْإِبِلِ فِي كُلِّ خُمُسٍ مِنَ الْإِبِلِ شَاةٌ.

8. Mbi atë që për robër dhe kuaj nuk jepet zekati

باب مَا جَاءَ لَيْسَ فِي الْخَيْلِ وَالرَّقِيقِ صَدَقَةٌ

627. Na kanë treguar Muhammed b. Ala Ebu Kurejbi dhe Mahmud b. Gajlani – ata i ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Sufjani dhe Shu’be, ata dytë nga Abdullah b. Dinari, ai nga Sulejman b. Jesari, ai nga Irak b. Maliku,⁵⁶⁶ ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Muslimani, nuk është i obliguar të jap zekat për kalin dhe robin.”⁵⁶⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Amri dhe Aliu. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.⁵⁶⁸ Sipas tij veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që për kuaj që janë në kullosa dhe për robërit nëse shërbejnë për punë, nuk duhet dhënë zekat,⁵⁶⁹ përveç nëse janë të dedikuar për tregti. Në rast se, janë të dedikuar për tregti, atëherë për vlerën e tyre minimale, pas skadimit të një viti që janë në pronën e ndokujt, duhet dhënë zekat.”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، مُحَمَّدُ بْنُ الْعَلَاءِ وَمَحْمُودُ بْنُ غِيْلَانَ قَالَا حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ سُفْيَانَ، وَشُعْبَةَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ دِينَارٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ يَسَّارٍ، عَنْ عَرَكَ بْنِ مَالِكٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَيْسَ عَلَى الْمُسْلِمِ فِي فَرَسِهِ وَلَا فِي عَبْدِهِ صَدَقَةٌ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّهُ لَيْسَ فِي الْخَيْلِ السَّائِمَةِ صَدَقَةٌ وَلَا فِي الرَّقِيقِ إِذَا كَانُوا لِلْجِدْمَةِ صَدَقَةٌ إِلَّا أَنْ يَكُونُوا لِلتَّجَارَةِ فَإِذَا كَانُوا لِلتَّجَارَةِ فِيهِ أَثْمَانُهُمُ الزَّكَاةُ إِذَا خَالَ عَلَيْهَا الْحَوْلُ .

9. Mbi zekatin për mjaltin

باب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ الْعَسَلِ

628. Na ka treguar Muhammed b. Jahja en-Nejsaburi – atë e ka informuar Amr b. Ebu Seleme et-Tinnisi, ai ka transmetuar nga Sadaka b. Abdullahu,⁵⁷⁰ ai nga Musa b. Jesari, ai nga Nafiu, ndërsa ai

⁵⁶⁶ Irak b. Malik el-Gifari el-Medeni, është transmetues ravi jashtëzakonisht i besueshëm dhe i vlefshëm. Shquhej si njohës i madh i Fik’hut. Ka vdekur pas vitit 100 sipas hixhretit, gjatë kohës së halifës Jezid b. Abdulmelik.

⁵⁶⁷ Në bazë të këtij hadithi, Dhahiritë pohojnë, që për kuaj dhe robër, assesi nuk jepet zekat, madje edhe nëse janë të dedikuara për tregti. Ndërkaq, Ibn Mundhiri, ka transmetuar që është arritur koncenzusi i ulemasë, që çdo mall tregtar, pa e marr parasysh se çfarë lloji është ai, i nënshtrohet zekatit. Në krahasim me këtë, kuajt dhe robërit, në rast se janë të dedikuar për tregti, i nënshtrohen obligimit të zekatit.

⁵⁶⁸ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁵⁶⁹ Shumica e dijetarëve, konsiderojnë se për kuaj – pa dallim se a janë duke kullotur në kullosa apo në stalla – dhe robërit që shërbejnë për punë, nëse nuk janë të dedikuar për tregti, nuk duhet dhënë zekat. Këtë mendim e bazojnë mbi hadithin e përmendur dhe të tjerët.

Ebu Hanife, konsideron, se për kuaj, edhe nëse nuk janë të dedikuar për tregti, duhet të jepet zekat, nëse ushqehen në kullosa; dhe atë për secilin kalë nga një dinar. Ai, qëndrimin e vet e bazon mbi hadithin të cilin e shënojnë Bejhekiu dhe Ed-Darekutni nga Xhabiri: “Për kuaj, që ushqehen në kullosa, për secilin prej tyre në emër të zekatit duhet të jepet nga një.” Abdurrahman el-Mubarekfuri konsideron, se ky hadith është jashtëzakonisht i dobët, sepse atë, siç thekson Bejhekiu, e ka transmetuar Fevrek, i cili, sipas dijetarëve të hadithit, është jashtëzakonisht ravi i dobët.

⁵⁷⁰ Sadaka b. Abdullah es-Semin ed-Dimeshki është transmetues i dobët. I takonte gjeneratës së shtatë të ravive.

nga Ibn Umeri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për çdo dhjetë meshinare me mjaltë, një duhet dhënë në emër të zekatit.”⁵⁷¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Ebu Sejjar el-Muteijj dhe Abdullah b. Amri. Mbi senedin e Ibn Umerit ka vërejtje.⁵⁷² Nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi këtë temë, nuk është transmetuar asgjë e besueshme.⁵⁷³ Sipas këtij hadithi, veprojnë shumica e dijetarëve. Në pajtim me të, janë edhe qëndrimet e Ahmedit dhe të Is’hakut. Disa dijetarë thonë, që për mjaltë nuk ka zekat.”⁵⁷⁴

حَدَّثَنَا عُمَرُو بْنُ أَبِي سَلَمَةَ النَّيْسَابِيُّ، عَنْ صَدَقَةَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ مُوسَى بْنِ بَسَارٍ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " فِي الْعَسَلِ فِي كُلِّ عَشْرَةِ أَزْقٍ رَقٌّ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَأَبِي سَيَّارَةَ الْمُتَعَمِّيِّ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ فِي إِسْنَادِهِ مَقَالٌ وَلَا يَصِحُّ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ فِي هَذَا الْبَابِ كَبِيرُ شَيْءٍ وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ لَيْسَ فِي الْعَسَلِ شَيْءٌ . وَصَدَقَهُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ لَيْسَ بِحَافِظٍ وَقَدْ خُولِفَ صَدَقَهُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ فِي رَوَايَةِ هَذَا الْحَدِيثِ عَنْ نَافِعٍ .

Transmeton Muhammed b. Beshari, Abdul-Vehab el-Thekafi, Abdullah bin Umer, nga Nafiu, i cili thotë: “Umer bin Abdul-Azizi më ka pyetur mbi zekatin për mjaltin, e unë i thash: “Ne nuk kemi mjaltë që t’mund të japim për zekat, por, El-Mugire bin Hakimi na ka informuar që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: ‘Nuk ka zekat për mjaltin.’ Kështu që Umeri tha: “Kjo është mjaft e drejt për mua.’ Kështu që ne i shkruam popullit, që janë liruar, domethënë (detyrimi i pagesës për të) nga ai.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ النَّخَعِيُّ حَدَّثَنَا عُيَيْدُ اللَّهِ بْنُ عُمَرَ عَنْ نَافِعٍ قَالَ سَأَلَنِي عُمَرُ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ عَنْ صَدَقَةِ الْعَسَلِ . قَالَ قُلْتُ مَا عِنْدَنَا عَسَلٌ نَتَصَدَّقُ مِنْهُ وَلَكِنْ أَخْبَرَنَا الْمُغِيرَةُ بْنُ حَكِيمٍ أَنَّهُ قَالَ لَيْسَ فِي الْعَسَلِ صَدَقَةٌ . فَقَالَ عُمَرُ عَذَلٌ مَرَضِيٌّ . فَكَتَبَ إِلَى النَّاسِ أَنْ تُوَضَعَ . يَعْنِي عَنْهُمْ .

10. Për pasurinë e arritur nuk ka zekat, derisa nuk kalon një vit nga arritja e tij

بَابُ مَا جَاءَ لَا زَكَاةَ عَلَى الْمَالِ الْمُسْتَفَادِ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ

629. Na ka treguar Jahja b. Musa – atë e ka informuar Harun b. Sali et-Talhi, atë Abdurrahman b. Zejd b. Eslemi, ai ka transmetuar nga babai i vet, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush arrin ndonjë pasuri, për te nuk ka për të dhënë zekat, gjithnjë, derisa nuk kalon një vit (pas arritjes së asaj pasurie).”⁵⁷⁵ Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi nga Serraja, e bija e Nebhanit.”⁵⁷⁶

⁵⁷¹ Në bazë të këtij hadithi, Ebu Hanife, Ahmed b. Hanbeli dhe Is’haku konsiderojnë, që në emër të zekatit për mjaltë jepet një e dhjeta nga sasia e plotë, e cila e ka arritur nisabin, si edhe te prodhimet bujqësore, të cilat ujitën në mënyrë natyrore.

⁵⁷² Pasi që, në te gjendet raviu Sadaka b. Abdullah dhe atë nga gjenerata e vet, i vetmi ai e transmeton këtë hadith.

⁵⁷³ Buhariu, në *Tarih*, thotë: “Që asnjë hadith, në të cilin flitet mbi zekatin për mjaltin, nuk është i besueshëm.”

⁵⁷⁴ Shafiu, Maliku dhe Sufjan eth-Thevriu, konsiderojnë, se për mjaltë nuk duhet dhënë zekat sepse të gjithë hadithet që flasin mbi atë nuk janë të besueshëm.

⁵⁷⁵ Abdurrahman b. Mubarekfuri, konsideron, se këtu duhet dalluar dy lloje të pasurisë së arritur: a) pasuria e cila është tërësisht e llojit të njëjtë për të cilën tani më ekziston nisabi – për shembull: ndokush ka aq deve sa që tani më është i obliguar të jep zekat e pastaj arrin edhe ca; b) pasuria e cila është tërësisht e llojit tjetër në krahasim me atë për të cilin ekziston nisabi, për shembull, kur pronari i deveve arrin bagëti, bagëtia llogaritet veçantë dhe për ta jepet zekat kur kalon një vit nga arritja e nisabit dhe kur përmbushen kushtet e tjera. Kur është fjala mbi llojin e parë të pasurisë së arritur, aty duhet dallohen dy nën-lloje: 1) Pasuria e cila arrihet gjatë vitit si produkt i të ekzistuarës. Për të duhet të jepet zekat për njëherë, së bashku me atë për të cilin tani është e domosdoshme të jepet zekati, duke mos e pritur që nga arritja të kalojë një vit; 2) pasuria e cila është arritur gjatë vitit, e nuk është produkt i pasurisë ekzistuese, por është arritur me trashëgimi, si dhuratë apo të ngjashme.

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ صَالِحٍ الطَّلَجِيُّ الْمَدَنِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ اسْتَفَادَ مَالًا فَلَا زَكَاةَ عَلَيْهِ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ عِنْدَ رَبِّهِ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ سَرَّاءَ بِنْتِ نَبْهَانَ الْغَوِيَّةِ .

630. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Abdulvehab es-Sekafi, atë Ejjubi, ai ka transmetuar nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “Kush arrin ndonjë pasuri, për të nuk ka për të dhënë zekat, derisa ajo pasuri nuk e kalon vitin tek ai.”

Ebu Isai, thotë: “Kjo është më e besueshme, sesa hadithi i Abdurrahman b. Zjed b. Esleme. E kanë transmetuar, Ejjubi, Ubejdullahu dhe shumë të tjerë, nga Nafiu, ai nga Umeri, si hadith-mevkuf. Abdurrahman b. Zejd b. Eslemi, është transmetues i dobët i hadithit. Atë të dobët, e konsiderojnë Ahmed b. Hanbeli, Ali b. Medini dhe dijetarët e tjerë të hadithit. Ai shumë gabonte (në transmetimin e haditheve). Shumica e as’habëve konsideron, që për pasurinë e arritur, nuk jepet zekati, derisa nga arritja e saj nuk kalon një vit. Kështu mendojnë edhe Malik b. Enesi, Shafiu, Ahmed b. Hanbeli dhe Is’haku.”

Disa, nga dijetarët, thonë: “Nëse ndokush, tani më, posedon pasuri për të cilën është i obliguar të jap zekat, ka për të dhënë zekat edhe për pasurinë e arritur. Ndërkaq, nëse nuk ka pasuri tjetër për të cilën është i obliguar të jap zekat, për pasurinë e arritur nuk ka për të dhënë zekat, derisa nga arritja e saj nuk kalon një vit. Nëse e arrin pasurinë, ai për pasurinë e arritur ka për të dhënë zekat, para se të kalojë viti së bashku me pasurinë, për të cilën tani ka qenë i obliguar për të dhënë zekat.” Kështu mendojnë Sufjan eth-Thevriu dhe dijetarët e Kufës.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ النَّخَعِيُّ، حَدَّثَنَا أَيُّوبُ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ مَنْ اسْتَفَادَ مَالًا فَلَا زَكَاةَ فِيهِ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ عِنْدَ رَبِّهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى أَيُّوبُ وَعَبِيدُ اللَّهِ بْنُ عُمَرَ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ مُوَفَّقًا . وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ ضَعِيفٌ فِي الْحَدِيثِ ضَعَّفَهُ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ وَعَلِيُّ بْنُ الْمَدِينِيِّ وَغَيْرُهُمَا مِنْ أَهْلِ الْحَدِيثِ وَهُوَ كَثِيرُ الْعَلَطِ . وَقَدْ رَوَى عَنْ غَيْرِ وَاحِدٍ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّ لَا زَكَاةَ فِي الْمَالِ الْمُسْتَفَادِ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ . وَبِهِ يَقُولُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِذَا كَانَ عِنْدَهُ مَالٌ تَجِبُ فِيهِ الزَّكَاةُ فَفِيهِ الزَّكَاةُ وَإِنْ لَمْ يَكُنْ عِنْدَهُ سِوَى الْمَالِ الْمُسْتَفَادِ مَا تَجِبُ فِيهِ الزَّكَاةُ لَمْ يَجِبْ عَلَيْهِ فِي الْمَالِ الْمُسْتَفَادِ زَكَاةٌ حَتَّى يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ فَإِنْ اسْتَفَادَ مَالًا قَبْلَ أَنْ يَحُولَ عَلَيْهِ الْحَوْلُ فَإِنَّهُ يَزَكِّي الْمَالِ الْمُسْتَفَادَ مَعَ مَالِهِ الَّذِي وَجِبَتْ فِيهِ الزَّكَاةُ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَأَهْلُ الْكُوفَةِ .

11. Muslimanët nuk janë të obliguar të paguajnë xhizjen

باب مَا جَاءَ لَيْسَ عَلَى الْمُسْلِمِينَ خِزْيَةٌ

631. Na ka treguar Jahja b. Eksemi – atë e ka informuar Xherriri, duke transmetuar na Kabus b. Ebu Zabjani, ai nga babai i vet, e ai nga Ibn Abbasi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Në një vend nuk mund të jenë dy kible,⁵⁷⁷ e as muslimanët nuk janë të obliguar ta paguajnë xhizjen.”⁵⁷⁸

Sipas mendimit të Ebu Hanifes, edhe për të menjëherë jepet zekati, duke mos pritur të kalojë viti. Sipas mendimit të Shafiut, Malikut dhe Ahmed b. Hanbelit, për pasurinë kryesore menjëherë duhet të jepet zekati, ndërsa për pasurinë e arritur, atëherë kur kalon një vit, nga arritja e saj.

⁵⁷⁶ Serraa, e bija e Nebhan el-Ganeviut, është as’have e njohur e cila ka transmetuar disa hadithe drejtpërdrejt nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁵⁷⁷ Domethënë që, dy fe, nuk mund të kenë trajtim të njëjtë në një vend. Muslimanët në vendin jomusliman nuk i kanë të drejtat e njëjta si jomuslimanët. Gjithashtu, jomuslimanët në vendin islam nuk i kanë të drejtat e njëjta e as obligime si muslimanët, edhe pse janë në pozitë larg më të volitshme se muslimanët në vendet jomuslimane. E vërtetë, ata e paguajnë tatimin, por nuk e paguajnë pse janë në pozitë të varur, por pse nuk japin zekat. Përveç kësaj, duke e paguar tatimin, as ata e as bijtë e tyre nuk janë të obliguar të shkojnë në luftë dhe ta mbrojnë vendin në rast të sulmit. Edhe tokën, edhe ata, edhe pasuritë e tyre i mbrojnë ekskluzivisht muslimanët.

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ أَكْثَمَ، حَدَّثَنَا جَرِيرٌ، عَنْ قَابُوسَ بْنِ أَبِي ظَبْيَانَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا تَصْلُحُ قِبْلَتَانِ فِي أَرْضٍ وَاحِدَةٍ وَلَيْسَ عَلَى الْمُسْلِمِينَ جَزِيَّةٌ " .

632. Na ka treguar Ebu Kurejbi – atë e ka informuar Xherriri, duke transmetuar nga Kabusi me këtë sened – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Seid b. Zejdi dhe gjyshi Harb b. Ubejdullah es-Sekafiu. Hadithi i Ibn Abbasit – nga Kabus b. Ebu Zabjani, nga babai i tij, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – është transmetuar edhe si hadith-mursel.⁵⁷⁹

Në përgjithësi, dijetarët, veprojnë sipas këtij hadithi. Ata konsiderojnë, që i krishteri nëse e pranon islamin, lirohet nga tatimi. Fjalët e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), as muslimanët nuk janë të obliguar për ta paguar xhizjen (kanë të bëjnë) përkojnë me tatimin mbi personat. Ekziston një hadith tjetër, i cili e sqaron këtë, ku i Dërguari thotë: “Të dhjetat janë të obliguar t’i japin vetëm jehudët dhe të krishterët, e jo muslimanët.”⁵⁸⁰

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا جَرِيرٌ، عَنْ قَابُوسَ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ . وَفِي الْبَابِ عَنْ سَعِيدِ بْنِ زَيْدٍ، وَجَدَّ حَرْبِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْتَّقْفِي . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ قَدْ رُوِيَ عَنْ قَابُوسَ بْنِ أَبِي ظَبْيَانَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ عَامَّةِ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ النَّصْرَانِيَّ إِذَا أَسْلَمَ وَضِعَتْ عَنْهُ جَزِيَّةُ رَقَبَتِهِ . وَقَوْلُ النَّبِيِّ ﷺ " لَيْسَ عَلَى الْمُسْلِمِينَ عَشُورٌ " إِنَّمَا يَعْني بِهِ جَزِيَّةَ الرِّقَبَةِ وَفِي الْحَدِيثِ مَا يُفَسِّرُ هَذَا حَيْثُ قَالَ " إِنَّمَا الْعَشُورُ عَلَى الْيَهُودِ وَالنَّصَارَى وَلَيْسَ عَلَى الْمُسْلِمِينَ عَشُورٌ " .

12. Mbi zekatin për stoli

باب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ الْخَلِيِّ

633. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Ebu Vaili, ai nga Amr b. Harith b. Mustaliku, ai nga djali i vëllait të Zejnebes, bashkëshortes së Abdullahut – që Zejnebja, bashkëshortja e Abdullahut, ka thënë: “Me një rast, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), na mbajti ligjëratë dhe tha: “O, grupi i grave, ndani lëmoshë, madje edhe nga stolitë e juaja – sepse në Ditën e Gjykimit, me të vërtetë shumë nga ju kanë për të qenë në mesin e banorëve të Xhehennemit!”⁵⁸¹

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي وَائِلٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ بْنِ الْمُنْطَلِقِ، عَنْ ابْنِ أَخِي، زَيْنَبِ امْرَأَةِ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ زَيْنَبَ، امْرَأَةِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ قَالَتْ خَطَبَنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَقَالَ " يَا مَعْشَرَ النِّسَاءِ تَصَدَّقْنَ وَلَوْ مِنْ خَلِيكُنَّ فَإِنَّكُمْ أَكْثَرُ أَهْلِ جَهَنَّمَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ " .

Duke shikuar nga ky aspekt dhe nga aspektet e tjera, ata në krahasim me muslimanët në vendet islame kanë pozitë të privilegjuar. Ndërkaq, ata megjithatë janë në pozitë të padrejtë, duke pasur parasysh që me çështjet kyçe për vendin, vendosin ekskluzivisht muslimanët.

⁵⁷⁸ Në rast se jomuslimani e pranon Islamin, e nuk e ka paguar tatimin për atë vit, ai as nuk ka për ta paguar – sepse muslimanët nuk janë të obliguar të paguajnë tatimin.

⁵⁷⁹ Tirmidhiu, mbi këtë hadith, nuk ka cekur asnjë vlerësim. “Unë theksoj” thotë El-Mubarekfuri – “që Kabus b. Ebu Zabjani, i cili gjendet në këtë sened të hadithit, është i pasigurt gjatë transmetimit të hadithit.” Këtë hadith e kanë shënuar edhe Ahmed b. Hanbeli, në *Musned* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

⁵⁸⁰ Nëse jomuslimanët shesin prodhime në territorin e shtetit islam, janë të obliguar që në emër të asaj, nëse ndërmjet tyre dhe muslimanëve nuk është bërë kurrfarë marrëveshje, shtetit islam t’i paguajnë një të dhjetën e atij malli. Por, nëse është arritur marrëveshja ndërmjet tyre, kanë për të vepruar sipas saj. Ebu Hanife thotë: “Të dhjetat për tregti kanë për t’i dhënë vetëm jomuslimanët, vendet e të cilave e marrin për ne të dhjetën pjesë, ndërsa ata që nuk i marrin nga ne nuk ka për t’u marr asgjë prej tyre.”

⁵⁸¹ Disa dijetarë, në mesin e të cilëve është edhe Tirmidhiu, e kanë kuptuar, që në hadithin e përmendur, bëhet fjalë mbi zekatin e obliguar, e jo mbi lëmoshën. Sipas tyre, ky hadith, siç thekson Ebu Mubarekfuri, do të thotë: “O grup i grave, jepni zekat për të gjithë pasurinë, për të cilën jeni të obliguara të jepni zekat! Jepini atë sikur të ishit të obliguara të jepni edhe nga stolitë e juaja!”

634. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, duke transmetuar nga Shu'be – që A'meshi, ka thënë: “E kam dëgjuar Ebu Vailin, se si rrëfente nga Amr b. Harithi, djali i vëllait të Zejnebes, ai nga Zejnebja, bashkëshortja e Abdullahut, ndërsa ajo, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e mëparshëm.”

Ebu Isai, thotë: “Kjo është më e besueshme sesa hadithi i Ebu Muaviut. Ebu Muaviu ka bërë lëshim gjatë transmetimit të këtij hadithi. Ai thotë: “Nga Amr b. Harithi, nga djali i vëllait të Zejnebes – ndërsa e drejtë është: “Nga Amr b. Harithi, djali i vëllait të Zejnebes.”

Transmetohet nga Amr b. Shu'ajbi – ai transmeton nga babai i vet, ai nga gjyshi i tij – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka konsideruar, që për stoli duhet dhënë zekat. Ndërkaq, mbi senedin e tij, ekzistojnë vërejtje.

Dijetarët janë ndarë në atë pikëpamje. Disa nga as'habët dhe tabi'inët, konsiderojnë, që për stoli jepet zekati, nëse është nga ari ose argjendi. Qëndrimet e tilla janë edhe të Sufjan eth-Thevriut dhe Abdullah b. Mubarekut. Disa as'habë, në mesin e të cilëve janë Ibn Umeri, Aishja, Xhabir b. Abdullahu dhe Enes b. Maliku, konsiderojnë, që për stoli nuk ka zekat. Qëndrimi i këtillë është transmetuar edhe nga disa fakihë nga gjenerata e tabi'inëve, por ashtu mendojnë edhe Malik b. Enesi, Shafi'u, Ahmedi dhe Is'haku.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، عَنْ شُعْبَةَ، عَنْ الْأَعْمَشِ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا وَائِلٍ، يُحَدِّثُ عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ ابْنِ أَخِي، زَيْنَبَ امْرَأَةَ عَبْدِ اللَّهِ - عَنْ زَيْنَبَ، - امْرَأَةَ عَبْدِ اللَّهِ - عَنِ النَّبِيِّ ﷺ تَحْوُهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ أَبِي مُعَاوِيَةَ وَأَبُو مُعَاوِيَةَ وَهُمْ فِي حَدِيثِهِ فَقَالَ عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ عَنْ ابْنِ أَخِي زَيْنَبَ . وَالصَّحِيحُ إِنَّمَا هُوَ عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ ابْنِ أَخِي زَيْنَبَ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعْبَةَ عَنْ أَبِيهِ عَنْ جَدِّهِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ رَأَى فِي الْخَلِيٍّ زَكَاةً . وَفِي إِسْنَادِ هَذَا الْحَدِيثِ مَقَالٌ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي ذَلِكَ فَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَالتَّابِعِينَ فِي الْخَلِيٍّ زَكَاةً مَا كَانَ مِنْهُ ذَهَبٌ وَفِضَّةٌ . وَبِهِ يَقُولُ سَفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ . وَقَالَ بَعْضُ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ مِنْهُمْ ابْنُ عُمَرَ وَعَائِشَةُ وَجَابِرُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ وَأَسْنُ بْنُ مَالِكٍ لَيْسَ فِي الْخَلِيٍّ زَكَاةً . وَهَكَذَا رُوِيَ عَنْ بَعْضِ فُقَهَاءِ التَّابِعِينَ وَبِهِ يَقُولُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

635. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ibn Lehi, duke transmetuar nga Amr b. Shuajbi, ai nga babai i vet, ai nga gjyshi i vet – që dy gra kishin ardhur tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e në duar kishin dy byzylyk të arit, ai u tha: “Vallë, a jeni duke dhënë zekat për to?” “Jo.” – u përgjigj njëra nga ato. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) në atë u tha: “Vallë, a dëshironi që Allahu (në duar) t’u vë byzylykë nga zjarri?” “Jo.” – thanë me zë të lartë ato, e ai në atë tha: “Atëherë, jepni zekat për to.”⁵⁸²

Ebu Isai, thotë: “Këtë hadith, në kuptim të ngjashëm, e ka transmetuar Musenna b. Sabbah nga Amr b. Shuajbi. Ndërsa, Musenna b. Sabbahun dhe Ibn Lehin, i kanë konsideruar si ravi të dobët. Mbi këtë, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk është transmetuar asgjë më e besueshme.”⁵⁸³

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا ابْنُ لَهْيَةَ، عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعْبَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، أَنَّ امْرَأَتَيْنِ، أَتَتَا رَسُولَ اللَّهِ ﷺ وَفِي أَيْدِيهِمَا سُورَانِ مِنْ ذَهَبٍ فَقَالَ لَهُمَا " أَتُؤَدِّيَانِ زَكَاتَهُ " . قَالَتَا لَا . قَالَ فَقَالَ لَهُمَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَتُحِبَّانِ أَنْ يُسَوِّرَكُمَا اللَّهُ بِسُورَيْنِ مِنْ نَارٍ " . قَالَتَا لَا . قَالَ " فَأَيَُّا زَكَاتَهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ قَدْ رَوَاهُ الْمُتَنِّي بْنُ الصَّبَّاحِ عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعْبَةَ تَحْوُهُ هَذَا . وَالْمُتَنِّي بْنُ الصَّبَّاحِ وَابْنُ لَهْيَةَ يُضَعِّفَانِ فِي الْحَدِيثِ وَلَا يَصِحُّ فِي هَذَا الْبَابِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ شَيْءٌ .

⁵⁸² Abdurrahman el-Mubarekfuri, këtë hadith e merr si argument për rregullsinë e qëndrimit të atyre, që konsiderojnë, që stolitë jepen për zekat.

⁵⁸³ Tirmidhiu pohon, që asnjë hadith, mbi dhënien e obliguar të zekatit për stolitë, nuk është i besueshëm. Ndërkaq, me këtë konstatim nuk pajtohen, Ibn Mulekkin, el-Mundhiri dhe Ez-Zejlei. Ata pohojnë, që hadithin i lartpërmendur i Amr b. Shuajbit, e kanë shënuar edhe Ebu Davudi në *Sunen*, me senedin, në të cilin nuk ka vërejtje.

13. Mbi zekatin për perime

بَاب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ الْخَضِرَوَاتِ

636. Na ka treguar Ali b. Hashremi – atë e ka informuar Isa b. Junusi, ai ka transmetuar nga Hasani, ai nga Muhammed b. Abdurrahman b. Ubejdi,⁵⁸⁴ ai nga Isa b. Talha⁵⁸⁵ - që Muadhi i ka shkruar të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke e pyetur atë mbi perimet (se a jepet zekati për to) dhe i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ishte përgjigjur: “Për to asgjë nuk jepet.”⁵⁸⁶

Ebu Isai, thotë: “Senedi i këtij hadithi nuk është i besueshëm, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi këtë temë, nuk është transmetuar asgjë e besueshme. Kjo nga Musa b. Talha, është transmetuar vetëm në transmetim mursel. Sipas kësaj janë duke vepruar dijetarët. Ata konsiderojnë, që për perime nuk ka zekat. Hasani është djali i Imares. Ai, sipas vlerësimit të dijetarëve të hadithit, është ravi i dobët. Të dobët atë e konsiderojnë Shu'be dhe të tjerët, derisa Abdullah b. Mubareku e refuzon atë.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حَسْرَمٍ، أَخْبَرَنَا عِيسَى بْنُ يُونُسَ، عَنِ الْحَسَنِ بْنِ عُمَارَةَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عُبَيْدٍ، عَنْ عِيسَى بْنِ طَلْحَةَ، عَنْ مُعَاذٍ، أَنَّهُ كَتَبَ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ يَسْأَلُهُ عَنِ الْخَضِرَوَاتِ وَهِيَ الْبُقُولُ فَقَالَ " لَيْسَ فِيهَا شَيْءٌ " . قَالَ أَبُو عِيسَى إسنَادُ هَذَا الْحَدِيثِ لَيْسَ بِصَحِيحٍ وَلَيْسَ يَصِحُّ فِي هَذَا الْبَابِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ شَيْءٌ وَإِنَّمَا يُرْوَى هَذَا عَنْ مُوسَى بْنِ طَلْحَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ لَيْسَ فِي الْخَضِرَوَاتِ صَدَقَةٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَالْحَسَنُ هُوَ ابْنُ عُمَارَةَ وَهُوَ ضَعِيفٌ عِنْدَ أَهْلِ الْحَدِيثِ ضَعْفُهُ شَعْبَةٌ وَغَيْرُهُ وَتَرْكُهُ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ .

⁵⁸⁴ Muhammed b. Abdurrahman b. Ubejd el-Kureshi, është i besueshëm. I takonte gjeneratës së gjashtë të rative.

⁵⁸⁵ Isa b. Talha b. Ubejdullah et-Tejmi el-Medeni, është ravi i besueshëm dhe i vlefshëm. I ka takuar gjeneratës së tretë të transmetuesve të hadithit.

⁵⁸⁶ Ky hadith argumenton se për perime, nuk jepet zekati. Ashtu mendojnë Shafiu dhe Malik b. Enesi. Hadiu dhe Kasimi, konsiderojnë, që zekati duhet dhënë për të gjitha perimet, përveç për gjethet e pallmës dhe kashtën. Ata, këtë e bazojnë mbi ajetet: “*Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.*” [Et-Tevbe: 103], “*Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!*” [El-En’am: 141], “*O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t’i pranonit ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëndat.*” [El-Bekare: 267]. Ata konsiderojnë që hadithi i përmendur është i dobët dhe që në bazë të tij nuk mund të precizohet konkretizimi i numrit të këtyre ajetëve.

El-Mubarekfuri thotë, se shumica e këtyre haditheve edhe pse janë të dobët, e fuqizojnë stabilitetin e domethënies së tij. Ai thotë, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), siç shihet nga hadithi të cilin e shënon Bejhekiu, me sened të besueshëm, e ka urdhëruar Muadh b. Xhebelin, kur e ka dërguar në Jemen, që të merr zekatin vetëm për katër lloje të prodhimeve bujqësore: për grurë, elb, hurme dhe stafile. Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ibn Maxhe në Sunnen, është përmendur si lloji i pestë edhe misri.

14. Mbi zekatin për atë që ujitet nga lumenjtë ose në ndonjë mënyrë tjetër

باب مَا جَاءَ فِي الصَّدَقَةِ فِيمَا يُسْقَى بِالْأَنْهَارِ وَغَيْرِهِ

637. Na ka treguar Ebu Musa el-Ensari - atë e ka informuar Asim b. Abdulaziz Medini, atë Harith b. Abdurrahman b. Ebu Zubabi, ai ka transmetuar nga Sulejman b. Jesari dhe Busër b. Seidi,⁵⁸⁷ ata dytë nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për atë që është ujitur me shi ose nga burimi, një e dhjeta. Ndërsa për atë që është ujitur me spërkatje, gjysma e të dhjetës.”⁵⁸⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Enes b. Maliku, Ibn Umeri dhe Xhabiri. Ky hadith – nëpërmjet Bukejr b. Abdullah b. Eshexhxhit, Sulejman b. Jesarit dhe Busër b. Seidit, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është transmetuar si mursel. Sikurse që ky hadith është më i besueshëm. Hadithi i Ibn Umerit është më i besueshëm nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) mbi këtë temë. Sipas tij veprojnë dijetarët e fikhut në përgjithësi.”

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا عَاصِمُ بْنُ عَبْدِ الْعَزِيزِ الْمَدَنِيُّ، حَدَّثَنَا الْحَارِثُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي ذُبَابٍ، عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ يَسَارٍ، وَبُسَيْرِ بْنِ سَعِيدٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " فِيمَا سَقَتِ السَّمَاءُ وَالْعُيُونُ الْعُشْرُ وَفِيمَا سَقَى بِالنَّضْحِ نِصْفُ الْعُشْرِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ وَابْنِ عُمَرَ وَجَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رُويَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ بُكَيْرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْأَشَجِّ عَنْ سُلَيْمَانَ بْنِ يَسَارٍ وَبُسَيْرِ بْنِ سَعِيدٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مَرْسَلًا . وَكَانَ هَذَا أَصَحُّ . وَقَدْ صَحَّ حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي هَذَا الْبَابِ وَعَلَيْهِ الْعَمَلُ عِنْدَ عَامَّةِ الْفُقَهَاءِ .

638. Na ka treguar Ahmed b. Hasani – atë e ka informuar Seid b. Ebu Merjemi, atë Ibn Vehbi, atë Junusi, duke transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Salimi, ai nga babai i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar një të dhjetën e asaj që ujitet me shi, nga burimi ose që është mbjell në tokat moçalore. Ndërsa, për atë që është ujitur me spërkatje, gjysmën e të dhjetës. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁵⁸⁹

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ الْحَسَنِ، حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ أَبِي مَرْيَمٍ، حَدَّثَنَا ابْنُ وَهْبٍ، حَدَّثَنِي يُونُسُ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ أَنَّهُ سَنَّ فِيمَا سَقَتِ السَّمَاءُ وَالْعُيُونُ أَوْ كَانَ عَثَرِيًّا الْعُشْرُ وَفِيمَا سَقَى بِالنَّضْحِ نِصْفُ الْعُشْرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

15. Mbi zekatin për pasurinë e jetimit

باب مَا جَاءَ فِي زَكَاةِ مَالِ الْيَتِيمِ

639. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili, atë e ka informuar Ibrahim b. Musai, atë Velid b. Muslimi, duke transmetuar nga Musenna b. Sabbahi, ai nga Amr b. Shuajbi, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga gjyshi i tij – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, duke u mbajtur ligjëratë njerëzve (në mes të tjerash), ka thënë: “Ai që e ka marr kujdestarinë mbi jetimin, i cili ka kapital, le të punoj me të dhe le të tregton dhe të mos e lë atë të deponuar – që ta ha zekati.”⁵⁹⁰

⁵⁸⁷ Busr b. Seidi, është ravi shumë i besueshëm dhe jashtëzakonisht i shquar. I takonte gjeneratës së dytë të transmetuesve të hadithit.

⁵⁸⁸ Me këtë dhe hadithin në vijin është caktuar përqindja e zekatin, e cila jepet për prodhimet bujqësore. Ajo përqindje është e ndryshme, varësisht se a ujitet ajo tokë në mënyrë artificiale apo natyrore. Nëse ujitet në mënyrë natyrore, me shi ose me rënien natyrore nga lumenjtë ose liqenet – pa përdorimin e pompave dhe makinerive tjera, përqindja e zekatit është dhjetë përqind nga sasia e tërësishme e prodhimeve bujqësore. Ndërkaq, nëse toka, për shkak të mungesës së ujit ose ujërave natyrorë, ujitet artificialisht, përmes ujitësve dhe makinerive tjera, përqindja e zekatit për këtë lloj të prodhimeve bujqësore nga toka e atillë është një e njëzeta.

⁵⁸⁹ E ka shënuar, Buhariu në *Sahih*.

⁵⁹⁰ Në bazë të këtij dhe disa transmetimeve, Shafi, Ahmed b. Hanbeli dhe Maliku, kanë vendosur, që për pasurinë e jetimit duhet të jepet zekati. Maliku në Muveta, shënon se babai i Abdurrahman b. Kasimit ka thënë:

Ebu Isai, thotë: “Hadithi, i cili është transmetuar me këtë rrugë ka vërejtje, sepse në senedin e tij gjendet Musenna b. Sabbah, të cilin e konsiderojnë si ravi të dobët. Disa kanë transmetuar, nga Amr b. Shuajbi, që Umer b. Hattabi ka thënë - dhe e kanë përmendur këtë hadith. Dijetarët, janë ndarë rreth kësaj pyetjeje. Shumica nga as’habët e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – siç janë Umeri, Aliu, Aishja dhe Ibn Umeri – konsiderojnë, që për pasurinë e jetimit duhet të jepet zekat. Këtë qëndrim e mbështesin edhe Maliku, Shafi, Ahmedi dhe Is’haku. Disa dijetarë, konsiderojnë, që për pasurinë e jetimit, nuk duhet të jepet zekati. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe Abdullah b. Mubarekut. Amr b. Shuajbi është djali i Muhammed b. Abdullah b. Amër b. Asit. Shuajbi, hadithet i ka dëgjuar nga gjyshi i vet, Abdullah b. Amri. Jahja b. Seidi, ka polemizuar mbi hadithin e Amr b. Shuajbit. Ai ka thënë: ‘Sipas mendimit tonë, ai është ravi i dobët. Të gjithë, që e kanë konsideruar ravi të dobët, atë e kanë bërë, sepse ai, hadithet i tregonte nga faqet (sahifet) e gjyshit të vet, Abdullah b. Amrit.’ Shumica e muhadithëve janë shërbyer me hadithet e Amr b. Shuajbit, duke e konsideruar si ravi i besueshëm, në mesin e tyre janë Ahmedi, Is’haku dhe të tjerët.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا أَبُو لَيْدٍ بْنُ مُسْلِمٍ، عَنِ الْمُثَنَّى بْنِ الصَّبَّاحِ، عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعَيْبٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ خَطَبَ النَّاسَ فَقَالَ " أَلَا مَنْ وَلِيَ يَتِيمًا لَهُ مَالٌ فَلْيَتَجَرَّ فِيهِ وَلَا يَتْرُكْهُ حَتَّى تَأْكُلَهُ الصَّدَقَةُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَإِنَّمَا رَوَى هَذَا الْحَدِيثَ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ فِي إِسْنَادِهِ مَقَالًا لِأَنَّ الْمُثَنَّى بْنَ الصَّبَّاحِ يُضَعَّفُ فِي الْحَدِيثِ . وَرَوَى بَعْضُهُمْ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعَيْبٍ أَنَّ عَمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ . فَذَكَرَ هَذَا الْحَدِيثَ . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي هَذَا الْبَابِ فَرَأَى غَيْرُ وَاحِدٍ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي مَالِ الْيَتِيمِ زَكَاةً . مِنْهُمْ عُمَرُ وَعَلِيٌّ وَعَائِشَةُ وَابْنُ عُمَرَ وَبِهِ يَقُولُ مَالِكٌ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَتْ طَائِفَةٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ لَيْسَ فِي مَالِ الْيَتِيمِ زَكَاةٌ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ . وَعَمَرُو بْنُ شُعَيْبٍ هُوَ ابْنُ مُحَمَّدَ بْنَ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ وَشُعَيْبٌ قَدْ سَمِعَ مِنْ جَدِّهِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . وَقَدْ تَكَلَّمَ يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ فِي حَدِيثِ عَمْرٍو بْنِ شُعَيْبٍ وَقَالَ هُوَ عِنْدَنَا وَاهٍ . وَمَنْ ضَعَّفَهُ فَإِنَّمَا ضَعَّفَهُ مَنْ قَبْلَ أَنَّهُ يُحَدِّثُ مِنْ صَحِيفَةِ جَدِّهِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَأَمَّا أَكْثَرُ أَهْلِ الْحَدِيثِ فَيَحْتَجُّونَ بِحَدِيثِ عَمْرٍو بْنِ شُعَيْبٍ وَيُثْبِتُونَهُ مِنْهُمْ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ وَغَيْرُهُمَا .

16. Nuk ka kompensim për atë që e shkatërron kafsha, ndërsa nga thesari i gjetur merret një e pesta

بَابُ مَا جَاءَ أَنَّ الْعَجَمَاءَ جُرْحُهَا جُبَارٌ وَفِي الرِّكَازِ الْخُمْسُ

640. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa’di, duke transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Seid b. Musejjebi dhe Ebu Seleme, ata dytë nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka kompensim për atë që e shkatërron kafsha,⁵⁹¹ e as

“Unë dhe vëllai im ishim jetim, por kishim dhe pasuri dhe Aishja, e cila zakonisht kujdesej për ne, jepte zekatë për pasurinë tonë.”

Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubareku dhe Ebu Hanife, konsiderojnë, që pasuria e jetimit nuk i nënshtrohet obligimit të zekatit. Qëndrimin e vet e mbështesin mbi hadithin e Aishes, në të cilin qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Pendët janë ngritur (dhe ato nuk i shënojnë as obligimet dhe as mëkatet), njeriut që është duke fjetur derisa nuk zgjohet, personit anormal derisa shërohet dhe fëmijës derisa nuk bëhet me moshë madhore.”

⁵⁹¹ Nëse ndokush, gjatë ditës i lëshon bagëtitë në kullosat publike dhe bagëtia shkon në kopshtin ose arën e ndokujt dhe bënë dëm, pronari i bagëtisë nuk është i obliguar në kompensimin e atij dëmi. Kjo do të ishte obligative, sikur bagëtia të ishte në kullosa ku bariu është i domosdoshëm. Ose, në rast se gjatë natës do ta kishin bërë ndonjë dëm, sepse dëmi do të ishte shkaktuar për shkak të pakujdesisë njerëzore, me lëshimin e bariut ose për atë që nuk ka qenë e mbyllur ose e lidhur mirë.

dëmshpërblim për atë të cilit i ndodh diç në xeherore ose në bunar,⁵⁹² ndërsa nga thesari i gjetur duhet dhënë një të pestën.”⁵⁹³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Enes Ibn Maliku. Abdullah b. Amri, Ubade b. Samiti, Amr b. Avf el-Muzeni dhe Xhabiri. Ky hadith është hasen-sahih.”⁵⁹⁴

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، وَأَبِي، سَلَمَةَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ قَالَ " الْعُجَمَاءُ جَرَحُهَا جَبَّارٌ وَالْمَغِينُ جَبَّارٌ وَالْبُيُوتُ جَبَّارٌ وَفِي الرِّكَازِ الْخُمْسُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَعَبَادَةَ بْنِ الصَّامِتِ وَعَمْرُو بْنُ عَوْفٍ الْمُرَزِيُّ وَجَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

17. Mbi vlerësimin

باب مَا جَاءَ فِي الْخُرُصِ

641. Na ka treguar Muhammed b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Shu'be – që Hubejd b. Abdurrahmani,⁵⁹⁵ ka thënë: “E kam dëgjuar Abdurrahman b. Mes'ud b. Nijarin,⁵⁹⁶ kur ka thënë: “Erdhi Sehl b. Ebu Hasmi⁵⁹⁷ në vendin ku ne ishim duke ndenjur dhe na tregoi që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur vlerësimin e (zekatit) e bëni me sy, ende për prodhimet e pavjelura, merrni (për bejtul-mal) dy të tretat e zekatit, ndërsa një të tretën lëreni (që pronari të mund ta ndajë si sadaka aty ku ai dëshiron). Nëse nuk e leni një të tretën, atëherë lëreni bile një të katërtën.”⁵⁹⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Attab b. Usejdi dhe Ibn Abbasi. Sipas hadithit të Sehl b. Ebu Hasmes, veprojnë shumica e dijetarëve, gjatë vlerësimit të zekatit me sy, ende mbi prodhimet e pa vjelura. Is'haku dhe Ahmedit, gjithashtu, pohojnë, që duhet vepruar sipas hadithit të Sehl b. Ebu Hasmes.”

Vlerësimi bëhet, kur piqen hurmet dhe rrushi, për të cilat jepet zekati. Sunduesi do ta dërgojë personin profesional, për ta zbatuar vlerësimin e zekatit. Vlerësimi bëhet, ashtu që personi profesional, duke i shikuar frutat, thotë: “Kjo mund të jap kaq rrush të terur, e kjo mund të jap kaq hurme.” – dhe të gjitha ato, i llogaritë. Pas asaj, do ta vërtetojë, se sa bënë një e dhjeta nga sasia totale, ndërsa sasinë e mbetur ia dorëzon pronarit. Një e dhjeta, në emër të Zekatit, merret tek atëherë, kur vilen pemët. Kështu këtë e komentojnë dijetarët. Këto janë qëndrimet e Malikut, Shafiut, Ahmedit dhe të Is'hakut.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، أَخْبَرَنَا شُعْبَةُ، أَخْبَرَنِي حُذَيْفَةُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، قَالَ سَمِعْتُ عَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنَ مَسْعُودٍ بْنِ نِيَارٍ، يَقُولُ جَاءَ سَهْلُ بْنُ أَبِي حَنْظَلَةَ إِلَى مَجْلِسِنَا فَحَدَّثَنَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يَقُولُ " إِذَا خَرَصْتُمْ فَخُذُوا وَدَعُوا الثَّلَاثَ فَإِنْ لَمْ تَدْعُوا

⁵⁹² Në rast se ndokush i merr punëtorët për të punuar në xeherore ose për t'ia qel një bunar dhe ndodh fatkeqësia duke pësuar me vdekje ose ndokush lëndohet – punëdhënësi nuk është i obliguar të paguaj dëmshpërblim as për të vdekurin e as për të lënduarin.

⁵⁹³ Shumica e dijetarëve islam, pohojnë, që vetëm nga thesari i gjetur i groposur nga stërgjyshërit, nga tërësia e tij jepet, e pesta, derisa në të gjitha llojet e thesareve – për shembull, që nxirren nga xeherorja – jepet përqindje e zakonshme e zekatit. Ebu Hanife, mendon se për çdo lloj të thesarit që nxirret nga toka – pa e pasur parasysh, se a ka të bëjë me thesarin e gropuar, apo thesarin nga xeherorja – jepet e pesta e saj.

⁵⁹⁴ Është i shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

⁵⁹⁵ Hubejd b. Abdurrahman b. Harith el-Medini, është transmetues i besueshëm. I takonte gjeneratës së katërt të ravive.

⁵⁹⁶ Abdurrahman b. Mes'ud b. Nijai el-Ensari el-Medeni, nga dijetarët e hadithit, është vlerësuar si transmetues i pranueshëm. I takonte gjeneratës së katërt të ravive.

⁵⁹⁷ Sehl b. Ebu Hasme i takon as'habëve më të rinj.

⁵⁹⁸ Ky hadith është argument, që personi është i obliguar të jap 2/3 për zekat në fondin e përbashkët (bejtul-mal), ndërsa 1/3 ose 1/4 ta shpërndanë siç dëshiron.

الثَّلَاثُ فَدَعُوا الرُّبْعَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَعَتَّابِ بْنِ أُسَيْدٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَالْعَمَلُ عَلَى حَدِيثِ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْمَةَ عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي الْخَرْصِ وَبِحَدِيثِ سَهْلِ بْنِ أَبِي حَنْمَةَ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَالْخَرْصُ إِذَا أُدْرِكْتَ الْبِمَارُ مِنَ الرُّطْبِ وَالْعِنَبِ مِمَّا فِيهِ الزَّكَاةُ بَعَثَ السُّلْطَانُ خَارِصًا يَخْرُصُ عَلَيْهِمْ . وَالْخَرْصُ أَنْ يَنْظُرَ مَنْ يُبْصِرُ ذَلِكَ فَيَقُولُ يَخْرُجُ مِنْ هَذَا مِنَ الزَّيْبِ كَذَا وَكَذَا وَمِنْ الثَّمَرِ كَذَا وَكَذَا فَيُحْصَى عَلَيْهِمْ وَيَنْظُرُ مَبْلَغَ الْعُشْرِ مِنْ ذَلِكَ فَيُنْبِثُ عَلَيْهِمْ ثُمَّ يَخْلَى بَيْنَهُمْ وَيَبْنِي الثَّمَارَ فَيَصْنَعُونَ مَا أَحْبَبُوا فَإِذَا أُدْرِكْتَ الْبِمَارُ أُجِدَ مِنْهُمْ الْعُشْرُ . هَكَذَا فَسَرَهُ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهَذَا يَقُولُ مَالِكٌ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

642. Na ka treguar Ebu Amr Muslim b. Amr el-Hadha el-Medini – atë e ka informuar Abdullah b. Nafiu, duke transmetuar nga Muhammed b. Salih et-Temmari, ai nga Ibn Shihabi, ai nga Seid b. Musejjebi – që Attab b. Usejdi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ua dërgonte njerëzve, ata që do t’ua vlerësonin fidanet e tyre, të rrushit dhe të pallmave.” Me këtë sened është transmetuar edhe që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi zekatin për rrush ka thënë: “Ai vlerësohet në mënyrë të njëjtë, ashtu si vlerësohen edhe pallmat, pastaj për të jepet zekati në rrush të terur, sikur që për pallma jepet zekati në hurme të terura.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen garib.” Ibn Xhurejxhi, këtë hadith e ka transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Urve, ndërsa ai nga Aishja. E kam pyetur Muhammedin (Buhariun) mbi këtë hadith, ai tha, që hadithi i Ibn Xhurejxhit nuk është ruajtur dhe mbajtur në mend mirë, ashtu që hadithi të cilin e transmeton Seid b. Musejjebe është më i besueshëm.”

حَدَّثَنَا أَبُو عَمْرٍو، مُسْلِمُ بْنُ عَمْرِو الْحَذَّاءُ الْمَدَنِيُّ حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ نَافِعٍ الصَّائِغُ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ صَالِحِ الثَّمَارِ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ عَتَّابِ بْنِ أُسَيْدٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يَبْعَثُ عَلَى النَّاسِ مَنْ يَخْرُصُ عَلَيْهِمْ كُزُومَهُمْ وَيَمَارَهُمْ . وَبِهَذَا الْإِسْنَادِ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ فِي زَكَاةِ الْكُرُومِ " إِنَّهَا تُخْرَصُ كَمَا يُخْرَصُ النَّخْلُ ثُمَّ تُؤَدَّى زَكَاةُ زَيْبِهَا كَمَا تُؤَدَّى زَكَاةُ النَّخْلِ تَمْرًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَقَدْ رَوَى ابْنُ جُرَيْجٍ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ عُرْوَةَ عَنْ عَائِشَةَ . وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ فَقَالَ حَدِيثُ ابْنِ جُرَيْجٍ غَيْرُ مَحْفُوظٍ وَحَدِيثُ ابْنِ الْمُسَيَّبِ عَنْ عَتَّابِ بْنِ أُسَيْدٍ أَثْبَتٌ وَأَصَحُّ .

18. Mbi punëtorin për mbledhjen e zekatit i cili angazhohet me vërtetësi

باب مَا جَاءَ فِي الْعَامِلِ عَلَى الصَّدَقَةِ بِالْحَقِّ

643. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Jezid b. Haruni, atë Jezid b. Ijadi, ai ka transmetuar nga Asim b. Umer b. Katade; Na ka treguar Muhammed b. Ismaili, atë e ka informuar Ahmed b. Halidi, duke transmetuar nga Muhammed b. Is’haku, ai nga Asim b. Umer b. Katade, ai nga Muhammed b. Lebidi – që Rafi b. Hadixhi, ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Punëtori, i cili angazhohet me vërtetësi në mbledhjen e zekatit, është në rangun e luftëtarit në rrugë të Allahut, gjithnjë, derisa nuk kthehet në shtëpinë e vet.”⁵⁹⁹

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Rafi b. Hadixhit, është hasen.”⁶⁰⁰ Jezid b. Ijadi, sipas vlerësimit të dijetarëve të hadithit, është transmetues i dobët, andaj, hadithi i Muhammed b. Is’hakut është më i besueshëm.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ هَارُونَ، أَخْبَرَنَا يَزِيدُ بْنُ عِيَّاضٍ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ عُمَرَ بْنِ قَتَادَةَ، ح وَحَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، قَالَ حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ حَالِدٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ إِسْحَاقَ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ عُمَرَ بْنِ قَتَادَةَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ أَبِيهِ، عَنْ رَافِعِ بْنِ خَدِيجٍ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ

⁵⁹⁹ Që luftëtarit të luftonte në rrugë të Allahut pa pengesë, është e domosdoshme që t’i sigurohet mbështetja logjistike. Njëri nga burimet e logjistikës luftarake janë edhe të ardhurat nga zekati. Prandaj, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atë që vërtetë punon në mbledhjen e zekatin drejtë, e krahason me luftëtarin në rrugë të Allahut, sepse ai me punën e vet ia siguron luftëtarit bazën materiale, pa të cilën nuk do të mund të luftonte.

⁶⁰⁰ E ka shënuar, Ebu Davudi në *Sunen*.

الله ﷻ يَقُولُ " الْعَامِلُ عَلَى الصَّدَقَةِ بِالْحَقِّ كَالْعَازِي فِي سَبِيلِ اللَّهِ حَتَّى يَرْجِعَ إِلَى بَيْتِهِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ رَافِعِ بْنِ خَدِيجٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَيَزِيدُ بْنُ عِيَاضٍ ضَعِيفٌ عِنْدَ أَهْلِ الْحَدِيثِ . وَحَدِيثُ مُحَمَّدِ بْنِ إِسْحَاقَ أَصَحُّ .

19. Mbi atë, i cili bënë shkelje në zekat

باب مَا جَاءَ فِي الْمُعْتَدِي فِي الصَّدَقَةِ

644. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Habibi, ai nga Sa'd b. Sinani,⁶⁰¹ ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ai që bën shkelje në zekat është i njëjtë me atë që nuk e paguan atë.”⁶⁰²

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Ummu Seleme dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Enesit në këtë formë është garib.⁶⁰³ Ahmed b. Hanbeli e ka kritikuar Sa'd b. Sinanin. Kështu, njëjtë thotë edhe Lejth b. Sa'di, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Habibi, ai nga Sa'd b. Sinani, ndërsa ai nga Enes b. Maliku. E kam dëgjuar Muhammedin, kur ka thënë: “E drejtë është: “Sinan b. Sa'd.”⁶⁰⁴ Fjalët e tij: “ai që bën shkelje në zekat është i njëjtë me atë që nuk e paguan atë” – domethënë, ai i cili në zekat kalon kufirin në zekat, ka të njëjtin mëkat sikur ai që refuzon ta japë zekatin.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ، عَنْ سَعْدِ بْنِ سِنَانٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " الْمُعْتَدِي فِي الصَّدَقَةِ كَمَا نَعِيَهَا " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَأُمِّ سَلَمَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ تَكَلَّمَ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ فِي سَعْدِ بْنِ سِنَانٍ . وَهَكَذَا يَقُولُ اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ عَنْ سَعْدِ بْنِ سِنَانٍ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ . وَيَقُولُ عَمْرُو بْنُ الْحَارِثِ وَابْنُ لَهْيَعَةَ عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ عَنْ سِنَانِ بْنِ سَعْدٍ عَنْ أَنَسٍ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَقُولُ وَالصَّحِيحُ سِنَانُ بْنُ سَعْدٍ . وَقَوْلُهُ " الْمُعْتَدِي فِي الصَّدَقَةِ كَمَا نَعِيَهَا " يَقُولُ عَلَى الْمُعْتَدِي مِنَ الْإِثْمِ كَمَا عَلَى الْمَانِعِ إِذَا مَنَعَ .

⁶⁰¹ Dijetarët e hadithit, i kanë paraqitur vlerësimet e ndryshme, mbi transmetuesin Sa'd b. Sinanin. Dhehebiu, në veprën e vet *Mizame i tidal*, thotë se Ahmed b. Hanbeli, për te ka thënë: Unë nga ai nuk shënoj hadithe, sepse ka qenë i prirë për *idtirab* (ngatërrim). Xhezevxhani thotë, se hadithet që i transmeton ai, janë të dobët. Ed-Darekutni thotë, se është ravi i dobët. Ibn Haxheri, në veprën *Tekribut-Tehzib*, thotë: “Sa'd b. Sinani, ndërsa është thënë edhe Siman b. Sa'd el-Kindi el-Masri - këtë të dytën Buhariu dhe Ibn Enesi e konsiderojnë më të drejtë – është transmetues i sinqertë, i takonte gjeneratës së pestë të ravive.”

⁶⁰² Abdurrahman el-Mubarekfuri, thotë, që kalimi i kufirit të zekatin, ka të bëjë me ata që punojnë në mbledhjen e zekatit. Në rast se ndonjëri nga ata, e shkelin masën dhe në emër të zekatit merr më tepër se sa duhet edhe atë njerëzit e vërejnë dhe vitin që vjen fillojnë me fshehjen e pasurisë për të dhënë më pak zekat. Ebu Davudi, në *Sunen*, shënon me sened, që Bishër el-Husasijj, ka thënë: “I thamë të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “O i Dërguar i Allahut, disa nga mbledhësit e zekatin, e kalojnë kufirin e të lejuarës dhe nga ne marrin më tepër sesa që duhet dhënë – andaj, a mundemi që nga pasuria, të fshehim aq sa marrin më tepër nga ne?” “Jo, nuk mundeni – tha i Dërguari i Allahut.”

Disa thonë, që kalimi i të lejuarës në zekat mund të ketë të bëjë edhe me atë që jep zekat. Në rast se ndokush duke dhënë zekat më tepër se që i takon, e sjell familjen në situatë të vështirë materiale, jo vetëm që nuk do të kishte sevap, por, për atë do të kishte mëkat të barabartë me atë që nuk jep zekat. Disa, bile thonë që kalimi i kufirit të zekatit ka të bëjë me ata të cilët zekatin e japin aty, ku nuk duhet.

⁶⁰³ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunene*, mandej Ibn Hibbani në *Sahih* – dhe të gjithë nëpërmjet Sa'd b. Sinanit nga Enes b. Maliku.

⁶⁰⁴ Dijetarët e hadithit kanë divergjenca në pikëpamje të emrit të Sa'd b. Sinanit. Lejthi konsideron, se emri i tij është Sa'd b. Sinan. Imr b. Harith dhe Ibn Lehiu thonë që emri i tij është Sinan b. Sa'd. Tirmidhiu e konsideron që Buhariu e konsideronte të drejtë që emri i tij është Sinan b. Sa'd.

20. Mbi kënaqësinë e mbledhësit të zekatin

باب مَا جَاءَ فِي رِضَا الْمُصَدِّقِ

645. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Muhammed b. Jezidi, ai ka transmetuar nga Muxhalidi, ai nga Sha'bi, ai nga Xherriri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur te ju vjen mbledhësi i zekatit, le të ndahet i kënaqur nga ju.”⁶⁰⁵

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَزِيدَ، عَنْ مُجَالِدٍ، عَنِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ جَرِيرٍ، قَالَ قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " إِذَا أَتَاكُمُ الْمُصَدِّقُ فَلَا يَفَارِقَنَّكُمْ إِلَّا عَنْ رِضَا " .

646. Na ka treguar Ebu Ammari – atij i ka treguar Sufjani, duke transmetuar nga Davudi, ai nga Sha'biu, ndërsa ai nga Xherriri, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai thotë: “Hadithin të cilin e transmeton Davudi nga Sha'biu, është më i besueshëm sesa hadithi i Muxhalidit.”⁶⁰⁶ Shumë dijetarë, Muxhalidin e kanë vlerësuar si ravi të dobët. Ai shumë gabonte gjatë transmetimit të haditheve.”

حَدَّثَنَا أَبُو عَمْرِو الْحُسَيْنُ بْنُ حُرَيْثٍ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ دَاوُدَ، عَنِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ جَرِيرٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ بِخَوِّهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ دَاوُدَ عَنِ الشَّعْبِيِّ، أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ مُجَالِدٍ . وَقَدْ ضَعُفَتْ مُجَالِدًا بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ وَهُوَ كَثِيرُ الْغَلَطِ .

21. Zekati merret nga të pasurit dhe u ndahet të varfërve

باب مَا جَاءَ أَنَّ الصَّدَقَةَ تُؤْخَذُ مِنَ الْأَغْنِيَاءِ فَتُرَدُّ فِي الْفُقَرَاءِ

647. Na ka treguar Ali b. Seid el-Kindi – atë e ka informuar Hafs b. Gijathi, ai ka transmetuar nga Esh'athe, ai nga Avn b. Ebu Xhuhejfe – që babai i Avn b. Ebu Huxhejfes, ka thënë: “Erdhi te ne mbledhësi i zekatin, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). E mori zekatin nga të pasurit tanë dhe ua ndau atë të varfërve tanë. Duke e pasur parasysh se (atëherë) isha ende fëmijë jetim, ma dha edhe mua një deve të re.”⁶⁰⁷

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Abbasi. Hadithi i Ebu Xhuhejfes është hasen.”⁶⁰⁸

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ سَعِيدٍ الْكِنْدِيُّ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا حَفْصُ بْنُ غِيَاثٍ، عَنْ أَشْعَثَ، عَنْ عَوْنِ بْنِ أَبِي جَحِيفَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ قَدِمَ عَلَيْنَا مُصَدِّقُ النَّبِيِّ ﷺ فَأَخَذَ الصَّدَقَةَ مِنْ أَغْنِيَائِنَا فَجَعَلَهَا فِي فُقَرَائِنَا وَكُنْتُ غُلَامًا يَتِيمًا فَأَعْطَانِي مِنْهَا قُلُوصًا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي جَحِيفَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ .

⁶⁰⁵ Zekati mbledhet i organizuar, në mënyrë sistematike. Patronati i mbledhjes së zekatit i takon shtetit islam. Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në këtë hadith, u ka sugjeruar pasuesve të islamit, që me mbledhësit e zekatin, të sillen bukur dhe që nga zekati, pa diskutim, ta ndajnë atë që janë të obliguar, që edhe ata, punën e vet, e cila nuk është aspak e lehtë, ta kryejnë me kënaqësi.

⁶⁰⁶ E ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

⁶⁰⁷ Në disa ekzemplarë, të dorëshkrimeve të përmbledhjes, së Tirmidhiut, qëndron: “E ka marr zekatin nga të pasurit tanë dhe ua ka ndarë të varfërve tanë në fisin dhe vendin tonë.” Këtë, Maliku, sipas transmetimeve, Shafiu dhe shumica e ulemasë, e kanë paraqitur si argument, që zekatin duhet ndarë të varfërve aty ku është mbledhur, në rast se ka të atillë që kanë nevojë për zekat dhe nuk është e lejuar të bartet në ndonjë vend tjetër. Ebu Hanife, Ebu Jusufi dhe Muhammedi, konsiderojnë, që zekati mund të bartet nga një vend në tjetrin dhe në ato vende t’u ndahet të varfërve. Edhe Buhariu e mbështet qëndrimin e tillë. Ai, në *Xhamius-Sahih*, e ka titulluar një kapitull: *Marrja e zekatit nga të pasurit dhe ndarja e tij të varfërve kudo qofshin ata*.

⁶⁰⁸ Shevkani në veprën *Nejlul-Evtar*, thekson, që të gjithë ravitë, në senedin e këtij hadithi, janë të besueshëm, përveç Esh’as b. Suvarit, të cilin, disa dijetarë të hadithit e kanë kritikuar. Megjithatë, nga ai, Muslimi në *Sahih* i ka transmetuar disa hadithe mutabea.

22. Kush e ka të lejuar ta pranojë zekatin

بَاب مَا جَاءَ مَنْ تَحِلُّ لَهُ الزَّكَاةُ

648. Na kanë treguar Kutejbe dhe Ali b. Huxhri, ata i ka informuar Sheriku, duke transmetuar kuptimin e njëjtë, nga Hakim b. Xhubejri, ai nga Muhammed b. Abdurrahman b. Jezidi, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Abdullah b. Mes'udi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kushdo që lyp nga njerëzit derisa ai ka atë çka i nevojitet, ai do të vijë në Ditën e Gjykimit me lypjen e tij - gërvishtje apo çarje, ose shenja kafshimi në fytyrën e tij.” “E sa është ajo që i mjafton, o i Dërguar i Allahut?” “Pesëdhjetë dërrhem, ose kundërvlera e tyre në ar.” – tha ai.⁶⁰⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Abdullah b. Amri. Hadithi i Ibn Mes'udit është hasen.⁶¹⁰ Shu'be e ka kritikuar Hakim b. Xhubejrin,⁶¹¹ në lidhje me këtë hadith.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَعَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، - قَالَ قُتَيْبَةُ حَدَّثَنَا شَرِيكٌ، وَقَالَ، عَلِيُّ أَخْبَرَنَا شَرِيكٌ، وَالْمَعْنَى، وَاحِدٌ، عَنْ حَكِيمِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ يَزِيدٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ سَأَلَ النَّاسَ وَلَهُ مَا يُغْنِيهِ جَاءَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَمَسْأَلَتُهُ فِي وَجْهِهِ خُمُوشٌ أَوْ خُدُوشٌ أَوْ كُدُوحٌ " . قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ وَمَا يُغْنِيهِ قَالَ " خُمْسُونَ دِرْهَمًا أَوْ قِيَمَتُهَا مِنَ الذَّهَبِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ مَسْعُودٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ تَكَلَّمَ شُعْبَةُ فِي حَكِيمِ بْنِ جُبَيْرٍ مِنْ أَجْلِ هَذَا الْحَدِيثِ .

649. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Jahja b. Ademi, atë Sufjani, duke transmetuar nga Hakim b. Xhubejri – këtë hadith. Abdullah b. Uthmani, nxënësi i Shu'bes, i tha (Sufjanit): “Ku është ai fat që ndokush tjetër ta kishte transmetuar këtë hadith, përveç Hakimit!” Sufjani, në atë tha: “Përse!? Vallë, a nuk e ka transmetuar Shu'be nga Hakimi?” “Jo, nuk e ka transmetuar.” – u përgjigj ai. Safvani, në atë tha: “E kam dëgjuar Zubejden, kur e ka transmetuar këtë hadith nga Muhammed b. Abdurrahman b. Jezidi.”

Në pajtim me këtë hadith, kanë vepruar disa dijetarë të hadithit. Ky është mendimi edhe i Eth-Thevriut, Abdullah b. Mubarekut, Ahmedit dhe i Is'hakut. Ata, thonë: “Nëse personi i posedon pesëdhjetë dërrhem, nuk e ka të lejuar të marr zekat.” “Disa dijetarë nuk iu përmbaheshin hadithit të Hakim b. Xhubejrit, ata në këtë kanë shkuar edhe më larg dhe kanë thënë: “Nëse ndokush do të posedonte pesëdhjetë ose më tepër dërrhem, por atij do t'i duheshin më tepër se aq, do ta kishte të lejuar të merrte zekat.”

Ky është qëndrimi i Shafiut, juristëve dhe i fakihëve të tjerë Islam.⁶¹²

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ آدَمَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ حَكِيمِ بْنِ جُبَيْرٍ، بِهَذَا الْحَدِيثِ . فَقَالَ لَهُ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عُثْمَانَ صَاحِبُ شُعْبَةَ لَوْ غَيْرَ حَكِيمٍ حَدَّثَ بِهَذَا الْحَدِيثِ . فَقَالَ لَهُ سُفْيَانُ وَمَا لِحَكِيمٍ لَا يُحَدِّثُ عَنْهُ شُعْبَةُ قَالَ نَعَمْ . قَالَ سُفْيَانُ سَمِعْتُ رُبَيْدًا يُحَدِّثُ بِهَذَا عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ يَزِيدٍ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَصْحَابِنَا وَبِهِ يَقُولُ الثَّوْرِيُّ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . قَالُوا إِذَا كَانَ

⁶⁰⁹ Nesaiu, shënon nga Abdullah b. Amri, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush kërkon nga njerëzit, e ka dyzet dërrhemë, i takon atyre të cilët i bezdisin njerëzit.” E shënojnë Ebu Davudi në *Sunen* dhe Ibn Hibbani në *Sahih*, nga Sehl b. Handhale – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush kërkon nga njerëzit, ndërsa ka aq sa i mjafton – ai bën përpjekje për xhehenem.” “E sa konsiderohet mjaftueshëm, o i Dërguar i Allahut?” – kanë pyetur të pranishmit. “Aq sa i duhen për mëngjes dhe darkë.” – tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁶¹⁰ E kanë shënuar Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Ed-Darimi në *Sunen*.

⁶¹¹ Ibn Haxher el-Askalani, në veprën *Takribut-tehziib*, thotë, që Hakim b. Xhubejri, është ravi i dobët dhe që ka anuar kah shiizmi.

⁶¹² Sipas mendimit të Ebu Hanifes, të pasur konsiderohen, të gjithë ata të cilët kanë pasuri me lartësi të nisabit dhe ata të cilët nuk mund të pranojnë zekat, ndërsa të gjithë të tjerët që kanë më pak se aq, munden.

عَنْ الرَّجُلِ خَمْسُونَ دِرْهَمًا لَمْ تَحِلَّ لَهُ الصَّدَقَةُ . قَالَ وَلَمْ يَذْهَبْ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى حَدِيثِ حَكِيمِ بْنِ جُبَيْرٍ وَوَسَّعُوا فِي هَذَا وَقَالُوا إِذَا كَانَ عِنْدَهُ خَمْسُونَ دِرْهَمًا أَوْ أَكْثَرُ وَهُوَ مُحْتَاجٌ فَلَهُ أَنْ يَأْخُذَ مِنَ الزَّكَاةِ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَغَيْرِهِ مِنْ أَهْلِ الْفَقْهِ وَالْعِلْمِ .

23. Kush nuk e ka të lejuar të merr zekat

باب مَا جَاءَ مَنْ لَا تَحِلُّ لَهُ الصَّدَقَةُ

650. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Ebu Davud et-Tajalisi, atë Sufjani; na ka treguar Muhammed b. Gajlani, atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Sufjani, duke transmetuar nga Sa'd b. Ibrahim, ai nga Rejhan b. Jezidi, ai nga Abdullah b. Amri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk është e lejuar, që zekatin ta marr i pasuri, e as ai i cili është në gjendje për të fituar.”⁶¹³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Hubshijj b. Xhunadi dhe Kabis b. Muhariku. Hadithi i Abdullah b. Amrit, është hasen.⁶¹⁴ Këtë hadith, me këtë sened të njëjtë, e ka transmetuar edhe Shu'be nga Sa'd b. Ibrahim, meqë ai atë nuk e lidh për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Në hadithet e tjera, transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘I pasuri dhe ai që është në gjendje të fitojë, nuk e kanë të lejuar të kërkojnë nga njerëzit.’ Nëse ndonjë person është fizikisht i aftë, por në nevojë, sepse nuk ka asgjë nga pasuria – dhe ndokush i ka dhënë zekat, ai i cili i ka dhënë zekat atij, me atë, sipas mendimit të dijetarëve, e ka kryer obligimin. Ky hadith, sipas mendimit të disa dijetarëve ka të bëjë me të kërkuarit nga njerëzit.”

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ، مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ سَعِيدٍ، ح وَحَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا سُفْيَانُ، عَنْ سَعْدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ رِيحَانَ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " لَا تَحِلُّ الصَّدَقَةُ لِغَنِيِّ وَلَا لِذِي مِرَّةٍ سِوَى " . قَالَ فِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَحُبْشَةَ بْنِ جُنَادَةَ وَفَيْصَةَ بْنِ مَخَارِقٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَى شُعْبَةُ عَنْ سَعْدِ بْنِ إِبْرَاهِيمَ هَذَا الْحَدِيثَ بِهَذَا الْإِسْنَادِ وَلَمْ يَرْفَعْهُ . وَقَدْ رَوَى فِي غَيْرِ هَذَا الْحَدِيثِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ " لَا تَحِلُّ الْمَسْأَلَةُ لِغَنِيِّ وَلَا لِذِي مِرَّةٍ سِوَى " . وَإِذَا كَانَ الرَّجُلُ قَوِيًّا مُحْتَاجًا وَلَمْ يَكُنْ عِنْدَهُ شَيْءٌ فَتَصَدَّقَ عَلَيْهِ أَجْرًا عَنِ الْمُتَصَدِّقِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ وَوَجْهٌ هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ عَلَى الْمَسْأَلَةِ .

651. Na ka treguar Ali b. Seid el-Kindi, atë e ka informuar Abdurrahim b. Sulejmani, duke transmetuar nga Muxhalidi, ai nga Amiri – që Hubshijj b. Xhund es-Seluli, ka thënë: “E kam parë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Haxhin Lamtumirës, kur, derisa ishte duke qëndruar në ‘Arafat, iu afrua një beduin, e morri për skajin e pelerinës dhe iu lut që t’i jepte diçka. Pasi që i dha, ai shkoi. Me atë rast është ndalur së lypuri. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tha: “Të lypurit nga njerëzit, është e ndaluar për të pasurin dhe për atë që është në gjendje të fitojë, është i lejuar vetëm për të varfrin, të mjerin dhe të mbyturin në borxhe. Ndërsa, kush kërkon nga njerëzit për ta shtuar kapitalin e vet, në Ditën e Gjykimit ka për të qenë i gërvishtur thellë me te mbi fytyrë dhe ai kapital i tij, ka për të qenë i shndërruar në gurrë të zjarri të Xhehennemit, të cilët ka për t’i ngrënë. Pra, (pasi që e dëgjuat këtë) kush donë (të kërkuarit nga njerëzit ose sasinë e atyre gurëve) le pakësojë, por kush dëshiron le t’i shtojë ata.”

⁶¹³ Nga ky hadith shihet qartë, se ai që është i pasur, i shëndosh, i aftë për të fituar, nuk është e lejuar ta marr zekatin. Disa dijetarë, konsiderojnë, që ky hadith ka të bëjë me të kërkuarit nga njerëzit. Pra, ai që është i pasur, i shëndoshë, i aftë dhe në gjendje për të fituar nuk e ka të lejuar të kërkojë nga njerëzit. Mbi kuptimin e këtillë, tregon edhe hadithi, të cilin e transmeton Hubshijj b. Xhunadi. Ndërkaq, sipas vlerësimit të disa dijetarëve të hadithit, ai është i dobët, sepse në senedin e tij gjendet Muxhalidi, i cili është ravi i dobët.

⁶¹⁴ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi dhe Ed-Darimi në *Sunen*.

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ سَعِيدٍ الْكِنْدِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحِيمِ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ مُجَالِدٍ، عَنْ عَامِرِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ حُبَيْبِ بْنِ جُنَادَةَ السَّلُولِيِّ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ فِي حَجَّةِ الْوَدَاعِ وَهُوَ وَقِفْتُ بِعَرَفَةَ أَنَّهُ أَغْرَابِي فَأَخَذَ بِطَرَفِ رِدَائِهِ فَسَأَلَهُ إِيَّاهُ فَأَعْطَاهُ وَذَهَبَ فَعِنْدَ ذَلِكَ حُرِمَتِ الْمَسْأَلَةُ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ الْمَسْأَلَةَ لَا تَحِلُّ لِعَبْدِي وَلَا لِزَيْ مَرَّةٍ سِوَى الْإِذِي فَقَرِ مُدَقِّعٌ أَوْ غَرِمٌ مُفْطِعٌ وَمَنْ سَأَلَ النَّاسَ لِيُثْرِيَ بِهِ مَالَهُ كَانَ خُمُوشًا فِي وَجْهِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَرَضْعًا يَأْكُلُهُ مِنْ جَهَنَّمَ فَمَنْ شَاءَ فَلْيَقِلَّ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْثِرْ " .

652.- Na ka treguar, Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Jahja b. Ademi, ai ka transmetuar nga Abdurrahim b. Sulejmani – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isaku thotë: “Ky hadith, në këtë formë, është garib.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ أَدَمَ، عَنْ عَبْدِ الرَّحِيمِ بْنِ سُلَيْمَانَ، نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

24. Kush nga borxhlinjtë dhe të tjerët e kanë të lejuar zekatin

باب مَا جَاءَ مِنْ تَحِلُّ لَهُ الصَّدَقَةُ مِنَ الْغَارِمِينَ وَغَيْرِهِمْ

653. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Bukejr b. Abdullah b. Eshexhxi, ai nga Ijad b. Abdullahu – që Ebu Seid el-Hudriu ka thënë: “Gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), një njeriu, fatkeqësia natyrore ia ka shkatërruar frutat që i kishte blerë, ashtu që, shumë kishte hyrë në borxhe – dhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tha: ‘Jepjani zekatin.’ Njerëzit ia dhanë zekatin. Por, pasi që atë (që e ka marr) nuk i kanë mjaftuar për t’i kthyer borxhet, i Dërguari i Allahut u tha emisarëve të tij. ‘Merrni atë që ka dhe mos kërkon asgjë tjetër!’”⁶¹⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Xhujejrija dhe Enesi. Hadithi i Ebu Seidit është hasen-sahih.”⁶¹⁶

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ بُكَيْرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْأَشَجِّ، عَنْ عِيَّاضِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ أَصِيبَ رَجُلٌ فِي عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي ثَمَارٍ ابْتِاعَهَا فَكَثُرَ دَيْنُهُ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " تَصَدَّقُوا عَلَيْهِ " . فَتَصَدَّقَ النَّاسُ عَلَيْهِ فَلَمْ يَبْلُغْ ذَلِكَ وَفَاءَ دَيْنِهِ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " خُذُوا مَا وَجَدْتُمْ وَلَيْسَ لَكُمْ إِلَّا ذَلِكَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَجُوَيْرِيَةَ وَأَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

25. Mbi mospëlqimin e dhënies së lëmoshës,⁶¹⁷ të Dërguarit, familjes së tij dhe të mbrojturve të tij

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الصَّدَقَةِ لِلنَّبِيِّ ﷺ وَأَهْلِ بَيْتِهِ وَمَوَالِيهِ

654. Na ka treguar Bundari – atë e kanë informuar Mekijj b. Ibrahim dhe Jusuf b. Ja’kub ed-Dubeijj, ata i ka informuar Behz b. Hakimi, duke transmetuar nga babai i vet – që gjyshi i Behz b. Hakimit, ka

⁶¹⁵ Rasti i përmendur, i ka ndodhur Muadh b. Xhebelit. Ai nga disa njerëz, i ka blerë frutat e papjekura të pallmës që kur piqen, t’i shiste ato dhe të fitonte diç. Ndërkaq, ishte shfaqur një sëmundje dhe deri në themel i ka shkatërruar frutat. Muadhi nuk kishte me çfarë ta kthente borxhin. Duke e kuptuar atë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i lejoi njerëzit t’ia jepnin zekatin për t’i sanuar borxhet. Njerëzit ia jepnin zekatin. Pasi ata nuk mjaftuan për t’i kthyer borxhet, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) nga të besueshmit e tij, ka kërkuar që ta praninin atë që kishte, e për të tjerat ta prisnin atë.

⁶¹⁶ E ka shënuar Muslimi, në *Xhamius-sahih*.

⁶¹⁷ Nga pikëpamja Islame, ekzistojnë dy lloje të sadakasë, lëmosha me karakter të obliguar, siç është zekati, dhe lëmosha jo e obliguar, siç është e përditshmja, e cila u jepet të varfërve. Edhe forma e parë edhe e dyta, për të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), familjen e tij dhe të mbrojturit e tij, ka qenë e ndaluar.

thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka pasur praktikë, që kur ndokush i jepte diç, të pyeste: ‘A është kjo lëmoshë apo hedije?’ Nëse thoshin që është lëmoshë, ai nuk atë e hante. Por, nëse thoshin që është hedije, ai atë e hante.”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Selmani, Ebu Hurejre, Enesi, Hasan b. Aliu, Ebu Amiri, gjyshi i Muarrif b. Vasil, i cili quhej Rushejd b. Maliku, Mejmun b. Mihrani, Ibn Abbasi, Abdullah b. Amri, Ebu Rafiu dhe Abdurrahman b. Alkame. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar edhe nga Abdurrahman b. Alkame. Ai, e transmeton nga Abdurrahman b. Ebu Akili, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Gjyshi i Behza b. Hakimit është Muavi b. Hajd el-Kushejri. Hadithi i Behz b. Hakimit është hasen garib.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا مَكِيُّ بْنُ إِبْرَاهِيمَ، وَيُوسُفُ بْنُ يَعْقُوبَ الضَّبْعِيُّ السُّوسِيُّ، قَالَ حَدَّثَنَا بَهْرُ بْنُ حَكِيمٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ إِذَا أَتَى بِشَيْءٍ سَأَلَ " أَصَدَقَهُ هِيَ أَمْ هَدِيَّةٌ " . فَإِنْ قَالُوا صَدَقَهُ لَمْ يَأْكُلْ وَإِنْ قَالُوا هَدِيَّةٌ أَكَلَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ سَلْمَانَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَأَنَسٍ وَالْحَسَنِ بْنِ عَلِيٍّ وَأَبِي عَمِيرَةَ جَدِّ مُعَرِّفِ بْنِ وَاصِلٍ وَأَسْمَةَ رُشَيْدِ بْنِ مَالِكٍ وَمَيْمُونِ بْنِ مِهْرَانَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَعَبْدَ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَأَبِي رَافِعٍ وَعَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنِ عُلْفَمَةَ . وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ أَيْضًا عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عُلْفَمَةَ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي عَقِيلٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَجَدُّ بَهْرُ بْنُ حَكِيمٍ اسْمُهُ مُعَاوِيَةُ بْنُ حَبِيبَةَ الْقُسَيْرِيُّ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَحَدِيثُ بَهْرُ بْنُ حَكِيمٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

655. Na ka treguar Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Muhammed b. Xha'feri, atë Shu'be, duke transmetuar nga Hakimi – që Ibn Ebu Rafiu, ka thënë: “E dërgoi i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), një njeri nga fisi Benu Mahzum, që ta mblidhte zekatin. Ai i tha Ebu Rafiut: “Më shoqëro që të marrësh diç nga zekati.” “Jo, nuk vijë”- tha ai “derisa nuk shkoi tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për ta pyetur mbi atë.” Shkoi tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e pyet, e ai tha: “Ne nuk e kemi të lejuar të marrim zekat, po edhe të mbrojturit e një populli kanë trajtim të njëjtë sikur populli i tyre.”⁶¹⁸

Tirmidhiu, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.⁶¹⁹ Ebu Rafiu ka qenë i mbrojturi i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai quhej Eslem. I biri i Ebu Rafiut quhej Ubejdullah b. Ebu Rafiu. Ai ishte shkruesi i Ali b. Ebu Talibit.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى، قَالَ حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ الْحَكَمِ، عَنْ ابْنِ أَبِي رَافِعٍ، عَنْ أَبِي رَافِعٍ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ بَعَثَ رَجُلًا مِنْ بَنِي مَخْرُومٍ عَلَى الصَّدَقَةِ فَقَالَ لِأَبِي رَافِعٍ اصْحَبْنِي كَيْمَا تُصِيبَ مِنْهَا . فَقَالَ لَا . حَتَّى آتِيَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَاسْأَلَهُ . فَانْطَلَقَ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَسَأَلَهُ فَقَالَ " إِنَّ الصَّدَقَةَ لَا تَحِلُّ لَنَا وَإِنَّ مَوَالِيَ الْقَوْمِ مِنْ أَنْفُسِهِمْ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو رَافِعٍ مَوْلَى النَّبِيِّ ﷺ اسْمُهُ أَسْلَمٌ وَابْنُ أَبِي رَافِعٍ هُوَ عُيَيْدُ اللَّهِ بْنُ أَبِي رَافِعٍ كَاتِبُ عَلِيِّ بْنِ أَبِي طَالِبٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ .

26. Mbi dhënien e lëmoshës të afërmve

باب مَا جَاءَ فِي الصَّدَقَةِ عَلَى ذِي الْقَرَابَةِ

656. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Asimi, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabeja, ajo nga xhaxhai i vet, Selman b. Amiri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndokush nga ju dëshiron të bëjë iftar, le ta bëjë atë me hurme – sepse ajo është me bereqet. Nëse nuk ka hurme, le ta bëjë atë me ujë – sepse ai me të vërtetë pastron.” Por, e ka thënë edhe këtë: “Me lëmoshë e cila ndahet të mjerit (i cili nuk është

⁶¹⁸ Në bazë të këtij hadithi, Ebu Hanife dhe disa dijetarë shafitë, janë të mendimit, që nuk është e lejuar të marrin zekat as lëmoshë si Hashimovitët e as robërit e tyre të lirë dhe të mbrojturit. Ndërsa, shumica e konsiderojnë, që robërve të liruar të Hashimovitëve dhe të mbrojturve të tyre është e lejuar marrja e zekatit dhe e lëmoshës, sepse ata, në realitet nuk i takojnë atij fisi.

⁶¹⁹ E kanë shënuar Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sahih*.

farefis), e bënë një të mirë. Ndërsa, me lëmoshë e cila i ndahet të afërmit, bëhen dy të mira. Njëra është ndarja e lëmoshës, ndërsa tjetra është mbajtja e lidhjeve farefisnore.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Zejnebja, bashkëshortja e Abdullah b. Mes’udit, Xhabiri dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Selman b. Amirit, është hasen.⁶²⁰ Rebabja, në të vërtetë, është nëna e Rakihs, vajzës së Sulej’es. Gjithashtu, transmeton Sufjan eth-Thevriu nga Asimi, ndërsa ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabja, ajo nga xhaxhai i vet Selman b. Amiri, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e mëparshëm. Ka transmetuar Shu’be nga Asimi, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ndërsa ajo nga Selman b. Amiri dhe gjatë asaj në sened, nuk e ka përmendur ‘nga Rebabja.’ Hadithin, të cilin e transmetojnë Sufjan eth-Thevriu dhe Ibn Ujejne, është më i besueshëm. Gjithashtu, e kanë transmetuar Ibn Avani dhe Hisham b. Hassani nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabja, e ajo nga Selman b. Amiri.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ، عَنِ الرَّبَابِ، عَنْ عَمَّاهُ، سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ يَبْلُغُ بِهِ النَّبِيُّ ﷺ قَالَ " إِذَا أَطَرَّ أَحَدُكُمْ فَلْيُفْطِرْ عَلَى ثَمَرٍ فَإِنَّهُ بَرَكَةٌ فَإِنْ لَمْ يَجِدْ ثَمَرًا فَلَالْمَاءِ فَإِنَّهُ طَهُورٌ " . وَقَالَ " الصَّدَقَةُ عَلَى الْمُسْكِينِ صَدَقَةٌ وَهِيَ عَلَى ذِي الرَّجْمِ ثِنْتَانِ صَدَقَةٌ وَصَلَةٌ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ زَيْنَبِ امْرَأَةِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَجَابِرِ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَالرَّبَابُ هِيَ أُمُّ الرَّائِحِ بِنْتُ صُلَيْعٍ . وَهَكَذَا رَوَى سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ عَنْ عَاصِمٍ عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنِ الرَّبَابِ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ هَذَا الْحَدِيثِ . وَرَوَى شُعْبَةُ عَنْ عَاصِمٍ عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ . وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ عَنِ الرَّبَابِ . وَحَدِيثُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ عُيَيْنَةَ أَصَحُّ . وَهَكَذَا رَوَى ابْنُ عُثْمَانَ وَهَشَامُ بْنُ حَسَّانٍ عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنِ الرَّبَابِ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ .

27. Mbi atë që në pasuri, përveç zekatit, ka edhe ndarje të tjera të obliguara

بَابُ مَا جَاءَ أَنَّ فِي الْمَالِ حَقًّا سِوَى الزَّكَاةِ

657. Na ka treguar Muhammed b. Medduvejh,⁶²¹ atë e ka informuar Esved b. Amiri, ai ka transmetuar nga Sheriku, ai nga Ebu Hamza, ai nga Sha’biu – që Fatimja, vajza e Kajsit, ka thënë: “E pyeta (ose është thënë: “Është pyetur...”)) të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi zekatin, ai tha: “Në pasuri ka edhe ndarje të tjera të obliguara, përveç zekatit.” Pastaj e recitoi këtë ajet nga sureja *“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi...”*⁶²²

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ أَحْمَدَ بْنِ مَدُودٍ، حَدَّثَنَا الْأَسْوَدُ بْنُ عَامِرٍ، عَنْ شَرِيكِ، عَنْ أَبِي حُمْزَةَ، عَنِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ فَاطِمَةَ بِنْتِ قَيْسٍ، قَالَتْ سَأَلْتُ أَوْ سَأَلَ النَّبِيُّ ﷺ عَنِ الزَّكَاةِ فَقَالَ " إِنَّ فِي الْمَالِ لَحَقًّا سِوَى الزَّكَاةِ " . ثُمَّ ثَلَا هَذِهِ الْآيَةَ الَّتِي فِي الْبَقَرَةِ (لَيْسَ الْبِرُّ أَنْ تُولُوا وَجُوهَكُمْ) الْآيَةَ .

658. Na ka treguar Abdullah b. Abdurrahmani – atë e ka informuar Muhammed b. Tufejli, duke transmetuar nga Sheriku, ai nga Ebu Hamza, ai nga Amiri,⁶²³ ai nga Fatimja, vajza e Kajsit – që i

⁶²⁰ Përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar edhe Ahmedi në *Musned*, Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Ed-Darimi, në *Sunen*. Asnjëri prej tyre, nuk përmend, që hurma është e bereqetshme, përveç Tirmidhiut. Hakimi konsideron, që senedi i këtij hadithi është i besueshëm.

⁶²¹ Ibn Haxher el-Askalani, në veprën *Tekribut-tehzi*, thotë, që është quajtur Muhammed b. Ahmed b. Husejn b. Medduvejh el-Kureshi Ebu Abdurrahman et-Tirmidhi. Është ravi i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së pesëmbëdhjetë.

⁶²² “*Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.*” (El-Bekare: 177)

⁶²³ Ai, në të vërtetë është Amir esh-Shabijj, dijetarë i njohur i hadithit, nga gjenerata e tabi’inëve.

Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Në pasuri ka edhe ndarje të tjera të obliguara, përveç zekatit.”

Ebu Isai, thotë: “Senedi i këtij hadithi është aq i fuqishëm.⁶²⁴ Ebu Hamza Mejmun el-A’veri, është konsideruar si ravi⁶²⁵ i dobët. Këtë hadith, Bejani dhe Ismail b. Salimi, e kanë transmetuar nga Sha’bi. Ai konsideron, që kjo është më e besueshme.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، أَخْبَرَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الطُّفَيْلِ، عَنْ شَرِيكِ، عَنْ أَبِي حَمْرَةَ، عَنْ عَامِرِ الشَّعْبِيِّ، عَنْ فَاطِمَةَ بِنْتِ قَيْسٍ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِنَّ فِي الْمَالِ حَقًّا سِوَى الزَّكَاةِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ إِسْنَادُهُ لَيْسَ بِذَلِكَ . وَأَبُو حَمْرَةَ مَيِّمُونُ الْأَعْوَرُ يُضَعَّفُ . وَرَوَى بَيَّانٌ وَإِسْمَاعِيلُ بْنُ سَالِمٍ عَنِ الشَّعْبِيِّ هَذَا الْحَدِيثَ قَوْلَهُ وَهَذَا أَصَحُّ .

28. Mbi vlerat e lëmoshës (zekatit)

بَاب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الصَّدَقَةِ

659. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejth b. Sa’di, duke transmetuar nga Seid el-Makburi,⁶²⁶ ai nga Seid b. Jasari, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Askush nuk ka për të dhënë lëmoshë nga pasuria e pastër – halal – ndërsa Allahu edhe nuk pranon përveç nga pasuria – halal,⁶²⁷ e që Mëshiruesi nuk ka për ta pranuar në dorën e djathtë,⁶²⁸ madje ajo qoftë edhe një hurme. Ajo do të rritet dhe do të zhvillohet në dorën e Mëshiruesit, mu ashtu sikur ndokush nga ju, që e rrit një viç ose një deve të vogël, ashtu që ka për t’u bërë më e lartë se kodra.”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aishja, Adijj b. Hatimi, Enesi, Abdullah b. Ebu Evfi, Harith b. Vehbi, Abdurrahman b. Avfi dhe Burejde. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.”⁶²⁹

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي سَعِيدٍ الْمَقْبُرِيِّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ يَسَارٍ، أَنَّهُ سَمِعَ أَبَا هُرَيْرَةَ، يَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَا تَصَدَّقَ أَحَدٌ بِصَدَقَةٍ مِنْ طَيِّبٍ وَلَا يَقْبَلُ اللَّهُ إِلَّا الطَّيِّبَ إِلَّا أَخَذَهَا الرَّحْمَنُ بِيَمِينِهِ وَإِنْ كَانَتْ تَمْرَةً تَرَبُّو فِي كَفِّ الرَّحْمَنِ حَتَّى تَكُونَ أَعْظَمَ مِنَ الْجَبَلِ كَمَا يَرَبِّي أَحَدُكُمْ فَلَوْهُ أَوْ فَصِيلُهُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ وَعَدِيٍّ بْنِ حَاتِمٍ وَأَنْسٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي أَوْفَى وَخَارِثَةَ بْنِ وَهَبٍ وَعَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ وَبُرَيْدَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

660. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili – atë e ka informuar Musa b. Ismaili, atë Sadaka b. Musa, duke transmetuar nga Thabiti – që Enesi, ka thënë: “Dikush e pyeti të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (mbi atë), se cili agjërim është më i vlefshëm pas ramazanit, ai tha: ‘Agjërimi në

⁶²⁴ Këtë hadith, përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar edhe Ibn Maxhe dhe Ed-Darimi në *Sunene*.

⁶²⁵ Mbi të, dijetarët kanë shqiptuar gjykime të caktuara. Ahmed b. Hanbeli konsideron, që është ravi i dobët dhe që hadithet që i transmeton ai, duhet refuzuar. Ed-Darekutni mendon, që ai është ravi i dobët. Buhariu thotë, që nuk është transmetues i fuqishëm. Nesaiu, thotë që është i besueshëm.

⁶²⁶ Sejjid el-Makburi, është i biri i Ebu Sejjid Kejsan Ebu Sa’d el-Medeniut. Ai është transmetues jashtëzakonisht i besueshëm. I takonte gjeneratës së tretë të ravive. Katër vjet para vdekjes, tërësisht e ka humbur kujtesën.

⁶²⁷ Kurtubi, ka thënë: “Allahu i Lartësuar nuk e pranon lëmoshën, e cila ndahet nga pasuria e arritur në mënyrë të pandershme, haram – sepse ajo pasuri, në realitet nuk është pronë e atij, i cili e ka shpërndarë.”

⁶²⁸ Të pranuarit e lëmoshës nga Allahu me dorën e djathtë, është shprehje e kënaqësisë së tij me veprën e bërë dhe shenjë, që ajo me të vërtetë ka për t’u pranuar.

⁶²⁹ Përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar edhe Buhariu dhe Muslimi në *Xhamius-sahih*.

muajin Shaban, për shkak të nderimit të ramazanit.⁶³⁰ ‘E cila lëmoshë është më e vlefshme?’ - Prapë dikush tha. “Lëmosha që ndahet gjatë ramazanit – u përgjigj ai.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib. Sadeka b. Musa, sipas mendimit të dijetarëve të hadithit, nuk është aq ravi i fuqishëm.”⁶³¹

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا مُوسَى بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا صَدَقَةُ بْنُ مُوسَى، عَنْ ثَابِتٍ، عَنْ أَنَسٍ، قَالَ سَأَلَ النَّبِيَّ ﷺ أَيُّ الصَّوْمِ أَفْضَلُ بَعْدَ رَمَضَانَ فَقَالَ " شَعْبَانُ لِتَعْظِيمِ رَمَضَانَ " . قِيلَ فَأَيُّ الصَّدَقَةِ أَفْضَلُ قَالَ " صَدَقَةٌ فِي رَمَضَانَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَصَدَقَةُ بْنُ مُوسَى لَيْسَ عَنْهُمْ بِذَلِكَ الْقَوِيُّ .

661. Na ka treguar Ukbe b. Mukrem el-Basriu – atë e ka informuar Abdullah b. Isa el-Hazari,⁶³² duke transmetuar nga Junus b. Ubejdi, ai nga Hasani⁶³³, ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Me të vërtetë, lëmosha e shuan hidhërimin e Sunduesit dhe (nga njeriu) e largon vdekjen e shpejtë (të papritur).” Tirmidhiu thotë: “Ky hadith në këtë formë, është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا عُقْبَةُ بْنُ مُكْرَمٍ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عِيسَى الْخَزَّازُ الْبَصْرِيُّ، عَنْ يُونُسَ بْنِ عُبَيْدٍ، عَنْ الْحَسَنِ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ الصَّدَقَةَ لَتُطْفِئُ غَضَبَ الرَّبِّ وَتُدْفِعُ مِيتَةَ السُّوءِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

662. Na ka treguar Ebu Kurejb Muhammed b. Ala – atë e ka informuar Vekiu, atë Abbad b. Mensuri, atë Kasim b. Muhammedi, i cili ka dëgjuar nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu pranon bamirësinë (zekatin), dhe Ai atë e pranon me (Dorën) të Djathtën e Tij, për ta rritur (zhvilluar) atë për njërën prej jush, sikur ndonjëri nga ju që do ta rriste një kërriç, derisa kafshata (e ushqimit) të bëhet e madhe sa Uhudi. Libri i Allahut, të Gjithëfuqishmit dhe Sublimit, dëshmon në atë: ‘Ai pranon pendimin nga adhuresit e Tij dhe ua pranon bamirësinë.’ Dhe: ‘Allahu do ta shkatërrojë Riban (kamatën) dhe do ta shtojë bamirësinë.’ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁶³⁴ Ngjashëm me këtë është transmetuar nëpërmjet Aishes, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).⁶³⁵

Shumë dijetarë, mbi këtë hadith dhe transmetimeve të ngjashme me atë (të cilët flasin), mbi veçoritë e Allahut dhe të zbriturit e Allahut të Lartësuar çdo natë mbi qiellin e kësaj toke, kanë thënë: “Mbi këtë, transmetimet janë të vërtetuara dhe mbi to mund të mbështetemi. Rreth kësaj, nuk duhet pasur dyshim, e as nuk duhet pyetur se si (zbret Ai).” Është transmetuar, që Malik b. Enesi, Sufjan b. Ujejne dhe Abdullah b. Mubareku, mbi këtë hadith kanë thënë: “Pranoni ata (ashtu siç janë), pa shtruar pyetje si?” Ky është qëndrimi i dijetarëve dhe Ehli-sunnetit.

⁶³⁰ Iraki, thotë: “Në këtë hadith, në njëfarë mënyre, e kundërshton hadithin, të cilin e ka shënuar Muslimi në *Xhamius-Sahih*, ai nga Ebu Hurejre, e në të cilin qëndron se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në pyetjen se cili agjërime është më i vlefshëm, është përgjigjur: “Më i rëndësishëm pas ramazanit është agjërimi në muajin muharrem.” Pasi që ky hadith është i besueshëm, ndërsa hadithi tematik të cilin e transmeton Enesi është i dobët, Iraki konsideron, se duhet mbajtur këtë hadith dhe duhet vepruar sipas tij. Unë konsideroj, se duhet vepruar edhe sipas njërës dhe sipas hadithit tjetër. Kush është në gjendje, duhet të përpaket për të agjëruar edhe në muajin Sha’ban edhe në muajin Muharrem – sepse, ashtu më së shpeshti ka vepruar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁶³¹ Jahja b. Meini, Nesaiu dhe të tjerët, atë e kanë vlerësuar si ravi të dobët. Ebu Hatemi, thotë: “Hadithet të cilat ai i transmeton, mund të shënohen, edhe pse ai nuk është ravi i fuqishëm.” Hafiz ibn Haxher el-Askalani, thotë, se ai është ravi i sinqertë, megjithëse ka qenë i prirë për gabime.”

⁶³² Abdullah b. Isa e Hazzazi, është ravi i dobët, i takonte gjeneratës së nëntë të transmetuesve të hadithit.

⁶³³ Hasan El-Basriu.

⁶³⁴ Edhe Mundhiri, në veprën *Et-Tergibu vet-Terhibu*, gjithashtu e ka vlerësuar si hadith të besueshëm.

⁶³⁵ Hadithin e Aishes, e ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

Xhehmijët, këto transmetime i mohojnë. Ata thonë, që këtu ka të bëjë me krahasim. Allahu i Lartësuar në shumë vende, në Librin e Vet, e ka përmendur dorën, të dëgjuarit dhe të parit. Xhehmijët këto ajete i kanë komentuar ndryshe nga dijetarët. Ata thonë: “Allahu i Lartësuar nuk e ka krijuar Ademin me Dorën e Vet.” Sipas tyre, këtu dora e ka kuptimin e fuqisë. Is’hak b. Ibrahim thotë: “Kjo do të mund të konsiderohej si krahasim kur do të kishte thënë dora sikurse dora (jonë), ose e ngjashme me dorën (tonë), ose të dëgjuarit sikurse (i yni) ose i ngjashëm me të dëgjuarit tonë. Ndërkaq, nëse thuhet përgjithësisht – ashtu si thotë Allahu i Lartësuar – dora, të dëgjuarit dhe të parit, pa atë sikurse ose ngjashëm me të dëgjuarit tanë ose sikurse ose ngjashëm me të parit (tonë), atëherë ajo nuk ka të bëjë me krahasimin. Allahu i Lartësuar, në Librin e Vet thotë: *“Askush nuk është si Ai! Ai çdo gjë dëgjon dhe çdo gjë sheh* [Esh-Shura: 11].”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، مُحَمَّدُ بْنُ الْعَلَاءِ حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا عُبَادُ بْنُ مُصْطُورٍ، حَدَّثَنَا الْقَاسِمُ بْنُ مُحَمَّدٍ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا هُرَيْرَةَ، يَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ اللَّهَ يَقْبَلُ الصَّدَقَةَ وَيَأْخُذُهَا بِبِمِينِهِ فَيَرْبِيهَا لِأَحَدِكُمْ كَمَا يَرْبِي أَحَدَكُمْ مُهْرُهُ حَتَّى إِنَّ اللُّقْمَةَ لَتَصِيرُ مِثْلُ أُخْدٍ " . وَتَصْدِيقُ ذَلِكَ فِي كِتَابِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ (وَهُوَ الَّذِي يَقْبَلُ التَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِ) وَيَأْخُذُ الصَّدَقَاتِ (بِمَحَقِّ اللَّهِ الرَّبَا وَيَرْبِي الصَّدَقَاتِ) . قَالَ أَبُو عِيسَى: هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَقَدْ رَوَى عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَحْوُ هَذَا. وَقَدْ قَالَ غَيْرُ وَاحِدٍ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي هَذَا الْحَدِيثِ وَمَا يُشَبِّهُ هَذَا مِنَ الرِّوَايَاتِ مِنَ الصِّفَاتِ وَنَزُولِ الرَّبِّ تَبَارَكَ وَتَعَالَى كُلُّ لَيْلَةٍ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا قَالُوا قَدْ تَثَبُّتِ الرِّوَايَاتُ فِي هَذَا وَيُؤْمَنُ بِهَا وَلَا يَتَوَهَّمُ وَلَا يُقَالُ كَيْفَ هَكَذَا رَوَى عَنْ مَالِكٍ وَسُفْيَانَ بْنِ عُيَيْنَةَ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ أَنَّهُمْ قَالُوا فِي هَذِهِ الْأَحَادِيثِ أَمْرُهَا بِلاَ كَيْفٍ. وَهَكَذَا قَوْلُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَهْلِ السُّنَّةِ وَالْجَمَاعَةِ. وَأَمَّا الْجَهْمِيَّةُ فَانْكَرَتْ هَذِهِ الرِّوَايَاتِ وَقَالُوا هَذَا تَشْبِيهٌ. وَقَدْ ذَكَرَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ فِي غَيْرِ مَوْضِعٍ مِنْ كِتَابِهِ الْيَدَ وَالسَّمْعَ وَالْبَصَرَ فَقَاوَلَتِ الْجَهْمِيَّةُ هَذِهِ الْآيَاتِ فَفَسَّرُوها عَلَى غَيْرِ مَا فَسَّرَ أَهْلُ الْعِلْمِ وَقَالُوا إِنَّ اللَّهَ لَمْ يَخْلُقْ آدَمَ بِيَدِهِ. وَقَالُوا إِنَّ مَعْنَى الْيَدِ هَاهُنَا الْقُوَّةُ. وَقَالَ إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ إِنَّمَا يَكُونُ التَّشْبِيهُ إِذَا قَالَ يَدٌ كَيْدٌ أَوْ مِثْلُ يَدٍ أَوْ سَمْعٌ كَسَمْعٍ أَوْ مِثْلُ سَمْعٍ. فَإِذَا قَالَ سَمْعٌ كَسَمْعٍ أَوْ مِثْلُ سَمْعٍ فَهَذَا التَّشْبِيهُ وَأَمَّا إِذَا قَالَ كَمَا قَالَ اللَّهُ تَعَالَى يَدٌ وَسَمْعٌ وَبَصَرٌ وَلَا يَقُولُ كَيْفَ وَلَا يَقُولُ مِثْلُ سَمْعٍ وَلَا كَسَمْعٍ فَهَذَا لَا يَكُونُ تَشْبِيْهًا وَهُوَ كَمَا قَالَ اللَّهُ تَعَالَى فِي كِتَابِهِ: (لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ)

29. Mbi të drejtat e lypsarit

باب مَا جَاءَ فِي حَقِّ السَّائِلِ

663. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Seid b. Ebu Hindi,⁶³⁶ ai nga Abdurrahman b. Buxhejdi – që gjyshja e Abdurrahman b. Buxhejdes,⁶³⁷ Ummu Buxhejd, njëra nga ato, që ia kanë dhënë besën të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (me një rast), ka thënë: “Nganjëherë vjen lypësi te dyert, ndërsa unë nuk kam çfarë t’i jap.” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “Nëse nuk ke asgjë për t’i dhënë tjetër, përveç rrobe të vjetruar – vija bile atë në dorë.”⁶³⁸ Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Husejn b. Aliu, Ebu Hurejre dhe Ebu Uname. Hadithi i Ummu Buxhejdes është hasen-sahih.”⁶³⁹

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي سَعِيدٍ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ بُجْدٍ، عَنْ جَدِّهِ أُمِّ بُجْدٍ، - وَكَانَتْ مِمَّنْ بَايَعَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ - أَنَّهَا قَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّ الْمُسْكِينَ لَيَقُومُ عَلَى بَابِي فَمَا أَجِدُ لَهُ شَيْئًا أُعْطِيهِ إِيَّاهُ . فَقَالَ لَهَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ لَمْ تَجِدِي شَيْئًا تُعْطِيهِ إِيَّاهُ إِلَّا طَلْفًا مُحَرَّفًا فَادْفَعِيهِ إِلَيْهِ فِي يَدِهِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَحُسَيْنِ بْنِ عَلِيٍّ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَأَبِي أُمَامَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أُمِّ بُجْدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁶³⁶ Sejid b. Ebu Hind el-Fezari, është transmetues i besueshëm. I takonte gjeneratës së tretë të ravive të hadithit.

⁶³⁷ Ummu Buxhejde, gjyshja e Abdurrahmanit, quhej Hava. Ajo ka qenë as’habe.

⁶³⁸ Ebu Davudi në *Sunen*, shënon nga Husejm b. Aliu, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Lypsarit duhet t’i jepet, madje nëse vjen edhe mbi kalë.” Pasi që sot, te ne dhe në botë, të lypurit është bërë një formë e profesionit, këtë transmetim duhet kuptuar në frymën e hadithit tematik. Kjo domethënë, se obligimi i dhënies lypësit, ka të bëjë vetëm me ata lypsa, të cilët na vijnë tek dera, e jo me secilin që e shtrin dorën, sepse vetëm skamja mund ta detyrojë dikë për t’i ardhur ndokujt te dera.

⁶³⁹ E ka shënuar edhe Ahmed b. Hanbeli, në *Musned* dhe Ebu Davudi në *Sunen*.

30. Mbi dhënien, atyre, zemrat e të cilëve dëshirojnë për t'i përvetësuar

باب مَا جَاءَ فِي إِعْطَاءِ الْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ

664. Na ka treguar Hasan b. Ali el-Halal – atë e ka informuar Jahja b. Ademi,⁶⁴⁰ duke transmetuar nga Ibn Mubareku, ai nga Junusi, ai nga Zuhriu, ai nga Seid b. Musejjebi – që Safvan b. Umejje,⁶⁴¹ ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Betejnë e Hunejnit⁶⁴² më dha diç (nga pasuria), ndërsa ishte krijesa më e urryer për mua. Ai vazhdoi të më jepte, ashtu që (tani është bërë) krijesa më e dashur për mua.”⁶⁴³

Ebu Isai, thotë: “Këtë, ose ngjashëm me të, më ka treguar Hasan b. Aliu. Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Seidi. Hadithin e Safvanit, e kanë transmetuar Ma’meri dhe të tjerët nga Zuhriu, ai nga Seid b. Musejjebi. Në të qëndron që, Safvan b. Umejje, ka thënë: ‘I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më ka dhënë diçka (nga pasuria).’ Sikur hadithi i (Mu’amerit dhe të tjerëve) nga Seid b. Musejjebi të ketë qenë (...) që Safvan b. Umejje’ është më i besueshëm nga hadithi të cilin e transmeton Junusi nga Mu’ameri.”

Dijetarët, janë ndarë në pikëpamje të të dhuruarit atyre, zemrat e të cilëve dëshirohet për t'i përvetësuar (për islam). Shumica mendojnë, që sot, të atillëve nuk duhet dhënë. Ato pohojnë që vetëm në kohën e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë një kategori njerëzish, zemrat e të cilëve duhej të përvetësoheshin, gjithnjë, derisa nuk e pranojnë Islamin. Ata mendojnë, që sot, në atë kuptim, nga zekati, nuk duhet t'i jepet asnjërit. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, dijetarëve të Kufës dhe i të tjerëve. Qëndrim të tillë kanë edhe Is’haku edhe Ahmedi. Disa thonë, sikur sot të kishte pasur të ngjashëm me ata që kanë qenë gjatë kohës së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe imami vendosë që t'i bëjë ta pranojnë islamin dhe u jep nga zekati, kjo do të ishte e lejuar. Ky është qëndrimi i Shafiut.

حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ الْخَلَّالُ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ آدَمَ، عَنْ ابْنِ الْمُبَارَكِ، عَنْ يُونُسَ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ صَفْوَانَ بْنِ أُمَيَّةَ، قَالَ أَعْطَانِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَوْمَ حُنَيْنٍ وَإِنَّهُ لَأُبْعِضُ الْخَلْقَ إِلَيَّ فَمَا زَالَ يُعْطِينِي حَتَّى إِنَّهُ لَأَحَبُّ الْخَلْقِ إِلَيَّ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَلِيٍّ بِهَذَا أَوْ شَبَّهَ فِي الْمَذَاكِرَةِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدَّثَنَا صَفْوَانُ بْنُ رَوَاهُ مَعْمَرٌ وَغَيْرُهُ عَنْ الزُّهْرِيِّ عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ أَنَّ صَفْوَانَ بْنَ أُمَيَّةَ قَالَ أَعْطَانِي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ . وَكَانَ هَذَا الْحَدِيثُ أَصَحَّ وَأَشْبَهَ إِنَّمَا هُوَ سَعِيدُ بْنُ الْمُسَيَّبِ أَنَّ صَفْوَانَ . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي إِعْطَاءِ الْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ فَرَأَى أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ لَا يُعْطُوا . وَقَالُوا إِنَّمَا كَانُوا قَوْمًا عَلَى عَهْدِ النَّبِيِّ ﷺ كَانُوا يَتَأَلَّفُهُمْ عَلَى الْإِسْلَامِ حَتَّى أَسْلَمُوا . وَلَمْ يَزُوا أَنْ يُعْطُوا الْيَوْمَ مِنَ الزَّكَاةِ عَلَى مِثْلِ هَذَا الْمَعْنَى وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ وَغَيْرِهِمْ وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ مَنْ كَانَ الْيَوْمَ عَلَى مِثْلِ حَالِ هَؤُلَاءِ وَرَأَى الْإِمَامَ أَنْ يَتَأَلَّفَهُمْ عَلَى الْإِسْلَامِ فَأَعْطَاهُمْ جَازَ ذَلِكَ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ .

⁶⁴⁰ Jahja b. Adem b. Sulejman el-Kufi Ebu Zekerija, është transmetues i besueshëm dhe hafiz i hadithit. I takonte gjeneratës së nëntë të ravive. Ka vdekur në vitin 203 sipas hixhretit.

⁶⁴¹ Saffan b. Umejje b. Halef b. Vehb el-Kureshi el-Meki, është as’hab. Është njëri nga ata, zemrën e të cilit e kanë përfutur në islam. Ka vdekur gjatë kohës së vrasjes së Uthmanit.

⁶⁴² Hunejn, është vendi ndërmjet Mekës dhe Taifit, në Arabinë Saudite. Aty është zhvilluar Beteja e njohur.

⁶⁴³ Dijetarët janë ndarë, mbi atë, se cilët janë, ata zemrat, e të cilëve duhet përfutur për islam. A ka të bëjë aty me muslimanët, të cilët e kanë pranuar islamin, por janë me iman të dobët dhe duke u dhënë nga zekati, të provohet për t'i përfutur zemrat e tyre, duke i forcuar në të besuar, apo jobesimtarët, zemrat e të cilëve ende duhet përfutur. Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, se nga shumica e haditheve mbi këtë temë, mund të konkludohet, se këtu është fjala mbi jobesimtarët, zemrat e të cilëve – ende duhet përfutur për islam. Atë e vërteton qartë edhe hadithi tematik.

31. Mbi atë i cili e trashëgon atë që është e ndarë

باب مَا جَاءَ فِي الْمُتَصَدِّقِ يَرِثُ صَدَقَتَهُ

665. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ali b. Mushiri, ai ka transmetuar nga Abdullah b. Atai, ai nga Abdullah b. Burejde, që babai i Abdullah b. Burejdes, ka thënë: “Isha duke ndenjtur tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur erdhi një grua dhe i tha: ‘O i Dërguar i Allahut, unë nënës time në emër të lëmoshës ia kam dhënë një robëreshë, ajo (tani) ka vdekur.’ ‘Ti (me atë) e ke merituar shpërblimin,⁶⁴⁴ ndërsa robëresha ka për të t’u kthyer me trashëgimi.’ O i Dërguar i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – përsëri tha gruaja – ajo ka mbetur borxh një muaj agjërim,⁶⁴⁵ prandaj, a mundem unë të agjëroj për të?’ ‘Agjëroje atë për të’ – tha i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). ‘O i Dërguar i Allahut, ajo as haxh kurrë nuk ka bërë – prandaj a mund të shkoj unë për të?’ ‘Mundesh, kryej haxhin për të’ - tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)”. Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih,⁶⁴⁶ nëpërmjet Burejdes është i njohur, vetëm me këtë rrugë. Abdullah b. Atai, sipas mendimit të dijetarëve të hadithit është ravi i besueshëm. Sipas këtij hadithi veprojnë shumica e dijetarëve. Ata konsiderojnë që, nëse ndokush ndanë diç si lëmoshë dhe ajo i kthehet me trashëgimi – ajo i bëhet e lejuar. Disa, nga dijetarët thonë: “Lëmosha është diç që jepet ekskluzivisht në emër të Allahut. Prandaj, nëse ndokujt diç që e ka ndarë i kthehet me trashëgimi, ai është i obliguar që përsëri ta ndajë atë në qëllim bamirësie.” Sufjan eth-Thevriu dhe Zuhejr b. Muaviu, këtë hadith, e kanë transmetuar nga Abdullah b. Atai.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ مُسْهِرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَطَاءٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بُرَيْدَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ كُنْتُ جَالِسًا عِنْدَ النَّبِيِّ ﷺ إِذْ أَتَتْهُ امْرَأَةٌ فَقَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّي كُنْتُ تَصَدَّقْتُ عَلَى أُمِّي بِجَارِيَةٍ وَإِنِّهَا مَاتَتْ . قَالَ " وَجِبَ أَجْرُكِ وَرَدُّهَا عَلَيْكَ الْمِيرَاثُ " . قَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّهَا كَانَ عَلَيْهَا صَوْمٌ شَهْرٍ أَفَأَصُومُ عَنْهَا قَالَ " صُومِي عَنْهَا " . قَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّهَا لَمْ تُحَجَّ قَطُّ أَفَأَحُجُّ عَنْهَا قَالَ " نَعَمْ حُجِّي عَنْهَا " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَلَا يُعْرَفُ هَذَا مِنْ حَدِيثِ بُرَيْدَةَ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَطَاءٍ ثِقَةٌ عِنْدَ أَهْلِ الْحَدِيثِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ الرَّجُلَ إِذَا تَصَدَّقَ بِصَدَقَةٍ ثُمَّ وَرَّثَهَا حَلَّتْ لَهُ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِنَّمَا الصَّدَقَةُ شَيْءٌ جَعَلَهَا اللَّهُ قِادًا وَرَّثَهَا فَيَجِبُ أَنْ يَصْرِفَهَا فِي مِثْلِهِ . وَرَوَى سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَزُهَيْرُ بْنُ مُعَاوِيَةَ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَطَاءٍ .

32. Kthimi i sadakasë është i papëlqyer

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الْعَوْدِ فِي الصَّدَقَةِ

666. Na ka treguar Harun b. Is’hak el-Hemdani – atë e ka informuar Abdurrezaku, duke transmetuar nga Ma’meri, ai nga Zuhriu, ai nga Salimi, ai nga Ibn Umeri – që Umeri, në emër të Allahut, e ka dhënë kalin për qëllime bamirësie. Pas asaj, e ka parë që ishte duke u shitur dhe kishte dëshiruar ta blente (përsëri), ndërsa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka thënë: ‘Mos iu kthe lëmoshës që e ke dhënë!’⁶⁴⁷ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.⁶⁴⁸ Sipas tij kanë vepruar shumica e dijetarëve.”⁶⁴⁹

⁶⁴⁴ E ke merituar shpërblimin për shkak të asaj që ke shpreh respekt ndaj nënës dhe ke mbajtur lidhjet farefisnore.

⁶⁴⁵ Në bazë të këtij hadithi dhe haditheve të ngjashëm me të, Ahmed b. Hanbeli konsideron, që nëse personi vdes dhe pas vete i lë ditët e ramazanit të premtuar, ose agjërimin kefaret – ato ditët të mosagjërura mund t’i kompensojë ndokush, prej familjes së tij, ose nga miqtë, nëse dëshiron të agjërojë për të. Ebu Hanife, Shafiu dhe Maliku, konsiderojnë, që nuk mund të agjërohet për të, por çdo ditë të agjërimit të humbur mund të ndahet fidja në vlerë të një sa’i elb ose gjysmë sa’i grurë.

⁶⁴⁶ E kanë shënuar Muslimi, në *Xhamius-Sahih*.

⁶⁴⁷ Në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, qëndron: “Mos e kthe sadakën të cilën e ke dhënë, edhe sikur ta kishte dhënë dikush një dërhem! Ai i cili e kthen prapa sadakën është i njëjtë sikur kur e kthen ushqimin të cilin e ka vjellë.”

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، عَنْ مَعْمَرٍ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَالِمٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنْ عُمَرَ، أَنَّهُ حَمَلَ عَلَى فَرَسٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ثُمَّ رَأَاهَا تُبَاغُ فَأَرَادَ أَنْ يَشْتَرِيَهَا فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " لَا تَعُدْ فِي صَدَقَتِكَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ .

33. Mbi ndarjen e sadakasë për të vdekurin

باب مَا جَاءَ فِي الصَّدَقَةِ عَنِ الْمَيِّتِ

667. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Revh b. Ubade, atë Zekerija b. Is’haku, atij i ka treguar Amr b. Dinari, duke transmetuar nga Ikrimë, e ai nga Ibn Abbasi – që një njeri kishte thënë: “O i Dërguar i Allahut, nëna ime ka vdekur – a ka për t’i shërbyer, nëse ndajë lëmoshë për të?” “Po, ka për t’i shërbyer.” – tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ai në atë tha: “Unë kam plantash të hurmeve, ty të marr si dëshmitar që atë ia jap lëmoshë (vakëfit) për nënën time.”⁶⁵⁰ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen,⁶⁵¹ në pajtim me të është edhe qëndrimi i dijetarëve. Ata thonë, që asgjë nuk arrin tek i vdekuri, përveç lëmoshës dhe duasë. Disa, këtë hadith, e kanë transmetuar nëpërmjet Amir b. Dinarit, ai nga Ikrimë, drejtpërdrejt nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si mursel. Fjalët e tij ‘Unë kam plantash të pallmave.’ – e kanë kuptimin: ‘Unë kam pemishte.’”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا رَوْحُ بْنُ عُبَادَةَ، حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا بْنُ إِسْحَاقَ، حَدَّثَنِي عُمَرُو بْنُ دِينَارٍ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ رَجُلًا، قَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّ أُمِّي تُؤَفِّقُنِي أَنْ تُصَدِّقْتُ عَنْهَا قَالَ " نَعَمْ " . قَالَ فَإِنَّ لِي مَخْرَفًا فَأُشْهِدُكَ أَنِّي قَدْ تَصَدَّقْتُ بِهِ عَنْهَا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَبِهِ يَقُولُ أَهْلُ الْعِلْمِ . يَقُولُونَ لَيْسَ شَيْءٌ يَصِلُ إِلَى الْمَيِّتِ إِلَّا الصَّدَقَةُ وَالِدُعَاءِ . وَقَدْ رَوَى بَعْضُهُمْ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ عُمَرُو بْنِ دِينَارٍ عَنْ عِكْرَمَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . قَالَ وَمَعْنَى قَوْلِهِ إِنَّ لِي مَخْرَفًا . يَغْنِي بُسْتَانًا .

34. Ndarja e lëmoshës nga gruaja nga shtëpia e bashkëshortit

باب مَا جَاءَ فِي نَفَقَةِ الْمَرْأَةِ مِنْ بَيْتِ زَوْجِهَا

668. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ismail b. Ajjashi, atë Shurahbil b. Muslim el-Havlani – që Ebu Umam el-Bahili, ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur gjatë ligjërimit në Haxhin Lamtumirës, ka thënë: “Gruaja nuk ka për të

⁶⁴⁸ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁶⁴⁹ Shumica e dijetarëve mendojnë, që blerja e asaj që është ndarë në emër të sadakasë, ose e kanë dhuruar në bamirësi, është mekruh-tenzihen. Disa dijetarë, atë bile, e konsiderojnë edhe haram.

⁶⁵⁰ Dijetarët, janë unik në mendimin, që lëmosha që ndahet në emër të të vdekurit dhe duaja me të cilën nga Allahu i Lartësuar, kërkohet lëmosha dhe mëshira, i shërbejnë të vdekurit. Ata, kanë divergjenca vetëm në pikëpamje të formës trupore të ibadetit, siç janë: namazi, agjërimi dhe këndimi i Kur’anit, se a i shërben ajo të vdekurit, nëse bëhen në emër të tij apo jo. Ebu Hanife, Ahmed dhe shumica e dijetarëve, konsiderojnë, se i shërbejnë. Shafiu dhe Maliku pohojnë, që nuk i shërbejnë. Ata mendimin e vet e mbështesin mbi ajetin “*Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar.*” [En-Nexhm: 39]. Pasuesit e mendimit të parë konsiderojnë që ajeti i cekur është deroguar me ajetin: “*E ata që vetë besuan, e edhe pasardhësit e tyre ishin me besim, Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve). Secili njeri është peng i asaj që ka punuar.*” [Et-Tur: 21]. Ata konsiderojnë, që nën nocionin njeri, në ajetin e përmendur, mendohet mbi kafirin, çka domethënë se e kafirit është ajo çfarë vet e ka bërë, derisa besimtari ka për të pasur dobi edhe nga ajo çfarë vet e ka bërë edhe nga ajo çfarë në emër të tij e bëjnë të tjerët.

⁶⁵¹ Këtë hadith, Tirmidhiu e konsideron hasen. Megjithatë, ai është sahih, sepse edhe Buhariu e shënon në *Sahih*. Përveç tij, atë e shënojnë edhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sumene*.

dhënë asgjë nga shtëpia e bashkëshortit të vet, përveç me lejen e tij.” Dikush, në atë tha: “Madje as ushqimin, o i Dërguar i Allahut?!” Ndërsa ai tha: “Ai (ushqim) është pasuria jonë më e vlefshme.”⁶⁵²

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Sa’d b. Ebu Vekkasi, Esmā, vajza e Ebu Bekrit, nga Ebu Hurejre, Abdullah b Amri dhe Aishja. Hadithi i Ebu Umames është hasen.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ عَيَّاشٍ، حَدَّثَنَا شُرَحْبِيلُ بْنُ مُسْلِمٍ الْخَوْلَانِيُّ، عَنْ أَبِي أُمَامَةَ الْبَاهِلِيِّ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ فِي خُطْبَتِهِ عَامَ حَجَّةِ الْوَدَاعِ يَقُولُ " لَا تَنْفِقُ امْرَأَةً شَيْئًا مِنْ بَيْتِ زَوْجِهَا إِلَّا بِإِذْنِ زَوْجِهَا " . قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا الطَّعَامَ قَالَ " ذَلِكَ أَفْضَلُ أَمْوَالِنَا " . وَفِي الْبَابِ عَنْ سَعْدِ بْنِ أَبِي وَقَّاصٍ وَأَسْمَاءَ بِنْتِ أَبِي بَكْرٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ وَعَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي أُمَامَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ .

669. Na ka treguar Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Muhammed b. Xha’feri, atë Shu’be, duke transmetuar nga Amr b. Murre, ai nga Ebu Vaili, ai nga Aishja – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur gruaja ndanë lëmoshë nga shtëpia e bashkëshortit të vet, ajo për atë ka shpërblim, bashkëshorti i saj ka shpërblim të njëjtë, si furnizues. Asnjëri me atë, nuk e zvogëlon shpërblimin e shokut të vet. Bashkëshortit i takon shpërblimi që ka fituar, ndërsa gruas për atë që ka ndarë.”⁶⁵³ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.”⁶⁵⁴

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ عَمْرِو بْنِ مَرْة، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا وَائِلٍ، يُحَدِّثُ عَنْ عَائِشَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " إِذَا تَصَدَّقَتِ الْمَرْأَةُ مِنْ بَيْتِ زَوْجِهَا كَانَ لَهَا بِهِ أَجْرٌ وَلِلزَّوْجِ مِثْلُ ذَلِكَ وَلِلْخَازَنِ مِثْلُ ذَلِكَ وَلَا يَنْقُصُ كُلُّ وَاحِدٍ مِنْهُمْ مِنْ أَجْرِ صَاحِبِهِ شَيْئًا لَهُ بِمَا كَسَبَ وَلَهَا بِمَا أَنْفَقَتْ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ .

670. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Muemili, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Mensuri, ai nga Ebu Vaili, ai nga Mesruku, ndërsa ai nga Aishja – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur gruaja ndanë vullnetarisht dhe pa ekzagjerime diç nga shtëpia e bashkëshortit, do ta ketë shpërblimin sikurse ai. Asaj i takon e mira të cilën e ka bërë nijet, ndërsa furnizuesit (bashkëshortit) i takon shpërblimi i njëjtë.”⁶⁵⁵

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih, ai është shumë më i besueshëm sesa hadithi i Amr b. Murres, nga Ebu Vaili. Amr b. Murre, në senedin e hadithit të vet, nuk e përmend Mesrukun.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيَالَانَ، حَدَّثَنَا الْمُؤَمَّلُ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ مُثُورٍ، عَنْ أَبِي وَائِلٍ، عَنْ مَسْرُوقٍ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ " إِذَا أَعْطَتِ الْمَرْأَةُ مِنْ بَيْتِ زَوْجِهَا بِطِيبِ نَفْسٍ غَيْرِ مُفْسِدَةٍ كَانَ لَهَا مِثْلُ أَجْرِ مَا نَوَتْ حَسَنًا وَلِلْخَازَنِ مِثْلُ ذَلِكَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهَذَا أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ عَمْرِو بْنِ مَرْة عَنْ أَبِي وَائِلٍ وَعَمْرِو بْنِ مَرْة لَا يَذْكُرُ فِي حَدِيثِهِ عَنْ مَسْرُوقٍ .

⁶⁵² Shumica e dijetarëve, pohojnë, që gruaja nuk e ka të lejuar të ndajë nga shtëpia dhe pasuria e burrit të vet, pa lejen e tij. Analogjikisht me të, as nëpunësit dhe as punëtorët e punësuar në dyqane apo firma, nuk lejohen të ndajnë atë kapital pa lejen e pronarit.

⁶⁵³ Në këtë dhe në hadithin e radhës, flitet mbi atë, që gruaja e cila me qëllim të mirë ndan diç nga shtëpia e burrit të vet, e ka shpërblimin e njëjtë sikur burri i saj, që e ka fituar atë pasuri. Kjo ka të bëjë me gratë, të cilave bashkëshortët ua kanë lejuar, që në mungesë të tyre munden, në rast se te dyert ju vjen lypësi, ose i varfëri, që t’u ndajnë diç ose nëse ju vjen mysafiri, ta shërbejnë dhe ta gostitin. Në Hixhaz, Mekke dhe Medine, gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), njerëzit bashkëshorteve të veta u jepnin leje të tilla.

⁶⁵⁴ Tirmidhiu, këtë hadith e konsideron hasen. Megjithatë, ai është sahih, sepse atë e shënon edhe Buhariu me Muslimin në *Sahihë*.

⁶⁵⁵ Përveç Tirmidhiut, atë e shënojnë edhe Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

35. Mbi sadakatul-fitrin⁶⁵⁶

باب مَا جَاءَ فِي صَدَقَةِ الْفِطْرِ

671. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Zejd b. Esleme, ai nga Ijad b. Abdullahu – që Ebu Seid el-Hudriu ka thënë: “Ne, në kohën e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në emër të zekatul-fitrit e jepnim një sa’a ushqim,⁶⁵⁷ ose një sa’a elb, ose një sa’a hurme, ose një sa’a rrush të terur, ose një sa’a djath të tharë. Gjithnjë, jepnim ashtu, derisa nuk erdhi Muaviu në Medine. Ai, atëherë, iu drejtuar njerëzve dhe në mes tjerash tha: “Unë mendoj, që dy sa’a të grurit të Shamit i përgjigjen një sa’ai me hurme.” Dhe njerëzit e pranuan atë. Ebu Seidi, thotë: “Unë edhe më tej (sadakatul fitrin) jam duke e dhënë siç jepja më herët (gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)).”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.⁶⁵⁸ Sipas tij, kanë vepruar disa dijetarë. Ata konsiderojnë që nga çdo produkt duhet dhënë nga një sa’a. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut. Disa dijetarë nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, konsiderojnë që nga çdo produkt jepet një sa’a, përveç nga gruri – nga ai mjafton dhënia e gjysmë sa’ai. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut, por edhe dijetarët Kufjan konsiderojnë që nga gruri duhet dhënë gjysmë sa’ai.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ عِيَّاضِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ كُنَّا نُخْرِجُ زَكَاةَ الْفِطْرِ إِذْ كَانَ فِيْنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ - صَاعًا مِنْ طَعَامٍ أَوْ صَاعًا مِنْ شَعِيرٍ أَوْ صَاعًا مِنْ تَمْرٍ أَوْ صَاعًا مِنْ زَبِيبٍ أَوْ صَاعًا مِنْ أَقِطٍ فَلَمْ نَزَلْ نُخْرِجْهُ حَتَّى قَدِمَ مُعَاوِيَةُ الْمَدِينَةَ فَتَكَلَّمَ فَمَا كَانَ فِيْمَا كَلَّمَ بِهِ النَّاسَ إِنِّي لَأَرَى مُدَّتَيْنِ مِنْ سَمَرَاءِ السَّامِ تَغِلُّ صَاعًا مِنْ تَمْرٍ . قَالَ فَأَخَذَ النَّاسُ بِذَلِكَ . قَالَ أَبُو سَعِيدٍ فَلَا أَرَأَى أَنْ أُخْرِجْهُ كَمَا كُنْتُ أُخْرِجْهُ . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ يَرَوْنَ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ صَاعًا . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ صَاعٌ إِلَّا مِنَ الْبُرِّ فَإِنَّهُ يُجْزَى بِصِنْفٍ صَاعٍ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَأَهْلِ الْكُوفَةِ يَرَوْنَ بِصِنْفٍ صَاعٌ مِنْ بُرٍّ .

672. Na ka treguar Ukbe b. Muhrim el-Basri⁶⁵⁹ - atë e ka informuar Salim b. Nuhi, ai ka transmetuar nga Ibn Xhurejxhi, ai nga Amr b. Shuajbi, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga gjyshi i tij – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka dërguar lajmëtarin, në të gjitha anët e Mekës, për të thirrur: “Dijeni, që sadakatul fitri është obligim për të gjithë muslimanët – meshkuj apo femra, të lirin apo robin, për të riun dhe të vjetrin – dhe atë: nga gruri dy mudd, ndërsa nga ushqimet e tjera një sa’a!” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është garib-hasen.”

حَدَّثَنَا عُقْبَةُ بْنُ مُكْرَمٍ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا سَالِمُ بْنُ نُوحٍ، عَنْ ابْنِ جُرَيْجٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ شُعَيْبٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَدِّهِ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ بَعَثَ مُنَادِيًا فِي فَجَاجِ مَكَّةَ " أَلَا إِنَّ صَدَقَةَ الْفِطْرِ وَاجِبَةٌ عَلَى كُلِّ مُسْلِمٍ ذَكَرَ أَوْ أُنْثَى حُرٍّ أَوْ عَبْدٍ صَغِيرٍ أَوْ كَبِيرٍ مُدَّانٍ مِنْ قَمْحٍ أَوْ سِوَاهُ صَاعٌ مِنْ طَعَامٍ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

673. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, duke transmetuar nga Ejjubu, ai nga Nafiu – që Ibn Umeri, ka thënë: “I Dërguari i Allahut, e ka urdhëruar sadakatul fitrin çdo mashkulli dhe çdo femrë – të lirin dhe robin – dhe atë: një sa’a hurme ose një sa’a elb, atë njerëzit e kanë barazuar me gjysmë sa’a grurë.”

⁶⁵⁶ Sadakatul-fitri, zekatul-fitir, zekatu-ramadan apo zekatus-savm – si quhet – është urdhëruar gjatë ramazanit, dy ditë para Bajramit, në vitin e dytë sipas hixhretit. Është urdhëruar si sadaka apo zekat për agjërim. Disa thonë, se është urdhëruar si sadaka apo zekat për anëtarët e shtëpisë, para fundit të ramazanit për çdo vit. Janë të obliguar ta japin edhe të pasurit edhe të varfrit, për të gjithë në familje, edhe të moshës madhore edhe për të miturit, edhe meshkuj edhe femra, edhe për të sëmurët edhe për të shëndoshët, edhe për të lirët edhe për robërit.

⁶⁵⁷ El-Harbi, konsideron, që këtu nën kuptimin ushqimi, mendohet në grurë.

⁶⁵⁸ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

⁶⁵⁹ Ukbe b. Mukrim Ebu Abdulmelik el-Basri është hafiz i hadithit. Ebu Davudi thotë, që ai është ravi i besueshëm.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi, Ibn Abbasi, gjyshi i Harith b. Abdurahman b. Zubabit, Thaleb b. Ebu Suajri dhe Abdullah b. Amrit.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ أَيُّوبَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، قَالَ فَرَضَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ صَدَقَةَ الْفِطْرِ عَلَى الذَّكَرِ وَالْأُنثَى وَالْخُرِّ وَالْمَمْلُوكِ صَاعًا مِنْ تَمْرٍ أَوْ صَاعًا مِنْ شَعِيرٍ . قَالَ فَقَدَلِ النَّاسُ إِلَى نَصْفِ صَاعٍ مِنْ بُرٍّ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَجَدَّ الْحَارِثِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي ذُبَابٍ وَتَعْلَبَةَ بْنِ أَبِي صُعَيْرٍ وَعَبْدَ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو .

674. Na ka treguar Is'hak b. Musa el-Ensari – atë e ka informuar Ma'ni, atë Maliku, ai ka transmetuar nga Nafiu – që Abdullah b. Umeri, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka urdhëruar sadakatul fitrin pranë ramazanit – dhe atë: një sa'a hurme ose një sa'a elb, për çdo fëmijë musliman⁶⁶⁰, të lirin ose robin, mashkullin ose femrën.”

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ibn Umerit është hasen-sahih. E ka transmetuar Maliku nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e Ejubit, duke e shtuar - *musliman*. Por, e kanë transmetuar edhe shumë të tjerë nga Nafiu dhe në te nuk kanë përmendur - *musliman*. Mbi këtë janë ndarë dijetarët.”

Disa, thonë: “Në rast se ndokush i ka robërit jo musliman, nuk është i obliguar, që për ta të jep sadakatul fitr.” Kështu mendojnë: Maliku, Shafi'u dhe Ahmed. Disa nga dijetarët, thonë: “Ka për të dhënë edhe për ata sadakatul fitrin, pa e pasur parasysh që nuk janë muslimanë.” Ky është mendimi i Eth-Thevriut, Ibn Mubarekut dhe i Is'hakut.

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا مَعْنٌ، حَدَّثَنَا مَالِكٌ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عُمَرَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ فَرَضَ زَكَاةَ الْفِطْرِ مِنْ رَمَضَانَ صَاعًا مِنْ تَمْرٍ أَوْ صَاعًا مِنْ شَعِيرٍ عَلَى كُلِّ حُرٍّ أَوْ عَبْدٍ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَى مِنَ الْمُسْلِمِينَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَرَوَى مَالِكٌ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَ حَدِيثِ أَيُّوبَ وَرَدَ فِيهِ مِنَ الْمُسْلِمِينَ . وَرَوَاهُ غَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ نَافِعٍ وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ مِنَ الْمُسْلِمِينَ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي هَذَا فَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا كَانَ لِلرَّجُلِ عَبْدٌ غَيْرُ مُسْلِمٍ لَمْ يُؤَدِّ عَنْهُمْ صَدَقَةَ الْفِطْرِ . وَهُوَ قَوْلُ مَالِكٍ وَالشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ يُؤَدِّي عَنْهُمْ وَإِنْ كَانُوا غَيْرَ مُسْلِمِينَ . وَهُوَ قَوْلُ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَإِسْحَاقَ .

36. Mbi dhënien e sadakatul fitrit para namazit të bajramit

باب مَا جَاءَ فِي تَقْدِيمِهَا قَبْلَ الصَّلَاةِ

675. Na ka treguar Muslim b. Amr b. Muslim Ebu Amr el-Hadhdha el-Medini – atë e ka informuar Abdullah b. Nafiu, ai ka transmetuar nga Ibn Ebu Zinadi,⁶⁶¹ ai nga Musa b. Ukbe, ai nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), urdhëronte që zekatul fitri të jepet, para shkuarjes në namazin e bajramit.⁶⁶²

⁶⁶⁰ Shafi'u dhe shumica e dijetarëve islamë, pohojnë, që sadakatul-fitri jepet vetëm për fëmijë muslimanë. Nëse dikush ka robër jomysliman, apo grua jomyslimane, ose, babai i tij është jomysliman, apo nëna – nuk është i obliguar që për ta të japë sadakatul-fitri.

⁶⁶¹ Ibn Ebu Zinad, është emri i Abdurrahman el-Medenit. Ka qenë i mbrojturi i kurejshitëve. Është i vlefshëm si ravi i sinkertë i fikhut. Mbamendja i është rënduar, pasi që është shpërngulur në Bagdad. I ka takuar gjeneratës së shtatë të ravive.

⁶⁶² Sadakatul-fitri, zakonisht jepet para Bajramit. Maliku, në *Muvetta*, shënon nga Nafiu, që Ibn Umeri, zakonisht sadakatul-fitrin e jepte dy-tri ditë para Bajramit. Hadithet tematike, tregojnë që sadakatul-fitri duhet të jepet para faljes së namazit të bajramit. Nëse atë dikush e bën pas faljes së namazit të bajramit, i llogaritet si sadakë e zakonshme.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib sahih.⁶⁶³ Dijetarët, e konsiderojnë mustehab, që zekatul fitri, të ndahet para shkuarjes në xhami për ta falur namazin e bajramit.”

حَدَّثَنَا مُسْلِمُ بْنُ عُمَرَ بْنِ مُسْلِمٍ أَبُو عَمْرٍو الْحَدَّاءُ الْمَدَنِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ نَافِعٍ الصَّائِغُ، عَنْ ابْنِ أَبِي الزِّنَادِ، عَنْ مُوسَى بْنِ عُقْبَةَ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يَأْمُرُ بِإِخْرَاجِ الزَّكَاةِ قَبْلَ الْغَدُوِّ لِلصَّلَاةِ يَوْمَ الْفِطْرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ . وَهُوَ الَّذِي يَسْتَحِبُّهُ أَهْلُ الْعِلْمِ أَنْ يُخْرِجَ الرَّجُلُ صَدَقَةَ الْفِطْرِ قَبْلَ الْغَدُوِّ إِلَى الصَّلَاةِ .

37. Mbi dhënien e zekatit para kohe

باب مَا جَاءَ فِي تَعْجِيلِ الزَّكَاةِ

676. Na ka treguar Abdullah b. Abdurrahmani⁶⁶⁴ - atë e ka informuar Seid b. Mensuri, atë Ismail b. Zekerijau, ai ka transmetuar nga Haxhaxh b. Dinari, ai nga Hakim b. Utejbë, ai nga Huxhejr b. Adijj – që Aliu ka thënë: “Abbasi e pyeti të Dërguarin e Allahut që ta lejonte atë ta jepte zekatin para kohe, ai e lejoi atë.”⁶⁶⁵

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، أَخْبَرَنَا سَعِيدُ بْنُ مَنْصُورٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ زَكَرِيَّا، عَنِ الْحَجَّاجِ بْنِ دِينَارٍ، عَنِ الْحَكَمِ بْنِ عُثَيْبَةَ، عَنْ حُجَيْبَةَ بِنْتِ عَدِيٍّ، عَنْ عَلِيٍّ، أَنَّ الْعَبَّاسَ، سَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنْ تَعْجِيلِ صَدَقَتِهِ قَبْلَ أَنْ تَحِلَّ فَرَحَصَ لَهُ فِي ذَلِكَ .

677. Na ka treguar Kasim b. Dinar el-Kufi – atë e ka informuar Is’hak b. Mensuri, ai ka transmetuar nga Israili, ai nga Haxhaxh b. Dinari, ai nga Hakem b. Xhahli, ai nga Huxhre el-Adeveiu, ai nga Aliu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka thënë Umerit: “Ne, zekatin e Abbasit, për këtë vit, e kemi marr në fillim të vitit.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ibn Abbasi. Nuk më është i njohur hadithi mbi dhënien e parakohshme të zekatit, të cilin e transmeton Israili nga Haxhaxh b. Dinari, përveç me këtë rrugë. Ndërsa, hadithi, të cilin e transmeton Ismail b. Zekerijai nga Haxhaxh b. Dinari, sipas mendimit tim, është më i besueshëm se hadithi të cilin e transmeton Israili nga Haxhaxh b. Dinari. Ky hadith, është transmetuar edhe nëpërmjet Hakem b. Utejbës, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si mursel.”

Në pikëpamje të dhënies së zekatit para se zekati të bëhet i obliguar, dijetarët kanë mendime të ndryshme. Disa, siç është, Sufjan eth-Thevriu, konsiderojnë, që zekati nuk duhet dhënë para se të bëhet i obliguar. Ai thotë: “Unë më shumë kam dëshirë që të mos jepet para se të bëhet i obliguar.” Shumica e dijetarëve, thonë: “Nëse ndokush do ta jepte atë para se të bëhet i obliguar, kjo do të ishte e drejtë dhe e mirë.” Kështu mendojnë edhe Shafiu, Ahmedi dhe Is’haku.⁶⁶⁶

حَدَّثَنَا الْقَاسِمُ بْنُ دِينَارٍ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ، عَنْ إِسْرَائِيلَ، عَنِ الْحَجَّاجِ بْنِ دِينَارٍ، عَنِ الْحَكَمِ بْنِ جَحْلٍ، عَنْ حُجْرِ الْعَدَوِيِّ، عَنْ عَلِيٍّ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ لِعُمَرَ " إِنَّا قَدْ أَخَذْنَا زَكَاةَ الْعَبَّاسِ عَامَ الْأَوَّلِ لِلْعَامِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى لَا أَعْرِفُ حَدِيثَ تَعْجِيلِ الزَّكَاةِ مِنْ حَدِيثِ إِسْرَائِيلَ عَنِ الْحَجَّاجِ بْنِ دِينَارٍ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَحَدِيثُ إِسْمَاعِيلَ بْنِ زَكَرِيَّا عَنِ الْحَجَّاجِ عُنْدِي أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ إِسْرَائِيلَ عَنِ الْحَجَّاجِ بْنِ دِينَارٍ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ عَنِ الْحَكَمِ بْنِ عُثَيْبَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ

⁶⁶³ E shënojnë edhe Buhariu me Muslimin, porse në këtë kuptim: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, që sadakatul-fitri të jepet pas namazit të sabahut, e para se njerëzit të dalin nga shtëpitë e tyre për ta falur namazin e bajramit.”

⁶⁶⁴ Abdullah b. Abdurrahman b. Fadl b. Behram es-Semerikandi Ebu Muhammed ed-Darimi, është dijetar i njohur i hadithit. E ka përmbledhur *Musnedin* e njohur. Është i vlefshëm si ravi i besueshëm dhe hafiz i hadithit. Nga ai hadithe kanë marrë Muslimi, Ebu Davudi, Buhariu – por jo në *Sahihë* – dhe Tirmidhiu. Ka vdekur në vitin 255 sipas hixhrtetit.

⁶⁶⁵ Këto hadithe janë argument, që Zekati, për vitin e ardhshëm mund të jepet edhe para përfundimit të vitit aktual.

⁶⁶⁶ Ky është qëndrimi i Ebu Hanifes.

فِي تَعْجِيلِ الرِّكَاتِ قَبْلَ مَجْلِئِهَا فَرَأَى طَائِفَةً مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ لَا يُعَجِّلَهَا . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ قَالَ أَحَبُّ إِلَيَّ أَنْ لَا يُعَجَّلَهَا . وَقَالَ أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِنَّ عَجْلَهَا قَبْلَ مَجْلِئِهَا أَجْزَأْتُ عَنْهُ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

38. Mbi ndalesën e të përkujtuarit

باب مَا جَاءَ فِي النُّهْيِ عَنِ الْمَسْأَلَةِ

678. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebul-Ahvesi, ai ka transmetuar nga Bejan b. Bishra,⁶⁶⁷ ai nga Kajs b. Ebu Hazimi⁶⁶⁸ - që Ebu Hurejre, ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kur ka thënë: “Që ndonjëri nga ju të ngrihet herët, të mbledh dru dhe t’i sjellë ato mbi shpinën e vet (dhe t’i shet ato) dhe një pjesë asaj t’a ndajë dhe me pjesën e mbetur t’i plotësoj nevojat e veta – është më mirë për të, se të kërkojë nga të tjerët, pa e pasur parasysh se a do t’i kishte dhënë apo do ta kishte refuzuar, sepse dora e sipërme (e cila jep) është më e mirë se e poshtme (e cila merr). Prandaj, fillo duke e ndihmuar familjen tënde!”⁶⁶⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Hakim b. Hizami, Ebu Seid el-Hudriu, Zubejr b. Avami, Atije es-Sadijj, Abdullah b. Mes’udi, Mesud b. Amri, Ibn Abbasi, Thevbani, Zijad b. Harith es-Sudaiju, Enesi, Hubshi b. Xhunades, Kabise b. Muhariku, Semure dhe Ibn Umeri. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih garib,⁶⁷⁰ senedi i tij nëpërmjet Bejanit nga Kajsi nuk është i zakonshëm.”

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ بَيَّانِ بْنِ بَشْرٍ، عَنْ قَيْسِ بْنِ أَبِي حَازِمٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ " لِأَنْ يَغْذُو أَحَدُكُمْ فَيَحْتَطِبَ عَلَى ظَهْرِهِ فَيَتَصَدَّقَ مِنْهُ فَيَسْتَعْنِيَ بِهِ عَنِ النَّاسِ خَيْرٌ لَهُ مِنْ أَنْ يَسْأَلَ رَجُلًا أَعْطَاهُ أَوْ مَنَعَهُ ذَلِكَ فَإِنَّ أَيْدِيَ الْعَالِيَا أَفْضَلُ مِنَ أَيْدِي السُّفْلَى وَإِبْدَأْ بِمَنْ تَعُولُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ حَكِيمِ بْنِ جَرَّامٍ وَأَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ وَالزُّبَيْرِ بْنِ الْعَوَّامِ وَعَطِيَّةِ السَّعْدِيِّ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَمَسْعُودِ بْنِ عَمْرٍو وَابْنِ عَبَّاسٍ وَثَوْبَانَ وَزِيَادَ بْنَ الْحَارِثِ الصُّدَّانِيَّ وَأَنَسَ وَخُبَيْشَ بْنَ جُنَادَةَ وَقَبِيصَةَ بْنَ مُخَارِقٍ وَسُمُرَةَ وَابْنَ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ يُسْتَعْرَبُ مِنْ حَدِيثِ بَيَّانٍ عَنْ قَيْسٍ .

679. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, atë Sufjani, duke transmetuar nga Abdulmelik b. Umejri, ai nga Zejd b. Ukbe, ndërsa ai nga Semure b. Xhundubi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Të lypurit është punë e mundimshme, me të cilën njeriu lodhet dhe nënçmohet, përveç kur kërkon nga sunduesi ose kur me të vërtetë është i detyruar.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁶⁷¹

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ عُمَيْرٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ عَفْبَةَ، عَنْ سُمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ الْمَسْأَلَةَ كَدٌّ يَكْدُ بِهَا الرَّجُلُ وَجَهَهُ إِلَّا أَنْ يَسْأَلَ الرَّجُلُ سُلْطَانًا أَوْ فِي أَمْرٍ لَا بُدَّ مِنْهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁶⁶⁷ Bejan b. Bishr el-Ahmesi Ebu Bishr el-Kufi është transmetues i sinqertë dhe i besueshëm. I takonte gjeneratës së pestë të ravive.

⁶⁶⁸ Kajs b. Ebu Hazim el-Bexheli el-Kufi, është muhadremin. Ka qenë transmetues i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së dytë të ravive.

⁶⁶⁹ Kjo nënkupton: “Atë që ke, së pari shpenzoje për familjen, për të cilën je i ngarkuar për ta mbajtur – dhe ajo që të mbetet, ndajua edhe tjerëve.”

⁶⁷⁰ Përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar edhe Buhariu me Muslimin në *Sahihë*.

⁶⁷¹ E shënojnë edhe Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*.

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit

Kapitulli mbi agjërimin

كتاب الصوم

I transmetuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)

عن رسول الله ﷺ

1. Mbi vlerat e muajit të Ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ شَهْرِ رَمَضَانَ

680. Na ka treguar Ebu Kurejb Muhammed b. Ala b. Kurejbi – atë e ka informuar Ebu Bekër b. Ajjashi, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Ebu Salihi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur hynë nata e parë e ramazanit, shejtanët dhe xhinnët⁶⁷² keqbërës lidhen, mbyllen të gjitha dyert e Xhehennemit, hapen të gjitha dyert e Xhennetit. Atëherë ndihet zëri (i melaikes):⁶⁷³ “O, ti i cili dëshiron dhe e kërkon të mirën, kthehu kah Allahu dhe shtoi veprat e mira! Ndërsa ti i cili dëshiron dhe e kërkon të keqen, ndalu me mëkatimin!” Me të vërtetë, ekzistojnë të tillët të cilët Allahu i liron nga Zjarri çdo natë.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdurrahman b. Avfi, Ibn Mes’udi dhe Selmani.”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، مُحَمَّدُ بْنُ الْعَلَاءِ بْنُ كُرَيْبٍ حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ عَيَّاشٍ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا كَانَ أَوَّلُ لَيْلَةٍ مِنْ شَهْرِ رَمَضَانَ صُفِّدَتِ الشَّيَاطِينُ وَمَرَدَةُ الْجِنِّ وَغُلِّقَتْ أَبْوَابُ النَّارِ فَلَمْ يُفْتَحْ مِنْهَا بَابٌ. وَفُتِّحَتْ أَبْوَابُ الْجَنَّةِ فَلَمْ يُغْلَقْ مِنْهَا بَابٌ وَيُنَادِي مُنَادٍ يَا بَاغِيَ الْخَيْرِ أَقْبِلْ وَيَا بَاغِيَ الشَّرِّ أَقْصِرْ وَلِلَّهِ عِتْقَاءُ مِنَ النَّارِ وَذَلِكَ كُلُّ لَيْلَةٍ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَسَلْمَانَ .

681. Na ka treguar Hennadi – atë e kanë informuar Abde dhe Muharibi, ata dy kanë transmetuar nga Muhammed b. Amri, ai nga Ebu Seleme, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut, ka thënë: “Kush, duke besuar dhe duke e shpresuar shpërblimin, i agjëron ditët e ramazanit dhe netët i kalon në

⁶⁷² Ibn Haxher el-Askalani, në komentimin e përmbledhjes së hadithit të Buhariut, *Fet’hul-Bari*, thotë, që ekziston besueshmëria, se këtu ka të bëjë me domethënien e vërtetë – që domethënë, se shejtanët dhe xhinët e shëmtuar gjatë ramazanit, janë me të vërtetë të lidhur – por ekziston mundësia, që ka të bëjë me kuptimin figurativ: që agjëruetit, duke bërë shumë vepra të mira, i prangosin shejtanët që t’i mashtrojnë, apo që t’i cypin njerëzit për të keqe, ashtu që ata, në krahasim me agjëruetit besimtarë, duken sikur të jenë të prangosur.

⁶⁷³ El-Mubarekfuri, konsideron, që këtu ka të bëjë mbi zërin e melaikeve.

namaz të natës, atij kanë për t’iu falur mëkatet, të cilat i ka bërë më herët.⁶⁷⁴ Ndërsa, kush, duke besuar dhe duke shpresuar shpërblimin, Lejletul-kadrin e kalon në namaz të natës, gjithashtu, kanë për t’iu falur mëkatet që i ka bërë më herët.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është sahih.⁶⁷⁵ Hadithi i Ebu Hurejres, të cilin nga ai e ka transmetuar Ebu Bekër b. Ajjashi, është garib⁶⁷⁶ dhe nuk më është i njohur, përveç nëpërmjet Ebu Bekër b. Ajjashit, nga A’meshi, nga Ebu Salihi, nga Ebu Hurejre. E pyeta Muhammed b. Ismailin mbi këtë hadith, e ai tha: “Na ka informuar Hasan b. Rebiu – atë e ka informuar Ebul-Ahves, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Muxhahidi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘Kur hynë nata e parë e ramazanit.’ – pastaj e përmendi tërë hadithin. Muhammedi ka thënë: Ky hadith, sipas mendimit tim, është më i besueshëm, sesa hadithi të cilin e transmeton Ebu Bekër b. Ajjashi.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ، وَالْمَحَارِبِيُّ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَامَ رَمَضَانَ وَقَامَهُ إِيْمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ وَمَنْ قَامَ لَيْلَةَ الْقَدْرِ إِيْمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ " . هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ الَّذِي رَوَاهُ أَبُو بَكْرٍ بْنُ عَيَّاشٍ حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ مِنْ رِوَايَةِ أَبِي بَكْرٍ بْنِ عَيَّاشٍ عَنْ الْأَعْمَشِ عَنْ أَبِي صَالِحٍ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ أَبِي بَكْرٍ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدَ بْنَ إِسْمَاعِيلَ عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ، فَقَالَ حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ الرَّبِيعِ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ الْأَعْمَشِ، عَنْ مُجَاهِدٍ، قَوْلُهُ " إِذَا كَانَ أَوَّلُ لَيْلَةٍ مِنْ شَهْرِ رَمَضَانَ " . فَذَكَرَ الْحَدِيثَ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَهَذَا أَصَحُّ عِنْدِي مِنْ حَدِيثِ أَبِي بَكْرٍ بْنِ عَيَّاشٍ .

2. Mos agjëroni para fillimit të muajit të ramazanit

بَاب مَا جَاءَ لَا تَقْدَمُوا الشَّهْرَ بِصَوْمٍ

682. Na ka treguar Ebu Kurejb – atë e ka informuar Abd b. Sulejmani, duke transmetuar nga Muhammed b. Amri, ai nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos agjëroni një ose dy ditë para fillimit të ramazanit, përveç nëse ai nuk është agjërimi të cilin ndokush e ka filluar më herët.⁶⁷⁷ Filloni me agjërimin, pasi që e keni parë hënën e re dhe agjëroni, gjithnjë, derisa nuk e shihni përsëri. Por, nëse bëhet vranët dhe nuk do të mund ta shihni atë, barazoni tridhjetë ditë të agjërimin dhe atëherë prisheni atë.”⁶⁷⁸

⁶⁷⁴ Sujutiju thotë, që në transmetimin e këtij hadithi, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, ekziston shtojca: “(...) dhe ato të cilët më vonë i ka bërë.” Ai gjithashtu, konsideron, që këtu mendohet mbi gabimet e vogla e jo në të mëdhatë.

⁶⁷⁵ E kanë shënuar, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁶⁷⁶ E ka shënuar edhe Ibn Maxhe në *Sunen*. Ibn Xhevziu konsideron, që këto dy hadithe kanë ardhur përmes Ebu Bekër b. Ajjashit, nga A’meshi, nga Ebu Salihi, nga Ebu Hurejre dhe që të dytë, janë të besueshëm. Mejreku thekson që Ebu Bekër b. Ajjashi, është i vlerësuar në mënyrë të ndryshme, nga dijetarët e hadithit. Shumica konsiderojnë, që ka bërë shumë gabime gjatë transmetimit. Prandaj është vlerësuar, si transmetues i dobët. Për atë, Tirmidhiu ka thënë, që ky hadith është garib dhe që nuk e ka të njohur, përveç nëpërmjet Ebu Bekër b. Ajjashit.

⁶⁷⁷ Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut, e ndalon agjërimin një apo dy ditë para ramazanit. Përse e ka bërë atë – është diskutabile në mesin e dijetarëve. Disa thonë që ata të cilët e kanë agjëruar muajin sha’ban, të pushonin ca dhe të forcoheshin për ramazan. Disa thonë: “E ka bërë atë që ta ndante agjërimin e muajit sha’ban i cili është nafle, nga agjërimi i ramazanit, i cili është farz.” Disa bile thonë: “Pasi që është rregull, që agjërimi i ramazanit fillon edhe mbaron me të parit e hënës së re, e ka bërë atë, që ai rregull të mos vihet në pyetje.” Është i lejuar agjërimi edhe i një apo dy ditëve para ramazanit, nëse ndokush ka filluar me agjërimin për t’i kompensuar ditët e pa-agjëruara, ose të premtuara ose me agjërimin kefaret dhe ai agjërim, në kontinuitet, të ketë kohë gjatësi deri në ramazan.

⁶⁷⁸ Ky hadith është përgjigje, në dilemat, në pikëpamje të dallimeve rreth përfundimit të ramazanit dhe fillimit të Bajramit, në krahasim me Arabinë Saudite dhe vendet e tjera islame. Në vendet ku mund të shihet hëna e re, përfundimi i ramazanit është atëherë kur shihet hëna e re. Në vendet në të cilat për shkak të vranësirave të

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar edhe nga disa as’habë. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih. Sipas tij barazohen dijetarët. Ata konsiderojnë, që është mekruh të nxituarit me agjërimin para se të hyjë ramazani, që të mos mendohej, se është agjërimi i ramazanit. Por, nëse ndokush ka filluar të agjërojë më herët dhe agjërimi i tij e përfshinë edhe atë periudhë, ajo – sipas mendimit të tyre - nuk pengon.”

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ بَنٍ سُلَيْمَانَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " لَا تَقْدَمُوا الشَّهْرَ بِيَوْمٍ وَلَا بِيَوْمَيْنِ إِلَّا أَنْ يُوَافِقَ ذَلِكَ صَوْمًا كَانَ يَصُومُهُ أَحَدُكُمْ صُومُوا لِزُؤَيْتِهِ وَأَفْطَرُوا لِزُؤَيْتِهِ فَإِنْ عَمَّ عَلَيْكُمْ فَعُدُّوا ثَلَاثِينَ ثُمَّ أَفْطَرُوا " . رَوَى مُنْصَوِّرٌ بَنُ الْمُعْتَمِرِ عَنْ رَبِيعِ بْنِ جَرَّاشٍ عَنْ بَعْضِ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ يَنْحُو هَذَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ بَعْضِ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ كَرَهُوا أَنْ يَتَعَجَّلَ الرَّجُلُ بِصِيَامٍ قَبْلَ دُخُولِ شَهْرِ رَمَضَانَ لِمَعْنَى رَمَضَانَ وَإِنْ كَانَ رَجُلٌ يَصُومُ صَوْمًا فَوَافِقَ صِيَامَهُ ذَلِكَ فَلَا بَأْسَ بِهِ عِنْدَهُمْ .

683. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Ali b. Mubareku, ai nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos agjëroni një ose dy ditë para fillimit të ramazanit, përveç nëse ai nuk është agjërim të cilin ndokush e ka filluar më herët. Në atë rast, le të agjërojë atë.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁶⁷⁹

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ عَلِيِّ بْنِ الْمُبَارَكِ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا تَقْدَمُوا شَهْرَ رَمَضَانَ بِصِيَامٍ قَبْلَهُ بِيَوْمٍ أَوْ يَوْمَيْنِ إِلَّا أَنْ يَكُونَ رَجُلٌ كَانَ يَصُومُ صَوْمًا فَلْيَصُمْهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

3. Ditën e dyshimtë (jevmushek) është e papëlqyer të agjërohet

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ صَوْمِ يَوْمِ الشَّكِّ

684. Na ka treguar Ebu Seid Abdullah b. Seid el-Eshexhxh – atë e ka informuar Ebu Halid el-Ahmeri,⁶⁸⁰ duke transmetuar nga Amr b. Kajs, ai nga Ebu Is’haku – që Sile b. Zuferi,⁶⁸¹ ka thënë: “Me një rast, ishim te Ammar b. Jasiri”⁶⁸² dhe ai e afroi delen e pjekur, duke thënë: “Urdhëroni hani!” Disa njerëz u larguan, duke thënë: “Ne jemi duke agjëruar.” Ammari në atë tha: “Kush agjëron ditën e dyshuar,”⁶⁸³ ai e ka kundërshtuar Ebu Kasimin (Resulullahun (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të))!⁶⁸⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre dhe Enesi. Hadithi i Ammarit është hasen-sahih.”⁶⁸⁵ Sipas kësaj kanë vepruar shumica e dijetarëve nga gjenerata e

vazhdueshme nuk mund të shihet hëna e re, e sidomos gjatë dimrit, Bajrami fillon pasi që plotësohen tridhjetë ditë të agjërimit. (Sipas mendimit të Doktor Kardavit, muslimanët e atyre vendeve nuk kanë për t’u drejtuar kah Arabia Saudite dhe vendet islame. Ata janë të obliguar të kryejnë tridhjetë ditë agjërim, çka është në pajtim me këtë hadith.

⁶⁷⁹ Është shënuar në *El-Kutubus-sitte*.

⁶⁸⁰ Ebu Halid el-Umer quhet Sulejman b. Hajjan el-Ezdi el-Kufi. Ai është ravi i sinqertë, mirëpo, ishte i prirë për gabime gjatë transmetimit të haditheve. I takonte gjeneratës së tetë të transmetuesve të hadithit.

⁶⁸¹ Sile b. Zubejr el-Kufi el-Abesi, është tabi’inë i njohur.

⁶⁸² Ammar b. Jasiri, është as’hab i njohur. Ka vdekur në betejën në *Sifine*, në vitin 37 sipas hixhretit.

⁶⁸³ Ditë e dyshimtë, konsiderohet dita e 30 e shabanit, në rast se, për shkak të vranësirës së natës së kaluar, nuk ka pasur mundësi të shihet Hëna e re. Quhet e dyshimtë, sepse nuk është e sigurt, se a ka hyrë mu në atë ditë muaji i ramazanit apo jo.

⁶⁸⁴ Ebu Kasimi është Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Këtë pseudonim e ka marrë sipas emrit të djalit të tij Kasimit.

⁶⁸⁵ E kanë shënuar edhe Ibn Hibbani dhe Ibn Huzejme në *Sahihë* dhe atë e konsiderojnë sahih, dhe ed-Darekutni dhe Bejhekiu në *Sahihë*.

as'habëve, tabi'inëve dhe të atyre pas tyre, siç është Sufjan eth-Thevriu, Malik b. Enesi, Abdullah b. Mubareku, Shafi'u, Ahmedi dhe Is'haku.⁶⁸⁶ Ata konsiderojnë, që është mekruh të agjërohet dita për të cilën dyshohet që i takon ramazanit. Shumica konsiderojnë, që personi, nëse e agjëron ditën e dyshuar, duhet ta agjëroj, madje qoftë ajo edhe në kuadër të ramazanit.”

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ عَنِ اللَّهِ بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ، حَدَّثَنَا أَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرِيُّ، عَنْ عَمْرِو بْنِ قَيْسٍ الْمَلَابِيِّ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ صِلَةَ بْنِ رُفْرٍ، قَالَ كُنَّا عِنْدَ عَمَّارِ بْنِ يَاسِرٍ فَأَتَانِي بِشَاةٍ مَصْلِيَّةٍ فَقَالَ كُلُوا . فَتَنَحَّى بَعْضُ الْقَوْمِ فَقَالَ إِنِّي صَائِمٌ . فَقَالَ عَمَّارٌ مَنْ صَامَ الْيَوْمَ الَّذِي يَشْكُ فِيهِ النَّاسُ فَقَدْ عَصَى أَبَا الْقَاسِمِ ﷺ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَأَنْسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَمَّارٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَمَنْ بَعْدَهُمْ مِنَ التَّابِعِينَ وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَمَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ كَرَهُوا أَنْ يَصُومَ الرَّجُلُ الْيَوْمَ الَّذِي يَشْكُ فِيهِ وَرَأَى أَكْثَرُهُمْ إِنْ صَامَهُ فَكَانَ مِنْ شَهْرِ رَمَضَانَ أَنْ يَقْضِيَ يَوْمًا مَكَانَهُ .

4. Mbi numërimin e ditëve të shabanit për shkak të ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي إحصاءِ هلالِ شَعْبَانَ لِرَمَضَانَ

685.- Na ka treguar Muslim b. Haxhxhaxhi⁶⁸⁷ – atë e ka informuar Jahja b. Jahja, atë Ebu Muaviu, duke transmetuar nga Muhammed b. Amri, ai nga Ebu Seleme, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Numëroni ditët e shabanit për shkak të ramazanit.”⁶⁸⁸

Ebu Isai, thotë: “Për ne, hadithi i Ebu Hurejres, në këtë formë është i njohur vetëm nëpërmjet Ebu Muaviut, ndërsa është e besueshme edhe ajo që është transmetuar nëpërmjet Muhammed b. Amrit – ai nga Ebu Seleme, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: ‘Mos e agjëroni një e as dy ditë para ramazanit!’ Gjithashtu, është transmetuar edhe nëpërmjet Jahja b. Ebu Kethirit – nga Ebu Seleme, nga Ebu Hurejre – ngjashëm me hadithin e Muhammed b. Amrit dhe El-Lejthiut.”

حَدَّثَنَا مُسْلِمُ بْنُ حَاجٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ يَحْيَى، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَحْصُوا هَلَالَ شَعْبَانَ لِرَمَضَانَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ لَا تَعْرِفُهُ مِثْلَ هَذَا إِلَّا مِنْ حَدِيثِ أَبِي مُعَاوِيَةَ . وَالصَّحِيحُ مَا رَوَى عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو عَنْ أَبِي سَلَمَةَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " لَا تَقْدَمُوا شَهْرَ رَمَضَانَ بِيَوْمٍ وَلَا يَوْمَيْنِ " . وَهَكَذَا رَوَى عَنْ يَحْيَى بْنُ أَبِي كَثِيرٍ عَنْ أَبِي سَلَمَةَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوُ حَدِيثِ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو اللَّيْثِيُّ .

5. Mbi fillimin dhe përfundimin e agjërimit duke e parë hënën e re

باب مَا جَاءَ أَنَّ الصَّوْمَ لِرُؤْيَا الْهَلَالِ وَالْإِفْطَارُ لَهُ

686. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebul-Ahves, duke transmetuar nga Simak b. Harbi, ai nga Ikrimë, ndërsa ai nga Ibn Abbasi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos agjëroni para ramazanit. Filloni me agjërimin sapo ta shihni hënën e re, por edhe

⁶⁸⁶ Shumica e as'habëve dhe të dijetarëve pas tyre – siç janë Sufjan eth-Thevriu, Malik b. Enesi, Abdullah b. Mubareku, Shafi'u, Ahmed b. Hanbeli, Is'haku dhe Ebu Hanife – në bazë të këtij hadithi, konsiderojnë, që është mekruh agjërimi i ditës së dyshimtë. Shumica e tyre, konsiderojnë që ai i cili e agjëron atë ditë, dhe vërtetohet që nuk ka qenë fillimi i ramazanit, është i obliguar që të njëjtën ditë ta agjërojë, për shkak se nuk e ka bërë nijet ta agjëroj si ditën e ramazanit, por vetëm si ditën e dyshimtë. Disa, bile, thonë se është i lejuar agjërimi i asaj dite. Ndërkaq, të gjithë ata që pohojnë, që dita e dyshimtë mund të agjërohet, nuk kanë argument të mirë për atë.

⁶⁸⁷ Ebu Husejn, Muslim b. Haxhxh b. Muslim el-Kushejri en-Nejsaburi, është autor i *Xhamius-sahih* të njohur. Tirmidhiu nga ai ka marr vetëm këtë hadith.

⁶⁸⁸ Pra, numëroni konstantë ditët e sha'banit, që ta dini saktë se kur fillon ramazani, që në atë mënyrë të mos ju ikë diç nga ramazani pa dashje.

ndërpriteni agjërimin sapo ta shihni atë. Nëse para ramazanit bëhet vranët, ju (në atë rast) plotësoni tridhjetë ditë të shabanit.”⁶⁸⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Ebu Bekri dhe Ibn Umeri. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.”⁶⁹⁰ Ai prej tij është transmetuar në shumë mënyra.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ سَمَاعِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا تَصُومُوا قَبْلَ رَمَضَانَ صُومُوا لِزُؤَيْتِهِ وَأَفْطِرُوا لِزُؤَيْتِهِ فَإِنْ حَالَتْ دُونَهُ غِيَايَةٌ فَأَكْمِلُوا ثَلَاثِينَ يَوْمًا " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَأَبِي بَكْرَةَ وَابْنِ عُمَرَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَقَدْ رُوِيَ عَنْهُ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ .

6. Mbi atë që muaji mund t'i ketë njëzet e nëntë ditë

بَابُ مَا جَاءَ أَنَّ الشَّهْرَ يَكُونُ تِسْعًا وَعِشْرِينَ

687. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Jahja b. Zekerija b. Ebu Zaide, atë Isa b. Dinari, duke transmetuar nga babai i vet, ai nga Amr b. Harith b. Ebu Dinari⁶⁹¹ - që Ibn Mes'udi ka thënë: “Nga ato (ramazane) që i kam agjëruar me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka pasur më tepër nga ata që kanë qenë nga njëzet e nëntë ditë.”

Tirmidhiu, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar edhe nga Umeri, Ebu Hurejre, Aishja, Sa'd b. Ebu Vekkasi, Ibn Abbasi, Ibn Umeri, Enesi, Xhabiri, Ummu Seleme dhe Ebu Bekri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Muaji mund t'i ketë edhe njëzet e nëntë ditë.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ زَكَرِيَّا بْنُ أَبِي زَائِدَةَ، أَخْبَرَنِي عِيسَى بْنُ دِينَارٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَمْرِو بْنِ الْخَارِثِ بْنِ أَبِي ضَرَارٍ، عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ، قَالَ مَا صُمْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ تِسْعًا وَعِشْرِينَ أَكْثَرَ مِمَّا صُمْنَا ثَلَاثِينَ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ وَسَعْدِ بْنِ أَبِي وَقَّاصٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَابْنِ عُمَرَ وَأَنَسٍ وَجَابِرٍ وَأُمِّ سَلَمَةَ وَأَبِي بَكْرَةَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " الشَّهْرُ يَكُونُ تِسْعًا وَعِشْرِينَ " .

688. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ismail b. Xha'feri – duke transmetuar nga Humejde – që Enesi, ka thënë: “Me një rast, i Dërguari i Allahut ishte betuar që ka për t'u izoluar një muaj nga bashkëshortet e veta dhe i vetëm në dhomë ka qëndruar njëzet e nëntë ditë. Pasi që doli, të pranishmit i thanë: ‘O i Dërguar i Allahut, ti je betuar që ke për t'u izoluar (prej tyre) një muaj ditë?’ – ai tha: ‘Muaji mund të ketë edhe njëzet e nëntë ditë.’”⁶⁹² Ebu Isai thotë: ‘Ky hadith është hasen-sahih.’”⁶⁹³

⁶⁸⁹ Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka vendosur rregullin sipas të cilit, duhet barazuar të të vërtetuarit e fillimit dhe përfundimit të agjërimit të ramazanit. Ai fillon, pasi që duket hëna e re, natën e fundit të sha'banit, ndërsa përfundon duke e parë hënën e re, natën e fundit të ramazanit. Duke e pasur parasysh, se atëherë hëna e re vështrohej vetëm me sy, ka qenë vështirë për ta parë, kur ka qenë vranët dhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si zgjidhje alternative në situatat e tilla dhe si rregull për ta vërtetuar fillimin dhe përfundimin e ramazanit, ka urdhëruar që sha'bani të plotësohej me tridhjetë ditë, kur është fjala për fillimin e agjërimit, përkatësisht të përmbushen tridhjetë ditë të ramazanit, kur ka të bëjë me përfundimin e agjërimit. Sot, për të vërtetuarit, e fillimit dhe të mbarimit të ramazanit, do të duhej të shërbeheshim me të gjitha ndihmesat shkencore, të cilat mund të shfrytëzohen për ta caktuar saktë fillimin dhe fundin e muajit.

⁶⁹⁰ Këtë hadith, përveç Tirmidhiut, e kanë shënuar edhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned* dhe Nesaiu në *Sahih*.

⁶⁹¹ Amër b. Harith b. Ebu Diras është as'hab. Ai është vëllai i bashkëshortes, së të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), Xhuvrejrijes. U takon as'habëve, të cilët kanë transmetuar pak hadithe nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁶⁹² Nga hadithe të shumta, mund të konkludohet, se muaji hënor, mund t'i ketë njëzet e nëntë ditë, po edhe tridhjetë ditë. Janë më të shpeshtë muajt nga njëzet e nëntë ditë. Ibn Haxher el-Askalani thotë, që disa hafidhë të hadithit theksojnë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë jetës i ka agjëruar

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنْ حُمَيْدٍ، عَنْ أَنَسٍ، أَنَّهُ قَالَ أَلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ مِنْ نِسَائِهِ شَهْرًا فَأَقَامَ فِي مَشْرَبَةٍ تِسْعًا وَعِشْرِينَ يَوْمًا قَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّكَ أَلَيْتَ شَهْرًا فَقَالَ " الشَّهْرُ تِسْعٌ وَعِشْرُونَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

7. Mbi agjërimin në bazë të dëshimit

باب مَا جَاءَ فِي الصَّوْمِ بِالشَّهَادَةِ

689. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili⁶⁹⁴ - atë e ka informuar Muhammed b. Sabbah,⁶⁹⁵ atë Velid b. Ebu Thevriu,⁶⁹⁶ ai ka transmetuar nga Simaku, ai nga Ikrimë – që Ibn Abbasi, ka thënë: “Me një rast, erdhi te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), një beduin dhe i tha: ‘Unë e kam parë hënë e re.’ I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e pyeti: ‘A je duke dëshmuar ti, që vetëm Allahu është Zot dhe a je duke dëshmuar që Muhammedi është i Dërguari i Allahut?’ ‘Po.’ – tha ai, ndërsa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: ‘Bilal, informoje popullin që (nga) nesër të agjërojë.’”⁶⁹⁷

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الصَّبَّاحِ، حَدَّثَنَا الْوَلِيدُ بْنُ أَبِي ثَوْرٍ، عَنْ سِمَاكِ، عَنْ عِكْرِمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ جَاءَ أَغْرَابِيٌّ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَ إِنِّي رَأَيْتُ الْهَيْلَالَ . قَالَ " أَتَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ أَتَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ " . قَالَ نَعَمْ . قَالَ " يَا بِلَالُ أَدْنِ فِي النَّاسِ أَنْ يَصُومُوا غَدًا " .

690. Na ka treguar Ebu Kurejbi – atë e ka informuar Husejn el-Xhu’fi, duke transmetuar nga Zaidi, e ai nga Simak b. Harbi – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Në pikëpamje të hadithit të Ibn Abbasit, ekzistojnë divergjenca. Sufjan eth-Thevriu dhe të tjerët, atë e kanë transmetuar nëpërmjet Simak b. Harbit, ai nga Ikrimë, e ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si hadith-mursel. Gjithashtu, shumica e nxënësve të Simakut, atë e kanë transmetuar nëpërmjet Simakut, ai nga Ikrimë, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si hadith-mursel.”

Sipas këtij hadithi kanë vepruar shumica e dijetarëve. Ata thonë: “Në pikëpamje të agjërimin, mund të pranohet dëshmia e një njeriu.” Këtë qëndrim e mbështetë Ibn Mubareku, Shafiu dhe Ahmedi. Is’haku thotë: “Nuk ka për t’u filluar me agjërimin derisa nuk dëshmojnë dy njerëz.” Në pikëpamje të

nëntë ramazane. Nga ata nëntë, vetëm dy i kanë pasur tridhjetë, derisa të gjithë i kanë pasur njëzet e nëntë ditë. Neveviu pohon, që nga dy, tre apo katër muaj, të një pas njëshëm mund ta kenë numrin e zvogëluar (njëzet e nëntë) të ditëve. Më tepër se katër nuk mund të jenë.

⁶⁹³ Përveç Tirmidhiut, atë e ka shënuar edhe Buhariu në *Sahih*.

⁶⁹⁴ Muhammed b. Ismaili, është imam i Buharës.

⁶⁹⁵ Muhammed b. Sabbah ed-Dulabi Ebu Xha’fer el-Bagdadi, është transmetues i njohur dhe hafiz i haditheve. I takonte gjeneratës së dhjetë të ravive.

⁶⁹⁶ Velid b. Abdullah b. Ebu Thevr el-Hamdani el-Kufi, sipas mendimit të Ibn Haxherit, është transmetues i dobët. I takonte gjeneratës së tetë të ravive.

⁶⁹⁷ Ky hadith është argument, se fillimi i ramazanit mund të konstatohet në bazë të dëshimit të një njeriu, që e ka parë hënë e re. Kusht për atë është, që dëshmitari të jetë zbatues i denjë i islamit. Qëndrimin e tillë e mbështet Ibn Mubareku, Shafiu, Ahmed b. Hanbeli, Ebu Hanife dhe shumica e dijetarëve të tjerë. Is’haku, Maliku, Lejthi, El-Evzaiu dhe Eth-Thevriu, konsiderojnë, që fillimi i ramazanit mund të konstatohet në bazë të dëshimit më së paku të dy vetave. Ata mendimin e këtillë e bazojnë mbi hadithin e Abdurrahman b. Zejd b. El-Hattabit, i cili me një rast, duke folur mbi ditën e dyshimit, ka thënë: “Unë jam shoqëruar me as’habët e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). I kanë pyetur, ndërsa ata më tregonin se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Filloni të agjëroni kur e shihni hënë e re, po edhe përfundoni me agjërimin kur e shihni atë. Sipas saj orientohuni edhe te të vërtetuarit e Kurban Bajramit. Nëse është vranësirë, atëherë agjëroni tridhjetë ditë. Por, kur dëshmojnë dy muslimanë, mundeni që në bazë të dëshmisë së tyre edhe të filloni por edhe të ndaloni së agjëruari.” Hadithin e transmetojnë Nesaiu dhe Ahmedi.

përfundimit të agjërimit, nuk ka divergjenca në mesin e dijetarëve. Të gjithë pajtohen, që për përfundimin e agjërimit është i nevojshëm dëshmia e dy njerëzve.

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا حُسَيْنُ الْجُعْفِيُّ، عَنْ زَائِدَةَ، عَنْ سِمَاكِ، نَحْوَهُ بِهَذَا الْإِسْنَادِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ فِيهِ اخْتِلَافٌ . وَرَوَى سَفْيَانُ الثَّوْرِيُّ، وَغَيْرُهُ، عَنْ سِمَاكِ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا وَأَكْثَرُ أَصْحَابِ سِمَاكِ رَوَوْا عَنْ سِمَاكِ عَنْ عِكْرَمَةَ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ قَالُوا نَقِلُ شَهَادَةَ رَجُلٍ وَاحِدٍ فِي الصِّيَامِ . وَبِهِ يَقُولُ ابْنُ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَأَهْلُ الْكُوفَةِ . قَالَ إِسْحَاقُ لَا يُصَامُ إِلَّا بِشَهَادَةِ رَجُلَيْنِ . وَلَمْ يَخْتَلِفْ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْإِفْطَارِ أَنَّهُ لَا يَقْبَلُ فِيهِ إِلَّا شَهَادَةُ رَجُلَيْنِ .

8. Dy muaj në të cilët janë bajramet nuk (shkurtohen)

باب مَا جَاءَ شَهْرَا عِيدٍ لَا يَنْقُصَانِ

691. Na ka treguar Jahja b. Halef el-Basriu – atë e ka informuar Bishr b. Mufeddal, duke transmetuar nga Halid el-Hadhau, ai nga Abdurrahman b. Ebu Bekri, ndërsa ai nga babai i vet – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dy muajt në të cilët janë bajramet (një pas një në vitin e njëjtë) nuk e shkurtojnë ramazanin⁶⁹⁸ dhe dhul-hixhen.”⁶⁹⁹

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Bekrit është hasen.”⁷⁰⁰ Ky transmetim, është transmetuar nëpërmjet Abdurrahman b. Ebu Bekrit, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – dhe si hadith-mursel.”

Duke folur mbi kuptimin e hadithit “Dy muaj, në të cilët janë bajramet, nuk shkurtohen.” – Ahmedi, thotë: “Nuk shkurtohen gjatë një viti në të njëjtën kohë edhe muaji ramazan edhe dhul hixhe. Nëse njëri shkurtohet, tjetri është i plotë.”

Is’haku, thotë: “Nuk shkurtohen, do të thotë nuk shkurtohet vlera e tyre. Prandaj, thotë ai: ‘Nëse muaji i ka edhe njëzet e nëntë ditë, është i plotë, nuk është i shkurtuar. Sipas meth’hebit të Is’hakut, dy muaj gjatë një viti mund të shkurtohen në të njëjtën kohë.

حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ، بِحَيْثُ بَنَى خَلْفَ الْبَصْرِيِّ حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ الْمُفَضَّلِ، عَنْ خَالِدِ الْحَدَّاءِ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي بَكْرَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " شَهْرَا عِيدٍ لَا يَنْقُصَانِ رَمَضَانُ وَذُو الْحِجَّةِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي بَكْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي بَكْرَةَ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . قَالَ أَحْمَدُ مَعْنَى هَذَا الْحَدِيثِ " شَهْرَا عِيدٍ لَا يَنْقُصَانِ " . يَقُولُ لَا يَنْقُصَانِ مَعَا فِي سَنَةٍ وَاحِدَةٍ شَهْرَ رَمَضَانَ وَذُو الْحِجَّةِ إِنْ نَقَصَ أَحَدُهُمَا تَمَّ الْآخَرُ . وَقَالَ إِسْحَاقُ مَعْنَاهُ " لَا يَنْقُصَانِ " يَقُولُ وَإِنْ كَانَ تِسْعًا وَعِشْرِينَ فَهُوَ تَمَامٌ غَيْرُ نَقْصَانٍ . وَعَلَى مَذْهَبِ إِسْحَاقَ يَكُونُ يَنْقُصُ الشَّهْرَانِ مَعَا فِي سَنَةٍ وَاحِدَةٍ .

⁶⁹⁸ Bajrami nuk është në ramazan, por në kontekst të këtillë, është përmendur në hadith, për atë shkak që bajrami i ramazanit fillon pasi që përfundon ramazani.

⁶⁹⁹ Sipas mendimit të Ahmed b. Hanbelit, ky hadith e ka këtë kuptim: “Të dy këta muaj, ramazani dhe dhul-hixhe, në të njëjtin vit, nuk mund të kenë nga njëzet e nëntë ditë. Nëse ramazani i ka njëzet e nëntë ditë, atëherë dhul-hixhe do të ketë tridhjetë ditë.” Sipas mendimit të Is’haku, ky hadith, e ka kuptimin, që shpërblimet dhe sevapet për veprat e mësuara, gjatë këtij muaji, nuk zvogëlohen. Ato janë të njëjta, pa e pasur parasysh, se a kanë pasur këta muaj njëzet e nëntë apo tridhjetë ditë. Disa dijetarë, konsiderojnë, se ky hadith domethënë, se ramazani dhe dhul-hixhe nuk munden, assesi, në të njëjtin vit të kenë nga njëzet e nëntë ditë, edhe pse, ndonjëherë edhe ajo mund të ndodhë.

⁷⁰⁰ Edhe pse Tirmidhiu këtë hadith e ka vlerësuar të mirë, ai është i besueshëm – sepse Buhariu dhe Muslimi atë e kanë shënuar në *Sahihë*.

9. Për banorët e çdo vendi, është një vështrim

باب مَا جَاءَ لِكُلِّ أَهْلِ بَلَدٍ رُؤْيَاهُمْ

692. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ismail b. Xha'feri – që Muhammed b. Ebu Harmele, ka thënë: “Mua më ka informuar Kurejbe, që Ummul-Fadl, vajza e Harithit, e ka dërguar Muaviun në Sham. Ai, thotë: “I përfundova punët e saja dhe hëna e re me zuri në Sham. Hënën e re e pamë natën e të premtes. Kur, para përfundimit të muajit, u ktheva në Medine, Ibn Abbasi, më pyeti (për shumë gjëra), pastaj e përmendi edhe hënën e re. Ai pyeti: ‘Kur e patë ju hënën e re?’ ‘E pamë natën e të premtes.’ – u përgjigja. ‘E, a e ke parë edhe ti natën e të premtes?’ - përsëri pyeti ai. ‘E kanë parë njerëzit dhe agjëruan, por agjëroi edhe vet Muaviu.’⁷⁰¹ Ai në atë, tha: ‘Ne e pamë natën e të shtunës, ashtu që ende jemi duke agjëruar dhe kemi për të agjëruar derisa nuk i agjërojmë tridhjetë ditë ose derisa nuk e shohim atë (hënën e re).” Unë thash: ‘Vallë, a nuk ju mjafton (edhe juve) të parit (e hënës së re) nga Muaviu?’ ‘Nuk mjafton.’ – tha ai. ‘Kështu na ka urdhëruar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).’⁷⁰²

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih-garib.⁷⁰³ Sipas këtij hadithi dakordoheshin dijetarët. Ata thanë, që për banorët e secilit vendi - gjykimi i çështjes është të parit e hënës së re.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ أَبِي حَرْمَةَ، أَخْبَرَنِي كُرَيْبٌ، أَنَّ أُمَّ الْفَضْلِ بِنْتَ الْحَارِثِ، بَعَثَتْهُ إِلَى مُعَاوِيَةَ بِالشَّامِ . قَالَ فَقَدِمْتُ الشَّامَ فَقَضَيْتُ حَاجَتَهَا وَاسْتَهْلَ عَلَى هِلَالٍ رَمَضَانَ وَأَنَا بِالشَّامِ فَرَأَيْنَا الْهِلَالَ لَيْلَةَ الْجُمُعَةِ ثُمَّ قَدِمْتُ الْمَدِينَةَ فِي آخِرِ الشَّهْرِ فَسَأَلَنِي ابْنُ عَبَّاسٍ ثُمَّ ذَكَرَ الْهِلَالَ فَقَالَ مَتَى رَأَيْتُمُ الْهِلَالَ فَقُلْتُ رَأَيْنَاهُ لَيْلَةَ الْجُمُعَةِ . فَقَالَ أَأَنْتَ رَأَيْتَهُ لَيْلَةَ الْجُمُعَةِ فَقُلْتُ رَأَى النَّاسُ وَصَامُوا وَصَامَ مُعَاوِيَةُ . قَالَ لَكِنْ رَأَيْنَاهُ لَيْلَةَ السَّبْتِ فَلَا نَزَالَ نَصُومُ حَتَّى نَكْمُلَ ثَلَاثِينَ يَوْمًا أَوْ نَرَاهُ . فَقُلْتُ أَلَا تَكْتَفِي بِرُؤْيَا مُعَاوِيَةَ وَصِيَامِهِ قَالَ لَا هَكَذَا أَمَرَنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّ لِكُلِّ أَهْلِ بَلَدٍ رُؤْيَاهُمْ .

10. Me çfarë është bukur të bëhet iftari

باب مَا جَاءَ مَا يُسْتَحَبُّ عَلَيْهِ الْإِفْطَارُ

693. Na ka treguar Muhammed b. Umer b. Ali el-Muhammed b. Umer b. Ali el-Mukaddemi – atë e ka informuar Seid b. Amiri, atë Shu'be, duke transmetuar nga Abdulaziz b. Suhejbi, ai nga Enes b. Maliku – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush gjen hurme, le të bëjë iftar me të. Ndërsa, kush nuk gjen, le të bëjë iftar me ujë, sepse uji me të vërtetë është i pastër.”⁷⁰⁴

⁷⁰¹ Në transmetimin e Muslimit, të këtij qëndron: “Po, e kam parë unë, por, atë e kanë parë edhe njerëzit dhe kanë agjëruar. Por ka agjëruar edhe vetë Muaviu.”

⁷⁰² Një numër i madh i dijetarëve, në bazë të këtij hadith, thonë, që banorët e cilit do vend janë kompetent që edhe fillimin edhe përfundimin e ramazanit ta vërtetojnë në bazë të vështrimit personal të hënës së re. Sipas mendimit të tyre, në rast se ndonjë vend informon se në të është parë hëna e re, kjo nuk është obligative për të tjerët. Neveviu në komentimin e *Sahihut* të Muslimit thotë: “Sipas mendimit tonë, qëndrimi i drejtë është i atyre, të cilët thonë, se të vështruarit e hënës së re, në ndonjë vend, nuk është obligative për të gjitha vendet. Të shikuarit e saj është obligative vetëm për fqinjët e saj, të cilët nga vendi përkatës nuk janë me distancë më të largët se distanca e cila e arsyeton shkurtimin e namazeve për udhëtarin. Malikitë konsiderojnë, që të shikuarit e hënës së re, në cilin do vend, është obligative për të gjitha vendet e botës. Ibn Abdul-Ber thekson se, përkundër qëndrimit të Malikive, është arritur koncenzi në mes dijetarëve, të cilët konsiderojnë, se të shikuarit e hënës së re, në ndonjë vend nuk i obligon të tjerët, por që çdo fillim dhe mbarim i ramazanit vërtetohet në bazë të vështrimit personal të hënës së re.

⁷⁰³ E ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

⁷⁰⁴ Hadithi i përmendur, tregon, se është mustehab, që ai i cili ka hurme, të bëjë iftar me hurme. Nëse nuk ka hurme, atëherë është më së miri që iftari të bëhet me ujë të pastër. Nga hadithet, të cilat i transmeton Enes b.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Selman b. Amiri. Nuk na është e njohur, që ndokush tjetër hadithin e Enesi nga Shu’be, e ka transmetuar në mënyrë të ngjashme, përveç Seid b. Amir. Ky hadith nuk është mbajtur në mend mirë,⁷⁰⁵ por, nuk e kemi të njohur që ka bazë në hadithin, të cilin e transmeton Abdulaziz b. Suhejbi nga Enesi. Nxënësit e Shu’bes, këtë hadith e transmetojnë nga Shu’be, ai nga Asim el-Ahveli, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabeja, ajo nga Selman b. Amiri, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Kjo është më e besueshme, sesa hadithi të cilin e transmeton Seid b. Amiri. Mu ashtu, e kanë transmetuar nga Shu’be, ai nga Asimi, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Selman b. Amiri, por në senedin e tij, nuk e kanë përmendur: ‘Nga Rebabeja.’ Ndërkaq, është e besueshme ajo, që e kanë transmetuar Sufjan eth-Thevriu, Ibn Ujejne dhe shumë të tjerë, nga Asim el-Ahveli, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabeja, ndërsa, ai nga Selman b. Amiri. Ibn Avni, thotë: ‘Nga Ummu Raih, vajza e Sulejhës, e ai nga Seman b. Amiri. Rebabeja është Ummu Raih.’”⁷⁰⁶

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَمْرِو بْنِ عَلِيٍّ الْمُقَدَّمِيُّ، حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ عَامِرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ صُهَيْبٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ وَجَدَ تَمْرًا فَلْيَفْطِرْ عَلَيْهِ وَمَنْ لَا فَلْيَفْطِرْ عَلَى مَاءٍ فَإِنَّ الْمَاءَ طَهُورٌ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَنَسٍ لَا نَعْلَمُ أَحَدًا رَوَاهُ عَنْ شُعْبَةَ مِثْلَ هَذَا غَيْرَ سَعِيدِ بْنِ عَامِرٍ وَهُوَ حَدِيثٌ غَيْرُ مَحْفُوظٍ وَلَا نَعْلَمُ لَهُ أَصْلًا مِنْ حَدِيثِ عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ صُهَيْبٍ عَنْ أَنَسٍ . وَقَدْ رَوَى أَصْحَابُ شُعْبَةَ هَذَا الْحَدِيثِ عَنْ شُعْبَةَ عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنْ الرَّبَابِ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ وَهُوَ أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ سَعِيدِ بْنِ عَامِرٍ . وَهَكَذَا رَوَوْا عَنْ شُعْبَةَ عَنْ عَاصِمِ بْنِ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنْ سَلْمَانَ وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ شُعْبَةَ عَنِ الرَّبَابِ . وَالصَّحِيحُ مَا رَوَاهُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَابْنُ عُيَيْنَةَ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ عَنِ الرَّبَابِ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ . وَابْنُ عُيَيْنَةَ يَقُولُ عَنْ أُمِّ الرَّائِحِ بِنْتِ صُلَيْعٍ عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ . وَالرَّيَابُ هِيَ أُمُّ الرَّائِحِ .

694. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, atë Sufjani, duke transmetuar nga Asim el-Ahveli, atij i ka treguar Hennadi, atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga Asim el-Ahveli, ai nga Hafsa, vajza e Sirinit, ajo nga Rebabeja, ajo nga Selman b. Amir ed-Dabbijj – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur ndokush nga ju dëshiron të bëjë iftar, le të bëjë iftar me hurme. Nëse nuk e gjen atë, atëherë, le të bëjë iftar me ujë, sepse ai me të vërtetë është i pastër.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، ح وَحَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، . وَحَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، قَالَ أَنَبَأَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، عَنْ حَفْصَةَ بِنْتِ سِيرِينَ، عَنِ الرَّبَابِ، عَنْ سَلْمَانَ بْنِ عَامِرٍ الصَّنَبِيِّ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا أَفْطَرَ أَحَدُكُمْ فَلْيَفْطِرْ عَلَى تَمْرٍ " . زَادَ ابْنُ عُيَيْنَةَ " فَإِنَّهُ بَرَكَةٌ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَلْيَفْطِرْ عَلَى مَاءٍ فَإِنَّهُ طَهُورٌ " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

695. Na ka treguar Muhammed b. Rafiu – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Xha’fer b. Sulejmani, ai ka transmetuar nga Thabiti – që Enes b. Maliku, ka thënë: “I Dërguari i Allahut bënte iftarë me hurme të pjekura, të freskëta para se ta falte (akshamin).⁷⁰⁷ Nëse të tilla nuk kishte, atëherë me hurme

Maliku, shihet se më së miri është të bëhet iftari me hurme të freskëta. Nëse nuk ka hurme të freskëta, atëherë me hurme të thara. Nëse nuk ka as hurme të thara, atëherë është më së miri të bëhet iftar me ujë.

⁷⁰⁵ Konsiderohet që ky hadith nuk është mbajtur në mend mirë, sepse atë, vetëm Sejid b. Amir e ka transmetuar nga Shu’be. Ai nga Abdulaziz b. Suhejbi, e ai nga Enesi, derisa përkrah tyre e kanë transmetuar të gjithë nxënësit e Shu’bes nga Shu’be, ai nga Asim el-Hadheli, ai nga Hafsa, e bija e Sirinit, e ai nga Selman b. Amiri. Gjithashtu, me sened të njëjtë, atë e kanë transmetuar nxënësit e Asim el-Hadhelit, në mesin e të cilëve janë: Sufjan eth-Thevriu, Sufjan b. Ujjejne dhe të tjerët.

⁷⁰⁶ Ummu Raih b. Sulejh dhe Rebaba, janë person i njëjtë. Emri i saj i plotë është Rebaba bint Sulejh ummu Raih el-Dabibijj el-Masrijje. Si ravi, dijetarët e hadithit e konsiderojnë të kënaqshëm. I takonte gjeneratës së tretë të transmetuesve të hadithit.

⁷⁰⁷ Ky hadith flet, që është mirë me nxitimin e iftarit, para se të falet namazi i akshamit. Ajo që Umeri dhe Uthmani e kanë pasur shprehur, që ndonjëherë, gjatë ramazanit, ta falnin së pari akshamin dhe pastaj, pas asaj, tanimë kur errësohej pak, bënin iftar, është vetëm argument, që është edhe ashtu e lejuar, që njerëzit të mos e kuptonin, që ngrënia e iftarit para akshamit, është obligim.

të pjekura të thara. Nëse as të atilla nuk kishte, atëherë i pinte disa gllënjka ujë.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen garib.”⁷⁰⁸

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ رَافِعٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا جَعْفَرُ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ ثَابِتٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ " كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَفْطِرُ قَبْلَ أَنْ يُصَلِّيَ عَلَى رُطَبَاتٍ فَإِنْ لَمْ تَكُنْ رُطَبَاتٍ فَتَمِيرَاتٍ فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَمِيرَاتٍ حَسَا حَسَوَاتٍ مِنْ مَاءٍ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ يُفْطِرُ فِي الشَّيْءِ عَلَى تَمَرَاتٍ وَفِي الصَّبْغِ عَلَى الْمَاءِ .

11. Bajrami i ramazanit është në atë ditë, kur ndalemi së agjëruari, ndërsa Kurban bajrami është në atë ditë kur therni kurbanin

باب مَا جَاءَ الصَّوْمَ يَوْمَ تَصُومُونَ وَالْفِطْرَ يَوْمَ تُفْطِرُونَ وَالْأَضْحَى يَوْمَ تُضْحُونَ

696. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili – atë e ka informuar Ibrahim b. Mundhiri, atë Is'hak b. Xha'fer b. Muhammedi, atij i ka treguar Abdullah b. Xha'feri, duke transmetuar nga Uthman b. Muhammedi, ai nga El-Makburiu, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ramazani fillon, atë ditë kur filloni të agjëron, Bajrami i ramazanit është atë ditë kur ndaleni së agjëruari, ndërsa Kurban bajrami është atë ditë kur therni kurbanin.”⁷⁰⁹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib-hasen. Disa dijetarë, këtë hadith e kanë komunikuar ashtu duke thënë që, te agjërimi dhe Bajrami duhet barazuar sipas xhematit dhe shumicës.”

أَخْبَرَنِي مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا إِبْرَاهِيمُ بْنُ الْمُنْذِرِ، حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ جَعْفَرِ بْنِ مُحَمَّدٍ، حَدَّثَنِي عَبْدُ اللَّهِ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنْ عُثْمَانَ بْنِ مُحَمَّدٍ الْأَخْنَسِيِّ، عَنْ سَعِيدِ الْمُقْبَرِيِّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " الصَّوْمُ يَوْمَ تَصُومُونَ وَالْفِطْرُ يَوْمَ تُفْطِرُونَ وَالْأَضْحَى يَوْمَ تُضْحُونَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَقَسَرَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ هَذَا الْحَدِيثَ فَقَالَ إِنَّمَا مَعْنَى هَذَا أَنَّ الصَّوْمَ وَالْفِطْرَ مَعَ الْجَمَاعَةِ وَغُظْمِ النَّاسِ .

12. Kur fillon nata dhe mbaron dita, agjëruesi mund të bëjë iftar

باب مَا جَاءَ إِذَا أَقْبَلَ اللَّيْلُ وَأَذْبَرَ النَّهَارَ فَقَدْ أَفْطَرَ الصَّائِمُ

697. Na ka treguar Harun b. Is'hak el-Hemmedani – atë e ka informuar Abde, duke transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, ai nga Asim b. Umeri, ai nga Umer b. Hattabi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur fillon nata e kalon dita dhe dielli perëndon, mund të bësh iftar.”

⁷⁰⁸ Këtë hadith, ed-Darekutni e konsideron sahih. E ka shënuar edhe Ebu Ja'la në *Musned* dhe atë në këtë formë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kishte dëshirë të bënte iftar me tri hurme, ose me diç që nuk ka qenë mbi zjarr.”

⁷⁰⁹ Ky hadith është argument, që në fillim dhe në fund të ramazanit duhet barazuar me shumicën. Nuk është e lejuar që individët vet të caktojnë fillimin dhe mbarimin e ramazanit, madje edhe nëse e shohin hënën e re. Muhammed b. Hasan esh-Shejbani, thotë: “Individi, te agjërimi dhe te haxhi, është i obliguar të veprojë me shumicën, madje edhe kur ajo është në kundërshtim me bindjen e tij. Hattabi konsideron, se nëse njerëzit do të përpiqeshin për ta parë hënën e re dhe nuk kanë mundësi për ta parë atë, deri pas tridhjetë ditëve të ramazanit dhe i agjërojnë tridhjetë ditë, ndërsa më vonë konstatohet, që ramazani ka zgjatur njëzet e nëntë ditë, ata nuk kanë mëkat, që kanë agjëruar ditën e Bajramit. Rast i njëjtë është edhe me haxhin. Nëse do t'u kishte kaluar Dita e A'rafatit (sepse në A'rafat kanë qëndruar një ditë më vonë), ata nuk do të ishin të obliguar ta përsërisin haxhin. Shumica e ulemasë konsideron, se ai që e sheh hënën e re, ai ka për të vepruar sipas bindjes personale. Ata, hadithin e përmendur e kuptojnë në kuptimin që pasuesit e islamit, në pikëpamje të agjërimit dhe haxhit, kanë për t'u ndarë në fraksione dhe kanë për të vepruar të kundërtën e asaj që e ka praktikuar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Disa, gjatë caktimit të fillimit të ramazanit dhe haxhit, kanë për t'ju mbajtur llogarive të veta personale, ndërsa të tjerët edhe agjërimin edhe A'rafatin kanë për ta filluar një ditë më herët. Në të gjitha, duhet vepruar ashtu siç vepron ehli-sunnet vel-xhemati.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Ebu Avfi dhe Ebu Seidi. Hadithi i Umerit është hasen-sahih.”⁷¹⁰

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَاصِمِ بْنِ عُمَرَ، عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا أَقْبَلَ اللَّيْلُ وَأَدْبَرَ النَّهَارُ وَعَابَتِ الشَّمْسُ فَقَدْ أَفْطَرْتُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ أَبِي أَوْفَى وَأَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عُمَرَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

13. Mbi të nxituarit me iftarin

698. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdiu, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Ebu Hazimi; ndërsa, na ka informuar edhe Mus’abi duke lexuar nga Malik b. Enesi, ai nga Ebu Hazimi, ai nga Sehl b. Sa’di – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Njerëzit kanë për të vepruar mirë, gjithnjë, derisa kanë për të nxituar me iftarin.”⁷¹¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Ibn Abbasi, Aishja dhe Enes b. Maliku. Hadithi i Sehl b. Sa’dit është hasen-sahih.”⁷¹² Ai e përmban qëndrimin, të cilin dijetarët nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, e kanë zgjedhur si të drejtë. Ata konsiderojnë, që është mustehab të nxituarit me iftarin. Ky është mendimi edhe i Shafiut, Ahmedit dhe i Is’hakut.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ أَبِي حَازِمٍ، ح قَالَ وَأَخْبَرَنَا أَبُو مُصْعَبٍ، قِرَاءَةً عَنْ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ، عَنْ أَبِي حَازِمٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا يَزَالُ النَّاسُ بِخَيْرٍ مَا عَجَّلُوا الْفِطْرَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَعَائِشَةَ وَأَنَسَ بْنِ مَالِكٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَهُوَ الَّذِي اخْتَارَهُ أَهْلُ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ اسْتَحَبُّوا تَعْجِيلَ الْفِطْرِ . وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

699. Na ka treguar Is’hak b. Musa el-Ensari – atë e ka informuar Velid b. Muslimi, duke transmetuar nga El-Evzaiu, ai nga Kurre, ai nga Ez-Zuhriu, ai nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Ebu Hurejre, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë, që Allahu i Lartësuar i Lartësuar ka thënë: “Për Mua robërit më të dashur janë ata robërit e Mi të cilët më së tepërmi nxitojnë me iftarin.”⁷¹³

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُوسَى الْأَنْصَارِيُّ، حَدَّثَنَا الْوَلِيدُ بْنُ مُسْلِمٍ، عَنْ الْأَوْزَاعِيِّ، عَنْ قُرَّةِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " قَالَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ أَحَبُّ عِبَادِي إِلَيَّ أَعَجَّلَهُمْ فِطْرًا " .

700. Na ka treguar Abdullah b. Abdurrahmani – atë e kanë informuar Ebu Asimi dhe Ebu Mugire, ata dytë kanë transmetuar nga El-Evzaiu – ngjashëm me hadithin e mëparshëm.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”⁷¹⁴

حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، أَخْبَرَنَا أَبُو عَاصِمٍ، وَأَبُو الْمُغِيرَةِ، عَنْ الْأَوْزَاعِيِّ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

⁷¹⁰ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁷¹¹ Është sunnet, që menjëherë pasi hyn koha e iftarit, të bëhet iftar, që të mos pritët me iftar, derisa të falet akshami. Ashtu ka vepruar, Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe shumica e as’habëve.

⁷¹² E kanë shënuar edhe Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁷¹³ Et-Tibi, konsideron, që shkaku për të cilin Allahu i Lartësuar i do ata që nxitojnë me iftarin, është ai, pse ata veprojnë sipas sunetit të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁷¹⁴ E kanë shënuar edhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, mandej Ibn Hibbani dhe Ibn Huzejme në *Sahihë*.

701. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Umer b. Umejri – që Ebu Atijje, ka thënë: “Hymë unë dhe Mesruku te Aishja dhe thamë: ‘O nëna e besimtarëve, dy as’hab të Muhammedit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), veprojnë ndryshëm. Njëri nxiton me iftar, por nxiton edhe me namaz, derisa tjetri e vonon iftarin, por e vonon edhe namazin?’ ‘Cili nga ata të dy nxiton me iftar dhe me namaz?’ – pyeti ajo. ‘Abdullah b. Mes’udi.’ – thamë ne; e ajo në atë tha: ‘Ashtu bente i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).’ I dyti prej tyre ishte Ebu Musai.”⁷¹⁵ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁷¹⁶ Emri i Ebu Atijjes është Malik b. Ebu Amir el-Hemdani, por është thënë edhe Malik b. Amir el-Hemdani, dhe kjo është më e drejtë.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ عُمَارَةَ بْنِ عُمَيْرٍ، عَنْ أَبِي عَطِيَّةٍ، قَالَ دَخَلْتُ أَنَا وَمَسْرُوقٌ، عَلَى عَائِشَةَ فَقُلْنَا يَا أُمَّ الْمُؤْمِنِينَ رَجُلَانِ مِنَ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ أَحَدُهُمَا يُعَجِّلُ الْإِفْطَارَ وَيُعَجِّلُ الصَّلَاةَ وَالْآخَرُ يُؤَخِّرُ الْإِفْطَارَ وَيُؤَخِّرُ الصَّلَاةَ. قَالَتْ أَيُّهُمَا يُعَجِّلُ الْإِفْطَارَ وَيُعَجِّلُ الصَّلَاةَ قُلْنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ مَسْعُودٍ. قَالَتْ هَكَذَا صَنَعَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ. وَالْآخَرُ أَبُو مُوسَى. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَأَبُو عَطِيَّةٍ اسْمُهُ مَالِكُ بْنُ أَبِي عَامِرٍ الْهَمْدَانِيُّ وَيُقَالُ مَالِكُ بْنُ عَامِرٍ الْهَمْدَانِيُّ وَابْنُ عَامِرٍ أَصَحُّ.

14. Mbi pezullimin (shtyerjen) e syfyrit (deri para agimit)

باب مَا جَاءَ فِي تَأْخِيرِ السُّحُورِ

702. Na ka treguar Jahja b. Musa Ebu Davud et-Tajalisi – atë e ka informuar Hisham ed-Destevai, ai ka transmetuar nga Katade, ai nga Enesi – që Zejd b. Thabiti ka thënë: “Hëngrëm syfyri me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), pastaj shkuam për ta falur namazin (e sabahut).’ ‘Thash’ - tha Enesi: ‘E sa kohë do të kishim prituri nga syfyri deri te namazi?’⁷¹⁷ Ai tha: ‘Aq sa do të ishin recituar pesëdhjetë ajete.’”⁷¹⁸

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ الطَّيَالِسِيُّ، حَدَّثَنَا هِشَامُ الدَّسْتَوَائِيُّ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ، قَالَ تَسَحَّرْنَا مَعَ النَّبِيِّ ﷺ ثُمَّ قُمْنَا إِلَى الصَّلَاةِ. قَالَ قُلْتُ كَمْ كَانَ قَدْرُ ذَلِكَ قَالَ قَدْرُ خَمْسِينَ آيَةً.

703. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Hishami – ngjashëm me hadithin e mëparshëm, përveç se, që Zejd b. Thabiti, në të ka thënë: “Aq sa do të mund të recitoheshin pesëdhjetë ajete.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Hudhejfe. Hadithi i Zejd b. Thabitit është hasen-sahih.”⁷¹⁹ Në pajtim me të janë edhe qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe i Is’hakut, të cilët konsiderojnë, që është mustehab shtyrja (pezullimi) e syfyrit (deri para agimit).”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ هِشَامٍ، بِخَوَرِهِ إِلَّا أَنَّهُ قَالَ قَدْرُ قِرَاءَةِ خَمْسِينَ آيَةً. قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عِيسَى حَدِيثُ زَيْدِ بْنِ ثَابِتٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَبِهِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ اسْتَحَبُّوا تَأْخِيرَ السُّحُورِ.

⁷¹⁵ Abdullah b. Mes’udi ka vepruar në këtë mënyrë, sepse ajo është në pajtim me sunnetin, derisa Ebu Musa, ka vepruar ndryshe, që të tregonte që edhe ajo është e lejuar.

⁷¹⁶ E ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

⁷¹⁷ Në transmetimi e Buhariut, të këtij hadithi: “E sa kohë do t’u kalonte nga (përfundimi i ushqimit) syfyri deri te ezani?”

⁷¹⁸ Ibn Haxheri, thotë: “Sa ajete kur’anore do të mund të lexoheshin ngadalë, pa u nxituar, pesëdhjetë ajete mesatare nga kur’ani – as shumë të gjatë, e as shumë të shkurtë.”

⁷¹⁹ E shënon Buhariu në *Sahih*.

15. Mbi të dalluarit e agimit

باب مَا جَاءَ فِي بَيَانِ الْفَجْرِ

704. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Mulazim b. Amri,⁷²⁰ atij i ka treguar Abdullah b. Nu'mani,⁷²¹ duke transmetuar nga Kajs b. Talk b. Aliu, atij i ka treguar babai i tij Talk b. Aliu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Hani dhe pini dhe mos u shqetësoni për shkak të agimit. Hani dhe pini, gjithnjë, derisa nuk shfaqet të kuqërremtit e agimit (në qiell).”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Adijj b. Hatimi, Ebu Dherre dhe Semure. Hadithi i Talk b. Aliut, në këtë formë, është hasen-garib. Në pajtim me të kanë vepruar dijetarët. Ata konsiderojnë, që agjëruesit i ndalohet ushqimi dhe pija, deri te shfaqja e të kuqërremtit e agimit. Ky është qëndrimi gjeneral i dijetarëve.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا مُلَازِمُ بْنُ عَمْرٍو، حَدَّثَنِي عَبْدُ اللَّهِ بْنُ النُّعْمَانِ، عَنْ قَيْسِ بْنِ طَلْقٍ، حَدَّثَنِي أَبِي طَلْقُ بْنُ عَلِيٍّ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " كُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا يَهْدِنَا السَّاطِعُ الْمُصْعِدُ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّى يَغْتَرِضَ لَكُمْ الْأَحْمَرُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَدِيِّ بْنِ حَاتِمٍ وَأَبِي دَرٍّ وَسَمُرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ طَلْقِ بْنِ عَلِيٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنَّهُ لَا يَحْرُمُ عَلَى الصَّائِمِ الْأَكْلُ وَالشَّرْبُ حَتَّى يَكُونَ الْفَجْرُ الْأَحْمَرُ الْمُعْتَرِضُ . وَبِهِ يَقُولُ عَامَّةُ أَهْلِ الْعِلْمِ .

705. Na kanë treguar, Hennadi dhe Jusuf b. Isa – ata i ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Ebu Hilali, ai nga Sevad b. Handhale – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos e ndërpritni për shkak të ezanit të Bilalit, e as për shkak të agimit, por ndërpritni atë kur e vëreni të kuqërremtit në sfond.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، وَيُوسُفُ بْنُ عِيسَى، قَالَا حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ أَبِي هِلَالٍ، عَنْ سَوَادَةَ بْنِ حَنْظَلَةَ، هُوَ الْقُسَيْرِيُّ عَنْ سَمُرَةَ بْنِ جُنْدَبٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا يَمْنَعَنَّكُمْ مِنْ سُحُورِكُمْ أَذَانُ بِلَالٍ وَلَا الْفَجْرُ الْمُسْتَطِيلُ وَلَكِنَّ الْفَجْرَ الْمُسْتَطِيرَ فِي الْأَفْقِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ .

16. Paralajmërim i rrept agjëruesit për shpifjet – përgojimet

باب مَا جَاءَ فِي التَّشْدِيدِ فِي الْغَيْبَةِ لِلصَّائِمِ

706. Na ka treguar Ebu Musa Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Uthman b. Umeri, atij i ka treguar Ibn Ebu Zi'bi, duke transmetuar nga Seid el-Mekburi, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ai i cili nuk e lë shpifjen (përgojimin) dhe të vepruarit sipas saj, nuk ka nevojë as për shkak të Allahut ta lë ushqimin dhe pijen.”⁷²² Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Enesi. Ky hadith është hasen-sahih.”⁷²³

⁷²⁰ Muladhim b. Amr b. Abdullah b. Bedr Ebu Amr el-Jemani, është transmetues i sinqertë. I takonte gjeneratës së tetë të ravive.

⁷²¹ Abdullah b. Nu'man es-Suhejmi el-Jemani, atë e ka shënuar si makbul (të kënaqshëm). I takonte gjeneratës së gjashtë të ravive. Ibn Hibbani e konsideron transmetues të besueshëm.

⁷²² Edhe pse, në tekstin e hadithit, fjalë për fjalë, qëndron: “Kush nuk e lë gënjeshtren”, Tirmidhiu këtë kapitull e ka quajtur si: *Paralajmërim i rrept për agjëruesin mbi bartjen e fjalëve*. Edhe dijetarët e tjerë, në mënyrë të njëjtë e kanë quajtur këtë kapitull. Sipas fjalëve të Irakit, ata bënin ashtu, sepse nga fjalët *kavledh-dhuri* kanë kuptuar që duhet ruajtur, në përgjithësi, nga të gjitha llojet e fjalëve të këqija.

⁷²³ E shënojnë të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Muslimit dhe Nesaiut.

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا عُثْمَانُ بْنُ عُفَيْرٍ، أَخْبَرَنَا ابْنُ أَبِي ذُنُبٍ، عَنْ سَعِيدِ الْمُقْبِرِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ بَأَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

17. Mbi vlerat e syfyrit

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ السُّحُورِ

707. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avani, duke transmetuar nga Katade dhe Abdulaziz b. Suhejbi, ata dytë nga Enes b. Maliku – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Hani (në ramazan) para agimit, sepse bereqeti është në syfyr.”⁷²⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Abdullah b. Mes’udi, Xhabir b. Abdullahu, Ibn Abbasi, Amr b. Asi, Irbad b. Sariju, Utbe b. Abdi dhe Ebu Derda. Hadithi i Enesit është hasen-sahih.”

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dallimi në mes agjërimit tonë dhe agjërimit të pasuesve të librave të tjerë, është në të ngrënit para agimit.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ قَتَادَةَ، وَعَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ صُهَيْبٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " تَسَحَّرُوا فَإِنَّ فِي السُّحُورِ بَرَكَهٌ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَعَمْرُو بْنُ الْعَاصِ وَالْعَرَبِيَّ بْنَ سَارِيَةَ وَعُثْبَةَ بْنَ عَدٍ وَأَبِي الدَّرْدَاءِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

وَرُويَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " فَضْلٌ مَا بَيْنَ صِيَامِنَا وَصِيَامِ أَهْلِ الْكِتَابِ أَكْلَةُ السَّحَرِ " .

708. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejthi, duke transmetuar nga Musa b. Aliu, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Kajsi, të mbrojturit e Amr b. Asit, ai nga Amr b. Asi, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) - mbi atë. Tirmidhiu thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁷²⁵ Dijetarët e Egjiptit thonë: “Musa b. Ali.” Ndërsa dijetarët e Irakut thonë: “Musa b. Ulejje b. Rebah el-Lahmi.”⁷²⁶

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ قُتَيْبَةُ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ عَنْ مُوسَى بْنِ عَلِيٍّ عَنْ أَبِيهِ عَنْ أَبِي قَيْسٍ مَوْلَى عَمْرِو بْنِ الْعَاصِ عَنْ عَمْرِو بْنِ الْعَاصِ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ بِذَلِكَ . قَالَ وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَهْلُ مِصْرَ يَقُولُونَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ وَأَهْلُ الْعِرَاقِ يَقُولُونَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ وَهُوَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ بْنِ رَبَاحٍ اللَّحْمِيُّ .

⁷²⁴ Sipas qëndrimit të njëzëshëm të dijetarëve, është mendub, ngrënia ose pirja e diçkaje gjatë ramazanit, para sabahut, madje, në qoftë se ajo është edhe një hurme – siç qëndron në hadithin, të cilin Ibn Hibbani e konsideron sahih – ose një kafshatë ushqim – siç qëndron në hadithin, të cilin e shënon Sejjid b. Mensuri – ose madje një gllënjë ujë – siç qëndron në hadithin, të cilin e shënon Ahmed b. Hanbeli në *Musned*.

⁷²⁵ E shënon Muslimi në *Sahih*.

⁷²⁶ Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, e drejtë është që, ky ravi është quajtur Musa b. Ali b. Rebah el-Lahmi Ebu Abdurrahman el-Basri. Ai është ravi i sinqertë, me atë, që ndonjëherë është i prirë për gabime gjatë transmetimit. I ka takuar gjeneratës së shtatë të transmetuesve të hadithit.

18. Është i qortuar agjërimi gjatë udhëtimit

بَاب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الصَّوْمِ فِي السَّفَرِ

709. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi, ai nga babai i vet – që Xhafer b. Muhammedi, ai nga babai i vet - që Xhabir b. Abdullahu, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në vitin e Çlirimit të Mekës,⁷²⁷ është nisur në Mekke. Gjatë udhëtimit, agjëronte. Me të agjëronin edhe njerëzit e tjerë, gjithnjë, derisa nuk arritën në (luginën) Kuraul-Gamim. Atëherë, dikush tha: ‘Njerëzit shumë vështirë pe përballojnë agjërimin, por janë duke shikuar se çfarë ti je duke bërë.’ Duke e dëgjuar këtë, ai pas ikindisë, e kërkoi një enë me ujë dhe e piu. Pinë edhe disa njerëz të tjerë, derisa të tjerët vazhduan të agjëronin. Kur ishte informuar mbi atë (që disa njerëz ende janë duke agjëruar), ai tha: ‘Ata janë të padëgjueshmit!’”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ka’b b. Asimi, Ibn Abbasi dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Xhabirit është hasen-sahih.”⁷²⁸

Transmetohet, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Nuk konsiderohet bamirësi të agjëruarit gjatë udhëtimit.”

Dijetarët kanë divergjenca në pikëpamje të agjërimin gjatë udhëtimit.⁷²⁹ Disa, na gjenerata e as’habëve dhe të tjerëve, konsiderojnë, që gjatë udhëtimit është më mirë të mos agjërohet. Disa shkojnë aq larg, sa që thonë, që ai i cili agjëron gjatë udhëtimit, është i obliguar për t’i agjëruar ato ditë përsëri. Ahmed i dhe Is’haku (gjithashtu) mos-agjërimin me rastin e udhëtimit e konsiderojnë të drejtë. Dijetarët tjerët nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, konsiderojnë që, ata të cilët konsiderojnë që janë të fuqishëm, më mirë është të agjërojnë gjatë udhëtimit. Edhe nëse dikush nuk agjëron, edhe kjo është mirë. Ky është mendimi edhe i Sufjan eth-Thevriut, Maliku b. Enesit dhe Abdullah b. Mubarekut.

Shafi i thotë: “Fjalët e të Dërguarit: ‘Nuk llogaritet bamirësi agjërimi gjatë udhëtimit,’ si dhe ato që i ka thënë pasi që e kanë lajmëruar se disa njerëz ende agjërojnë: ‘Ata janë të padëgjueshmit!’ – ka të bëjnë me ata, zemrat e të cilëve nuk kanë mundur ta pranin lehtësimin të cilin Allahu i Madhërishëm ua ka dhënë. Megjithatë, ai i cili do të konsideronte se gjatë udhëtimit është i lejuar mos-agjërimi, por, pasi që ka fuqi për atë, agjëron – kjo edhe më shumë më jep kënaqësi.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ جَعْفَرِ بْنِ مُحَمَّدٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ خَرَجَ إِلَى مَكَّةَ عَامَ الْفَتْحِ فَصَامَ حَتَّى بَلَغَ كُرَاعَ الْعَمِيمِ وَصَامَ النَّاسُ مَعَهُ فَقِيلَ لَهُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ شَقَّ عَلَيْهِمُ الصِّيَامُ وَإِنَّ النَّاسَ يَنْظُرُونَ فِيَمَا فَعَلْتَ . فَدَعَا بِدَحْجٍ

⁷²⁷ Çlirimi i Mekës, ka qenë në vitin e 8 sipas hixhretit.

⁷²⁸ E shënon Muslimi në *Sahih*.

⁷²⁹ Transmetohet, që Umer b. Hattabi, Ibn Ummeri, Ebu Hurejre, Ez-Zuhri, Ibrahim en-Nehaiu dhe dijetarët tjerë, konsideronin se, nëse personi gjatë udhëtimit e agjëron agjërimin e obliguar, është i obliguar t’i kompensojë ato ditë, qëndrimin e këtyre e bazojnë në ajetin: “*(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (dëtor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.*” [El-Bekare: 184] dhe hadithin: “Nuk konsiderohet bamirësi, të agjëruarit gjatë udhëtimit.” Ky qëndrim është i dhahirive. Shumica e juristëve islam – në mesin e të cilëve është edhe Ebu Hanife, Maliku dhe Shafi i – konsiderojnë, se ai i cili mund ta përballojë dhe të cilin agjërimi nuk i paraqet vështirësi gjatë udhëtimit, është më mirë të agjëroj gjatë udhëtimit. Evzaiu, Ahmed i dhe Is’haku, konsiderojnë, që është më mirë të shërbehet me lehtësim dhe të mos agjëroj gjatë udhëtimit, por ato ditë t’i kompensojë më vonë. Disa thonë, se për personin është më mirë ajo që është më e lehtë. Nëse e ka më lehtë të agjëroj gjatë udhëtimit, sesa t’i kompensojë ditët, atëherë për te agjërimi është më i mirë gjatë udhëtimit. Ky është mendimi i Umer b. Abdulazizit.

مِنْ مَاءٍ بَعْدَ الْعَصْرِ فَشَرِبَ وَالنَّاسُ يَنْظُرُونَ إِلَيْهِ فَأَقْطَرَ بَعْضُهُمْ وَصَامَ بَعْضُهُمْ فَلَبَّغَهُ أَنَّ نَاسًا صَامُوا فَقَالَ "أُولَئِكَ الْغَصَاةُ". قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ كَعْبِ بْنِ عَاصِمٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ جَابِرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَقَدْ رَوَى عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ قَالَ "لَيْسَ مِنَ الْبِرِّ الصِّيَامُ فِي السَّفَرِ". وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الصَّوْمِ فِي السَّفَرِ فَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ الْفِطْرَ فِي السَّفَرِ أَفْضَلُ حَتَّى رَأَى بَعْضُهُمْ عَلَيْهِ الْإِعَادَةُ إِذَا صَامَ فِي السَّفَرِ. وَاخْتَارَ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ الْفِطْرَ فِي السَّفَرِ. وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِنَّ وَجَدَ قُوَّةَ فَصَامَ فَحَسَنٌ وَهُوَ أَفْضَلُ وَإِنْ أَفْطَرَ فَحَسَنٌ. وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَمَالِكِ بْنِ أَنَسٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْمُبَارَكِ. وَقَالَ الشَّافِعِيُّ وَإِنَّمَا مَعْنَى قَوْلِ النَّبِيِّ ﷺ "لَيْسَ مِنَ الْبِرِّ الصِّيَامُ فِي السَّفَرِ". وَقَوْلُهُ جِبِينَ بَلَّغَهُ أَنَّ نَاسًا صَامُوا فَقَالَ "أُولَئِكَ الْغَصَاةُ". فَوَجَّهَ هَذَا إِذَا لَمْ يَحْتَمِلْ قَلْبُهُ قَبُولَ رُخْصَةِ اللَّهِ فَأَمَّا مَنْ رَأَى الْفِطْرَ مُبَاحًا وَصَامَ وَقَوِيَ عَلَى ذَلِكَ فَهُوَ أَعْجَبُ إِلَيَّ.

19. Mbi lejen për të agjëruar gjatë udhëtimit

باب مَا جَاءَ مِنَ الرُّخْصَةِ فِي الصَّوْمِ فِي السَّفَرِ

710. Na ka treguar Harun b. Is'hak el-Hemdani – atë e ka informuar Abd b. Sulejmani, duke transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, e ai nga Aishja – që Hamza b. Amër el-Eslemi, i cili shumë agjëronte, e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi agjërimin gjatë udhëtimit, e i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nëse dëshiron të agjërosh, ti agjëro. Por nëse nuk dëshiron ti (atëherë) ndërprite.”⁷³⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Enes b. Maliku, Ebu Seidi, Abdullah b. Mes’udi, Abdullah b. Amëri, Ebu Derda dhe Hamza b. Amër el-Eslemi. Hadithi i Aishes, mbi atë që Hamza b. Amër el-Eslemi e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është hasen - sahih.”⁷³¹

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدَةُ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ حُمْرَةَ بْنَ عَمْرِو الْأَسْلَمِيَّ، سَأَلَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنِ الصَّوْمِ فِي السَّفَرِ وَكَانَ يَسْرُدُ الصَّوْمَ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ "إِنْ شِئْتَ فَصُمْ وَإِنْ شِئْتَ فَأَقْطِرْ". قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ وَأَبِي سَعِيدٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَأَبِي الدَّرْدَاءِ وَحُمْرَةَ بْنَ عَمْرِو الْأَسْلَمِيَّ. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ أَنَّ حُمْرَةَ بْنَ عَمْرِو سَأَلَ النَّبِيَّ ﷺ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ.

711. Na ka treguar Nasër b. Ali el-Xhehdami – atë e ka informuar Bishr b. Mufeddali, duke transmetuar nga Seid b. Jezid Ebu Mesleme, ai nga Ebu Nadrei – që Ebu Seidi, ka thënë: “Ne, gjatë ramazanit udhëtonim (shpesh) me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Kurrë nuk ka ndodhur, ta këtë qortuar agjëruesin përse agjëron apo atë që e ka ndërprerë agjërimin, përse e ka ndërprerë.” Ebu Isa, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ الْجَهْضَمِيُّ، حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ الْمُفَضَّلِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ يَزِيدَ أَبِي مَسْلَمَةَ، عَنْ أَبِي نَضْرَةَ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ كُنَّا نَسَافِرُ مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي رَمَضَانَ فَمَا يَعِيبُ عَلَى الصَّائِمِ صَوْمَهُ وَلَا عَلَى الْمُفْطِرِ إِفْطَارَهُ. قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ.

712. Na ka treguar Nasër b. Aliu – atë e ka informuar Jezid b. Zureji, atë El-Xhurejxhi; ndërsa na ka informuar Sufjan b. Vekiu, atë Abdul-Ala, duke transmetuar nga El-Xhurejriu; e ai nga Ebu Nadri – që Ebu Seid el-Hudriu, ka thënë: “Ne udhëtonim me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe, ndonjëri nga ne agjëronte, e ndonjëri nuk agjëronte. Dhe as mos agjëruesi

⁷³⁰ Në transmetimin e këtij hadithi nga Muslimi, qëndron, se Hamza b. Amër el-Esleme, ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, unë agjëroj shumë – andaj a kam për të agjëruar gjatë udhëtimit?” Ibn Haxheri, thotë, se nga ky hadith të cilin e shënon Ebu Davudi në *Sunen*, e i cili është i besueshëm, mund të konkludohet se ai e ka pyetur mbi agjërimin e ramazanit gjatë udhëtimit. Neveviu konsideron, se nga hadithi i cekur, mund të konkludohet se gjatë udhëtimit është i lejuar edhe agjërimi edhe mosagjërimi.

⁷³¹ Është shënuar, në *El-Kutubus-sitte*.

nuk e qortonte agjëruesin (për atë), e as agjëruesi nuk e qortonte mos agjëruesin. Thjesht, konsideronin, që për atë i cili ka fuqi për të agjëruar, ajo është e mirë, ndërsa edhe për atë i cili ndjenë dobësi dhe e ndërprente, gjithashtu është mirë.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen - shih.”⁷³²

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، حَدَّثَنَا الْجَرِيرِيُّ، ح قَالَ وَحَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ وَكِيعٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْأَعْلَى بْنُ عَبْدِ الْأَعْلَى، عَنْ الْجَرِيرِيِّ، عَنْ أَبِي ثُنَيْسَةَ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ كُنَّا نُسَافِرُ مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَمِنَّا الصَّائِمُ وَمِنَّا الْمُفْطِرُ فَلَا يَجِدُ الْمُفْطِرُ عَلَى الصَّائِمِ وَلَا الصَّائِمُ عَلَى الْمُفْطِرِ فَكَانُوا يَزُورُونَ أَنَّهُ مَنْ وَجَدَ قُوَّةَ فَصَامَ فَحَسَنَ وَمَنْ وَجَدَ ضَعْفًا فَأَفْطَرَ فَحَسَنَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

20. Mbi privilegjin për mos-agjërimitin e luftëtarit

باب مَا جَاءَ فِي الرُّخْصَةِ لِلْمُحَارِبِ فِي الْإِفْطَارِ

713. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ibn Lehi, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Habibi – që Ma'mer b. Ebu Hurejre, e ka pyetur Ibn Musejjebin mbi agjërimitin gjatë udhëtimit dhe ky ka treguar, që Umer b. Hattabi, ka thënë: “Ne, gjatë muajit të ramazanit, kemi marr pjesë në dy beteja me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): Në Betejën e Bedrit dhe në Ekspeditën për çlirimin e Mekës. Në të dy betejat kemi ngrënë.”

Ebu Isai thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar edhe nga Ebu Seidi. Hadithi i Umerit na është i njohur vetëm në këtë formë.”⁷³³

Ebu Seidi transmeton, që gjatë një beteje në të cilën edhe vet ka marr pjesë, i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) i ka urdhëruar (luftëtarët) që ta prishin agjërimitin.⁷³⁴ Ngjashëm me këtë, është transmetuar nga Umer b. Hattabi. Ai i ka urdhëruar luftëtarët, që ta prishin agjërimitin gjatë përlëshjes me armikun. Në pajtim me këtë, është edhe qëndrimi i disa dijetarëve.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا ابْنُ لَهْيَعَةَ، عَنْ يَزِيدَ بْنِ أَبِي حَبِيبٍ، عَنْ مَعْمَرِ بْنِ أَبِي حَبِيبَةَ، عَنْ ابْنِ الْمُسَيَّبِ، أَنَّهُ سَأَلَهُ عَنِ الصَّوْمِ، فِي السَّفَرِ فَحَدَّثَ أَنَّ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ قَالَ غَزَوْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فِي رَمَضَانَ غَزَوَيْنِ يَوْمَ بَدْرٍ وَالْفَتْحِ فَأَفْطَرْنَا فِيهِمَا . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عُمَرَ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ أَمَرَ بِالْفِطْرِ فِي غَزْوَةِ غَزَاهَا . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ نَحْوُ هَذَا أَنَّهُ رَخَّصَ فِي الْإِفْطَارِ عِنْدَ لِقَاءِ الْعَدُوِّ وَبِهِ يَقُولُ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ .

21. Mbi favorizimin e shtatzënave dhe gji-dhënëseve për të mos agjëruar (gjatë ramazanit)

باب مَا جَاءَ فِي الرُّخْصَةِ فِي الْإِفْطَارِ لِلْحَبْلِئِي وَالْمَرْضِعِ

714. Na kanë treguar, Ebu Kurejbi dhe Jusuf b. Isai – ata i ka informuar Vekiu, atë e ka informuar Ebu Hilali, duke transmetuar nga Abdullah b. Sevadi – që Enes b. Maliku, pasardhësi i Abdullah b.

⁷³² E ka shënuar edhe Muslimi në *Sahih*.

⁷³³ Në senedin e këtij hadithi, Ibn Lejhi, sipas vlerësimit të dijetarëve të hadithit, është ravi i dobët. Ndërkaq, këtë hadith e fuqizon transmetuesi vijues i Muslimit nga Ebu Seidi.

⁷³⁴ Muslimi në *Sahih*, shënon nga Ebu Seid el-Hudriu, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Ju jeni duke iu afruar armikut, prandaj për ju është më mirë që (të hani) ta prishni agjërimitin.” Disa – thotë Ebu sendi – me atë rast e kanë prishur agjërimitin, ndërsa disa e kanë vazhduar agjërimitin. Mandej vazhduam me udhëtimin. Kur përsëri u ndalëm për të pushuar, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tha: “Së shpejti kemi për t’u përlëshur me armikun. Për ju, është më mirë ta prishni agjërimitin, andaj prisheni atë.” Atëherë, të gjithë e prishën agjërimitin.”

Ka'bit,⁷³⁵ ka thënë: “Na sulmuan kalorësit e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), unë shkova tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe e takova atë pranë ushqimit. Duke më parë, ai tha: ‘Afrohu dhe ha.’ ‘Unë jam duke agjëruar’- u përgjigja, ai në atë më tha: ‘Afrohu, të tregoj mbi agjërimin (ose mbi abstenimin)! Allahu i Lartësuar e ka liruar udhëtarin nga agjërimi dhe gjysmë namazi,⁷³⁶ ndërsa shtatzënë ose gjidhënësen nga agjërimi (apo abstenimi).’⁷³⁷ Pasha Allahun, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka përmendur të dyja ose (ka thënë) njëren prej atyre dyjave.⁷³⁸ O, sa rëndë më vjen në shpirt (edhe sot e kësaj dite), që atëherë nuk kam ngrënë ushqimin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)!”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Umejje. Hadithi i Enes b. Malik el-Ka'bit, është hasen.⁷³⁹ Nuk na është e njohur, që ky Enes b. Maliku, ka transmetuar edhe diç, përveç këtij hadithi të vetëm, nga i Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Në pajtim me këtë është edhe qëndrimi i disa dijetarëve.”

Disa, dijetarë, thonë: “Shtatzëna dhe gjidhënësa, kanë për të ngrënë (gjatë ramazanit), mandej, (për çdo ditë të pa agjëruar) kanë për ta ushqyer (një të varfër).” Këto janë qëndrimet e Sufjanit, Malikut, Shafiut dhe të Ahmedit.

Por, disa, nga dijetarët, thonë: “Ato dyja kanë për të ngrënë (gjatë ramazanit), ndërsa pastaj (për çdo ditë të pa agjëruar) kanë për ta ushqyer nga një të varfër, por nuk janë të obliguara për t'i agjëruar (ato ditë). Por, nëse do të kenë dëshirë për të agjëruar, atëherë nuk janë të obliguara për ta ushqyer (të varfrin).” Ky është qëndrimi i Is'hakut.

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، وَيُوسُفُ بْنُ عِيسَى، قَالَ حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا أَبُو هِلَالٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ سَوَادَةَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، رَجُلٌ مِنْ بَنِي عَبْدِ اللَّهِ بْنِ كَعْبٍ قَالَ أَغَارَتْ عَلَيْنَا خَيْلُ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَأَتَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ فَوَجَدْتُهُ يَتَعَدَّى فَقَالَ " اذْنُ فُكُلٍ " . فَقُلْتُ إِنِّي صَائِمٌ . فَقَالَ " اذْنُ أَحَدَيْكَ عَنِ الصَّوْمِ أَوْ الصَّيَامِ إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى وَضَعَ عَنِ الْمُسَافِرِ الصَّوْمَ وَشَطْرَ الصَّلَاةِ وَعَنِ الْحَامِلِ أَوْ الْمَرْضِعِ الصَّوْمَ أَوْ الصَّيَامِ " . وَاللَّهُ لَقَدْ قَالَهُمَا النَّبِيُّ ﷺ كِلْتَاهُمَا أَوْ إِحْدَاهُمَا فَيَا لَهْفٍ نَفْسِي أَنْ لَا أَكُونَ طِعْمَتْ مِنْ طَعَامِ النَّبِيِّ ﷺ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي أُمَيَّةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ الْكَعْبِيُّ حَدِيثٌ حَسَنٌ وَلَا نَعْرِفُ لِأَنَسِ بْنِ مَالِكٍ هَذَا عَنِ النَّبِيِّ ﷺ غَيْرَ هَذَا الْحَدِيثِ الْوَاحِدِ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ . وَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ الْحَامِلُ وَالْمَرْضِعُ يُفْطِرَانِ وَتَقْضِيَانِ وَطُعْمَانِ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ وَمَالِكٌ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ يُفْطِرَانِ وَطُعْمَانِ وَلَا قَضَاءَ عَلَيْهِمَا وَإِنْ شَاءَتَا قَضَيْنَا وَلَا إِطْعَامَ عَلَيْهِمَا . وَبِهِ يَقُولُ إِسْحَاقُ .

⁷³⁵ Këtu, ka të bëjë, me Enes b. Malikun, i cili i shërbente të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Fjala është, krejtësisht për as'habin tjetër, i cili është pasardhës i Abdullahu b. Ka'bit. Ka'bi i ka pasur dy djem, Abdullahun dhe Kurejshin. Abdullahu, është gjyshi i Enesit. Kur kalorësit e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e kanë sulmuar fisin e tij, Enesi atëherë, ishte musliman. Prandaj, ai shkon te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), për ta lutur që ta ndërpres sulmin.

⁷³⁶ Musafiri është i lejuar nga gjysmë namazi, ashtu që farzet katër trekatëshe i falë vetëm nga dy.

⁷³⁷ Në hadithin, të cilin e shënon Buhariu në *Sunen*, qëndron kjo: “Allahu i Lartësuar, e ka liruar musafirin për gjysmë namazi, nga agjërimi si dhe shtatzënë dhe gjidhënësen.”

⁷³⁸ Këtu, ka të bëjë, me dilemën e ndonjërit nga ravitë, i cili nuk është i sigurt, se a e ka përmendur Maliku b. Enesin edhe shtatzënë, edhe gjidhënësen, apo e ka përmendur vetëm njëren prej tyre.

⁷³⁹ E shënojnë Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe, në *Sunen*.

22. Mbi agjërimin për të vdekurin

باب مَا جَاءَ فِي الصَّوْمِ عَنِ الْمَيِّتِ

715. Na ka treguar Ebu Seid el-Eshexhxi – atë e ka informuar Halid el-Ahmeri, ai ka transmetuar nga A'meshi, ai nga Seleme b. Kuhejli dhe Muslim El-Betini,⁷⁴⁰ ata dy nga Seid b. Xhubejri, Ata'i dhe Muxhahidi – që Ibn Abbasi, ka thënë: “Erdhi një grua⁷⁴¹ tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: ‘Motra ime ka vdekur, por ka mbetur borxh dy muaj agjërim?’ Ai tha: ‘Sikur motra jote ta kishte lënë ndonjë borxh, a do ta kishte kthyer ti atë për të?’ ‘Po.’ – tha ajo, ai në atë tha: ‘E drejta e Allahut është më e rëndësishme.’”⁷⁴²

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Burejde, Ibn Umeri dhe Aishja. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ الْأَشْجِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرُ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ سَلَمَةَ بْنِ كَهَيْلٍ، وَمُسْلِمِ بْنِ أَبِي بَكْرٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، وَعَطَاءٍ، وَمُجَاهِدٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ جَاءَتْ امْرَأَةٌ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَتْ إِنَّ أُخْتِي مَاتَتْ وَعَلَيْهَا صَوْمُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ . قَالَ " أَرَأَيْتَ لَوْ كَانَ عَلَى أُخْتِكَ دَيْنٌ أَكُنْتَ تَقْضِيهِ " . قَالَتْ نَعَمْ . قَالَ " فَحَقُّ اللَّهِ أَحَقُّ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ بُرَيْدَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَعَائِشَةَ .

716. Na ka treguar Ebu Kurejbe – atë e ka informuar Ebu Halid el-Ahmeri, ai ka transmetuar nga A'meshi, me këtë sened – ngjashëm me hadithin e mëparshëm. Muhammedi, thotë: “Edhe të tjerët, përveç Halid el-Ahmerit, kanë transmetuar nga A'meshi ngjashëm me transmetimin e Ebu Halidit.”

Ebu Isai, thotë: “Ebu Muaviu dhe shumë të tjerë, këtë hadith e kanë transmetuar nga A'meshi, ai nga Muslim el-Betini, ai nga Seid b. Xhubejri, ai nga Ibn Abbasi, e ai nga i Dërguari, (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), por nuk kanë përmendur nga Seleme b. Kuhejli, e as nuk kanë përmendur nga Ata'i, e as nga Muxhahidi.” Emri i Ebu Halidit ishte Sulejman bin Hajjan.

حَدَّثَنَا أَبُو كُرَيْبٍ، حَدَّثَنَا أَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرُ، عَنِ الْأَعْمَشِ، بِهَذَا الْإِسْنَادِ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا، يَقُولُ جَوَّدَ أَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرُ هَذَا الْحَدِيثَ عَنِ الْأَعْمَشِ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَقَدْ رَوَى غَيْرُ أَبِي خَالِدٍ، عَنِ الْأَعْمَشِ، مِثْلَ رِوَايَةِ أَبِي خَالِدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى أَبُو مُعَاوِيَةَ، وَغَيْرُ، وَاجِدٍ، هَذَا الْحَدِيثَ عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ مُسْلِمِ بْنِ أَبِي بَكْرٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ . وَلَمْ يَذْكُرُوا فِيهِ سَلَمَةَ بْنَ كَهَيْلٍ وَلَا عَنْ عَطَاءٍ وَلَا عَنْ مُجَاهِدٍ . وَاسْمُ أَبِي خَالِدٍ سُلَيْمَانُ بْنُ حَيَّانٍ .

⁷⁴⁰ Muslim el-Bekini, është ravi i besueshëm. Bën pjesë, në mesin e atyre transmetuesve të hadithit, nga të cilët hadithet i kanë marrë në *El-Kutubus-sitte*.

⁷⁴¹ Në transmetimin e Buhariut, qëndron: “Erdhi një njeri tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: “Motra ime ka vdekur.” Në transmetimin tjetër, të këtij hadithi të Buhariut, qëndron: “Më ka vdekur nëna, e ka mbetur borxh dy muaj, një pas një, agjërim.” Ndërsa, në transmetimin e tretë të Buhariut qëndron: “(...) e ka mbetur borxh një muaj agjërim.” Në transmetimin e katër të Buhariut, qëndron: “(...) e ka mbetur borxh pesëmbëdhjetë ditë.” Në transmetimin, të cilin, në të njëjtën kohë e shënojnë edhe Buhariu edhe Muslimi qëndron: “(...) e ka mbetur borxh agjërimin e premtuar.” Ibn Haxheri, në komentimin e përmbledhjes së hadithit të Buhariut, *Fet'hul-Bari*, thotë: “Disa mendojnë, se këtu është fjala mbi përplasjen e ravive. Ndërkaq, unë mendoj se është fjala mbi disa situata të ndryshme.”

⁷⁴² Në transmetimin e Buhariut, qëndron: “Më e rëndësishme është, të kthehet borxhi ndaj Allahut.” Ahmedi, Muslimi dhe Ebu Davudi shënojnë, se Burejde, ka thënë: “Me një rast, derisa ishim duke ndenjur tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), erdhi një grua dhe tha: “Unë nënës time, derisa ishte gjallë, në emër të lëmoshës, ia kam dhënë një robërshë, e tani ajo ka vdekur.” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “Ti për atë, ke për të pasur shpërblim, ndërsa tani robërshën ktheje si trashëgim.” “O i Dërguar i Allahut.” – përsëri tha ajo – “nëna ime ka mbetur borxh një muaj të agjërimit – a mund të agjëroj për të, ato ditë?” “Agjëroi ato për të.” – tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

23. Mbi shpagimin (keffaretin)

باب مَا جَاءَ فِي الْكَفَّارَةِ فِي الصَّوْمِ

717. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abseri,⁷⁴³ duke transmetuar nga Esh'athi, ai nga Muhammedi, ai nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush vdes dhe mbetet borxh një muaj agjërim, le të ushqej për te ndonjëri (nga pasardhësit e tij) një të varfër, për çdo ditë të pa agjëruar.”⁷⁴⁴

Ebu Isai, thotë: “Hadithin e Ibn Umerit nuk e kemi të njohur si merfu’, përveç me këtë rrugë. Ai, nga Ibn Umeri është transmetuar besueshëm si mevkuf. Mbi këtë çështje, dijetarët janë ndarë. Disa konsiderojnë, që për të vdekurin (ditët e pa agjëruara) duhet të agjërohen. Kështu mendojnë, Ahmedi dhe Is’haku. Ata, thonë: “Në rast se i vdekuri ka mbetur borxh agjërimin e premtuar, ai, për atë, duhet ta kompensojë me agjërim, për te. Por, nëse ka mbetur borxh agjërimin e ramazanit (për çdo ditë të pa agjëruar), për te, duhet ushqyer një i varfër.” Maliku, Sufjani dhe Shafiu konsiderojnë, që askush për askënd nuk mund të agjërojë.”⁷⁴⁵ Esh'athi, është i biri i Sevvarit, ndërsa Muhammedi është Muhammed b. Abdurrahman b. Ebu Lejli.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ بْنُ الْقَاسِمِ، عَنْ أَشْعَثَ، عَنْ مُحَمَّدٍ، عَنْ نَافِعٍ، عَنْ ابْنِ عُمَرَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَنْ مَاتَ وَعَلَيْهِ صِيَامٌ شَهْرٍ فَلْيُطْعَمْ عَنْهُ مَكَانَ كُلِّ يَوْمٍ مِسْكِينًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عُمَرَ لَا نَعْرِفُهُ مَرْفُوعًا إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ وَالصَّحِيحُ عَنْ ابْنِ عُمَرَ مَوْقُوفٌ قَوْلُهُ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي هَذَا الْبَابِ فَقَالَ بَعْضُهُمْ يُصَامُ عَنِ الْمَيِّتِ . وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ قَالَا إِذَا كَانَ عَلَى الْمَيِّتِ نَذْرٌ صِيَامٍ يَصُومُ عَنْهُ وَإِذَا كَانَ عَلَيْهِ قِضَاءٌ رَمَضَانَ أَطْعَمَ عَنْهُ . وَقَالَ مَالِكٌ وَسُفْيَانُ وَالشَّافِعِيُّ لَا يَصُومُ أَحَدٌ عَنْ أَحَدٍ . قَالَ وَأَشْعَثُ هُوَ ابْنُ سَوَّارٍ . وَمُحَمَّدٌ هُوَ عِنْدِي ابْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَبِي لَيْلَى .

24. Mbi agjëruetin të cilin e kap vjellja

باب مَا جَاءَ فِي الصَّائِمِ يَذَرُّهُ الْقَيْءُ

718. Na ka treguar Muhammed b. Ubejd el-Muharribi – atë e ka informuar Abdurrahman b. Zejd b. Eslem, ai ka transmetuar nga babai i vet, ai nga Ata’ b. Jesari, ai nga Ebu Seid el-Hudriu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Tre gjëra nuk ia prishin agjëruetin agjërimin: lëshimi i gjakut (hixhami), vjellja dhe ejakulimi në ëndërr.”

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Seid el-Hudriut, nuk është mbajtur mirë në mend.”⁷⁴⁶ Abdullah b. Zejd b. Eslemi, Abdulaziz b. Muhammedi dhe shumë të tjerë, këtë hadith e kanë transmetuar nga Zejd b. Eslemi, si hadith mursel, duke mos e përmendur ‘nga Ebu Seidi’. Abdurrahman b. Zejd b. Eslemi,

⁷⁴³ Abser b. Kasim ez-Zubejdi Ebu Zubejd el-Kufi, është transmetues i besueshëm.

⁷⁴⁴ Nga transmetimet, të cilat i shënon Bejhekiu, vërehet, që sasia minimale e ushqimit, e cila i jepet të varfrit, çdo ditë të lëshuar të agjërimin, është një *mudd* grurë, ose kundërvlera e tij. Kjo përafërsisht është një sadakatul-fitër.

⁷⁴⁵ Abdurrahman el-Mubarekfuri, thotë: “Tirmidhiu, mbi këtë çështje i ka përmendur dy qëndrime. Unë konsideroj, se qëndrimi i drejtë është i atyre, të cilët thonë se ndokush nga trashëgimtarët mund të agjëroj ditët e pa-agjëruara për të vdekurin, pa e pasur parasysh se mbi çfarë lloji të agjërimin ka të bëjë.” Sipas fjalëve të Ibn Haxherit, qëndrimin e këtillë e mbështesin dijetarët e hadithit. Ata, atë e bazojnë mbi transmetimet e besueshme, të cilat i kemi përmendur më herët. Dijetarët e hadithit, më së miri e dinë, se çka është e besueshme mbi këtë çështje nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e çka jo.

⁷⁴⁶ E ka shënuar Bejhekiu, por, nuk është i përmendur: “Nga Ebu Seidi” gjithashtu, e ka shënuar edhe Ebu Davudi nga Zejd b. Esleme, e ai nga një as’hab i panjohur. Ebu Zura’a dhe Ebu Hatimi konsiderojnë, që ky transmetim është i besueshëm.

është ravi i dobët. E kam dëgjuar Ebu Davud es-Sixhziun,⁷⁴⁷ kur ka thënë: ‘Vëllai i tij, Abdullah b. Zejdi nuk është ravi i keq.’ Ndërsa, e kam dëgjuar Muhammedin, kur ka përmendur që Ali b. Abdullahu, ka thënë: ‘Abdullah b. Zejd b. Esleme është i besueshëm, ndërsa Abdurrahman b. Zejd b. Esleme, është ravi i dobët.’⁷⁴⁸ Muhammedi, ka thënë: ‘Unë nga ai nuk transmetoj asgjë.’”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ زَيْدٍ بْنُ أَسْلَمَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَطَاءِ بْنِ يَسَارٍ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " ثَلَاثٌ لَا يُفْطَرْنَ الصَّائِمَ الْحَجَامَةُ وَالْقِيَاءُ وَالْإِخْلَامُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ حَدِيثٌ غَيْرُ مَحْفُوظٍ . وَقَدْ رَوَى عَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدٍ بْنُ أَسْلَمَ وَعَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ وَغَيْرُ وَاحِدٍ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ زَيْدٍ بْنِ أَسْلَمَ مُرْسَلًا . وَلَمْ يَذْكُرُوا فِيهِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ . وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدٍ بْنُ أَسْلَمَ يُضَعَّفُ فِي الْحَدِيثِ . قَالَ سَمِعْتُ أَبَا دَاوُدَ السَّجْزِيَّ يَقُولُ سَأَلْتُ أَحْمَدَ بْنَ حَنْبَلٍ عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ زَيْدٍ بْنِ أَسْلَمَ فَقَالَ أَخُوهُ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدٍ لَا بَأْسَ بِهِ . قَالَ وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَذْكُرُ عَنْ عَلِيِّ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْمَدِينِيِّ قَالَ عَبْدُ اللَّهِ بْنُ زَيْدٍ بْنُ أَسْلَمَ ثَقَّةٌ وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ زَيْدٍ بْنُ أَسْلَمَ ضَعِيفٌ . قَالَ مُحَمَّدٌ وَلَا أُرْوِي عَنْهُ شَيْئًا .

25. Mbi atë i cili qëllimisht e nxitë vjelljen

باب مَا جَاءَ فِيهِ مِنْ اسْتِثْقَاءِ عَمْدًا

719. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Isa b. Junusi, duke transmetuar nga Hisham b. Hassani, ai nga Ibn Sirini, ndërsa ai, nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Atë që e kap vjellja, nuk është i obliguar për ta kompensuar agjërimin. Ndërsa, ai që qëllimisht e nxitë vjelljen, le ta agjërojë (atë ditë).”⁷⁴⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Derda, Thevbani dhe Fedale b. Ubejde. Hadithi i Ibn Hurejres, është hasen-garib.⁷⁵⁰ Ai është njëri, nga hadithet e Hishamit, të cilin e ka transmetuar nga Ibn Sirini, ai nga Ebu Hurejre, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i cili na është i njohur vetëm nëpërmjet Isa b. Junusit. Muhammedi, thotë: “Konsideroj, që nuk është mbajtur në mend mirë.” Ky hadith, nëpërmjet Ebu Hurejres, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është transmetuar në shumë mënyra, por, të gjithë senedet e tij janë jo të besueshëm. Ndërsa, është transmetuar nga Ebu Derda, Thevbani dhe Fedale b. Ubejde, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (me një rast) ka vjell dhe e ka prishur agjërimin. Ky hadith, do të thotë, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka qenë duke agjëruar agjërim vullnetar. Pasi që ka vjellë është dobësuar, prandaj e kishte prishur agjërimin. Komentimi i këtillë është transmetuar në disa nga hadithet.”⁷⁵¹

Qëndrimi i dijetarëve është në pajtim me hadithin, të cilin e transmeton Ebu Hurejre nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Agjëruenin, nëse e kap të vjellit, nuk është i obliguar të agjërojë atë ditë. Ndërkaq, nëse qëllimisht e nxitë të vjellit, le ta agjërojë atë ditë.” Ky është qëndrimi i Shafiut, Sufjan eth-Thevriut, Ahmedit dhe i Is’hakut.”

⁷⁴⁷ Iraki konsideron, që fjala është mbi Ebu Davud es-Sixhistaniun, autori i veprës së njohur *Sunen*, sepse Sixh është njëri nga emërtimet e sixhistanit. Përveç kësaj, Ebu Davud es-Shixhistani transmetonte hadithe nga Abdurrahman b. Zejd b. Esleme.

⁷⁴⁸ Abdurrahman el-Mubarekfuri, thotë: “Dije, që Zejd b. Esleme, i ka pasur tre djemë: Abdullahun, Abdurrahmanin dhe Usamen. Vetëm i pari është ravi i besueshëm, derisa dy të tjerët janë të dobët.” Jahja b. Meni konsideron, që të tre djemtë e Zejdut janë ravi të dobët.

⁷⁴⁹ Nga ky hadith, mund të vijmë në përfundim, që nuk e ka të prishur agjërimin, ai i cili pa dashje vjell. Në rast se kjo i ndodh dikujt, duhet ta vazhdoj agjërimin. Ndërkaq, agjërimin e ka të prishur, ai i cili qëllimisht vjellë. Në këtë rast, duhet që atë ditë ta agjërojë.

⁷⁵⁰ E shënojnë, të gjithë në *El-Kutubus-sitte*, përveç Buhariut.

⁷⁵¹ Hadithin, në të cilin është paraqitur sqarim i këtillë, e shënon Ibn Maxhe në *Sunen* nga Ebu Merzuku.

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا عَيْسَى بْنُ يُونُسَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ حَسَّانَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " مَنْ ذَرَعَهُ الْقَيْءُ فَلَيْسَ عَلَيْهِ قَضَاءٌ وَمَنْ اسْتَقَاءَ عَمْدًا فَلَيْقُضَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ وَتُوبَانَ وَفَضَالَةَ بْنِ عُبَيْدٍ . قَالَ أَبُو عَيْسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ مِنْ حَدِيثِ هِشَامٍ عَنْ ابْنِ سِيرِينَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ عَيْسَى بْنِ يُونُسَ . وَقَالَ مُحَمَّدٌ لَا أَرَاهُ مَحْفُوظًا . قَالَ أَبُو عَيْسَى وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ مِنْ غَيْرِ وَجْهِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَلَا يَصِحُّ إِسْنَادُهُ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ وَتُوبَانَ وَفَضَالَةَ بْنِ عُبَيْدٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَاءَ فَأَقْطَرَ . وَإِنَّمَا مَعْنَى هَذَا أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ صَائِمًا مُتَطَوِّرًا فَصَغَفَ فَأَقْطَرَ لِذَلِكَ . هَكَذَا رُوِيَ فِي بَعْضِ الْحَدِيثِ مُفَسَّرًا . وَالْعَمَلُ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ عَلَى حَدِيثِ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّ الصَّائِمَ إِذَا ذَرَعَهُ الْقَيْءُ فَلَا قَضَاءَ عَلَيْهِ وَإِذَا اسْتَقَاءَ عَمْدًا فَلَيْقُضَ . وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

26. Mbi agjëruetin i cili harron që është duke agjëruar dhe han ose pinë diçka

باب مَا جَاءَ فِي الصَّائِمِ يَأْكُلُ أَوْ يَشْرِبُ نَاسِيًا

720. Na ka treguar Ebu Seid el-Eshexh - atë e ka informuar Ebu Halid el-Ahmeri, ai ka transmetuar nga Haxhaxhi, ai nga Katade, ai nga Ibn Sirini, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush harron (që është duke agjëruar), e hanë, apo pinë diçka, ai nuk e ka prishur agjërimin⁷⁵² - ai është vetëm furnizim me të cilin Allahu e ka furnizuar.”⁷⁵³

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ الْأَشْجِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو خَالِدٍ الْأَحْمَرُ، عَنْ حَجَّاجِ بْنِ أَرْطَاةَ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ ابْنِ سِيرِينَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ أَكَلَ أَوْ شَرِبَ نَاسِيًا فَلَا يُفْطِرُ فَإِنَّمَا هُوَ رَزَقٌ رَزَقَهُ اللَّهُ " .

721. Na ka treguar Ebu Seidi – atë e ka informuar Ebu Usama, ai ka transmetuar nga Avfi, ai nga Ibn Sirini dhe Hal-lasi, ata dy nga Ebu Hurejre, ndërsa, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), – identik ose ngjashëm me hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi dhe Ummu Is’hak el-Ganeviji. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.⁷⁵⁴ Sipas tij, kanë vepruar shumica e dijetarëve. Në pajtim me të është edhe qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Shafiut, Ahmedit dhe Is’hakut.”⁷⁵⁵

Malik b. Enesi, thotë: “Nëse ndokush, gjatë ramazanit, duke harruar, do të kishte ngrënë diçka, do të ishte i obliguar për ta agjëruar (atë ditë).”⁷⁵⁶ Mendimi i parë është më i drejtë.

⁷⁵² Në transmetimin e Buhariut të hadithit, qëndron: “Ai që duke harruar (duke agjëruar) hanë apo pinë diçka, le të vazhdojë me agjërimin.”

⁷⁵³ Ahmed b. Hanbeli në Musned, shënon se me një rast, Ummu Is’haku është gjendur tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Është sjell një enë e dheut me përshesh dhe ajo ka ngrënë me të. Pasi që ka ngrënë, i është kujtuar se ka qenë duke agjëruar. Dhul-Jedejni i tha: “Vallë, a tani pasi që ke ngrënë!?” I Dërguari, në atë tha: “Vazhdoje agjërimin tënd, ky është vetëm furnizim, të cilin Allahu ta ka dhënë.” Abdurrezaku transmeton, nga Ibn Xhurejxi, ai nga Amër b. Dinari, se një njeri ka ardhur tek Ebu Hurejre dhe ka thënë: “Unë në mëngjes fillova të agjëroj dhe duke harruar, kam ngrënë.” “Nuk pengon.” Tha Ebu Hurejre. “Pas asaj shkova te një njeri dhe, duke e harruar që jam duke agjëruar, edhe tek ai, kam ngrënë dhe kam pirë.” “Nuk pengon ajo.” – tha Ebu Hurejre – “Allahu të ka dhënë të hash dhe të pish.” “Pas asaj.” – thotë ai – “shkova te një njeri tjetër dhe tek ai, duke harruar kam ngrënë.” – në atë Ebu Hurejre, tha: “Ti je personi i cili nuk është mësuar të agjëroj!”

⁷⁵⁴ E shënon edhe Buhariu edhe Muslimi në *Sahihë*.

⁷⁵⁵ Ata konsiderojnë, që personi i cili duke harruar që është agjërueshëm, hanë ose pinë diçka, nuk e ka prishur, dhe ai duhet të vazhdojë me agjërimin. Ky mendim është i Ebu Hanifes.

⁷⁵⁶ Maliku ka kuptuar, që hadithi i Ebu Hurejres ka të bëjë ekskluzivisht me agjërimin vullnetar e jo me agjërimin e ramazanit. Sipas mendimit të tij, nëse ndokush e agjëron agjërimin vullnetar dhe harron, ha ose pi diç – ai agjërim nuk është i prishur. Ndërkaq, nëse është duke e agjëruar agjërimin e ramazanit, ai do të ketë qenë i prishur dhe ai do të ishte i obliguar për t’i agjëruar ato ditë. Qëndrimi i këtillë, bie ndesh me hadithin të cilin e shënojnë Ibn Huzejme, Ibn Hibbani, Hakimi dhe ed-Darekutni nga Ebu Hurejre, në të cilin qëndron se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush nga harresa, paqëllim e prish

حَدَّثَنَا أَبُو سَعِيدٍ الْأَشْجِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو أَسَامَةَ، عَنْ عَوْفٍ، عَنْ ابْنِ سِيرِينَ، وَخَلَّاسٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مِثْلَهُ أَوْ نَحْوَهُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَأُمِّ إِسْحَاقَ الْغَنَوِيَّةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَكْثَرِ أَهْلِ الْعِلْمِ وَبِهِ يَقُولُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . وَقَالَ مَالِكٌ بْنُ أَنَسٍ إِذَا أَكَلَ فِي رَمَضَانَ نَاسِيًا فَعَلَيْهِ الْقَضَاءُ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ .

27. Mbi prishjen e qëllimshme të agjërimit

باب مَا جَاءَ فِي الْإِفْطَارِ مُتَعَدِّدًا

722. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e kanë informuar, Jahja b. Seidi dhe Abdurrahman b. Mehdiu, ata i ka informuar, Sufjani, duke transmetuar nga Habib b. Ebu Thabiti, ai ka transmetuar nga Ebu Mutavvisi, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush pa ndonjë arsye të fortë apo sëmundje e prish agjërimit një ditë të ramazanit, nuk do të mund ta kompensonte atë, sikur të agjëronte përjetësisht.”⁷⁵⁷

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Hurejres na është i njohur vetëm me këtë rrugë.”⁷⁵⁸ Por, e kam dëgjuar Muhammedin,⁷⁵⁹ kur ka thënë: “Emri i Ebu Mutavvisit është Jezid b. Mutavvis. Mua nuk më është e njohur, që ai e ka transmetuar edhe ndonjë hadith, përveç këtij.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ، وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، قَالَا حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ أَبِي ثَابِتٍ، حَدَّثَنَا أَبُو الْمُطَّوْسِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ أَفْطَرَ يَوْمًا مِنْ رَمَضَانَ مِنْ غَيْرِ رُخْصَةٍ وَلَا مَرَضٍ لَمْ يَقْضِ عَنْهُ صَوْمُ الدَّهْرِ كُلِّهِ وَإِنْ صَامَهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يَقُولُ أَبُو الْمُطَّوْسِ اسْمُهُ يَزِيدُ بْنُ الْمُطَّوْسِ وَلَا أَعْرِفُ لَهُ غَيْرَ هَذَا الْحَدِيثِ .

28. Mbi shpagimin (keffaretin) për prishjen e agjërimit gjatë ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي كَفَّارَةِ الْفِطْرِ فِي رَمَضَانَ

723. Na kanë treguar Nasër b. Ali el-Xhehdani dhe Ebu Ammari, kuptimin e njëjtë, ndërsa teksti i (këtij hadithi) është i Ebu Ammarit, i cili ka thënë: “Më ka informuar Sufjan b. Ujejne, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Humejd b. Abdurrahmani, që Ebu Hurejre, ka thënë: ‘Erdhi një njeri’⁷⁶⁰ (te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)) dhe tha: ‘I Dërguari i Allahut, unë jam i shkatërruar!’ ‘E çfarë të shkatërroi ashtu?’ – pyeti i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). ‘Kam pasur marrëdhënie seksuale me bashkëshorten time gjatë ramazanit.’⁷⁶¹ – tha ai. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: ‘A je në gjendje për ta liruar një rob?’ ‘Nuk jam’ – tha ai. ‘A je në gjendje për të agjëruar pa ndërprerë dy muaj?’ – pyeti i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). ‘Nuk jam’ – u përgjigj ai. ‘A je në gjendje për t’i ushqyer gjashtëdhjetë të varfër?’ – përsëri tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). ‘Nuk jam’ – tha ai. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atëherë tha: ‘Ulu!’ Dhe ai u ul. Pastaj, të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ia sollën një shportë të

agjërimit e ramazanit, nuk është i obliguar për ta agjëruar atë ditë, e as për atë nuk pason (kefaret) shpagimi.” Ibn Haxheri thotë, që ky hadith më së paku është hasen.

⁷⁵⁷ Tibi, thotë: “Nuk mund të zëvendësohet vlera e një dite të agjërimit të ramazanit, edhe sikur pas asaj të agjërojë nafile tërë jetën.” Dijetarët islamë, janë të pajtimit, se ajo ditë duhet të agjërohet.

⁷⁵⁸ E shënon edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*. Ibn Huzejme e ka vlerësuar sahih.

⁷⁵⁹ Muhammed b. Ismail b. Ibrahim el-Xhufi el-Buhariu.

⁷⁶⁰ Në transmetimin e Buhariut të këtij hadithi, qëndron: “Me një rast, derisa ishim duke ndenjur tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i erdhi një njeri.” Abdul-Gina në veprën *Mubhemat*, pohon që ai ka qenë Seleme b. Sahr el-Bejadi.

⁷⁶¹ Këto fjalë tregojnë, që ai, atë e ka bërë qëllimisht dhe, me atë e ka prishur agjërimit e ramazanit.

madhe me hurme dhe ai tha: ‘Shpërndani këto (të varfërve) në emër të lëmoshës!’ Njeriu në atë tha: ‘Në tërë Medinën, nuk ka më të varfër se ne.’ I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atëherë qeshi sa që ju dukën dhëmbët e syrit, pastaj tha: ‘Merre atë (shportën) dhe ushqije familjen tënde.’”⁷⁶²

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Aishja dhe Abdullah b. Amëri. Hadithi i Ebu Hurejres, është hasen-sahih. Sipas tij, veprojnë dijetarët kur është në pyetje marrëdhënia e qëllimshme seksuale gjatë ramazanit.”

Sa i përket atij, i cili me qëllim e prish agjërimin me ushqim dhe pije, në atë pikëpamje dijetarët kanë qëndrime të ndryshme. Disa thonë: “Është i obliguar ta agjërojë dhe të jap shpagim.” – duke e barazuar tërësisht ushqimin dhe pijen me marrëdhënien seksuale. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut dhe i Is’hakut. Disa, thonë: “Është i obliguar për të agjëruar, ndërsa nuk është i obliguar për të dhënë shpagimin, sepse nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është përmendur keffareti kur është në pyetje marrëdhënia seksuale, e jo ushqimi dhe pija. Nuk munden” – thonë ata të barazohen ushqimi dhe pija me marrëdhënien seksuale. Ky është mendimi i Shafiut dhe i Ahmedit.

Shafiû konsideron, që fjalët e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), të drejtuara njeriut, i cili e ka prishur agjërimin dhe të cilit ai i ka dhënë lëmoshë “Merre ushqije familjen tënde,” mund të kuptohen, që shpagimi është i obliguar për personin i cili është në gjendje për ta zbatuar atë. Ky njeri, nuk ka qenë në gjendje për ta zbatuar shpagimin edhe pasi i Dërguari i ka dhënë diçka. Pasi që ishte bërë pronari i asaj, njeriu tha: “Askush nuk ka nevojë për këtë më tepër se ne.” – ndërsa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), atëherë tha: “Merre atë dhe ushqije familjen tënde.” – sepse, keffareti zbatohet vetëm nëse diç tepron nga nevojat elementare të ndokujt. Shafiû konsideron të drejtë për atë i cili gjendet në situatë të ngjashme, që atë (çfarë i dhurohet) ta ha, e që shpagimi t’i mbetet si borxh. Atë ditë kur arrin pasuri, le ta zbatojë atë.

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ الْجَهْضَمِيُّ، وَأَبُو عَمَّارٍ وَالْمَعْنَى وَاجِدٌ وَاللَّفْظُ لَفْظُ أَبِي عَمَّارٍ قَالَ أَخْبَرَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنِ الرَّهْزِيِّ، عَنْ حُمَيْدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ أَتَاهُ رَجُلٌ فَقَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ هَلَكْتُ . قَالَ " وَمَا أَهْلَكَ " . قَالَ وَقَعْتُ عَلَى امْرَأَتِي فِي رَمَضَانَ . قَالَ " هَلْ تَسْتَطِيعُ أَنْ تَغْتِقَ رَقَبَةً " . قَالَ لَا . قَالَ " فَهَلْ تَسْتَطِيعُ أَنْ تَصُومَ شَهْرَيْنِ مُتَابَعَيْنِ " . قَالَ لَا . قَالَ " فَهَلْ تَسْتَطِيعُ أَنْ تُطْعِمَ سِتِينَ مِسْكِينًا " . قَالَ لَا . قَالَ " اجْلِسْ " . فَجَلَسَ فَأَتَى النَّبِيَّ ﷺ بِعَرَقٍ فِيهِ ثَمَرٌ - وَالْعَرَقُ الْمَكْتَلُ الضَّخْمُ قَالَ " تَصَدَّقْ بِهِ " . فَقَالَ مَا بَيْنَ لَابَتَيْهَا أَحَدٌ أَفْقَرُ مِنَّا . قَالَ فَصَنَعَكَ النَّبِيُّ ﷺ حَتَّى بَدَتْ أَنْيَابُهُ . قَالَ " خُذْهُ فَأُطْعِمَهُ أَهْلَكَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَعَائِشَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي مَنْ أَفْطَرَ فِي رَمَضَانَ مُتَعَمِّدًا مِنْ جَمَاعٍ وَأَمَّا مَنْ أَفْطَرَ مُتَعَمِّدًا مِنْ أَكْلِ أَوْ شَرَبٍ فَإِنَّ أَهْلَ الْعِلْمِ قَدِ اخْتَلَفُوا فِي ذَلِكَ فَقَالَ بَعْضُهُمْ عَلَيْهِ الْقَضَاءُ وَالْكَفَّارَةُ . وَشَبَّهُوا الْأَكْلَ وَالشَّرْبَ بِالْجَمَاعِ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَإِسْحَاقَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ عَلَيْهِ الْقَضَاءُ وَلَا كَفَّارَةَ عَلَيْهِ لِأَنَّهُ إِنَّمَا ذَكَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ الْكَفَّارَةَ فِي الْجَمَاعِ وَلَمْ تَذْكُرْ عَنْهُ فِي الْأَكْلِ وَالشَّرْبِ . وَقَالُوا لَا يُشْبِهُ الْأَكْلَ وَالشَّرْبَ الْجَمَاعَ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ . وَقَالَ الشَّافِعِيُّ وَقَوْلُ النَّبِيِّ ﷺ لِلرَّجُلِ الَّذِي أَفْطَرَ فَتَصَدَّقْ عَلَيْهِ " خُذْهُ فَأُطْعِمَهُ أَهْلَكَ " . يَحْتَمِلُ هَذَا مَعَانِي يَحْتَمِلُ أَنْ تَكُونَ الْكَفَّارَةُ عَلَى مَنْ قَدَرَ عَلَيْهَا وَهَذَا رَجُلٌ لَمْ يَقْدِرْ عَلَى الْكَفَّارَةِ فَلَمَّا أَعْطَاهُ النَّبِيُّ ﷺ شَيْئًا وَمَلَكَهُ فَقَالَ الرَّجُلُ مَا أَحَدٌ أَفْقَرُ إِلَيْهِ مِنَّا . فَقَالَ النَّبِيُّ ﷺ " خُذْهُ فَأُطْعِمَهُ أَهْلَكَ " . لِأَنَّ الْكَفَّارَةَ إِنَّمَا تَكُونُ بَعْدَ الْفَضْلِ عَنْ قُوَّتِهِ . وَاخْتَارَ الشَّافِعِيُّ لِمَنْ كَانَ عَلَى مِثْلِ هَذَا الْحَالِ أَنْ يَأْكُلَهُ وَتَكُونَ الْكَفَّارَةُ عَلَيْهِ دَيْنًا فَمَتَى مَا مَلَكَ يَوْمًا مَا كَفَّرَ .

⁷⁶² Ky hadith udhëzon në atë, që për atë i cili, pa arsye të justifikueshme e ndërpre agjërimin e ramazanit, përbëhet nga kjo: 1) nëse ka mundësi, ta lirojë një rob ose robëreshë; 2) nëse atë nuk është në gjendje ta bëjë, që të agjërojë gjashtëdhjetë ditë pandërprerë; 3) nëse edhe atë nuk është në gjendje, t’i ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Disa konsiderojnë, që është i obliguar t’i përmbahet këtij rendi. Derisa të tjerët, mendojnë, që nga këto tria, mund të zgjedhë më të lehtë.

29. Mbi përdorimin e misvakut nga agjëruesi

باب مَا جَاءَ فِي السَّوَالِ لِلصَّائِمِ

724. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdiu, atë Suffjani, duke transmetuar nga Asim b. Ubejdullahu,⁷⁶³ ai nga Abdullah b. Amir b. Rebiu – që babai i Amir b. Rebiut, ka thënë: “E kam parë të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), shumë herë, e përdorte misvakun derisa ishte duke agjëruar.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi nga Aishja. Hadithi i Amir b. Rebiut është hasen.⁷⁶⁴ Në pajtim me këtë është praktika e dijetarëve. Ata, në përdorimin e misvakut nga agjëruesi nuk shohin asgjë të keqe.⁷⁶⁵ Përfashtim nga kjo bëjnë disa, të cilët konsiderojnë, që për agjëruesin është mekruh përdorimi i misvakut nga druri i njomë⁷⁶⁶ dhe që është mekruh përdorimi i misvakut në fund të ditës.⁷⁶⁷ Shafi u konsideron që nuk ka pengesë që agjëruesi ta përdorë misvakun në fillim apo në fund të ditës, derisa Ahmed i dhe Is’haku konsiderojnë të papëlqyer përdorimin e misvakut në fund të ditës.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ عَصِمِ بْنِ عُيَيْدٍ اللَّهِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَامِرٍ بْنِ رَبِيعَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ مَا لَا أَحْصِي يَتَسَوَّكُ وَهُوَ صَائِمٌ . قَالَ فِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَامِرِ بْنِ رَبِيعَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ لَا يَرَوْنَ بِالسَّوَالِ لِلصَّائِمِ بَأْسًا إِلَّا أَنْ يَعْضَ أَهْلُ الْعِلْمِ كَرَهُوا السَّوَالِ لِلصَّائِمِ بِالْعُودِ الرَّطْبِ وَكَرَهُوا لَهُ السَّوَالِ آخِرَ النَّهَارِ وَلَمْ يَرَ الشَّافِعِيُّ بِالسَّوَالِ بَأْسًا أَوْلَ النَّهَارِ وَلَا آخِرَهُ وَكَرَهُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ السَّوَالِ آخِرَ النَّهَارِ .

30. Mbi përdorimin e surmes nga agjëruesi

باب مَا جَاءَ فِي الْكُحْلِ لِلصَّائِمِ

725. Na ka treguar A’la b. Vasili⁷⁶⁸ - atë e ka informuar Hasan b. Atijje, atë Ebu Atike – që Enes b. Maliku, ka thënë: “Një njeri, erdhi tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: ‘Më dhembin sytë, andaj a mund ta përdori surmen kur jam duke agjëruar?’ ‘Mundesh.’ – tha ai.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Rafiu. Senedi i hadithit të Enesit, nuk është i fuqishëm, dhe as nuk ka ardhur asgjë e besueshme nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi këtë temë, po edhe Ebu Atiku është konsideruar si ravi i dobët. Dijetarët kanë divergjenca në pikëpamje të përdorimit të surmes nga agjëruesi. Disa siç janë Sufjani,

⁷⁶³ Asim b. Ubejdullah b. Asim b. Umer b. Hattab el-Adevi el-Medeni, është transmetues i dobët. Atë të dobët e kanë vlerësuar Jahja b. Meini, Ez-Zuheli, Buhariu dhe të tjerët. I takonte gjeneratës së katërt të ravive.

⁷⁶⁴ E kanë shënuar, Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, Ebu Davudi në *Sunen* dhe Ibn Huzejme në *Sahih*.

⁷⁶⁵ Ebu Hanife, Maliku, Shafi u dhe shumica e dijetarëve, konsiderojnë, që nuk ka kurrfarë pengese, që agjëruesi ta përdor misvakun, para dhe pas dreke, pa e pasur parasysh se a është nga druri i thatë apo i njomë.

⁷⁶⁶ Disa dijetarë, jurist të shkollës juridike malikite dhe Sha’bij, konsiderojnë, që për agjëruesin, është mekruh ta përdorurit e misvakut nga druri i njomë që ka shije, andaj nuk është mirë të përdoret. Muhammed b. Sirini këtë arsyetim e përgënjeshtroi, duke pohuar se edhe uji ka shije dhe që, sipas logjikës së tillë, do të ishte mekruh shpëlarja e gojës me ujë.

⁷⁶⁷ Ata gjithashtu, konsiderojnë mekruh, për agjëruesin, që ta përdorte misvakun kah fundi i ditës, që të mos ia largonte erën e cila, siç ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Ditën e Gjykimit, do ta ketë erën më të fortë sesa misku. U është përgjigjur, në atë mënyrë, duke u thënë, se era nuk i vjen agjëruesit nga goja por nga stomaku, andaj misvaku, as nuk mund ta largojë atë, e as ta pakësojë. Përkundër asaj, edhe vet i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), edhe kur agjëronte edhe kur nuk agjëronte, disa herë gjatë ditës i pastronte dhëmbët dhe vazhdimisht insistonte që atë ta bënin edhe pasuesit e tij.

⁷⁶⁸ A’la b. Vasil b. Abdul-A’la el-Esedi el-Kufi, është transmetues i besueshëm. Bënë pjesë në mesin e ravive më të vjetër nga gjenerata e dhjetë.

Ibn Mubareku, Ahmedî dhe Is'haku, konsiderojnë që përdorimi i surmes nga agjëruesi është mekruh. Disa, siç është Shafi'u konsiderojnë që atë e ka të lejuar.⁷⁶⁹

حَدَّثَنَا أَبُو الْأَعْلَى بْنُ وَاصِلٍ الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا الْحَسَنُ بْنُ عَطِيَّةَ، حَدَّثَنَا أَبُو عَاتِكَةَ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ جَاءَ رَجُلٌ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَقَالَ اسْتَكْتُتُ عَيْنِي أَفَأَكْتَحِلُ وَأَنَا صَائِمٌ قَالَ " نَعَمْ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي رَافِعٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ لَيْسَ إِسْنَادُهُ بِالْقَوِيِّ وَلَا يَصِحُّ عَنْ النَّبِيِّ ﷺ فِي هَذَا الْبَابِ شَيْءٌ . وَأَبُو عَاتِكَةَ يُضَعَّفُ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْكُحْلِ لِلصَّائِمِ فَكَرَهُهُ بَعْضُهُمْ وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَرَخَّصَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ فِي الْكُحْلِ لِلصَّائِمِ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ .

31. Mbi puthjen e agjëruesit

باب مَا جَاءَ فِي الْقُبْلَةِ لِلصَّائِمِ

726. Na kanë treguar Hennadi dhe Kutejbe – ata i ka informuar Ebu Ahvesi, ai ka transmetuar nga Zijad b. Ilake, ai nga Amr b. Mejmoni – që Aishja ka thënë: “Me të vërtetë i Dërguari puthte gjatë muajit të agjërimit.”⁷⁷⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Umer b. Hattabi, Hafsa, Ebu Seidi, Ummu Seleme, Ibn Abbasi, Enesi dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Aishes është hasen-sahih.”⁷⁷¹

Dijetarët, nga gjenerata e as'habëve dhe të tjerët, janë ndarë në pikëpamje të puthjes së agjëruesit. Disa konsiderojnë, që puthja është e lejuar për personin më të vjetër, por jo edhe për personin më të ri – për shkak të frikës që të mos vihet në pyetje agjërimi i tij.⁷⁷² Të përkëdhelurit, sipas mendimit të tyre, është edhe më i rrezikshëm. Disa dijetarë, thonë që puthja e zvogëlon vlerën e agjërimit, por me atë agjëruesi nuk e prish agjërimin. Ata konsiderojnë, që nëse agjëruesi është në gjendje të kontrolloj veten, mund të puthë. Nëse nuk është në gjendje, atëherë nuk duhet puthur, për të qenë agjërimi i drejtë. Ky është mendimi i Sufjan eth-Thevriut dhe i Shafiut.⁷⁷³

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، وَقُتَيْبَةُ، قَالَا حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ زِيَادِ بْنِ عِلَاقَةَ، عَنْ عَمْرِو بْنِ مَيْمُونٍ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُقِيلُ فِي شَهْرِ الصَّوْمِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ وَخَفْصَةَ وَأَبِي سَعِيدٍ وَأُمِّ سَلَمَةَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَأَنَسٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ فِي الْقُبْلَةِ لِلصَّائِمِ فَرَخَّصَ بَعْضُ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي الْقُبْلَةِ لِلشَّيْخِ وَلَمْ يُرَخَّصُوا لِلشَّابِّ مَخَافَةَ أَنْ لَا يَسْلَمَ لَهُ صَوْمُهُ وَالْمُبَاشَرَةُ عَنْهُمْ أَشَدُّ . وَقَدْ قَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ الْقُبْلَةُ تَنْقُصُ الْأَجْرَ وَلَا تُفْطِرُ الصَّائِمَ . وَرَأَوْا أَنَّ لِلصَّائِمِ إِذَا مَلَكَ نَفْسَهُ أَنْ يُقِيلَ وَإِذَا لَمْ يَأْمَنْ عَلَى نَفْسِهِ تَرَكَ الْقُبْلَةَ لِيَسْلَمَ لَهُ صَوْمُهُ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَالشَّافِعِيِّ .

⁷⁶⁹ Ky është mendimi i Ebu Hanifes.

⁷⁷⁰ Në transmetimin e këtij hadithi nga Muslimi, qëndron: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kishte shprehur që ta puthte (ndonjëherë nga bashkëshortet e veta) gjatë ramazanit, derisa ishte agjërueshëm.”

⁷⁷¹ E shënon edhe Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁷⁷² Ata mendimin e vet e mbështetin në hadithin, të cilin e shënon Ibn Maxhe nga Ibn Abbasi, në të cilin qëndron: Erdhi një njeri tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe e pyeti se a mundet ta përkëdhel (bashkëshorten) dhe ai, e ka lejuar. Pas një kohe, erdhi tjetri (edhe e pyeti të njëjtën gjë), e ai nuk e lejoi atë. Ai të cilit i ka lejuar ka qenë plak, ndërsa ai të cilit ia ka ndaluar ka qenë i ri.”

⁷⁷³ Ky hadith, është qëndrimi i Ebu Hanifes. Ata mendimin e vet e mbështetin edhe mbi këtë hadith. Muslimi shënon, se Umer b. Ebu Seleme, thjeshtri i të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), se a mundet agjëruesi ta puth gruan e vet, ndërsa ai ka thënë: “Pyete këtë, Ummu Selemen.” Ajo e informoi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) e bënë atë. Ai në atë tha: “I Dërguari i Allahut, Allahu ty të ka falur mëkatet eventuale të cilat i ke bërë dhe të cilat ke për t'i bërë!” I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) tha: “Unë, pasha Allahun, më tepër se ju kam frikë nga Allahu dhe më së miri i njoh kufijtë e Tij!”

32. Mbi përkëdheljen e bashkëshortes nga agjëruesi

باب مَا جَاءَ فِي مَبَاشَرَةِ الصَّائِمِ

727. Na ka treguar Ibn Ebu Umeri – atë e ka informuar Vekiu, atë Israili, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Ebu Mejseri – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), më përkëdhelte derisa ishte agjërueshëm - e ai më mirë se ju mund t'i frenonte epshet e veta.”⁷⁷⁴

حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عُمَرَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا إِسْرَائِيلُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ أَبِي مَيْسَرَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يُبَاشِرُنِي وَهُوَ صَائِمٌ وَكَانَ أَمْلَكَكُمْ لِإِزِيهِ .

728. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Ibrahim, ai nga Alkame dhe Esvedi – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kishte shprehur të puthte dhe të përkëdhelte derisa ishte agjërueshëm, e ai më mirë se ju mund t'i frenonte epshet e veta.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁷⁷⁵ Ebu Mejser quhet Amër b. Sherahbil.⁷⁷⁶ *Epshet e veta* – do të thotë ëndjet e veta (seksuale).”

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ الْأَعْمَشِ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنْ عَلْقَمَةَ، وَالْأَسْوَدِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَقْبَلُ وَيُبَاشِرُ وَهُوَ صَائِمٌ وَكَانَ أَمْلَكَكُمْ لِإِزِيهِ . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو مَيْسَرَةَ اسْمُهُ عَمْرُو بْنُ شُرْحَبِيلٍ . وَمَعْنَى لِإِزِيهِ لِنَفْسِهِ .

33. Nuk ka agjërimit ai, i cili atë nuk e bën nijet gjatë natës

باب مَا جَاءَ لَا صِيَامَ لِمَنْ لَمْ يَغْرَمْ مِنَ اللَّيْلِ

729. Na ka treguar Is'hak b. Mensuri – atë e ka informuar Ibn Ebu Merjemi, atë Jahja b. Ejubi, duke transmetuar nga Abdullah b. Ebu Bekri, ai nga Ibn Shihabi, ai nga Salim b. Abdullahu, ai nga babai i vet, ai nga Hafsa - që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush nuk e bënë nijet agjërimit para agimit, ai nuk ka agjërimit.”⁷⁷⁷

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Hafses, si merfu, na është i njohur vetëm me këtë rrugë. Është transmetuar nëpërmjet Nafiut nga Ibn Umeri dhe kjo është më e besueshme. Kjo, sipas mendimit të disa dijetarëve, do të thotë, që nuk ka agjërimit ai, i cili gjatë agjërimit të ramazanit, gjatë agjërimit të ditëve të pa agjëruara dhe agjërimit të premtuar nuk e bënë nijetin para agimit. Nëse nuk e bënë nijetin para agimit, agjërimit i tij nuk ka për të qenë i drejtë. Ndërsa, sa i përket agjërimit vullnetar, është e lejuar që nijeti të bëhet edhe pas agimit. Ky është qëndrimi i Shafiut, Ahmedit dhe i Is'hakut.”

⁷⁷⁴ Neveviu konsideron, që këto fjalë të Aishes, duhet kuptuar në kuptimin e paralajmërimit. Shmanguni puthjeve dhe ledhatimeve, derisa jeni agjërueshëm, sepse ju nuk jeni si i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe nuk mund t'i rezistoni përherë sprovave.

⁷⁷⁵ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁷⁷⁶ Ebu Mejser Amr b. Shurahbil el-Kufi el-Hemdani, është muhadremi. Ishte jashtëzakonisht i besueshëm dhe i nënshtruar.

⁷⁷⁷ Në bazë të këtij hadithi, Ibn Umeri, Xhabir b. Zejdi, Maliku, El-Mazini dhe Davudi, kanë vërtetuar, që asnjë lloj i agjërimit – pa dallim se a ka të bëjë me agjërimit vullnetar apo të obliguar – nuk është i drejtë nëse nijeti nuk bëhet para agimit. Dijetarët e tjerë, konsiderojnë, se për agjërimit vullnetar, nijeti mund të bëhet edhe gjatë ditës. Këtë qëndrim e mbështesin mbi hadithin, të cilin e ka transmetuar Aishja. Ajo thotë: “Nganjëherë i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) pyeste: “A ka diç për drekë?” Kur i thosha se nuk ka, ai thoshte: “Atëherë sot kam për të agjëruar.”

حَدَّثَنَا إِسْحَاقُ بْنُ مُصُورٍ، أَخْبَرَنَا ابْنُ أَبِي مَرْيَمَ، أَخْبَرَنَا يَحْيَى بْنُ أَيُّوبَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ أَبِي بَكْرٍ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ سَالِمِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ حَفْصَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَنْ لَمْ يَجْمَعْ الصِّيَامَ قَبْلَ الْفَجْرِ فَلَا صِيَامَ لَهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ حَفْصَةَ حَدِيثٌ لَا نَعْرِفُهُ مَرْفُوعًا إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ نَافِعٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ قَوْلُهُ وَهُوَ أَصَحُّ وَهَكَذَا أَيْضًا رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ الزُّهْرِيِّ مَوْفُوفًا وَلَا نَعْلَمُ أَحَدًا رَفَعَهُ إِلَّا يَحْيَى بْنُ أَيُّوبَ . وَإِنَّمَا مَعْنَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ لَا صِيَامَ لِمَنْ لَمْ يَجْمَعْ الصِّيَامَ قَبْلَ طُلُوعِ الْفَجْرِ فِي رَمَضَانَ أَوْ فِي قَضَاءِ رَمَضَانَ أَوْ فِي صِيَامِ نَذْرٍ إِذَا لَمْ يَنْوِهِ مِنَ اللَّيْلِ لَمْ يُجْزِهِ وَأَمَّا صِيَامُ التَّطَوُّعِ فَمُبَاحٌ لَهُ أَنْ يَنْوِيهِ بَعْدَ مَا أَصْبَحَ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

34. Mbi prishjen e agjërimin nga ai i cili është duke agjëruar agjërim vullnetar

باب مَا جَاءَ فِي إِفْطَارِ الصَّائِمِ الْمُتَطَوِّعِ

730. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Ahvesi, duke transmetuar nga Simak b. Harbi, ai nga i biri i Umme-Hanes – që Umme-Hanja, ka thënë: “Me një rast, isha duke ndenjur tek i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Dikush i solli ujë dhe ai piu. Pastaj ma dha edhe mua, e edhe unë pira. Duke e bërë atë, thash: ‘Unë bëra mëkat, andaj kërko falje për mua!’ ‘Çfarë mëkati?’ – pyeti i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Unë thash: ‘Unë (sot) isha duke agjëruar dhe ja, pra bëra iftar?’ – ‘A ke qenë duke agjëruar agjërim kompensues?’ – pyeti ai. ‘Jo, por isha duke agjëruar nafile.’ – thash, ndërsa ai në atë tha: ‘Atëherë, për atë nuk ke mëkat.’”⁷⁷⁸

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو الْأَحْوَصِ، عَنْ سِمَاكِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ ابْنِ أُمِّ هَانِيٍّ، عَنْ أُمِّ هَانِيٍّ، قَالَتْ كُنْتُ قَاعِدَةً عِنْدَ النَّبِيِّ ﷺ فَأَتَانِي بِشَرَابٍ فَشَرِبْتُ مِنْهُ ثُمَّ تَوَلَّيْتُ فَشَرِبْتُ مِنْهُ فَقُلْتُ إِنِّي أَذْنَبْتُ فَاسْتَغْفِرْ لِي . فَقَالَ " وَمَا ذَاكَ " . قَالَتْ كُنْتُ صَائِمَةً فَأَقْطَرْتُ . فَقَالَ " أَمِنْ قَضَاءٍ كُنْتَ تَقْضِيهِ " . قَالَتْ لَا . قَالَ " فَلَا يَضُرُّكَ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَعَائِشَةَ .

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi⁷⁷⁹ dhe Aishja. Mbi senedin e hadithit të Umme-Hanes, ka vërejtje.⁷⁸⁰ Sipas tij kanë vepruar disa dijetarë nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Ata konsiderojnë, që ai, i cili është duke agjëruar nafile dhe e ka prishur agjërimin, nuk është i obliguar ta agjërojë për ta kompensuar atë ditë, përveç nëse dëshiron. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Ahmedit, Is’hakut dhe i Shafiut.”

قَالَ وَحَدِيثُ أُمِّ هَانِيٍّ فِي إِسْنَادِهِ مَقَالٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ الصَّائِمَ الْمُتَطَوِّعَ إِذَا أَقْطَرَ فَلَا قَضَاءَ عَلَيْهِ إِلَّا أَنْ يُحِبَّ أَنْ يَقْضِيَهُ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ وَالشَّافِعِي .

731. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, atë Shu’be – që Simak b. Harbi, ka thënë: “Më ka treguar njëri nga pasardhësit e Umme-Hanes, ndërsa unë e kam takuar më të çmuarin prej tyre, emri i të cilit ishte Xha’de dhe i cili Umme-Hanen e kishte gjyshe. Ai më ka treguar duke transmetuar nga gjyshja e vet, që me një rast, tek ajo kishte hyrë i Dërguari i Allahut dhe kishte kërkuar ujë, kishte pirë ujë, pastaj ia ka dhënë asaj dhe edhe ajo kishte pirë. Pastaj, kishte thënë: ‘I Dërguari i Allahut, unë isha duke agjëruar!’ – në çka i Dërguari i Allahut tha: ‘Ai që është duke agjëruar agjërim vullnetar, është i besueshmi i vetvetes. Nëse dëshiron, mund të agjërojë. Por nëse

⁷⁷⁸ Në transmetimin e këtij hadithi, nga Ebu Davudi, qëndron: “Nëse ka të bëjë me nafile, atëherë, në atë nuk ke mëkat.”

⁷⁷⁹ Bejhekiu shënon, se Ebu Seidi ka thënë: “Me një rast, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka përgatitur ushqim. Kur ishte shtruar ushqimi, një njeri, i cili gjithashtu ka qenë i ftuar, tha: “Unë jam duke agjëruar.” I Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “Vëllai yt të ka ftuar dhe për shkak tëndin ka shpenzuar, prandaj prishe agjërimin dhe nëse dëshiron, më vonë kompensoje!”

⁷⁸⁰ Në senedin e këtij hadithi, gjenden dy ravi, të cilët, disa dijetarë i konsiderojnë të dobët: Simak b. Harb, për të cilin Nesaiu thotë që në hadithet, të cilët ai i ka transmetuar nuk mund të mbështetemi, edhe Haruni, i biri i Umme Hannes, për të cilin Ibn Kattani ka thënë që është i panjohur.

nuk dëshiron mund ta prishë agjërimin.’ Shu’be, thotë: ‘Unë i thash: A e ke dëgjuar atë drejtpërdrejt nga Umme-Hanja?’ – e ai tha: ‘Jo, por më kanë informuar Ebu Salihi dhe të afërmit e mi, duke transmetuar nga Umme-Hanja.’”

Ebu Isai, thotë: “Këtë hadith e ka transmetuar Hammad b. Seleme nga Simaku, e ai ka thënë që e transmeton nga Haruni, ai nga djali i vajzës së Umme-Hanes, ndërsa ai nga Umme-Hanja. Transmetimi i Shu’bes është më i mirë. Të njëjtën, gjithashtu, na ka treguar Mahmud b. Gajlani, duke transmetuar, që Ebu Davudi, ka thënë: “Është i besueshmi i vetvetes.” Të tjerët, përveç Mahmudit na kanë treguar, duke transmetuar që Ebu Davudi, ka thënë: “Është *emir* (udhëheqës) i vetvetes.” – ose ‘Është *emin* (i besueshmi) i vetvetes.’ - por me mëdyshje. Gjithashtu edhe nga Shu’be është transmetuar me mëdyshje “Është *emir* ose *emin* i vetvetes.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، قَالَ كُنْتُ أَسْمَعُ سِمَاكَ بْنَ حَرْبٍ يَقُولُ أَخَذْتُ ابْنِي أُمَّ هَانِيَّ حَدَّثَنِي فَلَقِيتُ، أَنَا أَفْضَلُهُمَا، وَكَانَ، اسْمُهُ جَعْدَةَ وَكَانَتْ أُمُّ هَانِيَّ جَدَّتَهُ فَحَدَّثَنِي عَنْ جَدَّتِهِ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ دَخَلَ عَلَيْهَا فَدَعَى بِشَرَابٍ فَشَرِبَ ثُمَّ نَاولَهَا فَشَرِبَتْ فَقَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ أَمَا إِنِّي كُنْتُ صَائِمَةً . فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " الصَّائِمُ الْمُتَطَوِّعُ أَمِينٌ نَفْسِهِ إِنْ شَاءَ صَامَ وَإِنْ شَاءَ أَفْطَرَ " . قَالَ شُعْبَةُ فَقُلْتُ لَهُ أَأَنْتَ سَمِعْتَ هَذَا مِنْ أُمِّ هَانِيَّ قَالَ لَا أَخْبَرَنِي أَبُو صَالِحٍ وَأَهْلُنَا عَنْ أُمِّ هَانِيَّ . وَرَوَى حَمَادُ بْنُ سَلَمَةَ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ سِمَاكَ بْنِ حَرْبٍ فَقَالَ عَنْ هَارُونَ ابْنِ بَنْتٍ أُمِّ هَانِيَّ عَنْ أُمِّ هَانِيَّ . وَرَوَاهُ شُعْبَةُ أَحْسَنُ . هَكَذَا حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ عَنْ أَبِي دَاوُدَ فَقَالَ " أَمِينٌ نَفْسِهِ " . وَحَدَّثَنَا غَيْرُ مُحَمَّدٍ عَنْ أَبِي دَاوُدَ فَقَالَ " أَمِيرٌ نَفْسِهِ أَوْ أَمِينٌ نَفْسِهِ " . عَلَى الشَّكِّ وَهَكَذَا رَوَى مِنْ غَيْرِ وَجْهٍ عَنْ شُعْبَةَ " أَمِينٌ أَوْ أَمِيرٌ نَفْسِهِ " عَلَى الشَّكِّ .

Kryerja e një agjërimi vullnetar pa e planifikuar atë një natë më parë

بَابُ صِيَامِ الْمُتَطَوِّعِ بِغَيْرِ تَنْبِيْهِ

732. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Talha b. Jahja,⁷⁸¹ ai nga tezja e vet Aishja, vajza e Talhas – që Aishja, nëna a besimtarëve, ka thënë: “Një ditë hyri tek unë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) dhe tha: ‘A ke diç për të ngrënë?’ ‘Nuk kam asgjë.’ – thash unë – ndërsa ai tha: ‘Atëherë do të agjërojë.’”

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ طَلْحَةَ بْنِ يَحْيَى، عَنْ عَمْرِو بْنِ عَمَّارٍ، عَنْ عَائِشَةَ بِنْتِ طَلْحَةَ عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ، قَالَتْ دَخَلَ عَلَيَّ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَوْمًا فَقَالَ " هَلْ عِنْدَكُمْ شَيْءٌ " . قَالَتْ قُلْتُ لَا . قَالَ " فَإِنِّي صَائِمٌ " .

733. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Bishr b. Es-Serijj, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Talha b. Jahja, ai nga Aishja, vajza e Talhas – që Aishja, nëna e besimtarëve ka thënë: “Zakonisht, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), kthehej tek unë dhe më pyeste: ‘A ke diç për drekë?’ Nëse i thosha që nuk kam, ai thoshte: ‘Atëherë do të agjërojë.’ Kështu, një ditë – thotë ajo – erdhi dhe unë i thash: ‘Kemi marr hedie!’ ‘Çfarë?’ – pyeti ai. ‘Ushqim me hurme të përziera me tëlyen dhe kulloshtë?’ – thash unë, ai në atë tha: ‘Ndërsa unë në mëngjes fillova të agjëroj!’ ‘Pastaj’ – thotë ajo – ‘hëngri.’”⁷⁸² Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen.”⁷⁸³

⁷⁸¹ Talha b. Jahja b. Talha b. Ubejdullah et-Teimi el-Medini, është transmetues i sinqertë, por ka qenë i prirë për gabime. I takonte gjeneratës së gjashtë të ravine.

⁷⁸² Shumica e dijetarëve të hadithit, këtë hadith e marrin si argument që, ai i cili është duke e falur nafilen, e ka të lejuar, nëse dëshiron, ta prishë agjërimin, pa arsye të justifikueshme dhe që nuk është i obliguar ta agjëroj përsëri. Ebu Hanife konsideron, që as agjërimi vullnetar nuk mund të priset pa arsye të justifikueshme. Në rast se ndërpritet, duhet të agjërohet përsëri.

⁷⁸³ E shënon Muslimi në *Sahih*.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ السَّرِيِّ، عَنْ سَعْيَانَ، عَنْ طَلْحَةَ بْنِ يَحْيَى، عَنْ عَائِشَةَ بِنْتِ طَلْحَةَ، عَنْ عَائِشَةَ أُمِّ الْمُؤْمِنِينَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَأْتِينِي فَيَقُولُ " أَعْنَدِكَ عَدَاءٌ " . فَأَقُولُ لَا . فَيَقُولُ " إِنِّي صَائِمٌ " . قَالَتْ فَأَتَانِي يَوْمًا فَقُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّهُ قَدْ أَهْدَيْتَ لَنَا هَدِيَّةً . قَالَ " وَمَا هِيَ " . قَالَتْ قُلْتُ خَيْسٌ . قَالَ " أَمَا إِنِّي قَدْ أَصْبَحْتُ صَائِمًا " . قَالَتْ ثُمَّ أَكَلْتُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ .

35. Mbi obligimin e agjërimin për ta kompensuar agjërimin vullnetar

بَاب مَا جَاءَ فِي إِبْجَابِ الْقَضَاءِ عَلَيْهِ

734. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Kethir b. Hishami, atë Xha'fer b. Burkani, ai ka transmetuar nga Zuhriu, ai nga Urve – që Aishja, ka thënë: “Unë dhe Hafsa, një ditë ishim duke agjëruar. Na e ofruan ushqimin, për të cilin na kishte marr malli dhe ne e hëngrëm atë. Në atë moment erdhi i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndërsa Hafsa, e cila i ngjante babait të vet, iu drejtuar më parë, sesa unë: ‘O i Dërguari i Allahut, ne ishim duke agjëruar dhe ne na u shtrua ushqimi për të cilin na kishte marr malli dhe ne e hëngrëm.’ Ai, në atë tha: ‘Agjëroni një ditë tjetër në vend të kësaj.’”⁷⁸⁴

Ebu Isai, thotë: “Ngjashëm me këtë hadith kanë transmetuar Salih b. Ebul Ahdar dhe Muhammed b. Ebu Hafsa, nga Zuhriu, ai nga Urve, e ai nga Aishja. Ndërsa, e kanë transmetuar edhe Malik b. Enesi, Ma'meri, Ubejdullah b. Umeri, Zijad b. Sa'di dhe shumë hafiz të tjerë të hadithit nga Zuhriu, ai nga Aishja, si hadith-mursel, duke mos e përmendur ‘Nga Urve’. Kjo është më e besueshme, sepse është transmetuar, që Ibn Xhurejxhi ka thënë: ‘E pyeta Zuhriun: ‘A të ka treguar ty Urve diç nga Aishja?’ Ai, tha: ‘Unë mbi këtë nga Urve nuk kam dëgjuar asgjë, por gjatë kohës së hilafetit të Sulejman b. Abdulmalikut, i kam dëgjuar disa njerëz të cilët transmetonin nga disa vetë, të cilët e kanë pyetur Aishen mbi këtë hadith.’”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا كَثِيرُ بْنُ هِشَامٍ، حَدَّثَنَا جَعْفَرُ بْنُ بُرْقَانَ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ عُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كُنْتُ أَنَا وَخَفْصَةُ، صَائِمَتَيْنِ فَعَرَضَ لَنَا طَعَامٌ اسْتَهْنَيْنَاهُ فَأَكَلْنَا مِنْهُ فَجَاءَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فَبَدَرْتَنِي إِلَيْهِ خَفْصَةُ وَكَانَتْ ابْنَةً أَبِيهَا فَقَالَتْ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّا كُنَّا صَائِمَتَيْنِ فَعَرَضَ لَنَا طَعَامٌ اسْتَهْنَيْنَاهُ فَأَكَلْنَا مِنْهُ . قَالَ " أَفْضِيَا يَوْمًا آخَرَ مَكَانَهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى صَالِحُ بْنُ أَبِي الْأَخْضَرِ وَمُحَمَّدُ بْنُ أَبِي خَفْصَةَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ عُرْوَةَ عَنْ عَائِشَةَ مِثْلَ هَذَا . وَرَوَاهُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَمَعْمَرُ وَعُيَيْنَةُ اللَّهِ بْنُ عُمَرَ وَزِيَادُ بْنُ سَعْدٍ وَغَيْرُ وَاحِدٍ مِنَ الْحَفَاطِ عَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ عَائِشَةَ مُرْسَلًا . وَلَمْ يَذْكُرُوا فِيهِ عَنْ عُرْوَةَ وَهَذَا أَصَحُّ . لِأَنَّهُ رُوِيَ عَنِ ابْنِ جُرَيْجٍ، قَالَ سَأَلْتُ الزُّهْرِيَّ قُلْتُ لَهُ أَحَدُكَ عُرْوَةُ عَنْ عَائِشَةَ قَالَ لَمْ أَسْمَعْ مِنْ عُرْوَةَ فِي هَذَا شَيْئًا وَلَكِنِّي سَمِعْتُ فِي خِلَافَةِ سُلَيْمَانَ بْنِ عَبْدِ الْمَلِكِ مِنْ نَاسٍ عَنْ بَعْضِ مَنْ سَأَلَ عَائِشَةَ عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ .

735. Mbi këtë, na ka treguar Ali b. Isa b. Jezid el-Bagdadi – atë e ka informuar Revh b. Ubade, duke transmetuar nga Ibn Xhurejxhi dhe e përmendi hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët i përmbahen këtij hadithi. Ata konsiderojnë që ai i cili agjëron nafile pastaj e prish agjërimin, është i obliguar ta kompensojë atë ditë. Ky është qëndrimi i Malik b. Enesit.”

حَدَّثَنَا بِدْلَافُ بْنُ عِيسَى بْنُ يَزِيدَ الْبَغْدَادِيُّ حَدَّثَنَا رَوْحُ بْنُ عُبَادَةَ عَنْ ابْنِ جُرَيْجٍ فَذَكَرَ الْحَدِيثَ . وَقَدْ ذَهَبَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِلَى هَذَا الْحَدِيثِ قَرَأُوا عَلَيْهِ الْقَضَاءَ إِذَا أَفْطَرَ وَهُوَ قَوْلُ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ .

⁷⁸⁴ Malik b. Enesi dhe Ebu Hanife, e marrin për argument këtë hadith, ku pohohet, që personi i cili duke e agjëruar nafilen, e prish, është i obliguar ta agjëroj përsëri atë ditë.

36. Mbi bashkimin e muajit Sha'ban me atë Ramazan

باب مَا جَاءَ فِي وَصَالِ شَعْبَانَ بِرَمَازَانَ

736. Na ka treguar Bundari – atë e ka informuar Abdurrahman b. Mehdiu, duke transmetuar nga Sufjani, ai nga Mensuri, ai nga Salim b. Ebul-Xha'di, ai nga Ebu Seleme – që Umm Seleme, ka thënë: “Kam parë, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), agjëronte vetëm dy muaj rresht: sha'banin dhe ramazanin.”⁷⁸⁵

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar edhe hadithi nga Aishja. Hadithi i Ummu Selemes është hasen.⁷⁸⁶ Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar nëpërmjet Ebu Selemes, nga Aishja: “Kam parë, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në asnjë muaj tjetër nuk agjëronte aq (nafle), siç e bënte atë në muajin sha'ban. Gati të tërin, madje të tërin e agjëronte.”⁷⁸⁷

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ، عَنْ سُفْيَانَ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ سَالِمِ بْنِ أَبِي الْجَعْدِ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أُمِّ سَلَمَةَ، قَالَتْ مَا رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ يَصُومُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ إِلَّا شَعْبَانَ وَرَمَازَانَ. وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ. قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أُمِّ سَلَمَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ. وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ، أَيْضًا عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّهَا قَالَتْ مَا رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ فِي شَهْرِ أَكْثَرَ صِيَامًا مِنْهُ فِي شَعْبَانَ كَانَ يَصُومُهُ إِلَّا قَلِيلًا بَلْ كَانَ يَصُومُهُ كُلَّهُ.

737. Në të njëjtën mënyrë më ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Abde, duke transmetuar nga Muhammed b. Amëri, atij i ka treguar Ebu Seleme, duke transmetuar nga Aishja – ajo nga i Dërguari, (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) – sikurse hadithin e mëparshëm.

Ebu Isai, thotë: “Këtë hadith e kanë transmetuar Salim Ebu Nadr dhe të tjerët, nga Ebu Seleme, e ai nga Aishja, ngjashëm me transmetimin e Muhammed b. Amërit.”

Transmetohet, që Ibn Mubareku, duke folur mbi këtë hadith, ka thënë: “Është e lejuar në gjuhën arabe, që për atë i cili e ka agjëruar shumicën e ditëve të muajit të thuhet që e ka agjëruar tërë muajin. Ashtu për shembull, për dikë thuhet që është falur tërë natën, edhe pse ai gjatë asaj nate ka darkuar ose ndoshta ka bërë edhe disa punë të tjera.” Si duket, Ibn Mubareku të dy hadithet i konsideron të përshtatshme. Ai thotë: “Ky hadith (në të cilin qëndron që ka agjëruar tërë muajin) do të thotë, që ka agjëruar shumicën e ditëve të muajit.”

حَدَّثَنَا هَنَّاْدٌ حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ عَمْرٍو حَدَّثَنَا أَبُو سَلَمَةَ عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ بِذَلِكَ. وَرَوَى عَنْ ابْنِ الْمُبَارَكِ أَنَّهُ قَالَ فِي هَذَا الْحَدِيثِ هُوَ جَائِزٌ فِي كَلَامِ الْعَرَبِ إِذَا صَامَ أَكْثَرَ الشَّهْرِ أَنْ يُقَالَ صَامَ الشَّهْرَ كُلَّهُ وَيُقَالُ قَامَ فَلَانٌ لَيْلَهُ أَجْمَعٌ. وَلَعَلَّهُ تَعَشَّى وَاشْتَغَلَ بِبَعْضِ أَمْرِهِ. كَانَ ابْنُ الْمُبَارَكِ قَدْ رَأَى كِلَا الْحَدِيثَيْنِ مُتَّفِقَيْنِ يَقُولُ إِنَّمَا مَعْنَى هَذَا الْحَدِيثِ أَنَّهُ كَانَ يَصُومُ أَكْثَرَ الشَّهْرِ.

⁷⁸⁵ Në transmetimin e këtij hadithi, nga Ebu Davudi, qëndron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë vitit, nuk e ka agjëruar asnjë muaj në tërësi, përveç muajin sha'ban, të cilin e bashkonte me ramazanin.

⁷⁸⁶ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

⁷⁸⁷ Sipas mendimit të El-Mubarekfurit, ky hadith, mund të kuptohet në disa mënyra: 1) I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndonjëherë e agjëronte tërë muajin shaban, e ndonjëherë shumicën e ditëve të tij; 2) Ai i agjëronte një numër të caktuar ditësh në fillim të shabanit, një numër të caktuar në mes të shabanit dhe një numër të caktuar në fund, ashtu që me agjërim e përfshinte tërë muajin; 3) hadithi në të cilin qëndron, se e ka agjëruar shumicën e ditëve të shabanit, e sqaron tjetri, në të cilin qëndron, se e ka agjëruar të tërin. Sipas mendimit të Mubarekfurit, në të fjalat *të tërin* është përdorur në kuptimin e diçkaje në shumës, e jo në tërësi.

37. Është i qortuar agjërimi në pjesën e dytë të sha'banit për shkak të ramazanit

باب ما جاء في كراهية الصوم في النصف الثاني من شعبان لحال رمضان

738. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi, ai ka transmetuar nga Ala b. Abdurahmani, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kur mbetet gjysma e muajit sha'ban, mos agjëroni (më).”⁷⁸⁸

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih,⁷⁸⁹ e kemi të njohur vetëm me këtë rrugë dhe në këtë formë.”

Sipas mendimit të disa dijetarëve, ky hadith ka të bëjë me njeriun i cili nuk agjëron deri para fundit të muajit, pastaj agjëron për shkak të ramazanit. Ebu Hurejre, transmeton ngjashëm nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Mos agjëroni para fillimit të ramazanit, përveç nëse ai agjërim nuk është në kuadër të agjërimit, të cilin ndonjëri nga ju e ka bërë shprehi ta agjëronte.”⁷⁹⁰ Në këtë hadith, është argumenti që mos-pëlqyeshmëria ka të bëjë me atë i cili agjëron qëllimisht për shkak të ramazanit.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ الْعَلَاءِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِذَا بَقِيَ نِصْفُ مِنْ شَعْبَانَ فَلَا تَصُومُوا ". قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ عَلَى هَذَا اللَّفْظِ . وَمَعْنَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ أَنْ يَكُونَ الرَّجُلُ مُفْطِرًا فَإِذَا بَقِيَ مِنْ شَعْبَانَ شَيْءٌ أَخَذَ فِي الصَّوْمِ لِحَالِ شَهْرِ رَمَضَانَ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مَا يُشْبِهُ قَوْلَهُمْ حَيْثُ قَالَ ﷺ " لَا تَقْدَمُوا شَهْرَ رَمَضَانَ بِصِيَامٍ إِلَّا أَنْ يُوَافِقَ ذَلِكَ صَوْمًا كَانَ يَصُومُهُ أَحَدُكُمْ " . وَقَدْ دَلَّ فِي هَذَا الْحَدِيثِ أَنَّ كَرَاهِيَةَ عَلَى مَنْ يَتَعَمَّدُ الصِّيَامَ لِحَالِ رَمَضَانَ .

38. Mbi netët e gjysmës së muajit sha'ban⁷⁹¹

باب ما جاء في ليلة النصف من شعبان

739. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Jezid b. Haruni, atë Haxhaxhaxh b. Ertate, ai ka transmetuar nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Urve – që Aishja, ka thënë: “Një natë vërejta, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk ishte (pranë meje). Dola për të parë se ku është, kur ja, ai qëndronte në Bekkije.”⁷⁹² Duke më parë mua, tha: ‘Vallë, a pate frikë që Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë për të vepruar padrejtësisht ndaj teje?’ Unë thash: ‘I Dërguari i Allahut, mendova se ke shkuar te ndonjëra nga bashkëshortet e tua (të tjera).’ – ai në atë tha: ‘Allahu i Lartësuar zbret gjatë natës, në gjysmë të muajit sha'ban, mbi qiellin tokësor dhe falë më tepër mëkate sesa ka qime në leshin e tufës⁷⁹³ së deleve të Kelbiut.⁷⁹⁴

⁷⁸⁸ Ali el-Karin konsideron, se në këtë hadith, ndalesa është përdorur në kuptim të mekruhut më të lehtë, e jo të haramit. Shkaku, për çfarë i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk ua rekomandon agjërimin pasuesve të vet, në gjysmën e dytë të muajit shaban, është që të mos dobësoheshin fizikisht, sepse ajo do t'u paraqiste vështirësi gjatë agjërimit të ramazanit.

⁷⁸⁹ Ibn Hibbani këtë hadith e konsideron sahih.

⁷⁹⁰ Nëse ndokush ndjenë që fizikisht mund ta përballoj dhe zakonisht e agjëron tërë muajin shaban dhe e bashkon atë me ramazanin, me të nuk ka të bëjë kjo ndalesë. Ajo ka të bëjë me ata që e agjërojnë ditën e dyshimtë. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: “Mos agjëroni një ose dy ditë para ramazanit.”

⁷⁹¹ Kjo është, e pesëmbëdhjeta natë e sha'banit, të cilën e quajnë, Nata e amnestimit/Lejletul-berat.

⁷⁹² Bekija, janë varrezat e njohura muslimane në Medine.

⁷⁹³ Fisi Benu Kelb, nga të gjitha fiset arabe, kanë pasur më së tepërmi dele.

⁷⁹⁴ Abdurrahman el-Mubarekfuri thotë, se mbi natën e pesëmbëdhjetë të shabanit, flasin shumë hadithe. Ai është argument, pohon ai, se kjo natë ka bazë. Bejhekiu thotë, që Aishja ka thënë: “Një natë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), duke e falur namazin e natës, aq gjatë mbeti në sexhde, sa që

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Bekër es-Siddiku. Hadithi i Aishes,⁷⁹⁵ më është i njohur në këtë formë, vetëm nëpërmjet Haxhaxhit. E kam dëgjuar Muhammedin, kur ka thënë: “Këtë hadith e konsideronin të dobët sepse Jahja b. Ebu Kethiri, nuk ka dëgjuar hadithe nga Urve, e as Haxhaxhi, nuk i ka dëgjuar nga Jahja b. Kethiri.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ هَارُونَ، أَخْبَرَنَا الْحَجَّاجُ بْنُ أَرْطَاةَ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ عُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ فَقَدْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ لَيْلَةً فَخَرَجْتُ فَإِذَا هُوَ بِالْبَيْعِ فَقَالَ " أَكُنْتُ تَخَافِينَ أَنْ يَجِيفَ اللَّهُ عَلَيْكَ وَرَسُولُهُ " . قُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنِّي ظَنَنْتُ أَنَّكَ أَتَيْتَ بَعْضَ نِسَائِكَ . فَقَالَ " إِنَّ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ يَنْزِلُ لَيْلَةَ النَّصْفِ مِنْ شَعْبَانَ إِلَى السَّمَاءِ الدُّنْيَا فَيَغْفِرُ لَأَكْثَرِ مَنْ عَدِدَ شَعْرَ غَنَمٍ كَلْبٍ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ هَذَا الْوَجْهِ مِنْ حَدِيثِ الْحَجَّاجِ . وَسَمِعْتُ مُحَمَّدًا يُضَعِّفُ هَذَا الْحَدِيثَ وَقَالَ يَحْيَى بْنُ أَبِي كَثِيرٍ لَمْ يَسْمَعْ مِنْ عُرْوَةَ وَالْحَجَّاجِ بْنِ أَرْطَاةَ لَمْ يَسْمَعْ مِنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ .

39. Mbi agjërimin në muajin muharrem

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ الْمُحَرَّمِ

740. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avani, ai ka transmetuar nga Ebu Bishri, ai nga Humejd b. Abdurahman el-Himejri, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjërimi më i vlefshëm është agjërimi, pas agjëritit të ramazanit, agjërimi në muajin e Allahut muharrem.”⁷⁹⁶ Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Hurejres është hasen.”⁷⁹⁷

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ أَبِي بَشِيرٍ، عَنْ حُمَيْدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْحُمَيْرِيِّ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَفْضَلُ الصِّيَامِ بَعْدَ صِيَامِ شَهْرِ رَمَضَانَ شَهْرُ الْمُحَرَّمِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ .

741. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ali b. Mushiri, ai ka transmetuar nga Abdurrahman b. Is’haku, ai nga Nu’man b. Sa’di – që një njeri, e pyeti Aliun: “Në cilin muaj, pas ramazanit më kishe propozuar të agjëroj?” Ai i tha: “Vetëm një njeri e kam dëgjuar, që ka pyetur mbi atë. E kam dëgjuar atë duke e pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), derisa unë isha duke ndenjtur tek ai: ‘O, i Dërguar i Allahut, në cilin muaj, pas ramazanit më propozon të agjëroj?’ Ai tha: ‘Nëse pas ramazanit do të kishe dëshiruar të agjërosh, atëherë agjëro në muajin muharrem – sepse ai është Muaji i Allahut. Në të është dita, në të cilën Allahu e ka falur popullin’⁷⁹⁸ e

mendova se ka vdekur. Pasi e vërejta atë, u ngrita, ia lëviza gishtin tregues dhe ai lëvizi, mandej u kthye nga sexhdja. Kur u ngrit nga sexhdja dhe e përfundoi namazin, më tha: “O Aishe (se ka thënë: O Humejra), a mendove që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) të mashtroi?” Unë thash: “Jo, pasha Allahun, i Dërguari i Allahut! Nuk e mendova atë, por që ke vdekur, sepse mbete shumë gjatë në sexhde.” E ai , në atë tha: “Po, a e di se cila natë është kjo?” Thash: “Allahu dhe i Dërguari i Tij, më së miri e dinë atë!” Ai tha: “Kjo është nata në gjysmë të muajit shaban. Ndërsa në natën e gjysmë të muajit shaban, Allahu i Lartësuar i vështron me kujdes robërit e Vet, i falë ata, të cilët në të kërkojnë falje nga Allahu dhe i mbulon me Mëshirën e Vet, ata të cilët e kërkojnë atë prej Tij. Vetëm ata që i urrejnë të tjerët, i lë pa asgjë.” Shënon Bejhekiu, Taberaniu, në *Mu’xhemul-Vesit* dhe Ibn Hibbani, në *Sahih*, nga Muadh b. Xhebeli, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Natën e gjysmës së muajit shaban, Allahu i Lartësuar me kujdes i vështron robërit e Vet dhe i falë të gjitha krijesat e veta, përveç mushrikut dhe atë i cili i urren të tjerët.”

⁷⁹⁵ E shënon Ibn Maxhe dhe Bejhekiu. Senedi i këtij hadithi është i ndërprerë në dy vende: në mes Haxhaxhit dhe Jahjasë, si dhe Jahjasë dhe Urves.

⁷⁹⁶ Në transmetimin e Muslimit, të këtij hadithi, ekziston kjo shtojcë: “(...) E pas namazeve të obliguara më i vlefshmi është namazi i natës.”

⁷⁹⁷ Atë e shënon, Muslimi në *Sahih*.

⁷⁹⁸ El-Mubarekfuri, pohon, që ai ka qenë populli i Musait, të cilin Allahu i Lartësuar e ka falur dhe shpëtuar nga Faraoni.

mëhershëm dhe në të cilin ka për të falur popullin⁷⁹⁹ (i cili ka për të jetuar) më vonë.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، قَالَ أَخْبَرَنَا عَلِيُّ بْنُ مُسْهِرٍ، عَنْ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ إِسْحَاقَ، عَنِ الثَّعْمَانِ بْنِ سَعْدٍ، عَنْ عَلِيٍّ، قَالَ سَأَلَهُ رَجُلٌ فَقَالَ أَيُّ شَهْرٍ تَأْمُرُنِي أَنْ أَصُومَ بَعْدَ شَهْرِ رَمَضَانَ قَالَ لَهُ مَا سَمِعْتُ أَحَدًا يَسْأَلُ عَنْ هَذَا إِلَّا رَجُلًا سَمِعْتُهُ يَسْأَلُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ وَأَنَا قَاعِدٌ فَقَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ أَيُّ شَهْرٍ تَأْمُرُنِي أَنْ أَصُومَ بَعْدَ شَهْرِ رَمَضَانَ قَالَ " إِنْ كُنْتَ صَائِمًا بَعْدَ شَهْرِ رَمَضَانَ فَصُمِ الْمُحَرَّمَ فَإِنَّهُ شَهْرُ اللَّهِ فِيهِ يَوْمٌ تَابَ اللَّهُ فِيهِ عَلَى قَوْمٍ وَيَتُوبُ فِيهِ عَلَى قَوْمٍ آخَرِينَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

40. Mbi agjërimin e të premtëve

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ يَوْمِ الْجُمُعَةِ

742. Na ka treguar Kasim b. Dinari – atë e ka informuar Ubejdullah b. Musa dhe Talk b. Gannami, ata dy kanë transmetuar nga Shejbani, ai nga Asimi, ai nga Zirra – që Abdullahu,⁸⁰⁰ ka thënë: “I Dërguar i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në fillim të çdo muaji agjëronte nga tre ditë dhe rrallë herë nuk agjëronte të premtëve.”⁸⁰¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri dhe Ebu Hurejre. Hadithi i Abdullahut është hasen-garib.⁸⁰² Disa dijetarë, agjërimin të premtëve e konsiderojnë mustehab. Është mekruh të agjërohet vetëm të premtën pa agjëruar një ditë përpara ose pas të premtës. Shu’be, këtë hadith e ka transmetuar nga Asimi dhe nuk e ka lidhur atë për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا الْقَاسِمُ بْنُ دِينَارٍ، حَدَّثَنَا غُبَيْدُ اللَّهِ بْنُ مُوسَى، وَطَلْقُ بْنُ غَنَامٍ، عَنْ شَيْبَانَ، عَنْ عَاصِمٍ، عَنْ زَيْدٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَصُومُ مِنْ غُرَّةِ كُلِّ شَهْرٍ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ وَقَلَّمَا كَانَ يُفْطِرُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَبْدِ اللَّهِ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ . وَقَدْ اسْتَحَبَّ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ صِيَامَ يَوْمِ الْجُمُعَةِ وَإِنَّمَا يُكْرَهُ أَنْ يَصُومَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ لَا يَصُومَ قَبْلَهُ وَلَا بَعْدَهُ . قَالَ وَرَوَى شُعْبَةُ عَنْ عَاصِمٍ هَذَا الْحَدِيثَ وَلَمْ يَرْفَعْهُ .

41. Mbi atë që agjërimi të premtëve është mekruh (i papëlqyer)

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ صَوْمِ يَوْمِ الْجُمُعَةِ وَحْدَهُ

742. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga A’meshi, ai nga Ebu Salihi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Asnjëri nga ju të mos agjërojë të premtën, përveç nëse agjëron një ditë përpara ose një ditë pas saj.”⁸⁰³

⁷⁹⁹ Ata janë pasuesit e Muhammedit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁸⁰⁰ Ejala është për Abdullah b. Mes’udin, as’hab i njohur, i cili bie në mesin e atyre të cilët kanë transmetuar hadithe më së shumti nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).

⁸⁰¹ Duke e pasur parasysh, që shumica e dijetarëve konsiderojnë, që të agjëruarit vetëm të premtën pa agjëruar një ditë përpara ose një ditë prapa, është mekruh., Muz-hiri konsideron, që edhe në këtë hadith nënkuptohet, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me të premtën e agjëronte një ditë përpara ose prapa, megjithatë e agjëroja të premtën, por ka të bëjë me specifikën e cila ka vlejtur vetëm për të. Ebu Hanife dhe Maliku, duke u mbështetur në këtë hadith, konsiderojnë, që nuk është mekruh të agjërohet vetëm të premtën.

⁸⁰² E shënon Nesaiu në *Sunen*, Ibn Maxhe në *Sahih*. Ibn Hibbani e konsideron hadith sahih.

⁸⁰³ Në kapitullin e mëparshëm, kemi përmendur, që sipas mendimit të dijetarëve të shumtë, ndalesa në hadithet e cekura, është theksuar në kuptimin e mekruh të butë. Në përgjigjen, përse ndalohet agjërimi vetëm të premtën, dijetarët cekin disa shkaqe të mundshme: 1) E premtja është ditë mubarek e muslimanëve, andaj në atë ditë nuk është i rekomanduar agjërimi, përveç se agjërimi i një dite para saj ose pas saj; 2) që duke agjëruar, të mos

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Xhabiri, Xhunad el-Ezdriu, Xhujerija, Enesi dhe Abdullah b. Amëri. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-shih.⁸⁰⁴ Në pajtim me të, është edhe veprimi i dijetarëve. Ata konsiderojnë të papëlqyer agjërimin vetëm të premtëve, e jo edhe një ditë para ose pas të premtës. Ky është mendimi i Ahmedit dhe i Is’hakut.”

حَدَّثَنَا هَذَا، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ الْأَعْمَشِ، عَنْ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا يَصُومُ أَحَدُكُمْ يَوْمَ الْجُمُعَةِ إِلَّا أَنْ يَصُومَ قَبْلَهُ أَوْ يَصُومَ بَعْدَهُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَجَابِرٍ وَجُنَادَةَ الْأَزْدِيِّ وَجُوَيْرِيَةَ وَأَنَسٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ يَكْزَهُونَ لِلرَّجُلِ أَنْ يَخْتَصَّ يَوْمَ الْجُمُعَةِ بِصِيَامٍ لَا يَصُومُ قَبْلَهُ وَلَا بَعْدَهُ . وَبِهِ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

42. Mbi agjërimin të shtunave

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ يَوْمِ السَّبْتِ

744. Na ka treguar Humejd b. Mes’ade – atë e ka informuar Suffjan b. Habibi, ai ka transmetuar nga Thevr b. Jezidi, ai nga Halid b. Ma’dani, ai nga Abdullah b. Busra, ai nga motra e vet⁸⁰⁵ - që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Mos e agjëroni të shtunën, përveç asaj që u është urdhëruar.”⁸⁰⁶ Nëse ndokush nga ju nuk do të gjente asgjë (nga ushqimi) përveç gjithë të hardhisë ose degëzës së drurit, le ti përtpyo ato.”⁸⁰⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.⁸⁰⁸ Mos-pëlqyeshmëria këtu pasqyrohet në agjërimin vetëm të shtunave. Hebrejët e festojnë të shtunën.”

حَدَّثَنَا حُمَيْدُ بْنُ مُسْعَدَةَ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ حَبِيبٍ، عَنْ ثَوْرِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ خَالِدِ بْنِ مَعْدَانَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بُسْرِ، عَنْ أَخِيهِ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ قَالَ " لَا تَصُومُوا يَوْمَ السَّبْتِ إِلَّا فِيمَا افْتَرَضَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ فَإِنْ لَمْ يَجِدْ أَحَدُكُمْ إِلَّا لِحَاءَ عِنَبَةٍ أَوْ عُودَ شَجَرَةٍ فَلْيَمْضُغْهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَمَعْنَى كَرَاهَتِهِ فِي هَذَا أَنْ يَخْصَّ الرَّجُلُ يَوْمَ السَّبْتِ بِصِيَامٍ لِأَنَّ الْيَهُودَ تُعْظِمُ يَوْمَ السَّبْتِ .

dobësohet fizikisht për ibadetin, i cili të premtëve duhet të jetë më me intensitet; 3) nëse vazhdimisht do të agjërohej vetëm të premtën, njerëzit do të mund të fillonin të shenjtëronin atë, sikurse jehuditë që e shenjtërojnë të shtunën; 4) që njerëzit të mos e kuptojnë si obligim agjërimin e së premtës. 5) që të veprohej në kundërshtim me të krishterët, të cilëve u është urdhëruar agjërimi të premtëve. Sipas Ibn Haxherit, mendimi i parë do të mund të ishte më i drejtë, sepse është i bazuar mbi dy hadithe: “E premtja është ditë mubarek, andaj mos agjëroni të premtëve, përveç nëse me te e agjëroni një ditë para ose pas saj.” Ibn Ebu Shejbe, shënon, me sened të mirë, se Aliu ka thënë: “Kush nga ju dëshiron të agjëroj, agjërim vullnetar në çdo muaj, le të agjëroj të enjteve e jo të premtëve – sepse e premtja është ditë mubarek – gjatë së cilës edhe hahet edhe pihet.”

⁸⁰⁴ E kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁸⁰⁵ Motra e Abdullah b. Busras, quhej Behija. Ndërkaq, është më e njohur si Es-Samma.

⁸⁰⁶ Përveç, në rast se e shtuna, nuk bie ndesh me Ditën e ‘Arafatit, Ditën e Ashurës, ose me ndonjë ditë tjetër, në të cilën është mirë të agjërohet.

⁸⁰⁷ Nëse do të ndodhte, që ndokush të shtunave, nuk ka kurrfarë ushqimi, le të hajë atë ditë, madje edhe nëse do ta përtpypte lëvozhgën e hekurt, një degëz të drurit apo diç të ngjashme. Nga ky hadith, shumica e dijetarëve nxjerrin konkludim, se është mekruh të agjëruarit vetëm të shtunën, me përjashtim, nëse falet edhe një ditë para ose pas saj. Kjo është për atë, sepse jehudët e shenjtërojnë atë ditë dhe që të mos dukej që edhe muslimanët janë duke i dhënë rëndësi të veçantë. Nuk pengon, nëse agjërohet me nga një ditë para ose pas saj. Shënojnë, Nesaiu, Bejhekiu dhe Ibn Hibbani, që Kurejbe ka thënë, se njerëzit e kanë dërguar deri tek Ummu Sulejme, për ta pyetur, se cilat ditë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka agjëruar më së shpeshti, e ajo tha, se ai më së shpeshti e ka agjëruar të shtunën dhe të dielën. “Kur u ktheva dhe i informova se çfarë tha: ata të gjithë shkuan tek ajo dhe e pyetën të njëjtën gjë. Ajo tha: “Të vërtetën e ka thënë: Më së shpeshti e agjëronte të shtunën dhe të dielën dhe thoshte: “Këto dy ditë janë festa e idhujtarëve, andaj, kam dëshirë të dallohem me këtë prej tyre.”

⁸⁰⁸ Hakimi, këtë hadith, e konsideron të besueshëm, sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit. Neveviu thekson, që edhe shumë imam të tjerë, atë e vlerësojnë të besueshëm.

43. Mbi agjërimin të hënave dhe të enjteve

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ يَوْمِ الْاِثْنَيْنِ وَالْخَمِيسِ

745. Na ka treguar Ebu Hafs Amr b. Ali el-Fel-lasi – atë e ka informuar Abdullah b. Davudi, duke transmetuar nga Thevr b. Jezidi, ai nga Halid b. Ma’dani, ai nga Rebi el-Xhureshiu - që Aishja, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përpiquej të agjëronte të hënën dhe të enjten.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Hafsa, Ebu Katade dhe Usame b. Zejdi. Hadithi i Aishes, në këtë formë është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا أَبُو حَفْصٍ، عَمْرُو بْنُ عَلِيٍّ الْفَلَّاسُ حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ دَاوُدَ، عَنْ ثَوْرِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ خَالِدِ بْنِ مَعْدَانَ، عَنْ رَبِيعَةَ الْجُرَشِيِّ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَتَحَرَّى صَوْمَ الْاِثْنَيْنِ وَالْخَمِيسِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ حَفْصَةَ وَأَبِي قَتَادَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَأَسَامَةَ بْنِ زَيْدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

746. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e kanë informuar Ebu Ahmedi dhe Mu’avi b. Hishami, atyre u ka treguar Sufjani, duke transmetuar nga Mensuri, ai nga Hajthemi – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë një muaji agjëronte të shtunave, të dielave dhe të hënave, ndërsa muajin tjetër të martave, të mërkurave dhe të enjteve.”⁸⁰⁹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen. Abdurrahman b. Mehdiu, këtë hadith e ka transmetuar nga Sufjani dhe nuk e ka lidhur atë për të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِبْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو أَحْمَدَ، وَمُعَاوِيَةُ بْنُ هِشَامٍ، قَالَا حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ مَنْصُورٍ، عَنْ حَيْثَمَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَصُومُ مِنَ الشَّهْرِ السَّبْتِ وَالْاِثْنَيْنِ وَمِنَ الشَّهْرِ الْآخِرِ الثَّلَاثَاءِ وَالْاَرْبَعَاءِ وَالْخَمِيسِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَرَوَى عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ سُفْيَانَ وَلَمْ يَرْفَعْهُ .

747. Na ka treguar Muhammed b. Jahja – atë e ka informuar Ebu Asimi, duke transmetuar nga Muhammed b. Rifai, ai nga Suhejl b. Ebu Salihi, ai nga babai i vet, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Veprat prezantohen⁸¹⁰ të hënave dhe të enjteve, andaj kam dëshirë që veprat e mia të jenë të prezantuara derisa jam duke agjëruar.” Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ebu Hurejres mbi këtë temë është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَحْيَى، حَدَّثَنَا أَبُو عَاصِمٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ رِفَاعَةَ، عَنْ سُهَيْلِ بْنِ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ " تُعْرَضُ الْأَعْمَالُ يَوْمَ الْاِثْنَيْنِ وَالْخَمِيسِ فَأَجِبُ أَنْ يُعْرَضَ عَمَلِي وَأَنَا صَائِمٌ " . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ فِي هَذَا الْبَابِ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ .

44. Mbi agjërimin të mërkurave dhe të enjteve

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ يَوْمِ الْأَرْبَعَاءِ وَالْخَمِيسِ

748. Na kanë treguar Husejn b. Muhammed el-Harithi dhe Muhammed b. Medduvejh – ata i ka informuar Ubejdullah b. Musa, atë Harun b. Selmani, duke transmetuar nga Ubejdullah b. Muslim el-Kureshi – që Ubejdullah b. Muslim el-Kureshi, ka thënë: “E kam pyetur ose është pyetur i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi agjërimin e përvetshëm, e ai tha: ‘Ti ke obligime edhe

⁸⁰⁹ Et-Tibbi, thotë: “Në hadithin, nga kapitulli paraprak, është e përmendur e premtja. Kjo tregon, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me agjërimin vullnetar, përfshinte ditët e javës, me atë që – siç pohon Ibn Maliku – nuk i agjëronte vazhdimisht, por gjatë një muaji i agjëronte disa ditë, ndërsa në muajin tjetër, ditë të tjera.”

⁸¹⁰ Veprat, dy herë në javë, paraqiten përpara Allahut të Lartësuar dhe atë të Hënave dhe të Enjteve.

ndaj gruas tënde.’ – dhe pastaj shtoi: ‘Agjëroje ramazanin dhe muajin i cili vjen pas tij⁸¹¹ dhe agjëro çdo të mërkurë dhe të enjte. Nëse ke për të bërë ashtu siç të thash (ke për të pasur shpërblim) sikur të kishe agjëruar dhe të kishe bërë iftar (tërë jetën për çdo ditë).’

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadithi nga Aishja. Hadithi i Muslim el-Kureshit është garib.⁸¹² Disa e kanë transmetuar atë nga Harun b. Selmani, ai nga Muslim b. Ubejdullahu, e ai nga babai i vet.”

حَدَّثَنَا الْحُسَيْنُ بْنُ مُحَمَّدٍ الْحَرِيرِيُّ، وَمُحَمَّدُ بْنُ مَعْوِيَةَ، قَالَا حَدَّثَنَا عُبَيْدُ اللَّهِ بْنُ مُوسَى، أَخْبَرَنَا هَارُونُ بْنُ سَلْمَانَ، عَنْ عُبَيْدِ اللَّهِ بْنِ مُسْلِمٍ الْقُرَشِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ سَأَلْتُ أَوْ سُلَيْمَانَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنْ صِيَامِ الدَّهْرِ فَقَالَ " إِنَّ لَأَهْلِكَ عَلَيْكَ حَقًّا صُمْ رَمَضَانَ وَالَّذِي يَلِيهِ وَكُلَّ أَرْبَعَاءٍ وَخَمِيسٍ فَإِذَا أَنْتَ قَدْ صُمْتَ الدَّهْرَ وَأَفْطَرْتَ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ مُسْلِمٍ الْقُرَشِيِّ حَدِيثٌ غَرِيبٌ . وَرَوَى بَعْضُهُمْ عَنْ هَارُونِ بْنِ سَلْمَانَ عَنْ مُسْلِمٍ بْنِ عُبَيْدِ اللَّهِ عَنْ أَبِيهِ .

45. Mbi vlerat e agjërit në Ditën e ‘Arafatit

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ صَوْمِ عَرَفَةَ

749. Na kanë treguar Kutejbe dhe Ahmed b. Abde ed-Dabijj – ata i ka informuar Hammad b. Zejdi, duke transmetuar nga Gajlan b. Xheriri, ai nga Abdullah b. Ma’bed ez-Zimmani,⁸¹³ ai nga Ebu Katade – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Me agjërimin e Ditës së ‘Arafatit, shpresoj që Allahu, ka për t’i falur (mëkatet)⁸¹⁴ për vitin i cili është pas tij dhe vitin që është përpara tij.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi. Hadithi i Ebu Katades është hasen.⁸¹⁵ Dijetarët konsiderojnë, që agjërimi në ditën e ‘Arafatit, përveç (atyre të cilët janë) në vetë ‘Arafatin, është mustehab (i pëlqyer).”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَأَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ الصَّغِيِّ، قَالَا حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ غِيلَانَ بْنِ جَرِيرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَعْبُدٍ الرَّمَاثِيِّ، عَنْ أَبِي قَتَادَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " صِيَامُ يَوْمِ عَرَفَةَ إِنِّي أُحْتَسِبُ عَلَى اللَّهِ أَنْ يُكَفِّرَ السَّنَةَ الَّتِي قَبْلَهُ وَالسَّنَةَ الَّتِي بَعْدَهُ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي قَتَادَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ اسْتَحَبَّ أَهْلُ الْعِلْمِ صِيَامَ يَوْمِ عَرَفَةَ إِلَّا بِعَرَفَةَ .

46. Është i papëlqyeshëm agjërimi ditën e ‘Arafatit në ‘Arafat

باب كَرَاهِيَةِ صَوْمِ يَوْمِ عَرَفَةَ بِعَرَفَةَ

750. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ismail b. Ubejj, atë Ejub, duke transmetuar nga Ikrima - që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk agjëronte në ‘Arafat, Ummul Fadli⁸¹⁶ i ka dërguar qumësht dhe ai e ka pirë atë.”⁸¹⁷

⁸¹¹ Disa kanë shpjeguar, që këtu ka të bëjë me gjashtë ditët e muajit shevval, e disa, që këto fjalë kanë të bëjnë me muajin sha’ban. Shënojnë Muslimi në *Sahih* dhe Tirmidhiu në *Xhamiu*, nga Ebu Ejubi, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush e agjëron ramazanin dhe pas tij edhe gjashtë ditë të shevvalit, ato për të, janë sikurse të kishte agjëruar tërë jetën (për çdo ditë).”

⁸¹² E shënon Ebu Davudi, në *Sunen*.

⁸¹³ Abdullah b. Ma’bed ez-Zimmani el-Basri, është transmetues i besueshëm. I ka takuar gjeneratës së tretë të ravive.

⁸¹⁴ Sipas mendimit të Neveviut, Imamit të Haramenit dhe ehlu-sunnet vel-xhematu, këtu ka të bëjë me mëkatet e vogla. Për të mëdhatë, sipas mendimit të tyre, është tevbeja e domosdoshme, me të gjitha kushtet e saja.

⁸¹⁵ Këtë hadith, në formë diç më të gjatë, e ka shënuar Muslimi në *Sahih*.

⁸¹⁶ Ummul-Fadl, është e bija e Harithit, ndërsa bashkëshortja e Abbaz b. Abdulmutalibit.

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Ibn Umeri dhe Ummul Fadli. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih.”

Transmetohet, që Ibn Umeri, ka thënë: “E krevja haxhin me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e (ditën e ‘Arafatit) nuk ka agjëruar. E kam kryer edhe me Ebu Bekrin, as ai nuk ka agjëruar. Gjithashtu e kam kryer edhe me Umerin, e as ai nuk ka agjëruar.”

Në pajtim me këtë, është qëndrimi i shumicës së dijetarëve. Ata konsiderojnë, që është mustehab mos agjërimi në ‘Arafat, për shkak që personi të ishte më i përgatitur fizikisht për dua. Ndërsa, disa nga dijetarët, Ditën e Arafatit, kur kanë qenë në ‘Arafat e kanë agjëruar.

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا أَيُّوبُ، عَنْ عَجْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ أَفْطَرَ بِعَرَفَةَ وَأَرْسَلَتْ إِلَيْهِ أُمُّ الْفَضْلِ بِلَبْنٍ فَشَرِبَ . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَأُمِّ الْفَضْلِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ ابْنِ عُمَرَ قَالَ حَجَّجْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فَلَمْ يَصُمْهُ يَغْنِي يَوْمَ عَرَفَةَ وَمَعَ أَبِي بَكْرٍ فَلَمْ يَصُمْهُ وَمَعَ عُمَرَ فَلَمْ يَصُمْهُ وَمَعَ عُثْمَانَ فَلَمْ يَصُمْهُ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ يَسْتَجِيبُونَ الْإِفْطَارَ بِعَرَفَةَ لِيَتَقَوَّى بِهِ الرَّجُلُ عَلَى الدُّعَاءِ وَقَدْ صَامَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ يَوْمَ عَرَفَةَ بِعَرَفَةَ .

751. Na kanë treguar, Ahmed b. Meni dhe Ali b. Huxhri – ata i ka informuar Sufjan b. Ujejne dhe Ismail b. Ibrahim, duke transmetuar nga Ibn Ebu Nexhihi – që babai i Ibn Ebu Nexhihit, ka thënë: “Është pyetur Ibn Umeri mbi agjërimin në ‘Arafat, e ai ka thënë: ‘E kam kryer haxhin me të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ai nuk e agjëroi atë ditë; me Ebu Bekrin, as ai nuk e agjëroi atë; me Umerin, as ai nuk e agjëroi atë ditë; me Uthmanin, e as ai nuk e agjëroi atë ditë. As unë në ‘Arafat nuk e agjëroj atë ditë, andaj as nuk i urdhëroj, por as nuk ua ndaloj (për të agjëruar).”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen. Emri i Ebu Nexhihut është Jesar.”⁸¹⁸ Ai hadithet i ka dëgjuar nga Umeri. Ky hadith, gjithashtu, është transmetuar nga Ibn Ebu Nexhihi, ai e ka transmetuar nga babai i vet, ai nga një njëri, ndërsa ai nga Ibn Umeri.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، وَعَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، قَالَا حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، وَإِسْمَاعِيلُ بْنُ إِدْرِاهِيمَ، عَنْ ابْنِ أَبِي نَجِيحٍ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ سَأَلَ ابْنُ عُمَرَ عَنْ صَوْمِهِ يَوْمَ عَرَفَةَ فَقَالَ حَجَّجْتُ مَعَ النَّبِيِّ ﷺ فَلَمْ يَصُمْهُ وَمَعَ أَبِي بَكْرٍ فَلَمْ يَصُمْهُ وَمَعَ عُمَرَ فَلَمْ يَصُمْهُ وَمَعَ عُثْمَانَ فَلَمْ يَصُمْهُ . وَأَنَا لَا أَصُومُهُ وَلَا أَمُرُ بِهِ وَلَا أَنْهَى عَنْهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ ابْنِ أَبِي نَجِيحٍ عَنْ أَبِيهِ عَنْ رَجُلٍ عَنْ ابْنِ عُمَرَ . وَأَبُو نَجِيحٍ اسْمُهُ يَسَارٌ وَقَدْ سَمِعَ مِنْ ابْنِ عُمَرَ .

⁸¹⁷ Taberani konsideron, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk agjëronte në A'rafat, për t'u treguar njerëzve, që kanë të drejtën e zgjedhjes, kur janë në A'rafat, se a dëshiron të agjëroj apo jo. Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, dita e A'rafatit është mustehab të agjërohet për ata që janë në shtëpi, ndërsa është mekruh për ata që janë në A'rafat. Ata'i, thotë: “Ai që nuk agjëron në A'rafat, për të qenë fizikisht më i përgatitur për ibadet dhe për dua, atë ditë, në atë vend, ka shpërblim sikur të kishte agjëruar.” El-Mubarekfuri, të drejtë e konsideron mendimin e shumicës, që thonë, se është mustehab për ata që janë në A'rafat, që të mos e agjërojnë atë ditë, duke u mbështetur në hadithin e Ebu Hurejres, në të cilin qëndron, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka ndaluar agjërimin në ditën e A'rafatit, atyre që janë në A'rafat. Ibn Huzejme dhe Hakimi, këtë hadith e vlerësojnë të besueshëm.

⁸¹⁸ Ebu Nexhih Jesar el-Mekki, është transmetues i besueshëm. I takonte gjeneratës së tretë të ravive. Ka vdekur në vitin 109 sipas hixhretit.

47. Mbi nxitjen e agjërimit të ditës së ashures⁸¹⁹

باب مَا جَاءَ فِي الْحَثِّ عَلَى صَوْمِ يَوْمِ عَاشُورَاءَ

752. Na kanë treguar Kutejbe dhe Ahmed b. Abde ed-Dabij – ata i ka informuar Hammad b. Zejdi, duke transmetuar nga Gajlan b. Xheriri, ai nga Abdullah b. Ma'bed ez-Zemaniu, ndërsa ai nga Ebu Katade – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Me agjërimin e Ditës së ashures, shpresoj, që Allahu ka për t’ia falur mëkatet (atij që agjëron) e vitit që pason.”⁸²⁰

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Muhammed b. Sajfiu, Seleme b. Ekve, Hind b. Esmail, Ibn Abbasi, Rubej’a, vajza e Muavidh b. Afra’, Abdurrahman b. Seleme, xhaxhai i tij dhe Abdullah b. Zubejri. Të gjithë ata, kanë përmendur, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka nxituar, për ta agjëruar Ditën e ashures. Nuk na është e njohur që ai, në njërin nga hadithet e përmendura të ketë thënë: ‘Agjërimi në Ditën e ashures i fshinë mëkatet e një viti.’ Përveç se ne hadithin e Ebu Katades. Në pajtim me hadithin e Ebu Katades është qëndrimi edhe i Ahmedit dhe i Is’hakut.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَأَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ الصَّنِيِّ، قَالَا حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ غِيلَانَ بْنِ جَرِيرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَعْبُدٍ الرَّمَانِيِّ، عَنْ أَبِي قَتَادَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ قَالَ " صِيَامُ يَوْمِ عَاشُورَاءَ إِنِّي أُحْشِبُ عَلَى اللَّهِ أَنْ يُكَفِّرَ السَّنَةَ الَّتِي قَبْلَهُ ". وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَمُحَمَّدِ بْنِ صَيْفِيٍّ وَسَلْمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ وَهَنْدِ بْنِ أَسْمَاءَ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَالرُّبَيْعِ بْنِ مُعَوِّذٍ وَابْنِ عَفْرَاءَ وَعَبْدَ الرَّحْمَنِ بْنِ سَلَمَةَ الْخُرَاعِيِّ عَنْ عَمِّهِ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ الرَّبِيعِ ذَكَرُوا عَنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ أَنَّهُ حَثَّ عَلَى صِيَامِ يَوْمِ عَاشُورَاءَ . قَالَ أَبُو عِيسَى لَا نَعْلَمُ فِي شَيْءٍ مِنَ الرِّوَايَاتِ أَنَّهُ قَالَ " صِيَامُ يَوْمِ عَاشُورَاءَ كَفَّارَةٌ سَنَةٍ ". إِلَّا فِي حَدِيثِ أَبِي قَتَادَةَ . وَبِحَدِيثِ أَبِي قَتَادَةَ يَقُولُ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

48. Është i lejuar mos agjërimi i Ditës së ashures

باب مَا جَاءَ فِي الرُّخْصَةِ فِي تَرْكِ صَوْمِ يَوْمِ عَاشُورَاءَ

753. Na ka treguar Harun b. Is’hak el-Hemdani – atë e ka informuar Abd b. Sulejmani, duke transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet – që Aishja, ka thënë: “Ashura ka qenë dita, të cilën e kanë agjëruar Kurejshit gjatë kohës së xhahilijetit, por atë e ka agjëruar edhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Pas shpërnguljes në Medine, ai atë edhe më tej e agjëronte dhe e urdhëronte edhe popullin për ta agjëruar atë. Por, kur është urdhëruar Ramazani, agjërimi i ramazanit është bërë i obliguar, ndërsa agjërimi i ashures është lënë sipas dëshirës. Kush donte e agjëronte, ndërsa kush donte e braktiste atë.”⁸²¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Mes’udi. Kajs b. Sa’di, Xhabir b. Semure, Ibn Umeri dhe Muaviu. Në pajtim me hadithin e Aishes, i cili është i besueshëm,⁸²² është edhe qëndrimi i dijetarëve. Ata konsiderojnë, që agjërimi i Ditës së ‘Arafatit, nuk është i obliguar. Kush dëshiron mund ta agjërojë atë, për shkak të rëndësisë që është shqiptuar mbi të.

⁸¹⁹ Dita e Ashures, sipas mendimit të shumë dijetarëve, bie në ditën e dhjetë të muharremit.

⁸²⁰ “Në rast, se do të pyeste ndokush: Çfarë është shkaku, që me agjërimin e Ditës së ashures fshihen mëkatet e një viti, ndërsa me agjërimin e Ditës së A’rafatit, fshihen mëkatet e dy viteve?” – përgjigja, do të ishte: - thotë El-Mubarekfuri – Ky: “Agjërimi në Ditën e ashures, i përket sheriatit të Musait (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ndërsa agjërimi, në Ditën e A’rafatit, i përket sheriatit të Muhammedit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).” Kjo tregon, se agjërimi në Ditën e A’rafatit, është më i vlefshëm sesa agjërimi i Ditës së ashurës.”

⁸²¹ Nga ky hadith, vërehet, që agjërimi në ditën e ashures, ka qenë i obliguar. Pas vendosjes si obligim të agjërimin të ramazanit, ky obligim është ndërprerë. Agjërimi, në ditën e Ashures, ka mbetur nafile, e cila është mirë të praktikohet.

⁸²² E shënojnë Buhariu në *Sahih* dhe Nesaiu në *Sunen*.

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ بَنٍ سُلَيْمَانَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ عَاشُورَاءَ يَوْمًا تَصُومُهُ فُرَيْسٌ فِي الْجَاهِلِيَّةِ وَكَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَصُومُهُ فَلَمَّا قَدِمَ الْمَدِينَةَ صَامَهُ وَأَمَرَ النَّاسَ بِصِيَامِهِ فَلَمَّا افْتَرَضَ رَمَضَانُ كَانَ رَمَضَانُ هُوَ الْفَرِيضَةُ وَتَرَكَ عَاشُورَاءَ فَمَنْ شَاءَ صَامَهُ وَمَنْ شَاءَ تَرَكَهُ . وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ وَفَيْسِ بْنِ سَعْدٍ وَجَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَمُعَاوِيَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَالْعَمَلُ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ عَلَى حَدِيثِ عَائِشَةَ وَهُوَ حَدِيثٌ صَحِيحٌ لَا يَزُولُ صِيَامُ يَوْمِ عَاشُورَاءَ وَاجِبًا إِلَّا مَنْ رَغِبَ فِي صِيَامِهِ لِمَا ذَكَرَ فِيهِ مِنَ الْفَضْلِ .

49. Cila ditë është dita e ashures

باب مَا جَاءَ عَاشُورَاءَ أَيُّ يَوْمٍ هُوَ

754. Na kanë treguar Hennadi dhe Ebu Kutejbe – ata i ka informuar Vekiu, duke transmetuar nga Haxhib b. Umeri – që Hakim b. A’rexhi, ka thënë: “Erdha tek Ibn Abbasi, ndërsa ai pranë Zemzemit e kishte vënë pelerinën e vet nën kokë dhe ishte shtrirë: Unë thash: ‘Më informo mbi Ditën e ashures, cilën ditë duhet agjëruar?’ Ai tha: ‘Kur e sheh hënën e re të muajit muharrem, numëroi ditët. Kur agon dita e nëntë, ti agjëro.’ Unë thash: ‘Vallë, a e ka agjëruar ashtu atë Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të)?’ ‘Po.’ – u përgjigj ai.”⁸²³

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، وَأَبُو كُرَيْبٍ قَالَا حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ حَاجِبِ بْنِ عُمَرَ، عَنْ الْحَكَمِ بْنِ الْأَعْرَجِ، قَالَ انْتَهَيْتُ إِلَى ابْنِ عَبَّاسٍ وَهُوَ مُتَوَسِّدٌ رِدَاءَهُ فِي رَمَزٍ فَقُلْتُ أَخْبِرْنِي عَنْ يَوْمِ عَاشُورَاءَ أَيُّ يَوْمٍ هُوَ أَصَوْمُهُ فَقَالَ إِذَا رَأَيْتَ هِلَالَ الْمُحَرَّمِ فَاعْدُدْ ثُمَّ أَصْبِحْ مِنَ النَّاسِ صَائِمًا . قَالَ فَقُلْتُ أَهَكَذَا كَانَ يَصُومُهُ مُحَمَّدٌ ﷺ قَالَ نَعَمْ .

755. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdulvarith b. Junusi, duke transmetuar nga Hasani – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka urdhëruar, që ashura të agjërohet ditën e dhjetë (të muharemit).”

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih. Dijetarët kanë divergjenca në pikëpamje të Ditës së ashures. Disa thonë, se ajo është në ditën e nëntë, ndërsa disa thonë se është në ditën e dhjetë (të muajit muharrem).” Transmetohet, që Ibn Abbasi, ka thënë: “Agjëroni ditën e nëntë dhe ditën e dhjetë dhe dallohuni nga hebrenjtë. Në pajtim me këtë hadith, janë qëndrimet e Shafiut, Ahmedit dhe të Is’hakut.

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَارِثِ، عَنْ يُونُسَ، عَنْ الْحَسَنِ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ أَمَرَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ بِصَوْمِ عَاشُورَاءَ يَوْمَ الْعَاشِرِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي يَوْمِ عَاشُورَاءَ فَقَالَ بَعْضُهُمْ يَوْمَ النَّاسِ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ يَوْمَ الْعَاشِرِ . وَرَوَى عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ أَنَّهُ قَالَ صُومُوا النَّاسِ وَالْعَاشِرَ وَخَالِفُوا الْيَهُودَ . وَبِهِذَا الْحَدِيثِ يَقُولُ الشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ .

50. Mbi agjërimin dhjetë ditësh⁸²⁴

باب مَا جَاءَ فِي صِيَامِ الْعَشْرِ

756. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga A’meshi, ai nga Ibrahim, ai nga Esvedi – që Aishja, ka thënë: “Nuk kam parë kurrë, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka agjëruar dhjetë ditët (e para të dhul-hixhes).”⁸²⁵

⁸²³ Shumica e dijetarëve islamë, thonë, se Dita e ashures është me dhjetë muharrem. Ibn Abbasi, konsideron, se është me nëntë muharrem. Këtë qëndrim, të Ibn Abbasit, Neveviu është munduar ta barazojë me hadithet e besueshëm, duke e vërtetuar, që tek Arabët ka qenë zakoni, që ditën e pestë, kur i qonin devetë për të pirë, ta quajnë ditë e katërt. Ashtu, në përshtatshmëri me atë zakoni, ditën e nëntë, në të vërtetë, e quanin dita e dhjetë.

⁸²⁴ Ka të bëjë, me nëntë ditë të dhul-hixhes.

Ebu Isai, thotë: “Kështu, shumica kanë transmetuar nga A’meshi, ai nga Ibrahim, ai nga Esvedi, ndërsa ai nga Aishja. Eth-Thevriu dhe shumë të tjerë, kanë transmetuar nëpërmjet Mensurit – që Ibrahim, ka thënë: ‘I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk është parë duke agjëruar dhjetë ditët (e para) e dhul-hixhes.’ Por, ka transmetuar edhe Ebu Ahvezi nga Mensuri, ai nga Ibrahim, ndërsa ai nga Aishja, ndërsa në hadith nuk është përmendur: ‘(...) nga Esvedi.’ Shumica janë ndarë me Mensurin, në transmetimin e hadithit, prandaj, transmetimi i A’meshit, është më i besueshëm dhe e ka senedin më të plotë. E kam dëgjuar Ebu Bekr Muhammed b. Ebanin, kur ka thënë: ‘E kam dëgjuar Vekiun kur ka thënë: ‘A’meshi më mirë i ka mbajtur në mend sendet e Ibrahimit sesa Mensuri.’”

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنِ الْأَسْوَدِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ مَا رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ صَائِمًا فِي الْعَشْرِ قَطُّ. قَالَ أَبُو عِيسَى هَكَذَا رَوَى غَيْرُ وَاحِدٍ عَنِ الْأَعْمَشِ عَنْ إِبْرَاهِيمَ عَنِ الْأَسْوَدِ عَنْ عَائِشَةَ. وَرَوَى الثَّوْرِيُّ وَغَيْرُهُ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ مَنْصُورٍ عَنْ إِبْرَاهِيمَ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ لَمْ يَزْ صَائِمًا فِي الْعَشْرِ. وَرَوَى أَبُو الْأَخْوَصِ عَنْ مَنْصُورٍ عَنْ إِبْرَاهِيمَ عَنْ عَائِشَةَ. وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ عَنِ الْأَسْوَدِ. وَقَدْ اخْتَلَفُوا عَلَى مَنْصُورٍ فِي هَذَا الْحَدِيثِ وَرَوَايَةُ الْأَعْمَشِ أَصَحُّ وَأَوْصَلُ إِسْنَادًا. قَالَ وَسَمِعْتُ أَبَا بَكْرٍ مُحَمَّدُ بْنُ أَبَانَ يَقُولُ سَمِعْتُ وَكِيعًا يَقُولُ الْأَعْمَشُ أَحْفَظُ لِإِسْنَادِ إِبْرَاهِيمَ مِنْ مَنْصُورٍ.

51. Mbi aktivitetet gjatë këtyre dhjetë ditëve⁸²⁶

باب مَا جَاءَ فِي الْعَمَلِ فِي أَيَّامِ الْعَشْرِ

757. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Muslimi, ndërsa ai është i biri i Ebu Imran el-Betinit, ai nga Seid b. Xhubejri, ai nga Ibn Abbasi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka ditë në të cilën vepra e mirë për Allahun është më e dashur, sikurse që është në këto dhjetë ditë.”⁸²⁷ Ata, thanë: “O i Dërguar i Allahut, vallë a as lufta në rrugë të Allahut?” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: “As lufta në rrugë të Allahut, përveç veprës së personit i cili në luftë ka hyrë duke e dhënë pasurinë dhe jetën dhe me asgjë nga ato nuk është kthyer.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Umeri, Ebu Hurejre, Abdullah b. Amri dhe Xhabiri. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-garib-sahih.”⁸²⁸

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنِ الْأَعْمَشِ، عَنْ مُسْلِمٍ، هُوَ الْبَطْنِيُّ وَهُوَ ابْنُ عُمَرَ عَنْ سَعِيدِ بْنِ جُبَيْرٍ، عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَا مِنْ أَيَّامٍ الْعَمَلُ الصَّالِحُ فِيهَا أَحَبُّ إِلَى اللَّهِ مِنْ هَذِهِ الْأَيَّامِ الْعَشْرِ " . فَقَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَقَالَ

⁸²⁵ Neveviu thotë: “Dijetarët konsiderojnë, që në këtë hadith ekziston treguesi, i cili udhëzon mbi atë, që agjërimi në nëntë ditët e para të dhul-hixhes do të mund të ishte i qortuar. Ata pohojnë, që në te ekzistojnë tregues të atillë, por që, megjithatë, agjërimi i dhjetë ditëve të para të muajit dhul-hixhe, nuk është i papëlqyer, por madje mustehab. Buhariu, në *Sahih*, shënon, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka ditë, në të cilën janë veprat më të vlefshme se në këto ditë d.m.th. dhjetë ditët e para të dhul-hixhes.” Në konkludim të njëjtë, udhëzon edhe hadithi të cilin e transmeton Hamid b. Halidi, nga bashkëshortja e vet, që njëra nga gratë e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “I Dërguari i Allahut, i agjëronte dhjetë ditët e para të dheul-hixhes. Ditën e ashures, nga tre ditë prej secilit muaj dhe të hënën e parë dhe të enjten në muaj.” (Ebu Davudi, Ahmedi dhe Nesaiu). Ata konsiderojnë, se hadithi i Aishes, mbi të cilin është fjala, në këtë kapitull, ka të bëjë me gjendjen, gjatë udhëtimit ose sëmundjen. Domethënë, ajo kurrë nuk ka parë, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka agjëruar dhjetë ditët e para të dhul-hixhes, gjatë udhëtimit apo gjatë sëmundjes.

⁸²⁶ Gjithashtu, mendohet mbi nëntë ditët e para të muajit dhul-hixhe.

⁸²⁷ Se a janë më të vlefshme dhjetë ditët e fundit të ramazanit, apo të dhul-hixhes, është diskutabile në mesin e dijetarëve islam. Disa thonë, që ditët e para, e disa ditët e tjera. Është i zgjedhur mendimi i shumicës së dijetarëve: “Janë më të vlefshme dhjetë ditët e para të dhul-hixhes, për shkak të ‘Arafatit. Sa i përket netëve, janë më të vlefshme dhjetë netët e fundit të ramazanit, për shkak të lejletul-kadrit. Prandaj, në këtë hadith janë të përmendura ditët, e jo netët.

⁸²⁸ E shënojnë edhe Buhariu në *Sahih*, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " وَلَا الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ إِلَّا رَجُلٌ خَرَجَ بِنَفْسِهِ وَمَالِهِ فَلَمْ يَرْجِعْ مِنْ ذَلِكَ بِشَيْءٍ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عُمَرَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَجَابِرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ .

758. Na ka treguar Ebu Bekër b. Nafi el-Basriu⁸²⁹ - atë e ka informuar Mes'ud b. Vasili,⁸³⁰ ai ka transmetuar nga Nehhas b. Kahmi,⁸³¹ ai nga Katade, ai nga Seid b. Musejjebi, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nuk ka ditë më të dashura për Allahun, gjatë të cilave bëhet ibadet për Të se dhjete ditët të dhul-hixhes. Agjërimi vullnetar në secilën ditë prej atyre ditëve, është i barabartë me agjërimin vullnetar të një viti, ndërsa namazi vullnetar në çdo natë të tij, është i barabartë me namazin vullnetar natën e Lejletul-kadrit.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-garib.⁸³² Na është i njohur vetëm nëpërmjet Mes'ud b. Vasilit nga Nehhasi. Ndërsa, e kam pyetur Muhammedin mbi këtë hadith, e as ai nuk e njihje atë me rrugë tjetër, në kuptimin e ngjashëm. Ai thotë: ‘Diç nga kjo, si mursel, është transmetuar nga Katade, nga Seid b. Musejjebi, nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).’”

حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ نَافِعٍ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا مَسْعُودُ بْنُ وَاصِلٍ، عَنْ نَهَّاسِ بْنِ فَهْمٍ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " مَا مِنْ أَيَّامٍ أَحَبَّ إِلَى اللَّهِ أَنْ يُتَعَبَّدَ لَهُ فِيهَا مِنْ عَشْرِ ذِي الْحِجَّةِ يَغْدُلُ صِيَامُ كُلِّ يَوْمٍ مِنْهَا بِصِيَامِ سَنَةٍ وَقِيَامُ كُلِّ لَيْلَةٍ مِنْهَا بِقِيَامِ لَيْلَةِ الْقَدْرِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ مَسْعُودِ بْنِ وَاصِلٍ عَنِ النَّهَّاسِ . قَالَ وَسَأَلْتُ مُحَمَّدًا عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ فَلَمْ يَعْرِفْهُ مِنْ غَيْرِ هَذَا الْوَجْهِ مِثْلُ هَذَا . وَقَالَ قَدْ رَوَى عَنْ قَتَادَةَ عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا شَيْءٌ مِنْ هَذَا .

52. Mbi agjërimin e gjashtë ditëve të shevalit

بَاب مَا جَاءَ فِي صِيَامِ سِتَّةِ أَيَّامٍ مِنْ شَوَّالٍ

759. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ebu Muaviu, atë Sa'd b. Seidi, duke transmetuar nga Umer b. Thabiti, ai nga Ebu Ejjub – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush e agjëron ramazanin dhe pas tij gjashtë ditë të shevvalit, kjo për te është sikur ta kishte agjëruar tërë vitin .”⁸³³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Xhabiri, Ebu Hurejre dhe Thevbani. Hadithi i Ebu Ejubit është hasen-sahih.⁸³⁴ Në bazë të këtij hadithi, dijetarët konsiderojnë, që është mirë të agjërohet gjatë gjashtë ditëve të shevvalit.”

Ibn Mubareku, thotë: “Kjo është mirë, mu sikur agjërimi i tre ditëve gjatë çdo muaji. Në disa hadithe, transmetohet: “Ky agjërim barazohet me ramazanin.” Ibn Mubareku e ka zgjedhur që këto ditë të shevvalit të jetë në fillim të muajit. Gjithashtu, është transmetuar që Ibn Mubareku, ka thënë: “Nëse ndokush i agjëron gjashtë ditë të shevvalit ndaras, edhe ajo është e lejuar.”

⁸²⁹ Emri i tij i plotë, është Ebu Bekër Muhammed b. Ahmed b. Nafi el-Basri. Ai është transmetues i sinqertë. I takonte gjeneratës së dhjetë të ravive.

⁸³⁰ Mes'ud b. Vasil el-Ezrekiu nga Basriu, e vlerësojnë të butë në hadithe. I takon gjeneratës së nëntë të ravive.

⁸³¹ Nehhas b. Kahm el-Basri është ravi i dobët. I takonte gjeneratës së gjashtë.

⁸³² E shënon edhe Ibn Maxhe në *Sunen*. Abdurrahman el-Mubarekfuri konsideron, që ky hadith është i dobët, për shkak, se në senedin e tij gjendet Mes'ud b. Vasil, i cili është jo i sigurt në hadithe, dhe Nehhas b. Kahm, i cili, sipas vlerësimit të dijetarëve të hadithit është ravi i dobët.

⁸³³ Duke pasur parasysh, që Allahu i Lartësuar, për çdo vepër të mirë jep shpërblim të dhjetëfishit, shpërblimi për ramazan përmban sa dhjetë muaj, ndërsa shpërblimi për 6 ditë, shpërblim si për dy muaj, që në total është një vit. Nëse personi në atë mënyrë agjëron tërë jetën e tij, do të ketë shpërblimin sikur të ketë agjëruar tërë jetën.

⁸³⁴ E shënojnë edhe Muslimi në *Sahih*, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

Ebu Isai, thotë: “Abdulaziz b. Muhammedi, këtë hadith e ka transmetuar nga Safvan b. Sulejmi dhe Sa’d b. Seidi, ata dy nga Umer b. Thabiti, ai nga Ebu Ejjubi, ndërsa ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). E, këtë hadith e ka transmetuar edhe Shu’be nga Verka b. Umeri, ai nga Sa’d b. Seidi. Sa’d b. Seidi është vëllai i Jahja b. Seid el-Ensarit. Disa dijetarë, kanë pasur vërejtje mbi të mbajturit në mend nga Sa’d b. Seidi.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، حَدَّثَنَا سَعْدُ بْنُ سَعِيدٍ، عَنْ عُمَرَ بْنِ ثَابِتٍ، عَنْ أَبِي أَيُّوبَ، قَالَ قَالَ النَّبِيُّ ﷺ " مَنْ صَامَ رَمَضَانَ ثُمَّ أَتْبَعَهُ سِنًا مِنْ شَوَّالٍ فَذَلِكَ صِيَامُ الدَّهْرِ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ جَابِرٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَثَوْبَانَ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي أَيُّوبَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ اسْتَحَبَّ قَوْمٌ صِيَامَ سِنَةِ أَيَّامٍ مِنْ شَوَّالٍ بِهَذَا الْحَدِيثِ . قَالَ ابْنُ الْمُبَارَكِ هُوَ حَسَنٌ هُوَ مِثْلُ صِيَامِ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ . قَالَ ابْنُ الْمُبَارَكِ وَيُرْوَى فِي بَعْضِ الْحَدِيثِ " وَيُلْحَقُ هَذَا الصِّيَامُ بِرَمَضَانَ " . وَاخْتَارَ ابْنُ الْمُبَارَكِ أَنْ تَكُونَ سِنَةُ أَيَّامٍ فِي أَوَّلِ الشَّهْرِ . وَقَدْ رَوَى عَنْ ابْنِ الْمُبَارَكِ أَنَّهُ قَالَ إِنْ صَامَ سِنَةُ أَيَّامٍ مِنْ شَوَّالٍ مُتَّفَقًا فَهُوَ جَائِزٌ . قَالَ وَقَدْ رَوَى عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ عَنْ صَفْوَانَ بْنِ سُلَيْمٍ وَسَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ عَنْ عُمَرَ بْنِ ثَابِتٍ عَنْ أَبِي أَيُّوبَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ هَذَا . وَرَوَى شُعْبَةُ عَنْ وَرْقَاءَ بْنِ عُمَرَ عَنْ سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ هَذَا الْحَدِيثِ . وَسَعْدُ بْنُ سَعِيدٍ هُوَ أَخُو يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيِّ وَقَدْ تَكَلَّمَ بَعْضُ أَهْلِ الْحَدِيثِ فِي سَعْدِ بْنِ سَعِيدٍ مِنْ قَبْلِ جَفْظِهِ .

53. Mbi agjërimin e tre ditëve të çdo muaji

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ

760. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avani, duke transmetuar nga Simak b. Harbi, ai nga Ebu Rebiu – që Ebu Hurejre, ka thënë: “I Dërguari i Allahut më ka porositur tre gjëra: që të mos flejë derisa nuk e fali namazin e vitrit,⁸³⁵ agjërimin e tre ditëve për çdo muaj dhe faljen e namazit - duha.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ سِمَاكِ بْنِ حَرْبٍ، عَنْ أَبِي الرَّبِيعِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ عَوَّدَ إِلَيَّ النَّبِيُّ ﷺ ثَلَاثَةً أَنْ لَا أَنَامَ إِلَّا عَلَى وَثْرٍ وَصَوْمَ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ وَأَنْ أَصَلِّيَ الصُّحَى .

761. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, atë e ka informuar Shu’be, duke transmetuar nga A’meshi, ai nga Jahja b. Bessami, ai nga Musa b. Talha – ai nga Ebu Dherri, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “O Ebu Dherre, nëse ke për të agjëruar tre ditë për (çdo) muaj, atëherë agjëroje ditën e trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe ditën e pesëmbëdhjetë.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Katade, Abdullah b. Amëri, Kurre b. Ijas el-Muzeni, Abdullah b. Mes’udi, Ebu A’rebi, Ibn Abbasi, Aishja, Katade b. Milhani, Uthman b. Ebu Asi dhe Xherri. Hadithi i Ebu Dherres është hasen.⁸³⁶ Në disa hadithe, është transmetuar: ‘Ai i cili për çdo muaj i agjëron nga tre ditë, sikur ta agjëronte tërë vitin.’”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، قَالَ أَنْبَأَنَا شُعْبَةُ، عَنْ الْأَعْمَشِ، قَالَ سَمِعْتُ يَحْيَى بْنَ سَامٍ، يُحَدِّثُ عَنْ مُوسَى بْنِ طَلْحَةَ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا ذَرٍّ، يَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " يَا أَبَا ذَرٍّ إِذَا صُمْتَ مِنَ الشَّهْرِ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ فَصُمْ ثَلَاثَ عَشْرَةٍ وَأَرْبَعَ عَشْرَةَ وَخَمْسَ عَشْرَةَ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي قَتَادَةَ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَفَرَّةَ بْنِ إِسَاسِ الْمُرَزِيِّ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ وَأَبِي عَقْرِبٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ وَعَائِشَةَ وَقَتَادَةَ بْنَ مِلْحَانَ وَعُثْمَانَ بْنَ أَبِي الْعَاصِي وَجَرِيرٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي ذَرٍّ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَى فِي بَعْضِ الْحَدِيثِ أَنَّ " مَنْ صَامَ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ كَانَ كَمَنْ صَامَ الدَّهْرَ " .

⁸³⁵ Ibn Haxher el-Askalani, konsideron, se ky është argument, që është mustehab, për atë i cili, nuk është i sigurt, që mund të zgjohej, për ta falur namazin e vitrit, para se të bie të flejë. Shejh Abdul-Hakk, në veprën El-Sem’at, pohon, se kjo i është rekomanduar special Ebu Hurejres, sepse ai merrej natën gjatë me shkencë, me të mbajturit në mend dhe me të shkruarit e haditheve, andaj ka ekzistuar frika, se nuk do të mund të zgjohej, sikur ta linte namazin e vitrit pa e falur. Rekomandim i ngjashëm i është drejtuar edhe Ebu Dherdas, siç qëndron në hadithin, të cilin e shënon Muslimi dhe Ebu Dherre, siç qëndron në hadithin, të cilin e ka shënuar Nesaiu.”

⁸³⁶ E ka shënuar edhe Nesaiu në *Sunen*. Ibn Hibbani e konsideron të besueshëm.

762. Na ka treguar Hannadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai transmeton nga Asim el-Ahveli, ai ka transmetuar nga Ebu Uthmani, ndërsa ai nga Ebu Dherre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush për çdo muaj i agjëron nga tre ditë, është, sikur ta kishte agjëruar tërë vitin. Dëshminë për këtë, Allahu i Lartësuar e ka shpallur në Librin e Vet: ***Kush e bën një vepër të mirë, do të jetë dhjetëfish i shpërblyer.*** Një ditë, si dhjetë ditë. Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.”⁸³⁷ Këtë hadith, Shu’be e ka transmetuar nga Ebu Shimra dhe Ebu Tejjahi, ndërsa, ata dy nga Ebu Uthmani, por ka thënë edhe nëpërmjet Ebu Hurejres nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ عَاصِمِ الْأَحْوَلِ، عَنْ أَبِي عُثْمَانَ النَّهْدِيِّ، عَنْ أَبِي ذَرٍّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ صَامَ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ فَذَلِكَ صِيَامُ الدَّهْرِ " . فَأَنْزَلَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ تَصْدِيقَ ذَلِكَ فِي كِتَابِهِ : (مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ عَشْرُ أَمْثَالِهَا) . الْيَوْمَ بَعَثَرَهُ أَيَّامٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رَوَى شُعْبَةُ هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ أَبِي شَيْمِرٍ وَأَبِي النَّيَّاحِ عَنْ أَبِي عُثْمَانَ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ .

763. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, atë Shu’be, duke transmetuar nga Jezid er-Rishku – që Muadhe, ka thënë: “E kam pyetur Aishen: ‘A i ka agjëruar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), tre ditë për çdo muaj?’ ‘Po.’ – tha ajo. Unë thash: ‘Mirë, por cilat ditë i agjëronte?’ Një atë, ajo tha: ‘Ai nuk ia kushtonte vëmendjen (aq) se cilat ditë (gjatë muajit) do t’i agjëronte.’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁸³⁸ Jezid er-Rishk është Jezid ed-Dubeijj, ai në të vërtetë, është Jezid el-Kasim. Ai ishte ndarës i trashëgimisë. Fjala *er-rishk*, në gjuhën e banorëve të Basrasë, domethënë *ndarës i trashëgimisë*.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، أَخْبَرَنَا شُعْبَةُ، عَنْ يَزِيدَ الرَّشَكِيِّ، قَالَ سَمِعْتُ مُعَاذَةَ، قَالَتْ قُلْتُ لِعَائِشَةَ أَكَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَصُومُ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ مِنْ كُلِّ شَهْرٍ قَالَتْ نَعَمْ . قُلْتُ مِنْ أَيِّهِ كَانَ يَصُومُ قَالَتْ كَانَ لَا يُبَالِي مِنْ أَيِّهِ صَامَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَيَزِيدُ الرَّشَكِيُّ هُوَ يَزِيدُ الضُّبَيْعِيُّ وَهُوَ يَزِيدُ بْنُ الْقَاسِمِ وَهُوَ الْقَاسِمُ وَالرَّشَكِيُّ هُوَ الْقَاسِمُ بِلُغَةِ أَهْلِ الْبَصْرَةِ .

54. Mbi vlerën e agjërimin

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الصَّوْمِ

764. Na ka treguar Imran b. Musa el-Kazzaz el-Basriu – atë e ka informuar Abdulvarith b. Seidi, atë Ali b. Zejdi, duke transmetuar nga Seid b. Musejjebi, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Sunduesi juaj me të vërtetë, thotë: ‘Çdo vepër shpërblehet, që nga dhjetë e deri në shtatëqind herë, përveç agjërimin. Agjërimi është i Imi, dhe Unë për të kam për të dhënë shpërblim të veçantë. Agjërimi ka për të qenë mburojë nga zjarri. Ndërsa, aroma e gojës së agjëruarit, ka për të qenë më e këndshme tek Allahu sesa aroma e miskut. Nëse, ndaj jush, derisa jeni duke agjëruar, ndonjë i pa ditur sillet keq, le të thotë: “Unë jam duke agjëruar.””

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Muadh b. Xhebeli, Sehl b. Sa’di, Ka’b b. Uxhre, Selame b. Kajsuri dhe Beshir b. el-Hasasijje. Emri i Beshirit është Zahm b. Ma’bed, ndërsa Hasasijje është nëna e tij. Hadithi i Ebu Hurejres, në këtë formë është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا عِمْرَانُ بْنُ مُوسَى الْقَزَّازُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَارِثِ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " إِنَّ رَبَّكُمْ يَقُولُ كُلَّ حَسَنَةٍ بَعَثَرُ أَمْثَالِهَا إِلَى سَبْعِمِائَةِ ضِعْفٍ وَالصَّوْمُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ الصَّوْمُ جَنَّةٌ مِنَ النَّارِ وَلِخُلُوفِ فَمِ الصَّائِمِ أَطْيَبُ عِنْدَ اللَّهِ مِنْ رِيحِ الْمُسْكِ وَإِنْ جَهِلَ عَلَى أَحَدِكُمْ جَاهِلٌ وَهُوَ صَائِمٌ فَلْيَقُلْ إِنِّي صَائِمٌ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ مُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ

⁸³⁷ E ka shënuar Ibn Maxhe në *Sunen*.

⁸³⁸ E shënon edhe Muslimi në *Sahih*.

وَسَهْلُ بْنُ سَعْدٍ وَكُعْبُ بْنُ عُجْرَةَ وَسَلَامَةُ بْنُ قَيْصَرَ وَيَثِيرُ بْنُ الْخَصَاصِيَّةِ . وَاسْمُ بَشِيرٍ رَحْمُ بْنُ مَعْبِدٍ وَالْخَصَاصِيَّةُ هِيَ أُمُّهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

765. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Ebu Amir el-Akadi, duke transmetuar nga Hisham b. Sa'di, ai nga Ebu Hazimi, ai nga Sehl b. Sa'di – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Në Xhennet ekzistojnë dyert, të cilat quhen Rejjan. Në to kanë për t'u thirrur agjëruesit. Prandaj, kush ka për t'ju takuar agjëruesve, ka për të hyrë në to. Ndërsa, kush hynë në to, ai më kurrë nuk ka për të qenë i etur.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih-garib.”⁸³⁹

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا أَبُو عَامِرٍ الْعَقَدِيُّ، عَنْ هِشَامِ بْنِ سَعْدٍ، عَنْ أَبِي حَازِمٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ سَعْدٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِنَّ فِي الْجَنَّةِ لَبَابًا يُدْعَى الرَّيَّانَ يُدْعَى لَهُ الصَّائِمُونَ فَمَنْ كَانَ مِنَ الصَّائِمِينَ دَخَلَهُ وَمَنْ دَخَلَهُ لَمْ يَطْمَأْأِدْ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ .

766. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdulaziz b. Muhammedi, duke transmetuar nga Sehl b. Ebu Salihi, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjëruesi ka dy gëzime: gëzimi kur bënë iftar dhe gëzimi kur takohet me Sunduesin e vet.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ سَهْلِ بْنِ أَبِي صَالِحٍ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لِلصَّائِمِ فَرْحَتَانِ فَرْحَةٌ حِينَ يُفْطِرُ وَفَرْحَةٌ حِينَ يَلْقَى رَبَّهُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

55. Mbi agjërimin e përjetshëm

باب مَا جَاءَ فِي صَوْمِ الدَّهْرِ

767. Na kanë treguar Kutejbe dhe Ahmed b. Abd ed-Dabijj – ata i ka informuar Hammad b. Zejdi, duke transmetuar nga Gajlan b. Xherriri, ai nga Abdullah b. Ma'bedi – që Ebu Katade, ka thënë: “Dikush tha: ‘O i Dërguar i Allahut, çfarë thua për atë, i cili agjëron (të gjitha ditët) përjetësisht?’ Ai tha: ‘Ai as nuk ka agjëruar as nuk e ka prish agjërimin.’ Ose:”⁸⁴⁰ ‘Ai as nuk është duke agjëruar as nuk është duke e prish agjërimin.’”⁸⁴¹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Abdullah b. Amri, Abdullah b. Shihhiri, Imran b. Husejni dhe Ebu Musai. Hadithi i Ebu Katades është hasen.”⁸⁴²

Disa dijetarë, agjërimin e përjetshëm, e konsiderojnë të papëlqyer – mekruh. Ata thonë: “Agjërimi i përjetshëm konsiderohet, agjërimi, gjatë të cilit nuk hahet as ditët e para të bajramit të Ramazanit dhe të Kurban bajramit, e as tre ditët e tjera të Kurban bajramit. Kush ha gjatë këtyre ditëve, as nuk ka bërë mekruh, e as nuk i ka agjëruar të gjitha ditët përjetësisht.” Ashtu është transmetuar nga Malik b. Enesi dhe ky është qëndrimi i Shafiut. Ahmedi dhe Is'haku kanë thënë ngjashëm me këtë. Ata thonë:

⁸³⁹ E shënojnë Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

⁸⁴⁰ Këtu ka të bëjë mbi dilemën e njerit nga ravitë.

⁸⁴¹ Nga pikëqëndrimi islam, është i ndaluar agjërimi i vazhdueshëm, madje edhe për personat që do të mund ta përballonin atë dhe atë, nga disa arsye: 1) Çdonjëri, përkrah obligimeve ndaj Allahut, ka obligime ndaj të tjerëve, të cilat, nuk do të mund t'i plotësonte, nëse do të kishte agjëruar vazhdimisht. Për shembull, obligimet ndaj shokut bashkëshortor, obligimet ndaj të përgjigjuri në salihatet dhe të ngjashme. Ekzistojnë ditët, në të cilat i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka ndaluar agjërimin, siç është: Bajrami i Ramazanit dhe Bajrami i Kurbanit. 3) Me agjërim të pandërprerë, personi do ta kishte dëmtuar shëndetin, etj. në vend të asaj, për atë që dëshiron të agjërojë, është më së mirë ta agjërojë agjërimin e Davudit, e kjo do të thotë, që një ditë të agjërojë e një ditë jo.

⁸⁴² E kanë shënuar Muslimi në *Sahih*, diç në formë më të gjatë.

“Nuk është e domosdoshme të priset agjërimi, përveç këtyre pesë ditëve, gjatë të cilave i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka ndaluar të agjërohet, e ato janë: dita e parë e bajramit të Ramazanit dhe dita e parë dhe tre ditët e tjera të Kurban bajramit.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَأَحْمَدُ بْنُ عَبْدِ الصَّغِيِّ، قَالَا حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ غِيلَانَ بْنِ جَرِيرٍ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَعْنَدٍ، عَنْ أَبِي قَتَادَةَ، قَالَ قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ كَيْفَ يَمُنَّ صَامَ الدَّهْرَ قَالَ " لَا صَامَ وَلَا أَفْطَرَ " . أَوْ " لَمْ يَصُمْ وَلَمْ يَفْطِرْ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ الشَّجِيرِ وَعُمَرَانُ بْنُ حُصَيْنٍ وَأَبِي مُوسَى . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي قَتَادَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ كَرِهَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ صِيَامَ الدَّهْرِ وَأَجَازَهُ قَوْمٌ آخَرُونَ وَقَالُوا إِنَّمَا يَكُونُ صِيَامُ الدَّهْرِ إِذَا لَمْ يَفْطِرْ يَوْمَ الْفِطْرِ وَيَوْمَ الْأَضْحَى وَأَيَّامَ التَّشْرِيقِ فَمَنْ أَفْطَرَ هَذِهِ الْأَيَّامَ فَقَدْ خَرَجَ مِنْ حَدِّ الْكَرَاهِيَةِ وَلَا يَكُونُ قَدْ صَامَ الدَّهْرَ كُلَّهُ . هَكَذَا رَوَى عَنْ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ . وَقَالَ أَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ نَحْوًا مِنْ هَذَا وَقَالَا لَا يَجِبُ أَنْ يَفْطِرَ أَيَّامًا غَيْرَ هَذِهِ الْخَمْسَةِ الْأَيَّامِ الَّتِي نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنْهَا يَوْمَ الْفِطْرِ وَيَوْمَ الْأَضْحَى وَأَيَّامَ التَّشْرِيقِ .

56. Mbi agjërimin e pandërprerë

باب مَا جَاءَ فِي سَرَدِ الصَّوْمِ

768. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Hammad b. Zejdi, ai ka transmetuar nga Ejubi – që Abdullah b. Shekiku, ka thënë: “E kam pyetur Aishen mbi agjërimin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ajo tha: ‘Agjëronte (aq), sa që thoshim: Ka për të agjëruar (tërë muajin)! Ndërsa e prishte agjërimin (aq), sa që thoshim: Nuk ka për të agjëruar (tërë muajin)! I Dërguari i Allahut, (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përveç ramazanit, asnjë muaj tjetër nuk e agjëronte në tërësi.”⁸⁴³

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Enesi dhe Ibn Abbasi. Hadithi i Aishes është hasen-sahih.”⁸⁴⁴

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا حَمَّادُ بْنُ زَيْدٍ، عَنْ أَبِي يُوْبَ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ شَقِيقٍ، قَالَ سَأَلْتُ عَائِشَةَ عَنْ صِيَامِ النَّبِيِّ، ﷺ قَالَتْ كَانَ يَصُومُ حَتَّى نَقُولَ قَدْ صَامَ وَيُفْطِرُ حَتَّى نَقُولَ قَدْ أَفْطَرَ . قَالَتْ وَمَا صَامَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ شَهْرًا كَامِلًا إِلَّا رَمَضَانَ . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَنَسٍ وَابْنِ عَبَّاسٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

769. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ismail b. Xhaferi, duke transmetuar nga Humejde – që Enes b. Maliku, i pyetur mbi agjërimin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjëronte aq, gjatë muajit, sa që mendohej që gjatë tij nuk ka për ta prishur asnjë ditë, pastaj aq, nuk agjëronte, sa që mendohej që gjatë atij (muaji) nuk ka për të agjëruar asnjë ditë. Në çfarëdo kohe të natës, që do të dëshiroje, do ta kishe parë atë në namaz. Dhe në çfarëdo kohe të natës, që do të dëshiroje, do ta kishe parë duke fjetur.”⁸⁴⁵ Ebu Isai thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنْ حُمَيْدٍ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، أَنَّهُ سُئِلَ عَنْ صَوْمِ النَّبِيِّ، ﷺ قَالَ كَانَ يَصُومُ مِنَ الشَّهْرِ حَتَّى نَرَى أَنَّهُ لَا يُرِيدُ أَنْ يَفْطِرَ مِنْهُ وَيُفْطِرُ حَتَّى نَرَى أَنَّهُ لَا يُرِيدُ أَنْ يَصُومَ مِنْهُ شَيْئًا وَكُنْتُ لَا تَشَاءُ أَنْ تَرَاهُ مِنَ اللَّيْلِ مُصَلِّيًا إِلَّا رَأَيْتُهُ مُصَلِّيًا وَلَا نَائِمًا إِلَّا رَأَيْتُهُ نَائِمًا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

770. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Veki, ai ka transmetuar nga Mis'ari dhe Sufjani, ata dy nga Habib b. Ebu Thabiti, ai nga Ebu Abbasi, ai nga Abdullah b. Amri – që i Dërguari i Allahut

⁸⁴³ Në hadithin, të cilin e shënon Buhariu dhe Muslimi, e të cilin në njëfarë mënyre e sqaron ky, qëndron: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjatë muajit agjëronte aq, sa që mund të thoshin: ‘nuk do ta ndërpresë!’ Ndërsa në tjetrin (muaj) e prishte aq, sa që thoshin: ‘nuk ka për të agjëruar asgjë!’”

⁸⁴⁴ E shënojnë edhe Buhariu dhe Muslimi.

⁸⁴⁵ Ibn Haxheri, thotë: “Sjellja e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në pikëpamje të agjërimit vullnetarë, ishte e ndryshme. Ndonjëherë, namazin e natës, e falte në fillim të natës, ndonjëherë në gjysmë të natës, e ndonjëherë në fund të natës. Ashtu bënte edhe me namazin vullnetar. Ndonjëherë, agjëronte në fillim, ndonjëherë në mes, e ndonjëherë në fund të muajit.

(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjërimi më i vlefshëm është agjërimi i vëllait tim Davudit. Ai, një ditë e agjëronte, një ditë nuk e agjëronte – dhe nuk ikte kur takohej (me armikun).”⁸⁴⁶

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁸⁴⁷ Ebu Abbasi është poeti i verbër, i cili quhej Saib b. Ferruh.”

Disa dijetarë, thonë: “Agjërimi më i vlefshëm është agjërimi - një ditë po e një ditë jo. Ky, thuhet është agjërimi më intensiv.”

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ مِسْعَرٍ، وَسُفْيَانَ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ أَبِي ثَابِتٍ، عَنْ أَبِي الْعَبَّاسِ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَفْضَلُ الصَّوْمِ صَوْمُ أَخِي دَاوُدَ كَانَ يَصُومُ يَوْمًا وَيُفْطِرُ يَوْمًا وَلَا يَفِرُّ إِذَا لَاقَى " . قَالَ أَبُو عِيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو الْعَبَّاسِ هُوَ الشَّاعِرُ الْمَكِّيُّ الْأَعْمَى وَاسْمُهُ السَّائِبُ بْنُ فَرُّوخَ . قَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ أَفْضَلُ الصِّيَامِ أَنْ تَصُومَ يَوْمًا وَتُفْطِرَ يَوْمًا . وَيُقَالُ هَذَا هُوَ أَشَدُّ الصِّيَامِ .

57. Nuk është i pëlqyer agjërimi, ditën e parë të bajramit të Ramazanit dhe të Kurban bajramit

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الصَّوْمِ يَوْمَ الْفِطْرِ وَيَوْمَ النَّحْرِ

771. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdullah b. Muhammedi, ai ka transmetuar nga Amr b. Jahja, ai nga babai i vet – që Ebu Seid el-Hudriu, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), i ka ndaluar dy lloje të agjërimin: agjërimin e ditës së parë të Kurban bajramit dhe agjërimin e ditës së parë të bajramit të Ramazanit.”⁸⁴⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, është transmetuar hadith edhe nga Umeri, Aliu, Aishja, Ebu Hurejre, Ukbe b. Amiri dhe Enesi. Hadithi i Ebu Seidit është hasen-sahih.”⁸⁴⁹ Sipas tij veprojnë dijetarët. Amër b. Jahja, është i biri i Umare b. Ebu Hasan el-Mazin el-Medeniut. Ai gëzon respekt si ravi i besueshëm. Nga ai, kanë transmetuar hadithe Sufjan eth-Thevriu. Shu’be dhe Melik b. Enesi.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْعَزِيزِ بْنُ مُحَمَّدٍ، عَنْ عَمْرِو بْنِ يَحْيَى، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخُدْرِيِّ، قَالَ نَهَى رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَنْ صِيَامَيْنِ يَوْمَ الْأَضْحَى وَيَوْمَ الْفِطْرِ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ وَعَلِيٍّ وَعَائِشَةَ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعُقْبَةَ بْنِ غَامِرٍ وَأَنَسٍ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَبِي سَعِيدٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَيْهِ عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ . قَالَ أَبُو عِيْسَى وَعَمْرُو بْنُ يَحْيَى هُوَ ابْنُ غَمَارَةَ بْنِ أَبِي الْحَسَنِ الْمَازِنِيُّ الْمَدَنِيُّ وَهُوَ ثِقَةٌ رَوَى عَنْهُ سُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَشُعْبَةُ وَمَالِكُ بْنُ أَنَسٍ .

772. Na ka treguar Muhammed b. Abdulmelik b. Ebu Shevarib – atë e ka informuar Jezid b. Zureja – atë Ma’meri, duke transmetuar nga Zuhriu – që Ebu Ubejde, i mbrojturi i Abdurrahman b. Avfit, ka thënë: “E vështroja Umer b. Hattabin, ditën e parë të Kurban bajramit. Ai filloi me namaz para hutbes, pastaj tha: ‘E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), që e ndalon agjërimin gjatë këtyre dy ditëve: ditën e parë të bajramit të Ramazanit, sepse ajo është ditë me

⁸⁴⁶ Nuk ikte nga armiqet, sepse fizikisht ishte i gatshëm për luftë. Sikur të agjëronte për çdo ditë, ndoshta do të ishte i molisur dhe nuk do të mund të qëndronte në luftë, sidomos nëse ajo do të zgjaste.

⁸⁴⁷ Është i shënuar, në *El-Kutubus-sitte*.

⁸⁴⁸ Neveviu, në komentimin e *Sahihut* të Muslimit, thotë: “Dijetarët janë unik, që është haram agjërimi i këtyre dy ditëve – pa e pasur parasysh, se a ka të bëjë me agjërimin vullnetar, të premtuar apo me agjërimin për shkak të shpagimit (keffaretin). Në rast se ndokush, do të premtonte me vetëdije se ka për të agjëruar mu këto dy ditë, sipas mendimit të Shafiut dhe shumicës së dijetarëve, nuk do të kish qenë i obliguar, për ta përmbushur premtimin e këtillë, e as nuk do të duhej që t’i kompensonte ato duke agjëruar. Ebu Hanife konsideron, se është i obliguar për ta përmbushur atë premtim, duke i agjëruar ato dy ditë. Por, nëse edhe do t’i kishte agjëruar, edhe ajo, do të kishte vlejtur.

⁸⁴⁹ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

të cilën përfundon agjërimi i juaj, por me atë është edhe ditë feste e muslimanëve dhe, ditën e parë të Kurban bajramit që të hani nga kurban i juaj.”

Ebu Isai thotë: “Ky hadith është sahih.⁸⁵⁰ Emri i Ubejdes, i të mbrojturit të Abdurrahman b. Avfit, është Sa’d. Gjithashtu, thonë, që ka qenë i mbrojturi edhe i Abdurrahman b. Ez’herit, ndërsa Abdurrahman b. Ez’heri ishte djali i xhaxhait i Abdurrahman b. Avfit.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنُ أَبِي الشَّوَّازِ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، حَدَّثَنَا مَعْمَرٌ، عَنْ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَبِي عُبَيْدٍ، مَوْلَى عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ قَالَ شَهِدْتُ غَمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ فِي يَوْمِ النَّحْرِ بِدَا بِالصَّلَاةِ قَبْلَ الْخُطْبَةِ ثُمَّ قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَنْهَى عَنْ صَوْمِ هَذَيْنِ الْيَوْمَيْنِ أَمَّا يَوْمُ الْفِطْرِ فَفَطْرُكُمْ مِنْ صَوْمِكُمْ وَعِيدٌ لِلْمُسْلِمِينَ وَأَمَّا يَوْمُ الْأَضْحَى فَكُلُوا مِنْ لَحْمٍ نُسَكُّكُمْ . قَالَ هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ . وَأَبُو عُبَيْدٍ مَوْلَى عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ اسْمُهُ سَعْدٌ وَيُقَالُ لَهُ مَوْلَى عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ أَزْهَرَ أَيْضًا وَعَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ أَزْهَرَ هُوَ ابْنُ عَمِّ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ عَوْفٍ

58. Është i papëlqyer agjërimi i ditëve të teshrikut

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الصَّوْمِ فِي أَيَّامِ التَّشْرِيقِ

773. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Vekiu, ai ka transmetuar nga Musa b. Aliu, ai nga babai i vet, ai nga Ukbe b. Amiri – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dita e ‘Arafatit,⁸⁵¹ dita e parë dhe tre ditët e tjera të Kurban Bajramit – janë ditë feste për ne - pasuesit e islamit. Ato janë ditët e ushqimit dhe të pijes.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Aliu, Sa’di, Ebu Hurejre, Xhabiri, Nubejshiu, Bishr b. Suhajmi, Abdullah b. Hudhafe, Enesi, Hamza b. Amër el-Eslemiu, Ka’b b. Maliku, Aishja, Amër b. Asi dhe Abdullah b. Amri. Hadithi i Ukbe b. Amirit është hasen-sahih. Sipas këtij, veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që agjërimi i tre ditëve të Kurban bajramit është mekruh, megjithatë disa dijetarë atë ua lejojnë atyre të cilët me haxhin, e kanë bërë nijet edhe umrren (mutemetti), i cili nuk mund të ther kurban (në Meke) dhe as nuk ka arritur për t’i agjëruar dhjetë ditët e para (të dhul-hixhes). Ata e kanë të lejuar agjërimin tre ditët e tjera të Kurban bajramit (ejjamul-teshrik). Këtë qëndrim e mbështesin Malik b. Enesi, Shafiu, Ahmedi dhe Is’haku.”⁸⁵²

Ebu Isai, thotë: “Irakianët thonë: ‘Musa b. Ali b. Rebbahu, ndërsa Egjiptianët thonë: Musa b. Ali.’ Unë e kam dëgjuar Kutejben, kur ka thënë: ‘E kam dëgjuar Lejth b. Sadin, kur ka thënë, që Musa b. Aliu, ka thënë: ‘Nuk kam për të lejuar që cilido qoftë, që emrin e babait tim ta shqiptoj në deminutiv!’”

حَدَّثَنَا هَنَّاذٌ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، عَنْ مُوسَى بْنِ عَلِيٍّ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " يَوْمُ عَرَفَةَ وَيَوْمُ النَّحْرِ وَأَيَّامُ التَّشْرِيقِ عِيدُنَا أَهْلَ الْإِسْلَامِ وَهِيَ أَيَّامُ أَكْلِ وَشُرْبٍ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَسَعْدٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَجَابِرٍ وَثُبَيْثَةَ وَبِشْرِ بْنِ سَحِيمٍ وَعَبْدِ اللَّهِ بْنِ حُدَّافَةَ وَأَنَسٍ وَخَمْرَةَ بْنِ عَمْرٍو الْأَسْلَمِيِّ وَكَعْبِ بْنِ مَالِكٍ وَعَائِشَةَ وَعَمْرُو بْنُ الْعَاصِ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ عَمْرٍو . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثٌ

⁸⁵⁰ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

⁸⁵¹ Shevkani, thotë: “Hadithin, të cilin, në *El-Kutubus-sitte*, e shënojnë të gjithë, përveç Buhariut nga Ebu Katade, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjërimi, në Ditën e A’rafatit, është shpagim për mëkatet (e vogla), (fillon) gjatë dy ditëve: vitin që ka shkuar dhe vitin që pason.” – është argument, që është bukur të agjërohet Dita e A’rafatit. Hadithi i Ukbe b. Amirit, i përmendur në këtë kapitull, tregon, se është mekruh agjërimi Ditën e A’rafatit. Dijetarët, këto dy hadithe, në shikim të parë, kundërthënë, i kanë pajtuar, duke konsideruar, që në Ditën e A’rafatit, është bukur të agjërojnë ata, që janë në shtëpitë e veta, ndërsa mekruh për ata që janë në haxh.”

⁸⁵² Sipas mendimit të Ebu Hanifes, tre ditët e tjera të Kurban Bajramit, nuk është e lejuar të agjërohen. Nuk e ka të lejuar as ai që me haxh e ka bërë nijet edhe umren, e në Mekke nuk ka mundur ta therte kurbanin, por nuk ka arritur as t’i agjëronte dhjetë ditët e dhul-hixhes, e asnjërën prej tyre.

عُفَيْهَ بْنِ عَامِرٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ يَكْرَهُونَ الصِّيَامَ أَيَّامَ النَّشْرِيقِ إِلَّا أَنْ قَوْمًا مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَغَيْرِهِمْ رَخَّصُوا لِلْمَتَمِّعِ إِذَا لَمْ يَجِدْ هَدْيًا وَلَمْ يَصُمْ فِي الْعَشْرِ أَنْ يَصُومَ أَيَّامَ النَّشْرِيقِ . وَبِهِ يَقُولُ مَالِكُ بْنُ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيُّ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَأَهْلُ الْعِرَاقِ يَقُولُونَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ بْنُ رَبَاحٍ وَأَهْلُ مِصْرَ يَقُولُونَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ . وَقَالَ سَمِعْتُ قُتَيْبَةَ يَقُولُ سَمِعْتُ اللَّيْثَ بْنَ سَعْدٍ يَقُولُ قَالَ مُوسَى بْنُ عَلِيٍّ لَا أَجْعَلُ أَحَدًا فِي حِلِّ صَغَرِ اسْمِ أَبِي .

59. Lëshimi i gjakut (me ndihmën e kupëzës) duke qenë agjërueshëm është mekruh

باب كَرَاهِيَةِ الْجَمَامَةِ لِلصَّائِمِ

774. Na kanë treguar Muhammed b. Rafi en-Nejsaburi, Mahmud b. Gajlani dhe Jahja b. Musa – ata i ka informuar Abdurrezaku, ai ka transmetuar nga Ma’meri, ai nga Jahja b. Ebu Kethiri, ai nga Ibrahim b. Abdullah b. Karizi,⁸⁵³ ai nga Saib b. Jezidi, ai nga Rafi b. Hadixhi – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “E ka prishur agjërimin ai që e lëshon dhe ai të cilit i lëshohet gjaku.”⁸⁵⁴

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Sa’di, Aliu, Sheddad b. Evsi, Thevbani, Usama b. Zejdi, Aishja, Ma’kil b. Jesari – por thuhet edhe Ma’kil b. Sinani - Ebu Hurejre, Ibn Abbasi, Ebu Musai dhe Bilali. Hadithi i Rafi’ b. Hadixhit është hasen-sahih.”⁸⁵⁵

Transmetohet, që Ahmed b. Hanbeli ka thënë: “Diç më e besueshme mbi këtë temë, është hadithi i Rafi’ b. Hadixhit.” Është përmendur, që Ali b. Abdullahu, ka thënë: “Diç që është më e besueshme mbi këtë temë është hadithi i Thevbanit dhe i Sheddad b. Evsit, sepse Jahja b. Ebu Kethiri, të dy këta hadithë i ka transmetuar nga Ebu Kilabi, edhe hadithin e Thevbanit edhe të Sheddad b. Evsit.”

Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, konsideronin, që për agjëruesin është mekruh lëshimi i gjakut. Për atë shkak, disa nga as’habët, gjakun e lëshonin gjatë natës. Ashtu bënin Ebu Musa el-Esh’ari dhe Ibn Umeri. Ky është qëndrimi edhe i Ibn Mubarekut.

Ebu Isai, thotë: “E kam dëgjuar Is’hak b. Mensurin, kur ka thënë që Abdurrahman b. Mehdiu ka thënë: ‘Ai i cili e lëshonte gjakun, derisa ishte agjërueshëm, ai ishte i obliguar për ta agjëruar atë ditë.’ Is’hak b. Mensuri thotë, që të njëjtën e kanë thënë edhe Ahmed b. Hanbeli dhe Is’hak b. Ibrahim.”

Ebu Isai, thotë: “Më ka informuar Hasan b. Muhammed ez-Za’ferani, që Shafi’u, ka thënë: “Është transmetuar, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (me një rast) ia ka lëshuar vetes gjakun, derisa ka qenë agjërueshëm. Ndërsa, është transmetuar edhe që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘E ka prishur agjërimin edhe ai që e lëshon edhe ai të cilit i lëshohet gjaku.’ Nuk më është e njohur, që njëri hadith nga këta dy është vërtetuar. Më tepër kisha dashur, që personi të përmbahet nga lëshimi i gjakut, duke qenë agjërueshëm. Megjithatë, nëse është (agjërueshëm) dhe e lëshon, nuk konsideroj që me atë e ka prishur agjërimin.’ Kështu konsideronte Shafi’u, derisa ishte në Bagdad. Ndërkaq, në Egjipt e pranoi lehtësimin, ashtu që, në lëshimin e gjakut nuk shihte kurrfarë pengese. Si argument për atë, ka theksuar, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në Haxhin Lamtumirës, ia ka lëshuar gjakun vetes, duke qenë në ihrame dhe duke qenë agjërueshëm.”

⁸⁵³ Ibrahim b. Abdullah b. Karidh, është transmetues i sinqertë. I ka takuar gjeneratës së tretë të ravive.

⁸⁵⁴ Tibi, thotë, që në bazë të këtij hadithi, Ahmed b. Hanbeli dhe Is’haku, kanë vërtetuar, që lëshimi i gjakut, e prish agjërimin, edhe atij që ndokujt me ndihmën e kubëzave ia lëshon gjakun dhe atij, të cilit i lëshohet gjaku. Mesruku, Hasan el-Basri dhe Ibn Sirini, konsiderojnë, që lëshimi i gjakut agjëruesit, është mekruh, por nuk e prish agjërimin.

⁸⁵⁵ E shënojnë edhe Ibn Hibbani, në *Sahih* dhe Hakimi në *Mustedrek*. Hakimi, thotë, që sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit, është i besueshëm.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ يَحْيَى، وَمُحَمَّدُ بْنُ رَافِعٍ النَّيْسَابُورِيُّ، وَمُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، وَيَحْيَى بْنُ مُوسَى، قَالُوا حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، عَنْ مَعْمَرٍ، عَنْ يَحْيَى بْنِ أَبِي كَثِيرٍ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ قَارِظٍ، عَنِ السَّائِبِ بْنِ يَزِيدَ، عَنْ رَافِعِ بْنِ خَدِيجٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " أَفْطَرِ الْحَاجِمُ وَالْمُحْجُومُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَسَعْدِ بْنِ شَدَّادٍ بْنِ أَوْسٍ وَثُوبَانَ وَأَسَامَةَ بْنِ زَيْدٍ وَعَائِشَةَ وَمَعْقِلَ بْنِ سِنَانٍ وَيُقَالَ ابْنُ بَسَّارٍ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَابْنُ عَبَّاسٍ وَأَبِي مُوسَى وَبِلَالٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَحَدِيثُ رَافِعِ بْنِ خَدِيجٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَذَكَرَ عَنْ أَحْمَدَ بْنِ حَنْبَلٍ أَنَّهُ قَالَ أَصْحَحُ شَيْءٍ فِي هَذَا الْبَابِ حَدِيثُ ثُوبَانَ وَشَدَّادِ بْنِ أَوْسٍ لِأَنَّ يَحْيَى بْنَ أَبِي كَثِيرٍ رَوَى عَنْ أَبِي قِلَابَةَ الْخَدِيثَيْنِ جَمِيعًا حَدِيثُ ثُوبَانَ وَحَدِيثُ شَدَّادِ بْنِ أَوْسٍ . وَقَدْ كَرِهَ قَوْمٌ مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمُ الْجَمَاعَةَ لِلصَّائِمِ حَتَّى أَنْ بَعْضُ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ اخْتَجَمَ بِاللَّيْلِ مِنْهُمْ أَبُو مُوسَى الْأَشْعَرِيُّ وَابْنُ عُمرٍ وَبِهَذَا يَقُولُ ابْنُ الْمُبَارَكِ . قَالَ أَبُو عِيسَى سَمِعْتُ إِسْحَاقَ بْنَ مَنْصُورٍ يَقُولُ قَالَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ مَهْدِيٍّ مَنْ اخْتَجَمَ وَهُوَ صَائِمٌ فَغَلَبَهُ الْقُضَاءُ . قَالَ إِسْحَاقُ بْنُ مَنْصُورٍ وَهَكَذَا قَالَ أَحْمَدُ بْنُ حَنْبَلٍ وَإِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ . وَقَالَ أَبُو عِيسَى وَأَخْبَرَنِي الْحَسَنُ بْنُ مُحَمَّدٍ الرَّغْفَرَانِيُّ قَالَ قَالَ الشَّافِعِيُّ قَدْ رَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ اخْتَجَمَ وَهُوَ صَائِمٌ وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " أَفْطَرِ الْحَاجِمُ وَالْمُحْجُومُ " . وَلَا أَعْلَمُ وَاحِدًا مِنْ هَذَيْنِ الْخَدِيثَيْنِ ثَابِتًا وَلَوْ تَوَقَّى رَجُلٌ الْجَمَاعَةَ وَهُوَ صَائِمٌ كَانَ أَحَبَّ إِلَيَّ وَلَوْ اخْتَجَمَ صَائِمٌ لَمْ أَرِ ذَلِكَ أَنْ يُفْطَرَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَكَذَا كَانَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ يَبْغِضُ بَعْضُ النَّاسِ إِلَى الرُّخْصَةِ وَلَمْ يَزِ بِالْجَمَاعَةِ لِلصَّائِمِ بَأْسًا وَاجْتَنَعَ بِأَنَّ النَّبِيَّ ﷺ اخْتَجَمَ فِي حَجَّةِ الْوَدَاعِ وَهُوَ مُحْرَمٌ صَائِمٌ .

60. Mbi lehtësimin në atë

باب ما جاء من الرخصة في ذلك

775. Na ka treguar Bishr b. Hilal El-Basri – atë e ka informuar Abdulvarith b. Seidi, atë Ejubi, ai ka transmetuar nga Ikrimë, që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e ka lëshuar gjakun, duke qenë në ihrame dhe duke qenë agjërueshëm.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është sahih.”⁸⁵⁶ Ashtu, e ka transmetuar atë edhe Vuhejbi, ngjashëm me transmetimin e Abdulvarithit. Ndërsa, e ka transmetuar Ismail b. Ibrahim nga Ejubi – e ai nga Ikrimë, si mursal dhe në të nuk është përmendur ‘Nga Ibn Abbasi.’”

حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ هِلَالٍ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَارِثِ بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا أَيُّوبُ، عَنْ عِكْرَمَةَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ اخْتَجَمَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَهُوَ مُحْرَمٌ صَائِمٌ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ . وَهَكَذَا رَوَى وَهَيْبٌ نَحْوَ رِوَايَةِ عَبْدِ الْوَارِثِ . وَرَوَى إِسْمَاعِيلُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ عَنْ أَيُّوبَ عَنْ عِكْرَمَةَ مُرْسَلًا وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ .

776. Na ka treguar Ebu Musa Muhammed b. Musenna – atë e ka informuar Muhammed b. Abdullah el-Ensari, ai ka transmetuar nga Habib b. Shehidi, ai nga Mejmuna b. Mihrani – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ia ka lëshuar (vetes) gjakun, por ishte agjërueshëm.” Ebu Isai thotë: “Ky hadith në këtë formë është hasen-garib.”

حَدَّثَنَا أَبُو مُوسَى، مُحَمَّدُ بْنُ الْمُثَنَّى حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ عَبْدِ اللَّهِ الْأَنْصَارِيُّ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ الشَّهِيدِ، عَنْ مَيْمُونِ بْنِ مِهْرَانَ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ اخْتَجَمَ وَهُوَ صَائِمٌ . هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

777. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Abdullah b. Idrizi, duke transmetuar nga Jezid b. Ebu Zijadi, ai nga Miksemi – që Ibn Abbasi, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (gjatë udhëtimit) ndërmjet Mekës dhe Medinës, ia ka lëshuar gjakun vetes (me ndihmën e kupëzës), ndërsa ishte në ihrame dhe duke agjëruar.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Seidi, Xhabiri dhe Enesi. Hadithi i Ibn Abbasit është hasen-sahih. Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerë, në

⁸⁵⁶ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

frymën e këtij hadithi, kanë vërtetuar që lëshimi i gjakut nuk i pengon agjëruesit. Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut, Malik b. Enesit dhe i Shafiut.”⁸⁵⁷

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ إِدْرِيسَ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَبِي زَيْدٍ، عَنْ مِقْسَمٍ، عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ اخْتَجَمَ فِيمَا بَيْنَ مَكَّةَ وَالْمَدِينَةِ وَهُوَ مُحَرَّمٌ صَائِمٌ. قَالَ أَبُو عِيْسَى وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي سَعِيدٍ وَجَابِرٍ وَأَنْسٍ. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ ابْنِ عَبَّاسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ إِلَى هَذَا الْحَدِيثِ وَلَمْ يَرَوْا بِالْجَمَاعَةِ لِلصَّائِمِ بَأْسًا. وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَمَالِكِ بْنِ أَنَسٍ وَالشَّافِعِيِّ.

61. Është i papëlqyer bashkimi i agjërimit⁸⁵⁸

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ الْوَصَالِ لِلصَّائِمِ

778. Na ka treguar Nasr b. Ali el-Xhuhdami – atë e kanë informuar Bishr b. Mufeddali dhe Halid b. Harithi, ata dy kanë transmetuar nga Seid b. Ebu Arubi, ai nga Katade, ai nga Enesi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: ‘Mos i bashkoni (ditët e agjërimit).’ ‘Edhe ti i bashkon, o i Dërguar i Allahut?’ ‘Unë nuk jam si ju, mua më ushqen edhe më jep për të pirë Sunduesi im.’”⁸⁵⁹

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ebu Hurejre, Aishja, Ibn Umeri, Xhabiri, Ebu Seidi dhe Beshir b. Hasani. Hadithi i Enesit është hasen-sahih.⁸⁶⁰ Sipas tij veprojnë disa dijetarë. Ata, bashkimin e ditëve të agjërimit e konsiderojnë të papëlqyer.⁸⁶¹ Transmetohet, që Abdullah b. Zubejri i bashkonte ditët dhe nuk e prishte agjërimitin.”

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا بِشْرُ بْنُ الْمُفَضَّلِ، وَخَالِدُ بْنُ الْخَارِثِ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ أَبِي عَرُوبَةَ، عَنْ قَتَادَةَ، عَنْ أَنَسٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " لَا تَوَاصِلُوا ". قَالُوا فَإِنَّكَ تَوَاصَلْتَ يَا رَسُولَ اللَّهِ. قَالَ " إِنِّي لَسْتُ كَأَحَدِكُمْ إِنْ رَبِّي يُطْعِمُنِي وَيَسْقِينِي ". قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ عَلِيٍّ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ وَابْنِ عُمَرَ وَجَابِرٍ وَأَبِي سَعِيدٍ وَبَشِيرِ بْنِ الْخَصَّاصِيَّةِ. قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ أَنَسٍ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ. وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ كَرَهُوا الْوَصَالَ فِي الصَّيَامِ. وَرَوَى عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الزُّبَيْرِ أَنَّهُ كَانَ يُوَاصِلُ الْأَيَّامَ وَلَا يُفْطِرُ.

62. Mbi personin, i cili agon xhunub por dëshiron të agjërojë

باب مَا جَاءَ فِي الْجُنُبِ يَذُرُّهُ الْفَجْرُ وَهُوَ يُرِيدُ الصَّوْمَ

779. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Lejtthi, duke transmetuar nga Ibn Shihabi – që Ebu Bekër b. Abdurrahman b. Harith b. Hishami, ka thënë: “Më kanë informuar, Aishja dhe Ummu Seleme, bashkëshortet e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), që (nganjëherë) pas

⁸⁵⁷ Edhe Ebu Hanife, në bazë të këtyre haditheve të përmendura në këtë kapitull, konsideron, se lëshimi i gjakut-hixhami, nuk e prish agjërimitin. Ibn Hazmi, thotë: “Nuk ka dyshim, që është hadith i besueshëm: “E ka prishur agjërimitin edhe ai i cili e lëshon gjakun edhe ai, të cilit i lëshohet.” Ndërkaq, në hadithin e Ebu Seidit, senedi i të cilit është i besueshëm, hasim, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka lejuar që agjëruesit mund të bëjnë hixham. Sipas mendimit tonë, duhet vepruar në pajtim me këtë hadith, sepse lehtësimi vjen, pas urdhërësës së fuqishme, çfarë nga ana tjetër, tregon se ai është shfuqizuar. Në bazë të të gjithave të përmendura, nxjerrim konkludim se as nxjerrja e gjakut, siç praktikohet në kokën tonë, nuk e prish agjërimitin.

⁸⁵⁸ Bashkimi i agjërimit, nënkupton, që personi, pasi që agjëron ditën, gjatë natës nuk bën asgjë që e prish agjërimitin, por vazhdon të agjërojë edhe natën edhe ditën e ardhme ose më shumë ditë, e që assesi nuk e prish agjërimitin.

⁸⁵⁹ Sunduesi im, më jep të ha dhe të pijë – domethënë, që atij, që Allahu i Lartësuar, i jep forcë dhe fuqi, që ta durojë agjërimitin edhe disa ditë me radhë, duke mos e ndërprerë as natën, as ditën.

⁸⁶⁰ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në Sahihë.

⁸⁶¹ Shumica e dijetarëve, thonë, që bashkimi i agjërimit, në mënyrë të përmendur, është haram.

marrëdhënieve seksuale me njërin nga bashkëshortet e veta agonte xhunub, mandej lahej dhe e agjëronte (atë ditë).⁸⁶²

Ebu Isai, thotë: “Hadithi i Aishes dhe i Ummu Selemes është hasen-sahih.”⁸⁶³ Sipas këtij hadithi, kanë vepruar shumica e dijetarëve nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët. Përveç atyre, ky është edhe qëndrimi i Sufjanit, Shafiut, Ahmedit dhe i Is’hakut. Disa tabi’inë, thonë: “Kur ndokush agon xhunub, ai ka për ta kompensuar atë ditë me agjërim.”⁸⁶⁴ Mendimi i parë është më i drejtë.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا اللَّيْثُ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ أَبِي بَكْرٍ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ بْنِ الْحَارِثِ بْنِ هِشَامٍ، قَالَ أَخْبَرْتَنِي عَائِشَةُ، وَأُمُّ سَلَمَةَ زَوْجَا النَّبِيِّ ﷺ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُدْرِكُهُ الْفَجْرُ وَهُوَ جُنُبٌ مِنْ أَهْلِهِ ثُمَّ يَغْتَسِلُ فَيَصُومُ . قَالَ أَبُو عِيْسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ وَأُمِّ سَلَمَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا أَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ وَهُوَ قَوْلُ سَفْيَانَ وَالشَّافِعِيِّ وَأَحْمَدَ وَإِسْحَاقَ . وَقَدْ قَالَ قَوْمٌ مِنَ التَّابِعِينَ إِذَا أَصْبَحَ جُنُبًا يَقْضِي ذَلِكَ الْيَوْمَ . وَالْقَوْلُ الْأَوَّلُ أَصَحُّ .

63. Të përgjigjurit e agjëruetit ndaj ftesës në gazmend

باب مَا جَاءَ فِي إِبَابَةِ الصَّائِمِ الدَّعْوَةَ

780. Na ka treguar, Ez’her b. Mervan el-Basriu –atë e ka informuar Muhammed b. Seva, atë Seid b. Ebu Arube, ai ka transmetuar nga Ejubi, ai nga Muhammed b. Sirini, ndërsa ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nëse ndonjëri prej jush ftohet në ushqim, le të përgjigjet. Por, nëse është duke agjëruar, le të bëjë dua.”⁸⁶⁵

حَدَّثَنَا أَبُو هُرَيْرَةَ بْنُ مَرْوَانَ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ سَوَاءٍ، حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ أَبِي عَرُوبَةَ، عَنْ أَبِي ثَوْبٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ سِيرِينَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا دُعِيَ أَحَدُكُمْ إِلَى طَعَامٍ فَلْيُجِبْ فَإِنْ كَانَ صَائِمًا فَلْيُصَلِّ " . يَغْنِي الدَّعَاءَ .

781. Na ka treguar Nasër b. Aliu – atë e ka informuar Sufjan b. Ujejne, duke transmetuar nga Ebu Zinadi, ai nga A’rexhi, ai nga Ebu Hurejre – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nëse ndokush nga ju, derisa është duke agjëruar ftohet (në ushqim), le të thotë: ‘Unë jam

⁸⁶² Shumica vijnë në dilemë se, pasi që gjatë ramazanit, apo netëve të rëndomta, e gjatë natës kanë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten dhe bien pa u larë, ose gjatë natës ejakulojnë në gjumë, dhe agojnë xhunub, a mund të agjërojnë atë ditë? Përgjigjen për këtë hamendje e ofron ky hadith. Në bazë të kësaj, shumica e dijetarëve ka caktuar, që ajo ditë duhet të agjërohet, pa e pasur parasysh se a ka të bëjë me agjërimin obligativ apo vullnetar.

⁸⁶³ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

⁸⁶⁴ Është shënuar, se disa tabi’inë, konsideronin, se personi, kur agon xhunub, atë ditë nuk mund ta agjërojë, por ka për ta kompensuar atë ditë me agjërim. Ata këtë e bazojnë, mbi fetvanë e Ebu Hurejres, nga e cila ai hoqi dorë pasi që e kishte dëgjuar hadithin e Aishes dhe Ummu Selemes dhe hadithin, të cilin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*, gjithashtu nga Ebu Hurejre: “Kush agon xhunub, për te (ajo ditë), nuk ka agjërim.” Ibn Mundhiri thotë: “Më e mira që kam dëgjuar, për këtë hadith, është, se ai është deroguar.” Në të vërtetë, në fillim të islamit, agjëruetit e kishin të ndaluar, gjatë ramazanit edhe ngrënien gjatë natës, edhe pirjen edhe takimin me gruan. Më vonë, kur Allahu i Lartësuar, të tëra ato ua lejoi agjëruetesve, i është lejuar edhe personit në rast se agon xhunub që të mund të agjërojë.

⁸⁶⁵ Tirmidhiu, fjalën *fel-jusal-li* e ka kuptuar në kuptim të duasë. Domethënë, edhe pse i ftuari, për shkak të të qenit agjërueshëm, nuk mund t’i qaset ushqimit, megjithatë, mund t’i përgjigjet ftesës, që së bashku me të tjerët, t’i drejtohej me lutje Allahut të Lartësuar, që nikoqirit, t’i dhurojë bereqet. Këtë kuptim të fjalës – le të lutet – e vërteton edhe hadithi, të cilin e shënon Taberaniu nga Ibn Mes’udi: “Dhe nëse do të ketë qenë duke agjëruar, le të drejtohet me duanë për bereqet.” Disa, fjalën *fel-jusal-li*, e kanë kuptuar në kuptim të namazit. Domethënë, le t’i përgjigjet thirrjes dhe le të falet në shtëpinë e tij. Vërtetimin për këtë hadith, e gjejmë në hadithin, të cilin e shënon Buhariu nga Enesi: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) (me një rast) ka hyrë tek Ummu Sulejm. Ajo i ka ofruar hurme dhe tëlyen, në çfarë ai ka thënë: “Ktheni tëlyenin në meshinare, e hurmet në enë – sepse unë jam duke agjëruar.” Pastaj është ngritur dhe në fund të dhomës i fali dy rekate namaz vullnetar dhe drejtoi lutje, në të cilën lutej për Ummu Sulejmen dhe familjen e saj.”

duke agjëruar.”⁸⁶⁶ Ebu Isai, thotë: “Të dy hadithet nga Ebu Hurejre mbi këtë temë janë hasen-sahih.”⁸⁶⁷

حَدَّثَنَا نَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الْأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " إِذَا دُعِيَ أَحَدُكُمْ وَهُوَ صَائِمٌ فَلْيَقُلْ إِنِّي صَائِمٌ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَكَلاَ الْحَدِيثَيْنِ فِي هَذَا الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

64. Është e papëlqyer që gruaja të agjërojë pa lejen e bashkëshortit

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ صَوْمِ الْمَرْأَةِ إِلَّا بِإِذْنِ زَوْجِهَا

782. Na kanë treguar Kutejbe dhe Nasr b. Aliu – ata i ka informuar Sufjan b. Ujejne, duke transmetuar nga Ebu Zinadi, ai nga A’rexhi, ai nga Ebu Hurejre, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Le të mos agjërojë gruaja asnjë ditë jashtë ramazanit, kur bashkëshorti i saj është në shtëpi, përveç se me lejen e tij.”⁸⁶⁸

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ibn Abbasi dhe Ebu Seidi. Hadithi i Ebu Hurejres është hasen-sahih.⁸⁶⁹ Ky hadith është transmetuar nga Ebu Zinadi - nëpërmjet Musa b. Ebu Uthmanit, ai atë e transmeton nga babai i vet, ai nga Ebu Hurejre – nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، وَنَصْرُ بْنُ عَلِيٍّ، قَالَا حَدَّثَنَا سُفْيَانُ بْنُ عُيَيْنَةَ، عَنْ أَبِي الزِّنَادِ، عَنِ الْأَعْرَجِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " لَا تَصُومُ الْمَرْأَةُ وَزَوْجُهَا شَاهِدٌ يَوْمًا مِنْ غَيْرِ شَهْرِ رَمَضَانَ إِلَّا بِإِذْنِهِ " . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ وَأَبِي سَعِيدٍ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ أَبِي الزِّنَادِ عَنْ مُوسَى بْنِ أَبِي عُثْمَانَ عَنْ أَبِيهِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ .

65. Shtyrja e agjërimin për ta kompensuar ditët e pa agjëruara të ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي تَأْخِيرِ قَضَاءِ رَمَضَانَ

783. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Ebu Avvani, duke transmetuar nga Ismail Es-Sudijji, ai nga Abdullah el-Behijji – që Aishja, ka thënë: “Unë, ato ditë që isha e obliguar t’i agjëroja, për t’i kompensuar ditët e pa agjëruara të ramazanit, nuk i agjëroja, përveç në muajin sha’ban, gjithnjë, derisa i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është shpërngulur në Ahiret.”⁸⁷⁰

⁸⁶⁶ “Në rast se ndokush, për shkak të agjërimin nuk mund të përgjigjet në ushqim, le t’i kërkojë falje njeriut përkatës dhe le t’i sqarojë, se nuk mund të shkojë për shkak të agjërimin. Dhe – thotë Neveviu – nëse ai ia pranon kërkim faljen dhe e vlerëson arsyetimin, atëherë nuk është i obliguar të jetë prezent. Ndërkaq, nëse nikoqiri insiston edhe pas asaj në prezencën e tij, atëherë është i obliguar të jetë prezent, madje edhe nëse nuk hanë fare.”

⁸⁶⁷ E shënon, Muslimi në *Sahih*.

⁸⁶⁸ Ky hadith është argument, që gruaja nuk e ka të lejuar agjërimin e kurrfarë nafileje, kur bashkëshorti i saj është në shtëpi, përveç me lejen e tij. Të gjitha format e agjërimin të obliguar, është e obliguar t’i agjërojë, dhe për atë nuk i nevojitet pëlqimi i tij. Taberaniu, në Mu’xhemul-Kebir, shënon nga Ibn Abbasi, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Nga obligimet e gruas ndaj bashkëshortit të vet është edhe obligimi, që të mos agjëroj kurrfarë nafile pa lejen e bashkëshortit të vet. Nëse nuk e bënë atë (nuk merr leje nga ai) ajo ka qenë kotë e uritur dhe e etur, ai agjërim nuk ka për t’iu pranuar.”

⁸⁶⁹ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi.

⁸⁷⁰ Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që ky hadith është argument, që agjërimi i ditëve të humbura të ramazanit, mund të pezullohet gjithnjë, deri në ramazanin vijues, pa marrë parasysh, atë që, a ka arsye të justifikueshme apo jo. Pezullimi i ditëve të humbura të ramazanit, deri në ramazanin e ardhshëm, sipas el-Mubarekfurit, nuk është i lejuar.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih. Atë e ka transmetuar edhe Jahja b. Seid el-Ensari nga Ebu Seleme, ndërsa ai nga Aishja, ngjashëm me këtë.”

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا أَبُو عَوَانَةَ، عَنْ إِسْمَاعِيلَ السُّدِّيِّ، عَنْ عَبْدِ اللَّهِ الْبُهَيْ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ مَا كُنْتُ أَقْضِي مَا يَكُونُ عَلَيَّ مِنْ رَمَضَانَ إِلَّا فِي شَعْبَانَ حَتَّى تُوَفِّي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . قَالَ وَقَدْ رَوَى يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ الْأَنْصَارِيُّ عَنْ أَبِي سَلَمَةَ عَنْ عَائِشَةَ نَحْوَ هَذَا .

66. Mbi vlerat e agjëruesit kur iftari hahet tek ai

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ الصَّائِمِ إِذَا أَكَلَ عِنْدَهُ

784. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Sheriku, ai ka transmetuar nga Habib b. Zejdi, ai nga Lejlea, ajo nga zonja e saj – që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Për agjëruesin, i cili e përgatitë ushqimin për agjërues, melaiket kërkojnë falje.”

Ebu Isai, thotë: “Këtë hadith, Shu’be e ka transmetuar nga Habib b. Zejdi, ai nga gjyshja e vet Ummu Umare,⁸⁷¹ ndërsa, ajo nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e mëparshëm.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ خُزَيْرٍ، أَخْبَرَنَا شَرِيكٌ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ زَيْدٍ، عَنْ لَيْلَى، عَنْ مَوْلَاتِهَا، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " الصَّائِمُ إِذَا أَكَلَ عِنْدَهُ الْمَقَاتِيرُ صَلَّتْ عَلَيْهِ الْمَلَائِكَةُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَرَوَى شُعْبَةُ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ حَبِيبِ بْنِ زَيْدٍ عَنْ لَيْلَى عَنْ جَدَّتِهِ أُمِّ عُمَارَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَحْوَهُ .

785. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Ebu Davudi, atë Shu’be – që Habib b. Zejdi, ka thënë: “E kam dëgjuar të mbrojturën tonë, e cila quhej Lejla, kur tregonte nga Ummu Umare, vajza e Ka’bit, e cila ishte ensare, që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast kishte hyrë tek ajo dhe ajo i kishte ofruar ushqim. Ai tha: ‘Ha edhe ti!’ ‘Unë jam duke agjëruar’ – u përgjigj ajo, ndërsa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në atë tha: ‘Agjëruesin e bekojnë melaiket çdo herë kur ushqimi hahet tek ai, gjithnjë, derisa (të pranishmit) nuk përfundojnë (së ngrëni).’ Ose ka thënë: ‘Derisa nuk ngopen.’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih⁸⁷² dhe është më i besueshëm sesa hadithi i Sherikut.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيْلَانَ، حَدَّثَنَا أَبُو دَاوُدَ، أَخْبَرَنَا شُعْبَةُ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ زَيْدٍ، قَالَ سَمِعْتُ مَوْلَاةَ، لَنَا يُقَالُ لَهَا لَيْلَى تُحَدِّثُ عَنْ جَدَّتِهِ أُمِّ عُمَارَةَ بِنْتِ كَعْبِ الْأَنْصَارِيِّ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ دَخَلَ عَلَيْهَا فَقَدَمَتْ إِلَيْهِ طَعَامًا فَقَالَ " كُلِي " . فَقَالَتْ إِنِّي صَائِمَةٌ . فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ " إِنَّ الصَّائِمَ تَصَلَّى عَلَيْهِ الْمَلَائِكَةُ إِذَا أَكَلَ عِنْدَهُ حَتَّى يَفْرُغُوا " . وَرَبَّمَا قَالَ " حَتَّى يَشْبَعُوا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ وَهُوَ أَصَحُّ مِنْ حَدِيثِ شَرِيكِ .

786. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Muhammed b. Xha’feri, atë Shu’be, ai ka transmetuar nga Habib b. Zejdi, ai nga e mbrojtura e tyre, e cila quhej Lejla, ajo nga Ummu Umare, vajza e Ka’bit, e ajo nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ngjashëm me hadithin e mëparshëm, duke mos e përmendur në te “Gjithnjë, derisa ata nuk përfundojnë (me ushqimin) ose nuk ngopen.” Ebu Isai, thotë: “Ummu Umare është gjyshja e Habib b. Zejd el-Ensarit.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، حَدَّثَنَا شُعْبَةُ، عَنْ حَبِيبِ بْنِ زَيْدٍ، عَنْ مَوْلَاةَ، لَهَا يُقَالُ لَيْلَى عَنْ جَدَّتِهِ أُمِّ عُمَارَةَ بِنْتِ كَعْبِ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ نَحْوَهُ وَلَمْ يَذْكُرْ فِيهِ " حَتَّى يَفْرُغُوا أَوْ يَشْبَعُوا " . قَالَ أَبُو عِيسَى وَأُمُّ عُمَارَةَ هِيَ جَدَّةُ حَبِيبِ بْنِ زَيْدٍ الْأَنْصَارِيِّ .

⁸⁷¹ Ummi Ummari, quhet Nesibe. Ajo është e bija e Ka’b b. Amrit. U takon as’haveve.

⁸⁷² E kanë shënuar edhe Ahmed b. Hanbeli në *Musned*, edhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

67. Gruaja ka për ta kompensuar agjërimin e jo namazet e ikura gjatë menstruacioneve

باب مَا جَاءَ فِي قَضَاءِ الْحَائِضِ الصِّيَامِ دُونَ الصَّلَاةِ

787. Na ka treguar Ali b. Huxhri – atë e ka informuar Ali b. Mus’hiri, duke transmetuar nga Ubejde, ai nga Ibrahim, ai nga Esvedi – që Aishja, ka thënë: “Gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ne kishim menstruacione, pastaj laheshim – mandej i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), na urdhëronte që t’i kompensonim ditët e pa agjëruara, ndërsa nuk na urdhëronte që ta kompensonim edhe namazin e lëshuar.”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen.⁸⁷³ Është transmetuar gjithashtu, nëpërmjet Muadhit nga Aishja. Sipas këtij veprojne dijetarët. Nuk na është e njohur, që në mesin e tyre ka ndonjë divergjencë rreth asaj, që gruaja ka për ta kompensuar agjërimin, e nuk ka për t’i kompensuar namazet e lëshuara gjatë menstruacioneve. Ubejde është i biri i Muattib ed-Dabijj el-Kufit. Pseudonimi i tij sipas të birit është Ebu Abdulkërim.”

حَدَّثَنَا عَلِيُّ بْنُ حُجْرٍ، أَخْبَرَنَا عَلِيُّ بْنُ مُسْهِرٍ، عَنْ عُبَيْدَةَ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنِ الْأَسْوَدِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كُنَّا نَحِيضُ عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ ثُمَّ نَطْهَرُ فَيَأْمُرُنَا بِقَضَاءِ الصِّيَامِ وَلَا يَأْمُرُنَا بِقَضَاءِ الصَّلَاةِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَقَدْ رُوِيَ عَنْ مُعَاذَةَ عَنْ عَائِشَةَ أَيْضًا . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ لَا نَعْلَمُ بَيْنَهُمْ اخْتِلَافًا أَنَّ الْحَائِضَ تَقْضِي الصِّيَامَ وَلَا تَقْضِي الصَّلَاةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَغَيْدَةُ هُوَ ابْنُ مُعْتَبِرٍ الصَّبِيُّ الْكُوفِيُّ يُكْنَى أَبَا عَبْدِ الْكَرِيمِ .

68. Për agjëruesin shpëlarja e ekzagjeruar e hundës është e pa pëlqyer

باب مَا جَاءَ فِي كَرَاهِيَةِ مُبَالَغَةِ الْإِسْتِشْقِ لِلصَّائِمِ

788. Na kanë treguar Abdulvehab el-Verraku dhe Ebu Ammari – ata i ka informuar Jahja b. Sulejmi, atij i ka treguar Ismail b. Kethiri – që Asim b. Lekit b. Sabiri, duke transmetuar nga babai i vet, ka thënë: “Unë thash: ‘I Dërguari i Allahut, më informo mbi abdesin?’ Ai tha: ‘Merr abdes në mënyrë të përkryer, fërkoji gishtërinjtë në mes dhe shpëlaje hundën mirë, përveç nëse je duke agjëruar.’”

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.⁸⁷⁴ Disa dijetarë, konsiderojnë, që është mekruh futja e ilaçeve në hundë, gjatë agjërimit. Ata pohojnë, që ilaçi e prish agjërimin. Ky hadith përmban kuptimin i cili e mbështetë qëndrimin e tyre.”

حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَهَّابِ بْنُ عَبْدِ الْحَكَمِ الْبَغْدَادِيُّ الْوَرَّاقُ، وَأَبُو عَمَّارٍ الْحُسَيْنُ بْنُ حَرْبٍ قَالَا حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سُلَيْمٍ، حَدَّثَنَا إِسْمَاعِيلُ بْنُ كَثِيرٍ، قَالَ سَمِعْتُ عَاصِمَ بْنَ لَقِيطٍ بْنَ صَبْرَةَ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ قُلْتُ يَا رَسُولَ اللَّهِ أَخْبِرْنِي عَنِ الْوُضُوءِ . قَالَ " أَسْبِغِ الْوُضُوءَ وَخَلِّ بَيْنَ الْأَصَابِعِ وَبَالَغْ فِي الْإِسْتِشْقِ إِلَّا أَنْ تَكُونَ صَائِمًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ كَرِهَ أَهْلُ الْعِلْمِ السَّعُوطَ لِلصَّائِمِ وَرَأَوْا أَنَّ ذَلِكَ يُفْطِرُهُ وَفِي الْحَدِيثِ مَا يُقَوِّي قَوْلَهُمْ .

69. Kush shkon në vizitë te ndokush, të mos agjërojë përveç me lejen e tij

باب مَا جَاءَ فِيمَنْ نَزَلَ بِقَوْمٍ فَلَا يَصُومُ إِلَّا بِإِذْنِهِمْ

789. Na ka treguar Bishr b. Muadh el-Akad el-Basriu – atë e ka informuar Ejub b. Vakid el-Kufi,⁸⁷⁵ ai ka transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Aishja – që i Dërguari i Allahut

⁸⁷³ Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që ky hadith është daif, sepse në senedin e tij, gjendet raviu i dobët Ubejde b. Muttib el-Kufi. Ndërkaq, ky hadith me rrugë të tjera, nëpërmjet Muadhit është sahih. E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi.

⁸⁷⁴ E kanë shënuar edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunen*.

(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush shkon te ndokush si mysafir, të mos agjërojë agjërim vullnetar, përveç me lejen e tij.”⁸⁷⁶

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është munker. Nuk na është e njohur, që ndonjëri nga ravitë e besueshëm, e ka transmetuar këtë hadith nga Hisham b. Urve. Ka transmetuar Musa b. Davudi – nga Ebu Bekr el-Medini, ai nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, ndërsa ai nga Aishja, ajo nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), – ngjashëm me këtë. Ndërkaq, edhe ky hadith është i dobët, sepse Ebu Bekri, sipas vlerësimit të dijetarëve të hadithit, është ravi i dobët. Ai, Ebu Bekri el-Medini, i cili ka transmetuar nga Xhabir b. Abdullahu, quhej Fadl b. Mubeshshir dhe ai është më i vjetër dhe më i besueshëm sesa ky.”⁸⁷⁷

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مَعَاذٍ الْعَقَدِيُّ الْبَصْرِيُّ، حَدَّثَنَا أَيُّوبُ بْنُ وَاقِدٍ الْكُوفِيُّ، عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ نَزَلَ عَلَى قَوْمٍ فَلَا يَصُومُونَ تَطَوُّعًا إِلَّا بِإِذْنِهِمْ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ مُنْكَرٌ لَا نَعْرِفُ أَحَدًا مِنَ الثَّقَاتِ رَوَى هَذَا الْحَدِيثَ عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ . وَقَدْ رَوَى مُوسَى بْنُ دَاوُدَ عَنْ أَبِي بَكْرِ الْمَدِينِيِّ عَنْ هِشَامِ بْنِ عُرْوَةَ عَنْ أَبِيهِ عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَحْوًا مِنْ هَذَا . قَالَ أَبُو عِيسَى وَهَذَا حَدِيثٌ ضَعِيفٌ أَيْضًا . وَأَبُو بَكْرٍ ضَعِيفٌ عِنْدَ أَهْلِ الْحَدِيثِ وَأَبُو بَكْرٍ الْمَدِينِيُّ الَّذِي رَوَى عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ أَسْمُهُ الْفَضْلُ بْنُ مُبَشَّيرٍ وَهُوَ أَوْثَقُ مِنْ هَذَا وَأَقْدَمُ .

70. Mbi ‘itikafin⁸⁷⁸

باب مَا جَاءَ فِي الْإِيتَافِ

790. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma’meri, duke transmetuar nga Zuhriu, ai nga Seid b. Musejjebi, ai nga Ebu Hurejre dhe Urve - që Aishja ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), gjithnjë deri në vdekje, dhjetë ditët e fundit të ramazanit i kalonte në ‘itikaf.”⁸⁷⁹

Tirmidhiu, thotë: “Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Ubej b. Ka’bi, Ebu Lejli, Ebu Seidi, Enesi dhe Ibn Umeri. Hadithi i Ebu Hurejres dhe i Aishes është hasen-sahih.”⁸⁸⁰

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غِيلَانَ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ سَعِيدِ بْنِ الْمُسَيَّبِ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، وَعُرْوَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يَغْتَكِفُ الْعَشْرَ الْأَوَّلَ مِنْ رَمَضَانَ حَتَّى قَبِضَهُ اللَّهُ . قَالَ وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي بَكْرٍ وَابْنِ كَعْبٍ وَأَبِي لَيْلَى وَأَبِي سَعِيدٍ وَأَنْسِ وَأَيْنَ عُمَرُ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ أَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁸⁷⁵ Ejub b. Vakid el-Kufi Ebu Hasan, disa thonë Ebu Sehl, është metruk. I takon gjeneratës së tetë të ravijve të hadithit. Dhehebi, në veprën Mizanun – I’tidal, i paraqet vlerësimet, të cilat dijetarët e hadithit i kanë dhënë për të. Ahme b. Hanbeli, e konsideron si ravi i dobët, derisa Ibn Ne’imi thotë, se është i pabesueshëm.

⁸⁷⁶ Nuk është mirë, që si musafir të agjërohet agjërim vullnetar, sepse nikoqiri mund të ndihet i padisponuar. Agjërimi nafile, duke qenë musafir, pa lejen e nikoqirit, sipas mendimit të el-Mubarekfurit, është mekruh-tenzihen. Për agjërim të obliguar nuk nevojitet leja nga askush.

⁸⁷⁷ Të dy ravitë, me emrin Ebu Bekr el-Medini – dhe ai, që transmeton hadithe nga Hisham b. Urve, si dhe ai që transmeton nga Xhabiri, sipas mendimit të El-Mubarekfurit, janë të dobët, sepse siç thekson Tirmidhiu, ky i dyti është më i besueshëm sesa i pari.

⁸⁷⁸ I’tikaf, quhet qëndrimi në xhami, i personit të caktuar dhe në mënyrë të caktuar. Në rastin konkret, mendohet, mbi të qëndruarit e personit të caktuar në xhami dhjetë ditët e fundit të ramazanit, për shkak të ibadetit.

⁸⁷⁹ Nga ky hadith, mund të konkludohet, se të tërhequrit e dhjetë ditëve të fundit në xhami, për shkak të itikafit është sunnet i vërtetuar. I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) këtë e praktikonte vazhdimisht. Pas vdekjes së tij, atë e bënë bashkëshortet e tij. Nëse ndodhej në udhëtim, ai ramazanin që vinte e kompensonte atë dhe në vend të dhjetë ditëve ai në itikaf qëndronte njëzet ditë. Kjo shihet nga hadithi, të cilin e shënojnë Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Huzejme nga Ubej b. Ka’bi: “I Dërguari i Allahut rregullisht e praktikonte që dhjetë ditët e fundit të ramazanit t’i kalonte në itikaf. Në rast se gjatë një viti ka qenë në udhëtim dhe nuk ka mundur të qëndrojë në itikaf, vitin që vinte qëndronte njëzet ditë.”

⁸⁸⁰ Zuhriu, këtë hadith e ka transmetuar në dy mënyra: njërin me sened nga Ebu Hurejre, ndërsa të dytin nga Aishja. Të dy mënyrat i kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

791. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga Jahja b. Seidi, ai nga Amri – që Aishja, ka thënë: “Kur i Dërguari i Allahut qëndronte në ‘itikaf, ai e falte sabahun, pastaj hynte në dhomën ku kishte për të qëndruar në ‘itikaf.”⁸⁸¹

Ebu Isai, thotë: “Këtë hadith e ka transmetuar Jahja b. Seidi, nga Amre, ai nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), si mursel. Por edhe Maliku, sikurse edhe shumë të tjerë, atë nga Jahja b. Seidi e kanë transmetuar si mursel. Evzaiu e ka transmetuar atë, nga Sufjan eth-Thevriu, ai nga Jahja b. Seidi, ai nga Amri, ndërsa ai nga Aishja.”

Disa nga dijetarët veprojnë sipas këtij hadithi. Ata thonë: “Kur personi dëshiron të tërhiqet në ‘itikaf, ai së pari duhet ta falë sabahun, pastaj të hyjë aty ku dëshiron që të qëndroj.” Ky është qëndrimi i Ahmed b. Hanbelit dhe i Is’hak b. Ibrahimit. Disa dijetarë, thonë: “Kur personi dëshiron të tërhiqet në ‘itikaf, le të tërhiqet para perëndimit të diellit, ashtu që perëndimi i dielli atë ta zë në shtrat, në dhomën ku ka për të qëndruar në ‘itikaf.” Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe Malik b. Enesit.

حَدَّثَنَا هَنَّاذُ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ، عَنْ عُمَرَ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ إِذَا أَرَادَ أَنْ يَغْتَكِفَ صَلَّى الْفَجْرَ ثُمَّ دَخَلَ فِي مُغْتَكِفِهِ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رُوِيَ هَذَا الْحَدِيثُ عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ عَنْ عُمَرَ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ مُرْسَلًا . رَوَاهُ مَالِكٌ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ عَنْ عُمَرَ مُرْسَلًا . وَرَوَاهُ الْأَوْزَاعِيُّ وَسُفْيَانُ الثَّوْرِيُّ وَغَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ يَحْيَى بْنِ سَعِيدٍ عَنْ عُمَرَ عَنْ عَائِشَةَ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا الْحَدِيثِ عِنْدَ بَعْضِ أَهْلِ الْعِلْمِ يَقُولُونَ إِذَا أَرَادَ الرَّجُلُ أَنْ يَغْتَكِفَ صَلَّى الْفَجْرَ ثُمَّ دَخَلَ فِي مُغْتَكِفِهِ . وَهُوَ قَوْلُ أَحْمَدَ بْنِ حَنْبَلٍ وَإِسْحَاقَ بْنِ إِبْرَاهِيمَ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِذَا أَرَادَ أَنْ يَغْتَكِفَ فَلْيَغْتَبِ لَهُ الشَّمْسُ مِنَ اللَّيْلَةِ الَّتِي يُرِيدُ أَنْ يَغْتَكِفَ فِيهَا مِنَ الْغَدِ وَقَدْ قَعَدَ فِي مُغْتَكِفِهِ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَمَالِكِ بْنِ أَنَسٍ .

71. Mbi natën e Lejletul-kadrit

باب مَا جَاءَ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ

792. Na ka treguar Harun b. Is’hak el-Hemdani – atë e ka informuar Abde b. Sulejmani, duke transmetuar nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), dhjetë ditët e fundit të ramazanit tërhiqej (në ‘itikaf). Ai thotë: ‘Në dhjetë ditët e fundit të ramazanit kërkon natën e Lejletul-kadrit.”

Ebu Isai, thotë: Mbi këtë temë, janë transmetuar hadithe edhe nga Umeri, Ubej b. Ka’bi, Xhabir b. Semure, Xhabir b. Abdullahu, Ibn Umeri, Feletan b. Asimi, Enesi, Ebu Seidi, Abdullah b. Unejsi, Ebu Bekri, Ibn Abbasi, Bilali dhe Ubad b. Samiti. Hadithi i Aishes është hasen-sahih.⁸⁸² Fjala e saj *tërhiqej* e ka kuptimin: tërhiqej në ‘itikaf. Në shumicën e transmetimeve qëndron, që i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kërkoni atë në dhjetë ditët e ramazanit, në çdo natë tek.” Është transmetuar nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), që nata e Lejletul-kadrit do të mund të ishte në natën e njëzet e një, natën e njëzet e tre, natën e njëzet e pestë, natën e njëzet e shtatë, natën e njëzet e nëntë dhe në natën e fundit të ramazanit.”

Shafi'u, thotë: “Kjo, sipas mendimit tim, do të mund të kuptohet – e Allahu më së miri e di – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përgjigjet ashtu si pyetej. Atij i thuhej: “‘A kemi për ta kërkuar atë në këtë natë?’ – ai thoshte: ‘Kërkoni atë edhe në atë natë.’ Sipas mendimit

⁸⁸¹ Ahmed b. Hanbeli dhe Is’hak b. Ibrahim, në bazë të këtij hadithi, konsiderojnë, që duhet filluar që nga mëngjesi i ditës së njëzet e një. Shumica e dijetarëve, konsiderojnë, që me itikaf duhet filluar para akshamit në natën e njëzet e një të ramazanit. Sipas mendimit të tyre, nëse do të fillohej natën e njëzet e një të ramazanit, në itikaf nuk do të qëndrohej dhjetë ditë të plota.

⁸⁸² E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, në *Sahihë*.

tim, thotë Shafi'u – 'transmetimet më të fuqishme janë ato transmetime, në të cilat përmendet, që ajo natë do të mund të ishte natën e njëzet e një të ramazanit.'"

Ebu Isai, thotë: "Është transmetuar, që Ubejj b. Ka'bi, betohej që ajo është në natën e njëzet e shtatë. Ai thotë: 'Na ka informuar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), mbi shenjat e saja, andaj i llogaritëm dhe i mbajtëm në mend.' Ndërsa, është transmetuar, që Ebu Kilabi, ka thënë: 'Lejletul-kadri ndërrohet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit.' Mbi atë na ka informuar Abd b. Humejdi, atë e ka informuar Abdurrezaku, duke transmetuar nga Ma'meri, ai nga Ejubi, e ai nga Ebu Kilabe."

حَدَّثَنَا هَارُونُ بْنُ إِسْحَاقَ الْهَمْدَانِيُّ، حَدَّثَنَا عَبْدَةُ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ هِشَامِ بْنِ غَزْوَةَ، عَنْ أَبِيهِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُجَاوِرُ فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ مِنْ رَمَضَانَ وَيَقُولُ " تَحَرَّوْا لَيْلَةَ الْقَدْرِ فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ مِنْ رَمَضَانَ " . وَفِي الْبَابِ عَنْ عُمَرَ وَأَبِي وَجَابِرِ بْنِ سَمُرَةَ وَجَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ وَأَبْنِ عُمَرَ وَالْقَلْبَانِ بْنِ عَاصِمٍ وَأَبِي سَعِيدٍ وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ أَنَسٍ وَأَبِي بَكْرَةَ وَأَبْنِ عَبَّاسٍ وَبِلَالٍ وَغِبَادَةَ بْنِ الصَّامِتِ . قَالَ أَبُو عِيسَى حَدِيثُ عَائِشَةَ حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَقَوْلُهَا يُجَاوِرُ يَعْنِي يَغْتَكِفُ . وَأَكْثَرُ الرِّوَايَاتِ عَنِ النَّبِيِّ ﷺ أَنَّهُ قَالَ " التَّمَسُّوْهَا فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ فِي كُلِّ وَتَرٍ " . وَرَوَى عَنِ النَّبِيِّ ﷺ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ أَنَّهَا لَيْلَةٌ إِحْدَى وَعِشْرِينَ وَلَيْلَةٌ ثَلَاثٌ وَعِشْرِينَ وَخَمْسٌ وَعِشْرِينَ وَسِتٌّ وَعِشْرِينَ وَتِسْعٌ وَعِشْرِينَ وَأَخْرَجَ لَيْلَةَ مِنْ رَمَضَانَ " . قَالَ أَبُو عِيسَى قَالَ الشَّافِعِيُّ كَانَ هَذَا عِنْدِي وَاللَّهِ أَعْلَمُ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُجِيبُ عَلَى نَحْوِ مَا يُسْأَلُ عَنْهُ يَقَالُ لَهُ نَلْتَمِسُهَا فِي لَيْلَةٍ كَذَا فَيَقُولُ التَّمَسُّوْهَا فِي لَيْلَةٍ كَذَا . قَالَ الشَّافِعِيُّ وَأَقْوَى الرِّوَايَاتِ عِنْدِي فِيهَا لَيْلَةٌ إِحْدَى وَعِشْرِينَ . قَالَ أَبُو عِيسَى وَقَدْ رَوَى عَنْ أَبِي بِنِ كَعْبٍ أَنَّهُ كَانَ يَخْلِفُ أَنَّهَا لَيْلَةُ سَبْعٍ وَعِشْرِينَ . وَيَقُولُ أَخْبَرَنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ بِعَلَامَتِهَا فَعَدَدْنَا وَحَفِظْنَا . وَرَوَى عَنْ أَبِي قِلَابَةَ أَنَّهُ قَالَ لَيْلَةُ الْقَدْرِ تَنْتَقِلُ فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ . حَدَّثَنَا بِذَلِكَ عَبْدُ بْنُ حُمَيْدٍ أَخْبَرَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ عَنْ مَعْمَرٍ عَنْ أَبِي يُوْبَ عَنْ أَبِي قِلَابَةَ بِهَذَا .

793. Na ka treguar Vasil b. Abdul-A'la el-Kufi – atë e ka informuar Ebu Bekër b. Ajjashi, duke transmetuar nga Asimi – që Ebu Dherre ka thënë: "I thash Ubej b. Ka'bit: 'Nga e di ti, o Ebu Mundhir, se ajo është nata njëzet e shtatë?' 'Na ka informuar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), që ajo natë është me agimin e të cilit lindë dielli pa shkëlqim. Pastaj ne e llogaritëm dhe e mbajtëm në mend. Pasha Allahun, edhe Ibn Mes'udi e dinte që ajo është në ramazan dhe që është nata e njëzet e shtatë, por nuk donte të ju lajmëronte e që të bëheni përtacë." Ebu Isai thotë: "Ky hadith është hasen-sahih."⁸⁸³

حَدَّثَنَا وَاصِلُ بْنُ عَبْدِ الْأَعْلَى الْكُوفِيُّ، حَدَّثَنَا أَبُو بَكْرِ بْنُ عَيَّاشٍ، عَنْ عَاصِمٍ، عَنْ زَرٍّ، قَالَ قُلْتُ لِأَبِي بِنِ كَعْبٍ أَنَّى عَلِمْتَ أَنَّ الْمُنْدِرَ أَنَّهَا لَيْلَةُ سَبْعٍ وَعِشْرِينَ قَالَ بَلَى أَخْبَرَنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " أَنَّهَا لَيْلَةٌ صَبِيحَتُهَا تَطْلُعُ الشَّمْسُ لَيْسَ لَهَا شُعَاعٌ " . فَعَدَدْنَا وَحَفِظْنَا وَاللَّهِ لَقَدْ عَلِمَ ابْنُ مَسْعُودٍ أَنَّهَا فِي رَمَضَانَ وَأَنَّهَا لَيْلَةُ سَبْعٍ وَعِشْرِينَ وَلَكِنْ كَرِهَ أَنْ يُخْبِرَكُمْ فَتَنَكَّلُوا . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

794. Na ka treguar Humejd b. Mesade – atë e ka informuar Jezid b. Zureji – që Ujejne b. Abdurrahmani, ka thënë: "Më ka informuar babai im: 'Është përmendur nata e Lejletul-kadrit tek Ebu Bekri, ai ka thënë: 'Unë nuk kam për ta kërkuar atë në bazë të asaj çfarë kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), përveç në dhjetë ditët e fundit të (ramazanit), sepse e kam dëgjuar atë, kur ka thënë: 'Kërkoni atë në natën e njëzet e një, ose njëzet e tretë, ose njëzet e pestë, ose njëzet e shtatë, ose natën e fundit të (ramazanit).'" Ai, thotë: "Ebu Bekri, njëzet ditët e para të ramazanit falej njësoj, si çdo ditë gjatë vitit. Por kur hynin dhjetë ditët e fundit të ramazanit, ai e forconte ibadetin." Ebu Isai thotë: "Ky hadith është hasen-sahih."

حَدَّثَنَا حُمَيْدُ بْنُ مَسْعَدَةَ، حَدَّثَنَا يَزِيدُ بْنُ زُرَيْعٍ، حَدَّثَنَا غَيْبَةُ بْنُ عَبْدِ الرَّحْمَنِ، قَالَ حَدَّثَنِي أَبِي قَالَ، ذُكِرَتْ لَيْلَةُ الْقَدْرِ عِنْدَ أَبِي بَكْرَةَ فَقَالَ مَا أَنَا بِمَلْتَمِسِهَا، لِشَيْءٍ سَمِعْتُهُ مِنْ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ إِلَّا فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ فَإِنِّي سَمِعْتُهُ يَقُولُ " التَّمَسُّوْهَا فِي تِسْعٍ يَبْقَيْنَ أَوْ فِي سَبْعٍ يَبْقَيْنَ أَوْ فِي خَمْسٍ يَبْقَيْنَ أَوْ فِي ثَلَاثٍ أَوْ آخِرَ لَيْلَةٍ " . قَالَ وَكَانَ أَبُو بَكْرَةَ يُصَلِّي فِي الْعِشْرِينَ مِنْ رَمَضَانَ كَصَلَاتِهِ فِي سَائِرِ السَّنَةِ فَإِذَا دَخَلَ الْعَشْرَ اجْتَهَدَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁸⁸³ E ka shënuar, Muslimi në *Sahih*.

72. Edhe një kapitull mbi të njëjtën temë

باب مِنْهُ

795. Na ka treguar Mahmud b. Gajlani – atë e ka informuar Vekiu, atë Sufjani, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Hubejr b. Jerimi – që Aliu, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), (për shkak të namazit vullnetar) i zgjonte bashkëshortet e veta në dhjetë ditët e fundit të ramazanit.”⁸⁸⁴ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ غَيْلَانَ، حَدَّثَنَا وَكِيعٌ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ هُبَيْرَةَ بْنِ يَرِيمَ، عَنْ عَلِيٍّ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ كَانَ يُوقِظُ أَهْلَهُ فِي الْعَشْرِ الْآخِرِ مِنْ رَمَضَانَ. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ.

796. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdurrahman b. Zijadi, duke transmetuar nga Hasan b. Ubejdullahu, ai nga Ibrahim, ai nga Esvedi – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në dhjetë netët e fundit të ramazanit e shtonte ibadetin, në krahasim me netët e tjera.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih-garib.”⁸⁸⁵

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الْوَاحِدِ بْنُ زِيَادٍ، عَنِ الْحَسَنِ بْنِ عُثَيْدٍ، عَنْ إِبْرَاهِيمَ، عَنِ الْأَسْوَدِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ يَجْتَهِدُ فِي الْعَشْرِ الْآخِرِ مَا لَا يَجْتَهِدُ فِي غَيْرِهَا. قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ.

73. Mbi agjërimin gjatë dimrit

باب مَا جَاءَ فِي الصَّوْمِ فِي الشِّتَاءِ

797. Na ka treguar Muhammed b. Beshshari – atë e ka informuar Jahja b. Seidi, atë Sufjani, duke transmetuar nga Ebu Is'haku, ai nga Numejr b. Aribi,⁸⁸⁶ ai nga Amir b. Mes'udi – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Agjëro, se dimrit lehtë fitohet.”⁸⁸⁷

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është mursal,⁸⁸⁸ sepse Amir b. Mes'udi, nuk e ka takuar të Dërguarin (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai është babai i Ibrahim b. Amir b. Kurejshit, nga i cili Shu'be dhe Eth-Thevriu, i kanë transmetuar (hadithet).”

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ سَعِيدٍ، حَدَّثَنَا سُفْيَانُ، عَنْ أَبِي إِسْحَاقَ، عَنْ ثُمَيْرِ بْنِ عَرِيبٍ، عَنْ عَامِرِ بْنِ مَسْعُودٍ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ " الْغَنِيمَةُ الْبَارِدَةُ الصَّوْمِ فِي الشِّتَاءِ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ مُرْسَلٌ . عَامِرُ بْنُ مَسْعُودٍ لَمْ يُدْرِكِ النَّبِيَّ ﷺ وَهُوَ وَالِدُ إِبْرَاهِيمَ بْنِ عَامِرٍ الْقُرَشِيِّ الَّذِي رَوَى عَنْهُ شُعْبَةُ وَالثَّوْرِيُّ .

74. Mbi ata, që mezi e përballojnë agjërimin

باب مَا جَاءَ فِي (وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ)

798. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Bekër b. Mudari, ai ka transmetuar nga Amër b. Harithi, ai nga Bukejri, ai nga Jezidi, i mbrojturi i Seleme b. Ekves – që Seleme b. Ekve, ka thënë: “Pasi që është shpallur ajeti: ...*Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim*

⁸⁸⁴ Tirmidhiu, shënon nga Ummu Seleme: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e linte askënd, që ishte në gjendje të falej, në dhjetë ditët e fundit të ramazanit, e që të mos e zgjonte atë.”

⁸⁸⁵ E shënojnë edhe Ahmed b. Hanbeli, në *Musned* edhe Muslimi në *Sahih*.

⁸⁸⁶ Numejr b. Arib, siç thotë Ibn Haxheri në *Tekrib*, është ravi i kënaqshëm. I takonte gjeneratës së tretë.

⁸⁸⁷ Agjërimi gjatë dimrit, konsiderohet fitim i lehtë, sepse personi, kur agjëron dimrit, nuk ndjenë kurrfarë vështirësie, siç e ndjenë atë verës, ndërsa e ka shpërblimin e njëjtë, sikurse kur agjëron, ditëve të verës.

⁸⁸⁸ E ka shënuar, Ahmed b. Hanbeli, në *Musned*.

nga një të varfër për çdo ditë agjërimi... ai që donte e prishte agjërimin dhe e ushqente nga një të varfër – gjithnjë, derisa nuk është shpallur ajeti i cili pason pas tij, i cili e derogoi atë.”⁸⁸⁹

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih-garib.”⁸⁹⁰ Jezidi është i biri i Ebu Ubejdes, i të mbrojturit të Seleme b. Ekves.”⁸⁹¹

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا بَكْرُ بْنُ مُضَرَ، عَنْ عَمْرِو بْنِ الْحَارِثِ، عَنْ بُكَيْرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ الْأَسْحَجِ، عَنْ يَزِيدَ، مَوْلَى سَلَمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ عَنْ سَلَمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ، قَالَ لَمَّا نَزَلَتْ: (وَعَلَى الَّذِينَ يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ) كَانَ مَنْ أَرَادَ مِنَّا أَنْ يُفْطِرَ وَيَقْتَدِيَ حَتَّى نَزَلَتِ الْآيَةُ الَّتِي بَعْدَهَا فَتَسَخَّرَهَا. قَالَ أَبُو عَيْسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ. وَيَزِيدُ هُوَ ابْنُ أَبِي عُبَيْدٍ مَوْلَى سَلَمَةَ بْنِ الْأَكْوَعِ.

75. Mbi atë i cili (gjatë ramazanit) e prish agjërimin para se të nisej në udhëtim

باب مَا جَاءَ فِيْمَنْ أَكَلَ ثُمَّ خَرَجَ يُرِيدُ سَفَرًا

799. Na ka treguar Kutejbe – atë e ka informuar Abdullah b. Xha’feri, duke transmetuar nga Zejd b. Esleme, ai nga Muhammed b. Munkediri – që Muhammed b. Ka’bi, ka thënë: “Erdha tek Enes b. Maliku, gjatë kohës së ramazanit, kur ishte duke u përgatitur për udhëtim. E shaluara e tij ishte përgatitur, ndërsa ai i kishte veshur rrobat për udhëtim. Kërkoj ushqim dhe hëngër. Unë i thash: ‘A është kjo sunnet?’ ‘Po.’ – tha ai. ‘Kjo është sunnet.’ – pastaj hipi mbi të shaluarën.”⁸⁹²

حَدَّثَنَا قُتَيْبَةُ، حَدَّثَنَا عَبْدُ اللَّهِ بْنُ جَعْفَرٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ أَسْلَمَ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ كَعْبٍ، أَنَّهُ قَالَ أَتَيْتُ أَنَسَ بْنَ مَالِكٍ فِي رَمَضَانَ وَهُوَ يُرِيدُ سَفَرًا وَقَدْ رَجُلْتُ لَهُ رَاحِلَتَهُ وَلَيْسَ ثِيَابَ السَّفَرِ فَدَعَا بِطَعَامٍ فَأَكَلَ فَقُلْتُ لَهُ سِنَّةٌ قَالَ سِنَّةٌ. ثُمَّ رَكِبَ.

800. Na ka treguar Muhammed b. Ismaili - atë e ka informuar Seid b. Ebu Merjem, atë Muhammed b. Xha’feri, atë Zejd b. Esleme, atë Muhammed b. Munkediri – që Muhammed b. Ka’bi, ka thënë: “Erdha tek Enes b. Maliku gjatë kohës së ramazanit (...)” – pastaj e përmendi hadithin identik me të mëparshmin.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen. Muhammed b. Xha’fer b. Ebu Kethir Medini, është transmetues i besueshëm. Ai është vëllai i Ismail b. Xha’ferit. Ndërsa, Abdullah b. Xha’fer b. Nexhih, është babai i Ali b. Medinit. Jahja b. Meini, atë e konsideron si ravi të dobët. Sipas këtij hadithi, kanë vepruar disa nga dijetarët. Ata thonë: “Udhëtari mund të hajë në shtëpi para se të niset (në udhëtim), ndërsa nuk mund t’i shkurtojë namazet, para se ta lëshojë qytetin ose fshatin.” Ky është qëndrimi i Is’hak b. Ibrahim el-Handhalit.”

⁸⁸⁹ Shumica e dijetarëve islamë, konsiderojnë, që pjesa e ajetit - “...E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ...” 184, e sures El-Bekare, është deroguar me ajetin 185 – “(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.” të sures El-Bekare. Ibn Abbasi konsideron, se ky ajet nuk është i deroguar, por ende vlen dhe përkon ekskluzivisht me të vjetrit, të dobëtit dhe personat, të cilët nuk kanë shpresë që kanë për t’u shëruar dhe që gjendja e tyre ka për tu përmirësuar. Ata, për çdo ditë agjërimi, mund ta japin shpagimin.

⁸⁹⁰ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi, Ebu Davudi dhe Nesaiu.

⁸⁹¹ Jezid b. Ebu Ubejdi, i mbrojturi i Seleme b. Ekves, është transmetues i besueshëm. I takonte gjeneratës së katër të ravive.

⁸⁹² Ky hadith dhe ai pas tij, është argument, që personi i cili e ka ndërmend që të niset për udhëtim, e ka të lejuar të hajë para se të niset. Dhe jo vetëm që e ka të lejuar, por e ka sunnet që të veprojë ashtu – siç thekson Enes b. Maliku.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ، حَدَّثَنَا سَعِيدُ بْنُ أَبِي مَرْيَمَ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ، قَالَ حَدَّثَنِي زَيْدُ بْنُ أَسْلَمَ، قَالَ حَدَّثَنِي مُحَمَّدُ بْنُ الْمُنْكَدِرِ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ كَعْبٍ، قَالَ أَتَيْتُ أَنَسَ بْنَ مَالِكٍ فِي رَمَضَانَ فَذَكَرَ نَحْوَهُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ . وَمُحَمَّدُ بْنُ جَعْفَرٍ هُوَ ابْنُ أَبِي كَثِيرٍ هُوَ مَدِينِيٌّ ثِقَةٌ وَهُوَ أَخُو إِسْمَاعِيلَ بْنِ جَعْفَرٍ . وَعَبْدُ اللَّهِ بْنُ جَعْفَرٍ هُوَ ابْنُ نَجِيحٍ وَالِدُ عَلِيِّ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْمَدِينِيِّ وَكَانَ يَحْيَى بْنُ مَعِينٍ يُضَعِّفُهُ . وَقَدْ ذَهَبَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِلَى هَذَا الْحَدِيثِ وَقَالُوا لِلْمُسَافِرِ أَنْ يُفْطَرَ فِي بَيْتِهِ قَبْلَ أَنْ يَخْرُجَ وَلَيْسَ لَهُ أَنْ يَقْصُرَ الصَّلَاةَ حَتَّى يَخْرُجَ مِنْ جِدَارِ الْمَدِينَةِ أَوْ الْقَرْيَةِ . وَهُوَ قَوْلُ إِسْحَاقَ بْنِ إِبْرَاهِيمَ الْحَنْظَلِيِّ .

76. Mbi dhuratën për agjëruesin

باب مَا جَاءَ فِي تَخْفَةِ الصَّائِمِ

801. Na ka treguar Ahmed b. Meni – atë e ka informuar Ebu Muaviu, ai ka transmetuar nga Sa'd b. Tarifi,⁸⁹³ ai nga Umejr b. Me'muni,⁸⁹⁴ ai nga Hasan b. Aliu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Dhurata e veçantë për agjëruesin është vaji aromatizuar – *el-duhn* dhe temjanicë – *el-mixhmer*.”⁸⁹⁵

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është garib.”⁸⁹⁶ Senedi i tij nuk është aq i fuqishëm, na është i njohur vetëm nëpërmjet Sa'd b. Tarifi. Sa'd b. Tarifi është ravi i dobët, ndërsa edhe Umejr b. Me'muni gjithashtu.”

حَدَّثَنَا أَحْمَدُ بْنُ مَنِيعٍ، حَدَّثَنَا أَبُو مُعَاوِيَةَ، عَنْ سَعْدِ بْنِ طَرِيفٍ، عَنْ عُمَيْرِ بْنِ مَأْمُونٍ، عَنْ الْحَسَنِ بْنِ عَلِيٍّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ " تَخْفَةُ الصَّائِمِ الدُّهْنُ وَالْمِجْمَرُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ غَرِيبٌ لَيْسَ إِسْنَادُهُ بِذَلِكَ لَا نَعْرِفُهُ إِلَّا مِنْ حَدِيثِ سَعْدِ بْنِ طَرِيفٍ . وَسَعْدُ بْنُ طَرِيفٍ يُضَعَّفُ وَيَقَالُ عُمَيْرُ بْنُ مَأْمُونٍ أَيْضًا .

77. Mbi ardhjen e Kurban bajramit dhe bajramit të Ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي الْفِطْرِ وَالْأَضْحَى مَتَى يَكُونُ

802. Na ka treguar Jahja b. Musa – atë e ka informuar Jahja b. Jemani, ai ka transmetuar nga Ma'meri, ai nga Muhammed b. Munkediri, ai nga Aishja – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Bajrami i ramazanit është në atë ditë kur njerëzit përfundojnë me agjërimin e (ramazanit), ndërsa Kurban bajrami është atëherë kur njerëzit fillojnë të therin kurbane.”⁸⁹⁷ Ebu Isai, thotë: “E kam pyetur Muhammedin (Buhariun): ‘A ka dëgjuar Muhammed b. Munkediri hadithe nga Aishja?’ – ‘Po.’ – tha ai – sepse ai në rrëfimet e veta, thotë: ‘Kam dëgjuar nga Aishja.’” Ky hadith, në këtë formë, është hasen-garib-sahih.”

حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ مُوسَى، حَدَّثَنَا يَحْيَى بْنُ الْيَمَانِ، عَنْ مَعْمَرٍ، عَنْ مُحَمَّدِ بْنِ الْمُنْكَدِرِ، عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " الْفِطْرُ يَوْمَ يُفْطَرُ النَّاسُ وَالْأَضْحَى يَوْمَ يُضْحَى النَّاسُ " . قَالَ أَبُو عِيسَى سَأَلْتُ مُحَمَّدًا قُلْتُ لَهُ مُحَمَّدُ بْنُ الْمُنْكَدِرِ سَمِعَ مِنْ عَائِشَةَ قَالَ نَعَمْ يَقُولُ فِي حَدِيثِهِ سَمِعْتُ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ غَرِيبٌ صَحِيحٌ مِنْ هَذَا الْوَجْهِ .

⁸⁹³ Sa'd b. Tarif el-Handhale el-Kufi, është ravi, të cilin dijetarët e kanë refuzuar, për shkak të dyshimit të bazuar, që ka qenë i prirë për gënjeshtëri. Ibn Hibban, atë e akuzonte që imagjinonte hadithet. Ai ishte rafidi.

⁸⁹⁴ Umejr b. Me'muni, është ravi kënaqshëm. I takonte gjeneratës së katërt.

⁸⁹⁵ Ibn Esiri, në veprën *En-Nihaje*, konsideron, që rrëshira aromatike e ndezur në mangall, është e këndshme për agjëruesin, sepse ashtu më lehtë e përballon urinë dhe etjen.

⁸⁹⁶ Sipas vlerësimit të shumë dijetarëve, ky hadith është i dobët, sepse në senedin e tij, gjendet ravi i dobët Sa'd b. Tarifi.

⁸⁹⁷ Tirmidhiu thotë, që disa njerëz, këtë hadith e kanë sqaruar ashtu, duke thënë, që fillimi i agjëritimit të ramazanit dhe i bajramit duhet praktikuar me xhematin.

78. Mbi atë që del nga ‘itikafi

باب مَا جَاءَ فِي الْإِعْتِكَافِ إِذَا خَرَجَ مِنْهُ

803. Na ka treguar Muhammed b. Beshari – atë e ka informuar Ibn Ebu Adij, atë e ka informuar Humejd et-Tavili – që Enes b. Maliku, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në ‘itikaf qëndronte dhjetë ditë e fundit të ramazanit. Pastaj, një vit nuk qëndronte, pastaj vitin që pasonte qëndronte njëzet ditë.”⁸⁹⁸ Ebu Isai, thotë: “Ky hadith i Enesit është hasen-garib-sahih.”⁸⁹⁹

Dijetarët, kanë divergjenca në pikëpamje të personit, i cili e ndërprente ‘itikafin para se ta kalojë numrin e ditëve që i kishte bërë nijet. Disa thonë: “Nëse e ndërprente ‘itikafin, ai është i obliguar që në tërësi ta kompensojë atë.” Gjatë kësaj, ata mbështeten në transmetimin, në të cilin qëndron, se i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), me një rast, kishte dalë nga ‘itikafi, mandej, në muajin sheval, në itikaf kishte qëndruar dhjetë ditë. Këtë qëndrim e mbështetë Maliku. Disa thonë: “Nëse nuk ka të bëjë me ‘itikafin e premtuar, ose me ndonjë ‘itikaf tjetër, të cilin e ka marr si obligim, por është fjala mbi ‘itikafin vullnetar – atëherë nuk është i obliguar që ta kompensojë atë, përveç nëse atë e dëshiron. Përndryshe, nuk është i obliguar.” Ky është qëndrimi i Shafiut. Ai thotë: “Çdo punë vullnetare, nëse e fillon dhe e ndërprente, nuk je i obliguar ta kompensosh, përveç haxhit dhe umres.” Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Ebu Hurejre.

حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ بَشَّارٍ، حَدَّثَنَا ابْنُ أَبِي عَدِيٍّ، قَالَ أَنْبَأَنَا حُمَيْدُ الطَّوِيلُ، عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، قَالَ كَانَ النَّبِيُّ ﷺ يَعْتَكِفُ فِي الْعَشْرِ الْأَوَّلِ مِنْ رَمَضَانَ فَلَمْ يَعْتَكِفْ عَامًا فَلَمَّا كَانَ فِي الْعَامِ الْمُقْبِلِ اعْتَكَفَ عَشْرِينَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ غَرِيبٌ مِنْ حَدِيثِ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي الْمُعْتَكِفِ إِذَا قَطَعَ اعْتِكَافَهُ قِيلَ أَنْ يُتِمَّهُ عَلَى مَا نَوَى فَقَالَ بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ إِذَا نَقَضَ اعْتِكَافَهُ وَجِبَ عَلَيْهِ الْقَضَاءُ . وَاحْتَجُّوا بِالْحَدِيثِ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ خَرَجَ مِنْ اعْتِكَافِهِ فَأَعْتَكَفَ عَشْرًا مِنْ شَوَالٍ . وَهُوَ قَوْلُ مَالِكٍ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ إِنَّ لَمْ يَكُنْ عَلَيْهِ نَذْرٌ اعْتِكَافٍ أَوْ شَيْءٍ أُوجِبَهُ عَلَى نَفْسِهِ وَكَانَ مُتَطَوُّعًا فَخَرَجَ فَلَيْسَ عَلَيْهِ أَنْ يَقْضِيَ إِلَّا أَنْ يُحِبَّ ذَلِكَ اخْتِيَارًا مِنْهُ وَلَا يُجِبُ ذَلِكَ عَلَيْهِ . وَهُوَ قَوْلُ الشَّافِعِيِّ . قَالَ الشَّافِعِيُّ كُلُّ عَمَلٍ لَكَ أَنْ لَا تَدْخُلَ فِيهِ فَإِذَا دَخَلْتَ فِيهِ فَخَرَجْتَ مِنْهُ فَلَيْسَ عَلَيْكَ أَنْ تَقْضِيَ إِلَّا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ . وَفِي الْبَابِ عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ .

79. A mund të dal personi nga ‘itikafi për shkak të nevojave personale

باب الْمُعْتَكِفُ يُخْرَجُ لِحَاجَتِهِ أَمْ لَا

804. Na ka treguar Ebu Mus’ab el-Medini, ai duke lexuar ka transmetuar⁹⁰⁰ nga Maliku dhe Enesi, ai nga Ibn Shihabi, ai nga Urve dhe Amri – që Aishja, ka thënë: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), derisa ishte në ‘itikaf, ma afronte kokën dhe unë e krihja. Në shtëpi nuk hynte përveç për shkak të ndonjë nevojë që ka njeriu.”⁹⁰¹

⁸⁹⁸ E shënojnë, Nesaiu dhe Ebu Davudi në *Sunene*, e Ibn Hibbani në *Sahih*, nga Ubej b. Ka’bi: “I Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në itikaf ka kaluar dhjetë ditë e fundit të ramazanit. Në njërin vit, gjatë ramazanit ka qenë në udhëtim, ashtu që ramazanin tjetër ka qëndruar 20 ditë në itikaf.”

⁸⁹⁹ E shënojnë, Nesaiu dhe Ebu Davudi. Ibn Hibbani e konsideron të besueshëm.

⁹⁰⁰ Ekzistojnë shumë mënyra të marrjes së hadithit. Njëra nga to është që nxënësi ta lexoj hadithin nga përmbledhjet e mësuesve, e që ai ta dëgjojë.

⁹⁰¹ Nga ky hadith, arrihet konkludimi, se personi, derisa është në itikaf, analogë me të krehurit është e lejuar edhe larja, pastrimi, rregullimi, parfumimi, të qethurit dhe të tjera. Shumica e dijetarëve, konsiderojnë, se në itikaf, i ka të lejuara të gjitha ato që nuk janë mekruh të bëhen në xhami. Është e lejuar edhe dukja e ndonjë pjese të caktuar të trupit, sikurse që e ka të lejuar largimin nga itikafi, për shkak të kryerjes së nevojave fiziologjike.

Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-shih.⁹⁰² Kështu e kanë transmetuar shumica nga Malik b. Enesi, ai nga Ibn Shihabi, ai nga Urve dhe Amri, e ata nga Aishja, ndërsa e drejtë është: ‘Nga Urve dhe Amri, e ata nga Aishja.’ Kështu ka transmetuar Lejth b. Sadi nga Shihabi e ai nga Urve dhe Amri, ndërsa ata nga Aishja.”

حَدَّثَنَا أَبُو مُصْعَبٍ الْمَدَنِيُّ، قِرَاءَةً عَنْ مَالِكِ بْنِ أَنَسٍ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ عُرْوَةَ، وَعُمَرَةَ، عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّهَا قَالَتْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا اغْتَسَفَ أَذْنَى إِلَى رَأْسِهِ فَأَرْجَلُهُ وَكَانَ لَا يَدْخُلُ النَّبِيْتُ إِلَّا لِحَاجَةِ الْإِنْسَانِ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . هَكَذَا رَوَاهُ غَيْرُ وَاحِدٍ عَنْ مَالِكٍ عَنْ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ عُرْوَةَ وَعُمَرَةَ عَنْ عَائِشَةَ . وَرَوَاهُ بَعْضُهُمْ عَنْ مَالِكٍ عَنْ ابْنِ شِهَابٍ عَنْ عُرْوَةَ عَنْ عُمَرَةَ عَنْ عَائِشَةَ . وَالصَّحِيحُ عَنْ عُرْوَةَ وَعُمَرَةَ عَنْ عَائِشَةَ .

805.Mbi atë na ka treguar Kutejbe, duke transmetuar nga Lejthi. Sipas këtij hadithi, veprojnë dijetarët. Ata konsiderojnë, që personi, nuk do të duhej të dal nga ‘itikafi, përveq për shkak të ndonjë nevojë që ka njeriu. Ata janë të pajtimit, që personi mund të dalë për shkak të nevojave të tij fiziologjike. Por, kanë divergjenca në atë se a mundet personi të dal për ta vizituar të sëmurin, apo të marr pjesë në xhuma, ose në xhenaze. Disa dijetarë, nga gjenerata e as’habëve dhe të tjerët, konsiderojnë, që ai mundet, nëse atë e ka kushtëzuar gjatë njetit të bërë, të dal për ta vizituar të sëmurin, për ta përcjellë xhenazen ose për të marr pjesë në namazin e xhumasë.

Ky është qëndrimi i Sufjan eth-Thevriut dhe i Ibn Mubarekut. Disa thonë, që ai person (derisa është në ‘itikaf) asnjëherë nga ato nuk duhej t’i bënte. Ata gjithashtu, konsiderojnë, që në vendet ku falet xhumaja, personi ‘itikafin do të duhej ta kryente në xhami, në të cilën falet xhumaja, sepse derisa është në ‘itikaf, ai nuk do të mund të dilte për ta falur namazin e xhumasë, por nuk do të kishte guxim as ta linte atë pa e falur. Prandaj, ata thonë, ‘itikafin duhet ta kryej në xhaminë, aty ku falet xhumaja, që të mos mund të dilte, përveç për nevojat fiziologjike, sepse sipas mendimit të tyre, çdo dalje nga ‘itikafi, përveç për nevojat fiziologjike, e prish ‘itikafin. Ky është mendimi i Malikut dhe i Shafiut. Ahmedi, thotë: “Në pajtim me hadithin e Aishes, personi (derisa është në ‘itikaf) nuk ka për ta vizituar të sëmurin, e as nuk ka për ta përcjell xhenazen.” Is’haku, thotë: “Nëse atë e ka kushtëzuar në njet, ai mund të dalë për ta përcjell xhenazen dhe për ta vizituar të sëmurin.”

حَدَّثَنَا بِذَلِكَ، قُتَيْبَةُ حَدَّثَنَا اللَّيْثُ بْنُ سَعْدٍ، عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، عَنْ عُرْوَةَ، وَعُمَرَةَ، عَنْ عَائِشَةَ . وَالْعَمَلُ عَلَى هَذَا عِنْدَ أَهْلِ الْعِلْمِ إِذَا اغْتَسَفَ الرَّجُلُ أَنْ لَا يَخْرُجَ مِنْ اغْتِكَافِهِ إِلَّا لِحَاجَةِ الْإِنْسَانِ وَاجْتَمَعُوا عَلَى هَذَا أَنَّهُ يَخْرُجُ لِقَضَاءِ حَاجَتِهِ لِلغَايَةِ وَالنَّوْلِ . ثُمَّ اخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي عِيَادَةِ الْمَرِيضِ وَشُهُودِ الْجُمُعَةِ وَالْجَنَازَةِ لِلْمُعْتَكِفِ فَرَأَى بَعْضُ أَهْلِ الْعِلْمِ مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ وَغَيْرِهِمْ أَنَّ يَغُودَ الْمَرِيضَ وَيَتَّبِعَ الْجَنَازَةَ وَيَشْهَدُ الْجُمُعَةَ إِذَا اسْتَرَطَ ذَلِكَ . وَهُوَ قَوْلُ سُفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ . وَقَالَ بَعْضُهُمْ لَيْسَ لَهُ أَنْ يَفْعَلَ شَيْئًا مِنْ هَذَا وَرَأَوْا لِلْمُعْتَكِفِ إِذَا كَانَ فِي مِصْرٍ يُجْمَعُ فِيهِ أَنْ لَا يَغْتَكِفَ إِلَّا فِي مَسْجِدِ الْجَامِعِ لِأَنَّهُمْ كَرِهُوا الْخُرُوجَ لَهُ مِنْ مُعْتَكِفِهِ إِلَى الْجُمُعَةِ وَلَمْ يَزُوا لَهُ أَنْ يَتْرَكَ الْجُمُعَةَ فَقَالُوا لَا يَغْتَكِفُ إِلَّا فِي مَسْجِدِ الْجَامِعِ حَتَّى لَا يَخْتِاجَ إِلَى أَنْ يَخْرُجَ مِنْ مُعْتَكِفِهِ لِعَبْرِ قَضَاءِ حَاجَةِ الْإِنْسَانِ لِأَنَّ خُرُوجَهُ لِعَبْرِ قَضَاءِ حَاجَةِ الْإِنْسَانِ قَطْعٌ عِنْدَهُمْ لِلِاغْتِكَافِ . وَهُوَ قَوْلُ مَالِكٍ وَالشَّافِعِيِّ . وَقَالَ أَحْمَدُ لَا يَغُودُ الْمَرِيضَ وَلَا يَتَّبِعُ الْجَنَازَةَ عَلَى حَدِيثِ عَائِشَةَ . وَقَالَ إِسْحَاقُ إِنْ اسْتَرَطَ ذَلِكَ فَلَهُ أَنْ يَتَّبِعَ الْجَنَازَةَ وَيَغُودَ الْمَرِيضَ .

80. Mbi namazin (vullnetar) gjatë ramazanit

باب مَا جَاءَ فِي قِيَامِ شَهْرِ رَمَضَانَ

806. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Muhammed b. Fudajli, ai ka transmetuar nga Davud b. Ebu Hindi, ai nga Velid b. Abdurahman el-Xhureshi, ai nga Xhubejr b. Nufejri – që Ebu Dherre, ka thënë: “E agjëronim ramazanin me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të). Ai me ne (përveç fardit të jadisë), nuk falte kurrfarë namazi tjetër deri në natën e njëzet e tretë (të ramazanit). Atëherë me ne është falur, gjithnjë derisa nuk kaloi një e treta e natës. Natën e njëzet e

⁹⁰² E shënojnë Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe.

katërt, me ne nuk fali asgjë, për t'u falur me ne në natën e njëzet e pestë, gjithnjë deri pas gjysmës së natës. Ne thamë: 'O i Dërguar i Allahut, sikur të doje ta kaloje edhe pjesën e mbetur të kësaj nate me ne në namazin vullnetar?' Pas asaj ai me ne nuk është falur, deri në natën e njëzet e shtatë të muajit. Natën e njëzet e shtatë është falur me ne, duke e thirrur familjen e vet dhe bashkëshortet e veta. Është falur me ne, aq sa që u frikësua që do të na ikte *Felah* (mirëqenia). 'E çfarë *Felah* (mirëqenia)?' – e pyeta unë: 'Ushqimi i mëngjesit (syfyri)' - tha ai."⁹⁰³ Ebu Isai, thotë: "Ky hadith është hasen-sahih."⁹⁰⁴

Dijetarët, janë ndarë në pikëpamje të numrit të rekateve të namazit vullnetar (të teravive) gjatë ramazanit. Disa konsiderojnë, që së bashku me vitrin duhet falur dyzet e një rekate. Ky është qëndrimi i dijetarëve të Medinës, të cilët ashtu e praktikonin në Medine. Shumica e dijetarëve, në pajtim me atë që është transmetuar nga Aliu, Umeri dhe as'habët e tjerë të të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), konsiderojnë, që duhet falur njëzet rekate. Ky është mendimi edhe i Sufjan eth-Thevriut, Ibn Mubarekut dhe i Shafiut.⁹⁰⁵ Shafi'u thotë: "Unë, kështu i kam takuar, që në qytetin tonë, Meke i falin nga njëzet rekate." Ahmedi, thotë: "Mbi këtë, janë transmetuar transmetime të ndryshme." – dhe ai mbi atë nuk ka shqiptuar kurrfarë gjykimi. Is'haku, thotë: "Ne u japim përparësi (atyre të cilët thonë) që duhet falur dyzet e një rekate, në bazë të asaj që është transmetuar nga Ubej b. Ka'bi." Ibn Mubareku, Ahmedi dhe Is'haku, e kanë zgjedhur qëndrimin, që gjatë ramazanit (namazin vullnetar) duhet falur pas imamit. Shafi'u konsideron, që personi i cili di të lexoj, duhet të falet i vetëm."

حَدَّثَنَا هَنَادٌ، حَدَّثَنَا مُحَمَّدُ بْنُ الْفَضِيلِ، عَنْ دَاوُدَ بْنِ أَبِي هِنْدٍ، عَنِ الْوَلِيدِ بْنِ عَبْدِ الرَّحْمَنِ الْجَرَشِيِّ، عَنْ جُبَيْرِ بْنِ نُفَيْرٍ، عَنْ أَبِي ذَرٍّ، قَالَ صُمْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَلَمْ يُصَلِّ بِنَا حَتَّى بَقِيَ سَبْعٌ مِنَ الشَّهْرِ فَقَامَ بِنَا حَتَّى ذَهَبَ ثُلُثُ اللَّيْلِ ثُمَّ لَمْ يَقُمْ بِنَا فِي السَّادِسَةِ وَقَامَ بِنَا فِي الْخَامِسَةِ حَتَّى ذَهَبَ شَطْرُ اللَّيْلِ فَقُلْنَا لَهُ يَا رَسُولَ اللَّهِ لَوْ تَقُلْنَا بِقِيَّةِ لَيْلِنَا هَذِهِ فَقَالَ " إِنَّهُ مَنْ قَامَ مَعَ الْإِمَامِ حَتَّى يَنْصَرِفَ كُتِبَ لَهُ قِيَامُ لَيْلَةٍ " . ثُمَّ لَمْ يُصَلِّ بِنَا حَتَّى بَقِيَ ثَلَاثٌ مِنَ الشَّهْرِ وَصَلَّى بِنَا فِي الثَّالِثَةِ وَدَعَا أَهْلَهُ وَنِسَاءَهُ فَقَامَ بِنَا حَتَّى تَخَوَّفْنَا الْفَلَاحَ . قُلْتُ لَهُ وَمَا الْفَلَاحُ قَالَ السُّحُورُ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ . وَاخْتَلَفَ أَهْلُ الْعِلْمِ فِي قِيَامِ رَمَضَانَ قَرَأَى بَعْضُهُمْ أَنْ يُصَلِّيَ إِحْدَى وَأَرْبَعِينَ رَكْعَةً مَعَ الْوُثْرِ . وَهُوَ قَوْلُ أَهْلِ الْمَدِينَةِ وَالْعَمَلِ عَلَى هَذَا عِنْدَهُمْ بِالْمَدِينَةِ . وَأَكْثَرُ أَهْلِ الْعِلْمِ عَلَى مَا رَوَى عَنْ عُمَرَ وَعَلِيٍّ وَغَيْرِهِمَا مِنْ أَصْحَابِ النَّبِيِّ ﷺ عَشْرِينَ رَكْعَةً . وَهُوَ قَوْلُ سَفْيَانَ الثَّوْرِيِّ وَابْنِ الْمُبَارَكِ وَالشَّافِعِيِّ . وَقَالَ الشَّافِعِيُّ وَهَكَذَا أَدْرَكْتُ بِبَلَدِنَا بِمَكَّةَ يُصَلُّونَ عَشْرِينَ رَكْعَةً . وَقَالَ أَحْمَدُ رَوَى فِي هَذَا الْوَأْنِ . وَلَمْ يَقْضَ فِيهِ بِشَيْءٍ . وَقَالَ إِسْحَاقُ بَلْ نَخْتَارُ إِحْدَى وَأَرْبَعِينَ رَكْعَةً عَلَى مَا رَوَى عَنْ أَبِي بِنِ كَعْبٍ . وَاخْتَارَ ابْنُ الْمُبَارَكِ وَأَحْمَدُ وَإِسْحَاقُ الصَّلَاةَ مَعَ الْإِمَامِ فِي شَهْرِ رَمَضَانَ . وَاخْتَارَ الشَّافِعِيُّ أَنْ يُصَلِّيَ الرَّجُلُ وَحْدَهُ إِذَا كَانَ قَارِئًا .

⁹⁰³ Ky është, njëri nga hadithet, mbi të cilët është mbështetur namazi teraviv. Sikur që shihet, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nuk e falte çdo natë namazin teraviv. Bënte ashtu, që njerëzit të mos mendonin se namazi teraviv është obligim. Në këtë hadith, është përmendur, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), në teravitë e para, që i ka falur natën e njëzet e tre të ramazanit, ka qëndruar gati deri në syfyri. Ndërkaq, në te, nuk është përmendur, se sa rekate i ka falur. Nga transmetimi të cilin e transmeton Xhabir b. Abdullahu, kuptojmë se i ka falur nga tetë rekate të namazit të vitrit.

⁹⁰⁴ E shënojnë edhe Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*.

⁹⁰⁵ Tirmidhiu, këtu, në pikëpamje të numrit të rekateve të namazit teraviv, i ka përmendur dy mendime: a) që teravitë, së bashku me vitrin, përbëhen nga dyzet e një rekate, b) që teravitë, përbëhen nga njëzet rekate. Përveç të përmendurave, ekzistojnë edhe një varg mendimesh, siç janë: që namazi teraviv, përbëhet nga tridhjetë e gjashtë rekate, tridhjetë e nëntë dhe namazi vitër, tridhjetë e katër, njëzet e tetë, njëzet e katër dhe njëmbëdhjetë rekate, së bashku me namazin e vitrit. Abdurrahman el-Mubarekfuri, konsideron, që mendimi më i qëndrueshëm, është i atyre, që konsiderojnë, se namazi teraviv, me namazin vitër ka njëmbëdhjetë rekate. Sipas mendimit të tij, asnjë mendim tjetër, nuk ka qëndrim të qëndrueshëm të mirë.

81. Mbi vlerat e atij i cili agjëruesin e fton në iftar

باب مَا جَاءَ فِي فَضْلِ مَنْ فَطَّرَ صَائِمًا

807. Na ka treguar Hennadi – atë e ka informuar Abdurahim b. Sulejmani, duke transmetuar nga Abdulmelik b. Ebu Sulejmani, ai nga Atai, ai nga Zejd b. Halid el-Xheheniu – që i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), ka thënë: “Kush e thërret agjëruesin në iftar, ka për të pasur shpërblimin e njëjtë, sikur ai (agjëruesi), duke mos e pakësuar shpërblimin e tij.” Ebu Isai, thotë: “Ky hadith është hasen-sahih.”⁹⁰⁶

حَدَّثَنَا هَنَّادٌ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّحِيمِ بْنُ سُلَيْمَانَ، عَنْ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ أَبِي سُلَيْمَانَ، عَنْ عَطَاءٍ، عَنْ زَيْدِ بْنِ خَالِدٍ الْجُهَنِيِّ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ " مَنْ فَطَّرَ صَائِمًا كَانَ لَهُ مِثْلُ أَجْرِهِ غَيْرَ أَنَّهُ لَا يَنْقُصُ مِنْ أَجْرِ الصَّائِمِ شَيْئًا " . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

82. Mbi nxitjen e faljes të nafileve gjatë ramazanit dhe vlerave të saj

باب التَّرْغِيبِ فِي قِيَامِ رَمَضَانَ وَمَا جَاءَ فِيهِ مِنَ الْفَضْلِ

808. Na ka treguar Abd b. Humejdi – atë e ka informuar Abdurrezaku, atë Ma'meri, duke transmetuar nga Zuhriu, ai nga Ebu Seleme – që Ebu Hurejre, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), nxiste në faljen e namazit vullnetar, por atë nuk e urdhëronte rreptësisht. Ai thoshte: ‘Kush e kalon ramazanin duke bërë namaz vullnetar, duke besuar fuqishëm dhe duke e shpresuar shpërblimin – atij kanë për t’iu falur mëkatet e bëra deri atëherë.’⁹⁰⁷ I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), është shpërngulur në ahiret, ndërsa ajo dispozitë⁹⁰⁸ edhe më tej ishte në fuqi. Gjithashtu, ajo ishte në fuqi edhe gjatë kohës së hilafetit të Ebu Bekrit dhe në vet fillimin e hilafetit të Umerit.”

Ebu Isai, thotë: “Mbi këtë temë është transmetuar hadithi edhe nga Aishja. Ky hadith është sahih.”⁹⁰⁹ Ai gjithashtu, është transmetuar edhe nëpërmjet Zuhriut – ai nga Urve, ai nga Aishja – nga i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të).”

حَدَّثَنَا عَبْدُ بْنُ حُمَيْدٍ، حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ، أَخْبَرَنَا مَعْمَرٌ، عَنِ الزُّهْرِيِّ، عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُرَغِّبُ فِي قِيَامِ رَمَضَانَ مِنْ غَيْرِ أَنْ يَأْمُرَهُمْ بِعَزِيمَةٍ وَيَقُولُ " مَنْ قَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ " . فَتَوَقَّي رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَالْأَمْرُ عَلَى ذَلِكَ ثُمَّ كَانَ الْأَمْرُ كَذَلِكَ فِي خِلَافَةِ أَبِي بَكْرٍ وَصَدْرًا مِنْ خِلَافَةِ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ عَلَى ذَلِكَ . وَفِي الْبَابِ عَنْ عَائِشَةَ . قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ صَحِيحٌ . وَقَدْ رَوَى هَذَا الْحَدِيثُ أَيْضًا عَنِ الزُّهْرِيِّ عَنْ عُرْوَةَ عَنْ عَائِشَةَ عَنِ النَّبِيِّ قَالَ أَبُو عِيسَى هَذَا حَدِيثٌ حَسَنٌ صَحِيحٌ .

⁹⁰⁶ E shënojnë, edhe Nesaiu dhe Ibn Maxhe në *Sunene*, e Ibn Hibbani dhe Ibn Huzejme në *Sahihë*.

⁹⁰⁷ Neveiu, thotë: “Është e njohur, që këtu falja ka të bëjë vetëm për mëkatet të vogla. Njëjtë mendon edhe Imami i dy Haremeve, ndërsa Ijadi pohon, që ai është qëndrimi i dijetarëve të ehli-sunnetit. Ibn Mundhiri konsideron, që këtu falja ka të bëjë edhe për mëkatet e mëdha, e edhe për të voglat.

⁹⁰⁸ Fjala është, mbi urdhrin, që njerëzit ta falin namazin teravih në shtëpi, ose në xhami, sipas vetes. Sikur që është e njohur, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), disa teravi i ka falur me xhematë, mandej e ka lënë popullin që të falej nëpër shtëpitë e veta individualisht. Atë e ka bërë nga frika, sikurse njerëzit të falnin teravitë sidomos me xhematë, që të mos kuptohej si farz. Praktika e këtillë, është mbajtur gjatë kohës së hilafetit të Ebu Bekrit. Mu atëherë, kur hilafetin e mori Umeri, e ka tubuar popullin dhe e ka urdhëruar Ubej b. Ka'bin, që ta udhëheq namazin e teravive. Që nga atëherë, namazi i teravive, përsëri filloi të falet me xhematë. Ashtu, Umeri r.a. e përtëriu sunnetin e të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) të faljes së teravive, duke e pasur parasysh atë, që namazin e teravive pas vdekjes së tij, më askush nuk ka mundur ta konsiderojë si namaz obligativë.

⁹⁰⁹ E shënojnë, Buhariu dhe Muslimi në *Sahihë*.

Tabela e përmbledhjes

XHAMI'US-SUNENI I TIRMIDHIUT جامع الترمذي	1
VËLLIMI I	1
KAPITULLI MBI NAMAZIN (vazhdim)	4
كتاب الصلاة	4
Kapitulli mbi vitrin	42
أَبْوَابُ الْوُثْرِ	42
Kapitulli mbi ditën e Premte - Xhumanë	62
كتاب الْجُمُعَةِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ	62
Kapitulli mbi bajramet	88
أَبْوَابُ الْعِيدَيْنِ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ	88
Kapitulli mbi udhëtimin	96
أَبْوَابُ السَّفَرِ	96
Kapitulli mbi Zekatin	136
كتاب الزكاة	136
Kapitulli mbi agjërimin	172
كتاب الصوم	172